

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Konferencë shkencore me rastin e
50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit

SHQIPJA STANDARDE SOT

Prishtinë, 17 nëntor 2022

Përgatiti për botim: akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues: Rexhep Ismajli, kryetar; Sabri Hamiti, anëtar; Gjovalin Shkurtaj, anëtar;
Kristina Jorgaqi, anëtare; Ethem Likaj, anëtar dhe Shkumbin Munishi, sekretar.



PRISHTINË
2023

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

Scholarly conference on the occasion of the
50th anniversary of the Orthography Congress

STANDARD ALBANIAN TODAY

Prishtina, 17 November 2022

Prepared for publication by: Academician Rexhep Ismajli

Organizing board: Rexhep Ismajli, President; Sabri Hamiti, member; Gjovalin Shkurtaj, member; Kristina Jorgaqi, member; Ethem Likaj, member and Shkumbin Munishi, secretary.

Editor: Academician Sabri Hamiti, Secretary of the Section of Linguistics and Literature.



PRISHTINA
2023

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Konferencë shkencore me rastin e
50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit

SHQIPJA STANDARDE SOT

Prishtinë, 17 nëntor 2022

Përgatiti për botim: akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues: Rexhep Ismajli, kryetar; Sabri Hamiti, anëtar; Gjovalin Shkurtaj, anëtar;
Kristina Jorgaqi, anëtare; Ethem Likaj, anëtar dhe Shkumbin Munishi, sekretar.

Redaktor: Akademik Sabri Hamiti, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.



PRISHTINË
2023

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

REXHEP ISMAJLI: FJALA E HAPJES E KONFERENCËS 11

MEHMET KRAJA: 50-VJETORI I KONGRESIT TË
DREJTSHKRIMIT 19

SKËNDER GJINUSHI: FJALA E PËRSHËNDETJES 21

KUMTESAT

REXHEP ISMAJLI: GJUHA SHQIPE SOT 27

ETHEM LIKAJ: GJUHA STANDARDE DHE REALITETE
GJUHËSORE 43

SABRI HAMITI: POEZIA E GJUHËS SHQIPE..... 49

CHRISTIAN VOSS: KRAHASIM MIDIS PLURICENTRIZMIT TË
SHQIPES DHE TË SLLAVISHTES SË JUGUT 30 VJET PAS
SHPËRBËRJES SË JUGOSLLAVISË 57

XHEVAT LLOSHI: RIBOTIMI I FJALORIT DHE I RREGULLAVE
TË DREJTSHKRIMIT 67

IMRI BADALLAJ: EDHE DIÇKA MBI PASKAJOREN GEGE TË
TIPIT *ME + PJESORE* 81

BARDH RUGOVA: IDEOLOGJIA E PRESKRIPTIVIZMIT –
RASTI I SHQIPES 87

KRISTINA JORGAQI: NEVOJA E NGUTSHME PËR REFORMË
NË DREJTSHKRIMIN E SHQIPE..... 99

SHEZAI RROKAJ: KAHE ZHVILLIMI TË SHQIPES STANDARDE PAS VITEVE '90 DHE DISA QASJE EPISTEMOLOGJIKE RRETH TYRE.....	113
LEDI SHAMKU-SHKRELI: A ËSHTË <i>SUI GENERIS</i> NEOSTANDARDI I SHQIPES? NJË VËZHGIM KONTRASTIV	135
VALTER MEMISHA: SHQIPJA STANDARDE DHE FJALORËT SHPJEGUES KOMBËTARË.....	143
GJOVALIN SHKURTAJ: “KULTURA E GJUHËS DHE SHOQËRIA SHQIPTARE SOT”	163
MEHMET HALIMI: RESPEKTIMI I ELEMENTEVE PËRBËRËS TË KULTURËS GJUHËSORE NË RADIOTELEVIZION	173
MIMOZA KORE: NORMA DHE PRIRJE TË GJUHËS SË SOTME STANDARDE	193
BERTON SULEJMANI: GJUHA SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT SOT	203
ARDIAN DOKA: SHQIPJA STANDARDE MES JAKOBINIZMIT DHE LIBERALIZMIT GJUHËSOR.....	213
SHKUMBIN MUNISHI: MBI NEVOJËN E MODERNIZIMIT TË GJUHËS SHQIPE	221
ALEKSANDËR RUSAKOV, MARIA MOROZOVA: STRUKTURA FJALËFORMUESE E LEKSIKUT TË SHQIPES	233
TOMORR PLANGARICA: MBI NEVOJËN E SHQYRTIMIT TË DUKURIVE LIGJËRIMORE TË SHQIPES SË SOTME PËRTEJ GJUHËSISË SË SISTEMIT, PËRMES KONCEPTEVE E METODOLOGJIVE TË PËRFTUARA NË SHKENCAT E LIGJËRIMIT	243
MIMOZA PRIKU: DISA MODELE TË REJA NË FJALËFORMIMIN E SHQIPEN STANDARDE DHE SHTRIRJA E TYRE.....	259
RAHMAN PAÇARIZI: STANDARDIZIMI I SHQIPES SI PROCES - PASKAJORJA DHE PJESORJA E SHKURTUAR.....	273

ALJULA JUBANI: INTEGRIMI NË BE DHE MUNGESA E NJË UDHËRRËFYESI PËR NORMËSIMIN TERMINOLOGJIK NË GJUHËN SHQIPE.....	283
ELSA SKËNDERI: IDEOLOGJIA NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT GJUHËSOR (RASTI I KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT)	297
ABDULLA REXHEPI: FORMIMI I NJË GJUHE STANDARDE SIPAS SAMI FRASHËRIT: RASTI I SHQIPES	327
SHPËTIM ELEZI: RRETH THJESHTIMIT TË RREGULLAVE NË NORMËN E SHQIPES STANDARDE	337
ROZANA RUSHITI: ÇËSHTJE TË ZBATIMIT TË NORMËS SINTAKSORE NË ADMINISTRATË.....	357
LINDA MËNIKU: VËSHTRIM KRAHASUES I (DREJT)SHKRIMIT TË FJALËVE TË AUTORËT E VJETËR DHE NORMATIVAVE DREJTSHKRIMORE NË SHEKULLIN XX	369
TEUTA TOSKA: PËRKTHIMET NË SHQIP TË TEKSTEVE FETARE (BIBLA DHE KURANI) DHE ÇËSHTJET E PARIMIT SIMBOLIK TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES.....	393
RINA ASANI: PRAPASHTESAT -M, -N(Ë), -TË TË PJESORES SË SHQIPES DHE VARIANTET E TYRE	405



Pjesëmarrës të Konferencës



Hapja e Konferencës

Akademik Rexhep ISMAJLI

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë

FJALA E HAPJES E KONFERENCËS

I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
Akademik Mehmet Kraja,

I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademik
Skënder Gjinushi,

Kolege dhe Kolegë të dashur,

Miq të pranishëm,

Jemi mbledhur në këtë konferencë shkencore të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, me tematikën SHQIPJA STANDARDE SOT, që me pjesëmarrje kështu të gjerë në tubim pune të shënojme 50-vjetorin e zhvillimit me rëndësi themelore në historinë e planifikimit gjuhësor ndër shqiptarë, të KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE. Më lejoni që me këtë rast solemn të rikujtoj disa nga shënimet themelore për Kongresin dhe diçka që ndërlidhet me rrethanat e kohës.

Pesëdhjetë vjet më parë, nga 20 deri më 25 nëntor 1972, në Tiranë, *“me iniciativën e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës”*, u mbledh *“forumi më i lartë shkencor në shkallë kombëtare për të diskutuar e për të marrë vendime të rëndësishme për drejtshkrimin e gjuhës së sotme shqipe dhe në një vështrim më të gjerë për çështje që lidhen me normën letrare”*. Kongresi i zhvilloi punimet në mjediset e Kuvendit Popullor të Shqipërisë me pjesëmarrje të *“87 delegatëve nga të gjitha rrethet e vendit, përfaqësues të shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi – në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, si dhe të arbëreshëve të Italisë”*. Prej tyre 75 nga Republika Shqipërisë, 7 nga Kosova, 3 nga RS e Maqedonisë, 1 nga RS e Malit të Zi dhe 1 nga arbëreshët e Italisë. Nuk kishte përfaqësues të arbërorëve (arvanitëve) të Greqisë as të diasporës tjetër. Në Kongres ishin të pranishëm *“udhëheqës të Partisë e të Shtetit, shokët Enver Hoxha, Abdyl Këllezi, Adil Çarçani, Kadri Hazbiu, Koço Theodhosi, Manush Myftiu,*

Mehmet Shehu, Ramiz Alia, Rita Marko, Spiro Koleka, Pilo Peristeri, Pirro Dodbiba, Xhafer Spahiu, nënkryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Shqfjet Peçi, anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë, të presidiumit të Kuvendit Popullor, të Qeverisë dhe shokë të tjerë” nga Republika Popullore e Shqipërisë. Ishin të pranishëm ndër delegatë studiues të gjuhës shqipe, pedagogë, mësues të gjuhës shqipe e të letërsisë në nivele të ndryshme, shkrimtarë, publicistë, punonjës të ndërmarrjeve e të enteve botuese, veteranë të arsimit, etj. Punimet i ndoqën edhe “*mbi treqind pjesëmarrës e të ftuar, që punojnë në fusha të ndryshme të veprimtarisë së gjuhës së shkruar shqipe brenda e jashtë atdheut*”, studiues e lëvrues të gjuhës shqipe, mësues, shkrimtarë, gazetarë (ndër ta edhe nga Kosova) dhe studiues albanologë nga RD e Gjermanisë, Franca, Bullgaria.

Fjalën e hapjes e mbajti Ministri i arsimit dhe i kulturës i Republikës Popullore të Shqipërisë Thoma Deliana, ndërsa në dy seanca plenare Prof. Androkli Kostallari lexoi referatin “*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa problem themelore të drejtshkrimit të saj*”. Në seancën plenare të pasdites, të drejtuar nga rektori i USHT-së Agim Mero, u mbajtën kumtesat nga Prof. Mahir Domi, Prof. Eqrem Çabej, Prof. Idriz Ajeti, Prof. Bedri Dedja, Prof. Dhimitër Shuteriqi, Mr. Remzi Nesimi dhe Doc. Anastas Dodi. Komisioni organizues i Kongresit kishte 19 anëtarë, prej tyre 2 nga Kosova 1 nga Maqedonia e 1 arbëresh). Komisioni për hartimin e projektrezolutës përbëhej nga 15 anëtarë (prej tyre 1 nga Kosova, 1 nga Maqedonia dhe 1 arbëresh). Fjalën e mbylljes e mbajti Prof. Androkli Kostallari. Në seancën e fundit plenare të Kongresit morën pjesë po ashtu “*shokët Enver Hoxha, Adil Çarçani, Hysni kapo, Kadri Hazbiu, Manush Myftiu, Mehmet Shehu, Ramiz Alia, Pirro Dodbiba, Xhafer Spahiu, anëtarë të Komitetit Qendror të PPSH, të presidiumit të Kuvendit Popullor, të Qeverisë e shokë të tjerë*”. Aty “*u nënshkrua Rezoluta e Kongresit, e cila u miratua njëzëri*”.

Rezoluta e miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe shpalli: “*populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar*”, që si bazë ka *Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe të vitit 1967*. Në të, përveç 8 pikave parimore për drejtshkrimin dhe kërkesës për hartimin e mjeteve themelore, jepej porosia që zgjidhja të bëhej me sistem, “*jo vetëm brenda nën-sistemeve të gjuhës, por duke pasur parasysh edhe lidhjet midis këtyre nën-sistemeve*”. Në fund shprehej dhe mendimi se “*duke marrë parasysh*

ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si edhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, Rregullave të drejtshkrimit t'u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura". Në Rezolutë jepej thirrja për shtresat e ndryshme që "ta pasurojnë e ta ngrenë gjithmonë më lart gjuhën tonë letrare kombëtare".¹ Në ndjekje të vendimeve të Kongresit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (e sapothe-meluar), ku u përfshi Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në Tiranë më 1973 botoi veprën *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* (hartuar nga Komisioni: Prof. Androkli Kostallari (Kryetar), Prof. Mahir Domi, Prof. Eqrem Çabej, B. sh. Emil Lafe), ndërsa në Prishtinë kjo vepër doli më 1974 në botim të Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Më 8 mars 1974 Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë nxori Vendimin "Mbi masat për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe" të nënshkruar nga Kryetari i Këshillit të Ministarve Mehmet Shehu,² që me arsenalin mobilizues, ideologjik, patriotik, qytetar, shtetëror, urdhëronte zbatimin konsekuent të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe "si mbështetje kryesore teorike e praktike për përvetësimin e për kristalizimin e mëtejshëm të normës së gjuhës letrare kombëtare dhe për zbatimin e kësaj norme në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore e shoqërore". Urdhërohej të jepej provimi për drejtshkrimin e njësuar brenda viteve 1974-75, të zbatohet "detyrimisht norma e gjuhës letrare kombëtare në mbështetje të drejtshkrimit të njësuar në të gjitha botimet dhe në institucionet kulturore që kanë të bëjnë me trajtën e saj të folur". Urdhërohej po ashtu të merreshin masa që punonjësit e botimeve, të teatrove, të estradave, të kinematografisë, të radiotelevizionit e të institucioneve të tjera kulturore "të përvetësojnë në mënyrë të organizuar e të kontrolluar drejtshkrimin e njësuar dhe normën e gjuhës letrare kombëtare".

Vendime të natyrës administrative të organeve shtetërore apo të institucioneve të KSA të Kosovës, të RS të Maqedonisë, të RS të Serbisë dhe të RS të Malit të Zi, apo të nivelit federal të RFS të Jugosllavisë nuk ka pasur.

¹ Të gjitha shënimet dhe citimet e mësipërme janë marrë nga: *Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972 I*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1973, ff. 9-41.

² Mbi masat për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe, te *Studime filologjike*, 2 1974, Tiranë, ff. 3-6.

Në këto instanca Kongresi është konsideruar veprimtari shkencore-kulturore, në të cilën kanë marrë pjesë dhe përfaqësues të institucioneve përkatëse nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë. Ngjashëm ishte trajtuar edhe Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e vitit 1968, me dallimin që të nesërmen e përfundimit të punimeve të Konsultës delegacionin e saj e kishte pritur Fadil Hoxha, kryetar i Kuvendit të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës dhe me atë rast e kishte shprehur miratimin dhe mbështetjen e tij për vendimet e Konsultës dhe kishte thënë se tash duhej “*me kalue në zbatimin konkret*”. Në Kongresin e Drejtshkrimit nga Kosova dhe ish-Jugosllavia merrte pjesë si delegat edhe Ismail Bajra, drejtor i NBGB Rilindja (por në atë kohë ai ishte dhe funksionar i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues). Të tjerët ishin përfaqësues institucionesh shkencore-arsimore, kulturore e botuese. Fadil Hoxha, në një intervistë të botuar pas vdekjes kishte thënë se pjesëmarrësit e Kongresit të Drejtshkrimit nga Kosova kishin shkuar në Tiranë me miratimin e niveleve të larta politike.³ Nga Maqedonia si delegatë merrnin pjesë Petro Janura (Drejtor i Degës së Gjuhës Shqipe në Universitet) dhe Sefedin Sulejmani, drejtor i Flakës së vëllazërimit.

Vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit në Kosovë dhe ndër shqiptarët e ish-Jugosllavisë janë respektuar me entuziazëm nga institucionet shkencore, nga institucionet arsimore në të gjitha nivelet, nga institucionet e botimeve dhe të shtypit e të kulturës (zbatimi i rregullave të drejtshkrimit sipas versionit të vitit 1967 kishte nisur qysh më 1968). Megjithatë, nuk ka pasur vendime të tipit të dekretëve qeveritare. Kuptohet që entuziazmi i popullatës për vendimet e Kongresit ka luajtur rol me shumë rëndësi.

Sa i përket vetë korpusit të gjuhës standarde, në Kosovë dhe në tërë ish-Jugosllavinë vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit duhej të zbatoheshin në rrethana të statusit të ndryshëm të gjuhës standarde si gjuhë e kombësisë (minoritetit) në raport me atë të Shqipërisë, pra të ndryshëm sa i përket statusit

³ “Prej fillimit kemi qenë për unifikimin e gjuhës. Kjo është arritur në Kongresin e gjuhëtarëve në Shqipëri më 1972. Prej nesh kanë qenë në Kongres profesorë e intelektualë të tjerë me lejen tonë, jo me leje të shkruar; por me pajtimin tonë. Para se të shkonin shokët tanë në Shqipëri, u mora vesh me Petar Stambolliqin. ... Aty u bisedua se a ka ndokush mendim tjetër. Të gjithë jemi pajtuar që të kemi një gjuhë të njëjësuar.”, *Fadil Hoxha në vetën e parë*, shënimet dhe prathënia e V. Surroit, Koha, Prishtinë, 2010, f. 325.

të gjuhës standarde. Kjo ndërlikohet me raportet e dygjuhërisë (diku-diku edhe të diglosisë) me serbokroatishten/ maqedonishten; pak më e ndërlikuar shfaqej gjendja në Luginën e Preshevës apo në Malin dhe Zi dhe në Republikën e Maqedonisë, ku shqipja standarde kishte hapsirë më të ngushtuar përdorimi. Kuptohet, në rrethanat e komunikimeve krejtësisht të kufizuara e të kontrolluara me Shqipërinë, i tërë ky projekt duhej të realizohej në mbështetje të formës së shkruar dhe pa kontakte me bazën e përzgjedhur organike të standardit (pos sporadikisht në Maqedoni).

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore ka pasur veprimtari dhe ndërmarrje për reforma drejtshkrimore në Tiranë fillimisht për të dy variantet (1948, 1951, 1956), pastaj vetëm mbi bazën e toskërishtes - 1967), ndërsa në Prishtinë vetëm mbi bazë të gegnishtes (së përgjithshme, 1952, 1957 dhe 1964). Pas Konsultës Gjuhësore të Prishtinës 1968 dhe sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit 1972 flitej për *gjuhën e njësuar letrare, gjuhën e përbashkët të njësuar letrare, gjuhën e njësuar letrare kombëtare*, ndërsa më vonë thjesht për *gjuhën e përbashkët letrare* dhe më në fund për *gjuhën standarde*. Ndryshe nga dekadat e mëparme, tash e tutje veprat standardizuese (*Drejtshkrimi, Drejtshqiptimi, Shenjat e pikësimit, Gramatika, Fjalori drejtshkrimor dhe Fjalori i gjuhës shqipe*) do të hartoheshin nga institucionet në Tiranë dhe pa pjesëmarrje të tjerëve jashtë RP të Shqipërisë.

Në historinë e zhvillimeve në fushën e planifikimit gjuhësor, i cili, me fjalët e sociolinguistit Joshua Fishman, “*është edhe planifikim i kombësisë*”, po ndodhte kthesa themelore, gjithnjë përtej ndarjeve të imponuara shtetërore mbi 60-vjeçare, po jetësohej heqja dorë nga planifikimet pluricentrike, që, për pjesën këndeje kufirit, me elan të fuqishëm dhe me vendim të njëanshëm, kishte ndodhur 4 vjet më parë në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës: ndryshe nga dekadat e mëparme, tash e tutje në zhvillimet e planifikimit gjuhësor ndër shqiptarë nuk do të kishte më pluricentrizëm.

Mbetej, ndërkaq, realiteti i zbatimit të vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit në rrethana dukshëm të ndryshme në Republikën Socialiste të Shqipërisë, ku çdogjë realizohej sipas direktivave të Vendimit qeveritar të nënshkruar nga Kryeministri Mehmet Shehu dhe me angazhimin e drejt-përdrejtë të të gjitha instancave të arsimit në të gjitha nivelet, të institucioneve kulturore e të shkencës, të mjeteve të informimit të shkruar, të folur dhe

radio-televiziv, ndërsa në RSF të Jugosllavisë, konkretisht në Krahinën Autonome Socialiste të Kosovës kishte vullnet për implementimin e vendimeve të Kongresit në rrafshin e gjuhës së shkruar, ndërsa të folur kryesisht në situatat formale-zyrtare, në radio e televizion, në ligjërata mbisundimisht të albanologëve. Mund të thuhet se në mësimdhënie kishte evaluim të përdorimit të gjuhës së njësuar letrare kryesisht në mësimet e gjuhës dhe të letërsisë. Mësuesit e këtyre sektorëve kishin marrë sadopak formim, ndërsa të tjerët më pak. Kishte një numër profesorësh të shkollave të mesme që formimin universitar e kishin marrë në gjuhë të tjera (serbokroatisht, maqedonisht apo ndonjë gjuhë tjetër jashtë Kosovës). Në nivelin universitar kjo ndodhte më shpesh.

Vullneti i shprehur në Kongresin e Drejtshkrimit dhe më herët në Konsultën Gjuhësore të prillit 1968 ishte mbështetja kryesore për implementimin e vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit. Të gjitha mjetet e komunikimit publik tashmë po i zbatonin në parim vendimet e Konsultës 1968 dhe menjëherë edhe të Kongresit 1972. Formalisht i tërë sistemi shkollor i mbështeste ato vendime. Kishte përpjekje konkrete organizimi në të gjitha instancat, ashtu siç kishte vështirësi, sidomos në rrafshin e komunikimit publik gojor. Në shumë raste nëpër shkolla zbatimi i vendimeve të Kongresit mbeti kryesisht detyrë e përgjegjësve të lëndëve mësimore të gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Kështu vullneti i pjesëmarrësve në komunikimet formale publike ishte shumë i rëndësishëm për zbatimin e vendimeve, ndërsa përgatitja e brezave të mëparmë të pjesëmarrësve në procesin arsimor jo çdo herë ishte e mjaftushme për këtë ndërmarrje. Çdo gjë ndihmohej me shërbime plotësuese të lektorëve (redaktorëve gjuhësorë), të cilët kishin një rol edhe në mjetet e shkruara të informimit, edhe në radio e televizion e teatër, ashtu si në shërbimet e administratës. Procesi mori shpesh kahje formale, u përqendrua te gjuha e shkruar. Në mjedise më të largëta nga Prishtina, si në RS të Maqedonisë, në RS të Malit të Zi dhe në Luginën e Preshevës kishte edhe më shumë formalizëm në zbatimin e atyre vendimeve dhe shpesh shumë më pak mundësi përdorimi. Në dekadat e mëvona pati ngushtime të tjera për përdorimin publik të shqipes në shkolla, botime, radiotelevizione, në punë, etj. Proceset, në këtë mënyrë u kapluan nga zhvillime të ndryshme, dhe e tëra shoqërohej edhe me statusin jo të njëjtë të shqipes në raportet e bilinguizmit që karakterizonte tërë hapsirën e folësve të shqipes në

Jugosllavi (më vonë të përjashtimit të shqipes nga përdorimet e atilla). Rrethanat e ndryshme, raportet jo të njëjta lidhur me idiomën organike që ishte bazë e shqipes së njësuar letrare, dhe qasjet e ndryshme ndaj procesit të zbatimit të vendimeve, në realitete të ndryshme shoqërore-politike, të gjitha këto janë reflektuar drejtpërdrejt në rrjedhat e përvetësimit të shqipes së njësuar letrare kombëtare dhe në realitetet e sotme gjuhësore në hapsirat ku flitet shqipja. Vetëm pas viteve '90 të sh. XX pati mundësi më të gjera komunikimi të drejtpërdrejtë me folës organikë të shqipes së jugut e pastaj edhe të shqipes standarde të kryeqytetit. Diaspora tani më ishte përfshirë në lëvizje e dinamizëm të theksuar për pasojë shpërnguljesh nga Shqipëria e nga Kosova. Kongresi mëtonte të ishte në nivel të përfaqësimit gjithëpërfshirës për bashkësinë e folësve të shqipes brenda hapsirave politiko-shoqërore të shqiptarëve në Ballkan (mbetej dukshëm jashtë këtyre rrjedhave, qoftë dhe vetëm formalisht, diaspora ballkanike arbneshe dhe arbërore (arvanite)). Mund të jetë që hamendësimi për gjendjen e gjuhës tashmë obsolete në ato mjedise do të ketë qenë baza për këtë mospërfshirje. Edhe më e dukshme ishte mospërfshirja e diasporës së paorganizuar në Turqi e vende të tjera. Ndërkaq, diaspora tjetër, ajo që ia kishte dalë të vijonte veprimtarinë kulturore dhe të shkruar jashtë Shqipërisë dhe Jugosllavisë, gjithsesi politikisht në konfront me zhvillimet mbisunduese socialiste-komuniste në Ballkan, nuk ishte pajtuar me ato rrjedha dhe kishte vijuar përdorimin e shqipes së shkruar në gjendjen para këtij standardizimi (të standardizimeve të mëhershme). Vazhdonte botimet në ato variante dhe pati dhe kundërshtime të nyjëtura, si ai nga Stambolli i Tahir Kolginit, nga Amerika i Arshi Pipës, nga Gjermania i Martin Camajt, etj.

Funksionimi relativisht i mbyllur i bashkësisë së folësve të shqipes brenda dy tërësive të mëdha me orientim të deklaruar socialist-marksist (gjithsesi me dallime në konceptimet dhe në ritmet e zhvillimeve kulturo-historike e gjuhësore në periudhën pas vitit 1912), e bëri më të lehtë procesin e përhapjes së vendimeve, por la prapa dallime në raport me diasporën.

Vitet '90 me zhvillimet kaotike në Shqipëri dhe me përjashtimin e shqipes e të shqiptarëve nga hapsirat publike të organizuara e shtetërore në Kosovë e ish-Jugosllavi sollën gjendje të re. U shtuan diskutimet në një gjerësi të madhe. U mbajtën disa konferenca jubilarë për Kongrersin e Drejtshkrimit, të tjera për Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, konferenca për

shqipen standarde si ajo e Durrësit 2010, etj. Në këtë zgjerim të diskutimeve, porse, nuk ka pasur tendenca për hartimin e paautorizuar të mjeteve themelore për gjuhën standarde. Më 2005 u themelua Këshilli NdërkademiK për Gjuhën Shqipe me seli alternative Tiranë-Prishtinë, i cili në një sërë diskutimesh u mor me çështje të rishikimit të drejtshkrimit dhe me çështje të tjera nga fusha e gjuhës standarde. Vendimet e KNGJSH-së janë bërë të njohura publikisht në kohën kur janë marrë dhe pritet të botohen sërish bashkë me propozimet e grupeve përkatëse për diskutim, por nuk kanë qenë institucionalisht obligative.⁴

Historiku pesëdhjetëvjeçar i përdorimit të shqipes standarde në mjediset e ndryshme të bashkësisë së folësve të shqipes ka qenë i pabarabartë dhe me variacione jo të vogla në varësi të drejtpërdrejtë nga rrethanat shoqërore, nga kontekstet shtetërore në të cilat janë ndodhur pjesë të kësaj bashkësie, ashtu si nga lëvizjet e tjera shoqërore-ekonomike përcaktuese për vetë fatet e bashkësisë.

Shqyrtimi dhe studimi i gjendjes së shqipes standarde në rrethanat e saj të sotme përballet jo vetëm me gjendjen aktuale, por edhe me tërë këtë histori pesëdhjetëvjeçarë të shtrirë në hapsira që shkojnë larg përtej vetëm çështjeve të standardit. Uroj të kemi mjaftueshëm zell dhe durim mirëdashës që në tërë këtë ditë në seancat e përbashkëta dhe të ndara të kësaj konference shkencore të merremi me shqyrtimet e çështjeve që na dalin përpara sot, kuptohet në frymën e kritikës ndërtuese dhe të shqyrtimeve esull.

Ju faleminderit.

⁴ Ka pasur, ndërkaq, një rast të botimit të *Fjalorit drejtshkrimor* (nga autorët Ali Dhrimo dhe Rami Memushaj), me çka është hapur mundësia që edhe të tjerë të merren me dokumente të tilla, deri atëherë të hartuara vetëm nga komisione të autorizuara.

Akademik Mehmet KRAJA

Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

50-VJETORI I KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT

Të nderuar miq, akademikë, dhe të tjerë të pranishëm!

Shumica që jemi këtu, i takojmë gjeneratës së idealistëve, të cilët gjuhën letrare shqipe e kanë konsideruar dhe vazhdojnë ta konsiderojnë si më të madhen vlerë, e cila krijon njësinë tonë kombëtare të unitetit dhe identitetit. Kombi ynë është komb gjuhësor, para së gjithash!

Ky idealizëm i gjeneratave tona ka qenë i pranishëm gjerësisht në Kosovë dhe të paktë kanë qenë ata që gjuhën letrare shqipe nuk e kanë konsideruar si parashenjë të një kombi të bashkuar.

Ishte ky një idealitet, që kushtëzoi për një kohë të gjatë entuziazmin e zbatimit të standardit në rrethana të vështira gjuhësore për Kosovën, kur gjuha shqipe ishte gjuhë e dytë, në një shtet që i diskriminonte gjerësisht folësit e saj.

Natyrshet, vështirësitë me të cilat është përballur Kosova në zbatimin e standardit, vështirësi shtesë, kanë qenë të mëdha dhe kjo, herë pas here, *e ka dvarë* entuziazmin e orëve të para, prandaj ka qenë e natyrshme që të shfaqeshin dilema dhe skepticizma: po vihej në përdorim një gjuhë letrare, me të cilën Kosova nuk ishte familjarizuar ende.

Ky lloj skepticizmi ndonjëherë shpërqendroi vëmendjen e folësve dhe të shkruësve të gjuhës, por edhe të gjuhëtarëve herë pas here, të cilët sikur i shpërndërruan kauzat: e konsideruan më të rëndësishëm revidimin e standardit se vetë standardin; më të rëndësishme mbështetjen e “skizmës gjuhësore” sesa vetë kodit që i referoheshin.

Pra, dua të them se mund të ketë pasur dhe mund të ketë akoma përpjekje agresive për ta reviduar standardin, për ta përdorur faktin që tos-kërishtja është vendosur në bazë të standardit dhe për ta përdorur paskajoren si “*mea culpa*” për të gjitha dështimet.

Në Kosovë ka pasur dhe ka akoma shkrimtarë që nuk e kanë njohur

në masën e mjaftueshme gjuhën letrare shqipe, siç ka në Shqipëri shkrimtarë, folës dhe shkruer publikë që e kanë skematizuar gjuhën letrare, duke e privuar atë nga abstraksioni dhe depërtimet meditative. Por kjo nuk ka qenë dhe nuk është as sot arsye që letërsia jonë shqipe të mos e çojë njësinë e gjuhës së unifikuar përtej skemës recidiviste të mohimit dhe refuzimit të ndërsjellë. Jemi popull i vogël dhe nuk bëjmë dot dy letërsi, dy gjuhë, pavarësisht se kemi arritur të bëjmë dy shtete. Nuk kemi pse ta bëjmë gjuhën dhe letërsinë po aq të vështirës, siç e bëjmë politikën dhe historinë e saj.

Luigj Gurakuqi, në një çast të vështirë të jetës së tij, e kishte shqiptuar një mesazh me këto fjalë: *Me kenë me pasë me mujt me shku me i thanë me ardhë me m'pa!*

Mbase sot mund të themi (me mënyrën e tij) diçka ngjashëm: *Me kjenë me pasë mujt me iu thanë do miqve tonë a kishit mujt me na lanë me folë e me shkruer gjuhën tonë ashtu si na vjen ma mirë dhe ma mbarë, pa i fut gverret dhe inatet e veta gjithsecili!*

Ju faleminderit për vëmendjen!

Akademik Skënder GJINUSHI

Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë

FJALA E PËRSHËNDETJES

I nderuar akademik Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës;

Të nderuar akademikë e profesorë; gjuhëtarë, shkrimtarë e perkthyes; albanologë, studiues të gjuhës shqipe;

Ne sapo kemi kremtuar dy ngjarje me rëndësi: 50-vjetorin e themelimit të Akademisë së Shkencave dhe 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit.

Dëshiroj të falënderoj Kryesinë e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për bashkëpunimin e ngushtë në organizimin e tyre dhe për nderimin me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të saj në këto dy aktivitete.

Sigurisht, këto nuk janë dy data rastësisht afër njëra-tjetrës, por janë përmbyllje e dy proceseve të rëndësishme në zhvillimin e një shoqërie; janë tregues të arritjes së një stadi të ri zhvillimi të vetë shkencës e inteligjencës shqiptare, veçanërisht të shkencave albanologjike. Janë po këto procese që kishin çuar në krijimin e Universitetit të Tiranës e më pas në krijimin e Universitetit të Prishtinës dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Me rastin e krijimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë prof. Aleks Buda deklaronte se “ky është një cak në zhvillimin e një kombi”, ndër- sa, po në vitin 1972, me rastin e organizimit të Kuvendit të Parë të Studimeve Ilire, Eqrem Çabej deklaronte se me këtë ngjarje u dëshmuua se “albanologjia qe kthyer në shtëpinë e saj”. Është kjo shkallë pjekurie e albanologjisë shqiptare; ishte kjo plejadë studiuesish me dijetarë të tillë me njohje ndërkombëtare, si Eqrem Çabej, Idriz Ajeti, Aleks Buda, Ali Hadri, Besim Bokshi, të cilët, ashtu siç arritën të bëjnë të pranueshme e përcaktuese ndërkombëtarisht tezat për origjinën e popullit shqiptar, për lidhjen iliro-shqiptare, për origjinën e lashtësinë e gjuhës shqipe dhe afërsinë e dialekteve

kryesore të saj, ashtu ndërmorën edhe hapin e njësimimit të gjuhës shqipe.

Natyrisht njësimi i gjuhës nuk u bë në një ditë, ndaj, kur kremtojmë 50-vjetorin e kongresit të vitit 1972, është një rast e detyrim për të vlerësuar e shprehur mirënjohjen tonë për tërë ato ngjarje historike, që i paraprinë, përgatitën e çuan në këtë vendimmarrje, që nga akademia e ipeshkvijve, Kongresi i Manastirit, Komisia Letrare e Shkodrës, deri tek Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e vitit 1968; për të gjithë ata që kontribuan me mendimin e dijen e tyre, që nga mendimtarët rilindës deri te dijetarët e shekullit të kaluar.

Vetë rruga që përshkoi gjuha shqipe deri tek njësimi flet për një bashkëpunim të ngushtë dhe pa paragjykime midis intelektualëve shqiptarë në Shqipëri e në Kosovë. Vendimet që mori Kongresi i Drejtshkrimit u ngjizën në Prishtinë. Dhe kjo nuk është rastësi. Ashtu si kërkesa për pavarësi u ngjiz në Prizren dhe u shpall në Vlorë, edhe për njësimin e gjuhës shqipe vendimi u ngjiz në Prishtinë e u shpall në Tiranë, i parë ky si hap i parë drejt bashkimit e afrimit shqiptar.

Sot, pas 50 vjetësh, ne shohim me kënaqësi se kjo vepër historike e protagonistëve dhe figurave emblematike të dy akademive tona i rezistoi kohës. Gjuha letrare shqipe i ka dëshmuar tashmë tërë cilësitë e saj si funksione e si pasuri veçanërisht në periudhën e fundit, me hapjen që pati letërsia shqipe, sidomos në Shqipëri pas mbylljes ideologjike dhe në Kosovë pas diskriminimit e kufizimeve etnike në arsim e kulturë, kohë kur letërsia e gjuha u ballafaquan me gjithë gjuhët e mëdha, nëpërmjet veprave të shkrimtarëve tanë.

Norma letrare është përqafuar jo vetëm nga specialistët e fushës, por nga tërë gjeneratat e reja, gjatë arsimimit të tyre në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi, ku shqiptarët mësojnë të shprehën e shkruajnë pa asnjë vështirësi në gjuhën e njësuar. Efekt i njësimimit gjuhësor është qartësisht lehtësimi e rritja e komunikimit midis tyre pa dallime krahnore, kjo edhe për faktin se dallimet midis dialekteve historikisht nuk kanë qenë thelbësore.

Për rëndësinë që ka gjuha letrare, për faktin që ajo tashmë është gjuhë zyrtare në Shqipëri, Kosovë e në Maqedoninë e Veriut, dy akademitë tona kanë për mision e përgjegjësi për mbarëvajtjen dhe mbrojtjen e saj.

Mbarëvajtja e normës është detyrë e Këshillit Ndërkademiç të Gjuhës Shqipe, sepse gjuha është një qenie e gjallë, që zhvillohet, pasurohet, normësohet. Është detyrë e gjuhëtarëve t'i ndjekin këto procese e t'u dalin përpara tendencave për çmontim të gjuhës letrare, që janë të papranueshme, ndonëse e të pamundura jo vetëm shkencërisht, por edhe politikisht; ashtu sikurse dhe nga paprekshmëria, që krijon objektivisht refleksin e kundërt.

Nuk jam specialist, por më duket se gjuha letrare, produkt i një stadi të caktuar të zhvillimit të dialekteve të një gjuhe, është ashtu si fëmija që, ndërsa bart gjakun dhe ADN-në e të dy prindërve, gjyshërve e farefisit, si rregull më shumë i ngjan njërit prej të dyve. Por, pavarësisht nga kjo, nuk ka prind që do ta mohonte fëmijën për këtë shkak. Ndërkohë, fëmija, pavarësisht kujt i ngjan më shumë në pamje të jashtme, duhet të shprehë të njëjtën dashuri e kujdes ndaj prindërve e gjyshërve, duhet të jetë njëlloj i hapur në përthithjen e edukatës e zakoneve të mira. Ky duhet të jetë edhe qëndrimi ndaj gjuhës letrare e raporti i saj me dialektet.

Ne përshëndesim faktin se gjatë konferencës që u mbajt në Tiranë folësit shprehën këtë vlerësim e qëndrim ndaj gjuhës së njësuar, si gjuhëtarët, edhe politikanët në emër të institucioneve, që nga Arbëria, Maqedonia e Veriut, Kosova e Shqipëria. Ishte i rëndësishëm edhe shqiptimi i qeveritarëve, sepse gjuhëtarëve dhe akademivë u takon mbrojtja shkencore e mirëmbajtja e normës gjuhësore, ndërsa qeveritë kanë për detyrë mbrojtjen administrative e mirëpërdorimin e saj.

Kur flasim për mbrojtje është fjala për kërcënimin e gjuhës nga barbarizmat, nga ndikimet e gjuhëve të huaja e i teknologjisë së informacionit, nga humbja e gjuhës prej emigrantëve, probleme të cilat duhen përballuar, ndërkohë që gjuha mbetet faktor kryesor i identitetit shqiptar.

Vetë proceset e globalizimit e të integritimit nxisin proceset njësuëse, ne kemi zgjedhur rrugën e integritimit evropian, proces i cili fillon nga integritimi i vetë shqiptarëve, nga heqja e çdo kufiri shtetëror a gjuhësor midis tyre, pasi edhe sipas kërkesave e standardit të Bashkimit Evropian atje do të hyjmë me një gjuhë, me gjuhën e njësuar, gjuhën e integritimit evropian. Të gjitha këto do të trajtohen më me kompetencë nga pjesëmarrësit në këtë konferencë.

Ju uroj mbarësi, ju falënderoj për vëmendjen.

K U M T E S A T

Akademik Rexhep ISMAJLI

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë

GJUHA SHQIPE SOT

Le të pyesim menjëherë: *Ç'është gjuha shqipe sot?* dhe le të shprehim një përgjigje të shlrë, që mund të gjendet gjithandej për gjuhë të ndryshme: gjuha shqipe sot është i tërë potenciali shprehjor i bashkësisë gjuhësore shqipe. Ky potencial gjallon nëpër shtresa të shumta, si në të folmet organike vendore, në fenomene në kapërcyell midis të folmesh të ndryshme, në të folme qytetesh, në vernakularë e zhargone, e deri te manifestimi i gjuhës standarde me ndërlihdjet e ndërvarësitë e saj me aspekte të gjuhës shqipe, me manifestimet e saj pak a shumë formale në rrethet e arsimuara, krejtësisht formale në komunikimet zyrtare dhe në korrespondencat e punës, në letërsinë e shkruar të sotme me të gjitha varietetet e saj, në tërë letërsinë e shkruar në historinë e saj qysh nga libri i parë i njohur "Meshari" i Gjon Buzukut 1555, nëpër variantet e njohura si geqe veriperëndimore, verilindore, elbasanase, gegnishte e përgjithshme, arbëreshe, arvanite, arbneshë, në krijimet folklorike të moçme e të reja, që gjëllin edhe në diasporë e nëpër internet, etj.

Lidhur me funksionet shoqërore të gjuhës shqipe mund të shënohen po ashtu shtresëzime. U përmendën manifestimet e shqipes në kontaktet brenda saj, e do theksuar po ashtu realiteti i kontakteve të bashkësisë së folësve të shqipes apo të pjesëtarëve të saj me gjuhë e me dialekte gjuhësh të tjera, me greqishten, me sllavishtet e jugut, me turqishten, me anglishten, me gjermanishten, me frëngjishten, me gjuhët skandinave, me rumanishten e arumanishten, me arabishten, e më tej në tërë botën. Në ato kontakte shqipja jo çdoherë është e rendit të barabartë. Për më tepër, jo rrallë ajo është vetëm gjuhë e folur e shtëpisë, e rretheve të ngushta të miqësisë, ndërsa me të kaluar në nivele formale rëshqitet në gjuhë tjetër. Edhe në Prishtinë apo në Tiranë sot përdorimi i gjuhëve të ndryshme është përditshmëri.

Sociolinguistët jo një herë lidhur me standardizimin e gjuhëve e kanë theksuar nevojën që gjatë shpjegimeve të proceseve të qartësohen para-prakisht çështje si cila është instanca shoqërore që e bën standardizimin, për

cilën bashkësi shoqërore, kush janë ata që do ta bëjnë konkretisht atë, çka do të përzgjedhin, etj. Standardizimi është pjesë e asaj që në zhargonin socio-linguistik njihet si planifikim gjuhësor dhe ka të bëjë me përzgjedhjen e vetëdijshme dhe vënien në jetë në rrafshin shoqëror të përzgjedhjeve përkatëse (shih Haugen 1959). Spolsky 2009 madje në këto raste fliste për *drejtim* të gjuhës, *dirigjim*, jo *planifikim*, sepse, sipas tij, termi i tillë i përmbledh të gjitha mënyrat që individët apo institucionet vënë në përdorim qëllimshëm në çështje gjuhe. Një tjetër autor i rëndësishëm modern vinte me një përkufizim më të gjerë për planifikimin gjuhësor: “*synim i paramenduar për të ndikuar në sjelljen e të tjerëve duke respektuar në atë rast përvetësimin, strukturën, apo përcaktimin funksional të kodeve të tyre gjuhësore*” (Cooper 1989:45). Modelet përshkruese të proceseve mund të shihen te Haugen 1983:276.

Në frymën e diskutimeve të atilla do të shënojmë vetëm kaq se dallimet midis gjuhës standarde dhe varieteteve të tjera të një gjuhe janë më parë të natyrës së dallimeve të shkallës dhe jo të llojit. Edhe në varietetet jo-standarde bëhen vlerësime dhe përzgjedhje, ndërsa folësit e tyre, me apo pa vetëdije, ua përshtatin të folurën e tyre të tjerëve, nëse atë tjetrën e konsiderojnë me prestigj apo nëse duan të identifikohen me të. Gjithsesi, planifikimi është i ndërlidhur edhe me ndryshimin e natyrshëm në gjuhë. Është bërë tashmë traditë në sociolinguistikë që, në vijën e Heinz Kloß-it (1969), të veçohen dy aspekte të planifikimit: *planifikimi i statusit* dhe *planifikimi i korpusit*. Planifikimi i statusit, sipas tij, ka të bëjë me vendimet për statusin e varietetit gjuhësor të përzgjedhur në raport me të tjerët, kështu që mund të rezultojë të kemi përcaktim varietetesh të ndryshme gjuhësore për funksione të ndryshme (shih dhe Cooper 1989:32). Planifikimi i korpusit ka të bëjë me vendimet për formën konkrete të vetë gjuhës, me drejtshkrimin, me gramatikën dhe leksikun. Të gjitha këto mund të diskutohen në gjendjen e sotme nga aspekti i përzgjedhjeve konkrete në raport me horizontin e atëhershëm në bashkësinë gjuhësore të shqipes.

Në kohën e Kongresit të Drejtshkrimit (vitet '60-'70 të shekullit XX) *bashkësia gjuhësore shqipe*, me traditën e varianteve letrare, me shtresëzime shoqërore, shtrihej në shtetin kombëtar shqiptar të RP(S) të Shqipërisë së izoluar me sistem nga më rigjidët të Lindjes, në shtetin federal multietnik të RFSJ-së, ku shqiptarët kishin statusin e kombësisë (minoritetit kombëtar, pra, jo të bartësit të shtetësisë kombëtare; këtë të dytën e besonin

vetë dhe e synonin në bazë të realiteteve etnike brenda shtetit) me të drejta të caktuara në fushën e përdorimit publik dhe shtetëror të gjuhës së vet, por gjithnjë në pozitë të nënrenditur në raport me gjuhët përkatëse të kombeve (serb, maqedonas, malazias). Në atë bashkësi komplekse sundonte sistemi socialist, më pas vetëqeverisës, paksa i ndryshëm nga sistemi rigjid socialist stalinist i Shqipërisë, por me kontroll e mbisundim të dukshëm të serbokroatishtes, me ideologjinë e bashkim-vëllazërimit, prapa së cilës jo rrallë fshiheshin mëtesa dhe praktika konkrete të mekanizmave jo gjithnjë të sofistikuar të supremacisë e madje të asimilimit. Komunikimi midis pjesëve të bashkësisë gjuhësore në Shqipëri dhe në ish-Jugosllavi gati nuk ekzistonte, pos pasivisht përmes dëgjimit të radios, më vonë televizionit, apo përmes librave. Pjesët e tjera të bashkësisë gjuhësore shqipe në diasporën historike e në diasporën aktuale thuaja se nuk kishin komunikime me trungun. *Bashkësia e folësve të shqipes* ishte e ndarë e në kontroll të rreptë politik-ideologjik e propagandistik. Objektivisht pjesa në Shqipëri jetonte me vetëdijen e pjesës bartëse të kombëtares, që kujtonte se i garantohej me vetë të qenit e Shqipërisë ndërkombëtarisht të njohur si shtet komb, ndërsa pjesa e bashkësisë shqipe në Jugosllavi ishte jetësisht e ngërthyer në synimin dhe luftën e vazhdueshme për statusin e të barabartit me kombet e tjera (sllovenët ishin afërsisht sa shqiptarët, boshnjakët (muslimanët) po ashtu, ndërsa maqedonasit e malaziasit edhe më të paktë), sepse gjendja që kishin ishte limituese në raport me të drejtat që gëzonin të tjerët edhe në fushën e gjuhës. Brenda Jugosllavisë as statusi, as jetësimi real i tij nuk ishte i njëjtë në të gjitha hapsirat: në Kosovë ishte siguruar një shkallë nominalisht e barabartë me serbokroatishten (pos në ushtri), e cila ishte dhe gjuhë mbisunduese në nivel të federatës, ndërsa në Malin e Zi, në Maqedoni dhe në Serbi kishte më shumë probleme. Në të gjitha këto mjedise lufta për një status më të mirë të shqipes ishte e lidhur me nevojat reale të funksionimit të bashkësisë së folësve të shqipes. Aty jetohej me pakënaqësinë për statusin (në sytë e tyre zhvlerësues) të gjuhës së vet dhe me synimin e afrimit dhe barazimit të tij me atë të shqipes në Shqipëri dhe të gjuhëve të tjera të kombeve në Jugosllavi. Në ato rrethana ishte krejt normale dhe e pritshme që shkalla identifikuese të ishte ajo që dëshmohej në Shqipëri, prandaj çdo gjë në këtë fushë që vinte prej andej ishte e pranueshme, madje e synueshme. Mund të

diskutohet lidhur me shkallën e vetëdijesimit për dallimet, ashtu si me parashikimet eventuale për problemet që mund të dilnin më vonë gjatë implementimit të projektit që objektivisht në procesin e ndërtimit dhe të jetësimit të tij nuk i kishte marrë parasysh vështirësitë reale sociolinguistike të kësaj pjese të bashkësisë folëse të shqipes.

Sot bashkësia gjuhësore e shqipes nyjëtohet në shtete të ndara dhe në diasporën me shtresa të ndryshme. Bashkësia e folësve të shqipes jeton kryesisht në sisteme demokratike me orientime vlerore liberale, pjesërisht në diasporë në sisteme autokratike. Komunikimi midis folësve të kësaj bashkësie sot është më i madh se ndonjëherë në histori. Dallimet dhe ngjashmëritë midis varieteteve diatopike, diastratike, diafazike e të tjera ndodhen në kontakte e ndërthurje gjithnjë e më të dendura. Hapsirat dhe mundësitë e përdorimit të varietetit gjuhësor standard sot janë të ndryshme nga të kohës kur u mbajt Kongresi. Në atë kohë kontrolli i asaj që botohej në gazeta, në botime, në radio-televizion bëhej kryesisht në mënyrë të përqendruar në nivel shtetëror në Shqipëri, në nivel sociokulturor në ish-Jugosllavi, dhe kjo i jepte shanse më të mëdha përdorimit në hapsirat publike të varieteteve me bazë gjuhën standarde. Sot, krahas hapsirës së zgjeruar për pordorimet e varieteteve standarde, për pasojë shumëfishimi të qendrave të atilla të kontrollit, ndonjëherë madje mungesë fare të kontrollit, bëhet e mundur që në hapsirën publike të vijë me tërë shumësinë variacionale vernakularët më të ndryshëm që ekzistojnë në hapsirën e bashkësisë folëse të shqipes në Ballkan.

Pos tjerash, gjysmë shekulli më vonë, shqipja nuk është krejt e njëjtë me shqipen e viteve '60-'70 të shekullit XX, pavarësisht nga fakti se sa e hetojmë ne këtë në shikim të parë, sidomos në leksik e në terminologji, pale në shprehjet e zhvillimeve të reja. Ndërkohë ka pasur dhe një revolucion informatik. Atëherë kishte shtyp të kontrolluar në Shqipëri, ashtu si në Kosovë e Jugosllavi, marginal në diasporë. Pas viteve '90 pati hipertrofi në shtyp po edhe në botime të ndryshme në Shqipëri, ndalesa dhe përpjekje për t'i tejkaluar ato në Kosovë. Me kohë ndërkomunikimi u bë më i dendur dhe më pak i kontrollueshëm. Pas viteve '2000, sidomos me zhvillimet në domenin digjital, erdhën ndryshime rrënjësore në komunikimet, qoftë thjesht fizike, apo edhe të shtypit të shkruar tashmë të digjitalizuar dhe të folur me prani rruzullore. Gjendja e re sociale nëpër hapsirat e ndryshme

urbane me manifestimet e slengut të rinjtë, rritja më e madhe se kurrë ndonjëherë e përkthimeve nga gjuhë të ndryshme, rritja e botimeve nga qendrat e ndryshme fetare dhe me problematikë fetare, përpjekjet për të zënë hapin me ç'po ngjet në këtë kohë në rrafshin rruzullor sidomos nëpër botimet online, rritja enorme e emetuesve televizivë, por rënia e dukshme e botimeve reviale profesionale-shkencore në gjuhën shqipe, të gjitha këto bashkë me rikomponimet mikrosocietale brenda pjesëve të ndryshme të bashkësive të folësve të shqipes në hapsirat ballkanike, ndihmojnë për laryshinë përdorimore të shqipes aktuale në zonat publike.

Shqipja sot është gjuha e folësve të saj për nevoja e domene të ndryshme në hapsira shpesh të përbashkëta me gjuhë të tjera e në konkurrencë me to. Ritmet e zhvillimit të saj nëpër pjesë të ndryshme të bashkësisë kanë qenë të ndryshme, çka po ashtu ka lënë pasojë. Kjo mund të jetë me rëndësi për zhvillimet. Përfshirja e gjerë e shqiptarëve sot në vorbullin e dinamizmit rruzullor migrues ka bërë që aktualisht ndoshta gjysma e potencialit të folësve të shqipes të jetë në gjendje të eksponimit të përditshëm ndaj situatës bilinguale në të cilën shqipja është kryesisht gjuhë e shtëpisë, jo rrallë vetëm e komunikimit në internet. Për shkak të proceseve globale të komunikimit qysh në brezin parë të të mërguarve të vegjël apo të të lindurve jashtë hapsirës ku shqipja me varietetet e saj është gjuhë e parë, sot po jetojmë situatën në të cilën realiteti i folësve të saj si gjuhë e shtëpisë, apo shpesh edhe të gjysmëfolësve të saj, është dukshëm mbisundues në tërë këtë hapësirë dukshëm të rritur dhe me tendenca frikësuese të rritjes enorme për pasojë të ngecjeve në zhvillimin e vendit. Gjithnjë e më të dukshme janë fenomenet e të rinjve të famshëm në botë në domene të ndryshme, me të cilët hapsira publike jona krenohet, por që kur u kërkohet të flasin shqip, na nxjerrin përpara fare klluq realitetin e përkorë, madje edhe të gjysmëgjuhës në shumë raste. Mësimi i shqipes si gjuhë e origjinës në orët shtesë nëpër shkollat europiane mund të luajë vetëm një rol të kufizuar në rrafshin e identitetit, por nuk mund ta përmbushë hapsirën e jetës në gjuhën e vet. Si të arrihet qëllimi i përfshirjes së tij në bashkësinë tonë të folësve edhe përtej favoreve evidente që krijon gjuha e mjedisit ku rritet?

Një nga mësimet e rëndësishme të tërë zhvillimeve të këtij gjysmëshekulli të sociolinguistikës ka të bëjë me dievrsitetin gjuhësor, me vari-

acionet. Nuk ka gjuhë të cilën folësit e saj nuk e përdorin në forma të ndryshme në të gjitha nivelet e përdorimit, siç dëshmon realiteti i praktikave të folësve, ashtu si vlerësimet për mënyrat e të folurit: gjithandej ndeshen dallime, pabarazi, gjykime vlerësie, madje diskriminime për individë, për grupe apo për bashkësi. E tërë ngrehina variacionale buron nga format e ndryshorëve dhe kushtet e ndryshimit, që janë të rendit jashtëgjuhësor, nuk janë intrinseke në vetë gjuhën. Kështu në sociolinguistikë zakonisht hetohen dallime variacionesh të mënyrave të të folurit sipas më shumë parametrave, ndër të cilët veçohen: ai i kohës, i hapsirës, i variacioneve shoqërore të folësve, i veprimtarive që ushtrojnë folësit. Diversiteti në kohë – *diakroni* na thotë se të gjitha gjuhët ndryshojnë në shkallë të ndryshme me kohë. Për të kaluarën e gjuhëve të folura, ndërkaq, kemi kryesisht dëshmi vetëm të shkruara, në rastin tonë nga Buzuku 1555, Matranga 1592 e deri te të rëndësishmit e sh. të vonë XX, ta zëmë Pashku, Xoxe, më pak këta të kohës sonë. Ç'ka qenë dikur gjuha e folur kemi vetëm, apo kryesisht, dëshmi nga dokumentime me shkrim.

Diversitetet hapësinore, apo *diatopike* ndërlidhen me fenomenin e ndarjeve të përdorimeve gjuhësore në zona – të folme, dialekte. Në traditën e studimeve shpesh është menduar se të folmet e fshatrave duhet të jenë më të pastra, çka është gjithsesi iluzion, sepse, siç është thënë gjerësisht në studimet e sotme sociolinguistike, çdo idiomë realizohet në raporte shoqërore me pasojat të ndryshme dhe kundërthënëse. Diversifikimet hapësinore mund të kenë të bëjnë me çështje të veçanta (si p.sh. dallimi midis *y* dhe *i*, apo mosdallimi i tyre, në të folmet e Luginës së Preshevës, apo me më shumë çështje si dallimet e shkaktuara nga veprimi rotacizmit në hapsirat shqiptare veri – jug, dallimet në reflekset e grupeve të dikurshme *kl*, *gl* në nëndialekte të shqipes, dallimet në fushën e përdorimit të paskajores me *me* dhe, për pasojë, të çështjeve të ndërtimit tekstor, në veri e jug, dallimet në leksik, etj. Meqë ka rënë në sy gjithandej, diversiteti i tipit diatopik ka qenë objekt i hershëm i vrojtimit.

Në historinë e shqipes së shkruar deri në pjesën e parë të sh. XX kanë qenë zhvilluar varinante të gjuhës së shkruar me shkallë të ndryshme standardizimi sipas varietetit dialektor të veriut – *gegnishtja letrare* (me varietetet e lehta brenda), sipas varietetit dialektor të jugut – *toskërishtja letrare* dhe *arbërishtja*. Ka pasur ndërkohë dhe sprova e tendenca për përdorime me

elemente nga të dy skajet. Më 1916-18 me Komisinë Letrare të Shkodrës (4 vjet pas Kongresit të alfabetit) nisi procesi i normativizimit të një varianti të gjuhës letrare të përbashkët me bazë në të folmet e Elbasanit dhe të Shqipërisë së Mesme, çka u përligj si gjuhë zyrtare në Shqipëri më 1923. Ndërkohë përdorimet e varieteteve të tjera me bazë të ndryshme dialektore kanë vazhduar në rrafshin e letërsisë dhe të publicistikës, ashtu siç kanë vazhduar kontestimet e gjendjes së vendosur dhe kërkimet për zgjidhje më të përshtatshme. Më 1944 Selman Riza vinte me idenë që për arritjen tek idealja gjuhë e përbashkët kombëtare dilte e nevojshme më parë të afroheshin ndër vete dy variantet e mbështetura në dy kryedialektet e shqipes, dhe, meqë varianti i toskërishtes paraqitej relativisht më i njësuar, duhej të kërkohesh një variant i gegnishtes, qoftë dhe pjesërisht i rindërtuar, ashtu që t'i përgjigjej në mënyrë sa më paralele toskërishtes, të cilat pastaj me kohë do të merrnin rrugën e shkrirjes në një varietet unik. Kuptohet, e shpallur në rrethana të luftës së ngatërruar dhe me konflikte politike, pas lufte ideja e atillë edhe për shkak të fatit të autorit, as mund të merrej parasysh në hovin e ri të forcave politike. Sido që të jetë, mbetet vrojtimi se variacionet diatopike të natyrës dialektore vijuan të prodhonin efekte në rrafshin e variacioneve të tipit të standardit me natyrë dhe nivele të tjera.

Nga ana tjetër, faktorë të ndryshëm shoqërorë, si lëvizjet e popullatës, edukimi, qendrat e rrezatimit, kanë lënë efekte homogjenizuese, ndonjëherë madje hibridizuese (siç dëshmon dialektologjia jonë lidhur me të folmet e ashtuquajtura kalimtare në jug të lumit Shkumbin), kështu që ndodh jo rrallë të kihen vështirësi sa i përket lokalizimit për folës konkretë. Në rastet kur kontaktet janë më të kufizuara ruhen më shumë partikularizmat, pra konkretisht të fshatarët më pak mobilë, të më të moshuarit e tek ata me më pak shkollim. Efekte të tilla homogjenizimi, edhe hibridizimi, vërehen sidomos në qendrat e mëdha si kryeqytetet Tirana e Prishtina. Varietetet e shqipes sot janë në kontakte më të afërta se kurrë midis tyre, por njëherësh edhe më të përhapura se kurrë në historinë tonë nëpër gjithë rruzullin tokësor. Për pasojë të emigrimit eksisiv diaspora e ndryshme shqipe sot ndodhet në kontakte të përditshme, më shpesh si gjuhë e rendit të dytë, me gjuhë të ndryshme, po ashtu të diversifikuara. Kështu mund të vërehen diversitete midis shqipes në Kosovë, në Shqipëri, në Turqi, në Itali, në Greqi, në Amerikë, etj., shpesh jo shumë të përcaktuara, apo të hetuara

sipërfaqësisht kryesisht në tipare të caktuara.

Krahas këtyre, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën hapsirë mund të vërehen diversitete të natyrës shoqërore, të njohura si *diastratike*. A nuk ndeshim çdo ditë edhe në vlerësime, si *shqipe e mirë, shqipe e thjeshtë*, etj.? Në lokalitetin më të vogël shqiptar nuk flasin krejt njësoj mësuesi dhe fshatari, apo bariu, zanatçiu, hoxha, prifti apo plakat e mëhallës.

Ka edhe më tej burime diversiteti, siç është ai i tipit të quajtur stilistik apo situativ, i njohur si *diafazik*. Folësit kanë në dispozicion repertorë të caktuar të diversifikuar sipas situatave ku ndodhen, sipas rolit të protagonistit, sipas fushëveprimit apo synimeve brenda një shkëmbimi gjuhësor. Për shembull, përdorimi i lidhëzave si *nëse, prandaj*, etj. mund të shfaqet më shpesh në diskursin e një profesori, sesa te barinjët apo fshatarët. Dimensionet e afërsisë, të distancës në komunikim shfaqen po ashtu si të rëndësishme.

Ka dhe një tjetër dimension burimesh të variacionit, e që është ai i kanalit të komunikimit. Nuk është njësoj nëse komunikojmë me shkrim, apo me gojë, në telefon apo në bisedë pranë e pranë. Ky njihet si dimension i *diamezik*.

Sido që të jetë, gjuha ka një natyrë dinamike në çdo kohë dhe dinamizmin e saj e karakterizon gjithëprania e diversitetit, e heterogjenitetit, e rregullsisë dhe e varieteteve. Midis varieteteve të identifikueshme në shkallë dhe nivele të ndryshme ka dhe një dinamikë ndërthurjesh ekologjike: folësit përdorin më shumë forma rajonale sa më i ulët të jetë statusi i tyre sociokulturor dhe sa më familjare të jetë situata. Kështu në sociolinguistikë është vërejtur se spektri diastratik është më i gjerë drejt pjesës së poshtme të shkallarit shoqëror. Gjuhë të ndryshme parametrat e tillë i vënë në përdorim në mënyra të ndryshme, ndërsa variete të të gjitha llojeve të shqipes sot janë në kontakte me varietete po ashtu të ndryshme gjuhësh të ndryshme në botë çdo ditë. Dhe ato i vënë në përdorim në mënyra të ndryshme parametrat e përmendur. Diku mbisundon elementi diastratik, diku tjetër diatopiku stigmatizohet. Variacioni dhe varieteti nuk do të thonë kapërcim dhe mohim të asaj që kuptojmë me *gjuhë homogjene* (Gadet 2007), pavarësisht se brenda saj veprojnë faktorë të ndryshëm si stabiliteti dhe variacioni (si presigtiji shoqëror/ identiteti grupor i bashkësisë, statusi/ solidariteti, distanca/

afërsia, shkollimi/ përdorimi gojor, përdorimi institucional/ përdorimi në intimitet, shkrimi/ përdorimi gojor, karakteri publik/ rrethi privat, etj.).

Çështja e homogjenitetit në gjuhë ndërlidhet edhe me historinë e saj, po edhe me çështje të rendit shoqëror, politik, të historisë, e gjithsesi edhe të ndërhyrjes së shtetit në proceset e standardizimit, e në rastin tonë, së paku në historinë e deritashme, jemi dëshmitarë zhvillimesh me shkallë, dimensione dhe ritme të ndryshme ndërhyrjesh të atilla. Ato janë hetuar në çështje të rëndësishme si përcaktimi dhe modifikimi i statusit të gjuhës, përzgjedhja e bazës (dialektore), ndoshta dhe e grupit apo grupeve dominante shoqërore, apo të tjera. Ky ndikim është vërejtur në elaborimin e funksioneve dhe në kodifikimin e modifikimet e korpusit të gjuhës standarde me synim që t'i jepet asaj stabilitet. Ndërkaq, paraleleisht, ideologjia e standardit e valorizon uniformitetin si ideal për një gjuhë, ashtu siç shfaqet me shkrim. Standardi paraqitet si i parapëlqyer, si formë par excellence e gjuhës, si e vetmja, kështu që folësit e tillë marrin dhe status të rritur shoqëror. Prandaj, jo rrallë varietetet e tjera shihen si deformime. Ndërkaq, tashmë dihet në sociolinguistikë se standardi është konstruksion gjuhësor e diskursiv i tendencës së homogjenizimit (Gadet 2007). Sapo të ekzistojë një standard përdorimet e tjera zhvlerësohen, sepse pozita publike e standardit qëndron në aktivitete me prestigj shoqëror, kulturor e politik. Me faktin se standardizimi lidhet me formën e shkruar, distanca midis shprehjes gojore dhe të shkruarës u shtrohet gjykimeve të vlerësisë. Prandaj historikisht ndodh që statusi i gjuhës standarde duhet vazhdimisht të risigurohet.

Gjuha standarde ndërlidhet dhe me çështjen e normës, të cilën zakonisht e shohin si një term polisemik. Shpesh veçohet *norma objektive*, e vrojtueshme, që të çon tek ideja e dendurisë të ndërlidhur me mbienmrin *normal*, -e, te tendenca, nga *norma subjektive*, si sistem vlerash të vendosura historikisht, pra, *normativ*, i *normuar* sipas një përdorimi të valorizuar. Kështë folësve u imponohet një shtrëngesë shoqërore që hap rrugë për gjykime vlerësie, çka te ne ndeshet jo rrallë, po shpesh e dendur. Përvojat e përdorimeve të normës kanë treguar se në procese të tilla bashkësitë ndeshin fenomenin e pasigurisë gjuhësore, në raport me çfarë thonë dhe se çfarë besojnë se thonë, prandaj edhe fenomenet e mbikorrigjimit janë të shpeshta. Fenomene të këtij lloji, ashtu si artificialiteti e ngathësia në të folur, po edhe në përdorime të tjera, e elemente të tjera, bien në sy në shkallë të ndryshme

gjithandej. Kështu ka lindur dhe njëloj *'purizmi dialektor'* me përmasa e impakte të ndryshme në bashkësinë tonë të folësve, shpesh me implikime sociokulturore.¹

Në një nga mësimet më të rëndësishme që merren në shkollë, në orët e gjuhës, kur e nxëmë gjuhën standarde kërkohet që nga përdorimi ynë ta largojmë sa më shumë që të jetë e mundshme spontanitetin dialektor, i cili na largon nga gjuha standarde. Ç'është e vërteta, në përdorimet e gjuhës standarde ka nivele ku spontaniteti evitohet për arsye të ndërtimit të tekstit, për arsye psikologjike, për arsye të saktësisë në të menduar, për arsye kulturore, etj. Një shkallë e "artificialitetit" në përdorimet e gjuhës standarde është gjithësi e pranishme dhe ajo hetohet, por bëhet e ndjeshme kur distanca midis standardit dhe shprehjes spontane ndërlihet me parametra të komunikimit, si situata (formale/ joformale), lloje teksti, apo rrethana të tjera sociolinguistike. Ndërkaq, pjesëtarë të bashkësisë së folësve të shqipes janë edhe ata që e kanë marrë shkollimin përkatës në sisteme të ndryshme në Republikën e Shqipërisë, në Republikën (Krahinën Autonome Socialiste) e Kosovës, në Republikën e Maqedonisë (së Veriut), në Republikën e Malit të Zi, në Luginën e Preshevës, dhe të tjerët shkollimin përkatës e kanë marrë në hapsira të tjera ku nuk përdoret shqipja, apo që nuk e kanë pasur këtë mundësi fare në cilëndo hapsirë, ose e kanë pasur krejt sipërfaqësisht.

Përfytyrimi themelor për njësinë kombëtare i përhapur ndër breza bën të ndërjegjësohemi se nëse e zotërojmë tërësinë e komunikimit me gjuhën standarde do të kemi mundësi të komunikojmë me lehtësi në tërë këtë bashkësi gjuhësore, kontinuale a të përthyer nga nënbashkësi folësish me gjuhë të tjera, e me ndarje që nuk varen nga vullneti i folësve. Zotërimi i gjuhës standarde do të na bënte të mundur këtë komunikim me lehtësi. Sa e

¹ Në këto vitet e fundit kanë rënë në sy në opinionin publik reagimet mosdruuese të mjedi-seve përkatëse në Tiranë ndaj varietetit (diatopik, apo edhe më kompleks të variacionit diatopik të standardit) në raste të ndryshme: një pretendenti për ambasador të Shqipërisë Komisioni parlamentar i paraqiti si objeksion për mospërzgjedhjen e tij pretendimin se ai fliste gegërisht dhe jo gjuhën standarde, paçka se ai kundërpërgjigjej se në dokumentacionin e shkruar e përdorte shqipen standarde. Rasti tjetër eklatant është ai i ministres në qeverinë e Shqipërisë me prejardhje nga Prishtina, e cila në fund të mandatit ankohej se si vështirësi me rëndësi punë normale, pra si mosdurim që i shfaqej vazhdimisht, ishte pikërisht varietetet i saj i shqipes standarde. Nuk është asnjë prej nesh që në Tiranë nuk e ka ndërjerë formën diferencuese të vlerësimit – sa bukur flitke shqip!

bëjnë këtë të mundur realitetet e përdorimeve tona? është pyetje që do ta lëmë të hapur.

Në frymën e ideve tashmë të hershme sociolinguistike të Einar Haugen-it, gjendja e përdorimeve të shqipes në nivelet ku pritet gjuha standrade, për faktin se standardi është ngushtësisht i lidhur me formën e shkruar me tendencë që të jetë njëdrejtimshëm e fiksuar, pra stabile, në bashkësitë me dallime midis formës së shkruar dhe të folurës, për shkak të faktit se e shkruara është fiksuar më herët e ndërkohë kanë ndodhur zhvillime, apo, siç interpretohet më pastaj edhe në rastet kur fiksimi me shkrim bëhet sipas një baze diatopike, të ndryshme nga baza tjetër diatopike që poashtu ka zhvilluar një varietet të shkrimit standard, ashtu siç kishte propozuar sociolinguisti tjetër C. A. Ferguson (1959), kemi një raport të prerë midis ‘stileve’ të lartë (*High*) dhe të ulët (*Low*), pra një raport të identifikuar në sociolinguistikë si *diglosi* (si në rastin e arabishtes së Koranit dhe arabishteve të zhvilluara mbi bazat e varieteteve të folura, apo midis kathareusa dhe dhimotiqi të greqishtes). Haugen-i, ndërkaq, mendonte se në këto zhvillime ka raste, si në anglishten, ku kemi të bëjmë me një shkallë më të butë të dallimeve me efekte që ai do t’i quante skizoglosike brenda një kontinuumi. Në vitet ’90 të sh. XX një fenomen të atillë brenda shqipes ne e patëm quajtur *sidiglosi* (Ismajli, 1994:178). Për shkak të kontinuumit brenda tërësisë së gjuhës shqipe, prej nga janë zhvilluar variacionet standardizuese mbi bazë diatopike ne nuk na dukej i pranueshëm cilësimi që theksonte dallimet e prera të stilit (*High* dhe *Low*) tout court *diglosi* me të gjitha implikimet sociale. Në këtë kontinuum jo vetëm hapsinor, brenda një gjuhe si shqipja ka ‘stile’ sipas situatave, stile funksionale, të cilat shfaqin diversitet të shëndoshë brenda gjuhës dhe kështu bëjnë që të krijohet një fleksibilitet (elasticitet) në raport me stabilitetin dhe rigjeditetin e normës. Me fjalët e Haugen-it do të themi: “Një gjuhë e plotë i ka stilet e veta formale dhe informale, theksat e vet dhe zhargonet klasorë e profesionalë, që nuk e rrënojnë njësinë e saj për aq për sa të jenë qartësisht të diversifikuar në funksione dhe të shfaqin një shkallë të arsyeshme solidariteti midis tyre” (Haugen 108-109).

Vështrimi i shqipes si një tërësi shumështrësore me ndërlidhje na çon te një dritë tjetër. Tradita e stilizimeve të shqipes në variante letrare bën pjesë në tërësinë *gjuhë shqipe*. Shqipja e njësuar letrare, shqipja standarde nuk mund të shihet si e ndarë nga shqipja letrare e mëhershme, përkundrazi,

aty dalin mundësi e burime për të. Ato janë pjesë të shqipes. Shqipja është horizonti i gjerë, ndërsa shqipja standarde është pjesë e këtij horizonti, sigurisht më e rëndësishmja, dhe është e tillë për shkak se i përthith lëngjet në ato burime. Më duket i drejtë mendimi i atyre që thonë se, pasi të jetë krijuar gjuha standarde, variantet e stilizimet e mëparme sikur bëhen stile funksionale të saj. Shqipja është realitet i gjallë në vorbullin kompleks e që po bëhet gjithnjë e më i ndërliqshëm në epokën e globalizmit. Marrja e dhënia midis varieteteve të shqipes nuk e ka natyrën e huazimit, po është diçka brenda sferës së gjuhës shqipe. Ndryshe nga një numër studiuesish të kohës sonë lidhur me statusin e elementeve me bazë të ndryshme të varietetit organik në shqipen standarde, jam i prirur ta vlerësoj më parë mënyrën se si konceptohej kjo në vitet e largëta '70-'80 të sh. XX, sesa qëndrimin e atyre që sot janë të prirur që si bazë të shqipes standarde ta shohin ekskluzivisht toskërishten *tout court*. As për këtë arsye, as për arsye të tjera të raporteve midis varieteteve dialektore të shqipes, nuk i përkas grupit të atyre që në raste përdorimi të elementeve që organikisht mund të jenë geqe, kur zënë vend në përdorimet standarde të trajtohen si huazime. Përkundrazi, një proces dinamik i ndërthurjes në shkallë dhe situata të ndryshme midis elementeve të dy bazave, ashtu si nevoja e afrimit sa më të madh midis tyre, janë evidente dhe të domosdoshme për të evituar situatën në të cilën do të shkelej në raportin gjithnjë e më të theksuar diglosik me baza diatopike.

Shqipja standarde me burimet e saj nga gjuha e gjallë do selitur në frymën e përshtatjes së gjerë me nevojat e botës moderne, duke përthithur sa më shumë nga shprehja e saj e gjallë. Ajo e përcakton hapsirën e lirisë shprehëse. Zgjerimi i spontanitetit shprehjor të ndërlidhur me gjallninë jetësore, duke mbajtur parasysh të kuptuarit sa më të lehtësuar në hapsirën e bashkësisë së folësve, është diçka që do synuar dhe përmbushur në shkallë të gjerë në proceset dinamike standardizuese.

Në vise të ndryshme (ndoshta gjysma e folësve të shqipes së trungut ballkanik sot është në dinamikën e mërgimit), folësit e shqipes janë në gjendje që të mos kenë preokupime të njëjta në raport me gjuhën shqipe dhe varietetet e saj, edhe të gjuhës standarde. Ka të atillë ndër ne që shqipen e kanë vetëm gjuhë amtare, ka të tjerë që varietetin standard e kanë për gjuhë amtare. Të tillët e kanë mundësinë që çdogjë të realizojnë në këtë gjuhë: të

flasin në familje, shkollë, shoqëri, punë, lexime letrare, shkencore, veprimtari të prodhimit, të shkencës e të kulturës, por sa e gjerë është kjo shtresë? Ka të tjerë që e kanë gjuhë amtare, por në një varietet dukshëm të ndryshëm nga standardi. Të tjerë që edhe kur mund ta përdorin shqipen, duhet të luftojnë me dyshimin për racionalitetin e përdorimit të saj. Kemi raste tashmë që në shkencë e përdorin kryesisht anglishten apo ndonjë gjuhë tjetër e kjo tendencë po bëhet mbisunduese në stimulimet shoqërore lidhur me botimet e valorizimin e tyre vetëm jashtë, sidomos pas revolucionit informatik. Po ç'të themi për varietetet e vetë standardit sipas mjediseve të ndryshme (Prishtinë – Tiranë – Shkodër – Tetovë – Korçë)?

Kujdesi për gjuhën ndërlidhet me prestigjin, modernitetin, demokracinë, zhvillimin, gjithsesi jo me izolimin. Shqipja standarde shfaqet herë mjaft e fuqishme për të shprehur modernitetin, herë mjaft e dobët për të qenë dominuese, por duhet të jetë gjithnjë e zonja për federimin midis varieteteve që e ushqejnë. Nëse duam ta shohim gjuhën shqipe në kuptimin e saj të shumëfishtë, duhet të shohim qartë se ajo është me shpërfaqje shumësore, në forma, në theks, në situatat ku përdoret si mjet shprehjeje, në kuptimësi. Kemi nevojë që gjuhën ta trajtojmë si kulturë në tërë gjerësinë e manifestimeve të saj. Me i dhanë qytetarit një gjuhë sipas masës së tij, kjo, thuhet ndër standardologë, duhej të ishte synimi i standardizimit të vazhdueshëm. Dhe pa e fajësuar përdoruesin, po duke kërkuar ta përshtatim mjetin. Na ngroh besimi i gjithandeshëm se gjuha jonë duhet të na shërbejë të gjithëve nëpër të gjitha rrethanat. Zgjerimi optimal dhe qëndrimi përfshirës ndaj manifestimeve të ndërliqshme është një dalje sot. Bashkekzistenca e përdorimeve duhet të valorizohet, qoftë dhe për t'i evituar largimet nga trupi i standardit, apo evakuimin e përdorimeve standarde në situata specifike.

Përtej të arriturave në fushën e drejtshkrimit dhe të lavrimit të gjerë të pamohueshëm, më duket se situatat e dy dekadave të fundit po na çojnë drejt nevojave të ngutshme për rregullime në raport me gjuhën e folur, çka del më e ndërliqshme se problematika thjesht drejtshkrimore. Teknologjitë e reja të komunikimit na kanë vënë përpara nevojës që shprehjen ta kemi më shpesh ashtu si vjen e folur. Orientimi drejt komunikimit të reduktuar përmes celularit e kompjuterit ka krijuar pasoja, që nuk mund të superohen përmes reduktimit të komunikimeve, duke shkurtuar botimet e gazetave. Paralelisht, nuk mund të mos bien në sy mungesat në formimin e vazhdueshëm

në fushën e kulturës së të folurit, të kulturës së shprehjes publike, e mungesës së plotë të mësimdhënies së gojtarisë.

Në këto dy dekada kemi pasur shtrirje në hapësira gjithnjë e të reja të përdorimit të shqipes në fusha të kulturës shprehjore. Veprimtaria e botimeve dhe sidomos e përkthimeve nga gjuhë të ndryshme në letërsi, në fushat e dijeve shoqërore, në filozofi, po arrin nivele që nuk i ka arritur ndonjëherë përdorimi i gjuhës shqipe dhe kjo po pasqyrohet në zgjerimin e mundësive shprehjore, në zbulimin e anëve më pak të njohura, pra në përgjithësimin drejt një rrafshi më të lartë të asaj që përkrahim si gjuhë standarde dhe gjuhë të kulturës. Gjithsesi dukshëm më pak kemi zhvillime të këtij lloji në fushat e shkencave të sakta e të zbatuara, të teknologjisë së kohës. Kemi rrjet hipertrofik qendrash studimi universitar, por paradoksisht më pak botime revisitash për këto nivele në gjuhën shqipe. Ku të selitet ajo në këto fusha?

Në bindjet e mia, në këtë kohë, përtej përqëndrimeve shpesh të natyrave teknike në preokupimet për shqipen standarde lidhur me drejtshkrimin dhe gverret e debateve në këtë fushë, ka kuptim dhe mund të jetë më frytdhënëse të orientohemi drejt shqyrtimeve në frymën e përshtatjes dhe të zhvillimit të mundësive tona shprehjore në kuadrin më të gjerë që kemi pasur ndonjëherë të kontakteve midis pjesëtarëve të bashkësisë sonë gjuhësore, gjithë duke u dalë përpara sfidave që kanë sjellë horizonti i ri kulturor dhe nevojat tona jetësore për t'u integruar në zhvillimet e gjithmbarshme. Integrimi në vete gjithsesi duhet t'i paraprijë ose së paku të shkojë paralelisht me globalin.

Literatura

Bourdieu, Pierre (1982), *Ce que parler veut dire*, Paris, Fayard.

Cooper, Robert L. (1989), *Language Planning and Social Change*, Cambridge, Cambridge University Press.

Coseriu, E. (1988), *Historische Sprache und ,dialekt*, Albrecht, J./ Lüdke, J./ Thun, H. (Hrsgb.), *Energeia und Ergon. Sprachliche Variation, Sprachgeschichte, Sprachtypologie*, Studia in honorem E. Coseriu, I, 54-61.

Gadet, Françoise (2007), *La variation sociale en français*, OPHRYS.

Haugen, Einar (1959), *Planning for a standard language in modern Norway*, *Anthropological Linguistics* 1:8-21, .

- Haugen, Einar (1966), *Dialect, language, nation*, American Anthropologist, 68:922-935, rimarrë te Pride, J. B. and Janet Holmes (eds.) (1972), *Sociolinguistics*, Penguin books, Middlesex, Baltimore, Victoria, 97-111.
- Ismajli, R. (1994), Etni e modernitet, *Në gjuhë dhe për gjuhë*, Dukagjini, Pejë, Fryma 1, ff. 159-192.
- Ismajli, Rexhep (2020), *Gjuhë standard dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2020 (botim i dytë i zgjeruar).
- Ismajli, Rexhep (2019), *Bashkësi gjuhësore, njësi, varietet*, ASHAK, Prishtinë.
- Kloß, Heinz (1967), *Abstand languages and ausbau languages*, Anthropological Linguistics 9:29-41.
- Kloß, Heinz (1969), *Research possibilities on group bilingualism: A report*. Quebec: International Center for Research on Bilingualism.
- Koch, Peter/ Oesterreicher, Wulf (1990), *Gesprochene Sprache in der Romania: Französisch, Italienisch, Spanisch*, Niemeyer.
- Spolsky, Bernard (2009), *Language Management*, Cambridge, Cambridge University Press.

Akademik Ethem LIKAJ

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

GJUHA STANDARDE DHE REALITETE GJUHËSORE

Vendosja e standartit gjuhësor të shqipes 50 vjet më parë shenjohej si një fitore e madhe e mendimit intelektual dhe shkencor të gjuhësisë shqiptare. Kjo ngjarje e madhe historike e popullit shqiptar merr një vlerë të dyfishtë, së pari, sepse bashkoi mendimin gjuhësor shqiptar për të njohur vetëm një standard gjuhësor dhe së dyti, sepse realizoi një standard të mbështetur në kriteret e njohura dhe më të përgjithshme shkencore. Shqipje u bashkua kështu me të gjitha gjuhët evropiane, duke u përfaqësuar me dinjitet dhe autoritet ndër to. Këtij vendimi të gjitha institucionet përgjegjëse të kombit shqiptar iu përgjigjën menjëherë me realizimin në kohën më të shpejtë të një sërë dokumentesh normative. Me entuzizëm iu përveshën përvetësimit të këtyre dokumenteve, fillimisht më mirë institucionet mësimore, shkencore dhe zyrtare të Kosovës, për arsyt e njohura historike dhe shoqërore. Në Shqipëri zbatimi, krahas entuziazmit, u parapri thujse nga detyrimi i organizuar. Këto 50 vjet të jetës së tij standardi përlligji zgjidhjen shkencore dhe praktike, çka vërtetohet, në radhë të parë, nga pasqyrimi përmes saj i letërsisë më të arrirë artistike dhe i shkencës më të ndërlikuar dhe më të saktë botërore dhe kombëtare.

Standardi i sotëm thujse nuk ka aq probleme serioze në vetvete sesa detyra për zbatimin e tij. Vlerat e një standarti të përcaktohen në radhë të parë nga rruga e zgjedhjes dhe e zgjidhjes së tij, sidhe nga aftësia që ka fituar për të komunikuar përmes tij sa më mirë dhe sa më saktë. Për zgjidhjen shkencore të tij, besoj, të gjithë jemi në një mendje se ajo zgjidhje ishte në përputhje edhe me zgjidhjet e njohura të gjuhëve të tjera standard evropiane, ose, së paku, nuk është në kundërshtim me zgjidhjet e tyre. Të gjitha ato përfaqësohen vetëm nga një variant. Në ndonjë rast, për të pranuar një dysi variantesh standardi, është marrë si shembull norvegjishtja. Shembulli për t'ia vënë përballë njësisë së vetme të standartit është i papërshtatshëm për arsye historike dhe praktike. Norvegjishtja, për arsye historike, vuan nga një

paradoks: gjuha që flet 85-90 % e popullsisë është një variant norvegjes i danishtes; vetëm 15% e popullsisë flet një norvegjishte që mbështetet në dy dialektet kryesore të saj¹. Është pikërisht kjo norvegjishte e pak novegjisht-folësve, që dëshirohet dhe pritet të bëhet normë kombëtare e saj.

Ky është një realitet gjuhësor, por i papranueshëm, sepse nuk flet për identitet kombëtar ose traditë gjuhësore kombëtare.

Prandaj norvegjishtja është në pritje të standardit norvegjes, kjo është arsyeja që ende janë në përdorim dy variantet.

Duke u kthyer te standardi i shqipes, dua të theksoj:

Kongresi i Drejtshkrimit, siç ka marrë edhe emërtimin, atëherë dhe më pas normativizoi kryesisht drejtshkrimin e shqipes, duke hartuar për këtë synim Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe dhe një dokument tjetër, gjithashtu për drejtshkrimin, të emërtuar Drejtshkrimi i gjuhës shqipe; tre fjalorët shpjegues, Fjalori i gjuhës shqipe (1984), Fjalori i gjuhës shqipe (198...) dhe Fjalori i gjuhës shqipe (2006); një botim tjetër i shkurtër dhe i përzier, Gjuha letrare shqipe për të gjithë, ka vlerë praktike, por nuk është i plotë; është selektiv, jo sistematik. Vepra tjetër, në mbështetje të standardit, Gramatika e gjuhës shqipe I dhe II, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Universitetit të Tiranës, është vepër teorike akademike, me vlera historike dhe shkencore të panjohura në parë. Këto vepra, që pasuan Kongresin e Drejtshkrimit janë njohur dhe vlerësuar nga opinioini shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar si monumente përgjithësuese të gjuhës shqipe. Mbi këto vepra është mbështetur gjithë letërsia gjuhësore shkollore dhe passhkollore e të gjitha niveleve; janë ndërtuar metoda e metodika të reja; është drejtuar përgatitja e mësuesve; janë bërë përpjekje për të përçuar kudo e tekdo kulturore e gjuhës standarde, duke e shndërruar atë jo vetëm në një pasuri kulturore kombëtare, por edhe në frymë kombëtare. Megjithatë kanë kaluar shumë vjet dhe koha dhe arritjet shkencore, në metodë dhe përmbajtje, kërkohet një vështrim të ri. Nga ana tjetër, ndryshe nga dokumentet e sipërpërmendura drejtshkrimore, të miratuara në një kongres, Gramatika e gjuhës shqipe është rezultat vetëm i gjykimit shkencor të përfaqësuesve të institucioneve përkatëse botuese. Duke qenë një vepër kryesisht teorike, si vepër akademike, ajo vetëm në vija themelore e të përgjithshme pasqyron praktikën gramatikore. Për këtë shkak ka edhe dukuri gramatikore praktike të

mangëta, sidomos në sistemin foljor; në këtë vështrim, nuk është thënë gjithçka. Pra edhe duhet thënë çka nuk është thënë, edhe duhet saktësuar e klasifikuar, ndofta edhe duhet vendosur, për çka, me ndërjegje, është lënë në mëdyshje.

Në këto rrethana, standardit të shqipes i mungon një botim praktik, që të përfshijë drejtshkrimin, drejtshqiptimin dhe gramatikën praktike të standardit. Stuktura dhe përmasat e kësaj vepre do të kushtëzoheshin nga nevojat e përcaktuara nga përvoja e zbatimit të standardit në këto 50 vjet, ku mendimet kryesore priten nga mësuesit metodistë me përvojë relativisht të gjatë. Një botim i tillë - praktik dhe i thjeshtuar - do të ishte një ndihmë me vlerë për secilin dhe për të gjithë.

Zbatimi i standardit nuk është një rrugë e lehtë. Ecuria e zbatimit të standardit nuk vështirësohet kaq shumë nga ndërhyrja e dialektit sesa nga vështirësitë, që ka çdo standard në vetvete. Vështirësia e zbatimit të standardit nuk e zhvleftëson atë; standardi është një; të heqësh dorë prej tij, për shkak të vështirësive është kthim mbrapa. Zgjedhja e një varianti tjetër, do të ishte një rinisje vetëm për të vonuar. Vështirësitë e zbatimit të standardit janë të kuptueshme. Në radhë të parë, se ai ende mund të quhet standard i ri, por edhe sepse, si çdo gjuhë tjetër standarde, madje edhe shumë e vjetër dhe me traditë standardizuese të gjatë, ka vështirësi edhe në vetvete, edhe së jashtmi. Sidoqoftë standardi jo vetëm duhet njohur, por edhe duhet përdorur, jo vetëm thjesht se duam, por, në radhë të parë, sepse duhet. Edhe gjuhët e përpunuara prej kohësh nevojën e përdorimit të standardit ende e shtrojnë në mënyrë kategorike. Për gjermanishten, p. sh. gjuhëtarë të njohur njohjen e standardit e shtojnë kështu: “Kush nuk di shkrim e këndim, është analfabet; kush nuk zotëron në njëfarë mase gjuhën standarde, qëndron jashtë kulturës shkrimore të popullit të vet dhe jashtë mundësisë për të komunikuar në rrafsh mbikrahinor”². Kjo ide përputhet me postulatit e historianit të mirënjohur izraelit Harar, i cili në një botim, që përshkruan një histori të shkurtër të njerëzimit, thekson: “. . .humanët zotëruan botën, falë gjuhës së tyre të përbashkët”³. Megjithatë dialekti asnjëherë nuk duhet nënvlerësuar ose edhe më keq përbuzuar, sepse ai lidhet me emocionet edhe me idenditetin e folësve. Madje kjo është edhe arsyeja pse disa prej këtyre folësve dialektorë mbajnë një qëndrim mohues ndaj standardit. Natyrisht standardi ka ende probleme teorike, jo aq shumë të ndryshimit, sesa të studimit, që kanë të bëjnë me lidhjet

e tij me dialektet, me ngjyrimet që merr ai në të folmet krahinore (gjithmonë si standard), me raportet me gjuhën e folur, raportet e tij me drejtshqiptimin etj. Detyra të veçanta dalin për pasurimin dhe ruajtjen e tij. Ka ende gjëra të pathëna, me të cilat duhet plotësuar standardi, sidomos në rrafshin e gramatikës normative; kurse problemi i ruajtjes në periudhën e globalizmit e të teknologjisë së re të komunikimit duhen parë krahas me parimet, që ndiqen edhe në gjuhët e tjera. Edhe standardi ndryshon, por gjithmonë udhëhiqet nga e ashtuquajtura “dorë e padukshme” (në kuptimin e fillimit nga **kush** dhe të kohës **kur**), i cili paraprihet nga gjuha e folur. Standardi është në bashkëpërdorim dhe në ndërlidhje me dialektet dhe me gjuhën e folur; pasurimi i tij me fjalë dialektore është i vazhdueshëm; vështirësia qëndron në përzgjedhjen, jo të fjalëve që i mungojnë, por në përcaktimet dhe vendimmarrjet për sinonimet leksikore dhe gramatikore. Kurse ndërhyrjet shtesë apo ndryshimet gramatikore, kryesisht morfologjike, nga pikënisja në përgjithësim, si në çdo gjuhë, kërkojnë mjaft kohë. Ndërlidhjet e standardit me drejtshqiptimin, me përputhjet a shmangiet në shqipen e sotme dhe në shqipen e ardhme, pasqyrojnë një realitet tjetër gjuhësor. Këtu do të theksoja, në radhë të parë, zhvillimet e togut zanor **-ue-**, por edhe **-ua-**, qoftë rrafsh shqiptimor, qoftë edhe në rrafsh gramatikor. Në rrafsh shqiptimor togu zanor **-ue-**, sidomos në fjalëformim dhe në sistemin foljor, shqiptohet përgjithësisht si një zanore e vetme. Ky realitet i përgjithshëm shqiptimor mund të çojë në të ardhmen edhe në realitete të tjera fjalëformuese a gramatikore. Koha e zgjatjes së këtij ndryshimi është në varësi të ndryshimeve sociolinguistike. Shqipja dhe standardi do të ndjekin prirjen e përgjithshme të gjuhëve që synojnë thjeshtimin e strukturave morfologjike dhe fonetike. Kjo është një dukuri që në gjuhën shqipe, kryesisht në gjuhën e folur, është mjaft largvajtëse; proceset thjeshtuese mund të shkonin dhe mund të shkojnë edhe më tej, nëse përball tyre nuk do të qëndronte gjuha standarde, e cila në këtë rast luan rol ruajtës e frenues.

Ka edhe mospërputhje të tjera të standardit me shqiptimin. Dhe këtu çështjet nuk shtrohen vetëm si pyetje, po, në radhë të parë, si problem: A duhet këmbëngulur për një shqiptim në përputhje me standardin, apo do t'i lëmë rrugë të hapur parimit historik të drejtshkrimit, duke ia kundërvënë parimit fonetik shqiptimor? Njëra rrugë të çon në ngurtësimin e shqiptimit në përputhje me drejtshkrimin, tjetra - në ndryshime a zhvillime në përputhje me parimin fonetik të shqiptimit.

Këshilli Ndërkademi i Gjuhës Shqipe, organizuar nga dy akademitë tona, ka bërë një punë të madhe për ta studiuar standardin edhe si krijim, edhe si realizim. Ai ka ndjekur në mënyrë sistematike thujtë të gjitha normat gjuhësore të vendosura më parë; ka dhënë gjithashtu mendime për çdo gjendje a zhvillim të standardit. Duhet thënë se, në të vërtetë, i është mëshuar më tepër vështirimit të përgjithshëm e të shpërndarë sesa problematikës së zbatimit të tij. Ndofta rruga më e mirë do të ishte përqëndrimi në vështirësitë praktike të zbatimit të tij. Këtu mund të ndihmonin mirë mësuesit metodistë të formuar mirë, të cilët kanë munguar në përbërjet e këshillit përkatës. Në raste jo të rralla nuk duhej lënë jashtë vëmendjes marrëveshja gjuhësore në të mirë të lehtësimit praktik të zbatimit të standardit sesa ndjekja me rreptësi e parimit shkencor, pa dalë nga modelet shkencore gjuhësore, siç është vepruar, p. sh. me përjashtimin e ë-së ndërmjetëse në formimet mbiemërore me prapashtesën **-shëm** dhe në ndonjë rast tjetër.

Në çdo rast, detyra e çdo qytetari është t'i shërbejë gjuhës standarde dhe shërbimi më i madh është përpjekja për përvetësimin e saj. Si një standard i ri ka nevojë për përvetësim, mbrojtje dhe zbatim. Standardi, përgjithësisht, njihet si luks i një gjuhe; njohja dhe përdorimi i tij nuk bëhen për luks, por për nevojë gjithëpërfshirëse.

Në këtë Jubile të madh të gjuhës shqipe rasti është për ta njohur gjuhën standarde si pasuri të çmuar mbarëkombëtare, që duhet mbrojtur gjithmonë si një monument i gjallë i kulturës sonë, që mban lidhur mbas kombit gjithë bashkësinë e ngulitur dhe të shpërndarë shqiptare.

Literaturë

Radim Socharek, Norwegisch – eine oder zwei Sprachen?

Helmut Spieckermann, Die Deutsche Standardsprache (në: Requires Authentication Published by Max Niemeyer Verlag 2008)

Yaval Harari, Sapiens (Një histori e shkurtër e njerëzimit), 27

Akademik Sabri HAMITI

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë

POEZIA E GJUHËS SHQIPE

[Frashëri, Mjedja, Fishta, Poradeci]

I.

1. Parafjala

Gjithmonë kur ndodhemi në udhëkryq ekzistencial, sprovën e reflektimit e mbështesim te klasikët kombëtarë. Jo vetëm për të provuar kauzalitetin e trinitetit: Shqipja - Shqiptari - Shqipëria, në nivel të identitetit kulturor e të ideologjisë kombëtare, por edhe në lakimin e vlerave letrare të artikuluar në gjuhë amtare. Kjo i rrok në mënyrë të barabartë të gjithë shqiptarët që e kanë shqipen “gjuhë të gjallë” dhe specifikisht gjuhëtarët që e *përshkruajnë* këtë gjuhë dhe shkrimtarët që e *shkruajnë* këtë gjuhë.

Sprova për gjuhën shqipe si qenësi që rrok mitin për identitetin kombëtar kapërcen në trajtimin e saj si strukturë për të arritur identitetin letrar. Mëtesa është për të përshkruar kalimin nga formulimi “gjuha shqipe e poezisë” në formulimin “poezia e gjuhës shqipe” nëpërmjet analizës së poezive të Naim Frashërit, Ndre Mjedjes, Gjergj Fishtës dhe Lasgush Poradecit, fillimisht si vjersha okazionale e qëllimore, pastaj për të ndriçuar poetikat individuale të krijimeve të një teme, duke nxanë kumtin e stilin e tyre.

Këto krijime të klasikëve shqiptarë, për shqipen në gjuhën shqipe, janë shkruar dhe botuar në deceniet e fundit të shekullit XIX dhe deceniet e para të shekullit XX.

2. Naim Frashëri

I pari, Naim Frashëri, në vjershat okazionale: *Gjuha jonë* dhe *Korça*, e provon poezinë identitare të shqipes, duke e lakuar nëpër katër sintagma. Sintagmat poetike: “gjuha e zjarrtë” dhe sintagma individuale “gjuha e zemrës” janë të përmbajtura në sintagmat metafizike: “gjuha e Perëndisë” dhe

sintagmën identitare: “gjuha jonë” (shqipe). Poezia okazionale e qellimore e Naim Frashërit përshkohet nga funksioni iluminues i shqipes, për të na kujtuar venerimin e Pjetër Bogdanit “Në dhé të Arbënit ka uri mosdijeje” (1685) dhe përcjell amzën thirrrore kryengritëse të vjershës së Pashko Vasës “Mori Shqypni e mjera Shqypni” (1880). Mirëpo, cilësia themelore e vjershës së Naimit, duke ndjell admirimin për shqipen, këtë kërkesë e përkthen në një trajtë të lutjes e të mahnitjes, që është trajtë e joshjes përkëdheltare të habitjes intime, edhe pse në superlativin e butë:

*Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmbël, sa e gjerë!
Sa e lehtë, sa e lirë!
Sa e bukur, sa e vlerë!*

Ligjërimi intim i përbërë nga një varg epitetesh i pushton zemrat e pafajësisë: e gjerë, e lehtë, e ëmbël, e mirë, e lirë, e bukur, e vlerë, për të rrjetuar këngën e mirësisë dhe të dashurisë, tashmë të universalizuar.

Këto cilësi duket që i ka pasur parasysh Midhat Frashëri kur shkruante për gjuhën e gjallë shqipe të Naimit, në diskutimin e tij për historinë e shkrimit shqip.

3. Ndre Mjedja

Ndre Mjedja poemën e vet *Giûha shqype* (1892) ia kushton Gustav Meyerit. Vepra ka 23 katrena me 92 vargje, në të cilën çdo strofë është një frazë poetike, por kumtet poetike mbështeten në dije e ndjesi personale, kohore, hapësinore, rmbi dhé e në qiell, duke shtuar problematika identitare, lavdërime e mallkime, e gjithë kjo në dramatikën e këngës. Katrena e hapjes tregon farën poetike të Mjedjes:

*Permbi zâ qi lëshon bylbyli
Giûha shqype m'shungullon;
Permbi erë qi nep zymyli
Pá daë zêmrën m'a ngushllon.*

Ky është nivel i identifikimit personal. Në vijim bëhet identifikimi kombëtar i shqipes, duke u ngjitur e duke zbritur nëpër topikat e dheut e të qiellit, të historisë e të gjeografisë së shqipes, duke pasur në konsideratë dhe

përmbylljen për lavdërimin e nderit. Mjedja në poemën e vet është gjuhëtar e poet, madje moralizator. Drama e këtyre pozicionimeve artikulon edhe kër-
citjet idhnake të mallkimit, edhe rënkimet e zemrës për përvuejtninë si da-
shuni. Kjo shqiptohet në parantezat e mallkimit të shqiptarëve, si grindje vë-
llezërisht që ndajnë “Ça natyra vetë përpoq”; dhe parantezat për Mayerin dhe
adhuruesin e tij që “Porsi dielli tue flakue shpërmdan terrin që na mbulon”.
Dijetari austriak zbulon rrënjët e shqipes, familjen e saj, në një histori “sá mij’
vjet”. Se shqipja e dashur është në Tivar e në Prevezë, në burimin e Drinit, në
Gegni e në Toskëri, dëshmon Roma, Iliri e Bardili. Mirëpo, Shqyptaria e
pazbuluar është nën dhé, ku harrimi e ka mbytur lumninë.

Mjedja dijetar e Mjedja poet përfundimisht tronditet për burrat që toka
i mbulon, kurse eshtrat e tyre përzihen “si ’j arë grun, kúr éra lëshon”. Dhe
kurora e poemës është në strofën e fundit, në të cilën poeti ngrit kriterin
moral të vetin nëpërmjet mëtesës së burrave të dheut:

*Don’ m’u çue e gjith per s’mbarit
Me u prië nipave mb’nji cak:
Don’ me t’bâ si ké kenë s’parit
T’ndërës me kapë t’lumnueshmin prak.*

Motivim ky i fundit i ngjashëm me poezinë thirrore të Gjergj Fish-
tës, *Çohi, të dekun!*

4. Gjergj Fishta

Poema e Gjergj Fishtës *Gjuha shqype* (1911) është hartuar në tetë
oktava dhe ka 64 vargje, ku secila oktavë përbën një frazë poetike. Fishta e
nis himnin për gjuhën shqipe në dy oktava, që fillimisht i ngjet poemës së
Ndre Mjedjes, por në vijim me enumeracion krahasimesh i përget më tepër
poemës së Naim Frashërit.

*Porsi kanga e zogut t’veres,
Qi vallzon n’blerim të Prillit;
Porsi i amlu flladi i eres,
Qi lmon gít e drandofillit:*

është figuracion binjak me të Mjedjes. Kurse vijimi i përshkrimit të shqipes,
me krahasimet: vala e detit, gjâma e rrfés, ushtima e tërmetit, po është

fishjtane; porse krahasimet: gjumi i kërthís, drita plot uzdajë, Fleta e Kerubinit, e Vallet e amshimit, janë perceptime e përjetësime naimiane. Kontrapunkti i këtij himnizimi është mallkimi i njohur fishjtjan, për të gjithë ata që nuk e lënë trashëgimi këtë thesar. Të mallkuar janë ata shqiptarë që flasin në gjuhë të huaj.

Po, sepse shqipja për Fishtën është kulturë, identitet, është mënyrë perceptimi, ndijimi, njohjeje, ekzistence. Shqipja jetohet dhe trashëgohet: nga djepi deri në dekë. Është gjuhë e besimit, e këngës, trashëgimisë, e historisë së Lekës (Aleksandrit) dhe Kastriotit. Pra, gjuha shqipe shkon përtej komunikimit, është identitet historik, kulturor e shpirtëror i shqiptarit. Është karta e identitetit të shqiptarit. Poema kryhet me porosinë për shqiptarët në trajtë të urdhëresës. Fishta epik e heroik, këtë lirikë e kurorëzon me brohorimën e vet:

*Prandej, prá, n' e doni fisin,
Mali, bregu edhë Malcija
Prej njaj goje sod t'brohorisin:
Me gjûhë t'vet rroftë Shqypnija!*

5. Lasgush Poradeci

Lasgush Poradeci u kanonizua poet me dy poema të shkruara më 1921: *Naim Frashërit* dhe *Zog' i Qiejve*. Me të parën e pranoi solemnisht atësinë (burimësinë) poetike të Naim Frashërit. Me të dytën inauguroi shqipen poetike të modernes shqiptare dhe të individualitetit të tij poetik. Këtu kemi dramën krijuese të adhurimit dhe të kapërcimit. Të dy poemat formalisht janë të ngjashme: tetërokëshi i dyzuar naimian (gjashtëmbëdhjetërokëshi) me rimë të puthur. Poema *Naim Frashërit* bën portretin poetik, human e atdhetar të Naimit, për të përfunduar me “heroizimin” poetik lasgushjan të nderimit eternal:

*Se kuxove të na thuash me kalem të zi në kartë
Mall' e Math që të pat djegur: Fjalët e Gjuhës së Zjartë.*

Rrallë, apo kurrë, nuk ka ndodhur në poezinë shqipe, që një poet t'i detyrohet shpirtërisht në këtë mënyrë një poeti pararendës. Ky njëjtësim

merr formën kapitale të përkufizimit të shqipes naimiane nëpërmjet figurimit lasgushjan:

Gjuha: shpirt i shent' i kombit, që kalon dyke kënduar!

Gjuha: zjarr ku djeg me dritë një mendim i frymëzuar!

Gjuha: afsh' i gjall' i jetës! shpat' e ndritur e lirisë!

Gjuha: yll i vjershërisë! Gjuha: Verb' i Perëndisë!

Mirëpo, Lasgushi poet i burrëruar, këtu bëhet *Zog' i Qiejve* për të promovuar *ars poetica*-n e vet të modernizmit shqiptar, duke folur në vetën e parë të personalizuar:

Këng' e lasht' e vjershërisë, më pëlqeu aq fare pak ...

Do t'j-a marr që sot e tutje si bilbil parëverak,

Që nga fund' i vetëvetes do këndoj një mall të ri.

Malli i ri i gjuhës poetike shqipe, në gegnisht e në toskërisht, do të jetë i pashuar përderisa të jetë “shqipja e gjallë” e trashëgimtarëve të klasikes shqipe.

II. GJUHA SHQIPE E POEZISË

[Mjedja, Poradeci]

Po kalojmë në trajtimin e dytë të temës në dy variante: Gjuha shqipe e poezisë dhe Poezia e gjuhës shqipe, që shtjellon temën identitare, që lidh e njëson *Shqyptarinë* e *Shqipërinë*. Tashmë duke lexuar në mënyrën e për-qasjes të poezisë *Ândërr* (1909), të lirikut klasik Ndre Mjedja dhe poezisë *Poradeci* (1921) të lirikut modern Lasgush Poradeci. Mëtesa është për të zbuluar poetikat individuale të dy lirikëve shqiptarë.

Ndre Mjedja në tingëllimin *Ândërr* thur dramatikën e mbrendshme të perceptimit: në dy katrenat shenjohet akti i kalimit nga mrekullia qiellore në mrekullinë tokësore, deri në aktin e zgjimit. E bukura fluturon duke shpërndarë rreze si “dielli n’ mjesditë”, si Engjëll që “nji çike i giake”, në vallet e qiellit. Në katrenën e dytë, përshkrimi i qenies estetike dhe eterike merr trajtat e një qenieje tokësore (të Dheut): “Flokët e arit”, “si zgjeta dritën e syve”, “mollëzat rumbullake”, “E buzët e vocrra me të ngjyeme gjake”, duke zgjuar pëlqimin e pasionin, për qenien që pushton si *mahnitje*.

Në dy tercinat, është gjendja e zgjimit, bashkë me dëshirën për njohje e komunikim me qenien e bukur, që bën dallimin e qenies hyjnore nga qenia njerëzore. Rinjohja dhe zbulimi kur poeti pyet:

“Engjëll a vajzë je ti, o bukurija ?”

Goca qesh, tashmë e zgjuar, si vashë që pihet:

“Motër e nanë, tha, m’ke – jam Shqyptarija”

Mjedja në trajtë të tingëllimit klasik, me gjuhë të figuruar, rrëfen zbulimin e mbrendshëm të solemnitetit shpirtëror, ku pëlqehen e rimojnë Bukurija e Shqyptarija nëpërmjet Dashtnís. Një ândërr ideale, e shfaqur si familjaritet që dëfton intimitetin e vëllait, që ka motër e ka nânë. Intima, perlë e përjetësisë poetike, është këtu *Shqyptarija*.

Lasgush Poradeci në poezinë *Poradeci* (1921) me varg të matur aleksandrin, në tri katrena kap kadencën që shenjon çastin e ngrysjes: pra nga zgjimi shkon kah ëndrra e përjetësisë (poetike dhe eterike). Topikat e lirikës, të perëndimit të dritës, janë Qyteza, Liqeri, Lëndina, Mali, Fshati, Katundi, Shqiponja, Mali i Thatë, të gjitha këto si shenja të përhershme, të zëna në një të tashme historike, gati si neutralitet. Mirëpo të gjitha këto shenja të atdheut në singularitet, përmyllen në katrenën e dytë me personalizimin e fuqishëm lasgushjan:

Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t’im.

Prandaj, kur fisi, jeta dergjet dhe e zë gjumi dhe zotëron errësira, si gjendje ritmike kalimtare, poeti së rishmi rigjen veten për të kumtuar porosinë poetike dhe etnike të përjetësisë, në mbyllje të poezisë:

*Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,
Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi...*

Është një kodifikim i Shqipërisë fizike dhe metafizike.

Për të ripohuar rileximin e përbashkët të dy lirikave shembullore *Ândërr* të Mjedjes e *Poradeci* të Lasgush Poradecit se si lidhin *Shqyptarinë* e *Shqipërinë*, është e kërkueshme të lexohen në heshtje e me gjuhë të gjallë këto lirika shqiptare, të shkruara në gjuhë të nënës, që është në origjinë gjuha e poezisë.

Ndre Mjedja

ÂNDERR

*Pezull prej qiellit fluturote e shkreta
E si dielli n'mjesditë rreze shpërdake;
Engjëll nder cucat o një çikë giake
Qi veç qielli numron nder valle t'veta.*

*Arit i kishte flokët, e kish si zgjeta
Driten e syve e mollzat rrumbullake,
E buzët e vocrra me të ngjyeme gjake,
Qi kur i pash krejt i mahnitun mbeta.*

*Mandej si njeri, qi prej gjumit ngrihet,
Mora zemër e e pveta me trimnî:
“Engjëll a vajzë je ti, o bukurijia?”*

*Qeshi goca një herë, si vashë qi pîhet,
Uli kryetin teposhtë e me dashtnî
“Motër e nanë, tha, m'ke – jam Shqyptarija”.*

Lasgush Poradeci

PORADECI

*Perëndimi i vagëlluar mi Ligerin pa kufir.
Po përhapet dal-nga-dale një pluhúrë si një hije.
Nëpër Mal e nër Lëndina shkrumb' i natës që po bije.
Dyke sbritur që nga qjelli përmi fshat po bëhet fir.. .*

*E kudó krahin' e gjërë më s'po qit as pipëlim:
Në katund kërcet një portë... në Liger heshtë një lopatë...*

*Një shqiponjë-e arratisur fluturon në Mal-të-Thatë...
Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im.*

*Tërë fisi, tërë jeta, ra... u dergj... e zuri gjumi...
Zotëroj më katër anë errësira...*

Po tashi:

*Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,
Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi...*

Prof. Dr. Christian VOSS
Humboldt Universität, Berlin

KRAHASIM MIDIS PLURICENTRIZMIT TË SHQIPES DHE TË SLLAVISHTES SË JUGUT 30 VJET PAS SHPËRBËRJES SË JUGOSLLAVISË

Në tetor të vitit 2022 punësuam një lektore të re në Departamentin tim of South Slavic Studies at Humboldt University Berlin. Ajo vjen nga Universiteti i Sarajevës dhe flet boshnjakisht. Të parët e saj ishin nga Novi Sadi dhe flisnin serbisht. Zëvendësuesi i saj për dy semestra ishte një student PhD-je kroat nga Zagrebi. Studentët e tyre ndjekin të njëjtën lëndë dhe studiojnë të njëjtën kurrikul që quhet BCMS (Bosnian-Croatian-Montenegrin-Serbian) - një gjuhë pluricentrike. Rrjedhimisht, janë dashur shumë konvencione për ta etiketuar, që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë - gjithmonë sipas ideologjisë: Ilirishtja, “gjuha jonë” “ (*naš jezik*), serbo-kroatishtja, serbishtja, kroatishtja ose ilire etj.

Me anë të këtij punimi, dua të diskutoj dy aspekte: Si e formësoi situata gjuhësore në ish-Jugosllavi konceptualizimin e gjuhëve standarde në gjuhësinë e përgjithshme¹: A është i mjaftueshëm për këtë situatë modeli klasik i zhvilluar nga gjuhëtarët e Pragës që nga 1920-a? Pyetja e dytë: Çfarë qasjesh të reja kërkimore nxiti situata post-jugosllave dhe cilat mëtoada mund të përshtaten edhe për pluricentrizmin shqiptar?²

Eksperimenti jugosllav

Po përpiqem të përmbledh kontekstin historik me pak fjali: Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, nisi një lëvizje jugosllave si konvergjim i dy grupeve shumë të ndryshme kulturalisht: kroatëve katolikë dhe serbëve ortodoksë. Në

¹ Shih veprën referencë të Cvetković-Sander 2011, si dhe artikullin e përgjithshëm të Voss 2011, për situatën aktuale Voss 2019 dhe 2022.

² Për një krahasim midis pluricentrizmit të shqipes dhe sllavishtes jugore shih Jusufi/Voss 2013.

1850, shkrimtarët dhe intelektualët më në zë të kohës u takuan në Vjenë dhe hodhën postulatit për unitetin e varieteteve të sllavishtes së jugut, me këtë tekst: “Një komb i bashkuar ka nevojë për një letërsi të vetme... Jemi mbledhur së bashku për të bashkuar dhe unifikuar gjuhën tonë”³. Fatkeqësisht, që prej fillimit, ishte e paqartë se kujt i përkiste kultura folklorike mbi bazën e së cilës qëndronte gjuha e re e folur: U përkiste të gjithë sllavëve të jugut të bashkuar në një shtet apo ishte thjesht serbisht?⁴ Kjo paqartësi, gjatë shekullit të njëzetë, solli forma dhe eksperimente të ndryshme dhe dështimin e Jugosllavisë. Shqiptarët në Kosovë - që në këtë kontekst ishin vetëm një humbje kolaterale – përjetuan trajtime shumë të ndryshme nga Jugosllavët: represion, tolerancë, por edhe promovim dhe mbështetje në vitet 1966-1981.⁵

Ndarja e serbo-kroatishtes në katër gjuhë të sotme pasardhëse - BCMS (BKMS) - mund të shpjegohet me ndërtimin e Jugosllavisë socialiste nga Titoja si një përpjekje për të ndrequr politikën asimiluese të Jugosllavisë monarkike: Ai u dha status republike dhe, deri diku, një gjuhë, kujtdo prej gjashtë kombeve jugosllave (Sllovenët dhe maqedonasit kishin gjuhët e tyre standarde). Kush e përcakton nëse BMCS-ja është një apo katër gjuhë? Brezi i mësuesve të mi dhe gjuhëtarët formalistë priren ta shohin si një gjuhë të vetme (duke vërejtur ndërkuptueshmërinë dhe mungesën e dallimeve gramatikore), ndërsa sociolinguistët mbështesin sjelljet e komuniteteve gjuhësore dhe respektojnë vetë-deklarimin e tyre (Marenčić 2018). Sikurse është përkufizuar nga Ulrich Ammon (2005, 2011), një gjuhë pluricentrike përdoret në më shumë se një vend, nuk ka vetëm një qendër kombëtare dhe ka zhvilluar variacione të ndryshme kombëtare me normat e tyre - jo rastësisht ky model u

³ Cf. Greenberg 2004: 170: “Dolje potpisani znajući da jedan narod treba jednu književnost da ima, i po tom sa žalost gledajući, kako nam je književnost raskomadana, ne samo po bukvi, nego još i po pravopisu, sastajali smo se ovijeh dana, da se razgovorimo, kako bismo se što se za sad što više može u književnosti složili i ujedinili.” [“Ne të nënshkruarit duke e ditur se një popull duhet të ketë një letërsi, dhe pastaj duke pare me keqardhje se si na është e coptuar letërsia, jo vetëm sipas alfabetit, po edhe sipas drejtshkrimit, jemi takuar gjatë këtyre ditëve, që të bisedonim, që sa më shumë të jetë e mundshme tash për tash të pajtohemi dhe bashkohemi.”] (Përkthimi shqip Redaksia).

⁴ Cf. Wachtel 1998: 68.

⁵ Kjo mund të vërehet te trajtimi i shqiptarëve në Enciklopedinë e Jugosllavisë midis 1955 dhe 1990; cf. Mujadžević/Voss 2020 dhe 2021.

mbështet në gjuhësinë gjermane për të përshkruar situatën e gjermanishtes në Gjermaninë Perëndimore dhe Lindore, Zvicër dhe Austri.

Konceptet pluricentrike

Modeli pluricentrik, për mua, duket se nënkupton ekuilibër, një decentralizim të balancuar dhe një konkurrencë të drejtë mes anëtarëve të përfshirë. Por kjo nuk ndodh në mënyrë absolute. Gjuhët pluricentrike shpesh krijohen në kontekste post-koloniale dhe post-perandorake - shihni anglishten, spanjishten ose frëngjishten globalisht. Edhe në ish-Jugosllavi, një nga partnerët - serbishtja - ishte më e fortë se të tjerët. Dalldia koloniale e Serbisë duket qartë në këtë hartë që tregon situatën ushtarake në fillim të viteve 1990. Dhe kuptohet që ky është një diskutim shumë politik. Sepse: “Nëse gjuha jote është vetëm një varietet i times, atëherë unë mund të lakmoj të zotëroj territorin tënd.” Disa vjet më parë, shkrova një artikull për malazezishten dhe maqedonishten dhe e quajta “Emancipimi brenda hartës mendore serbe” (Voss 2019). Asnjë gjuhëtar serioz nuk do pretendonte se maqedonishtja ka një marrëdhënie pluricentrike me serbishten, sepse ka një gramatikë të ballkanizuar (sikurse dhe shqipja, greqishtja dhe rumanishtja) dhe është e afërt me bullgarishten. Pavarësisht kësaj, pas Luftërave Ballkanike, Maqedonia, si Kosova, ishte pjesë e “Serbisë së vjetër” (*Stara Srbija*) dhe u asimilua nëpërmjet represionit.

Modeli i zhvilluar nga Rudolf Muhr (2012, 2018) “Gjuhët dominuese kundër atyre jo-dominuese” ishte i dobishëm për studimin e rastit të sllavishtes së jugut. Po ju jap një shembull të freskët: Në 2020-n, Serbia fabrikoi një shfaqje digjitale të quajtur “Vuku dhe Gjermanët”.⁶ Ky është një version etnocentrik dhe shumë problematik i historisë së gjuhës, që me gojën e Vukut thotë: “të gjithë folësit e dialekteve shtovakiane janë serbë” - dhe mohon me plot gojën ekzistencën e kombeve kroate, boshnjake dhe malaziasë. Ekzistojnë pamflete, si “Një fjalë në gjuhën serbe” (Slovo o srpskom jeziku) nga 1998-a⁷, ku gjuhëtarë të shquar nga Serbia pretendojnë të njëjtën gjë: “Serbë të gjithë dhe kudo”. Ky qëndrim përfshin dhe pretendon të jetë serb

⁶ https://www.bsb-muenchen.de/fileadmin/pdf/ausstellungen/virtuell/vuk_und_die_deutschen.pdf.

⁷ Botuar nga Fondi i së vërtetës për serbët (Fond istine o Srbima), cf. svevlad.org.rs/srbistika/slovo.html.

dhe eposi i famshëm i Hasanagicës: I zbuluar nga italianii Alberto Fortis në Dalmacinë Venete (Wolff 2001: 173ff.), një histori tragjike dashurie myslimane - por e pretenduar si serbe. Trajtimi shovinist i kombeve më të vogla e më të reja është një kriter tipik i përfaqësuesve të varieteteve dominuese.⁸ Sot kemi një libër shkollor të shkruar nga Ronelle Alexan der 2006 (të quajtur BCS), si dhe një gramatikë për MBCS-në (BKMS) të shkruar nga eksperti më i mirë francez, Paul-Louis Thomas 2017. Meqenëse nuk jeni njohës të sllavistikës, lejomëni t'ju jap një ide të përgjithshme për dallimet midis kroatishtes dhe serbishtes (cf. Voss 2011: 769-771): Dallimi më i madh është mungesa e paskajores në serbisht (serb. Hoću da radim vs. kroat. Hoću raditi “Dua të punoj, Due me punue”), që është një tipar i tërësisë gjuhësore ballkanike. Tipari i dytë është pozicioni i klitikave, pozicion në të cilin kroatishtja parapëlqen pozicionin fonetik ndërsa serbishtja pozicionin sintaksor (sh. serb. Marko Petrović je došao vs. kroat. Marko je Petrović došao “M. P. ka ardhur”). Këto janë të vetmet dallime në nivel gramatikor.⁹ Megjithatë, sikurse mund të shihni te kjo hartë me ndarjet fetare të Evropës, sfondet e ndryshme fetare dhe kulturore të kroatëve dhe serbëve u kanë dhënë trajtë fjalorëve të ndryshëm, me kroatishten që është përkatësisht puriste në mënyrë ksenofobike, dhe serbishten të hapur ndaj internacionalizmave me origjinë greke dhe latine (për shembull “barbatore, muzikë, universitet, futboll”: serb. apoteka, muzika, univerzitet, fudbal vs. kroat. ljekarna, glazba, sveučilište, nogomet).

Si duken modelet për përshkrimin e gjuhëve standarde? Mund t'ju njoh me tri faza të ndryshme të diskutimit. E para është strukturalizmi i Pragës me katër kategoritë e standardit: norma, detyrueshmëria, polivalenca dhe dallueshmëria stilistike (tabela e mëposhtme dhe të tjerat janë marrë nga Voss 2022).

⁸ E njëjta gjë mund të shihet te konflikti midis Rusisë dhe Ukrainës, me Rusinë që pretendon territore në bazë të argumenteve historike dhe gjuhësore.

⁹ Dallime të tjera minore shfaqen lidhur me përdorimin e rasës së predikativit (me mjete në kroatishten dhe emërore në serbishten) ashtu si me kundërvënien e mbiemrave të përcaktuar përballë të papërcaktuara që ekziston gjithnjë në kroatishten dhe është bjerrë në serbishten.

Përkufizimi “klasik”:

Normë	Obligueshmëri	Polivalencë	Stil	Diferencim
Bosnishte	+	+	?	?
Kroatishte	+	+	+	+
Maqedonishte	+	+	+	+
Malazezishte	+	-	?	?

Këtu mund të themi dy gjëra të rëndësishme: së pari, kategoritë e normës, polivalencës e dallueshmërisë janë graduale. Në Wikipedia mund të shihni, për shembull, se si gjuhët e minoriteteve dhe ato rajonale pushtojnë zotërimi të reja, prodhojnë tekste në zona të ndryshme të dijës moderne, bëhen polivalente dhe prodhojnë vepra referuese normative. Po në Wikipedia, mund të vëreni dhe situatën e zbalancuar të katër gjuhëve trashëgimtare BCMS (BKMS): 643.562 artikuj të shkruar në këto gjuhë, me 454.544 në serbisht, 225.344 në kroatisht, 85.142 në boshnjakisht, 0 në malazisht. Në krahasim me gjuhët e minoritetizuara si bretonishtja (69.315 artikuj) varietetet më të vogla të BCMS-së kanë çuditërisht performancë të dobët polivalence.

Kriteri më interesant është detyrueshmëria (Obligatoriness). Këtu po citoj një thënie të Max Weinreich-ut i cili ka thënë: “*Gjuha është një dialekt që ka ushtri dhe flotë*” (Stern 2018: 14-39). Kjo nuk është shaka por një metaforë për faktin që politikanët dhe statusi politik i një komuniteti gjuhësor (pavarësia kombëtare dhe pasja e shtetit) janë ata që përcaktojnë statusin e varieteteve gjuhësore. Që një gjuhë të bëhet e detyrueshme, ka nevojë për monopolin e sistemit edukativ, pra ka nevojë për shtet. Duke qenë se boshnjakët dhe malazezët, në kushtetutat e tyre të 1990-s dhe 2000-s, i quajnë gjuhët e tyre boshnjake dhe malaziase, duhet të pranojmë vullnetin e tyre politik. Kjo pikëpamje nënkupton se: duke qenë se kemi një shtet të dytë shqiptar që nga pavarësia e Kosovës më 2008, ka potencial për një standard të dytë shqip, në varësi të elitës politike në Prishtinë.

Me këto kriteret në mendje, i pyes përherë studentët e mi për dimensionin historik të pluricentrizmit jugosllav: për sa kohë ekzistoi serbo-kroatishja, apo ndoshta kurrë? Apo midis viteve 1850 dhe 1991? Përkufizimi im është shumë i qartë: ekzistoi midis marrëveshjes së Novi Sadit më 1954 dhe Pranverës Kroate më 1967, kur shumica e intelektualëve kroatë u deklaruan në favor të kroatishtes në vend të serbo-kroatishtes. Pra, trembëdhjetë vjet.

Së dyti kemi zhvillimin e standardologjisë (Wingender 2003). Sikurse

u përmend më herët, varësia nga mënyrat e së shkuarës (*path dependency*) e gjuhëtarëve dhe formimit të tyre është vendimtare: gjuhëtarët formalistë do të pyesin për heterogjenitetin e bazës gjuhësore, ndikimet nga gjuhë të tjera, dallueshmërinë etj. Ndërsa sociolinguistët, nga ana e tyre, do të theksojnë kategoritë “e buta”: Përbërësin funksional (zhvillimin e sferave funksionale, vitalitetit dhe sjelljeve zyrtare), Përbërësin social (sjelljet e përdoruesit, vlerat dhe traditat simbolike/ historicitetin) dhe Përbërësin situacional (autonominë, ngulitjen socio-linguistike).

Përbërësit:	gjuhësorë	funksionalë	shoqërorë	situativë
Bosnishte	+	+	+	+
Kroatishte	+	+	+	+
Maqedonishte	+	+	+	+
Malazezishte	+	?	?	?

Në ish-Jugosllavi mund të vihet re se purizmi gjuhësor është shumë i dobët, edhe pse kufijtë etnikë janë shumë të qartë e të theksuar. Për shembull, pas gjenocidit të vitit 1995, myslimanët boshnjakë kanë zhvilluar një identitet të qartë kombëtar, por kjo nuk përkon me pasivitetin e tyre në nivelin gjuhësor: për shembull, prirja për rigjallërimin e fjalëve të vjetra turke dhe otomane, si në fillim të viteve 1990, është shumë e dobët sot: si shembull do të jap shprehjet për konceptin “javë” në “Oslo Corpus of Bosnian Language Corpus” (të ndërtuar nga Svein Mønnesland):

<i>sedmica</i>	(neutrale)	>50
<i>ned(j)elja</i>	(neutrale)	37
<i>tjedan</i>	(kroatizëm)	26
<i>hefta</i>	(turqisht/arkaike)	13

Edhe kroatët që deri tani kanë ndjekur politikat gjuhësore më puriste dhe të qëndrueshme që nga vitet 1990, janë bërë më të moderuar (Langston/Peti-Stanić 2014). Gjatë viteve 1990 e kam dëgjuar dhe në konferenca pyetjen se pse kroatët nuk e përdorën shkrimin glagolitic (siç u shpik nga Kirili dhe Metodi në shekullin e nëntë), ose pse nuk e përqafuan dialektin çavakian nga Dalmacia, që është një dialekt ekskluzivisht kroat nga pikëpamja etnike. Unë njoh vetëm një ndryshim të tillë rrënjësor kolektiv, hebraishten moderne, dhe arsyeja për këtë është shumë e qartë - përvoja e Holokaustit ndaj hebrenjve evropianë.

Në mënyrë mjaft tipike, modeli i varieteteve dominuese kundër atyre jo-dominuese u zhvillua në Graz, Austri, dhe jo në Gjermani. Kjo do të thotë

të mbash anën e “varieteteve më të vogla” (Muhr 2012), që mund të perceptohen si “thjesht deviacione”, si të gabuara, qesharake apo rurale nga qendra hegjemoniste dhe që mund të kenë përjetuar zhvlerësim, diskriminim apo edhe përbuzje dhe mohim të identitetit të grupit të tyre nga grupi dominues (fenomene të ngjashme lidhur me folësit e gegërishtes janë përshkruar nga Rugova 2021). Kësisoj, pyetja praktike duhet të jetë gjithmonë: Si t'i fuqizojmë varietetet jo-dominuese?¹⁰

	<i>minimal</i>		<i>basal</i>		<i>full</i>	
	<i>Occurrence</i>	<i>Status</i>	<i>Distinctiveness</i>	<i>Identity</i>	<i>Acceptance</i>	<i>Codification</i>
Bosnshte:	+	+	?	+	-	+
Kroatishte:	+	+	+	+	-	+
Maqedonishte:	+	+	+	+	-	+
Malazezishte:	+	+	?	?	-	?

Dallimi midis pluricentrizmit minimal, bazor e të plotë, është rezultat i disa faktorëve socio-psikologjikë, funksionalë dhe formalë, sipas Muhrit. Pluricentrizmi minimal nënkupton vetëm ekzistencën në më shumë se një shtet dhe një status njohjeje, edhe pse minimale. Pluricentrizmi bazor do të thotë dallueshmëri gjuhësore dhe faktorë identiteti, ndërsa pluricentrizmi i plotë arrihet nga normat kombëtare dhe nga pranimi në të gjitha komunitetet gjuhësore. Një pyetje e vështirë do të ishte si të përshkruash situatat kur varieteti jo-dominues është në kundërshti me afërsinë gjenetike gjuhësore (deri diku, si kroatët). Kjo do të thotë se nuk mund të përkufizohet si pluricentrizëm i plotë dhe Ammon-i propozon termin e “gjuhëve të ndara” (“*divided languages*”, si në dy Koretë) duke nënkuptuar “ish-pluricentrik” (Ammon 2005).

Performanca e pluricentrizmit jugosllav dhe post-jugosllav

Nëse shqyrtojmë efektshmërinë nga lart-poshtë të pluricentrizmit në kohën e Jugosllavisë, vëmë re se, në kohën e Titos, kishte vullnet për të mposhtur hegjemoninë serbe: gazeta e partisë, BORBA (“Luftë”), për dekada me radhë, shtypej në dy variante, me alfabetin latin në Zagreb dhe me alfa-

¹⁰ Aspekti i fuqizimit të grupeve të pafavorizuara ka qenë në agjendën e humaniteteve majtiste që nga vitet 1960, p.sh. me metodën e Historisë Gojore (*Oral History*) apo me fokusin tek migrantët, gratë apo minoritete të tjera.

betin cirilik në Beograd. Edhe aspekti i dytë i dominancës serbe në periudhën midis luftërave, dialekti ekavian i Beogradit (*belo* në vend të *bijelo* “i bardhë”) u zgjidh në BORBA.

Aspekti i fundit që dua të trajtoj është çështja e metodave të kërkimit shkencor të shkaktuara nga pluricentrizmi jugosllav dhe post-jugosllav. Po përmend dy prej tyre: E para është puna empirike në terren me metoda sasiore dhe cilësore - për shembull, verifikimi i pranueshmërisë së politikës së gjuhës kombëtare nga popullsia. Do t’ju them një shaka nga Sarajeva: është për perceptimin e diskriminimit etnik dhe testit Shibolet.

Në kohët pas Dayton-it, një kroat është ulur në një bar në Sarajevë. Vjen kamerieri dhe kroati thotë: “Një kafe, të lutem (në kroatisht).” “Nuk ka!” Kroati mendohet pak dhe thotë “A mund të më sjellësh një kafe (në serbisht)?” Kamerieri serish: “Ka mbaruar!”. Kroati mendohet dhe pak dhe thotë: “Si i bëhet për një kafe (në boshnjakisht)?” Kamerieri: “Vëlla, (boshnjakisht) s’e bëjmë dot se s’ka ujë!”

Janë bërë disa disertacione (si e Tolimir-Hölzl-it 2009 ose e Neusius-it 2008) lidhur me pasigurinë e folësve vendas që përballen me normat e reja. Studimi i sjelljeve dhe stereotipave etnikë përfshin testet *matched-guise* (përputhja e maskimeve) si dhe studimet mbi përdorimin e varieteteve të filmat e dubluar. Sociolinguisti kroat Ivo Žanić shkroi librin “Si po pëllasin gomarët kroatisht”, si reagim ndaj faktit që në filmat e animuar, si Epoka e Akullnajave ose Shrek, kafshët budallaqe flasin gjithmonë në dialektet e provincave kroate (Žanić 2009).

Pika e fundit që dua të trajtoj është shembulli negativ i shkencës qytetare dhe të kuptuarit publik: më 2017 në vendet e ish-Jugosllavisë u publikua “Deklarata mbi gjuhën e përbashkët” nga OJQ-ja Krokodil dhe nga persona të njohur të Shoqërisë Civile. Por ajo fajësonte nacionalistët e gjuhës për fundin e Jugosllavisë dhe provokonin neonacionalistët (sidomos në Kroaci) me anë të postulatit për një gjuhë të vetme serbo-kroate. Deklarata është nënshkruar nga thujse dhjetë mijë (10.000) vetë deri më sot, nga të cilët dyzet 40% janë nga Serbia, njëzet 20% nga Bosnjë-Hercegovina (me shumë mundësi serbë nga Bosnja) dhe 20% nga diaspora. Përse nënshkruan këta njerëz: Për shkak të nostalgjisë ndaj Jugosllavisë, tolerancës gjuhësore apo për pozicionin e Serbisë së madhe, siç u formulua nga Vuku në fillim të

shekullit të nëntëmbëdhjetë? Çfarë i shkon në mendje popullsisë, pas luftërave të përgjakshme gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, nëse u përmend “gjuhën e përbashkët”? A nuk ishte vallë Millosheviçi personi i fundit që shpallte se punonte për shpëtimin e Jugosllavisë së përbashkët? Dhe nëse sot shkon në rajone të traumatizuara e të spastruara etnikisht në Kroaci apo Bosnjë, apo në rajone me minoritete si Novi Pazari në Sanxhak, ku njerëzit luftojnë që ta quajnë gjuhën e tyre ashtu siç duan (boshnjakisht) apo të përdorin alfabetin që duan - a mundemi ne, si gjuhëtarë, t'u predikojmë që flasin të njëjtën gjuhë? Veç kësaj, Deklarata injoron debatet e kohëve të fundit për gjuhët standarde dhe kriteret e tyre sociolinguistike. Në një mënyrë arrogante dhe elitiste, ajo fajëson ata që nuk duan më ta quajnë serbo-kroatisht gjuhën e tyre: Kjo përputhet plotësisht me përshkrimin e Muhrit për varietetet dominuese: injorim, përbuzje dhe mohim.

Literatura

- ALEXANDER, Ronelle; ELIAS-BURSAĆ, Ellen (2006): *Bosnian, Croatian, Serbian: A Grammar with Sociolinguistic Commentary*. Madison, Wis.
- AMMON, Ulrich (2005): *Pluricentric and divided languages*. In: Ulrich Ammon et al. (eds.): *Sociolinguistics. An International Handbook of the Science of Language and Society*. Vol. 2. Berlin, New York: 1536–1543.
- AMMON, Ulrich (2011): *Deutsch als plurizentrische Sprache – mit Hinweisen auf die Nachfolgestaaten des früheren Jugoslawien*. In: S. Gavrić (ed.): *Sprach(en)politik in Bosnien und Herzegowina und im deutschsprachigen Raum*. Sarajevo: 38–46.
- CVETKOVIĆ-SANDER, Ksenija (2011): *Sprachpolitik und nationale Identität im sozialistischen Jugoslawien (1945–1991)*. Serbokroatisch, Albanisch, Makedonisch und Slowenisch. Wiesbaden.
- GREENBERG, Robert (2004): *Language and Identity in the Balkans. Serbo-Croatian and its Disintegration*. Oxford, New York.
- JUSUFI, Lumnije; VOSS, Christian (2013): *Plurizentrik im Albanischen sowie im Serbokroatischen und seinen Nachfolgesprachen*. In: Daniel Muller, Monika Wingender (eds.): *Typen slavischer Standardsprachen. Theoretische, methodische und empirische Zugänge*. Wiesbaden: 177–195.
- LANGSTON, Keith; PETI-STANTIĆ, Anita (2014): *Language Planning and National Identity in Croatia*. Basingstoke.
- MARENČIĆ, Sara (2018): *Grenzen zwischen Einzelsprachen, Grenzen der Klassifikationen. Der Sprachenkonflikt um BKMS in der kroatischen Kroatistik*. In: Jusufi, Lumnije (ed.): *The Potentiality of Pluricentrism. Albanian Case Studies and Beyond*. Wiesbaden: 251-266.

- MUHR, Rudolf (2012): Linguistic dominance and non-dominance in pluricentric languages. A typology. In: Rudolf Muhr (ed.): *Non-Dominant Varieties of Pluricentric Languages. Getting the Picture*. Frankfurt am Main: 23–48.
- MUHR, Rudolf (2018): “Misconceptions about pluricentric languages and pluricentric theory – an overview of 40 years”. In: Rudolf Muhr, Benjamin Meisnitzer (Hrsg.): *Pluricentric languages and Non-Dominant Varieties Worldwide. New Pluricentric Languages – Old Problems*. Berlin: 17–56.
- MUJADŽEVIĆ, Dino; VOSS, Christian (2020): Ndërtimi i identitetit sub-jugosllav në Enciklopedija Jugosllavije (1955–1990): Shembulli i çështjes shqiptare. In: *Studime. Revishtë për studime filologjike* 27: 99–116.
- MUJADŽEVIĆ, Dino; VOSS, Christian (2021): Sub-Yugoslav Identity Building in the Enciklopedija Jugosllavije (1955–1990): The Case of the Albanian Question. In: *Comparative Southeast European Studies* 69/2–3: 375–397.
- NEUSIUS, Boris (2008): *Sprache und Sprachbewusstsein in Kroatien. Empirische Untersuchungen zum heutigen Kroatischen in Zagreb* (unpublished dissertation).
- RUGOVA, Bardh (2021): *Ideologjia e gabimit gjuhësor*. Prishtinë.
- STERN, Dieter (2018): Languages without an army: minority, regional and literary micro-languages. In: Stern, Dieter et al. (eds.): *Linguistic Regionalism in Eastern Europe and Beyond*. Berlin: 14–39.
- THOMAS, Paul-Louis; OSIPOV, Vladimir (2017): *Grammaire du bosniaque, croate, monténégrin, serbe*. Paris.
- TOLIMIR-HÖLZL, Nataša: *Bosnien und Herzegowina. Sprachliche Divergenz auf dem Prüfstand*. Berlin 2009
- VOSS, Christian (2011): Dissolving multilingual empires in the history of Europe: Yugoslavia. In: B. Kortmann, J. van der Auwera (eds.): *The Languages and Linguistics of Europe. A comprehensive guide*. Berlin, New York: 761–774
- VOSS, Christian (2018): Linguistic emancipation within the Serbian mental map: The implementation of the Montenegrin and Macedonian standard languages. *Aegean Working Papers in Ethnographic Linguistics* 2. 1–16.
- VOSS, Christian (2022): Modellierungen sprachlicher Dominanz im südslawischen Raum. Die aktuelle Plurizentrikdebatte. In: *Zeitschrift für Balkanologie* 58/12: 169–187.
- WACHTEL, Andrew B. (1998): *Making a Nation, Breaking a Nation. Literature and Cultural Politics in Yugoslavia*. Stanford.
- WINGENDER, Monika (2003): Überlegungen zur Weiterentwicklung der Theorie der Standardsprache. In: W. Gladrow (Hrsg.): *Die slawischen Sprachen im aktuellen Funktionieren und historischem Kontext*. Frankfurt/M.: 133–152.
- WINGENDER, Monika (2013): Modell zur Beschreibung von Standardsprachentypen. In: Monika Wingender, Daniel Müller (Hrsg.): *Typen slawischer Standardsprachen. Theoretische, methodische und empirische Zugänge*. Wiesbaden: 19–37.
- ŽANIĆ, Ivo (2009): *Kako bi trebali govoriti hrvatski magarci? O sociolingvistici animiranih filmova*. Zagreb.

Prof. dr. Xhevat LLOSHI
Tiranë

RIBOTIMI I FJALORIT DHE I RREGULLAVE TË DREJTSHKRIMIT

Qëndrueshmëria e zgjidhjeve të miratuara në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 është mbështetur nga përdorimi i tyre gjatë gjysmë shekulli dhe kjo na lejon të shprehim bindjen se një qëndrueshmëri e tillë ka një të ardhme të sigurtë përpara. Përcaktimi përfundimtar i normave të drejtshkrimit ka qenë një hap historik në rrugën e shqipes së shkruar, i tillë që radhitet në ecurinë nga Kongresi i Manastirit, te Komisia Letrare e Shkodrës dhe te Kongresi i Lushnjës. Kjo ka qenë një reformë gjuhësore, sepse Kongresi i Drejtshkrimit, pavarësisht prej emërimit të tij, përvijonte trajtën e gjuhës standarde.

Arritja më e rëndësishme e Kongresit të Drejtshkrimit ishte se ai u mbështet si në historinë, edhe në gjendjen e kohës, si në punën e bërë brenda Shqipërisë politike, edhe në ndihmesat e studiuesve dhe lëvruarëve të shqipes jashtë kufijve politikë. Ishte bërë një punë e pandërprerë me projekte të drejtshkrimit, ishte organizuar Konsulta gjuhësore e Prishtinës më 1968, ishin botuar mendime të ndryshme e ishin bërë diskutime të gjera.

Ndërkaq, ashtu si çdo reformë, edhe kjo kishte nevojë si për t'u konkretizuar, edhe për t'u zbatuar, sidomos për arsyen se përballet me detin e pafund dhe përherë në lëvizje të gjuhës. Pas Rezolutës u botuan rregullat në "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe" më 1973, ku përfshihej edhe një fjalës i she mbujve prej mbi 100 faqesh, më pas "Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe" më 1976 me 32 mijë fjalë. Botimi i *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* më 1980 dhe i *Gramatikës së gjuhës shqipe* (vëll. I 1996, v. II 1997), pavarësisht prej të metave të kuptueshme kur dalin për herë të parë vepra të tilla madhore, i dha një mbështetje shkencore dhe praktike zbatimit të normës së vendosur më 1972.

Standardi siguron komunikimin më të gjerë e më të pasur në kohën e sotme, domethënë komunikimin sinkronik, por siguron edhe komunikimin

e gjithë periudhave historike, domethënë komunikimin historik. Ai është shndërruar në hambarin e kujtesës kolektive historike. Pa këtë nuk ka ndërgjegje të përbashkët kombëtare e sidomo shërben për të ruajtur lidhjet me gjithë kulturën në gjuhën shqipe, sepse *standardi është përcjellësi dhe ruajtësi më i pasur i ndërgjegjes kombëtare.*

Është e vërtetë që 50 vjet nuk janë edhe aq shumë në historinë e një populli dhe të kulturës së tij, por njëkohësisht nuk mund të mohohet, që pas 50 vjetësh shumë gjëra kanë ndryshuar. Të tjera janë sot rrethanat e zbatimit të normës së ngulitur: kanë ndryshuar kushtet politike të përdorimit në trevat ku flitet shqip në Ballkan. Në rrafshin ndërkombëtar Shqipëria pritet të hyjë në Bashkimin Europian. Siç dihet, gjithë dokumentacioni europian do të jetë edhe në gjuhën shqipe. Për fat të mirë, kësaj i përgjigjet arritja e 50 vjetëve më parë në kohën e duhur. Ka ndryshuar thellësisht e gjerësisht mjedisi në të cilin përdoret standardi. Mjafton të shohim mjetet elektronike, kompjuterët, telefonat celularë, stacionet e shumta televizive; është bërë i mundshëm përkthimi me makinë. Tashti jemi përfshirë pa kthim në epokën e globalizimit. Kjo do të thotë se edhe gjuha shqipe është e përfshirë në komunikimin global. Nuk është ndonjë gjë e fshehtë, që gjuha e globalizimit është anglishtja. Kjo gjuhë ushtron ndikim global. Një nga rrethanat e reja është përhapja e gjerë e dygjuhësisë të shqiptarët. Po kërkohet tashti që gjuha e huaj të futet në klasat e shkollës fillore. Mjafton me kaq për të vërtetuar se kanë ndryshuar rrethanat jashtëgjuhësore dhe brendagjuhësore.

Ndërkaq, përballë këtyre ndryshimeve të dukshme, vihet re që veprat e botuara më 1973 dhe më 1976 as nuk janë ribotuar, as nuk janë ndryshuar. Koha sjell ndryshime dhe risi, gjuha përballët me dukuri dhe me nevoja të reja. Nuk e mohon askush, se koha kërkon ndonjë ndryshim për fjalë të veçanta, si dhe për të pasur një fjalor më të pasur drejtshkrimor. Po flitet këto ditë për një fjalor të madh të shqipes. Po nuk është zënë puna nga kreu. Në radhë të parë duhet të përcaktohet regjistri i fjalësit nga pikëpamja drejtshkrimore.

Rrahja e mendimeve për mbrojtjen dhe lëvrimin e shqipes nuk është një diskutim i mbyllur, përkundrazi, kjo është një fushë e hapur, që e shtyn përpara edhe shkencën tonë, edhe përmirësimin e praktikës ligjerimore, Ne,

domethënë zbatuesit konsequentë të normës së shqipes standarde, duke përfshirë edhe ata që kanë nënshkruar Rezolutën e vitit 1972, nuk u shmangemi mendimeve alternative të shprehura gjatë gjysmë shekulli. Përkundrazi, diskutimet dhe kundërshtimet i kemi ndjekur me vëmendje, pa asnjë paragjykim. Prandaj përgatitëm dy vëllime me titullin “Propozime për drejtshkrimin”, që u botuan më 2021 nga ALSAR në Tiranë dhe më 2022 nga ITSHKSH në Shkup. Edhe qëndrimet kundërshtuese vlejné në një rast të tillë, sepse e shtyjné mendimin shkencor të thellohet më tej, të argumentojë dhe, aty ku e sheh të drejtë, të pajtohet e të shkojë përpara.

Fjalori dhe Rregullat e drejtshkrimit kanë nevojë të ngutshme të ribotohen, por besojmë se të gjithë pajtohemi, që kundrejt kësaj vonese të padrejtë, duhet sa më shpejt të bëjmë përmirësimet e nevojshme. Është e pamundur në një kumtesë të vështrohen të gjitha çështjet, prandaj do të ndalemi vetëm në dy aspekte: parimi themelor i drejtshkrimit dhe pasuria leksikore.

I. Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit përcaktoi në vendimet se: “Parim themelor i rregullave të drejtshkrimit të shqipes të jetë *parimi fonetik*. Ky parim do të zbatohet në të gjitha rastet kur shqiptimi letrar paraqitet i njësuar; në këtë mënyrë do të vendoset një lidhje e ngushtë midis formës së shkruar dhe formës së folur të gjuhës letrare” Në atë kohë ky parim e luajti rolin e vet shumë të rëndësishëm. Ndërsa me një vështrim shkencor të rreptë, drejtshkrimi i shqipes është vetëm pjesërisht fonetik. Parimi fonetik është përcjellë me synimet për të pajtuar kërkesat objektive të kohës me traditat e ndryshme, me mendësinë krahinore dhe me mitet kombëtare. Për ta thënë shkurt, vazhdimisht kanë qenë përpjekje për të përputhur realitetin me ideologjinë, nëpërmjet. koncepteve të ndryshme ideologjike, romantike dhe kombëtare.

Nuk është rasti këtu për parashtrime të hollësishme, por mjafton të shtrohen këto pyetje: Çfarë do të thotë gjuha e popullit? Duhet të heqim dorë nga formula të tilla, si për shembull “Gjuhën e krijon populli . . .” etj. Gjuhën e krijon një etni dhe ajo e përdor, e pasuron derisa kthehet në një komb dhe ndërton një shtet, e njëkohësisht përpunon kulturën e shkruar. Gjuhën e ruan dhe e lëvron një popull në qoftë se me këtë kuptojmë që nga monarku e diktatori, nga kleriku e shkencëtari, nga politikani e shkrimtari dhe deri te

fshatari më i fundit, që të mos përfundojmë te pyetja humoristike: A është prifti popull? Cili është ky shqiptim i përgjithshëm, diçka mjaft tërheqëse, por e mjegullt? Shqiptimi letrar nuk është as shqiptim dialektor, as shqiptim popullor, as shqiptim i përgjithshëm. Ai është shqiptimi në një shtrirje të ngushtë, sepse edhe është shqiptim i mbështetur te gjuha e shkruar, edhe është shqiptim i një sferë të ngushtë komunikimi, kur përdoret stili i plotë. Natyrisht, është e dëshirueshme që ai të bëhet sa më i përgjithshëm, por aspak nuk ka zënë fill si i përgjithshëm. Ky është kufizimi i vërtetë, objektiv, i parimit fonetik kur është puna për përcaktimin e trajtave drejtshkrimore. Kështu, edhe në të gjitha shkrimet e diskutimet, madje edhe në vetë Kongresin e Drejtshkrimit, parimi fonetik është mbështetur gjerësisht në pohime, por është zbatuar objektivisht në mënyrë të kufizuar. Këtë konstatim nuk e formulojmë si kritikë, përkundrazi, e quajmë se zgjidhjet konkrete kanë qenë të drejta edhe shkencërisht, edhe praktikisht.

Një koncept tjetër romantik e kombëtar është shfrytëzuar për kapërcimin e butë të procesit real, domethënë: bashkëveprimi ndërdialektor ose procesi konvergjent në sferën e gjuhës letrare kombëtare dhe kështu kjo gjuhë po kalonte përfundimisht nga gjendja dyformëshe në *një njësi njëformëshe*. Zanafilla ka qenë te Komisia Letrare, kur u pranua të përpunohej një drejtshkrim sa më tepër i përbashkët për të dy dialektet dhe u gjet që të merrej për bazë dialekti i Elbasanit, i cili ishte një urë në mes të dy kryedialekteve. Ishte një frymë rilindëse e shëndoshë, që dha disa rezultate, por ecuria historike ka qenë tjetër. Na duhet ta formulojmë në një mënyrë të prerë (ndonëse në realitet proceset nuk kanë qenë kështu kaq të prera), se nuk ka pasur ndonjë bashkëveprim ndërdialektor, as një zhvillim konvergjent. Këto janë dëshira të mira romantike e kombëtare, por sot pengojnë vështrimin shkencor të pavarur. Autorët, si mbështetësit e standardit, edhe kundërshtarët e tij, i kanë rrahur gjerësisht arsyet gjuhësore dhe jashtëgjuhësore për mbizotërimin e variantit mbi bazën jugore. Ai evoluoi dhe u pasurua si një sistem më vete.

Standardi është zhvilluar e pasuruar për t'u bërë një sistem i mëvetësishëm, i lëvruar sa më mirë për kërkesat e kulturës shqiptare; ai nuk është ndonjë hibrid, as nuk ka pësuar ndonjë zhvillim për t'u bashkuar me diçka tjetër. Edhe varianti mbi bazën e gegërishtes nuk dimë të ketë pasur ndonjë

proces “konvergjent”; ai është lëvruar për të qenë gjithashtu një sistem i mëvetësishëm, i cili në rrethana të caktuara gjithashtu mund të ishte në rolin e standardit dhe përkohësisht e luajti rolin e gjuhës zyrtare, rol në të cilin nuk gjejmë ndonjë bashkëveprim ose konvergjencë.

Është krejt e natyrshme që çfarëdo standardi do të mbështetej mbi tiparet dhe mjetet e përgjithshme të shqipes, përndryshe do të kishim gjuhë të dalluara, siç është shfaqur me këmbëngulje veçimi i gjuhëve të ndryshme sllave. Këtu do të shtojmë diçka tjetër. Për të funksionuar si gjuhë e një kulture të kohëve të reja, shqipja standarde ka qenë e hapur edhe kundrejt ndikimeve të gjuhëve të huaja të reja. Kështu mund të mjegullohej fakti, që shqipja standarde ishte ngritja në nivelin e një strukture të vetme kombëtare e njërit variant letrar. Kongresi i Drejtshkrimit ishte një veprim vendimtar, mbi baza historike e shkencore, me rrezatim të pakufizuar kulturor e kombëtar dhe me vlera praktike të prekshme.

Parimi morfologjik nuk ka hasur kundërshtime, por ka nxjerrë probleme zbatimi i tij. Pikërisht zgjidhje të atilla, kur nuk ka pasur konsekuencë në zbatimin e parimit morfologjik, shkaktojnë diskutime.

Në rast se do ta vështrojmë në gjerësinë e tij leksikun e gjuhës letrare, do të bindemi se është e kundërta, domethënë është parimi historik që ka një zbatim shumë të gjerë. Ky parim ka luajtur rol në rritje sidomos për shkak të rritjes së vazhduar të huazimeve të reja në gjuhën shqipe. Kështu, ka mbizotëruar mendimi, që për një grup fjalësh të mos merret trajta e cila përfaqëson shqiptimin në një gjuhë të re, por të parapëlqehen trajtat që shkojnë te gjuhët e vjetra, greqishtja e latinishtja, sepse edhe trajtat e gjuhëve të reja vijnë prej andej. Me këtë rrugë drejtshkrimi i shqipes në disa pika është më i afërt me gjuhët e tjera europiane, domethënë edhe me anglishten, me gjermanishten, me rusishten, natyrisht duke mos përjashtuar përshtatjet përkatëse të pamënjueshme në secilën gjuhë. I gjithë kreu III “Disa tipa fjalësh me prejardhje të huaj dhe emrash të përveçëm” i librit të Drejtshkrimit është prova më bindëse, se parimi historik ka një zbatim shumë më të gjerë sesa është pranuar me fjalë nga rregullat e drejtshkrimit, domethënë e ka ngushtuar ndjeshëm parimin fonetik. Nga ana jonë, pajtohemi plotësisht me këtë zgjedhje, sepse me këtë rrugë drejtshkrimi i shqipes bëhet më i afërt me gjuhët e tjera europiane.

Pas një gjysmë shekulli mund të pohohet, se parimi pjesërisht fonetik i drejtshkrimit të shqipes tashmë ka bërë që rrjedhojat e tij gjithashtu të mbeten historike dhe kështu drejtshkrimi i shqipes pak nga pak po bëhet i ngjashëm me atë të gjuhëve të tjera europiane. Ai nuk mund të jetë parim i përhershëm, sepse do të kërkonte ndryshime të përhershme, domethënë bie ndesh me rolin themelor të kodifikimit të gjuhës standarde për qëndrueshmërinë e saj gjeografike dhe historike. Me kalimin e kohës edhe gjuha shqipe e shkruar vjen në po atë gjendje në të cilën janë gjuhët e tjera europiane. Pa hyrë në trajtime teorike, dëshirojmë ta përmbledhim këtë pikë kështu: drejtshkrimi do të mbështetet jo në shqiptimin më të përgjithshëm, që është një nocion i vagullt e i pazbatueshëm, por te shqiptimi i shtresave të kulturara, që e përdorin gjerësisht gjuhën e shkruar në komunikimin publik, dhe jo te shqiptimi i analfabetëve funksionalë, të cilët edhe mund të përbëjnë një shumicë si sasi, por për të cilët ne kemi nevojë ta ngremë nivelin e tyre kulturor e gjuhësor dhe jo të ulemi te niveli i tyre.

Drejtshkrimin e përcakton jo përdorimi në gjuhën e gjallë dhe në variantet krahinore, por përdorimi i gjuhës së shkruar nga ata që e shkruajnë vazhdimisht gjuhën, që kujdesen për lëvrimin dhe pasurimin e saj në mënyrë të vetëdijshme, që e kanë mjet të punës, të veprimtarisë e të krijimtarisë, që përpunojnë sfera të cilat nuk i mbulon gjuha e zakonshme e folur, domethënë shkenca, teknologjia, ekonomia, politika, drejtësia, administrata, mjekësia, letërsia dhe kultura përgjithësisht. Për ta sintetizuar këtë mendim, do ta themi shkurt: rregullat e drejtshkrimit i përcakton një elitë.

Nuk jemi më te fillimet, por te qëndrueshmëria e vazhdimësisë.

Për mendimin tonë, tashmë për drejtshkrimin e shqipes ka vetëm dy parime; parimi morfologjik dhe parimi historik. Edhe në shkollë ta vëmë theksin te parimi morfologjik e historik dhe të këmbëngulim, që gjuha e shkruar mësohet në shkollë dhe e dimë që shkolla fillore është shkolla e dy lëndëve: gjuhës dhe aritmetikës. Të këmbëngulim që në komunikimin publik të mbizotërojë shqiptimi letrar, domethënë shqiptimi më i afërt me gjuhën e shkruar, dhe jo e kundërta: gjuha e folur ta heqë zvarrë gjuhën standarde.

Drejtshkrimi nuk është një zgjedhje e mbështetur në sasi, në numrin e frymorëve ose të faqeve të shkruara, është një përzgjedhje ndërmjet tyre, por

asnjëherë të mos harrohet se përzgjedhjen e bëjnë njerëzit dhe kur vjen fundi te drejtshkrimi këtë përzgjedhje e bën një numër i vogël njerëzish, i cili e përlligj përfundimin me parimet që parashtron dhe përsëri parashtrimin e bëjnë një grup njerëzish. Gjuha e shkruar është produkt i kulturës dhe e lëvrojnë njerëzit e kulturës.

Në mënyrë paradoksale, ai parim që mundësoi kapërcimin e ngërçit për një drejtshkrim të shqipes standarde, ai parim që shpallej si themelori, pikërisht ai po shfrytëzohet në mënyrë keqdashëse për ta goditur standardin. Shembujt konkretë i kam dhënë hollësisht në librin “E duam drejtshkrimin si gjithë Europa” (2022) dhe nuk do t’i rimarr këtu. Disa autorë shpërdorimin e parimit fonetik e mbulojnë madje me *fake news* dhe duke sulmuar si armike ndonjë tingull e shkronjë, ose nën emrin e sistemorësisë, marrin një trajtë si ua do veshi dhe kërkojnë që pastaj të bëhen sipas saj edhe fjalë të tjera. Gjuha nuk është një sistem matematik ose mekanik, që të shkruhet sipas disa formulave dhe këto formula të sajohen sipas mendjes së njërit apo tjetrit, ndërsa gjuha e shkruar nuk është një organizëm i gjallë, i cili ndryshoka si një organizëm, ide që është hedhur poshtë prej kohësh nga gjuhësia shkencore. Ajo është një dukuri shoqërore historike me të gjitha ndërlikimet, me shtresa të ndryshme, të cilat nuk mund të rrafshohen sipas një prapamendimi, sidomos sipas prapamendimeve krahinore.

Pasoja më e rëndë e shpërdorimit të parimit fonetik është largimi i gjuhës së shkruar shqipe nga gjuhët e shkruara me alfabetin latin të Europës (dhe të Amerikës, të Australisë e diku gjetkë).

Parimi fonetik në një varg rastesh nuk është e mira të zbatohet edhe për arsye pikërisht fonetike. Edhe nga autorë të tjerë është vënë në dukje, se me këtë rrugë do të shtohet numri i homonimeve, domethënë në vend të bëhej ndonjë thjeshtësim do të shfaqej një ndërlikim, madje gjuha shqipe do të përfundonte në një gjuhë me fjalë njërrrokëshe.

Sfidën më të madhe për parimin fonetik e paraqesin sot hapja e gjuhës shqipe dhe anglishtja si gjuha e globalizimit. Na duket se vëmendja tashti duhet drejtuar sidomos te dukuria e citimeve, të cilat sjellin ndërlikime nga disa pikëpamje. Problemi i drejtpërdrejtë me anglishten është se ajo ka një shkëputje të madhe ndërmjet trajtës së shkruar dhe shqiptimit. Si do të bëjmë me drejtshkrimin e fjalëve, duke nisur me më të zakonshmen: *e-mail*? Është

tejet e ngutshme të rrihen gjerësisht këto çështje nga specialistët dhe të arrihet te një zgjidhje e pranueshme. Kjo pikë tregon sesa e rëndësishme është të merremi jo me debate boshe për të kaluarën, por me probleme të mprehta të sotme dhe të së ardhmes. Përshkrimi i pesëdhjetë vjetëve na vë për detyrë të shohim për më tej, për pesëdhjetë vitet e ardhshme, që të jetë i sigurtë komunikimi në vazhdimësi.

Në tekstet shqipe tashmë nuk janë të paktë shembujt, kur diçka ndryshe shkruhet dhe ndryshe lexohet, domethënë parimi fonetik e ka luajtur rolin e vet në kohën e duhur, por tashti nuk gjen vend zbatimi i tij si parimi i parë në rrethanat e hapjes kundrejt gjuhëve të tjera, e shtimit të dygjuhësisë e sidomos nën ndikimin e globalizimit nëpërmjet anglishtes.

Gjysmë shekulli nuk është pak edhe për jetën e një gjuhe të shkruar, sidomos në epokën e sotme të zhvillimeve të vrullshme në të gjitha anët. Pesëdhjetë vjet pas vendosjes së normave përfundimtare për shqipen standarde natyrshëm shtrohet pyetja: a ka nevojë për ndryshime? Si do të pasqyrohen huazimet e reja pa një diskutim shkencor paraprak?

Ka edhe një pyetje tjetër, me të cilën e vlen të merremi dhe që na duket po ashtu mjaft tërheqëse: a ka nevojë për plotësime? Pa dyshim ka dhe këtë jemi përpjekur ta argumentojmë duke trajtuar pikën e citimeve.

Nuk është përfshirë fusha e citimeve as në rregullat e drejtshkrimit të miratuara nga Kongresi i Drejtshkrimit më 1972 dhe as në Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe, të botuar më 1976. Ka nevojë për një dallim thelbësor ndërmjet citimeve dhe huazimeve. Rrethanat më të përshtatshme për depërtimin e citimeve i krijon prania e dygjuhësisë, prandaj kur flitet për huazimet në shqipen nga një gjuhë e huaj ose për etimologjitë është mirë të dëshmohen edhe kushtet e dygjuhësisë.

Citimet janë të njohura për shqipen qysh te libri i Gjon Buzukut. Ato janë rastet kur diçka ndryshe shkruhet dhe ndryshe shqiptohet. Faktet janë kokëforta dhe na duhet të hulumtojmë e të gjejmë shpjegimin e tyre ose zgjidhje të reja. Është e dukshme, që në kushtet e dygjuhësisë (dhe po shkojmë drejt gjendjes kur shumica e shqiptarëve do të jenë dygjuhësh, ashtu siç janë shtetasit e Vendeve nordike), kur anglishtja po mësohet që në fillore, kur për gjithçka mjafton të hapet celulari ose kompjuteri, disa çështje drejtshkrimore kanë nevojë për rrahje mendimesh. Sepse është shteti ynë që po promovon dygjuhësinë.

Mendoj që është e mira t'i drejtohemi edhe një parimi të tillë: fjalët të shkruhen si citime ose sa më afër drejtshkrimin në shumicën e gjuhëve europiane dhe jo sa më afër shqiptimit në një katund shqiptar, ku për fat të keq edhe popullsia po vjen duke shterur.

Në mënyrë fare sintetike dhe simbolike po pohojmë, se problemi i shqipes së sotme janë “live” dhe “like”. Pyetja është: si do të shkruajmë *bachelor*, *baccalaureate*? Rrjedhimi kryesor i këtij diskutimi është, se parimi fonetik e ka luajtur rolin e vet gjysmë shekulli më parë në përcaktimin e rregullave të drejtshkrimin, por ai nuk pajtohet me zhvillimet e mëtejshme.

II. Dyfishimi i fjalëve në ribotimin e Fjalorit drejtshkrimor është plotësisht i mundshëm brenda një kohe të shkurtër. Puna mund të bëhet brenda periudhës që diskutohen e vendosen zgjidhjet e tjera sipas rregullave. Ndërkaq, mund të parashtrihen disa kërkesa.

Në një fjalor drejtshkrimor jepen shpjegime fare të shkurtra, sidomos me një sinonim, vetëm kur fjala nuk është e njohur përgjithësisht.

Në rast se vlerësohet që një fjalë e huazuar është e panevojshme të përdoret në shqipen standarde, ajo nuk përfshihet në rregullat dhe në fjalorët. Në rast se megjithatë ajo nuk mund të mënjanohet, fjalori drejtshkrimor ka për detyrë të japë trajtën e saj shkrimore sipas normës. Të gjithë e ngrenë zërin kundër fjalëve të huaja të panevojshme, domethënë e kemi për detyrë të bëjmë një përzgjedhje kundrejt fjalëve që dalin jo vetëm nga anglishtja, por edhe nga italishtja, greqishtja, gjuhët sllave, turqishtja, serbishtja. Kjo kërkon studime të mëtejshme dhe jo zgjidhje sipas parapëlqimeve vetjeake.

Fjalët e huaja hyjnë sot në shqipen, në fillim edhe si citime, ndërsa kjo do të vijojë edhe në të ardhmen. Kjo kumtesë nuk synon të jap zgjidhje, por të paraqesë gjendjen dhe vetëm një diskutim i gjerë specialistësh do të na tregojë rrugët për të ardhmen, duke u nisur nga parime shkencore.

Nuk do të pajtohemi me përpjekjet për ta larguar leksikun e shqipes nga gjuhët europiane. Ndërsa njëkohësisht nuk kemi përse të pranojmë neologjizma të sajuar, që bien erë myku nja një shekull më parë dhe duken si ajo puna e dyrrotakut. Ka trajtime që janë në kundërshtim me natyrën e shqipes. Qe një shembull. Janë përdorur si fjalë të përngjitura mjaft sajime, si për shembull ‘sygomari’. Në gjuhën shqipe kjo do të thoshte: që e ka syrin si të

gomarit. Në të vërtetë ka një lule, e cila natyrisht nuk ka sy, por i ngjan syrit të gomarit dhe prandaj drejtshkrimi i saj është *syri i gomarit*.

Është e vërtetë që ka edhe përdorime të ligjërimit të shkujdesur, madje edhe fjalë të pakulturuara, por nuk do të ishte e drejtë të përfshiheshin këto në një fjalor, i cili në thelbin e tij përfaqëson kulturën e gjuhës shqipe.

Së fundi, terminologjia e të gjitha fushave të dijës është zgjeruar në përmasa të papara; kimia ka arritur një milion njësi. Jo vetëm do të përzgjidhen ato që dalin më shpesh edhe në tekstet jo speciale, por edhe një punë plotësuese e bëjnë fjalorët terminologjikë. Disa detyra u bie t'i zgjidhin fjalorët e posaçëm. Kështu, është e nevojshme të ketë një Fjalor të shkurttimeve. Është botuar Fjalori i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë (2002) dhe po punohet për një të tillë edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Diçka më vete janë ekzotizmat. Shkurt, jo gjithçka e ka vendin në Fjalorin drejtshkrimor.

Gjithsesi, problemi themelor mbetet, se cili është koncepti ynë për korpusin e leksikut të shqipes, çfarë do të pranojmë dhe do të jetë pjesë e fjalorit drejtshkrimor dhe çfarë nuk do ta përfshijmë. Para së gjithash, ai e ka për detyrë të pakësojë numrin e varianteve të shkruara dhe krahinore. Shumë variante, sidomos me dukuri tejet të ngushta dialektore, e paraqesin leksikun e shqipes së shkruar të pastabilizuar, gjithashtu edhe formimet e gjuhës së folur me gjithfarë prapashtesash po nga ajo temë.

Në tekste të shqipes mund të dalin fjalë, të cilat ose autori nuk ka ditur si t'u thotë shqip, ose në trajta e kuptime të gabuara sipas paditurisë së vet. Është e papranueshme që gjëra të tilla të rastit, pas asnjë jetë në leksikun e shqipes, të përshihen në fjalor; përndryshe leksiku i shqipes del një përshesh gjuhësh.

Si parim drejtues do të ishte, që pasuria e leksikut në fjalor ta mbështeste idenë, se *kjo është gjuha jonë e ëmbël dhe e bukur dhe jo një korpus, që do të mbështeste fyerjen se shqipja është një gjuhë e përzier*.

Fjalorët normalë të të gjitha gjuhëve kanë zgjidhje teknike të caktuara, për shembull, i vënë numërorët si pjesë e parë, japin vetëm disa fjalë me përdorim të dendur, por jo rastet potenciale. Ndërkaq, nuk marrin si njësi të leksikut rastet kur gjuha e shkruar ka zgjidhje të veçanta, për shembull, me

një vizë lidhëse. Po ashtu me një parashtesë mund të ndërtohet një numër i madh foljesh, por jo të kapërcehet çdo masë. As dukuritë stilistike dhe neologjizmat vetëm në tekstet e autorëve të veçantë apo për qëllimet satirike nuk i përkasin drejtshkrimit.

E quaj se duhet të shndërrohet në një parim të drejtshkrimit, që emrat e përveçëm të huaj mundësisht të shkruhen sa më afër drejtshkrimit në gjuhën përkatëse me alfabet latin. Në shkallë ndërkombëtare është kërkuar që në hartat emrat e vendeve të shkruhen sipas trajtës që kanë në gjuhën e vendit. Propozimi që *Viktoria* të shkruhet ‘Viktorje’ sepse më kujton *fitorjet* e E. Hoxhës. Kurse për toponimet shqipe nuk ka përse të kthehemi te trajtat krahinore aty, ku tashmë ka gjetur përdorim një trajtë letrare e përgjithshme, domethënë do ta kemi *Shkëmbi i Kavajës* dhe nuk ka kuptim të kthehemi te ‘Shkomi Kavajs’.

Është rishfaqur kërkesa për të shkruar me të madhe emrat e popujve dhe të etnive. Më duket më e drejtë të vijojmë traditën neolatine, duke nisur me emrin e popullit tonë. Vërejtja e përgjithshme është që rregullat e shkrimit me shkronjë të madhe kanë nevojë të thjeshtohen e të bëhen më përgjithësuese.

III. Mendimet, diskutimet dhe propozimet janë kurdoherë të mirëpritura, vetëm se për gjithçka që është e drejtë dhe e dobishme, ka nevojë të ndiqet një rrugë, që të kthehet në realitet, që të zbatohet. Nuk shohim, se janë rrethanat për të kërkuar ndonjë kongres tjetër.

Rregullat e drejtshkrimit dëshirojmë t’i quajmë si një farë kushtetute të shqipes standarde. Është provuar se ndryshimet e shpeshta kushtetuese sjellin pështjellime në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike. Qëndrueshmëria është një e mirë e paçmueshme për jetën e vendit, për kulturën dhe identitetin kombëtar. Ndryshimet e nevojshme për kushtetutat paraqiten si amendamente. Drejtshkrimi i shqipes nuk ka nevojë as për përmbyesje, as për rishikim, as për ta gërryer nga brenda me disa ndryshime kinse të jashtme. Ai nuk ka nevojë sidomos për protagonizëm mburracak të njerëzve të veçantë ose të grupeve të veçanta. Ai ka nevojë vetëm për amendamente.

Ka ardhur koha që menjëherë Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë si hapi i parë të ngrerë një Komision drejtshkrimi me përfaqësues mbarëshqiptarë të institucioneve akademike dhe universitare, gjuhëtarë e pedagogë, duke

përfshirë edhe kolegët e Prishtinës e të Shkupit, i cili të diskutojë çështjet e reja që kanë dalë gjatë këtij gjysmëshekulli, por jo që të zhbëjë arritjet e gjuhës standarde. Tani për tani pa shumë shpenzime mund të ngrihej si qendër virtuale: Komisioni i Amendamenteve të Drejtshkrimit. Diskutimet të bëhen publike herë pas here derisa të arrihet te zgjidhje të pranueshme. Për ta ndihmuar punën e një Komisioni të tillë kemi botuar vjet edhe dy vëllimet “Propozime për drejtshkrimin”. Ky Komision të përçaktojë edhe grupin e atyre, që do të ribotojnë Fjalorin e drejtshkrimit të shqipes. Por në asnjë mënyrë të mos fshihen emrat e hartuesve të vitit 1976.

Për konkretizim po marr si shembull emrin *Evropë* dhe gjithë fjalët e tjera lidhur me këtë temë fjalëformimi. Nuk ka nevojë për shumë gjurmime, që të provohet se sot tashmë shkruajnë *euro*, *eurodeputet*, *Eurovizion*, *eurozonë* etj. Komisionit i propozohet Amendamenti 1, domethënë këtej e tutje do të zbatohet në shkrim tema *euro*-. Propozimi u njoftohet edhe gjithë mediave, shtëpive botuese, redaksive etj., që të shprehin miratimin ose kundërshtimin. Komisioni i shqyrton të gjitha përgjigjet dhe harton një raport përfundimtar. Ai u dërgohet ministrive të arsimit e të shkencës, që ta miratojnë me një vendim zyrtar. Vendimi u përcillet të gjithëve, deri te shkollat fillore, me lutjen që ta zbatojnë. Më pas i vjen radha një amendamenti tjetër me të njëjtën ecuri, për shembull, për drejtshkrimin e emrave të përveçëm të gjuhëve të huaja.

Zgjidhja e vërtetë dhe e themeltë do të ishte të ngrihej një institucion i tipit të *Academia della Crusca*, që funksionon prej shekujsh për italishten, Mjafton të merret përvoja e saj dhe të krijohet sipas modelit të saj *Akademia e Visarit të Shqipes*. Ideja themelore e këtij propozimi është që drejtshkrimi mbetet i sanksionuar, vijon t’u shërbejë të gjithëve pa mëdyshje dhe pa orvatje individuale; ai hyn në procesin e përmirësimit pa ia tronditur parimet dhe këto përmirësime të shkallëshkallëshme nuk ia vështirësojnë punën askujt, as nuk shoqërohen me shpenzime të mëdha. Do të ecej përpara pa u ndier lëkundje dhe do të parapërgatitej *Akademia e Visarit*.

Kombi shqiptar e ka tashmë një gjuhë standarde me historinë e vet. E ka tepër të dobishme dhe po aq të nevojshme në rrethanat, kur është i shpërndarë në disa shtete brenda arealit të gjuhës së vet. Kombi shqiptar po

i plotëson më së miri gjithë kërkesat e veta në komunikimin publik me gjuhën standarde, e cila nuk e pengon përdorimin e varianteve të tjera, sidomos në fushën e krijimtarisë. Kombi shqiptar paraqitet me një gjuhë të vetme shtetërore edhe në marrëdhëniet me shtetet e tjera, edhe në familjen e gjuhëve të Bashkimit European.

Kombi shqiptar nuk ka nevojë për abetare të ndryshme, për drejtshkrime të ndryshme, për gramatika dhe fjalorë me baza dialektore të ndryshme. Me studimin e tyre le të merret shkenca gjuhësore, historia. Kombi shqiptar nuk ka nevojë për fjalorë dygjuhësh shqip-shqip, ose po ta shprehim ndryshe, nuk ka nevojë të përgatisë përkthyes ndërmjet dy gjuhësh të huaja nga shqipja në shqipen, sipas shembullit ndërmjet kroatishtes dhe serbishtes.

Tashmë po bëhet pothuaj gjysma e periudhës së shtetit të pavarur shqiptar, gjatë së cilës ai zbaton një gjuhë standarde. Pa dyshim, ka interes shkencor të shqyrtohet historia e ngulitjes së normës standarde bashkë me rrethanat jashtëgjuhësore, politike e kulturore, që ndikuan procesin e gjatë deri në mbylljen e tij. Norma gjuhësore dhe aq më pak historia e saj nuk ua cenon njerëzve gjallërinë e komunikimit në jetën e përditshme; ashtu si në çdo vend të botës gjuha e gjallë ka rrjedhën e vet, nga e cila përkundrazi, nxjerr pasuri të reja standardi, as nuk pengon përdorimet shprehëse dhe estetike.

Proceset historike bëjnë punën e tyre dhe neve nuk na takon t'i paragjykojmë, t'i shtrembërojmë e t'i cenojmë me ndërhyrje të parakohshme e të papjekura.

Shqipja standarde e ka të ardhmen përpara në një rrugë pasurimi, lëvrimi e përsosjeje. Tradita tashmë gjysmëshekullore e bën atë solide dhe e ndihmon që të mos perceptohet si diçka e vjetruar, për ta rrënuar, përkundrazi, të vijojë të përdoret e të përvetësohet nga brezat e rinj si mjet i shkëlqyer i përbashkësisë kombëtare, i identitetit dhe i kulturës së shqiptarëve në kohët e reja.

Mbetet në rend të ditës puna për ngritjen e kulturës përgjithësisht dhe të kulturës së gjuhës në veçanti, ndërsa kulturës së ligjërimit del nevoja t'i drejtohem për shkak të rënies së ndjeshme të etikës, të mirësjelljes në komunikim.

Duke ndjekur një parullë politike, dëshiroj t'i sintetizoj mendimet e

mia me këtë shprehje: *E duam drejtshkrimin si gjithë Europa*. E duam me e-mail, me online, me live, me Apple, me Benz, me Toyota.

Duhet të mësohemi të jetojmë në një botë shumëgjuhëshe, duke ruajtur identitetin tonë dhe gjuhën tonë të shtrenjtë.

Prof. dr. Imri BADALLAJ

Prishtinë

EDHE DIÇKA MBI PASKAJOREN GEGE TË TIPIT *ME + PJESORE*

Dominon mendimi se paskajorja si formë perifrastike është krijuar brendapërbrenda shqipes gjatë zhvillimit historik të saj, atëherë kur u krijuan edhe format e tjera foljore. Si e tillë kjo formë foljore gjallon në të dy kryedialektet e shqipes, por me dallime në mënyrën e ndërtimit të saj dhe në dendurinë dhe masën e përdorimit apo të shtrirjes.

Në shqipen standarde, sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, tipi i paskajores *me punue*, që është tipar qenësor i gegërishtes dhunshëm u përjashtua nga përdorimi, duke u zëvendësuar nga forma foljore e pashtjelluar e përbërë nga pjesëza parafoljore dhe emri foljor asnjanes i pashtuar: *për të punuar*, formë kjo, që në shqipen standarde u bë zotëruese, ngase e gjithë toskërishtja në sistemin e saj foljor e posedon një formim kështu. Përndryshe, në sferën dialektore paskajorja e mirëfilltë (*me ba, me la, me punue*) ka një shtrirje fort të dendur, jo vetëm në gegërishten e Shqipërisë Veriore dhe në atë të Shqipërisë së Mesme, por edhe në gjithë Kosovën, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në trevat shqiptare në Jug të Serbisë.

Pra, tipi i paskajores *me punue* është kryekëput dominues në shtrirjen më të madhe të shqipes, duke kryer funksione të shumta gramatikore.

Është për t'u përmendur edhe tipi i paskajores *për me punue*, që haset në gegërishten jugore, që padyshim është rezultat i kontaminimit të paskajores *me punue*, por një formë e këtillë nuk i kaloi caqet e të folmeve, që i përmendëm. Sipas Jorgji Gjinarit në toskërishten veriore shpesh haset një formë e kohës së shkuar të paskajores, e cila ka gjetur vend në një funksion sintaksor të caktuar dhe përdoret si folje kallëzues e një fjalie kushtore: *Mos me pa dit, kishte nejt*.¹

¹ Jorgji Gjinari, Dialektologjia shqiptare, Tiranë, 1988, f. 98.

Mendimi i gjuhëtarëve rreth kësaj forme foljore në segmentin diakronik është shumë i diskutueshëm, sepse edhe vetë udha e formimit të saj në gjuhën shqipe ka qenë me ndryshime të mëdha. Prandaj, mendimet e gjuhëtarëve, që shpeshherë janë kontradiktore, na bëjnë të gjykojmë, se çështja e infinitivit në gjuhësinë shqiptare është e një rëndësie të veçantë. Ata të cilët mendojnë se paskajorja është një kategori foljore, e cila është zhvilluar në familjen e gjuhëve indoevropiane nuk janë të pakët. Mirëpo, mënyra e formimit të saj në këtë familje të madhe gjuhësh ka pasur një zhvillim me drejtime të ndryshme, çfarë edhe përcaktimi i tipareve dalluese ose edhe i tipareve të përbashkëta ndërmjet tyre është mjaft i vështirë për t'u shpjeguar.

Tentime për shpjegimin e kësaj forme foljore, sidomos në rrafshin e gjuhëve ballkanike kanë bërë: Selman Riza, Eqrem Çabej, Jozef Brajan, Helmut Shaller, Kristian Sanfeld, Besim Bokshi, Holger Pedersen, Ölberg Herman, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Vaclav Cimohovski, Idriz Ajeti, Mehmet Çeliku, Kolec Topalli, Jup Kastrati, Bahri Beci. Rexhep Ismajli, Tomor Osmani, L. Mario Savoja, Imri Badallaj, Seit Mansaku, Françesko Altimari, Nuhi Veselaj e ndonjë tjetër.

H. Pedersen² është i mendjes se ka ekzistuar një paskajore, që një një fazë të zhvillimit të saj është bërë unifikimi i formës së pjesores me format e paskajores. Format e pjesores: *pa pasur* dhe *do me thanë* i trajton si paskajore të mbarë shqipes. I këtij mendimi është edhe N. Jokl, K. Sanfeld e ndonjë tjetër.

I përmenda këta dy gjuhëtarë, sepse ata kishin bërë shpjegime të argumentuara, se shqipja ka pasur një paskajore me kuptim indoevropian, tezë kjo që disa gjuhëtarë, ndoshta më pak të thelluar në këtë problematikë e mohojnë një qëndrim të tillë.

Gjuhëtari ynë i madh- Selman Riza, çështjes së paskajores i ka bërë një trajtim më të gjerë se të gjithë të tjerët, që ky origjinalisht e sheh infinitivale edhe pjesoren brenda formës së përcjellores: *tue punue* dhe *nxjerr*, se trajta *punue*, të cilën e njohim sot si pjesore, do të ketë qenë në shqipen e lashtë vetëm paskajore³. Ndërsa Mahir Domi shprehet: *Trajta primare e paskajores së shqipes ka qenë gjitha gjasash e thjeshtë si ajo e gjithë gjuhëve*

² Holger Pedersen, IF – ANZEIGER, 91-93.

³ Selman Riza, Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore, Tiranë, 1994, f. 94.

*motra indoevropiane*⁴. Ky më tutje shton, se trajtën e paskajores së thjeshtë të lashtë duhet ta kërkojmë ndër trajtat e sotme të pjesores, që me kohë i kanë përzier funksionet e pjesores me ato të paskajores dhe kështu u formua paskajorja analitike, që padyshim trajtat e thjeshta mbeten si trajta pjesoreje.

Pra, Domi shpreh mendimin e tij se paskajorja me *me* ka qenë e tërë shqipes, sepse mbeturinat e këtij mjeti gramatikor nuk mungojnë edhe në toskërishten.

Edhe Dhimitër Kamarda në shqipen ka parë një paskajore sintetike me formantin *-me* (*me shkrueme*). Ndërsa Gustav Vajgandi emrat prejfoljorë të tipit *ndihmë* dhe emrat përpjesorë të tipit: *e shkumja*, *e dridhmja* etj., i trajton si infinitiva të substantivuar.

Gabinski prapashtesën *-me* të Kamardës e vë në dyshim, që kjo prapashtesë të ketë pasur lidhje me sufiksin participor *-m* të gjuhëve të tjera indoevropiane⁵.

Eqrem Çabej ka besuar në praninë e një infinitivi sintetik në shqipen, por duke mos e përzier këtë me format e pjesores të çfarëdo faze qofshin ato⁶.

Shaban Demiraj në tipin e formave *me ba* sheh ekzistimin e paskajores, që me kohë këto forma janë zhvilluar si zëvendësime të formave të një paskajoreje më të vjetër, e cila ka mundur të jetë zhdukur. Mirëpo, Besim Bokshi në studimin e tij monografik: *Pjesorja e shqipes - vështrim diakronik* na duket se më shumë se gjithë të tjerët është thelluar edhe rreth çështjes së paskajores në shqipen, për të cilën shton: Argument kryesor në të cilin bazohet mendimi, se shqipja e fazës së dokumentuar ka krijuar dëshmi të pranisë së dukshme të paskajores sintetike, e cila del me formën e pjesores së sotme me burim nga participi pasiv i perfektit, merret në radhë të parë bashkëvajtja e kësaj forme foljore modale *duhet* dhe *do*: *duhet thënë – do thënë, duhet larë – do larë*, duke pasur parasysh se në gjuhët neolatine perëndimore këto folje ndiqen nga infinitivi. Nga kjo, shton më tutje Bokshi, u konkludua pastaj edhe për format: *me la – pa la*, apo *pa larë*, si të përbëra burimisht

⁴ Mahir Domi, Morfologjia historike (Konspekt leksionesh), Tiranë, f. 67.

⁵ Mark Gabinski, Pojavljenje i utrata pervičnogo albanskogo infinitiva, Leningrad, 1990, f. 9.

⁶ Eqrem Çabej, Studime filologjike, 3, 1975, f. 55.

nga paskajorja me parafjalë e u nxor në vijim i njëjti përfundim për përcjelloren: *tue la – duke larë*⁷.

Gjergj Pekmezi mendon se trajta e shkurtër e pjesores brenda kohëve të përbëra është e besueshme të jetë formë e shkurtuar e infinitivit të lashtë⁸⁸). Edhe Xhuvani është kategorik në bindjen e tij, se shqipja e lashtë ka pasur një paskajore sintetike të tipit indoevropian.

Ndërsa Gabinski në një studim të tij shton: *Analiza kritike e argumenteve për dhe kundër infinitivit të lashtë të shqipes (apo protoshqipes) të çfarëdo infinitivi më të vjetër, përveç atij të përdorshmit nuk ka*⁹.

Për këtë infinitiv, që Gabinski e quan të përdorshëm, për Çabejn skema e paskajores *me+pjesore* nuk ka qenë e mbarë shqipes dhe të jetë zhdukur pastaj në toskërishten¹⁰.

Disa gjuhëtarë pa një analizë dhe shpjegim të thuktë për këtë mjet të rëndësishëm gramatikor e mohojnë ekzistencën e mëhershme. Të tillët janë:

Bariqi, Ajeti, Majeri e Hahni. Përkundër këtyre gjuhëtarëve që po sa i zumë ngoje, F. Altimari është i bindur thellë për ekzistencën “...e njëjti arketipi të përbashkët *me + pjesore*, dikur pjesë e shqipes së përbashkët e me gjasë, zëvendësues i një forme më të vjetër sintetike të realizuar me anë të pjesores sipas modelit indoevropian, duhet të jenë gjeneruar paralelisht në shqipen e përbashkët dy struktura perifrastike të paskajores: *për+me+ pjesore* dhe *për+të+pjesore*, dikur të shtrira në të dy dialektet edhe në arbërisht, dëshmi kjo e një faze më të njësuar të shqipes, të paktën që në shekujt e parë të dokumentimit të saj. Më vonë këto trajta të paskajores pësuan ngushtim të funksionev.¹¹ Ja edhe disa shembuj të paskajores të shtruar nga ky gjuhëtar arbëresh, të cilat forma infinitivale janë vjelë nga autorët arbëreshë dhe arbërishtfolës të sotëm me strukturën: *me+pjesore*.

Nga Nikollë Filja në veprën *Kodi i Qeftit (Il Codice Chieutino): E sa tona t'mira t'jenë gjithë të tijët e s'jan me thënë*, f. 143). Andaj ka *mo*

⁷ Besim Bokshi, Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik, Prishtinë, 1998, f. 11.

⁸ Gjergj Pekmezi, Grammatik der albanesischen Sprache, Wien, 1908, s. 130

⁹ Mark Gabinski, Po aty, f. 35.

¹⁰ Eqrem Çabej, Po aty, f. 56.

¹¹ Francesco Altimari, Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshë, Prishtinë, 2002, f. 114.

ardhurë, mo gjukuar të gjalltë e të vdekurit, po aty, f. 47). Ka mo ardhure. Krishti papa në jetë, po aty, f.47. Shërbiset e mia s'janë për me o thën, f. 50.

Nga Nikollë Keta në veprën *Urtsia e Kërshtë e Ndëlgisa e Barisisë të gjith Rruzullimit: Vjen me rarë, f. 64. Desh me mbësuarë të marrëvet jevre, po aty, f. 58. Për mbi malet kanë me mbetur ujërat, f. 88. Këtu mbarë kam me porositurë, f. 66; Në të folmen e Fermës F. Altimari regjistroi personalisht forma të paskajores të tipit: *për me ngrënë, për me pūr*. Edhe në të folmen e Lungrës i ka gjetur shembujt me të njëjtat forma si në Fermë: *pri me ngrënë, pri me pir*. Edhe në Shën Vasil janë të përhapura ndërtimet analoge si: *pri ma ngrōn* (< për me ngrënë) e *pri ma pūr* (< *për me pir*)¹² etj.*

Nga të gjitha mendimet dhe gjykimet e gjuhëtarëve të zënë ngoje më sipër për paskajoren, mendojmë se shpjegimi i Selman Rizës më bindshëm qëndron, i cili thotë: *Nuk ka dyshim trajta punue, të cilën na sot e njohim, vetëm si particip, do të ketë qenë në shqipen e lashtë vetëm infinitiv*¹³.

Në anën tjetër edhe vetë funksionet sintaksore, të cilat shprehen dhe ndërtohen me paskajore, bindshëm përforcojnë mendimin e gjuhëtarëve:

N. Joklit, K. Sanfeldit, S. Rizës, B. Bokshit e ndonjë tjetrit, që kësaj radhe këtu më poshtë po i shtrojmë disa shembuj, ku shihen qartë funksionet sintaksore të paskajores gege (me+pjesore).

Ndërtime qëllimore: *Kambët janë me ecë*.

Ndërtime krahasore: *Nuk ashtë aq i keq sa mos me i zanë besë*.

Ndërtime përcaktore: *Nuk e ka fort shprehi me u tallën me njerëz*.

Ndërtime pyetëse: *Ma mirë me punue apo me u sjellë udhëve?*

Ndërtime kryefjalore: *Nuk i kujtohet se me cilin kishte me këndue*.

Rrethanor kohe të paraprirë *me para se: Matu mirë para se me folë*.

Ndërtime kushtore: *Me e pa, kishit me u çmendë*.

Ndërtime lejore: *Sado vonë me ra, ai ngrihet gjithmonë herët*.

Ndërtime rrjedhore: *Derdhi sa muji ujë rreth vetes, aq sa m'u ba një liqe*.

Ndërtime të së ardhmes: *Duhet me ia ba një dhuratë për martesën e djalit*.

¹² F. Altimari, Po aty, fq, 104, 105, 111.

¹³ Selman Riza, Tri monografina albanologjike, Tiranë, 1944, f.125.

Në shembullin: *Ma mirë me krye punë apo **me pushue***? Toskërishtja këtë funksion sintaksor e shpreh me vetën e dytë të lidhore: *Më mirë të kryesh punë apo **të pushosh***? Çfarë shihet qartë, se kjo vetë e dytë e lidhore toske (*të pushosh*) i ka humbur lidhjet kuptimore me vetën e dytë të lidhore së mirëfilltë, që pa dyshim në këtë rast është funksionalisht e barasvlershme me paskajoren gege të tipit *me punue*.

Pra, shikuar në përgjithësi përhapja apo përdorimi i paskajores gege na del me shumë funksione sintaksore, që si e tillë tregon se është, sa e lashtë, aq edhe e përhapur dendur në tri të katërtat e folësve të shqipes. Atëherë, pse kundërshtohet inkuadrimi i paskajores në shqipen e sotme standarde, kur argumentet flasin në favor të saj.

Prof. dr. Bardh RUGOVA
Anëtar korrespondent i ASHAK-ut

IDEOLOGJIA E PRESKRIPTIVIZMIT – RASTI I SHQIPES

Synim i këtij punimi është që, duke e pasur parasysh se preskriptivizmi është ideologji më vete, të hetojmë ndikimin e tij në gjuhësinë shqiptare, si rast të veçantë studimi. Ky është një metastudim, i cili i bën analizë diskursit të përdorur në shkrimet e gjuhëtarëve preskriptivë shqiptarë të viteve tetëdhjetë. Hulumtimi mëton të nxjerrë përgjigjet e pyetjeve: Cili ka qenë grupi përfitues? Cilat kanë qenë synimet prapa kësaj ideologjie? Cilët mekanizma janë shfrytëzuar? Cilat janë pasojat kryesore të kësaj ideologjie?

Mirëpo, para kësaj le të shqyrtojmë teorinë prapa nocionit ideologji.

Në të vërtetë, termi ideologji shpesh mbart më vete konotacion negativ. Ky konceptim ideologjik vjen nga epoka e Marxit dhe e Engelsit, të cilët ideologjinë e shohin si “vetëdije false”, duke e parë klasën e lartë që imponon idetë e veta mbi klasën punëtore për ta nënshtruar dhe shtypur (Van Dijk 2006: 729). Pra, kjo klasë e lartë imponon sistem vlere, mbi të cilin ata legjitimohen në pushtetin e tyre mbi klasën punëtore.

Ky konotacion negativ ka vazhduar (dhe vazhdon në masë të madhe edhe sot) dhe është parë si njëfarë kundërvënieje me termin objektivitet. Pra, sipas këtij botëndijimi, një mendim mund të jetë objektiv dhe subjektiv, e ky subjektivitet është ideologjik. Foucault, ndërkaq, heq dorë nga termi ideologji dhe e zëvendëson me diskurs, duke theksuar se gjuha e përdorur për komunikim mes njerëzish ka funksione të ndryshme dhe se nuk mund të përcaktohet nëse një thënie është ideologjike ose jo, duke e kundëruar jashtë kontekstit të përgjithshëm (Shih Graham 2005). Autorë të tjerë (Althusser 1971, Johnstone 2008, Eagleton 1991) janë dakord për të hedhur poshtë argumentin epistemik, në favor të atij

politik e social, duke pasur parasysh se kognicioni ka rëndësi për anësitë sociale e politike. Ideologjia nuk është e mirëqenë dhe as nuk mund të funksionojë jashtë kontekstit. Secili nga këta autorë ofron përkufizime të ndryshme të ideologjisë, por po përpiqemi t'i gjejmë të përbashkëtat e secilit: Ideologjia përfshin një varg nocionesh, nga të cilat mund të kundrohesh ndjekja e diskurseve të caktuara në favor të një grupi shoqëror, kryesisht për qëllime pushteti a prestigji. Së këndejmi, për të pasur ideologji, duhet të ketë një grup shoqëror përfitues dhe një diskurs të orientuar drejt këtij synimi.

Van Dijk (2006:728), duke folur për ideologjinë dhe diskursin, thotë se politika është domen social, praktikat e së cilës janë zulumshëm diskursive. Sipas tij, kognicioni politik është i mbështetur ideologjikisht dhe ideologjitë politike riprodhohen përmes diskursit.

Në variantin e gjatë të punimit kemi elaboruar koncepte për ideologjinë të Van Dijkut, të Bourdieut, deri te Feyerabandi që edhe shkencën e fut si ideologji më vete, tok me kundërshtimet e Kuntzit e të Bloomit.

Duke e parë ideologjinë si term që nuk ka konotacion negativ, në këtë punim është i shprehur këndvështrimi i studiuesit dhe ideologjia e tij. Pra, edhe ideologjia ime si autor i këtij punimi.

Këtu ndalemi të preskriptivizmi dhe të ideologjia preskriptiviste.

Preskriptivizmi në gjuhësi, sipas Pullumit (2004, 2006), është ideologji më vete – si një prirje për t'iu shmangur studimit, në favor të normëzimit. Sipas tij, preskriptivizmi lidhet me ideologjinë konservatore që mëton ruajtjen e një tradite të caktuar, në dëm të zhvillimit, ndërsa ideologët preskriptivistë e marrin si të mirëqenë punën deskriptive (ose si të panevojshme – mjafton që një klasë e caktuar ta konsiderojë korrekte një formë).

Brenda nocioneve të preskriptivizmit do të përmendim dy terma të ndryshëm: ideologjinë e standardit, në një anë dhe ideologjinë e superioritetit gjuhësor në anën tjetër.

Milroy (2007:133) thotë se në disa vende është më e shprehur e ashtuquajtura kulturë e gjuhës standarde dhe në këto kultura atitudat gjuhësore dominohen nga qëndrime të forta ideologjike, të cilat mbësh-

teten në ekzistimin e supozuar të formës standarde. Këto njihen si ideologji të standardit. Sipas tij, folëset që e kanë këtë ideologji kujtojnë se kjo është normale, se kështu duhet të jetë dhe se standardi është këndvështirmi objektiv dhe neutral i botës.

Ideologjia e standardit, pra, është një anësi e paragjykuar mbi vlerën e një gjuhe të idealizuar homogjene që imponohet dhe vihet nën përkujdesje të një institucioni dominues – Akademi, Qeveri e kështu me radhë (Shih Milroy 2007: 133 – 136; Pullum 2004). Mund ta kundrojmë në këndvështrime të ndryshme. Në njërin anë standardi nënkupton zgjedhjen e një varianti gjuhësor (si bazë ose krejtësisht) si variant të përdorimit formal. Zgjedhja e atij varianti në mesin e më shumë varianteve ndikohet nga faktorë të jashtëm. Anësia e këtyre faktorëve (pushteti) e përbën ideologjinë e standardit. Ky është këndvështrimi i imponimit dhe i zgjedhjes së variantit që do të shërbejë si standard. Në anën tjetër, ekzistojnë atituda gjuhësore që dominohen nga qendra të fuqishme ideologjike e të cilat variantin e standardizuar e vendosin si të barabartë me gjuhën dhe i denigrojnë variantet e tjera. Në këtë ideologji, format standarde konsiderohen korrekte, ndërsa ato jostandarde jokorrekte. Format jostandarde janë njësoj gramatikore si ato standarde. Ky është këndvështrimi i mirëmbajtjes së standardit. Si në çdo ideologji, anësia përcaktohet nga pushteti dhe i përket grupit, i cili përfiton nga ai standard.

Ideologjia e superioritetit gjuhësor (Milroy 2007: 136 – 137; Pullum 2004), ndërkaq, nënkupton anësi të paragjykuar për një variant gjuhësor kundruall varianteve të tjera. Në këtë kuadër luajnë rol dy elemente: autoriteti, pra pushteti në një anë dhe prestigji shoqëror në anën tjetër e që mund të jetë imponuar nga autoriteti.

Gjuha shqipe është një nga ato gjuhë që kanë një variant të standardizuar që shërben për komunikime formale. Është krijuar në një kohë kur a. shoqëria shqiptare ka qenë nën diktaturë, pra krejtësisht dogmatike dhe b. kur bota ka qenë shumë më konformiste se sot.

Sidoqoftë, shqipja standarde është një variant i përpunuar e i kodifikuar i gjuhës së popullit shqiptar. Është variant që pritet të realizohet në domene formale përdorimi. Shqipja e njësuar letrare ka kaluar nëpër

një shteg të gjatë e kompleks të zhvillimit të saj krahas proceseve të vendosjes së rregullave të drejtshkrimit që ka kulmuar me Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 (shih FEK).

Në Shqipëri, shqipja e njësuar letrare është sanksionuar me Vendimin nr. 50 “Mbi masat për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe”, të datës 8. 3. 1974, nënshkruar nga Mehmet Shehu.

“Partia e Punës dhe pushteti popullor, duke e çmuar gjuhën amtare si një thesar të pazëvendësueshëm, si shprehje e fuqishme të kulturës sonë kombëtare e të shpirtit krijues të popullit, janë kujdesur vazhdimisht për zhvillimin, pasurimin dhe lulëzimin e saj. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që u mbledh në nëntor të vitit 1972, si forumi më i lartë shkencor gjithëkombëtar, pas një diskutimi e analize shkencore të gjerë e të thelluar, miratoi rezolutën ku përcaktohen parimet dhe vijat themelore për hartimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në trajtë përfundimtare”, thuhet aty.

Në vendim, në 7 pika, kërkohet zbatimi i detyrueshëm i normës dhe kërkohet ndihmë e institucioneve shkencore për këtë.

- Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit të përkrahet nga të gjitha organet shtetërore dhe “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, i hartuar në bazë të kësaj rezolute, si drejtshkrimi i parë i njësuar në historinë e gjuhës sonë letrare kombëtare (sic), të zbatohet detyrimisht në të gjithë veprimtarinë arsimore e botuese, si edhe në gjithë veprimtarinë tjetër shtetërore e shoqërore.

Krahas kësaj, ndërhyrja në punën kërkimore të gjuhëtarëve u shpreh me vendimin nr. 82, “për organizimin e punës për pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe”. Në mesin e pesë pikave të këtij vendimi, këtu thuhet: “Akademia e Shkencave, ministrinë dhe institucionet e tjera kërkimore-shkencore, Universiteti i Tiranës dhe të gjitha shkollat e vendit tonë të përfshijnë kryerjen e detyrave që u dalin në këtë fushë në planet e tyre vjetore dhe të ngarkojnë për këtë njerëzit më të aftë e më të përgatitur”.

Akademia dhe institucionet kërkimore, me fjalë të tjera, nuk kanë çfarë të kërkojnë a të hulumtojnë a të studiojnë më. E vërteta si në një religjion, tashmë ekziston dhe krejt çfarë duhet të bëjnë ata studiues është të mos studiojnë, por të ruajnë e të mbrojnë të vërtetën e shpallur. Në një nga kapitujt e mëvonshëm të këtij libri do të tregojmë se sa në

kundërshtim me idenë e shkencës dhe të kërkimit të së vërtetës është një qëndrim i këtyllë.

Ky punim në vazhdim mëton të shohë si i janë përgjigjur këtij urdhëri punonjësit shkencorë dhe si është pasqyruar kjo ideologji në ligjërimin dhe në punën e tyre. Për këtë studim janë nxjerrë qëndrimet e disa autorëve preskriptivistë më me ndikim të asaj kohe. Për nevoja praktike, të gjitha janë nga i njëjti vëllim. Janë mendime të përsëritura gjithandej, por këto janë vjelë nga vëllimi “*Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*”. Shembujt dhe autorët janë zgjedhur sipas peshës së tyre dhe namit, por edhe ndikimit të autorë të tjerë të asaj kohe dhe të kohës së sotme.

1. Androkli Kostallari:

“Politika gjuhësore e Partisë sonë, e shoqërisë së re shqiptare, duke i lidhur në një fill të vetëm të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen, i ka çuar shumë më përpara idetë e Rilindjes dhe u është përgjigjur e u përgjigjet tre (sic) qëllimeve themelore a. të lehtësojë e të forcojë funksionin komunikues të gjuhës shqipe si tipar dallues a si mjet përparimi për gjithë kombin dhe ta ngrëjë e ta mbajë këtë gjuhë në shkallën e kulturës botërore bashkëkohore; b. t’i ruajë gjithnjë të gjalla lidhjet e gjuhës letrare me gjuhën popullore; c. të ruajë e të zhvillojë më tej traditat kombëtare të gjuhës letrare dhe vetëqenien e origjinalitetin e saj, si shprehëse e kulturës së lashtë e të re, origjinale të popullit shqiptar dhe e njësisë së tij shpirtërore, si forcë aktive për këtë njësi. Kjo politikë gjuhësore, që mishëron dëshirat më të zjarrta të popullit tonë, ka vepruar jo në rrugë thjesht administrative, por nëpërmjet shkencës gjuhësore (sic), shkollës, botimeve, radiotelevizionit, teatrit, kinematografisë etj.

...Dialektet e shqipes... në kohën tonë janë kategori mbeturinore në rrugën e shuarjes...

...Ky është një proces dialektik, që, pa dyshim, do të çojë dalngadalë e shkallë-shkallë në një epokë kur në jetën e popullit do të zotërojnë në qytet e në fshat vetëm gjuha letrare, me sistemin e pasur të stileve të saj... Kështu zgjidhja e problemit të gjuhës sonë letrare kombëtare u pranua jo vetëm nga shkenca gjuhësore, por edhe nga shoqëria.”

(Kostallari 1989: 11 – 12)

Siç mund të vërehet këtu, Kostallari e përcakton qartë “*Politikën gjuhësore të Partisë sonë*” si detyrë që duhet arritur e realizuar. E përmend nocionin e “*njësimi*”, pra uniformitetin shoqëror që qe prioritet i kësaj politike. Në këto mendime, qartazi preskriptive, sepse jepet një lloj udhëzimi a urdhëri i sjelljes dhe i veprimit, tregohet për mbështetjen që i jep “*shkenca*” politikës gjuhësore të partisë, tok me mekanizmat e tjerë: shkolla, televizioni, madje edhe teatri e kinematografia. Pra, autori e sheh shkencën në funksion të një diçkaje e jo në funksionin e saj të kërkimit të së vërtetës. Mendimi se dialektet e shqipes janë kategori mbeturinore që duhen zhdukur e jep nocionin e uniformitetit social si prioritet politik të Partisë dhe e ndalon kërkimin deskriptiv linguistik që është edhe baza e studimit shkencor gjuhësor.

Në anën tjetër, shkenca mund të përkufizohet si veprimtari e sistemuar që e ndërton dhe e organizon dijen në formë të shpjegimeve të testueshme dhe të parashikimeve për botën (shih Wilson 1998). Pra, është doemos deskriptive. Autorët kryesorë të metodës shkencore (shih Popper 2005, Pigliucci 2009) e shohin në formën e të mbështeturit në fakt dhe në qëndrim kritik, duke vërejtur se një shkencëtar, studiues nuk njih autoritet. Pra, shkenca nuk është në funksion të dikujt, pos të kërkimit të së vërtetës dakull.

Megjithatë, Kostallari si një ndër autoritetet më të rëndësishme gjuhësore të asaj kohe flet për imperativin e partisë: arritjen e uniformitetit të plotë, pra kur “*do të zotërojë në qytet e në fshat vetëm shqipja letrare*”.

Të shohim autorin tjetër.

2. Jani Thomai:

“Shtypi ynë popullor është vepër e Partisë dhe e shokut Enver Hoxha. Shoku Enver ka përcaktuar edhe tiparet themelore të shtypit tonë që i ka rrënjësuar në të thellë partia, si partishmëria e lartë, parimorësia dhe vërtetësia, papajtueshmëria me armiqtë, shpirti luftarak e sulmues, karakteri popullor masiv etj. Me këto e me llojet e shkrimeve janë përcaktuar edhe kërkesat për gjuhën e stilin në shtyp që formojnë një sistem të plotë e shkencor (sic) e i përgjigjen politikës së përgjithshme gjuhësore të Partisë dhe evolucionit të gjuhës letrare kombëtare në tërësi...”

...Karakterit popullor e masiv i shtypit tonë dhe funksionet e mëdha shoqërore të tij, në kuptim të gjerë, e bëjnë atë gjitator dhe edukator kolektiv jo vetëm në aspektin politik, ideologjik, shoqëror e kulturor, por edhe në ngritjen e kulturës gjuhësore të masave punonjëse...

... Përpyekja për një gjuhë sa më të thjeshtë, me ndërtime të qarta, të kuptueshme e vepruese rrjedhin gjithashtu prej njërit nga parimet e politikës së re gjuhësore: mbështetja në gjuhën e popullit..."

(Thomai 1989: 200 paragrafi i parë; paragrafët e tjerë f. 211)

Sërish e kemi Partinë si përfituese dhe sërish shkencën në funksion të saj. E vërteta shihet si diçka që del nga ajo që ka përcaktuar Shoku Enver. Duke thënë Shoku Enver (Hoxha 1908 – 1985 që ishte kryetari i Partisë së Punës dhe personi më i pushtetshëm në Shqipërinë moniste nga viti 1944 deri në vdekjen e tij më 1985), nënkuptohet se çdo gjë që ai thotë është e vërteta e padiskutueshme. Në paragrafin e dytë, të përzgjedhur këtu, Thomai ofron pikë për pikë edhe përkufizimin e totalitarizmit, mbështetur në konceptet e Leninit (1902 [1967]), sipas të cilit shtypi nuk duhet të jetë vetëm agjitor, por edhe organizator apo edukues kolektiv. Ky koncept, thjesht, është bartur edhe në gjuhësi, me ç'rast, siç e shohim nga ky paragraf dhe nga ai pasues, gjuhëtarët rreken të organizojnë synimet e partisë: jo vetëm si agjitate, por edhe si organizatore vepruese të atyre synimeve të parashkrura.

Në paragrafin e tretë të zgjedhur këtu, shohim të flitet për një gjuhë "sa më të thjeshtë, me ndërtime të qarta, të kuptueshme e vepruese". Cila qenka një gjuhë më e qartë se një tjetër? Në rrafshin gjuhësor do të kishim mundur të flisnim për folëse që janë më të artikuluar: poete, oratore, por është zor të mendohet se paska një gjuhë a një variant që është më i qartë se një tjetër.

Fjala e fundit e sekuencës së nxjerrë nga artikulli i Thomait, po ashtu, mbështet faktin se gjuha letrare është e ideuar nga partia dhe se gjuhëtarët "rreken të organizojnë synimet e parties.

3. Xhevat Lloshi:

"Themelimi i PPSH-së më 1941 përbën një ngjarje me rëndësi vendimtare për gjithë historinë e popullit tonë. Për herë të parë në Shqipëri kishim një parti të vërtetë politike, të organizuar dhe me një ideologji e

program të qartë. Gjuha shqipe u vu përballë kërkesës për të përpunuar një sistem leksikor që të shprehte saktë nocionet e kësaj ideologjie”.

(Lloshi 1989: 216)

Më duket se as nuk ka nevojë të diskutohet më gjatë. Lloshi ka ditur të përkufizojë, kështu që nuk kemi as çfarë të shtojmë më shumë. E thënë troç: Kemi partinë me ideologji të qartë dhe kemi gjuhën shqipe të vënë përballë kërkesës për të përpunuar një sistem leksikor që do të shprehte saktë nocionet e kësaj ideologjie. Orveliane.

4. Emil Lafe:

“Kujdesi dhe vëmendja që i kanë kushtuar vazhdimisht Partia dhe shoku Enver zhvillimit të gjuhës letrare, kanë qenë një ndihmë e madhe e drejt-përdrejtë edhe për punën për pastërtinë e gjuhës. Këtë çështje shoku Enver e ka vlerësuar si një detyrë me rëndësi të veçantë për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës sonë kombëtare socialiste... Nga ky mësim i shokut Enver, gjuhësia jonë normative ka nxjerrë detyra të rëndësishme për veprimtarinë e saj teorike dhe praktike”.

(Lafe 1989: 245)

Po ashtu, e thënë qartë: Nga ky mësim i shokut Enver “gjuhësia jonë normative” ka nxjerrë detyra të rëndësishme për veprimtarinë e saj teorike dhe praktike. Sintagma “gjuhësia jonë normative”, tregon se gjuhësia do të jetë preskriptive dhe se nuk paska fare nevojë për studime deskriptive (përshkruese). Shohim diskutimin mbi pastërtinë e gjuhës – me ç’rast pastërtia përfshin edhe nga elementet dialektore që shihen si kontaminuese (v.j.).

Shtojmë, po ashtu, siç kemi argumentuar më parë, se ajo që ka ndodhur, ka qenë pastrim, por jo pasurim i gjuhës. Gjuhësia preskriptive ka punuar në favor të varfërimit.

Vërejmë, po ashtu, sintagmën kultura jonë kombëtare socialiste, si një term karakteristik.

Në një tjetër rast, Lafe jep një lloj betimi se do ta ndjekë rrugën e “Shokut Enver”:

“Mësimet dhe idetë e pavdekshme të shokut Enver Hoxha për gjuhën tonë amtare... do të na udhëheqin kurdoherë në studimet tona shkencore dhe në gjithë veprimtarinë praktike për pasurimin e mëtejshëm dhe për pastërtinë e gjuhës shqipe”.

(Cituar sipas Luka 2011:421)

Siç dëshmon leximi i këtyre katër autorëve, këtu kishte një grup, i cili kishte një program dhe i cili e kërkonte mbështetjen “e shkencës”, ndërsa “shkenca” po i përgjigjej, duke preskriptuar receta për zbatimin e këtij programi. Kjo realizohet jo vetëm në forma agjitacioni, por, siç kërkonte Lenini, edhe në forma organizimi të gjithëmbarshtëm.

Të gjithë këta autorë thirren në atë që ka thënë kryetari i Partisë e që është personi më i lartë në hierarkinë shtetërore. Enver Hoxha nuk ka pasur vetë kualifikime të gjuhësisë, megjithatë secili nga këta gjuhëtarë të kualifikuar fjalën e tij e mer si të vërtetë të padiskutueshme për çkado që lidhet me gjuhën a gjuhësinë. Ja disa shembuj:

Androkli Kostallari (1989: 10):

“Në dritën e teorisë marksiste-leniniste për kombin dhe kulturën shqiptare, shoku Enver Hoxha ka përpunuar me një largpamësi shkencore politikën gjuhësore të Partisë dhe të shtetit tonë”.

Pra, ajo që duhet të zbatohet është parashkrimi i Partisë, të cilën gjuhëtarët u dashka ta zbatojnë.

Jani Thomai (1989: 201):

Gjuha e Enver Hoxhës, pra, duhet të jetë model për të gjithë varëtësit a shtetasit.

Xhevat Lloshi, duke folur për terminologjinë (1989: 216): *“Dokumentet e Partisë dhe vetë shkrimet e udhëheqësit tonë, shokut Enver Hoxha, kanë luajtur e vazhdojnë të luajnë edhe sot rolin kryesor për përpunimin e kësaj terminologjie”.*

Partia dhe Enver Hoxha edhe si urdhëruese se çfarë duhet të jetë gjuha, por njëherësh edhe shkrimet e tyre janë model i gjuhës që duhet të elaborohet.

Emil Lefe (1989: 245): *“Kujdesi dhe vëmendja që i kanë kushtuar vazhdimisht Partia dhe shoku Enver zhvillimit të gjuhës letrare, kanë*

qenë një ndihmë e madhe e drejtpërdrejtë edhe në punën për pastërtinë e gjuhës. Këtë çështje shoku Enver e ka vlerësuar si një detyrë me rëndësi të veçantë...”

Sërish, shoku Enver dhe Partia si urdhërues për detyrat që duhet të realizohen nga gjuhëtarët.

Cilat do të mund të ishin përfundimet e kësaj që u shtrua deri këtu, brenda punimit?

Së pari, grup përfitues i kësaj ideologjie ishte Partia e Punës me politikën e saj shoqërore që synonte në njërën anë uniformitet shoqëror në një anë dhe shërbim të “shkencës” jo vetëm për agjitacion, por edhe organizim “të të vërtetave” partiake. Autoritetet e institucioneve që pri- tet të kryejnë veprimtari shkencore e studimore, vihen nën urdhërat për zbatim të koncepteve të partisë për uniformitet dhe konformizëm, përfshirë uniformitetin gjuhësor. Ata shihen si ruajtës dhe mbrojtës të vep- rës së partisë. I nënshtrohen partisë. Pushon kërkimi i së vërtetës. E vet- mja e vërtetë është ajo që do ta servojë partia. Pastërtia gjuhësore shihet si tërësi gjuhësore dhe për ruajtjen e asaj pastërtie duhen shmangur shkarjet nga rregullat e paracaktuara po aq sa edhe elementet dialektore, sepse, siç thuhet aty, dialektet janë “kategori mbeturinore”.

Së dyti, synimi i uniformitetit gjuhësor ishte pjesë e mëtimeve për uniformitet të përgjithshëm shoqëror dhe, siç shprehet njëri nga autorët: *“...kishim një parti të vërtetë politike, të organizuar dhe me një ideolo- gjë e program të qartë. Gjuha shqipe u vu përballë kërkesës për të për- punuar një sistem leksikor që të shprehte saktë nocionet e kësaj ideo- logjie”*. Synim i uniformitetit është që të mos ketë mendime konku- rruese me atë që propozon Partia (pushteti, autoriteti).

Së treti, mekanizëm kryesor i kësaj ideologjie uniformiste në fu- shën e gjuhësisë del gjuhësia preskriptive, si koncept udhëzues, normë- zues; kundrimi i normës si variant i vetëm i drejtë i gjuhës dhe tabuizimi e stigmatizimi i çdo varianti tjetër. Të përmendurit se “shkenca jonë” është në shërbim të pushtetit, e dëshmon këtë;

Së katërti, kjo ideologji ka pasur pasoja për shqipen dhe shoqërinë shqiptare përgjithësisht. Pasojat kryesore janë se, duke e imponuar pres- kriptivizmin, është hequr elementi i studimit gjuhësor (kërkimi në fushën e

gjuhësisë) nga magisteria e gjuhësisë. Gjuha dhe standardi janë marrë si të mirëqena dhe gjuhësia duhet të merrej vetëm me ruajtjen e mbrojtjen e asaj të vërtete të padiskutueshme. Pasoja e kësaj mendësie janë, po ashtu, stigmatizimi i formave dialektore, rreziku i zhdukjes së të folmeve të ndryshme shqipe që do të dëmtonte ekologjinë gjuhësore, krijimi i pasigurisë gjuhësore dhe konservimi i një kodi të shkruar që mund të vijë në situatë të dallojë shumë nga gjuha e folur.

Bibliografia:

- Althusser, Louis. 1971 [2006]. *Lenin and philosophy and other essays*. Delhi: Aakhar Books/Eagleton 1991
- Graham, Linda J. 2005. Discourse analysis and the critical use of Foucault. Në *Australian Association for Research in Education – Annual Conference*. Sydney
- Johnstone, Barbara. 2008. *Discourse Analysis*. Singapore: Blackwell
- Kostallari, Androkli. 1989. Gjuha letrare shqiptare dhe epoka jonë. Në: Kostallari, A. (red) *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III*. Tiranë: ASHRSH
- Lafe, Emil. 1989. Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tone. Në: Kostallari, A. (red) *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III*. Tiranë: ASHRSH
- Lenin, Vladimir Ilich (1902 [1967]). *Collected Works vol 5*. Moscow: Progress Publishers
- Lloshi, Xhevat. 1989. Zhvillimi i leksikut politik-shoqëror në gjuhën shqipe pas Çlirimit. Në: Kostallari, A. (red) *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III*. Tiranë: ASHRSH
- Lluka, David. 2011. A mund të zgjerohet baza dialektore e shqipes standarde. Në: *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*. Tiranë: Botimet albanologjike
- Milroy, James. 2007. The Ideology of the Standard Language. Në: Llamas, Carmen; Mullany, Louise; Stockwell, Peter (red.) *The Routledge Companion to Sociolinguistics*, London, New York: Routledge
- Pigliucci, Massimo. 2010. *Nonsense on Stilts. How to tell Science from Bulk*. Chicago: University of Chicago Press
- Popper, Karl. 1935 [2005]. *Logic of Scientific Discovery*. London, New York: Routledge
- Pullum, Geoffrey. 2004. Adverbs & demons: Just how good is the former English teacher's English? Në: Burnsteint, Dan, De Keijzer, Arne (red.) *Secrets of Angels and Demons: An Unauthorized Guide to the Best-Selling Novel*. New York: CDS Books
- Pullum, Geoffrey. 2006. Ideology, Power and Linguistic Theory. Në: <https://people.ucsc.edu/~pullum/MLA2004.pdf>

- Rugova, Bardh. 2015. Ideologjia e preskriptivizmit në gjuhën shqipe. Në: *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 33/1*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës
- Rugova, Bardh. 2020. *Ideologjia e gabimit gjuhësor*. Prishtinë; ASHAK
- Thomai, Jani. 1989. Tipare e prirje të gjuhës së shtypit në kohën tonë. Në: Kostallari, Androkli (red.) *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III*. Tiranë: ASHRSH
- Van Dijk, Teun A. 2006. Politics, Ideology and Discourse. Në: Brown, Keith (red.). *Encyclopedia of Language and Literature*. Boston: Elsevier
- Wilson, Edward. 1998. *Consilience: The Unity of Knowledge*. New York: Vintage Books

Akademike Kristina JORGAQI
Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

NEVOJA E NGUTSHME PËR REFORMË NË DREJTSHKRIMIN E SHQIPE

“... qëndrimi ynë ndaj këtyre reformave zbulon pa dashur diçka nga mënyra se si e shohim ne përgjithësisht botën”¹.

Planifikimi i një reforme drejtshkrimore është një ndërmarrje jo e lehtë e komplekse, por, bash për këtë, jo e pagjasë për të qenë e suksesshme, sikurse na dëshmojnë shembujt e një numri gjuhësh. Sfidat e reformimit të një kodi drejtshkrimor, qoftë ky edhe një reformim i pjesshëm e i moderuar, jo vetëm barabiten, por nganjëherë i tejkalojnë edhe ato të kodifikimit *de novo* të normës drejtshkrimore. Natyrisht që këto sfida janë më të mëdha për bashkësi, që kanë një traditë të hershme shkrimi, kodifikimi dhe përdorimi të gjuhës së normuar sesa për ato me histori a traditë të re (Fishman: XVI)², siç është dhe shqipja.

Përdora termat “reformë” dhe “reformim” - jo “përmirësim”, “rishikim”, “pasurim”, “përditësim” i drejtshkrimit, terma që “popullojnë” më së shumti diskursin e gjuhëtarëve tanë - duke dashur të shprehem kështu hapur e që në krye për llojin e ndërhyrjeve, që mendoj se duhet të ndërmerren në kodin drejtshkrimor pesëdhjetëvjeçar (sipas ndokujt, shtatëdhjetëvjeçar³) të shqipes. Këta terma, për hir të së vërtetës, kanë ngjallur gjithnjë aversion

¹ “...in the position we take towards these reforms, we involuntarily betray something about our innate view of the world at large”, Maita Arnautová, *Literární noviny*, 14 korrik 1994 (cituar sipas Bermel: 262).

² Tjeter mendim ka studiuesi Mark Sebba, sipas të cilit rezistenca ndaj ndryshimit nuk ka të bëjë me historinë e re apo të vjetër të kodifikimit të normës drejtshkrimore (“Megjithëse shpesh diskutimet për t’iu kundërvënë ndryshimit bazohen te lashtësia dhe trashëgimia e hershme, është fakt që, pasi vendoset një normë, ka gjithmonë rezistencë ndaj ndryshimit, edhe në rast se norma ka një histori të shkurtër” (Sebba: 133).

³ “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe i botuar më 1973 [...] në rregullat e tij themelore mbështetet te Ortografia e gjuhës shqipe e vitit 1956, pra, ka rreth shtatëdhjetë vjet që zbatohet” (Lafe: X).

ndër gjuhëtarët, që kanë trajtuar çështje nga sfera e drejtshkrimit të shqipes, në atë shkallë sa edhe thjesht përmendja e tyre të krijojnë ndjesinë e të bërit të një lloj sakrilegji, sakrilegj jo thjesht dhe vetëm ndaj drejtshkrimit të shqipes, por ndaj shqipes standarde e shqipes në përgjithësi.

Për qëndrimin refraktar të gjuhëtarëve tanë kundrejt çdo lloj ndërhyrjeje në kodin drejtshkrimor të shqipes flet mbi të gjitha fakti se përgjatë pesë dekadave nuk është realizuar asnjë lloj ndryshimi i tij. Edhe propozimet e ideuara e të formuluarat prej një organizmi si *Këshilli Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe* (2004)⁴ vijnë të mbeten ende të tilla. 50 vjet, në të vërtetë, janë shumë për ta ruajtur tërësisht “të paprekur” një kod drejtshkrimor, për më tepër kur shoqëria që e përdor atë, ka kaluar e po kalon nëpër një varg ndryshimesh të mëdha të natyrës politike, sociale e kulturore, të reflektuar drejtpërdrejt në gjuhë⁵.

Rezistenca e treguar në këto 5 dekada për të mos realizuar qoftë edhe disa modifikime minimale në kodin drejtshkrimor të shqipes ka natyrisht shpjegimet e veta. Duhet përmendur këtu, para së gjithash, vala e diskutimeve, kryesisht prej joprofesionistësh, lidhur me standardin, posaçërisht mbi bazën e tij dialektore, fill pas ndërrimit të regjimit politik në Shqipëri në fillim të viteve '90. Frika për ndonjë “shfuqizim” a “përmbysje” të mundshme të standardit me bazë toskërishten letrare dhe zëvendësimin e tij me një standard të ngritur mbi ndonjë të folme të gegërishtes ngjalli një qëndresë të fortë në mbrojtje të të parit. Kjo qëndresë gjeti shprehjen e vet më të qartë në mosprekjen dhe mbështetjen pa kushte të drejtshkrimit të shqipes

⁴ Ky Këshill, një organizem jovendimmarrës, u ngrit si një projekt bashkëpunimi mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Kosovës, me qëllim që të orientonte, siç thuhet në aktin e themelimit, “përpjekjet institucionale për mbrojtjen, zhvillimin dhe pasurimin e shqipes standarde”.

⁵ Le të kujtojmë se *Akademia franceze* (1635), organizmi përgjegjës për rregullimin e drejtshkrimit të **frëngjishtes**, përgjatë 3 shekujsh të veprimtarisë së saj (1694-1990) ka ndërhyrë mesatarisht çdo 38 vjet për të kryer ndryshime drejtshkrimore. Në periudha lëvizjesh e zhvillimesh të rëndësishme politike e sociale ndërhyrjet e saj kanë qenë më të shpeshta, çdo 15-20 vjet, kurse në periudha më të qeta, çdo 40-50 vjet. Në **çekishte**, deri aty nga fundi i viteve '50, ishin kryer ndërhyrje, madje të rëndësishme, çdo 10-20 vjet. Me daljen e Rregullave të reja të drejtshkrimit në v.1957, nuk u realizua për 36 vjet rresht asnjë ndërhyrje, edhe pse rishikime të vogla ndërmerreshin afërsisht çdo 5 vjet (Bermel: 143).

standarde. Mbrojtësit e tij – autorët e kodit drejtshkrimor, bashkëpunëtorët e tyre në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë dhe në Universitetin e Tiranës, gjuhëtarët në Shqipëri, por dhe ata përtej kufijve, puna e të cilëve kishte qenë e lidhur me përpunimin dhe kodifikimin e normës drejtshkrimore – “u fortifikuan” nëpër llogore për të mos lejuar edhe modifikimin më të vogël të drejtshkrimit⁶.

Klimën e rezistencës ndaj ndryshimeve në kodin drejtshkrimor e favorizoi ndërkohë edhe një rrethanë tjetër siç qe destrukurimi i një institucioni si Akademia e Shkencave të Shqipërisë në v.2007. Heqja prej varësisë së saj e instituteve kërkimore-shkencore, mes të cilave dhe e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, dhe vënia e tyre nën ombrellën e një institucioni të krijuar rishtas, Qendrës së Kërkimeve Albanologjike (2008) (sot Akademia e Studimeve Albanologjike (2017)), krijoi një paqartësi dhe çorientim lidhur me organizmin përgjegjës për planifikimin e mëtejshëm drejtshkrimor të shqipes, situatë që vijon edhe tani që flasim. Krijimi ndërkohë i *Këshillit Ndërademik të Gjuhës Shqipe* si një organizëm këshillimor jo vetëm nuk ndihmoi për tejkalimin e gjendjes së krijuar, por e komplikoi atë edhe më shumë, çka e dëshmon, ndër të tjera, reshtja *de facto* e veprimtarisë së tij në v. 2014.

Së fundi, mungesa e një axhende për ndryshim e motivuar politikisht ose ideologjikisht ka patur, gjithashtu, pjesën e vet, madje jo të vogël, të ndikimit në ruajtjen e paprekur të drejtshkrimit.

Sot, megjithatë, gjysmë shekulli nga kodifikimi drejtshkrimor i shqipes standarde, nuk duhet të vihet në dyshim nevoja, madje e ngutshme, për të ndërhyrë; dhe jo thjesht “për të mbushur ndonjë gropëz ose për të lëmuar ndonjë thep”, siç është shprehur një koleg, por për të ndërmarrë një reformë në lëmë të drejtshkrimit. Dhe, për të mos i lënë vend keqkuptimeve të mundshme, do të doja të bëja të njohur menjëherë konceptin e reformës, të cilit

⁶ Hartimi dhe botimi nderkaq i një fjalori drejtshkrimor alternativ të shqipes (Ali Dhimo, Rami Memushaj, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë, 2011, 925 f.), që përmban ndreqje dhe modifikime të një numri zgjidhjesh të fjalorit drejtshkrimor të Akademisë (Androkli Kostallari et al., *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1976, 621 f.), nuk ndryshoi asgjë, pasi qe e mbeti një nismë individuale, e pamanduar a sanksionuar zyrtarisht.

unë i përmbahem e sipas të cilit duhet “të modelohen” sot ndërhyrjet në drejtshkrimin e shqipes. Ky është koncepti i studiuesit amerikan Neil Bermel, i cili me reformë kupton “një varg **ndryshimesh të propozuara**, që lidhen me **arsyetime** dhe **parime të qëndrueshme** [nënvizimi im – K. J.]”, parime këto të natyrës gjuhësore dhe jashtëgjuhësore (Bermel: 6)⁷. Reforma, siç mund të deduktohet, nuk është, pra, doemos përmbysje e as thjesht “sasi e madhe ndryshimesh”, por ndryshime të realizuara mbi bazë parimesh. Shkalla apo sasia e ndryshimeve përcakton nëse një reformë është e gjerë dhe e thellë ose e pjesshme a e moderuar.

Po sa është e mundur të ndërmerret e të realizohet praktikisht një reformë në drejtshkrimin e shqipes? Për momentin një ndërmarrje e tillë nuk është e realizueshme, pasi mungon aktori i sanksionuar për ta kryer atë (Bermel: 8). Sidoqoftë, kjo pengesë institucionale, e pranishme prej 15 vitesh, që me ndarjen e instituteve kërkimore-shkencore prej Akademisë së Shkencave, është plotësisht e tejkalueshme përmes mandatimit për këtë qëllim të një institucioni të posaçëm⁸. Vetëm pas kësaj mund të vijohej puna për reformën drejtshkrimore.

Një reformë e tillë doemos kërkon ideimin dhe hartimin e një platforme, ku të gjejnë vend e të shpërfaqen qartë disa elemente të rëndësishme. *Së pari, qëllimi/ qëllimet*, që kërkohet të arrihen përmes ndryshimeve të propozuara, qofshin këto të ashtuquajturat *qëllime të hapura* (overt ends), që lidhen e ndikojnë drejtpërdrejtë në sjelljen gjuhësore të përdoruesve të gjuhës; qofshin *qëllime të fshehura* (latent ends), të lidhura me sjelljen jogjuhësore të tyre (Cooper: 91-92; Bermel: 11-13). *Së dyti, motivet (gjuhësore, praktike dhe politiko-shoqërore)*, që qëndrojnë në bazë të ndërmarrjes së ndryshimeve. *Së treti, parimet* mbi bazën e të cilave do të ndërhyhet për të realizuar ndryshimet. *Së katërti, çështjet* e drejtshkrimit, që do të bëhen objekt rishikimi e ndryshimesh.

Do të doja të ndalesha veçanërisht te çështja e *parimeve*, mbi bazën e

⁷ Në tipologjinë e një reforme drejtshkrimore nuk përfshihen, sipas Bermel-it, ndryshimet e grafisë së një numri fjalësh, që kryhen në fjalorin e një gjuhe.

⁸ Personalisht do të isha për krijimin menjëherë të një organizmi në varësi të Akademisë së Shkencave, që të merrej me veprimtari kërkimore, kodifikuese dhe këshillimore në fushën e përdorimit dhe të zhvillimit të shqipes, ndër të cilat dhe me kodifikim drejtshkrimor.

të cilave mendoj se duhet ndërhyrë sot në drejtshkrimin e shqipes në kuadrin e një reforme drejtshkrimore. Kujtojmë se këtu e gjysmë shekulli përpara drejtshkrimi i shqipes u kodifikua si një drejtshkrim kryesisht fonemik, pasi në kushtet e një gjuhe të shkruar vonë dhe me një sistem shkrimi të stabilizuar edhe më vonë, nuk mund të kishte alternativë tjetër. Them drejtshkrim “kryesisht fonemik”, pasi parimi fonemik, ndonëse parimi bazë i drejtshkrimit të shqipes, nuk ishte dhe nuk është i vetmi parim veprues. Parimi morfologjik është një tjetër parim i qenësishëm në drejtshkrimin e shqipes, aq sa do të ishte më e saktë që shqipja të cilësohej si një gjuhë me drejtshkrim morfofonemik. Kurse parimi historik e ai simbolik kanë gjetur aty hapësirë veprimi në një shkallë shumë më të vogël se dy të parat.

Shtrohet pyetja: nisur prej faktit që shqipja ka një drejtshkrim kryesisht fonemik, a mund të supozohet që ndërhyrjet reformuese të ndërmerren në emër vetëm apo kryesisht të parimit fonemik? Referuar teorisë së planifikimit gjuhësor dhe historisë së gjuhëve standarde, përpjekjet e planifikuara për ta ruajtur “të pastër” në rrjedhë të kohës karakterin fonemik të drejtshkrimit të një gjuhe janë tejet të vështira, për të mos thënë të pamundura. Ndërhyrjet planifikuese me qëllim që shkrimi të ndjekë hap pas hapi shqiptimin, jo vetëm kërkojnë shumë kohë, mund e mjete financiare, por, çka është më e rëndësishme, e bëjnë drejtshkrimin e një gjuhe një kod shumë të paqëndrueshëm, duke i rënë kështu ndesh vetë thelbit të shkrimit si një sistem me shumë më tepër stabilitet sesa gjuha e folur dhe mjet komunikimi efikas midis brezave. Ndërhyrjet me karakter fonemizues konsiderohen sot të nevojshme veçanërisht në gjuhë me drejtshkrim etimologjik, sikurse është anglishtja⁹. Në ato me drejtshkrim fonemik, për hir të ruajtjes së qëndrueshmërisë së kodit, por edhe ruajtjes së transparencës apo tejdukshmërisë së strukturës fjalëformuese të leksikut, duhet t’i lihet gjithnjë e më shumë hapësirë veprimi një **parimi** tjetër, sic është ai **morfologjik**.

Për të folur konkretisht, po i referohem shkurt **drejtshkrimit të zanores ë në pozicion të patheksuar në fjalë**, një prej çështjeve të rëndësishme e më të diskutuara drejtshkrimore të shqipes. Me gjithë përpjekjet e

⁹ Shih *Modernizing English spelling: principles & practicalities*, botuar nga Simplified Spelling Society.

bëra për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme në “Drejtskrimin e gjuhës shqipe” (1973), përsëri ka aty një numër zgjidhjesh kontradiktore dhe përjashtimesh. Kjo, pas mendimit tonë, është rezultat i ndërhyrjeve të bëra në mënyrë jokohërente dhe jo mbi bazë parimesh të qëndrueshme. Mbështetja vetëm ose kryesisht në parimin fonemik për drejtskrimin e ë-së së patheksuar nuk ka dhënë e as mund të japë garanci për një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë për këtë çështje. Parimi morfologjik, përkundrazi, do të ishte ai që do të siguronte në këtë rast më shumë stabilitet e sistematicitet. Nga këndvështrimi i këtij parimi duhen riparë, pas mendimit tonë, edhe pjesa më e madhe e zgjidhjeve të ofruara në “Drejtskrim...” (1973), veçanërisht **fjalët e prejardhura e të përbëra**, temat e të cilave përmbajnë një ë të pazëshme si pjesë të tyre. Nuk ka pse, në bazë të parimit fonemik, të vijojnë të shkruhen ende, fjala vjen, *lojtar, rojtar, nevojtari, amtar, furratar, floktar, zyrtar, kishtar, meshtar, pishtar, ngatërrestar, pendestar, fillestar* etj., kur mund të rishkruhen duke zbatuar parimin morfologjik: *lojëtar, rojëtar, nevojëtar, amëtar, furrëtar, flokëtar, zyrëtar, kishëtar, meshëtar, pishëtar, ngatërresëtar, pendesëtar, fillesëtar* etj. Pra, pavarësisht se si shqiptohet ë-ja e pathekse në këto fjalë, morfemat përbërëse të tyre duhet të ruhen të plota në shkrim, përfshirë këtu edhe ë-në e pathekse, që ato përmbajnë.

Një qasje krejtësisht të kundërt me këtë ka patur komisioni i drejtskkrimit i *Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe*, kur ka propozuar që të rikodifikohen sipas parimit fonemik një numër fjalësh të prejardhura e të përbëra (*gojtar, antar; hollsi, njerzi; mjeshtri; dobsoj, punsoj; gjelbroj, numroj; gjithfuqi, gjithvjetor* etj.)¹⁰ të kodifikuara drejt, sipas nesh, pesë dekada përpara në bazë të parimit morfologjik (*gojëtar, anëtar; hollësi, njerëzi; mjeshteri; dobësoj, punësoj; gjelbëroj, numëroj; gjithëfuqi, gjithëvjetor* etj.)¹¹.

¹⁰ Për këtë janë dhënë argumente të tipit: ë-ja “nuk dëgjohet në shqiptim dhe thyen parimin fonetik”; “rënia e zanores ë është një fakt gjuhësor i standardit [sic]”; heqja e zanores ë është “në mbështetje të prirejeve të zhvillimit të mëtejme të vetë strukturës së gjuhës shqipe”; etj. (Përfundimet nga mbledhjet e KNGJSH (2010-2014), në *Propozime për drejtskrimin*, I, Alsar, Tiranë, 2021, f. 41-53 (material i publikuar së pari në internet në v. 2014)).

¹¹ Një analizë të hollësishme të kësaj veprimtarie gjeni në artikullin tonë “Reforma drejtskrimore dhe planifikimi gjuhësor (Mbi ndryshimet e propozuara në Drejtskrimin e gjuhës shqipe (1973))”, në *Studime albanologjike*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, 2015, nr. 1).

Është shkuar deri aty, madje, sa zbatimi i këtij parimi të konsiderohet si një “kthim prapa” duke u absolutizuar kështu roli i parimit fonemik në ndërhyrjet rregulluese drejtshkrimore të shqipes¹².

Drejtskrimi i ë-së së patheksuar është vetëm një nga çështjet ku zbatimi i parimit morfologjik duhet të shtrihet më gjerë, por ai nuk është i vetmi. “Pozitat” e këtij parimi duhet të forcohen edhe më shumë në ndërhyrjet rregulluese të mëtejshme, duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë relative të zgjidhjeve drejtshkrimore të shqipes¹³.

Një tjetër çështje në drejtshkrimin e shqipes, që ka nevojë për ndërhyrje është ajo e shkrimit të një numri **huazimesh**, që kanë depërtuar në shqipe gjatë këtyre 100 viteve të fundit, më së shumti prej gjuhëve neolatine. Shkrimi i tyre është kodifikuar këtu e gjysmë shekulli përpara sipas jo një, por disa kritereve, sic na rezulton prej analizës që kemi bërë:

a. sipas *parimit fonemik*, pra, shkrimi mbështetet mbi shqiptimin e ngulitur ose më të përgjithshëm të tyre¹⁴;

b. sipas *fonetizmit të një gjuhe klasike*, siç është latinishtja, por edhe një ndikimi të mundshëm nga rusishtja, *si rezultat i ndërhyrjeve rregulluese të gjuhëtarëve*, kriter i zbatuar kryesisht për fjalë, që kanë hyrë në shqipe nga më shumë se një burim (*censurë, central, certifikatë, ciklamin, procedurë, proces* etj.);

c. sipas *analogjisë me disa modele shqiptimore ekzistuese të shqipes* (*gjen, gjest, gjirafë* etj.);

d. sipas *parimit etimologjik*, d.m.th. duke respektuar shqiptimin e huazimeve në gjuhën prej nga ato kanë ardhur dhe jo trajtën shqiptimore që

¹² “...duhet ose të gjitha fjalët të shkruhen me ë, që do të ishte kthim prapa [sic], ose të gjitha të shkruhen pa ë, që do të ishte në mbështetje të prirjeve të zhvillimit të mëtejshëm të vetë strukturës së gjuhës shqipe [sic] ...” (*Propozime*, I: 17).

¹³ Gjermanishtja, një gjuhë po me drejtshkrim fonemik, sa për të marrë një shembull, ka njohur ndërhyrje jo të pakta pikërisht në emër të këtij parimi në kuadrin e reformës së fundit drejtshkrimore të ndërmarrë (Johnson).

¹⁴ “Për ata tipa fjalësh, shqiptimi letrar i të cilëve është i njësuar dhe i përgjithësuar me kohë, ky kriter [kriteri fonemik – K.J.] të jetë vendimtar në caktimin e trajtës së tyre drejtshkrimore...” (*Drejtskrimi*: 23).

ato kanë në gojën e shqipfolësve (*anuloj, bastard, blof, brefotrof, bulon, holandez, kanotierë, kloun, pavijon, salsiçe* etj.).

Korpusi i huazimeve të kodifikuara sipas tre kritereve të fundit ka nevojë, pas mendimit tonë, që të rishihet për t'u vlerësuar nën optikën e parimit fonemik, në mënyrë që të ndreqen ato trajta shkrimore, që nuk përputhen me shqiptimin real të shqipfolësve (sa janë ata që thonë *agjenci, ciklamin, certifikatë, gjips, kloun, lotari, marmelatë*, sa për të përmendur vetëm pak shembuj?!)¹⁵. Zbatimi i këtij parimi përgjithësisht nuk ka pse të vihet në diskutim për këto kategori huazimesh, që kanë një histori të re në shqipe, por janë tashmë të përshtatura nga pikëpamja formale e njëherësh të integruara plotësisht në sistemin leksikor të saj.

Këto 2-3 dekadat e fundit, për herë të parë që prej kodifikimit drejtshkrimor të shqipes standarde, është e pranishme në shtyp e botime të ndryshme, në lajmet e shkruara në median audiovizive si dhe në peizazhin gjuhësor shqiptar një dukuri e re: shumë fjalë të huajtura rishtas shkruhen në shqipe njësoj si në gjuhët burimore. Këto janë më së shumti huazime të marra drejtpërdrejt prej anglishtes, të pranishme njëherësh edhe në shumë gjuhë të tjera të botës - terma nga bota e modës dhe e kozmetikës, e sportit dhe e spektaklit, terma të teknologjisë informatike, të politikës, financës dhe ekonomisë etj. Janë aty si pasojë e fenomenit të globalizimit, njohjes e përhapjes masive të anglishtes dhe kthimit të saj në gjuhë të komunikimit ndërkombëtar falë edhe mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. A do të konsiderohet kjo praktikë shkrimi e ruajtjes së grafisë origjinale të fjalëve si një shkelje flagrante e rregullave në fuqi të drejtshkrimit të shqipes apo do të merret si një "shkas" për zgjerim e pasurim të këtyre rregullave?¹⁶.

¹⁵ Një numër idesh për ndërhyrje rregulluese kemi paraqitur në artikullin tonë "Vështrim retro-prespektiv mbi drejtshkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj në shqipe", në *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot* (Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit), Tiranë, 2003, f. 218-229.

¹⁶ Problemi në këtë rast shtrohet kryesisht për ato fjalë prej gjuhësh të tjera, të cilat përdoren nga shqipfolësit, pasi në shqipe nuk ka emërtime për konceptet që ato shënojnë, por edhe për ato që shënojnë kuptime dhe ngjyrime stilistike e funksionale të reja (p.sh. *boom, chat, check up, facebook, iPad, iPhone, jogging, leasing, overdraft, peeling, reality show* etj.).

Kemi të bëjmë me një nga ato çështje, që, për t'u zgjidhur drejt, kërkon vështrimin e praktikave që ndiqen sot edhe në gjuhë të tjera me drejtshkrime fonemike.

Marrim rastin e italishtes, një gjuhë me drejtshkrim fonemik, e cila po zbaton prej pak dekadash një drejtshkrim “etimologjik” për shumë huazime të reja, e pikërisht ato të konsideruara si **huazime të papershtatura**, ku korrespondencat mes grafemave dhe fonemave janë krejt të ndryshme e të pazakonta nga ato të fjalëve vendase e huazimeve të hershme. Një praktikë e tillë është ndjekur edhe te *Grande Dizionario d'Italiano (1999)*, fjalor në 6 vëllime, me 260000 lema, hartuar nën kujdesin e *Tullio De Mauro-s*¹⁷. Modeli i paraqitjes në fjalorët shpjegues i shumë huazimeve të reja, vecanërisht i anglicizmave, me grafinë e tyre si në gjuhët burimore, haset, megjithatë, edhe në gjuhë të tjera europiane, siç kemi patur mundësi të hetojmë në fjalorin e anglicizmave europianë të Manfred Görlach¹⁸.

Çështja e shkrimit të huazimeve, ndërkohë, vijon të mbetet e hapur, duke përbërë dhe një prej temave të pranishme në “axhendën” e reformave drejtshkrimore të disa prej gjuhëve europiane. Kështu, në reformën e fundit drejtshkrimore të gjermanishtes (1996) nuk u arrit që, për një numër huazimesh, të kodifikohej një trajtë e vetme grafike e tyre, por u propozua që të lireshin në fuqi si trajta normative dy variante: si grafia e përshtatur, ashtu dhe ajo e papërshtatur e fjalëve (p.sh. *Portemonnaie* dhe *Portmonee* “kuletë”, *Spaghetti* dhe *Spagetti* etj.). Një zgjidhje e tillë flet, në të vërtetë, për një koncept më elastik a më fleksibël të normës drejtshkrimore, në përputhje me realitetin kompleks të “botës” së huazimeve sot¹⁹.

¹⁷ Ja disa statistika lidhur me grafinë e huazimeve të përfshira në këtë fjalor, sipas *Enciclopedia Treccani*, zëri “lessico”: nga 6.292 *anglicizma*, 1.989 janë paraqitur grafikisht të përshtatura, kurse 4.303, të *papërshtatura*; nga 4.982 *francezizma*, 3.517 janë të përshtatura, kurse 1.465, të *papërshtatura*; nga 1.055 *hispanizma*, 792, të përshtatura, kurse 263, të *papërshtatura*; nga 648 *gjermanizma*, 360 janë të përshtatura, kurse 288, të *papërshtatura*.

¹⁸ *A Dictionary of European Anglicisms* (A usage dictionary of anglicisms in sixteen European languages), Oxford University Press, 2001.

¹⁹ Kundërshtarët e reformës drejtshkrimore të gjermanishtes kane ngritur shqetësimin se ky variacion normativ mund të rrisë diferencimin social në radhët e përdoruesve të gjuhës (Sebba: 98).

Referuar rrethanave jashtëgjuhësore që përmendëm pak më sipër dhe veçanërisht një faktori shumë të rëndësishëm, siç është ai që Sebba e quan “interlinguizmi i drejtshkrimit” (interlinguality of orthography)²⁰, jemi të mendimit se në drejtshkrimin e shqipes duhet të ngushtohen disi hapësirat e veprimit të parimit fonemik në sferën e huazimeve të reja, sidomos atyre prej anglishtes, duke i lënë më shumë vend parimit etimologjik a historik. Kjo mund të materializohet edhe përmes një rregulle përgjithësuese apo “udhëheqëse” në manualin e ri drejtshkrimor të shqipes e të reflektohet pastaj në fjalorët shpjegues të saj. Tek e fundit, është realiteti gjuhësor ai që imponon zgjidhjet e qëndrimet, jo e kundërta.

Megjithatë, pavarësisht nevojës për zgjerimin e veprimit të parimit etimologjik në drejtshkrimin e huazimeve të reja, nuk ka dyshim që parimi fonemik do të vijojë të mbetet mbizotërues. Ai është e vetmja alternativë, kur është fjala për huazime prej gjuhësh, që nuk shkruhen me alfabetë me bazë latine, si greqishtja, rusishtja, arabishtja etj. Do të ishte një ndihmë e paçmuar për përdoruesit e shqipes, që puna ia do të merren me shkrime, përkthime, redaktime e korrektive etj., nëse në manualin e ri drejtshkrimor të saj do të përfshiheshin në trajtë tabelash, siç e kemi vënë në dukje edhe më parë, sisteme transkriptimi nga një numër gjuhësh të huaja në gjuhën shqipe²¹.

Shumë i dobishëm do të ishte, gjithashtu, përpunimi i disa rregullave, që do të ndihmonin përdoruesit e shqipes, në mënyrë të veçantë redaktorët, gazetarët e përkthyesit, për të përshtatur menjëherë nga pikëpamja formale, për nevojat e komunikimit, fjalë të huajtura nga gjuhë të tjera, sidomos ato me të cilat shqipja është më së shumti në kontakt. Fjala është për rregulla, me ndihmën e të cilave do të përftohej trajta shqiptimore e duhur e fjalëve si dhe do të sigurohej përfshirja e tyre në klasa të caktuara të lakimit e zgjedhimit. Përballjet intensive e të gjera të shqipes me gjuhë të tjera në të ardhmen e afërt, sidomos në kuadrin e një organizmi mbikombëtar si

²⁰ “... në botën e sotme, gjuhët dhe drejtshkrimet përkatëse nuk ekzistojnë të izoluara. Përdoruesit e tyre kanë njohuri, ku më shumë e ku më pak, mbi gjuhë ose varietete të tjera gjuhësore, që përdorin drejtshkrime të ndryshme prej të tyreve, dhe mund t’i përdorin këto njohuri në shumë mënyra. Kjo është ajo që unë kuptoj me “interlinguizëm të drejtshkrimit” (Sebba: 163).

²¹ “Vështrim retro-perspektiv ...”, art.cit.

Bashkimi Europian, e bëjnë këtë një kërkesë të ngutshme, që duhet zgjidhur me profesionalizëm.

Disa fjalë, së fundi, për shkrimin e antroponimeve e të toponimeve me origjinë të huaj në shqipe²². Shkrimi i tyre është kodifikuar, siç dihet, sipas parimit fonemik, por të paktën prej tre dekadash ky parim nuk zbatohet për pjesën më të madhe të emrave të njerëzve e të vendeve, që depërtojnë rishtas në shqipen e shkruar, sidomos në media, në peizazhin gjuhësor në Shqipëri etj. Rregulla e drejtshkrimit që standardizon këtë çështje²³, po shpërfillet, herë me vetëdije e herë pa vetëdije, në një shkallë aq të lartë, sa nuk mund të shmanget ndjekja e praktikës së shkrimit si në gjuhët prej nga vijnë ata emra²⁴. Kjo e ka bërë të domosdoshëm modifikimin e riformulimin e rregullës, çka nuk nënkupton doemos mënjanimin tërësisht të parimit fonemik dhe zëvendësimin e tij me parimin etimologjik. Ne do të ishim, siç jemi shprehur edhe më parë, për një “bashkëjetesë” të parimit fonemik me atë etimologjik në këtë lëmë të drejtshkrimit, ku zbatimi i njërit apo i tjetrit të realizohet në varësi të *shkallës së vjetërsisë* së antroponimit/ toponimit të huazuar si dhe të *llojit të tekstit* ku ai përdoret. Konkretisht, do të duhej të ruhej grafia origjinale e toponimeve/antroponimeve të huajtura rishtas, që dalin në media, si dhe pa përjashtim e të gjitha atyre që dalin në tekste shkencore, shkencore-divulguese, dokumentare, zyrtare (pasaportë, kartë identiteti, çertifikatë²⁵) etj. Kurse për emrat e njerëzve e të vendeve, që kanë një

²² Këtë çështje e kemi cekur fillimisht në një shkrim tonin, pjesë e një rubrike gjuhësore në media (“Si t’i shkruajmë emrat e huaj të njerëzve?”, *Gazeta shqiptare*, 18 korrik 1998), kurse më pas e kemi trajtuar gjerësisht në dy shkrime studimore duke dhënë edhe sugjerime për zgjidhjen alternative (“Vështrim retro-prespektiv..., art.cit.; “Reforma drejtshkrimore...”, art. cit.).

²³ “Emrat e përveçën të huaj të shkruhen duke u mbështetur në traditën e përdorimit të tyre në gjuhën shqipe dhe duke marrë parasysh shqiptimin në gjuhën përkatëse”, *Drejtshkrimi...*, vep. cit., f. 23.

²⁴ Kjo vlen për gjuhë që përdorin alfabetë me bazë latine, pasi ato me alfabetë jolatine si dhe gjuhë me sisteme shkrimi joalfabetike kanë një tjetër problematikë.

²⁵ Ky do të duhej të ishte rasti i emrave të njerëzve, që u takojnë pakicave kombëtare, të huajve që fitojnë nënshtetësinë shqiptare, atyre që kryejnë martesë me shqiptarë dhe figurojnë në dokumentet përkatëse etj. E them në mënyrë hipotetike pse jo vetëm nuk ka një dokument ligjor të posaçëm, që rregullon shkrimin e emrave të përveçëm në dokumentet zyrtare në Republikën e Shqipërisë, por aktualisht ekziston dhe një konflikt mes nenit 14 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili shpall shqipen si gjuhë

traditë të hershme përdorimi në shqipe, parimi fonemik do të ishte plotësisht i përshtatshëm për t'u zbatuar në të gjitha llojet e teksteve, me përjashtim të atyre të sapopërmendura. Zbatimi në mënyrë të përzgjedhur i parimit fonemik i hap rrugën një norme më liberale, gjithmonë në përputhje me realitetin mjaft kompleks e të nuancuar në këtë fushë. Për këtë arsye formulimi i një rregulle/rregullave të ngurta, të prera, me idenë për t'u zbatuar në mënyrë automatike e me skrupulozitet nuk do të ishte i përshtatshëm dhe efikas. Në vend të tyre do të nevojiteshin rregulla më të përgjithshme me synimin për ta orientuar drejt praktikën e shkrimit të emrave të përveçëm në shqipe sot në shek. XXI. Shqipja, si çdo gjuhë europiane, duhet të ketë rregullat e veta të shkrimit të emrave të përveçëm të njerëzve e të vendeve, që s'ka dhe s'mund të jenë plotësisht të njësuara mes tyre. Edhe Bashkimi Europian, pjesë e të cilit Shqipëria shpresojmë të jetë në një të ardhme të afërt, shkrimin e këtyre emrave ia ka njohur si kompetencë vetë shteteve anëtare²⁶, një arsye më shumë kjo për ta sistemuar mirë këtë fushë të drejtshkrimit të shqipes.

Do të doja ta përmbyllja këtë parashtrësë duke thënë se nuk kemi luksin të vazhdojmë të humbasim kohë, por duhet të ndërmarrim sa më shpejt një projekt serioz për reformimin e drejtshkrimit të shqipes, pra, për të realizuar një ndërhyrje profesionale në emër parimesh e kriteresh të qarta, që do t'u jepte në dorë përdoruesve të shqipes standarde një mjet shumë më efikas për shkrimin e saj sesa ai paraardhës.

zyrtare të shtetit shqiptar (duke nënkuptuar kështu edhe shkrimin e emrave të huaj të njerëzve e të vendeve sipas sistemit shkrimor të gjuhës shqipe), dhe disa dokumenteve ligjore, si Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë (nr. 96/2017) dhe një sërë marrëveshesh ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ku Republika e Shqipërisë është palë, që sanksionojnë shkrimin e këtyre emrave sipas grafisë së gjuhës origjinale/burimore. Emri konsiderohet një element thelbësor i identitetit të njeriut, prandaj dhe shkrimi i tij, së bashku me mbiemrin, në gjuhën origjinale është një e drejtë e njeriut. Shkrimi i emrave të përveçëm nuk është dhe nuk mund të jetë asnjëherë vetëm një çështje e pastër gjuhësore, por ajo është edhe një çështje e fushës së të drejtës.

²⁶ Modelet e standardizimit shkrimor të këtyre emrave janë nga më të ndryshmet, që nga ai i një gjuhe si letonishtja, që i përshtat ata plotësisht nga pikëpamja grafike sipas rregullave të saj, e deri te anglishtja, frëngjishtja e italishtja, që i ruajnë tërësisht të paprekuara grafitet origjinale.

Bibliografia

- BERMEL, Neil (2007), *Linguistic authority, language ideology, and metaphor: the Czech orthography wars*, Mouton de Gruyter, Berlin New York.
- COOPER, Robert (1989), *Language Planning and Social Change*, Cambridge, Cambridge University Press.
- DREJTSHKRIMI i gjuhës shqipe (1973), Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë
- DHRIMO, Ali & MEMUSHAJ, Rami, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë, 2011, 925 fq.
- FISHMAN, Joshua (1977), *Advances in the creation and revision of writing systems*, The Hague: Mouton.
- GÖRLACH, Manfred (2001), *A Dictionary of European Anglicisms* (A usage dictionary of anglicisms in sixteen European languages), Oxford University Press.
- JOHNSON, Sally A. (2005), *Spelling trouble? (Language, Ideology and the Reform of German Orthography)*, Multilingual Matters Ltd, Clevedon- Buffalo-Toronto.
- JORGAQI, Kristina (2003), Vështrim retro-prespektiv mbi drejtshkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj në shqipe, *Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”* (Tiranë, 11-12 nëntor, 2002), f. 218-229.
- JORGAQI, Kristina (2014), Reforma drejtshkrimore dhe planifikimi gjuhësor (Mbi ndryshimet e propozuara në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” (1973)), *Studime albanologjike*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, nr. 1.
- LAFE, Emil (2021), “Parathënie”, *Propozime për drejtshkrimin*, I, Alsar, Tiranë.
- MODERNIZING *English spelling: principles & practicalities*, botuar nga Simplified Spelling Society (<http://spellingsociety.org> > 2000modernizing-leaflet).
- PROPOZIME për drejtshkrimim, I, II (2021), Alsar, Tiranë.
- SEBBA, Mark (2007), *Spelling and society. The culture and politics of orthography around the world*, Cambridge University Press, New York.
- TAULI, Valter (1977), Speech and Spelling, në *Advances in the Creation and Revision of Writing Systems*, Joshua Fishman ed., Mouton, The Hague, f.17-36.

Prof. dr. Shezai RROKAJ
Universiteti i Tiranës, Tiranë

KAHE ZHVILLIMI TË SHQIPES STANDARDE PAS VITEVE '90 DHE DISA QASJE EPISTEMOLOGJIKE RRETH TYRE

Në këtë punim do të trajtohen disa prirje kryesore të shqipes standarde, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë në qasjen gjuhësore të shqipfolësve si dhe me debatet e qëndrimet që janë mbajtur këto dekadat e fundit. Gjuha shqipe po përballet me disa kahe zhvillimore të rëndësishme pas viteve '90, si:

Së pari, çlirimi gradual prej “gjuhës së drunjtë” e cila, gjatë periudhës komuniste, në shumë aspekte të ligjërimit politik e publik, shprehte një model perceptimi të shqiptarëve brenda kornizës së dogmës ideologjike komuniste.

Së dyti, ndryshimi gjeopolitik pas viteve '90 krijon mundësi të reja qarkullimi të njerëzve e bashkë me ta edhe të vetë gjuhës, e cila po del prej enklavave tradicionale, duke kapërcyer pengesat e dikurshme, që vinin nga izolimi i kufijve politikë e demografikë. Brenda kufijve politikë lëvizja e lirë ka vënë gjithashtu në dyshim konceptet demografike klasike të të folmeve dhe të dialekteve, duke u orientuar drejt krijimit të një komunikimi folësish heterogjenë nga prurje enklavash të ndryshme, sidomos në qendrat e mëdha urbane. Ashtu si gjithëgjuha edhe standardi aktual, i parë në përgjithësi si gjuhë e shtetit, shkollës dhe medias, është vënë ‘në provë’ përballë sfidave të një zhvillimi të brendshëm, i cili shpërfaqet në ligjërimit politik e publik në shkallë të gjerë, por gjithaq i hapur edhe ndaj teknologjisë, gjinive letrare, përkthimeve etj.

Së treti, ndryshimet politike e shoqërore pas viteve '90 e hapën shoqërinë shqiptare ndaj globalizmit, gjë që është shoqëruar edhe me një trysni të madhe të fjalëve dhe strukturave të huaja në gjuhën shqipe, herë të dobishme e herë të dëmshme, duke krijuar ndonjëherë në komunikim situata shprehëse të një mbivendosjeje gjuhësore me pasoja mbi ligjërimit standard e më gjerë në gjithë gjuhën shqipe.

Së katërti, gjithashtu, pas viteve '90, vetë procesi dinamik i zhvillimit të gjuhës shqipe dhe të standardit të saj ka hapur kahe qasjesh meta-linguistike, të cilat kanë synuar të 'çlirojnë' një debat akademik dhe publik të gjerë për atë çfarë ka ndodhur para viteve '90, kryesisht me KD, por gjithaq edhe që shestojnë të hapin një perspektivë reformimi të standardit në gjendjen e re gjuhësore të ndryshimeve gjeopolitike, shoqërore e demografike të arealit shqipfolës zyrtar e në diasporë.

Të ndalemi më gjerë në çështjet e përmendura më lart:

Çështja e parë lidhet me faktin se pas viteve '90, me ndryshimet ideologjike e politike, një nga problemet me të cilat u sfidua shqipja ishte edhe 'çlirimi' gradual prej "gjuhës së drunjtë". Në periudhën komuniste ky tip ligjërimi vinte si një përgjigje e gjuhës shqipe në nevojën për t'iu përshtatur 'perceptimit të dogmës ideologjike marksiste-leniniste', e cila 'filloi të ngurtësohej e të kalcifikohet në një shtrat të gjerë parafabrikatesh tipike për shprehjen e një vetëdijeje botëkuptimore *ad hoc* për këtë dogmë' (Rrokaj, 2009, f. 67-69). Në terminologjinë gjuhësore kjo mënyrë komunikimi është njohur me shprehjen "gjuhë e drunjtë", gjuhë e ngurtësuar, e cila "përkthen" perceptimin e dogmës. Ky përdorim gjeti shtrat të përshtatshëm në ligjërimet politike e publike, si ato që lidhen me kodin e besimit, me marrëdhëniet shoqërore, me ligjërimet nacionaliste, me ligjërimin ndërinstitucional etj." (Rrokaj, po aty).

Me stereotip ideologjik këtu do të kuptojmë parafabrikate gjuhësore tipike, ide të paraformuara, që merren si të gatshme dhe që përsëriten në diskursin ideologjik, politik e publik, pa e vënë në diskutim themelin racional ose jo të tyre. Dogmat ideologjike përbëhen nga tërësi parimesh që, duke u përsëritur, kthehen në një rrjet shprehës stereotipik. Ky kalcifikim ideologjik shkon në përpjesëtim të drejtë me drunjëzimin e gjuhës që e shpreh. Në përgjithësi të gjitha regjimet përpunojnë ideologji *ad hoc*, të cilat profilizojnë gjedhe të gjuhës për shprehjen e tyre. Kjo mënyrë shprehjeje nuk mbështetet në realitete të krijuara nga veprimtaria praktike e bashkësisë, por janë realitete të huazuara a të imponuara nga ideologjia ose individët e pushtetshëm. Bourdieu shprehet se pushteti i fjalëve është i lidhur ngushtë varësisht nga pushteti i individit apo i klasës dominuese (Bourdieu, *Ce que parler veut dire...* 1980).

Siç dihet, kjo dukuri u shpërfaq në gjuhën shqipe pothuajse në gjysmën e dytë të shek. XX. Sikundër edhe në vende të tjera, vendosja e regjimit komunist pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri la gjurmë të thella edhe në gjuhë, sepse asnjë ideologji a pushtet nuk ka qenë aq i kujdesshëm për të përpunuar “gjuhën e vet” sa komunizmi. Kjo ‘gjuhë e re’, ‘e çliruar’ apo ‘e zhveshur’ prej karakterit të saj natyror e tejkaloi sferën e ligjërimit politik dhe ideologjik dhe depërtoi thuajse në të gjitha sferat e komunikimit publik: shoqëror, kulturor, politik, artistik, administrativ etj., dhe zuri shtrat në fjalorët e shqipes të periudhës 1980 dhe 1984, ku ajo u kodifikua tashmë.

Duke i konsideruar fjalorët si vepra kodifikuese, ata transkriptojnë një perceptim në sistem të shoqërisë që përdor gjuhën e, më tej, ata ‘diktojnë’ në përdorim gjedhet e saj. Kështu që, në Fjalorin më të madh të shqipes, të 1980-ës, duke iu referuar vetëm shkronjës A, konstatohet se nga 1849 lema që ka shkronja kjo shkronjë, 120 lema, ose 6.4 %, shprehin këtë stereotip ideologjik, me një mesatare 1.6 lemë të ideologjizuar për një faqe fjalori.

Gjuhën e drunjtë në këtë fjalor e gjejmë në tri rrugë, që lidhen me mënyrën e shpjegimit të fjalëve në fjalor: a) në shpjegimin e kuptimit tërësor të lemës; b) në një pjesë të shpjegimit të saj, në ndonjë ose disa përbërës kuptimorë dhe c) te shembujt që jepen në formën e sintagmave, të frazave, citateve a parullave, të cilat ilustronë përdorimin e lemave.

Kësisoj përdorimi i gjuhës së drunjtë ka sjellë devijime semantike të fjalës, duke krijuar një referent B të imponuar nga ideologjia, i cili ka një lidhje periferike me referentin A që fjala e ka pasur ose mund ta ketë pasur në përdorimin e përditshëm.

Në këtë kategori përfshihen përkufizime të lemave të jetës politike, fetare, shoqërore etj. Termat politikë janë veçanërisht dhe qartësisht të devijuar dhe janë pasqyrë e ideologjisë. Për shembull, kuptimi i dytë i fjalës *anglez*: -Ai që zbaton politikën e synimet e imperializmit anglez, përfaqësues i qarqeve qeveritare ose pjesëtar i forcave pushtuese të Britanisë së Madhe, i shpjeguar kështu e përfshin fjalën posaçërisht në ligjërimin politik dhe shpjegohet ideologjikisht. Shpjegimi leksikor i nënshtrohet një formulimi ideologjik, që nuk ka lidhje me realitetin referues.

Po kështu *amerikan*: 3. bised. -Ai që zbaton politikën e synimet e

imperializmit amerikan, përfaqësues i qarqeve qeveritare ose pjesëtar i forcave pushtuese të SHBA.

Lema *amerikanatë* - (f. sh. keq.) 1. Veprim që shkel rregullat e zakonshme të sjelljes në shoqëri, sjellje e shthurur; aventurë për të bërë bujë. Amerikanatë e çmendur. 2. Muzikë e shthurur; *amerikanizoj* -1. (keq.) e bëj si amerikan, i fut mënyrën amerikane të jetesës. 2. E vë nën vartësinë ekonomike, politike e ushtarake të imperializmit amerikan. Fjalët ‘amerikanatë’ dhe ‘amerikanizoj’, si neologjizma të gjuhës së drunjtë, nuk shfaqen më në Fjalorin e vitit 2002 e në vijim, i cili është një ribotim i përpunuar i Fjalorit të vitit 1984 pra, ‘i pastruar nga infektimi ideologjik’. Autorët janë treguar të kujdesshëm në vlerësimin e pranisë së ideologjisë në fjalorin e parë dhe shprehen se ‘janë përmirësuar shpjegime ose përkufizime fjalësh e termash, duke i shkarkuar ato nga ngarkesa të panevojshme ose me karakter politizues etj.’ (Fjalori, 2002, f.7).

Në këtë mënyrë, termi *apolitik* -Që qëndron mënjanë nga jeta politike e shoqërore, që i shmanget pjesëmarrjes në veprimtarinë politike; që fsheh një ideologji a qëndrim politik të caktuar, duke u hequr si asnjanes, sikur qëndron larg politikës - përqendron një sasi të lartë, deri agresive të ideologjisë. Në Fjalorin 2002 formulimit i mungon ideologjizimi i skajshëm: ‘që qëndron mënjanë nga jeta e veprimtaria politike, që karakterizohet nga apolitizimi’. Një shembull shumë interesant është edhe kuptimi i dytë i përmrit *ata* 2. përd. em. -Pala që ndryshon nga botëkuptimi dhe nga mënyra e jetesës prej nesh; pala që ka qëllime e synime të kundërta o të ndryshme prej nesh; të tjerët, kundërshtarët; kund. ne. Ky përdorim është qartësisht një krijim e përdorim ideopolitik.

Një rast tjetër i devijimit semantik është përshkrimi i gabuar ose i tjetërsuar i disa disiplinave shkencore të quajtura ‘borgjeze apo joshkencore’ prej shkencave të pushtetit popullor në Shqipëri. Kështu, përshkrimi i termit *antropologji* -Shkenca që studion veçoritë biologjike të njeriut si qenie e gjallë e natyrës, ndërkohë që përkufizimi është tejet i ngushtë dhe ka përjashtuar studimin e njeriut edhe nga aspekti shoqëror, kulturor etj. Ndërsa në shpjegimin e lemës *astrologji* -Dituri e rreme, që përpiket të parashikojë ngjarjet dhe fatin e njerëzve, duke vëzhguar vendosjen e trupave qiellorë, lexuesi nuk ka mundësi të informohet në lidhje me kuptimin e fjalës, duke

qenë se mbiemri ‘e rreme’, i vendosur që në fillim, zhvlerëson të gjithë përkufizimin semantik të fjalës, që është pjesa më e konsiderueshme e shpjegimit leksikor të saj. Një formulim i tillë e ‘asgjëson’ informacionin për lexuesin dhe madje të gjithë aktin kumtues. Po i kësaj natyre është edhe shpjegimi në fjalën *art* i togut *arti për art* -parimi themelor i një teorie estetike reaksionare, që e sheh artin si qëllim në vetvete, të shkëputur nga përmbajtja, nga jeta shoqërore e politike dhe nga detyra për t’u shërbyer masave të gjera. Fraza ‘teori estetike reaksionare’ e asgjëson komunikimin me lexuesin dhe përcjelljen e informacionit të togut në fjalë. Në ribotimin e 2002 është mënjeluar mbiemri *reaksionar* dhe ‘nga jeta shoqërore e politike dhe nga detyra për t’u shërbyer masave të gjera’. Një ‘rishkrim i historisë’ shfaqet edhe te lema *antizogist* mb. hist. 1. -Që luftonte kundër regjimit antipopullor të Ahmet Zogut, që drejtohej kundër regjimit zogist. Lëvizje (demonstratë) antizogiste. Grup antizogist. 2. si em. ~, ~I m. sh. ~Ë, ~ËT. Kundërshtar i regjimit antipopullor të Ahmet Zogut. Fjala nuk shfaqet më në Fjalorin 2002.

Pësojnë devijimin semantik dhe lemat që i përkasin ligjërimit fetar në shqipe, si për shembull, *fe* -Besimi i verbër se gjithçka në botë përcaktohet e drejtohet gjoja nga forca të mbinatyreshme, hyjnore, i cili ka lindur qysh në kohë shumë të hershme dhe është i papajtueshëm me botëkuptimin shkencor, materialist; tërësi dogmash që japin një botëkuptim fund e krye idealist e reaksionar, i cili është armik i betuar i përparimit e i shkencës, dhe përdoret nga klasat sunduese për të mashtruar e për të nënshtruar masat punonjëse; besimi te zoti: feja e krishterë (ortodokse, katolike, myslimane), origjina (përhapja) e fesë, lufta kundër fesë, ndërroi fenë, mohoj (luftoj) fenë, feja është opium për popullin. Shkalla e lartë e agresivitetit ideologjik shfaqet në çdo përbërës të përshkrimit kuptimor. Mbiemri ‘i verbër’ asgjëson gjithë kuptimin dhe shpjegimin e lemës.

Krijim ideologjik, i interpretuar ideologjikisht dhe me synim ‘luftarak’ është rasti i fjalës *antiklerikal* -Që është kundër klerikalizmit ose kundër ndërhyrjes së kishës e të klerit në jetën politiko-shoqërore; që lufton kundër klerikalizmit e klerit. Kjo fjalë është hequr nga Fjalori i 2002-shit.

Antagonizëm 1. -Kontradiktë e papajtueshme, kontradiktë që zgjidhet vetëm me ndeshjen e të kundërtave, me luftë ose me revolucion (zëvendësuar me ‘dhunë’ në Fjalorin 2002). Tek: *aristokraci* f. 1. -Shtresa më

e lartë e feudalëve, shtresa e fisnikëve të një vendi; pjesa më e privilegjuar e klasës sunduese në shoqërinë shfrytëzuese. 2. -Pjesë e vogël e një klase ose e një grupi shoqëror, që ka disa privilegje dhe një vend të veçantë: aristokracia financiare, aristokracia punëtore ‘pjesa e borgjezuar e klasës punëtore’. Vihet re këtu devijimi që krijohet prej përdorimit të mbiemrave ‘sunduese’, ‘shfrytëzuese’ apo edhe neologjizmi ‘e borgjezuar’. Mungesa e dy mbiemrave të parë do ta zhvishte edhe shpjegimin leksikor të fjalës prej gjuhës së drunjtë. Thom në monografinë e saj për gjuhën e drunjtë shprehet: ‘Funksioni i veçantë i mbiemrit në gjuhën e drunjtë lidhet me këtë ‘aksiologji imanente’ me të cilën diskursi ngarkohet për t’u bërë i dukshëm: nëse një term ka fituar njëfarë asnjësisë, i bashkëngjitet detyrimisht një mbiemër që e hedh fjalën nga njëra anë në tjetrën’ (Thom, *La langue de bois* 1987, f. 26).

Po kështu vihet re ngarkesa ideologjike e mbiemrit ‘reaksonar’ në shpjegimin e fjalës *atë* - 4. fet. Titull fetar që u jepet priftërinjve a murgjve; në sh. apostujt, shenjtorët që i kanë sjellë shërbime kishës në veprimtarinë e saj reaksionare (në vendet ku vepron kisha e krishterë; në të kaluarën edhe në Shqipëri).

Vihet re prania e mbiemrave në kuptimin e tretë të emrit *auditor* - Vend ku mësohet për të zgjeruar e për të thelluar njohuritë teknike e shkencore, politike, ideologjike etj. Mësimi në shkolla e universitete nuk mund të mos përfshijë njohuritë politike e ideologjike.

Për shembull, *armatë*, kuptimi 2. fig. -Masë e madhe njerëzish, që punojnë së bashku në një lëmë ose për një qëllim të vetëm; ushtri: *armatë* e fuqishme, *armata* e punëtorëve të pararojës, *armata* e arsimitarëve (e mjekëve). Përdorimi metaforik në kuptimin e dytë të fjalës krijon metaforën e shoqërisë si një ushtri, prej këtij koncepti i jetës si një betejë, shpreh qartë një ndikim të ideologjisë komuniste. Po kështu kemi edhe shembuj të tjerë të ushtrisë e ushtarakes si metaforë, në të gjithë familjen e fjalës *armë*, për shembull, *armë* 3. fig. - Mjet për të luftuar kundër dikujt; mjet që përdoret për t’ia arritur një qëllimi, *armë* politike (ideologjike); *armatos* (kuptimi i katërt i fjalës është: pajis me njohuri, me dije etj. për një veprimtari të caktuar... E *armatos* me teorinë revolucionare. *armatosem* -kuptimi i tretë, pajisem me njohuri, me dije etj. për një veprimtari të caktuar: *armatosem* me dije, *armatosem* me teorinë revolucionare, *armatosem* për jetën.

Siç u përmend më lart, gjuha e drunjtë shfaqet edhe në shembujt ilustrues të kuptimeve të leksemave. Aty shembujt janë sintagma e më rrallë fjali, të cilat kodifikojnë, në njëfarë mënyre, ndërkalljen në sistem të gjuhës së drunjtë. Shembujt, me qëllim të qartë didaktik, në pjesën më të madhe të rasteve, synojnë edhe të përvetësuarit doktrinor, ideologjik.

Kështu, në fjalën *anë*, ku nuk shfaqet gjuha e drunjtë në 10 kuptimet e saj dhe në frazeologjitë e shumta aty, kemi shembuj, si: ana politike, në anën tjetër të barrikadës. Po japim më poshtë disa struktura fjalësh, si: imperialistët angloamerikanë (lema anglo-amerikan); klasa antagoniste (lema antagoniste); te lema *e ardhme*: e ardhme e sigurt (e dyshimtë). e ardhmja e fshatit, ardhmja e vendit (e popullit), ndërtojmë të ardhmen, punoj për të ardhmen, siguroj të ardhmen. Te lema *art*: arti popullor (kombëtar), arti socialist (revolucionar), arti përparimtar. Për lemën *i arratisur*: i arratisur politik, është shembulli i parë që jepet në kuptimin e kësaj fjale. Te lema *aspekt* si një fjalë e përgjithshme: aspekti politik (ideologjik), aspekt i luftës së klasave; te lema *atmosferë*: atmosferë e shëndoshë (e gjallë), atmosferë revolucionare, atmosfera politike, atmosferë pune (luftë) etj.

Forma më stereotipike dogmatike e gjuhës së drunjtë ishin parullat të cilat, përveçse shfaqeshin shesheve dhe faqeve të mureve, ato ishin pjesë e pandarë e veprave kodifikuese (shih Fjalori..., 1980): “luftë kundër rehatisë personale; i gjithë populli ushtar; lavdi marksizëm-leninizmit, internacionalizmit proletar; të mendojmë, të punojmë, të luftojmë si revolucionarë; kur flet klasa hesht burokracia; kursim natë e ditë; njeriu i ri; sjelljet, shfaqjet e huaja; forcim i stilit në punë, i vigjilencës, i radhëve të Partisë, i unitetit; ç’thotë Partia bën populli, ç’do populli bën Partia; nga fitorja në fitore, agjitacion dhe propagandë; aksion me goditje të përqendruar; frymë revolucionare, frymë e aksioneve; ambient mikroborgjez; aksionist; analizë klasore; brigadat e arave; aparat i Komitetit Qendror; armatos me teorinë marksiste-leniniste; kritikë asgjësuese; autokritikë e shëndoshë; armë politike, ideologjike; internim; bie nga fiku, rrëshqet këmba; Shqipëria një kala, vigjilenca fort e mba, feja është opium për popullin” etj.

E gjithë kjo mënyrë ligjërimore, e mbështetur mbi dogmën, e ngulitur në gjuhë, në fjalorë, që përdorej në shkollë, në jetën e marrëdhënieve

politike, shoqërore, kulturore do të bierrej pas viteve '90, bashkë me përmbysjen e sistemit komunist, duke krijuar fillimisht një boshllëk, një krizë *elokuientia* faqe realiteteve të reja që po shfaqeshin me shpejtësi, të cilat gjuha do t'i shenjonte, teksa ajo pjesë e gjuhës së drunjtë po dilte (proces që vazhdon ende) nga shtrati natyror i shqipes.

Sot pas disa dekadash, Fjalori i vitit '80, më i madhi ende deri sot në shqipen standarde, i cili shënoi një arritje për leksikografinë shqiptare të kohës, është gjithashtu një pasqyrë e asaj që ideologjia komuniste synoi të krijonte: një realitet të ri për të imponuar dhe për të manipuluar mendjen e një bashkësie të tërë, duke bërë të besohej se: *popull* do të thotë 'masat e gjera punonjëse'. Kjo mënyrë perceptimi bardhë e zi nxiti krijime të drunjta në gjuhë si *agjit-prop*, *antipushtet*, *antiparti*, *antiklerikal*, por edhe fjalë me referentë të tjetërsuar, të krijuara nga ideologjia ose të huazuara. Mirëpo, pas viteve '90, vetë ndryshimet e mëdha politike, shoqërore e arsimore i hapën rrugën një 'çlirimi' nga kjo gjuhë e drunjtë, e cila u reflektua në vijim edhe në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe të 2002-shit, e sidomos në atë të 2006-ës.

Çështja e dytë, që përmendëm më lart, lidhet me pasojat që u reflektuan në gjuhë prej periudhës para viteve '90, e cila karakterizohet prej copëzimit në disa shtete dhe ka lënë gjurmë të thella në gjithë përbërjen materiale e shpirtërore të shqiptarëve. Ndarja në disa shtete në përballje me gjuhë dhe kultura të ndryshme, trysnia e tyre e pashmangshme, e mbarsur me ideologji etnike nacionaliste si dhe komunistizimi, që ideologjizoi jetën politike dhe publike, kanë sjellë pasoja të rënda për konstituimin e një kombi shqiptar funksional të njësuar e gjithëpërfshirës në rrafshin kombëtar, e shprehur kjo në sendërtimin e marrëdhënieve politike, shoqërore, arsimore, *ipso facto* edhe gjuhësore. Pavarësisht konvergjencës prej qenësisë natyrore shqiptare, ky çrregullim identitar i areas kombëtare nuk ka ndihur për një njësim të natyrshëm të arealit gjuhësor, pasi folësit e saj janë gjendur në kushte copëzimi të panatyrshme.

Mirëpo, pas viteve '90, kanë ndodhur dy dukuri demografike me ndikim të drejtpërdrejtë në arealin gjuhësor të shqipes. Kemi dy shtete shqiptare, janë hequr barrierat gjeopolitike që pengonin qarkullimin e njerëzve e, bashkë me ta, edhe të mallrave, ideve, marrëdhënieve shoqërore e kulturore, të cilat gjejnë shprehje më të gjerë në rrjetin e shenjave gjuhësore. Gjithmonë

e në rritje shqiptarët po dalin nga enklavat, ku i pati vendosur e shkuara historike dhe, vetë ‘lëvizja e tyre e lirë’ po ndikon dukshëm për një përafrim natyror kombëtar. Kjo sepse, bashkë me ta, është vënë në lëvizje edhe kultura, gjuha, institucionet, mënyra e njëjtë e perceptimit të botës dhe e formësimit të vetëdijes gjuhësore *ipso facto* dhe kombëtare.

Përpos kësaj dukurie makrolinguistike, një dukuri tjetër po ndodh në arealin e shqipes: krahas trysnisë së standardit aktual në disa kahe të komunikimit publik, vetë zhvendosja e lirë e njerëzve përtej enklavave, hap pas hapi, po “godet” dialektet dhe të folmet, në kuptimin klasik të këtyre koncepteve, duke dhënë një pamje të re në atlantin ligjërimor të shqipes. Gjithë kjo gjë ka bërë të mundur që brumi i shqipes të vihet në lëvizje shumë më të gjerë dhe shumë më të thellë sesa një binom standard-dialekt (toskërisht a gegërisht), duke rritur ndjeshëm frekuencën e kontaktit gjuhësor, dhe ku vetë standardi po përballet me një realitet tjetër, karshi atij të para viteve ’90.

Ky kontekst i ri po përqas te përdoruesit sjellje gjuhësore të panjohura ose shumë pak funksionale më parë. E tillë është dukuria e krijimit të *varianteve gjuhësore*, e njohur edhe në mjaft gjuhë të zhvilluara, të cilat po marrin një rëndësi të veçantë në shqipen e sotme. Përkundër ndonjë mendimi që e sheh ekzistencën e varianteve si dukuri që i kundërvihet njësisimit të standardit, në fakt, ato përbëjnë mozaikun, larminë, vitalitetin dhe bukurinë e çdo gjuhe. Ato i njohin edhe gjuhë të zhvilluara dhe të njësuara prej kohësh. Po japim disa shembuj të qëmtuar nga ligjërimi gojor dhe i shkruar: i kalbët / i kalbur, i sigurtë / i sigurt, me ba / për të bërë, dyzet / katërdh(j)etë, kahmot / ngamot, ftohtë / ftohtas / ftohtazi, fshaçe / fshatshe / katundisht, shumësoj / shumëztoj, agu / agimi, rallëkush / rallëcili, pakush / pakcili, keqoj / keqësoj, grykagrykë / fytafyty, kotni / kotësi, qyshkur / qyshse, tymnajë / tymtajë, pagjumi / pagjumësi, ballaballë / ballpërballë, i humbur / i humbët, i pamatë / i pamasë, kuje / thirravajë, hirosje / hirmosje, teposhtë / tatëpjetë, alivani / vilani, bipartisan / dypartiak, bord drejtues / staf drejtues, reçipeta / soutienë / gjimbajtëse / gjoksmbajtëse, kotsëkoti / kotmësëkoti, i pambarimtë / i pambarim (në fjalor), i pamendë / i pamend (në fjalor), i dytësuar / dytësor (në fjalor) etj.

Një dukuri tjetër është ajo e *rigjallërimit të fjalëve dialektore a të folmeve*, si: kahmot, pash Zotin, vara-vinga, përndritje, përdreqnoj, çel besën, lisi i tamblit, dromca bisedash, i vetoi nëpër mend, nëpërmend (folje), majekrah, krejtkotshëm, e çë pastaj, kryekrejet, e thënmja, mysafirhane, kumarhane, çeltinë (fjalor çeltirë), pagjumi, thirravajshëm, gjumësitim, i tjetërfarshëm, sqepëtim, platiqe, trandje, hënëzim, gërmushje, kërkëllitje, çarturi, cfinafutës/i, mëmëvrasje, pasjetësosje, i grimcuar, i përçarë, i sapombirë, i tjetërfartë, i kalbët, i humbët, hirmosje, hiroshë, gjakhupës, troshit, troshitje, kotni, marrok, kuqësi, asomoti, bjerraditje, çkamund, idengulët, këmbimore, barnatore, lehtshëm, kyçem, përcjell (një lajm), ligështues, i njëmendtë, i pamendtë (fjalor i pamend) ndofarë, tejlart, vramendje, frikëkallës, këndellës etj.

Po kështu, me vetë shënjesit, duke shfrytëzuar gjedhet e saj fjalëformuese, gjuha shqipe dhe vetë standardi po rritin pasurinë me *fjalë të prejar dhura, kompozita, fjalë të përbëra etj.*, si: shnjoh, këngëtim, zymtare, shkurtan, padijës, i hapësirshëm, kaltëreme, diellishte, rrugëtim, orëligu, besa e vogël, besa e madhe, i kotsëkotshëm, kotsëkoti, zhdehës, nismëtoj, i përdhunshëm, shumësoj, yllësi, parajsëri, humbëtar, kryeshyt, hamendësoj, i porsaderdhur, pragmuzg, vargor miqsh, binjakëzim, ngushtazi, përpiktas, i zhburrëruar, ftohtas / ftohtazi, i fundbotshëm, shkrepëtimtas, vdekësor/e, plagosës(e), i parefuzueshëm, i refuzueshëm, shpeshtirë, i pamatë, pakcili, rrallëcili, gurëri, sipërane, qyshse, i paskaj, afatgjatësi, alarmim, atëçast, bjerraditje, i bortë, i dalëmode, zëulët, ëndërrtjerrës, gjithëseqysh, gjitholog, gjoksbajtëse, gjimbajtëse, humbamendje, idengulët, ikeardhje, jashtëterritorial, i kudondierë, kot(më)sëkoti, larmingjyrësh, i pambarimtë, nëpërmend (folje), mendjehapur, i pakapërdishëm, pllaquritje, qelqnajë, lulanjë, fernajë, terrnajë, pyllnajë, habitshmerisht, kokërrzë, trimërim, rrëmujthi, vagulltazi, vajzuke, vetëshërbej, çëfësht, mëdyshës, i ndërzymë etj.

Një rrugë fjalëformimi aktive mbetet ajo e *gramatikalitetit* (me *devijim ose kalim klase*), përgjithësisht nga mbiemra të nyjshëm në ndajfolje, si: (i) përdhunshëm, brengosur, përbuzshëm, mundimshëm, dehshëm, mallëngjyeshëm, përdhunueshëm, njëmendshëm, mirëkuptueshëm, padukshëm, dridhshëm, këmbëngulshëm, pakapërdishëm, mezidukshëm, shkujdesshëm,

frikshëm, trishtueshëm, vetvetishëm, humbshëm, përzishëm, trembshëm, përhumbshëm, pikëllueshëm, shtrëngueshëm, përhumbur, ndjellazi/u, të pandarët, tjetërsi, pranguar, matanja (matanë), idealja, shpirtërorja, i kësojetshmi, etj.

Gjithashtu, një mënyrë tjetër është edhe ajo e *shqipërimit të fjalëve të huaja*, si: fundjavë (week-end), ndërqytetas (interurban), fundashtrrojë, arkë-mort (arkivol), dypartiak (bipartisan), përrethësi (entourage), rijetës/oj/im (rivitalizzare / rivitalizzazione).

Çështja e tretë lidhet me hapjen e shoqërisë shqiptare ndaj shoqërisë globale, me trysninë e gjuhëve të vendeve të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht me të cilat shqipja është në kontakt. Kjo trysni është më e spikatur në fazat e para të hapjes. Fjalët dhe strukturat e huaja ‘vërshojnë’ nga të gjitha anët, saqë duket se po ia marrin frymën gjuhës. Por, hap pas hapi, folësit fillojnë e reagojnë me vetëdijen e vetëmbrojtjes gjuhësore; shtien në punë kujtesën e përbashkët për të kërkuar brenda gjuhës që përdorin gje-gjëset e tyre dhe, vetëm kur bëhet i pamundur zëvendësimi, atëherë pranojnë t’i përdorin fjalët e huaja, duke ia nënshtruar sistemit të gjuhës amtare. Sa më i plotë të jetë standardi i një gjuhe nga pikëpamja e gjithëpërfshirjes gjuhësore anekënd dhe masës së folësve që e përdorin, aq më shumë vepron imuniteti amënor gjuhësor ndaj trysnisë së huazimeve.

Në ligjërimin e folur, por edhe të shkruar gëlojnë fjalë dhe struktura të panevojshme, si: “kishin mundur të fitonin duke aplikuar me emrin e firmës (duke përdorur emrin e ndërmarrjes), çamët do të diskutohen në Athinë (çështja çame do të diskutohet), bëj mjekun, bëj mësuesin (është mjek, mësues), konvertoj paratë (këmbej), bord (kryesi, komision), integritet (tërësi), krucial (i qenësishëm), kredibilitet (besim), fazë tranzicioni (kalimtare), takoi Biden (Bajdenin), debolesë (dobësi), axhendë/agjendë (rend dite), demilitarizim (çmilitarizim), handicap (pengesë, paaftësi), konfrontim (ballafaqim), Aa! (Ëë), Aha (Ëhë), bla-bla-bla (llaka-llaka, dërr-dërr, gamgam), jeni të mirëpritur (mirardhshi), kontaktoni me numrat (lidhuni me), i avancuar (i përparuar), divergjencë (papajtueshmëri), konfidencë (mirëbesim), novacion (risi), Ok! (Po!, mirë!), i dha ok (i dha pëlqimin), salutoj (përshtëndes), përfitoj nga rasti t’Ju shpreh komplimentat e mia (përgëzimet), komunitet (bashkësi), abonohem (pajtohem), aprovoj (miratoj), publicitet (reklamë), gelateria (akulllore), pasticceria (ëmbëltoje), Pizzeria (piceri),

adoptoj (birësoj), adaptoj (përshtas); primar (parësor), seleksionoj (përzgjedh), intermediar (ndërmjetës), përtej kësaj (pavarësisht nga kjo), premio (çmim), nac(z)ionale (kombëtare), pankinë (stol), GDP (PBB), Shërbimi Inteligent (Shërbimi Informativ), komision bipartizan (dypartiak)” etj.

Por, nga ana tjetër, fjalorët normativë po hapen gradualisht për të pranuar si pjesë të ususit standard fjalë me frekuencë të lartë, që përdoren në komunikimin publik dhe që shqipja nuk i ka pasur pjesë të realiteteve të saj shprehëse, si: kompjuter, laptop, tablet, softuer, harduer, bord, meny, monitor, lavatriçe, aspirator kuzhine, lavaman, lavapjatë, lavastovilje, banane, avokado, deodorant, brioshë, kek, komunitet, kivi, arrë kokosi, aplikacion, klas (biletë në klas të parë, vishet me klas), bojkot, bojkotoj, bio (ushqim), faturino, profesor i asociuar, mobilitet (në arsim), dakord, dakordësim, dakordësoj, dekoroj qytetin (zbukuroj), prezantoj, prezantim, viskoz, komplet (një komplet), diasporë, dypartiak, tripartiak, koleksionoj, masazhim, masazhoj, portollambë, shezlong, celular, pub (pab), fitnes, pozitë, opozitë, diasporë etj.

Si edhe në gjuhë të tjera, në fazën e parë të hapjes trysnia e gjuhës ardhëse është më e fortë sesa imuniteti amënor i gjuhës pritëse (shqipes), sepse pragmatizmi për mbijetesë te folësit rrit ngutshëm nevojën për një komunikim global utilitar, që shkon përtej caqeve imunitare të normës së idiomës kombëtare. Nga ana tjetër, këta dy parametra lëvizin pozitivisht ose negativisht në raport të drejtë me disa faktorë, ndër të cilët përmbledhtazi përmendim:

- a) Frekuencën dhe forcën e trysnisë së gjuhës ardhëse, nga njëra anë, dhe qëndresën imunizuese të gjuhës pritëse, nga ana tjetër,
- b) Kohëzgjatjen e përballjes së ndërsjellë të tyre,
- c) Shkallën e zotërimit të gjuhës pritëse nga folësit në gjithë shtrirjen e arealit gjuhësor,
- d) Nevojën shoqërore të gjuhës pritëse për lëndë gjuhësore të gjuhës ardhëse për t’iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë ndaj hapjes globale,
- e) Shkallën e njësimimit të standardit të gjuhës pritëse për të mënjeluar kakofoninë gjuhësore që krijohet midis këtij të fundit dhe prurjeve dialektore, e të dyja bashkë ndaj huazimeve në ekspansion,

f) Përkujdesjen e institucioneve që merren me mësimin, leximin në shqipe, kulturimin dhe ruajtjen e gjuhës, letërsisë dhe të kulturës kombëtare etj.

Të gjithë këta faktorë veprojnë diku më shumë, diku më pak, herë të gjithë bashkë e herë në mënyrë të veçuar. Sidoqoftë, teoritë a qëndrimet e ndryshme të purizmit gjuhësor të skajshëm apo prirje të ngurta identitare të kulturës së gjuhës janë të dëmshme sepse, si çdo gjuhë, edhe gjuha shqipe reflekton lëvizjet e faktorëve jashtëgjuhësorë, të cilët ndikojnë në sjelljen e saj. Si dhe gjuhë të tjera edhe shqipja ka huazuar dhe do të huazojë nga gjuhët në kontakt, sot kryesisht më shumë nga anglishtja. Për aq kohë sa huazimi është një nevojë apo mjet pasurimi i gjuhës amtare, që vjen nga kërkesat zhvillimore të qenësishme të shoqërisë në marrëdhëniet e saj me shoqëri të tjera, ai duhet parë si dukuri e frytshme, sepse shoqëritë, gjuhët e kulturat e tyre nuk mund të mbijetojnë duke u mbyllur e u izoluar, përkundrazi, hapja dhe përballja midis tyre rrit aftësinë konkurruese e rezistencën për mbijetesë, sikundër shërben edhe si një mjet pasurimi i ndërsjellë. Në të kundërt, huazime të panevojshme, në rastet kur gjuha i ka mjetet e saj shprehëse dhe i vetëpëmbush nevojat e komunikimit, veç e dëmtojnë kumtimin në gjuhën amtare dhe e shëmtojnë gjendjen e saj natyrore.

Çështja e katërt lidhet me faktin se, si vetë gjuha në tërësi e standardi si pjesë e saj, ashtu dhe qasja epistemologjike ndaj tyre, nuk janë produkte përfundimtare, por dukuri dinamike bashkëveprimi e zhvillimi në kontekste të reja gjeopolitike e shoqërore, të cilat ridimensionohen dhe zhvillohen në një proces të ndërsjellë. Ndaj edhe referimi historik për zhvillimin e gjuhës shqipe, të ngjarjeve, emrave dhe vendimeve që kanë zënë shtrat gjatë rrugëtimit të saj nuk duhen parë vetëm si pikënisje, as si pikëndërprerje e, aq më pak, si pikëmbërritje të këtij procesi dinamik zhvillimi. Gjuhëtarët nuk bëjnë gjuhë, e as mund të shndërrohen thjesht e vetëm në mësues për të zbatuar politikë gjuhësore. Lyons (Hyrje..., f. 55) shprehet se detyra e parë e gjuhëtarit është të përshkruajë se si njerëzit, në të vërtetë, e flasin gjuhën e tyre (dhe e shkruajnë), jo të urdhërojnë se si duhet ta flasin dhe ta shkruajnë atë... Gjuhëtarit duhet të studiojë gjendjen dhe të vërejë prirjet se si gjuha dhe folësit janë në një dinamikë të pandërprerë ndryshimi të ndërsjellë.

Këtë qasje e sjell edhe Nelson (Description and Prescription, 2006), kur pohon se qasja deskriptive përfshin, sa të jetë e mundur, përkrahimin objektiv dhe jogjykses të përdorimit të gjuhës. Përkundrazi, qasja preskriptive përfshin parashtrimin ose parashkrimin e rregullave për përdorim korrekt të gjuhës.

Një qëndrim të ngjashëm mban gjithashtu në vitet '90 edhe Teun Van Dijk, (Social cognition, 1990), ku theksohet se dukuria diskursive (ligjërimore) është një hap para rregullave gramatikore (kupto preskriptive). Në fakt, gjuha natyrore i paraprin çdo lloj akti vetëdijesimi që realizohet nëpërmjet një procesi metalinguistik pasues.

Nga ky këndvështrim duhet parë edhe Kongresi i Drejtshkrimit (1972) dhe gjithë zhvillimi i mëpasshëm i gjuhës shqipe, *ipso facto* edhe ai metalinguistik: që të dyja këto procese të para në konvergencë për të realizuar gjuhën e njësuar, si një ngjarje gjuhësore, kulturore e arsimore, politike e publike, kombëtare shtetformuese.

Ky kongres vinte pas vendimeve historike të Komisionit Letrar të Shkodrës, një vepër kolektive, e cila për herë të parë hodhi themelet e një politike gjuhësore unifikuese në kuptimin teorik të këtij koncepti, po të mbajmë parasysh se për herë të parë kemi një mbështetje institucionale nga Komanda austro-hungareze me synime të qarta në këtë drejtim (Rrokaj, Çështje 4, 2018, f. 89). Vetë Kongresi i Manastirit (1908) për unifikimin e alfabetit, duke mënjeluar alfabetet e tjera dhe Kongresi i Elbasanit (1909), që i hapi rrugë Shkollës Normale të Elbasanit (1909) për mësimin e gjuhës shqipe dhe mbrojtjen e saj, ishin gjithashtu vepra kolektive në shërbim të gjuhës së njësuar, si kërkesë që përligjte dhe e bënte funksional unitetin politik të shtet-kombit (Rrokaj, Çështje 2, 2009, f. 55).

Pra, në të gjitha këto ngjarje vendimmarrëse preskriptive, prej Kongresit të Manastirit e deri te Kongresi i Drejtshkrimit e në vijim, nevoja për të realizuar një gjuhë standarde ka qenë po aq organike sa edhe nevoja për ngritjen e shtetit, të arsimit kombëtar dhe të mjeteve të larmishme të komunikimit të gjerë publik. Prandaj, parimi i trysisë për kompromis të natyrshëm të vetë folësve të gjuhës amtare për një funksionim ndërdialektor të njësuar të koineve të shqipes letrare, prej Rilindjes Kombëtare e këtej, ka

ndikuar medoemos pozitivisht në njësimin e gjuhës shqipe, duke qenë një faktor nxitës *sui generis* për standardizimin e saj.

Po t'u referohemi disa vendimeve, si: pranimi i ë-së toske të De Radës, mënjanimi nga alfabeti i zanoreve të gjata dhe të shkurtra apo dhe i hundoreve (të gegërishtes) në Kongresin e Manastirit, apo edhe përfshirja e grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, ng, nd, ngj* në Komisinë Letrare të Shkodrës, vërejmë se mundësia e dialektit toskë për të qenë në bazë të substratit të gjuhës standarde ishte tashmë e hapur.

Por, deri këtu, duket se nuk ka çështje për të ngjallur debat a kundërti. Në literaturën teorike dhe nga përvoja e formimit të gjuhëve standarde nuk ka asnjë kundërvënie teorike apo empirike për sa i përket standardit të gjuhës shqipe sepse, siç thekson Hudson (Sociolinguistika, 1995, f.740), si teorikisht edhe nga përvoja e formimit të gjuhëve të tjera standarde, mbështetja e standardit në një dialekt (në rastin e shqipes, toskë), duke e pasur dialektin (pra, gegërishten) a dialektet e tjera përplotësuese, është fakt historik e teorik i përligjur në realitetet e gjuhëve të tjera standarde si dhe në studimet teorike bashkëkohore. Përkundër kësaj, argumenti i përfaqësimit më të madh numerik të folësve për të përligjur *ipso facto* një standard *ad hoc*, që është sjellë nga ndonjë studiues së fundmi (Konf. Gjuhësore, Durrës, 2010) në dobi të një ristandardizimi (pra: popullsia gege sasiorisht më e madhe sesa ajo toske), duke mos marrë parasysh shtrirjen e standardit të sotëm gjatë këtyre dekadave edhe në arealin dialektor gegë, nuk duket se është një parim teorik *sine qua non* i vetmjaftueshëm, por gjithaq, edhe më pak një domosdoshmëri e qenësishme sot për një planifikim standardizues të frytshëm me kahe drejt gjithëgjuhës në trojet etnike e në diasporë. Nga ana tjetër, edhe parimi për një kovergjencë natyrore *sui generis* të varianteve gjuhësore, pa pasur shtysë prej një sërë faktorësh jashtëgjuhësorë, mbetet po ashtu deri sot vetëm një mundësi teorike (Kostallari, Gjuha e sotme letrare shqipe..., 1973).

Pas viteve '90, çështja e Kongresit të Drejtshkrimit, lidhur me zgjidhjet që dha për standardin dhe raportet e tij me dialektet, është bërë objekt diskutimesh e debatesh në mjaft tubime shkencore e më gjerë. Debatet kanë pasur të bëjnë kryesisht me bazën dialektore të standardit, me parimet teorike që lidhen me të, e deri tek ideja e një standardi të ri me bazë gegërishten

apo edhe mbajtjen e dy standardeve të gjuhës shqipe (Rrokaj, Çështje 3, 2014, f. 55).

Çështjet që hapën debat ndër studiues, por më shumë edhe ndër jo-studiues, ishin sidomos tezat e Kongresit për ‘bazën mbidialektore’ (Kostallari, Gjuha e sotme letrare shqipe..., 1973) të standardit. Gjithashtu, argumentet e sjella mbi ‘traditën administrative të gegërishtes’ në periudhën e Zogut, përfshirë edhe kryeqytetin në arealin gegë, shtrinin pyetje legjitime mbi arsyet që nuk mbështetën ngritjen dhe shtrirjen e një standardi me bazë substrati gegërishten. Në fakt, përkundër tezës së një substrati ‘mbidialektor’ në Kongresin e Drejtshkrimit, sot duket e pranuar teza se substrati i këtij standardi është dialekti toskë dhe se gegërishtja po luan në vijim rolin e një superstrati të rëndësishëm përplotësues.

Mirëpo, pohimet në Kongresin e Drejtshkrimit se gjuha letrare (kupto standarde) ishte një realitet tashmë në tërë arealin shqipfolës, ashtu si dhe pohimi për natyrën e saj ‘mbidialektore’ ishin jorealiste pra, joshkencore dhe shumë syresh u ‘bishtonin’ fakteve reale, nën petkun e një asperate kombëtare njësuere. Siç u theksua më lart, në atë kohë vetë kushtet gjeopolitike e shoqërore në tërësi as e kishin favorizuar dhe as mund ta favorizonin këtë proces deri disa dekada më parë, pas ndryshimeve të mëdha gjeopolitike në vitet ‘90.

Duhet theksuar gjithashtu se koncepti ‘mbidialektor’ kishte të bënte vetëm me funksionin e standardit për gjithë arealin shqipfolës. Baza dialektore ku mbështetej standardi dhe funksioni mbidialektor gjithëpërfshirës janë dy koncepte të ndryshme, që Kongresi nuk i ndau qartas, duke lënë të kuptohej se meqenëse funksioni i standardit do të ishte mbidialektor, për pasojë baza e këtij standardi ishte ‘natyrshëm’ mbidialektore. Doemos, funksioni i çdo standardi natyrshëm është gjithëpërfshirës kombëtar ose zyrtar shtetëror, kurse substrati mbi të cilin u ngrit standardi i shqipes është pa dyshim toskë. Pra, në thelb çështja nuk shtrohet përse si bazë substrati mund të ishte njëri dialekt apo tjetri. Siç u theksua më lart, teorikisht nuk ka lajthitje epistemologjike dhe as kundërti, po të kihet parasysh përvoja historike e formimit të shumë gjuhëve standarde. I mbështetur si në toskërishte apo në gegërishte substrati do të ishte po aq shqip për çdo tip standardi të gjuhës shqipe.

Vetë funksioni gjithëpërfshirës i standardit, pavarësisht substratit, pas gjithë këtyre dekadave i bën të panevojshme disa qëndrime emocionale krahinoriste që janë prirur ta kthejnë çështjen e standardit në pikën e nisjes së 1972-shit, duke mëtuar për një standard tjetër ‘mbidialektor’ të përmbysur, me bazë substrati gegërishten pra, duke e rikthyer gjendjen gjuhësore po në të njëjtën pikë zero, kur vetë rrugëtimi pas shumë dekadash i zbatimit të standardit, edhe pse me vështirësi e pa përpikëri, po dëshmon se ai po u përgjigjet në rritje kërkesave komunikuese në trojet etnike e në diasporë.

Edhe ndonjë tezë për një neostandard metropolitane (L. Shamku-Shkreli, Standard dhe neostandard, 2007) është e po aq e paqëndrueshme sa dhe vetë lëvizjet brenda territorit indigjen të popullsisë së ardhur nga enklava të ndryshme në këto treva. Homogjeniteti gjuhësor dhe planifikimi standardizues janë në raport të ndërsjellë me qëndrueshmërinë e popullsisë në territor dhe planifikimin e saj urban. Kësisoj, planifikimi gjuhësor dhe ai urban, edhe pse nga qasje të ndryshme, krijojnë gjasa për sinergji me ndikim konvergues të ndërsjellë.

Vijoj gjithashtu t’i përmbahem mendimit se me gjithë diskutimet e debatet, ky standard, edhe pse ende në proces formësimi dhe shtrirjeje, e mbrojti gjuhën shqipe prej “krisjes së brendshme gjuhësore”, si rrjedhojë e një lloji “krisjeje kombëtare”, që po realizohej heshturazi gradualisht për shkak shkëputjes së trevave prej copëtimit gjeopolitik e ideologjik të kombit në disa shtete, e ku shqipja, sikundër vetë shqiptarët po formonin *volente o nolente* një arkipelag gjuhësor, pa mundësi komunikimi brendaetnike prej një “ishulli gjuhësor” të një shteti tek tjetri. (Rrokaj, Çështje 3, f. 57).

Në gjendjen e sotme është e qartë se as trojet etnike shqipfolëse e as gjuha e tyre nuk janë më në kontekstin e kohës kur u vendos norma drejtshkrimore në KD. Pas viteve ’90, shpërfaqja gjeopolitike e arealit gjuhësor shqipfolës në troje dhe në diasporë erdhi në vijim të përmbysjeve të sistemit ideologjik njëpartiak dhe ndryshimeve në ish-Jugosllavi, të hapjes së shoqërisë shqiptare më së pari mes vetes me lëvizje demografike brenda saj, por gjithaq edhe prej hapjes së saj ndaj shoqërisë globale me ndikimet përkatëse në gjuhën shqipe. Siç u përmend më lart, kjo gjendje ‘lëvizëse’ gjuhësore ka filluar të prodhojë një realitet të ndryshëm në larminë gjuhësore edhe të vetë

standardit. Nga ana tjetër, gjendja e dobët politike, ekonomike, shoqërore e kulturore e shqiptarëve në kontinent e përtej tij, periudha shumë e vogël për shtrirjen dhe përsosjen e standardit qysh prej KD nuk po krijojnë ende gjasa për një reformë të frytshme dhe komplekse që t'i përgjigjet kësaj shpërfaqjeje gjuhësore të re. Siç dihet, një shtet i fuqishëm si Gjermania ka gati një shekull që ka ndërmarrë një reformë gjuhësore, e cila vijon ende të jetë në proces. Për shoqërinë tonë, me problematika formësuese e njësuere kombëtare ende të hapura, pesë dekada prej Kongresit të Drejtshkrimit dhe vetëm tri dekada (edhe më pak po të kemi parasysh pavarësimin e Kosovës) prej ndryshimeve të mëdha politiko-shoqërore, po të mbahen parasysh faktorët gjeopolitikë dhe historikë, është një periudhë kohore shumë e vogël për të formësuar një standard të ngulitur, gjithëpërfshirës, të shtrirë e të njësuar në gjithë trevën shqipfolëse.

Është ende herët për të ndërmarrë një reformë standardizuese me spektër të gjerë sa kohë që ende trojet nuk kanë arritur një njësim gjeopolitik e publik me frekuencë të lartë prirjeje unifikuese. Në gjendjen e sotme shqiptarët me gjuhën e tyre, bashkë me mallrat e idetë, perceptimet mbi botën brenda enklavave të territorit përkatës, janë ende në 'kërkim' të njëri-tjetrit dhe në një qarkullim spontan, hera-herës kaotik. Shkolla, media si dhe gjuha administrative nuk po e 'thyejnë' me fuqinë e duhur barrierën e enklavës gjuhësore brenda territorit indigjen dhe nuk po e mbajnë dot barrën e kësaj shpërfaqjeje gjeopolitike në kontekstin e ri gjuhësor.

Sidoqoftë, studimet gjuhësore po mundësojnë mbledhjen e një përvoje studimore, ku problemet e gjuhës së njësuar synohen të kundrohen nga këndvështrimi i gjuhës në përdorim, i cili është përcaktues për normën e çdo gjuhe standarde. Si shumë studiues të tjerë (Ismajli, Drejtshkrimet e shqipes, 2021), mendoj se debate dobiprurëse për çështje të ardhshme të standardit, të realizuara kryesisht nga studiues dhe në institucione universitare e akademike, siç ka qenë edhe puna e Këshillit Ndërademik apo botime veprash akademike, si fjalorët etj., shërbejnë për të gjetur e propozuar zgjidhje në fushë të standardit, pas të cilave lipset të ndërmerret një reformë planifikuese gjuhësore sa më pranë gjithëgjuhës në përdorim. Sigurisht, më së pari, është e nevojshme t'i largohemi debatit të padobishëm deri sot: toskërisht apo gegërisht, si një përplasje krahinore dhe t'i qasemi sa më afër

realitetit të gjuhës në përdorim në shtrirje të gjerë. Gjithashtu, nisma normëzuese individuale dhe propozime me synime detyruese për përdoruesit e standardit, pa mohuar vlerën e tyre, nuk mund të shërbejnë si rregulla normative të standardit në përdorimin publik (Dhrimo & Memushaj, Fjalor drejtshkrimor..., 2015). Si në çdo vend tjetër, vendimet për reforma në fushën e standardit merren me konsensus institucionesh akademike dhe në bashkëpunim me institucionet shtetërore.

Duke qenë edhe “gjuhë e shtetit” dhe e institucioneve të tij, për pasojat që kanë këto ndryshime standardizuese në tërë veprimtarinë shtetërore e publike, ato duhen bërë me konsensus shtetëror. Kjo do të thotë se përpos një diskutimi akademik, dhe një përgjegjësie ndërinstitutionale, është e nevojshme edhe një “dritë jeshile” nga shteti. Te shqiptarët ky “mandatim” është ndërshtetëror, sepse ndryshimet prekin komunikimin ndërshtetëror, ndërinstitutional, një legjislacion të njësuar nga ana gjuhësore për përkthimin e ligjeve dhe akteve ndërkombëtare, shkollën në tërësi, median dhe gjithë veprimtaritë e tjera publike në rrafshin kombëtar. Pra, çështja e standardit është sa përgjegjësi individuale e studiuesve po aq edhe përgjegjësi e institucioneve që merren me gjuhën. Por, kjo përgjegjësi është edhe e shtetit, i cili e ka “gjuhën e vet” të komunikimit në tërë shtrirjen e marrëdhënieve shtetërore e publike. Kurse në rrafshin gjeopolitik të shqiptarëve kjo është një përgjegjësi kombëtare ndërshtetërore, por gjithaq edhe duke përfshirë shqiptarët aty ku janë pakicë kombëtare e në diasporë.

Për të harmonizuar këto tri nivele përgjegjësie është më e udhës që mëtimi mbi shqipen të bëhet nisur nga këndvështrimi i rezultateve dhe i ecurisë gjuhësore, i kushteve të reja gjeopolitike dhe i sfidave të përbashkëta kombëtare për të ardhmen. Në vend të shpërfaqjeve të diletantizmit shkencor, të euforisë nacionaliste apo të egocentrizmit krahinorist është e nevojshme të kemi sa më shumë studime që mbajnë parasysh dinamizmin e gjuhës në realitetin gjeopolitik aktual, duke zbatuar mbi to metodologjinë shkencore, në mënyrë që eksperimentet parashkencore, që gëlojnë nëpër qarqe ‘gjithologësh’, të mbudhen drejt laboratorit të vetë shqipes natyrore.

Sot standardi i shqipes është shkëputur dukshëm nga koineja toske, duke ndjekur rrugën e vet të zhvillimit, por edhe duke u pasuruar nga gjithë areali dialektor i mbarë shqipes, kryesisht ai gegë. Natyrisht, nga Këshilli

Ndërkademi, por edhe nga studiues të veçantë janë bërë disa propozime, ku mund të ndërhyhet për rregullime normative, por, siç u theksua më lart, mendoj se është ende herët për të ndërhyrë në standard në mënyrë tërësore dhe të thellë, sepse ndryshimet gjuhësore në këtë prag shekulli e kanë vënë gjuhën shqipe dhe standardin e saj përballë sfidash shumë më komplekse dhe të thella sesa thjesht një nevojë për disa rregullime normëzuese në standardin aktual, duke marrë si referencë platformën drejtshkrimore të Kongresit të Drejtshkrimit. Shqipja sot po përballlet me një “stuhi” gjuhësore prej gjuhëve të tjera, kryesisht me anglicizmat. Vetë ky standard ka ende probleme të mëdha për t’u ngulitur në të gjitha trojet. Koha e shkurtër për shtrirjen e tij, faktorët demografikë, shkolla, institucionet e ndryshme, mungesa e një politike planifikuese gjuhësore në kushtet e reja gjeopolitike etj. nuk ndihmën ende në shtrirjen sa dhe si duhet të standardit në gjithë trevën shqipfolëse. Ndaj, futja e ndryshimeve të tjera, në një kohë relativisht të shkurtër, veç do ta rriste më tej mundin kolektiv për njësim e do ta përkeqësonte më tej “kakofoninë” gjuhësore. Çdo reformë e çalët a gjysmake mund të sjellë më shumë çoroditje sesa dobi në këtë drejtim.

Sidoqoftë, shtysa për ndërhyrje të pritshme në standardin aktual po vjen prej bashkëveprimit të disa faktorëve ndër të cilët veçojmë: dinamizmin e zhvillimit të vetë standardit, që lidhet edhe me ndryshimet e sistemit politik e ideologjik, bashkë me ndryshimet gjeopolitike, kryesisht në dy-tri dekadat e fundit. Nga ana tjetër, është e kuptueshme se vetë Kongresi i Drejtshkrimit nuk mund të mbyllte gjithçka plotësisht dhe drejt për arsye të mosnjohjes plotësisht të të gjithë arealit gjuhësor të trevave shqipfolëse, që vinte nga gjendja e pamjaftueshme e studimeve dialektologjike të kohës në gjithë arealin shqipfolës, të cilat nuk ishin gjithmonë konverguese, për shkak edhe të copëtimit politik të kombit tonë si dhe të mungesës së hapësirës teorike njohëse të kohës në kushtet e izolimit të vendit nga gjithë zhvillimi i gjuhësisë bashkëkohore. Siç dihet, vetë Kongresi la shumë çështje të hapura për t’u ndjekur në dinamikën e mëtejshme të zhvillimit të gjuhës. Sot njësimi i standardit po bëhet një realitet më i natyrshëm, sipas gjuhës në përdorim, dhe se studimet po hapen ndaj gjuhësisë së korpuseve për të dhënë zgjidhje mbështetur në këtë realitet të prekshëm. Vërehet gjithashtu se qasjet preskriptive po orientohen edhe më shumë prej studimeve deskriptive, të cilat po u referohen prirjeve të standardit të sotëm dhe të gjithëgjuhës në shtrirje

të gjerë në kontekstin e kësaj shpërfaqjeje reale gjeopolitike sipas gjuhës në përdorim, duke zbatuar metodologji të reja të mbështetura në gjuhësinë e korpuseve dhe analizave të diskutit të sotëm shqip.

Në përfundim, mund të themi se 50 vjet pas KD, në gjendjen e sotme të arealit shqipfolës, shqiptarët nuk mund të kenë dy standarde gjuhësore e as nuk mund të nisin nga e para një të ri. Në gjendjen e sotme gjuhësore është e nevojshme që të lihet mënjane debati kundërvënës gegërisht / toskërisht apo Veri-Jug. Cilado zgjidhje normëzuese për ndërhyrje në standard të mbudhet në një perspektivë zgjerimi dhe pasurimi të tij, mbështetur në gjuhën në përdorim e me shtrirje të gjerë hapësinore drejt gjithëgjuhës, me qëllim që shqiptarët të arrijnë një kohezion më të shpejtë shpirtëror e gjuhësor dhe të kenë një komunikim me frekuencë të lartë në të gjithë sjelljen e tyre politike, ekonomike, shoqërore, arsimore, edukative etj. Në këtë proces, ndërhyrjet reformuese dhe përvetësimi i standardit nuk mund të bëhen dhe nuk mund të realizohen jashtë vetëdijes për gjithëgjuhën në kushtet e reja gjeopolitike e, aq më pak, duke iu referuar platformës normëzuese të vendimeve të '72-shit, kur është e qartë se realiteti i ri po i sjell shqiptarët dhe gjuhën e tyre në një kontekst tjetër nga ai i vitit '72. Gjithashtu, njësimi dhe përvetësimi i standardit nuk mund të jenë gjithashtu një proces i vetëmjaftueshëm, duke lënë mënjane vetëdijen për rolin e dialekteve dhe të folmeve të tjera, e ca më pak, vështirimin e tyre si të ishin gjuhë tjetër apo të folme deficitare apo duke e parë vetë standardin si të vetmen 'gjuhë komunikimi'. Kjo do ta dëmtonte rëndë hapësirën natyrore perceptuese të shqipfolësve anekënd, sepse do ta ngushtonte vizionin e tyre mbi botën, të krijuar qysh në zanafillë bashkë me vetë qenien e tyre.

Në ndërkohë, një investim në rritje në shkollë, në administratat e shteteve dhe në media për përvetësimin e gjuhës së njësuar, së bashku me një debat gjuhësor shtetëror në institucione, i cili gjendjen gjuhësore të sotme e sheh në funksion të një reforme komplekse dhe gjithëpërfshirëse, besoj së është rruga e frytshme për të ardhmen e gjithëgjuhës dhe të standardit të saj.

Bibliografi

ASH e RPSSH, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.

ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor ishqipes së sotme, Toena, Tiranë, 2002.

- Bourdieu P., Ce que parler veut dire. L'économie des changements linguistiques, Fayard, Paris, 1980.
- Bussmann H., Lexikon der sprachwissenschaft, digitalizuar, 2008.
- De Mauro T., 'Disa konsiderata mbi politikat gjuhësore', si dhe 'Mbi gjuhën dhe edukimin gjuhësor, në Dukuri të shqipes bashkëkohore, 5-8 tetor, 2005.
- Demiraj Sh., Shqipja e sotme letrare në prag të shekullit XXI, GjJ, 1-4, 1998.
- Dhrimo A., Memushaj R., Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, infobotues, Tiranë 2015.
- Haugen E., Language Planning in Modern Norway. De Cruyter Mouton, 1968.
- Hobsbawm E.J., Nazioni e nazionalismi dal 1870, Einaudi, Torino, 1990.
- Françoise Th., La langue de bois, Commentaire Julliard, 1987.
- Ismajli R., Drejtshkrimet e shqipes, Tiranë, ASHA, 2021.
- Kadare I., Vepra 20 vëll, Onufri, 2007.
- Konferencë gjuhësore: Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit, Durrës, 2010.
- Kostallari A., Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj, Tiranë, 1973.
- Lyons J., Hyrje në Gjuhësinë teorike, Dituria, Tiranë. 2010.
- Louis Martinez, La langue de bois soviétique, në Commentaire, vëll. 4, 1981-1982.
- Nelson G., Description and prescription, University College London, London, UK, Elsevier, Ltd, Encyclopedia of language and Linguistics, 2006.
- Richard A., Sociolinguistika, Tiranë, 1995.
- Rrokaj Sh., Çështje të gjuhës shqipe 1, Albatros, Tiranë, 2007.
- Rrokaj Sh., Çështje të gjuhës shqipe 2, Shkronjë pas shkronje, Tiranë, 2009.
- Rrokaj Sh., Çështje të gjuhës shqipe 3, Shkronjë pas shkronje, Tiranë 2014.
- Rrokaj Sh., Çështje të gjuhës shqipe 4, Pegi, Tiranë, 2018.
- Rrokaj Sh., Çështje të politikave arsimore në Shqipëri, Pegi, Tiranë, 2019.
- Savoia L., Aspekte ideologjike të nacionalizmit gjuhësor, GjJ, 1-2/2003.
- Shamku-Shkreli L., Standard dhe neostandart. Prirje vetëstrukturuese të shqipes së sotme, Çabej, Tiranë, 2007.
- Teun Van Dijk, Social cognition, 1990.
- Vebiu A Shqipja totalitare: Tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990, Çabej, 2009.

Prof. Dr. Ledi SHAMKU-SHKRELI
Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

A ËSHTË *SUI GENERIS* NEOSTANDARDI I SHQIPES? NJË VËZHGIM KONTRASTIV

Sa e kemi vëzhgu ne jetën e Shqipes Vehikulare?

Nergut po e nis aty ku e la Çabej: te nevoja për ta vëzhgu gjuhën kur nisi industrializimi masiv. Pak, shumë pak studime të këtilla kemi, e thujse kryekëput dialektologjike (hiq më të rrallë ndonjë studim të rendit *dialektologji urbane*). Kemi humbur shumë pa dokumentuar. Edhe

gjithë çka ka lindë në qendrat e mëdha industriale, edhe ligjërimet e kriptuara në kohë të diktaturës sikundër qe “mbrapshtja” me metatezë të rrokjeve, e folmja rinore e qendrave të mëdha urbane, e njëjtë për nga tipologjia me Verlan-in francez.

Shumë kemi humbë e vijojmë më humbë, pa dokumentu thujse asgjë. Preskriptivizmi vijon me e pasë ende davanë e fituar ndaj Deskriptivizmit.

Po shtroj të parën pyetje. Si qe shëndeti i standardit pasi ai u sprovua si mjet i shkollimit masiv të shoqërive shqipfolëse? Faktikisht nuk e dimë. Pavarësisht entuziazmit prej Realsoc-i të do pohuesve të cilët thonë se standardi u përhap me sukses ngado, në fakt kurrnji matje s’ka pasur dhe ende nuk ka.

Faktikisht nuk e dimë, por empirikisht mundemi disi ta ndërtojmë, së paku për Shqipërinë. Dhe po arsyetojmë kësi shtegu: Nëse nga pikëpamja sociolinguistike standardi qe një varietet detyruës shpesh i largët nga ligjërimet vendase, duke i përbuzur shpesh trojet pritëse, nga pikëpamja demografike në paralel me këtë imponim, u krye edhe kontrolli e plotë i lëvizjes demografike. E cila ngriu.

E thënë më shkoqur, çdokush që lindte në një fshat të vogël ose në një qytet të madh, rritej dhe vdiste aty pa lëvizur. Këta dy faktorë, pra *hiperkontrolli gjuhësor* nga njëra anë (bazuar mbi imponim, ndalesë dhe përçmim) dhe *hiperkontrolli i lëvizjes demografike* nga ana tjetër, po ta mendo-ni mirë, krijojnë kushtet perfekte për lindjen dhe konsolidimin e diglosisë.

Gjuha e shtetëzuar (standardi nuk qe thjesht gjuhë shteti, pasi Shteti u soll me pronën gjuhësore njëlloj si me pronën materiale: shtetëzoi cdo pasuri), gjuha e shtetëzuar pra mbeti të përdorej vetëm në situata tejet formale, duke mos hyrë dot në gjysmëformale dhe informale. Ngrirja e lëvizjes demografike solli që bashkësitë gjuhësore të mbeteshin për 40 vjet shumë homogjene, kulturalisht të tipit “esprit de clocher”, siç do të thoshte Saussure. Për pasojë nëse varieteti i lartë dhe i imponuar erdhi si një risi në kuadrin gjuhësor të komuniteteve shqipfolëse, ai duke u gjendur përballë *l'esprit de clocher*, si dhe i ofruar nga ideologjia si një pushtim gjuhësor, iu desh të luftonte për të kaluar nga diglosia në një dilali të çalë, në të cilën varieteti i lartë (pra standardi) riprodhohet keq dhe përdoret më së shumti në situata imponuese hiperformale. Krejt spektri tjetër i diafasisë mbeti i vetërregullueshëm.

Pikërisht me këtë këmbë, me këmben e një dilalie të çale, hyri dija në Shqipëri në stadin e vet social, stad kur gjuhësisht varietetet vehikulare standarde nisën të kalojnë atë që Saussure quante “prova e zjarrit”, pra të shkruhen nga miliona duar e madje edhe të synohet të fliten nga miliona gojë.

Sa më shumë shkolloheshin bashkësitë, aq më të shumta ishin varietetet që përftoheshin. Nëse dikur hapësirat ligjërimore populloheshin nga varietete diatopike dhe një cep i ngushtë, tejet i ngushtë diamezik që përfaqësohej nga varieteti shkrimor pa ndonjë interferencë të qenësishme me të parat, shkollimi solli me vete pashmangësisht përdorimin e vehikulares në diatopi të ndryshme në diafazi të ndryshme (sipas konteksteve), në diamezi të ndryshme (me shkrim a me gojë), e sidomos në diastrati të ndryshme (shtresa të ndryshme socio-kulturore kishin inercitë e veta konservatore ndaj varieteteve natyrore, ndaj takonin të reja por pa harruar të vjetra). Shkollimi masiv dhe thuajse përmbushja e alfabetizimit bëri më në fund që pas thuajse një shekulli sot çdo individ që flet të jetë edhe një individ që shkruan. Shkollimi solli me vete lindjen e continuumit sociolinguistik, i cili është tejet më i larmishëm se continuumi dialektologjik. Hapësira komunikuese u tejmbush me variante e realizime ligjërimore gjithfarë, dhe nisi ndeshja për të krijuar pole (dendësime). Neostandardi është njëri nga këto dendësime.

Neostandardi ka moshën e shkollimit masiv.

E sikur të mos mjaftonte gjithë kjo tektonikë, aty nga fundi i shekullit të njëzetë një tjetër revolucion teknologjik e fuqizoi edhe më ndeshjen në

gjuhë, pikërisht se shtoi ligjërimet “banore” të variacionit gjuhësor. Futja masive e internetit (e cila solli me vete whatsapp, facebook, instagram, portale online e çdo log komunikimi virtual) i dha shkas lindjes së asaj që po konsiderohet si Netlekt. Po ç’është Netlekti në strukturën e vet? Në thelb ai paraqet zbutjen e skajme për herë të parë të hendekut diamezik (shkrim/e folme). Çfarë të reje solli teknologjia e bazuar në komunikimin virtual? Ajo shprishi pikërisht këtë ndarje themelore: kohën. Në ehatsapp, në komente online, në mesazhistikë e deri diku edhe në mail, shkruesi dhe lexuesi rrojnë për të parën herë në sinkroni si të ishin folës e dëgjues. Lindin kështu netlektet, komunikimet e mundësuar nga teknologjia, në të cilat për herë të parë të shkruarit dhe të folurit janë bashkë.

Më kryesorja është se Netlektet i japin mundësi gjithkujt të shkruajë publikisht, pra jo veç atyre që shkruajnë për shkak të profesionit. Nga njëra anë kjo i mban njerëzit më të lidhur pas gjuhës së shkruar, me të cilën përndryshe do t’i kishin rralluar a shuar krejt marrëdhëniet pas shkollimit. Por, më anë tjetër në diapazonin e shkrimeve publike depërtimin e gjuhës së folur apo të pambikëqyrrur. Gjithë ky revolucion teknologjik mbipopullon me një mori variantesh repertorin e përdorimeve, ndaj ndeshja në gjuhë përveçse e pashmangshme vjen e bëhet edhe tejet domethënëse. Kjo epokë për rrjedhje është epoka e sociolinguistikës që studion ndeshjet intra dhe ekstra-linguistike. Për vetë gjuhën, epoka e ndeshjeve të tilla është në thelb një epokë e artë, pasi një gjuhë gëzon shëndet të mirë kur ka marrëdhënie të vijuar dykahëshe mes të shkruarit e të folurit si dhe kur gjuha realizohet në të karta funksionet: lexim, shkrim, dëgjim, të folur.

Falë teknologjisë është rritur në mënyrë eksponenciale numri i atyre që vijnë të shkruajnë dhe të lexojnë. Dhe ky është njimend lajm shumë i mirë për Kulturën e Gjuhës. Si edhe mundësi e vyer për Deskriptivistët e Shqipes.

Si paraqitet **tipologjikisht** ky Neostandard? Cilat nivele të analizës ristrukturon dhe në çfarë elementesh? Krahasuar me proceste vetërregulluese që përshkruhen se ndodhin në gjuhët tipologjikisht të afërta, a ka të përbashkëta Neostandardi i Shqipes, apo është sui generis (sikundër u tha se ishte Standardi saj). Ka shumë rëndësi krahasimi mes Shqipes dhe gjuhëve të tjera, sa u takon këtyre tipologjive, pasi kësi shtegu na vjhen më e qartë edhe metoda e qëndrimi i mandejmë.

Vijojmë pra me një kontrast tiparësh mes Neostandardit të Shqipes dhe Neostandardit të Italishtes, duke marrë në shqyrtim (nga 24 tipare rishtruktuese) veç ato më domethënëset, për sa na lejon koha e kësaj kumtese-Ky studim është gjithqysh në process.

Përemrat

Sa i takon *përemrave*, përvec çeshtjes “*që*” dhe “*i cili*”, si edhe thuarjes shuarjes së distancës lokative mes “*këtë*” dhe “*atë*”, vlejnjë të përmenden edhe tipologjia e togfjalëshit “*ai + emër në trajtën e shquar*” – [*ai djali, ajo hera kur, ajo dita, ai momenti, ai rasti që, atë punën për të cilën më the, atë çeshtjen*]. Dhe këtu mund të përkapet edhe një zanafillë tektonike e trajtës së pashquar, e cila po humbet truall në favor të së shquarës. Mendojmë se kjo ndodh pasi në mendësinë e shqipfolësve një vektor e bën të dukshme trajtën, pra e bën të shquar. Njëjtë vërehet se ndodh edhe në italisht me dëftorin “*quello*”, “*quella*”. “*quel*”. Duke iu referuar përdorimeve neostandarde të tij në italishte, Ramat verën (dhe po e citoj) se “*një pikë tjetër interesante përbëhet nga përdorimet atipike të dëftorit që tregojnë distancën nga folësi, por afërsinë me bashkëbiseduesin: jo rrallë, në fakt, ne jemi dëshmitarë të përdorimit të asaj si mbiemër i desemantizuar po edhe zëvendësues i njëjës shquese*”.

Sërish te përemrat: shtrirja e madhe e “*që*” polivalente, duke rrudhur ndjeshëm përdorimin më formal “*i cili*”.

Edhe kjo dom lexuar si një prirje drejt thjeshtimit dhe drejt fjalive me bashkërenditje se të tilla struktura sintaksore parapëlen i foluri – bashkërenditëse pra. Njëjtë edhe këtu si italisht. E meqë jem inë temë, le të shtojmë edhe shfaqjen e “*ku*” si alternativë ndaj “*të cilit*”. Korpusi na dëshmon për një pik rritjeje eksponencile (kryesisht në regjistrin e shkruar, dhe “*ku*” na del pa funksion vendor. Shembull nga korpusi: “*Ekipi i vajzave u nderua me çmim, ku çmimi qe plotësisht i merituar*”.

Përkim i plotë rishtrukturues me shqipen vërehet edhe në italisht me “*dove*”. Madje një pyetësori të njëjtë, të shpërndarë në 50 italishtfolës e 50 shqipfolës për arsyet e përdorimit të “*dove* e “*ku*” si alternative e “*quale*” dhe “*cilit*”, shumica iu përgjigj me motivin “*është më formale*”. Pra kemi jo veç përkim në formë, po edhe në qëndrim.

Përsëritjet përemërore

Nuk kemi përkim mes “a me mi piace” dhe “mua më pëlqen”. Kjo përshtfaqje (me redondancë të përemrit), në Italishte është neostandarde, në shqipe jo. Por ky dallim lidhet thjesht me dy tradita të ndryshme të gjuhës së shkruar në dy vendet (histori të ndryshme të gjuhës së shkruar).

Luhatjet e mënyrës lidhore

Lidhorja në italisht dhe shqip trandet po njësoj. Vecse ka një dallim në diafazi. Në italisht lidhorja është e shkëputur nga paradigma gramatikore. Pra qëndron vetëm si një mënyrë e nuk gjendet gjetiu. Si e tillë, në neostandardin e italishtes humbja e saj vihet re qysh në regjstrat gjysëm të lartë, mandej të mesëm e me radhë. Dhe jo rrallë humbet edhe në shkrim. Ndërsa shqipja si gjuhë ballkanike, lidhoren e ka të ngërthyer edhe gjetiu, ta zemë e ka tek koha e ardhme. Kjo shtrirje e mbron deridiku lidhoren në shqip, ndaj humbja e saj sot për sot vërehet në regjistrat nën nivelin mesatar dhe më së shumti në gjuhën e folur.

Në shqip: *Po ka guxim, le të flasë, Po do le të vijë vetë, mbesim me shpresë që përgjigja jonë merr vëmendjen tuaj*, - diafazikisht mbetet ende në substandard, ndonëse në akrolektin e tij. Gjithsesi, për ta dyshuar atë që sapo thashë, kërsëror mbetet fakti se kjo luhatje e lidhores, vihet re më së shumti në burimet toskë, pikërisht aty ku përdorimi i lidhores është më i shpeshtë dhe ekzistenca e saj edhe me e ngulët.

Paskajorja foljore

Kjo risi e Neostadardit të shqipes, në italishte mungon si ristrukturim, pasi italishtja e ka paskajoren (infinito verbale). Në fakt, bën me dashtë gjuhëtarët, edhe varieteti standard i shqipes e ka, se “do me thënë” e “me qenë se” a nuk përbëjnë prani të rregullt të paskajores në standard? Thjesht kanë dashur të shkruhen bashkë për të krijuar një opakëzim formal, çka nuk ka qenë e nevojshme te “në qoftë se”, e cila shkruhet damas.

E kam hetuar diakroninë e paskajores, përse mundet ta hetojë një individ. Për të folur me shifra dhe të dhëna konkrete, kam ndërtuar një korpus me shkrimet shkollore të nxënësve, duke u përqëndruar në 5 qytete të mëdha:

dy në Veri, Tiranën dhe dy në Jug. Theksojmë se asnjëra nga shkollat nuk është shkollë periferie. Korpusi u mendua me dy nëndarje: esetë e provimit të lirimit dhe esetë e maturës (ngaqë flitet për moshën të ndryshme dhe stadi të ndryshme të edukimit shkollor). Në jug nuk hasëm asnjë prani të paskajores. Në Tiranë, për nëngrupin e 14 vjeçarëve përdorimi i paskajores në vitin 2015 rezultonte në masën 13.8% ndërsa për 18 vjeçarët në masën 17.7%. Ndërsa në 2021 pas 6 vjetësh për nëngrupin e 14 vjeçarëve përdorimi i paskajores rezultoi në masën 19.2% ndërsa për 18 vjeçarët në masën 21.3%. Në Veri rezultatet e 2015 ishin: 36.6% për nivelin e 14-vjeçarëve dhe 38.2% për 18-vjeçarët. Kryesisht paskajoret janë nga folje të zgjedhimit të dytë e të tretë. Hasen mjaft edhe pjesore të shkurta të zgjedhimit të parë.

Korpuse të tjerë po për këtë qëllim i ndërtuam edhe me gazetën në Shqipëri e Kosovë, duke zgjedhur për fokus rubrikën “Kronikë”. Vërehet një prani e interesante e paskajores në gazetën e Shqipërisë, por gjithnjë në brendi të lajmit e sidomos kur perifrazohet i intervistuari. Mesa duket gazetari, duke ritregu intervistën e vjelë me zë e pra si ligjërim i folur, duket se nuk refuzon me përdorë paskajoren në shkrim, nonëse shkruan në standard.

Ndërsa në gazetën e Kosovës paskajorja e shkruar shfaqet ndjeshëm, në masën 41.2% të rasteve dhe madje haset edhe në testat e gazetave apo titujt e lajmeve. Dua të theksoj se sa u takon gazetave të njëjtin korpus patëm ndërtuar në vitin 2008, por prania e paskajores në gazetën e Tiranës që pothuajse e papërfillshme, ndërsa në Kosovë mjaft e paktë atbotë.

Ja pra që Neostandardi i Shqipërisë nuk është aspak sui generis. Nuik ka qenë i tillë as standardi i saj, mirëfilli toskë. Po, ka pasur në të vërtetë diçka sui generis. Të tilla kanë qenë politikat gjuhësore dhe sociolinguistike me të cilat shteti përcolli standardin, duke e dëmtuar shumë atë, pasi e shndërroi në një varietet që rron veçse në kushte totalitare.

Pyetja që shtrohet në fund është: cili i bie të jetë sot roli i gjuhëtarit. Ose për ta thënë me fjalët e Saussure, të shkrimet e pabotuara: sa punë të mira ka mundësi të bëjë gjuhëtarit që nuk i bën.

Sipas meje gjuhëtarit sot i duhet për së pari të luftojë me kaosin që lind nga ndeshja e gjuhëve. Dhe ka vetëm dy armë në këtë luftë: shkencën dhe shkollën. Shkencën për të kuptuar ç’drejtime po merr ndeshja, dhe shkollën për të rritur kompetencën të reja gjuhësore, pa humbur të vjetrat. Për të

ndërtuar ligjërime aulike pa humbur ligjërimet e fëmijërisë, të pasionit, të inatit, të gjyshërve e të rrugicave qorre. Shkencën për të kuptuar sa e natyrshme (dhe e papërbuzshme) është antigjuha e adoleshentëve që lind si rebelim ndaj autoritetit, si shfaqje e anarkisë moshore, dhe Shkollën për t'ia futur këtë antigjuhë aty ku i takon në repertorin e përdorimeve që shkojnë nga akrolektet te bazilektet. Shkencën për ta kuptuar ku ndan gjuhësisht demokracia nga diktati dhe shkollën për ta kultivuar demokracinë e cila s'është tjetër në thelb përveçse një demokraci me baza ligjërimore.

Gjuhëtari duhet të jetë në luftë me pushtetet e çdo rendi, pasi pushteti ushtron fuqinë e vet jo vetëm përmes luftës me armë gjuhët, por edhe përmes manipulimeve tinëzare gjuhësore. Pasi gjuhëtari e di se gjuhët kanë fuqi të krijojnë edhe realitete, e se njerëzimi jep e merr objekte linguistike. Pakkush arrin ta kuptojë se roli i gjuhëtarit është rol kyç si në luftë ashtu edhe në paqe. Veçse paqja është një gjendje e përkohshme e njerëzimit, pasi dinamikat e pushteteve dhe ideologjive e shtyjnë atë vijimisht drejt luftës. Kësodore po i bashkohem zërit të Calvet, duke thënë tok me të: “Kjo e bën të qartë si drita e diellit faktin se ndorimi i çështjeve të gjuhës e të ligjërimeve nuk i duhet lënë në dorë asesi pushtetit. Nëse lufta është vazhdimi i politikës, por me mjete të tjera, atëherë politika gjuhësore është forma më e qytetëruar e luftës së gjuhëve. Ndaj dhe, pasi është tretur çdo vegulli pacifiste, gjuhëtarit i bie barra që në punën e vet të sillt si qytetar dhe të ushtrojë mbi të gjitha politikat një vigjilencë të përhershme demokratike”.

Akademik i asocuar, Valter MEMISHA
Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

SHQIPJA STANDARDE DHE FJALORËT SHPJEGUES KOMBËTARË

50-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit na jep shtysë për të parë ecurinë e shtrirjes dhe të nxënies së shqipes së njësuar ase *standardit* (term, tashmë, i pranuar gati si barasvlerës i konceptit *gjuhë e njësuar letrare kombëtare*¹). Dhe për të qenë të saktë në gjykime e në vlerësime, detyrimisht pika e referimit duhet të jetë ky kongres, i mbajtur në vitin 1972, i cili, sipas akademikut Jorgo Bulo, “ishte akti më i madh historik i bashkimit shpirtëror të shqiptarëve të të gjitha trevave shqipfolëse, sepse ai konsakroi njësinë e gjuhës dhe njësia e gjuhës është kushti themelor i njësisë së kombit”².

Qëndrimet për gjuhën e njësuar shqipe, sidomos këta 30 vjetët e fundit, janë artikulluar gati në pandërprerje. Duke qenë dhe vetë në linjën e vlerësimit

¹ Akad. A. Kostallari shkruan “... nuk është e drejtë që gjuha letrare kombëtare, e cila ka një pasuri e larmi kaq të madhe mjetesh leksikore e frazeologjike, gramatikore e stilistike, një shtrirje kaq të gjerë e një dinamikë të tillë historik, pra ka mundësi të pakufizuara, të quhet ‘gjuhë standarde’, siç kanë filluar ta quajnë atë një varg autorësh, sidomos në këta 20–30 vjetët e fundit. Në gjuhën letrare kombëtare gjen shprehjen më të përqendruar e më të shumanshme gjithë jeta e popullit, kultura e tij lashtë dhe e re, bota e tij shpirtërore, aftësia dhe veprimtaria e tij krijuese e pashtershme. Ajo është gjithnjë në lëvizje, pasurohet e lëmohe. Njësimi e normëzimi nuk e ngurosin asnjëherë atë. Përkundrazi. Ata ia shtojnë gjallërinë dhe mundësitë e përtëritjes, sepse e bëjnë me të vërtetë gjithëkombëtare gurrën krijuese që e ushqen pandërprerë, dhe rrezin e veprimit. Asnjë “standard” nuk mund ta ketë një gjallëri, larmi e shumanësi të tillë. “Standardi”, sido që të jetë, paraqitet si diçka e rëndomtë, e paravendosur pak a shumë në mënyrë subjektive, e palëvizshme, e ngurosur dhe ka një fushë veprimi të caktuar, gjithashtu të paravendosur e të kufizuar nga detyra e qëllime të caktuara. Nocioni i “standardit” buron, me sa duket, nga njëjtësimi i gjuhës me kodet. Por asnjë lloj kodi nuk mund të njëjtësohet as me gjuhën në përgjithësi, as me gjuhën letrare kombëtare veçanërisht.” *Shih më gjerë* A. Kostallari, *Mbi disa drejttime të përkryerjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, në Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, III, Tiranë, 1989, f. 66.

² J. Bulo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Tiranë, f. 48.

dhe të mbështetjes së zgjidhjes që u bë për këtë variant po sjellim më të disa vlerësime që lidhen drejtpërdrejt dhe me fjalorët shpjegues kombëtar normativë. Studiuesi Xh. Lloshi nënvizon se “Sot ne kemi një gjuhë shqipe letrare, që është gjuha e një kombi, e një shteti dhe e një kulture kombëtare. Ajo është forma e lartë e ekzistencës së kësaj gjuhe historikisht dhe në kohën e sotme. Ajo i ka përpunuar dhe po i zhvillon më tej funksionet e saj, duke qenë në korrelacion me shoqërinë së cilës i shërben, me veprimtarinë politike, ekonomike, intelektuale e kulturore që ajo zhvillon.”³

50 vjet nuk janë pak, por as shumë në jetën e një gjuhe të njësuar. Kjo ka vlerë dhe për shqipen standarde. Sipas Xh. Lloshit, “karakteristikë e saj është lidhja ngushtë më gjuhën e gjallë të folur, lidhje e cila ishte në qendër të vëmendjes edhe në Kongresin e Drejtshkrimit, 1972.”⁴ Por një nga problemet më të mëdha që nxori krijimi i variantit të njësuar ase i standardit ashtu si ndodh domosdoshmërisht dhe patjetër tek të gjitha gjuhët e tjera në botë, gjatë këtij procesi, është përballja me një gjendjeje diglosie, ndërmjet variantit të njësuar dhe gjuhës së folur (me të folmet dialektore apo shoqërore të saj). Sipas studiuesit, kjo gjendje shpërfaqet dhe në një prerje stilistike dhe shkruan se “Nga ana tjetër, kjo nënkupton edhe një specializim të gjuhës për nevojat funksionale, gjë që do të thotë se tashmë kemi edhe fenomenin e diglosisë, në kuptimin e përdorimit të regjistrave të ndryshëm shoqërorë-stilistikë”⁵ nga i njëjti njeri.

Për të kapërcyer këtë gjendje ‘diglosie’, në bazë të politikave dhe të planifikimit gjuhësor, u hartuan vepra themelore kodifikuese, ku u mishëruan struktura dhe sistemi i standardit. Pas Kongresit u botuan përkatësisht: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973; *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980; *Gramatika e gjuhës shqipe, I (Morfologjia)*, 1995; *Gramatika e gjuhës shqipe, II (Sintaksa)*, 1997). Këto vepra “bashkë me plotësueset e tyre, janë tri kulme të së njëjtës ndërtesë madhështore historike, më se njëqindvjeçare, themelet e së cilës janë hedhur në Rilindje, që quhet shqipe standarde.”⁶

³ Xh. Lloshi, *Shqipja e sotme në kontekste të ndryshme kulturore*, GjSh, 1998, 1, f. 36

⁴ Xh. Lloshi, *Shqipja e sotme në kontekste të ndryshme kulturore*, GjSh, 1998, 1, f. 36

⁵ Xh. Lloshi, *Shqipja e sotme në kontekste të ndryshme kulturore*, GjSh, 1998, 1, f. 36

⁶ M. Çeliku, *Çështje të standardizimit, tri vepra kodifikuese madhore të gjuhësisë shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX*, në M. Çeliku, *Çështje të shqipes standard*, Tiranë, 2014, f. 189

Sipas studiuesit M. Çeliku, që është marrë së shumti dhe drejtpërdrejt me shqipen standarde, këto “janë tri kryevepra të gjuhësisë shqiptare dhe të albanologjisë në përgjithësi”, dhe “kanë luajtur e luajnë një rol të jashtëzakonshëm në zhvillimin e shkencës, të arsimit e të kulturës kombëtare si edhe në forcimin e unitetit kombëtar. Nëpërmjet tyre gjuha letrare shqipe u zhvillua mjaft dhe u pajis me kodet themelore që i duhen një gjuhe letrare të njësuar. Këto kanë mundësuar hartimin e shumë veprave të tjera gjuhësore, si gramatika, fjalorë të të gjitha llojeve, monografi, tekste shkollore, etj, nga autorë vendas dhe të huaj. Vlerat e tyre sigurisht do të jenë të mëdha edhe në të ardhmen, duke shërbyer si mbështetëse për studime të mëtejshme.”⁷

Veprat janë hartuar nga forcat shkencore më të mira të kohës dhe u realizuan si projekte që *do të përcaktonin rrugëtimin dhe ardhmërinë e shqipes së njësuar / të shqipes standarde*. Sipas studiuesit M. Çeliku, “Që të tria veprat janë kryer me punë të përqendruar (të centralizuar) institucionale nga institucionet më të larta shkencore të vendit e pikërisht nga Akademia e Shkencave të Tiranës (IGJL) dhe vetëm Gramatika në bashkëpunim me UT (Katedra e gjuhës shqipe e FHF), janë vepra të hartuara nga bashkautorë me punë kolektive; komisionet hartuese udhëhiqen e përbëhen nga gjuhëtarë, disa prej të cilëve janë nga më të shquarit gjuhëtarë shqiptarë të shek. XX, si: Xhuvani, Çabej, Cipo, Kostallari, Domi, Demiraj, që të gjithë me formim shumë të mirë teorik shkencor bashkëkohor perëndimor dhe lindor.”⁸

Studiuesi, gjithashtu, ndalet me të drejtë në akribinë e punës së hartuesve e në metodologjinë shkencore, duke hedhur poshtë njëherazi keqinterpretimet e qëndrimet atakuuese të ndonjërit ndaj këtyre veprave themelore të gjuhësisë sonë bashkëkohore. Ai, ndër të tjera, thekson se “Të gjithë këta autorë kanë punuar me objektivitet shkencor dhe në normëzimin e gjuhës autorë si Xhuvani, Çabej, Cipo, Domi etj. nuk mund të akuzohen si përmbushës të ‘direktivave’ politike. Ata kanë bërë një përgjithësim kritik të traditës, duke shfrytëzuar dhe pasqyruar arritjet e mëparshme në fushat përkatëse, mbështeten në një letërsi faktike dhe teorike shumë të pasur, pasqyrojnë zhvillimin e hovshëm të gjuhës letrare. Materialet faktike janë marrë

⁷ M. Çeliku, Çështje të standardizimit ..., f. 194

⁸ M. Çeliku, Çështje të standardizimit ..., f. 192

nga gjuha e gjallë e popullit dhe nga letërsia e shkruar, sistemuar në kartoteka shumë të pasura.”⁹

Edhe pse në këtë punim të shkurtër jemi përqendruar te *Shqipja standarde dhe fjalorët shpjegues kombëtarë*, mendojmë se është me vend të shihen marrëdhëniet ndërmjet këtyre tri veprave kodifikuese, të cilat gjithnjë sipas M. Çelikut, “ndërvaren dhe njëkohësisht mbështesin njëra-tjetrën: *Drejtshkrimi* ka shërbyer si bazë për *Fjalorin e Gramatikën*, *Gramatika* ka ndihmuar mjaft *Fjalorin* dhe që të tria ndihmojnë për ngulitjen e drejtshqiptimit. Nga ana tjetër, *Drejtshkrimi*, *Fjalori drejtshkrimor* dhe *Shenjat e pikësimit* përbëjnë një tërësi të vetme të pandashme e organike, sepse ato plotësojnë njëra-tjetrën në normëzimin e variantit shkrimor të gjuhës letrare.”¹⁰

Ky studiuesi ndalet, ndër të tjera, në përbashkësinë e këtyre tri veprave akademike. Sipas tij, ato “kanë shumë gjëra të përbashkëta: të tria kanë bërë objekt studimi gjuhën e sotme letrare shqipe, të tria janë punime përgjithësuese (sintetizuese), janë mbështetur në kërkime shumëvjeçare gjatë disa dhjetëvjeçarëve, të tria janë normative, janë kodifikuese të shkrimit të njësuar të shqipes letrare, të glosarit të saj, dhe të strukturës morfologjike e sintaksore të shqipes së sotme, të tria janë me vlerë teorike dhe praktike.”¹¹

Gjuhë e njësuar do të thotë gjuhë e kodifikuar, gjuhë e normëzuar. Veprat, për të cilat me vetëdije po i referohemi gjerësisht artikullit “Çështje të standardizimit, tri vepra kodifikuese madhore të gjuhësisë shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX” të M. Çelikut, janë ato pa të cilat shqipja standarde nuk mund të funksionojë e të kryejë misionin për të cilin luftuan breza e breza të tërë atdhetarësh e dijetarësh. M. Çeliku shkruan se “*Drejtshkrimi* ka kodifikuar normat e shkrimit, duke u mbështetur në trashëgiminë, përfshirë arritjet e KLSH, si dhe në vetë zhvillimin e gjuhës letrare; *Fjalori* ka kodifikuar normën leksikore, duke përzgjedhur e përgjithësuar fjalët e frazeologjitë si dhe duke zbatuar normën drejtshkrimore e morfologjike në paraqitjen e fjalëve dhe të trajtave të tyre; *Gramatika* ka kodifikuar normën morfologjike e sintaksore të gjuhës letrare shqipe, duke synuar një përkrahje tërësor e të thellë dhe shpjegim sa më të plotë. Këto tri kode mund të

⁹ M. Çeliku, Çështje të standardizimit ..., f. 192

¹⁰ M. Çeliku, Çështje të standardizimit ..., f. 192

¹¹ M. Çeliku, Çështje të standardizimit ..., f. 189

quhen *Drejtshkrimi* (i parë) i njësuar i shqipes, *Fjalori* (i parë) normativ i shqipes, *Gramatika* (e parë) normative i shqipes; me terminologjinë më të fundit mund të quhen: *Drejtshkrimi i shqipes standarde*, *Fjalori i shqipes standarde*, *Gramatika e shqipes standarde*, sepse që të tria japin një kontribut të shënuar në njësimin e kristalizimin e plotë e përfundimtar të gjuhës letrare kombëtare shqipe.”¹²

Veprat kodifikuese, gjithashtu sendërtojnë, përvojën më të përparuar botërore dhe me parime shkencore të hartuara nga shkencëtarë të njohur që u qëndrojnë kohës. Gjithnjë sipas M. Çeliku “Nuk ka dyshim se, krahas përvojës vendëse, këto vepra janë mbështetur edhe në gjuhësinë më të përparuar botërore, megjithëse u hartuan në rrethana të një izolimi të skajshëm. Parimet teorike, hartuar nga kryeredaktorët (është fjala për *Fjalorin* dhe *Gramatikën*) janë bashkëkohore, të detajuara, në një nivel teorik të lartë dhe në përputhje me natyrën e shqipes. Po përmendim këtu parimin themelor që ka udhëhequr zgjedhjen e fjalëve e përfshirjen ose jo në Fjalor: “Të gjitha fjalët dhe njësitë frazeologjike të gjuhës shqipe Fjalori i ka vlerësuar si pasuri të përbashkët kulturore të popullit shqiptar. Vlerësimi bëhet sipas vlerës objektive në strukturën leksikore të gjuhës së sotme letrare kombëtare”. Ky parim, shumë i njohur për lingistikën, është ndjekur edhe më herët në leksikografinë shqiptare (Kristoforidhi).”¹³

Gjuha letrare e njësuar shqipe / standardi është nga gjuhët me karakter më popullor në Evropë. Veprat kodifikuese e ato plotësuese për procesin e shtrirjes së saj, e ruajnë këtë tipar themelor, ngrihen mbi gjuhën e popullit dhe e ndihmojnë popullin të përvetësojë standardin. Akademik A. Kostallari “Gjuha e sotme letrare shqipe i shërben gjithë kombit dhe zotërohet në mënyrë aktive nga shumica dërrmuese e popullsisë, sidomos në trajtën e shkruar. Përvetësimi i vetëdijshëm i sistemit të saj arrihet, në vijat themelore, që gjatë arsimit tetëvjeçar të detyrueshëm; këto njohuri zgjerohen e thellohen në shkallët më të larta të shkollimit dhe mbështeten e përforcohen nga të gjitha botimet e mjetet e përdorimit gojor të gjuhës letrare kombëtare. Pra, kjo gjuhë mund të quhet sot me plot të drejtë edhe gjuhë popullore e mirëfilltë.

¹² M. Çeliku, Çështje të standardizimit ..., f. 189

¹³ M. Çeliku, Çështje të standardizimit ..., f. 194

Ky është një tipar i ri që ka fituar gjuha letrare shqipe e epokës sonë.”¹⁴

Veprat kodifikuese për të cilat po flasim, bëhen treguese dhe të prestigjit kombëtar, por dhe të atij ndërkombëtar të shqipes së njësuar / standarde. Madje ato kanë rol të pazëvendësueshëm dhe në nxënien e kësaj gjuhe nga shqiptarët jashtë kufijve, në diasporë, në ngulime të ndryshme apo dhe në vendosje të përkohshme punësimi të shqiptarëve. Sipas studiuesit Xh. Lloshi, “Duke mos pasur zbrazëti në sistemin e vet funksional, gjuha e sotme shqipe krijon mundësitë për një kontakt të gjerë me gjithë kulturën tjetër botërore, madje e lehtëson edhe përvetësimin e gjuhëve të huaja në shkollë. Pikërisht këto rrethana kanë bërë që gjendja e gjuhës shqipe jashtë kufijve të Shqipërisë nuk mund të kuptohet më jashtë marrëdhënieve me gjuhën letrare kombëtare dhe ndikimit të fortë të saj. Ky ndikim, ndër të tjera, përforcohet edhe me rolin specifik të veprave kodifikuese, drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori gjuhës së sotme shqipe, të cilat sigurojnë njësinë e gjuhës në shkollë, në botimet, në mjetet e komunikimit masiv dhe në veprimtaritë gojore publike.”¹⁵

Deri në këtë 50-vjetor të Kongresit të Drejtshkrimit, në fushën e leksikografisë shpjeguese kombëtare vërehen arritje të shënueshme, edhe pse nuk jemi atje ku duhet. Janë hartuar e botuar 5 fjalorë normativë: *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (FGjSSh, 1980), me 41 000 fjalë dhe 7.000 njësi frazeologjike, me 180.000 kuptime e 1.500.000 thënie ilustruese; *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (FShS, 1984) me rreth 34 000 fjalë, i ripunuar, i përditësuar i plotësuar dhe i botuar me të njëjtin emërtim, *Fjalor i shqipes së sotme* (FShS), 2002, me rreth 35 000 fjalë; *Fjalor i gjuhës shqipe* 2006, me 48.000 fjalë, me 5.000 njësi frazeologjike dhe me mbi 120.000 kuptime; si dhe *Fjalor i vogël i gjuhës shqipe*, 2020 me rreth 35.000 fjalë e 3.000 njësi frazeologjike.

Këta fjalorë, në një prerje kohore, sjellin lëndë nga leksiku i shqipes në periudhën kur ata janë hartuar. Njëherazi, mbartin dhe pasuri nga fjalorët paraprijës, të botuar para Kongresit të Drejtshkrimit (pra nga fjalorë që nuk përfshihen në lagjen e fjalorëve normativë). Akademik J. Thomai nënvizon për këtë: “Pothuajse gjithë fjalorët, përveç burimeve të gjuhës së shkruar në të gjitha stilet, të ligjërimeve të folura popullore, të krijimtarisë gojore folklorike

¹⁴ A. Kostallari *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, në “A. Kostallari, I”, Tiranë, 2016, f. 366

¹⁵ Xh. Lloshi, *Shqipja e sotme në kontekste të ndryshme kulturore*, GjSh, 1998, 1, f. 36

etj., kanë marrë më të mirën edhe të fjalorëve të mëparshëm dhe kanë shtuar lëndë të re në fjalës, në kuptime, në frazeologji etj. Si shembull mjafton të përmendim përsëri “*Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*”, i cili përvetësoi gjithçka të mirë të fjalorëve të mëparshëm dhe më pas vetë shërbeu e shërben si burim lënde e zgjidhjesh leksikografike për hartimin e fjalorëve të tjerë dygjuhësh, sinonimikë, frazeologjikë etj., madje për “*Fjalorin e shqipes së sotme*” (1984/2002), i hartuar thuajse nga i njëjti grup leksikografësh dhe i botuar në Tiranë nga Akademia e Shkencave, e për “*Fjalorin e gjuhës shqipe*” të tipit të vogël që po hartohet. Vërehet qartë në këtë rrugë zhvillimi një plotësim i mirë në shumë drejtime. Ky është shfrytëzimi i përvojës së arritur brenda-përbrenda leksikografisë dhe pasurimi i saj i mëtejshëm.”¹⁶

Nga të gjitha këta fjalorë, më i rëndësishmi është *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (1980). Puna për hartimin e tij, i konceptuar në disa vëllime, nisi në mesin e viteve '60 të shekullit të kaluar. Në vitin 1976, katër vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit, u rikonceptua për t'u hartuar si vepër me një vëllim, që nga numri i njësive leksikore (fjalë dhe njësi frazeologjike) që do të përfshinte, do të ishte një fjalor i tipit të mesëm, me një makrostrukturë që do të synonte rreth 50.000 njësi (Fjalori që kemi në duar, ka mbi 48.000 njësi: mbi 41 000 fjalë dhe 7.000 njësi frazeologjike). Vepra u hartua në bazë të parimeve shkencore të hartuara nga A. Kostallari¹⁷.

Vepra, që identifikohet si e para e leksikografisë sonë normative pas Kongresit, u hartua për të kryer dy funksione kryesore: të kishte **karakter informues** sa më të gjerë, sa më të saktë, sa më të qartë e sa më shkencor, si dhe të kishte **karakter normativ**, të mishëronte e të edukonte normën leksiko-frazeologjike e semantike (madje, përmes elementeve mbishtresore e sintagmatikës ilustruese, edhe normën fonetike, gramatikore e stilistikore).

Vepra përdallon, në radhë të parë, për vlerësimin e pasurisë që ka zënë vend në të. Akademik A. Kostallari, kur vepra ishte në proces hartimi, shkruante: “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, që ka filluar të hartohet nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë i Universitetit Shtetëror të Tiranës, e

¹⁶ J. Thomai, *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, në *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 16

¹⁷ A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e 'Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe'*, në A. Kostallari, III, Tiranë 2017, f. 285-412

përcakton në mënyrë edhe më të vetëdijshme, më të plotë e më të përpiktë veçorinë themelore objektive të formimit e të zhvillimit të fondit leksikor të shqipes së sotme letrare kombëtare. ‘Parimi udhëheqës më i përgjithshëm në zgjedhjen e fjalëve, ... mund të formulohet në këtë mënyrë: Fjalori i gjuhës së sotme shqipe duhet t’i shohë të gjitha fjalët e fondit leksikor të shqipes së sotme, nga çdo burim i tyre, si pasuri e përbashkët kulturore e popullit shqiptar. Vlerësimi i çdo fjale-leksemë (për ta përfshirë ose jo në Fjalor) duhet të bëhet, në radhë të parë, jo sipas burimit dialektor, as sipas autorit që e përdor; por sidomos sipas vlerës së saj objektive në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare’¹⁸.

Kurse akademik J. Thomai vëren se “Ky fjalor përbën pa dyshim një nga arritjet më madhore të gjuhësisë shqiptare. Nga lënda leksikore, frazeologjike e kuptimore që përmban, më e gjerë se gjithë fjalorët e mëparshëm së bashku, nga karakteri sistemor e normativ dhe nga niveli shkencor i zgjidhjeve leksikografike në hullinë e gjuhësisë bashkëkohore ai shënon një hap të madh cilësor në zhvillimin e leksikografisë sonë të kohës. Duke u mbështetur në një kartotekë të pasur të leksikut të shqipes (atë kohë me rreth 4.000.000 skeda), *Fjalori* pati mundësi të zgjedhë pjesën më të mirë të leksikut të shqipes, u dha vendin e merituar fjalëve e shprehjeve të bukura popullore, hodhi në qarkullim mjaft fjalë e shprehje të panjohura ose pak të njohura, dha struktura të gjera kuptimore të fjalëve, u hapi rrugë leksikut e frazeologjisë vetjake të shqipes. *Fjalori* bëri edhe shtresimin e leksikut e të frazeologjisë sipas kërkesave të normës gjuhësore e të normës stilistike.”¹⁹

Studiuesja Sh. Islamaj nënvizon faktin se “Ne vazhdojmë të kemi një fjalor shumë të mirë shpjegues të gjuhës së sotme shqipe, i cili u bë bazë për shumë fjalorë tipash të ndryshëm, po edhe për fjalorët e këtij lloji, që duhet të trajtohen tash e tutje.”²⁰

Por dihet tashmë se një fjalor “vjetrohët” që ditën që botohet. Për njërën apo tjetrën arsye, për shkak të tipit a të vëllimit, për shkak të faktorëve

¹⁸ A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, në A. Kostallari, I, Tiranë, 2016, f. 46

¹⁹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2020, f. 393.

²⁰ Sh. Islamaj, *Leksikografia shqiptare në rrethanat e reja, gjuha dhe fjalorët*, në Sh. Islamaj, *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, Prishtinë, 2004, f. 129-130

gjuhësorë a jashtëgjuhësorë, një fjalor shpjegues nuk mund të përfshijë gjithë pasurinë leksikore e semantike të gjuhës. Edhe fjalorët “tesaurus”, gjithëpërfshirës, nuk e mundësojnë këtë gjë. Duke nxjerrë në pah vlerat e *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, si dhe duke u ndalur në arealin gjeografik nga vjen pasuria që ai ngërthen, studiuesi M. Çeliku vë në dukje se “Fjalori përmban shumë fjalë të gurrës popullore, mbledhur nga të gjitha trevat duke mbajtur një qëndrim vlerësues edhe ndaj pasurive leksikore të Veriut. Si në të gjithë vendin, shumë ekspedita leksikologjike dhe dialektologjike u organizuan edhe në Veri për të mbledhur fjalë dhe frazeologjizma me shumë interes, megjithëse pasuritë leksikore të këtyre trevave, për shkak të izolimit të Shqipërisë nga bota shqiptare e përtej kufirit, praktikisht u pasqyruan vetëm pjesërisht.”²¹

Kurse studiuesja Sh. Islamaj shkruan se “Ky fjalor mund të bëhet bazë e mirë edhe për fjalorin e mbarë shqipes, i cili do të hartohet duke shfrytëzuar burime të reja, duke përfshirë në të fjalorët që botohen çdo ditë, duke u zgjeruar me leksikon e të folmeve popullore, duke shfrytëzuar lëndën e mbledhur nga hulumtimet dialektologjike dhe, natyrisht, duke futur edhe vetë hartuesit fjalë që dinë e që nuk gjenden në burimet e shfrytëzuara. Edhe FSHS duhet të plotësohet, sepse, e kemi thënë edhe herë të tjera, një fjalor vjetrohët posa të dalë nga shtypi, sidomos ai i përgjithshmi dhe sidomos në rrethanat në të cilat gjendet sot shoqëria shqiptare; duhet të plotësohet, sepse çdo ditë shtypen dhjeta libra, gazeta e revista, në të cilat shfaqen shumë njësi të reja leksikografike. Për mungesë njerëzish e mjetesh nuk është e mundur të bëhen të gjitha këto punë shpejt, prandaj gjithmonë fjalori do të ketë të meta e mungesa të arsyeshme.”²²

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, u kthye në shkollën e leksikografisë shkencore bashkëkohore shqiptare. Ai i ndihua gjithë punës së mëtejshme hartuese në leksikografinë njëgjuhëshe e, patjetër, asaj dygjuhëshe. Por ai nuk mund t’i plotësojë gjithë nevojat që ka praktika ligjërimore shqipe sot. Ndaj është koha që ky fillim shekull ta kapërcejë këtë gjendje. Shqipja sot e ka të domosdoshme dhe nevojë urgjente hartimin e një fjalori të madh normativ (edhe pse procesi për hartimin e fjalorëve të vëllimeve e të tipologjive të tjera e të ndryshme përmbajtësore nuk duhej të ndërpritet asesi), ashtu si ka nevojë dhe për fjalorin e madh tesaurus. Fjalorët në qarkullim, krahas funksioneve e

²¹ M. Çeliku, *Çështje të standardizimit ...*, f. 190

²² Sh. Islamaj, *Leksikografia shqiptare ...*, f. 129-130

rolit të pazëvendësueshëm, nuk mund të plotësojnë këtë nevojë e njëherazi këtë zbrazëti. Kushtet e reja gjuhësore, zhvillimi e pasurimi i ndjeshëm e me ritme të hovshme të leksikut të gjuhës sonë e trysnojnë këtë sipërmarrje.

Leksiku i shqipes së sotme, ka njohur shkallë të reja zhvillimesh sa-siore e cilësore në katër procese: në pasurimin horizontal (është pasuruar me njësi leksikore e frazeologjike), në pasurimin vertikal (në shtimin e mijëra e mijëra kuptimeve të reja përmes shndërrimeve të figurshme), në intelektualizimin e pandërprerë (si pasurim i leksikut mundësor, abstrakt, terminologjik etj.) dhe në demokratizimin i shpejtë (duke u bërë pronë jo vetëm e elitave gjuhësore, por e mbarë popullsisë). Sot vërejmë se leksiku i shqipes standarde është rritur ndjeshëm si pasurim i brendshëm dhe si pasurim i jashtëm. Është hedhur e po hidhet në qarkullim një pasuri që rrok me dhjetëra mijëra njësi nga gjuha e popullit; ka njohur ritme të jashtëzakonshme fjalëformimi (ku përdallojnë formimet jo si krijim i fjalëve të veçanta, por krijimi i vargjeve të tëra leksikore, që ndërtohen kryesisht me brumin e me mjetet fjalëformuese të vetë shqipes); janë futur në përdorim mijëra e mijëra terma dhe sisteme terminologjike për fusha të ndryshme të dijes e të teknikës, leksiku i përgjithshëm është pasuruar ndjeshëm përmes shterminologjizimit të njësive të ndryshme, madje përmes shterminologjizimit të sistemeve të tëra terminologjike²³, ashtu si vetë proces huazues si pasurimi i jashtëm, ka njohur nivele të papara më parë.

²³ A. Kostallari shprehet se “Edhe në gjuhën tonë të sotme vihen re qartë dy procese të përkundërta. Më njërën anë, terminologjia depërton mjaft gjerë nga të ashtuquajturat “mikrogjuhë” a “nëngjuhë” të shkencës e të teknikës në gjuhën e përgjithshme të masave punonjëse, domethënë terminologjia shterminologjizohet. Nga ana tjetër, njësi të leksikut popullor terminologjizohen. Kështu, p.sh., fjalë të gjuhës së përgjithshme të popullit, si *bërthamë, bisht, ballë, bosht, brez, cak, degë, farë, flegër, furrë, fushë, fyzë, gërshërë, gisht, grykë, gur, gushë, gjë, hap, hojzë, këmishë, kërthizë, kësulë, kopsht, kripë, kulm, kurorë, lejlek, lëmsh, lundër, nyjë, palë, pellg, pikë, qiri, rend, rrënjë, rruazë, sy, shkallë, shkarkoj, e shkarkim, trung, trup, thelb, unazë, urë, valë, rrymë, vesh, vëlla, vijë, xhep, yzengji, zinxhir* etj. janë bërë tashmë edhe terma në fusha të ndryshme të shkencës, të teknikës, të artit, të sportit, të ushtrisë etj. dhe shërbejnë edhe si tema prodhuese për terminologjinë (krhs. p.sh. *bërthamë* si pjesë e fortë e frytës të pemëve e si term në botanikë, në fizikë – *bërthama* e atomit, energjia *bërthamore*, në gjeologji – *bërthama* e Tokës, në biologji – lëng *bërthamor* dhe mbiemrin e prejardhur terminologjik *bërthamor*-e etj.)”. Shih më gjerë A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, në A. Kostallari, I, Tiranë, 2016, f. 394-395.

Shqipja është ndër të rrallat gjuhë që nuk ka një fjalor madh normativ. Fjalorët shpjegues që janë në përdorim, për nga numri i fjalëve dhe i njësive frazeologjike që pasqyrojnë, janë të tipit të mesëm. Fjalori i ri, duke ruajtur karakterin normativ e duke theksuar atë informues, do të jetë shumë më i hapur për pasurinë që nuk është përfshirë sidomos, në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (rreth 42.000 fjalë e 7 njësi frazeologjike) dhe në *Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006* (48.000 fjalë e 5.000 njësi frazeologjike). Nevoja për një fjalor të madh është artikuluar herë pas here kohët e fundit. Studiuesja Sh. Islamaj shkruan se “Fjalorët e mëdhenj shpjegues e përshkrues, përgjithësisht na mungojnë. Na mungon sidomos një fjalor i mbarë shqipes. FGJSSH, ashtu si të gjithë fjalorët shpjegues të këtij lloji, nuk mund të përfshijë leksikon e tërësishëm të gjuhës, dhe këtë ambicie nuk mund ta realizojë asnjë ndërmarrje kolektive e aq më pak individuale leksikografike. Fjalorët e mëdhenj shpjegues përpunohen nëpër vite e shekuj.”²⁴

Përdoruesi i sotëm i shqipes, si qytetar i thjeshtë, si shtetar, si politikan, si student, si mësues, si gazetar, si shkrimtar, si diplomat, si studiues, si përkthyes e si kushdo që merret me të, ka nevojë për një fjalor që të ketë të paktën një vëllim me dyfishin e njësive (fjalëve) të fjalorëve në qarkullim (kjo kërkesë del dhe në synimet e shqipes për të plotësuar spektrin saj leksikografik krahas hartimit të veprave të llojeve të ndryshme, sidomos të fjalorëve shkollorë a moshorë, të fjalorëve për vepra e autorë, të fjalorëve ideotematikë etj.).

Në shekullin XXI Shqipëria është përfshirë në zhvillime të vrullshme dhe të shumanshme, të cilat trysnojnë zhvillime të tilla dhe në gjuhë. Shqipja është e hapur dhe i ndjek këto zhvillime që i përkasin botës materiale, mendësore, estetike etj. të shqiptarit të sotëm. Dihet se nënsistemi gjuhësor më i hapur dhe i lidhur drejtpërdrejt me to është sistemi leksikor. Fjalori i shqipes sot është rritur shumë. Ky pasurim ka sjellë hartimin e fjalorëve të ndryshëm që u përgjigjen nevojave të përdoruesve. Vërehet me kënaqësi se janë hartuar fjalorë dygjuhësh, që mbulojnë kontaktet gati me të gjitha gjuhët kryesore në botë (*anglisht-shqip e shqip-anglisht, gjermanisht-shqip e shqip-gjermanisht, frëngjisht-shqip e shqip-frëngjisht, italisht-shqip e shqip-italisht, greqisht-shqip e shqip-greqisht, spanjisht-shqip e shqip-spanjisht, suedisht-*

²⁴ Sh. Islamaj, *Leksikografia shqiptare...*, f. 129

shqip e shqip-suedisht, rusisht-shqip e shqip-rusisht, maqedonisht-shqip e shqip-maqedonisht, serbisht-shqip e shqip-serbisht etj.). Shqipja sot ka në përdorim fjalorë shpjegues (të hartuar institucionalisht apo nga individë), të cilët shkojnë deri te fjalorë të tipit të mesëm (që pasqyrojnë rreth 50.000 apo 60.000 fjalë). Dy veprat më të plota, të hartuara nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë: *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980, dhe *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006, kanë rol të pazëvendësueshëm dhe për leksikografinë dygjuhëshe, por nuk janë fundorë. Hartimi i *fjalorit të madh të shqipes standarde*, që nënkupton rritjen e karakterit informues, por dhe zgjerimin e pasurisë leksikore e semantike normative, do të lehtësonte e të ndihmojë shumë edhe procesin e hartimit të fjalorëve dygjuhësh, sidomos të atyre kur shqipja është gjuhë e parë.

Gjithashtu, një leksikografi e zhvilluar e ditëve të sotme nënkupton që të mbulojë nevojat e përdoruesit me fjalorë shpjegues njëgjuhësh, jo thjesht me fjalorë të formatit të printuar (të shtypur si libra), por së pari me fjalorë të formatit on-line. Këta e kanë komponentin e pasurimit të hapur dhe kjo është shtysë e fuqishme për të hartuar një fjalor të madh që është ngaherë i hapur për prurjet e reja fjalësore e kuptimore, si dhe për qortimin apo sistemimin e pasurisë së pasqyruar më parë në të.

Fillesat e punës për një vepër të tillë i gjejmë që në vitin 1963 (kur vepra u konceptua me disa vëllime), por puna u ndërpre në vitin 1976. Ajo rinisi në vitin 2006, por u ndërpre përsëri për shkak të reformës në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. U paraqit si projekt në vitin 2008 nga Qendra e Studimeve Albanologjike (sot Akademia e Studimeve Albanologjike), por përfundimisht puna për hartimin e një fjalori të madh të shqipes standarde mori rrugë në vitin 2021, si zbatimi i një projekt i drejtuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Është parashikuar që vepra të hidhet në qarkullim në vitin 2024.

Fjalori ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme dhe synohet të jetë vepër madhore leksikografike me rreth 100.000 njësi leksikore (90.000 fjalë dhe 10-12.000 njësi frazeologjike) dhe si e tillë do të pasqyrojë, do të ruajë dhe do të hedhë në përdorim pasurinë më të madhe leksikore, frazeologjike e semantike të gjuhës shqipe së sotme. Ai do të rritë ndjeshëm **funksionin informues** (tashmë vepra vjen me dyfishin e pasurisë leksikore të fjalorit më të mirë shpjegues të shqipes të hartuar deri tani) dhe do të jetë njëherazi një

vepër normative, pra pasuria që do të përfshihet në të (fjalë, kuptime, njësi frazeologjike, sintagmatika ilustruese etj.) i përket apo lidhet me shqipen e njësuar, standarde.

Realizimi i objektivit për dyfishim të karakterit informues është potencialisht dhe realisht i arritshëm. Kurse ruajtja e karakterit normativ shpërfaq jo pak çështje, sepse dhe vetë nocioni *normë leksikore e semantike* është shpesh i kritikuar, madje edhe i mospranuar. Studiuesi e leksikografi profesionist Miço Samara shkruan se “Puna për *kodifikimin* e leksikut në fjalorët shpjegues ka qenë një ndër detyrat më të vështira të leksikografisë sonë, për të cilën ka pasur mjaft vlerësime, por edhe vërejtje. Zgjidhja e kësaj detyre është e lidhur ngushtë me mbështetjen në konceptin e drejtë shkencor për *normën leksikore*.”²⁵

Dhe vazhdon se “Në mënyrë më të përmbledhur, *norma leksikore* i hap rrugën ose i paraprin *kodifikimit*, i cili kryhet nga leksikografët, duke ndjekur me kujdes zhvillimin e saj (d.m.th. të *normës*), në përputhje me zgjerimin e polivalencës së standardit në rrafsh vertikal e horizontal, ku leksiku, ndryshe nga elementet e tjera gjuhësore, vlerësohet me të drejtë si pasuri e përbashkët e gjuhës letrare kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektor.”²⁶

Gjithë grupi i realizimit të projektit për këtë fjalor e ka detyrë parësore, jo thjesht realizimin e numrit të zërave leksikografikë, por dhe përzgjedhjen e kodifikimit e njësive të reja sipas kësaj norme.

²⁵ M. Samara nënvizon se “Koncepti për *normën leksikore* dhe *kodifikimin* e saj është shumë i gjerë e kompleks. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me dy terma (*norma* e *kodifikimi*), të lidhur e të kushtëzuar nga njëri-tjetri.

a) Në një kuptim, më konkret, *norma leksikore* dhe *kodifikimi* kanë të bëjnë me pasqyrimin e drejtë e në sistem të njësive leksiko-semantike, të vlerave të tyre shënuese në rrafsh paradigmatic e sintagmatik, të makrostrukturës e të mikrostrukturës në fjalor.

b) Në një kuptim tjetër, më teorik, *norma* dhe *kodifikimi* në fjalor janë të lidhur me konceptin për standardin e nënstandardin dhe raportet ndërmjet tyre, me qëndrimin e drejtë ndaj fjalës së huaj dhe asaj ndërkombëtare, ndaj dialektizmit e krahinorizmit, si edhe me konceptin për *normën terminologjike*, *fjalëformuese* e *stilistike*, për *sinoniminë* e *antoniminë*, *homoniminë*, *neologjinë* e *poliseminë*.” Shih më gjerë, M. Samara, *Rreth normës leksikore dhe kodifikimit të saj në fjalorët shpjegues të shqipes në Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 54

²⁶ Shih më gjerë, M. Samara, *Rreth normës leksikore dhe kodifikimit të saj në fjalorët shpjegues të shqipes*, në *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 54

Në projektin që po zbatohet theksohet se “*Fjalori* do të shënojë regjistrimin e parë të pasurisë më të madhe e më kryesore të fjalëve, të frazeologjisë e të kuptimeve leksikore të gjuhës sonë, pasurinë e gjallë të gjuhës; do të jetë një vepër përgjithësuese që do të përfshijë shtresën më aktive të leksikut të shqipes dhe një pjesë të madhe të shtresës pasive, strukturat kuptimore të fjalëve dhe karakteristikat kryesore gramatikore, stilistike e shprehëse. Zgjerim do të kenë disa shtresa leksikore të pasuruara e të gjallëruara rishtas, si nga fushat e elektronikës e të informatikës, të financave e të bankave, të artit e të kulturës, të biznesit, të organizimit shtetëror etj. Zgjerim do të kenë shtresat leksikore nga fusha e terminologjisë, e leksikut dialektor, e neologjizmave, e huazimeve të përligjura etj.”

Hartimi i *Fjalorit të madh* mbështet domosdoshmërisht në shfrytëzimin e pasqyrimin e lëndës leksiko-frazeologjike e semantike të shqipes në gjithë shtrirjen e saj truallsore, kohore e të përdorur në të shkruar e në të folur, pra, ai do të jetë gjithëpërfshirës e bashkëkohor. Ndaj për të, gjatë gjithë vitit 2021 - 2022 (por dhe në dhe në vazhdim) u punua e po punohet për ngritjen e Kartotekës së posaçme (apo thënë ndryshe, për krijimin e një Korpusi / *data base-i ad hoc* për Fjalorin). Korpusi ishte parashikuar të përfshinte deri te 150.000-160.000 fjalë e njësi frazeologjike, por në këto çaste (nëntor 2022), fjalësi i korpusit ka arritur në rreth 200.000 njësi leksikore e frazeologjike. Prej këtij korpusi, njëherazi ka filluar puna edhe për përzgjedhje e njësive që do të zënë vend në fjalor (rreth 90.000 fjalë e mbi 10 njësi frazeologjike).

Burimet kryesore të lëndës për ngritjen e kësaj kartoteke ishin dhe janë të hapura disa:

1. Shfrytëzimi i Kartotekës së leksikut të shqipes dhe i Kartotekës së dialektologjisë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, i kartotekës në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Universitetet e qendrat e tjera shkencore brenda e jashtë vendit, të cilat kanë në fondet e tyre pasuri të rëndësishme leksiko-semantike të shqipes.

2. Shfrytëzimi i lëndës së fjalorëve të botuar:

- a. Lëndë nga fjalorët shpjegues institucionalë, të botuar deri tani në Shqipëri: “Fjalor i gjuhës shqipe”, 1954; “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, 1980; “Fjalor i shqipes së sotme”, 2002; “Fjalor i gjuhës shqipe”, 2006;

“Fjalor i gjuhës shqipe”, 2020. Vendin kryesor këtu e zë “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, 1980 (botim i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë). Ai, për nga numri i njësive leksikore e frazeologjike që përfshin, futet *te fjalorët e mesëm*, por ndërtimi i zërave leksikografikë (zbërthimi e shpjegimi i kuptimeve, ndërtimi i strukturave kuptimore, ilustrimet me shembuj, treguesit gramatikorë, ngjyrimet stilistike e ligjërimore etj.) janë të përmasave e të cilësisë të një fjalori të madh për shumicën e fjalëve që përmban. Ai do të shfrytëzohet *në mënyrë integrale*, shterueshëm, në gjithë vlerat e tij, por ky proces nuk do të jetë mekanik, sepse do të ripunohet nga e para. Në përshtatje me tipin e *Fjalorit* të madh, tashmë do të rishikohen gjithë zërat leksikografikë (fjalë e frazeologji), gjithë strukturat kuptimore e shpjegimet përkatëse, gjithë shembujt ilustrues etj.

b. Burim tjetër i rëndësishëm për lëndën e Fjalorit të madh normativ të shqipes janë *fjalorët tematikë* mbarëkombëtarë: 1. “*Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*”, 29.000 fjalë (AShSh, grup autorësh); “*Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*”, 11.000 njësi frazeologjike (J. Thomai); “*Fjalor i homonimeve në gjuhën shqipe*”, 16.000 njësi (A. Jashari); “*Fjalor i gjuhës shqipe*” për shkollën 9-vjeçare, 10.000 njësi (Sh. Rrokaj, A. Kananaj); “*Fjalor i shprehjeve të huaja në shqipe*”, 4.000 njësi (A. Jashari), *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja* (M. Ndreca) etj.

c. Gjithashtu, është vjelë e po vilet lëndë nga fjalorët dygjuhësh, të hartuar kohët e fundit, sidomos ata të tipit të mesëm e të madh (me mbi 50.000 fjalë) ku shqipja del si gjuhë e dytë apo si gjuhë e parë, duke veçuar këtu vepra si *Fjalor anglisht - shqip* dhe *Fjalor shqip - anglisht*; *Fjalor italisht - shqip* dhe *Fjalor shqip - italisht*; *Fjalor gjermanisht - shqip* dhe *Fjalor shqip - gjermanisht*; *Fjalor frëngjisht - shqip* dhe *Fjalor shqip - italisht*; *Fjalor serbisht - shqip* dhe *Fjalor shqip - serbisht* etj.

3. Në Fjalorin e madh normativ të shqipes shtohet ndjeshëm *pasuria leksikore e frazeologjike që vjen nga dialektet e të folmet e shqipes*, pa nënvleftësuar këtu asnjë areal gjuhësor, duke sjellë pasuri të përzgjedhur nga gegërishtja a të folmet veriore, nga toskërishtja a të folmet jugore, nga të folmet arbëreshe, arvanitase e nga të folmet e ngulimeve shqiptare në vende të tjera në Evropë a më gjerë. Përparësi këtu do të marrin fjalë, kuptime, njësi frazeologjike, thënie ilustruese që janë mbledhur në Kosovë, në Maqedoninë

e Veriut, në Malin e Zi, apo në të folmet veriore, veriperëndimore a verilindore të Shqipërisë. Mendohet se nga dialektet dhe të folmet krahinore të zërë vend një pasuri me rreth 10.000 fjalë që nuk janë pasqyruar në fjalorët e mëparshëm normativë. Kështu fjalori fiton karakter të theksuar mbarëkombëtar, por njëkohësisht i vlerëson dialektet si burim kryesor që ushqen pandërprerë leksikun e shqipes standarde.

Më të drejtë akademik A. Kostallari nënvizonte se “Mund të themi pa e tepruar se struktura leksikore e shqipes letrare është pasqyra *më e plotë e bashkëveprimit ndër-dialektor*. Kjo është një strukturë e hapur për të gjitha ato njësi që i sjellin asaj mundësi të reja shprehjes së nocioneve e të ngjyimeve më të holla semantike e stilistikore shprehëse. Bile, kjo strukturë u është drejtuar e u drejtohet për t’u pasuruar jo vetëm dialekteve që përfshihen në truallin e shtetit të sotëm shqiptar, por edhe nëndialekteve jashtë këtij trualli, të cilat ruajnë vlera kulturore-gjuhësore që i shërbejnë së sotmes . Kjo veçori i ka dhënë e po i jep leksikut të gjuhës letrare kombëtare tiparet e një koineje leksikore gjithëshqiptare, në të cilën njësitë leksikore, pavarësisht nga burimi i tyre, kanë hyrë në marrëdhënie sistemore semantike e stilistikore.”²⁷

a. Punën tonë në këtë drejtim e lehtëson dukshëm botimi i shumë veprave që i përkasin *leksikografisë dialektore* (të cilat i kanë sjellë fondit të regjistruar leksikor një pasuri me mbi 150.000 njësi). Po përmendim këtu disa nga këto vepra: *Fjalori i gjuhës shqipe*, 18.500 njësi (A. Xhuvani); *Fjalori i gjuhës shqipe*, 42.000 fjalë (M. Elezi); *Fjalori me fjalë e shprehje nga e folmja e Ujemujës*, 8.000 njësi (H. Shehu); *Fjalori i Malësisë së Madhe*, 10.000 njësi (Gj. Shkurtaç); *Fjalori i fjalëve dhe i shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, 20.000 njësi (Q. Murati); *Fjalori i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës*, 16.000 njësi (Q. Murati); *Fjalor frazeologjik i të folmeve të Kosovës dhe të folmeve shqipe të Maqedonisë së Veriut*, 2.300 njësi (Q. Murati); *Fjalori popullor*, 20.000 fjalë (A. Zymberi); *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*, 13.000 njësi (A. Jashari); *Fjalor i Çamërishtes*, 5.000 njësi (F. Muçaj); *Fjalori fjalësh dhe shprehjesh popullore*, 8.000 njësi (A. Sula); *Fjalë e shprehje nga Puka*, 2.000 njësi (I. Ahmetaj); *Emërtime për kafshë e shpendë në Labëri*, 8.500 njësi (V. Memisha), etj.²⁸

²⁷ A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale...*, në A. Kostallari, I, Tiranë, 2016, f.126

²⁸ Të gjitha këto vepra leksikografike (ashtu si dhe burimet e tjera nga janë bërë vjelje

Po t'u hedhësh një sy këtyre botimeve nga leksikografia dialektore, vërehet lehtësisht se shumica vjen nga areali gjuhësor gegë. Kjo nënkupton se vendi i pasurisë leksikore që vjen nga ky dialekt dhe të folmet që përfshihen në të, do të jetë shumë më i madh se nga dialekti apo të folmet toske. A. Kostallari, thekson se “Struktura leksikore dhe ajo fjalëformuese e shqipës letrare, si strukturat më të hapura e më dinamike, vazhdojnë të thithin vlera që ruhen ende në gjuhën e popullit, pavarësisht nga cilat troje vijnë ato. Kriteri i vlerësimit për këto njësi është që ato t'i sjellin diçka të re fjalorit të gjuhës letrare e sistemit stilistikor të saj, të thellojnë pastërtinë e saj dhe të rritin më tej peshën specifike të fondit popullor të leksikut përballë fondit të krijuar gjatë lëvrimit libror të gjuhës, të të ashtuquajturit fond dituror. Kjo prirje bën që gjuha letrare të mos shkëputet nga baza e saj popullore, tek e cila mbështetet që nga fillimet e saj.”²⁹

b. Gjithashtu janë më dhjetëra punimet monografike në fushën e dialektologjisë, që u përkasin arealeve gjuhësore mbarëshqiptare dhe që sjellin pasuri leksikore të begatë dialektore e krahinore (që zë vend përgjithësisht si fjalorth në fund të këtyre punimeve).

c. Vend të veçantë në fjalorin që po hartohet do të ketë dhe pasuria leksikore e semantike e ardhur nga bota arbëreshe. Tashmë nga arealet gjuhësore të kësaj bote është mbledhur një pasuri e vyer që shkon përtej paraqitjes leksikografike në këtë vepër. Akademik F. Altimari, “Jemi të bindur se nëpërmjet punës së rëndësishme që është kryer në Itali në gjysmëshekullin e fundit, sidomos nga katedrat albanologjike, janë bërë deri sot hapa të rëndësishëm përpara drejt përgatitjes së një repertori leksikor më të gjerë dhe më sistematik për sa i përket arbërishtes së Italisë. Të gjithë e ndiejmë domosdoshmërinë e një repertori të tillë, meqenëse nuk dëftohet më i përshtatshëm fjalori i vetëm panarbëresh që kemi në dispozicion, fjalori i arbërishtes i studiuesit të mirënjohur Emanaul Jordanit. Ky fjalor kur doli patjetër përfaqësoi një kontribut shumë të dobishëm e të rëndësishëm për komunitetin tonë, por sot dëftohet i pamjaftueshëm për nevojat e reja të shoqërisë

leksikore) do të listohen te *Parathënia* e Fjalorit, duke dhënë të plotë të gjithë treguesit shkencorë referues.

²⁹ A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, në A. Kostallari, I, Tiranë, 2016, f. 394

arbëreshe, të rritura e të gjallëruara nga ana gjuhësore e kulturore pas miratimit të ligjit për minoritetet, por edhe për nevojat e kërkesat gjuhësore e letrare të botës arbëreshe, pas zhvillimit që mori shkenca albanologjike edhe në Itali në dhjetëvjetëshat e fundit të shek. XX.”³⁰

4. Ligjërimi politiko-shoqëror e veçanërisht media e shkruar kanë në përdorim një pasuri shumë të vyer leksikore e frazeologjike që do të zërë vend për herë të parë në fjalor. Janë bërë vjelje të bollshme dhe me metodat bashkëkohore kompjuterike është lematizuar (është fjalësuar) e po lematizohet (fjalësohet) e gjithë lënda e po bëhet përzgjedhje e njësive të ndryshme. Është parashikuar që nga kjo fushë të zënë vend në vepër disa mijëra njësi të reja.

5. Burim kryesor për pasurimin e Kartotekës së posaçme të *Fjalorit* dhe prej këtej, për pasqyrimin në Fjalor është vepra e shkrimtarëve të njohur, nga e cila po bëhet vjelje integrale për leksik e frazeologji, duke përfshirë, së pari, autorët më përfaqësues në letërsinë shqiptare dhe me shtrirje mbarëkombëtare. Po përmendim këtu vjelje leksikore nga vepra e Gj. Fishtës, e M. Camaj, e E. Koliqit, e F. Arapit, e I. Kadaresë, D. Agollit, e B. Xhaferit e A. Podrimjes, e A. Shkrelit, e D. Mehmetit, e R. Qosjes, e A. Demaçit, e M. Isakut etj. Kjo është përsëri një komponent përcaktues i karakterit mbarëkombëtar të veprës. Parashikohet që nga letërsia artistike të zërë vend në fjalor një pasuri me mijëra e mijëra fjalë e kuptime të reja.

6. Në Fjalor do të shtohet ndjeshëm numri i termave. Zhvillimet e shumanshme të botës shqiptare kanë trysnuar dhe përdorimin e dhjetëra mijë termash të rinj. Janë përcaktuar mbi 25 fusha të dijes, të shkencës, të teknikës, të artit etj. në të cilat është përqendruar vjelja terminologjike. Parashikohet që numri i termave të rinj do të jetë rreth 10.000 njësi, duke përfshirë në vepër njësi që janë terma ndërkombëtarë ose të kalkuar apo të krijuara me brumin e me mjetet e shqipes, gjithmonë, duke ruajtur natyrën e fjalorit si një fjalor i përgjithshëm e duke mos e kthyer atë në fjalorë të mirëfilltë terminologjik.

³⁰ F. Altinari, *Puna kërkimore e zhvilluar në Universitetin e Kalabrisë në fushën e leksikografisë arbëreshe: drejtime dhe rezultate*, në *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 47

7. Në fjalor do të përfshihen dhe shumë huazime, të domosdoshme dhe të nevojshme në komunikimin gjuhësor përmes shqipes sot. Kjo mbështetet në parimin se gjuha jonë është e hapur për huazime, duke i vlerësuar gjithnjë në bazë të vlerave shënuese e shprehëse që ato sjellin, duke mos lejuar një konkurrencë të panevojshme të tyre me fjalën shqipe apo duke mos e mënjanuar këtë të fundit nga përdorimi e duke i dhënë përparësi fjalës së huaj. Kontaktet e shqipes sot janë të shumta, po ashtu dhe të shumta janë huazimet leksikore. Madje shpesh përdoret dhe pohimi se shqipja po ndjehet e kërcënuar nga huazimet pa kufi. Fjalori do të pasqyrojë një numër të caktuar prej tyre, ato që janë të përligjura, duke e orientuar përdoruesin te karakteri normativ edhe për këtë shtresë leksikore. Mendohet se numri i huazimeve mund të shkojë edhe te 2-3.000 njësi të reja.

Fjalori i madh normativ i gjuhës shqipe, me 100.000 fjalë e njësi frazeologjike po hartohet nga specialistë / leksikografë shqiptarë nga Shqipëria, nga Kosova e Maqedonia e Veriut, nga Universitetet e Kozencës e Palermos, të Munihut e të Selanikut e deri nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Puna është e organizuar në disa nivele, ndër të tjera me një redaksi shkencore prej 7 vetash, me një grup hartuesish me 27 veta dhe me bashkëpunëtorë që shkojnë deri në 50 veta. Pra dhe vetë spektri i pjesëtarëve në realizmin me sukses të veprës është me shtrirje mbarë kombëtare.

Fjalori, kuptohet që krahas funksionit informuese e normëzues, do të jetë pikë referimi e mbështetjeje e pazëvendësueshme për hartimin në të ardhmen të fjalorëve të tjerë të tipeve të ndryshme. Ai do të jetë një vepër edhe me rrezatim të gjerë përdorimi, për të gjithë ata që merren veçanërisht me gjuhën e shkruar, e të folur, që punojnë me shqipe e për shqipen.

Duke mbyllur këtë artikull, ku informacioni për punën që po bëhet për hartimin e *Fjalorit të madh normativ të shqipes* me 100.000 fjalë e njësi frazeologjike zë një vend të posaçëm, po sjell në kujtesë të lexuesve thënien e albanologut të shquar Holger Pedersen, i cili shkruan se “Gjuha shqipe ka një zhvillim të vetin dhe është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar.”³¹

Hartimi i kësaj vepre sendërton dhe këtë zhvillim.

³¹ H. Pedersen, *Gjuha shqipe*, në *Gjuha jonë*, 1999 / 1-2, f. 93

Akademik Gjovalin SHKURTAJ

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

“KULTURA E GJUHËS DHE SHOQËRIA SHQIPTARE SOT”

Të nderuar organizatorë dhe pjesëmarrës,

Qëllimi i kumtesës sime është që, përkujtimi dhe vlerësimet për 50-vjetorin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972-2022), të na shërbejë si një kthjellim e zotim për ta shtuar kujdesin për shqipen në përdorimet zyrtare të administratës, të mediave e reklamave në hapësirat shqiptare, duke qenë kështu, edhe si model për shqiptarët e arbëreshët jashtë atdheut. Boshti i kumtesës sime është i thjeshtë e me theksim të qartë: **Mbrojtja e gjuhës shqipe letrare nuk është censurë, por detyrim e peng moral gjithëkombëtar.**

E pata të pamundshme të mos i përsëris disa vlerësime e pohime, natyrisht edhe me kritikën përkatëse, sepse situata e sotme e kulturës gjuhësore në krejt bashkësinë shoqërore shqiptare nuk është ashtu si duhej të ishte dhe, në disa mjedise e raste, sidomos në ligjërimin e politikanëve dhe të mjaft gazetarëve, është vërtet shqetësuese. Ka shumë vjet që është lënë pas dore kujdesi për shqipen e shkruar dhe të folur. Ka gazeta e revista që dalin pa pasur asnjë redaktim a përkujdesje drejtshkrimore e pa i respektuar normat e rregullat morfo-sintaksore të shqipes. Kultura dhe etika e të folurit publik kanë pësuar “krisje” të dukshme e të rënda. Dhe, në fakt, ka jo pak politikanë e gazetarë që flasin e shkruajnë si të krisur. Ka mjedise shoqërore dhe institucionale, ku shkruhet e flitet dosido, pa asnjë kujdes për etnografinë e ligjërimin, me shpërfillje të dukshme ndaj traditave dhe normave të etikës së kuvendit e të fjalës publike. Kjo “flamë” gjuhëprishëse prek shpesh si deputetë e zëdhënës të shtypit, politikanë e shtetarë të lartë, ashtu edhe gazetarë e sidomos artikullshkrues të organeve partiake, që ndjekin shembullin e tyre. Pakujdesia dhe papërgjegjshmëria për shqipen e shkruar e të folur shfaqet dukshëm edhe në rendjen e pamotivueshme e të papranueshme pas fjaëve të huaja dhe mënyrave të të thënit të “shartuara” sipas modeleve të anglishtes, por që nuk janë as të pranueshme dhe as të nevojshme. Gjithmonë shqiptarët kanë thënë, p.sh.: **pi kafe, ha bukë, ha drekë, ha darkë** etj. Tashti “modernët” po thonë gjithnjë e më shpesh: *konsumoj një*

kafe, po konsumoj një drekë apo darkë etj. Dhe, populli i thjeshtë, që motejetë e ka dashur, po edhe e ka ruajtur gjuhën shqipe, pyet me të drejtë: pse po e prishin etnografinë e të folurit shqip shqiptarisht disa shtetarë e gazetarë? Pse po ia marrim frymën shqipes me reklamat e shkruara tmerrësisht keq e që po ia zvjerdhin shijen e të folurit shqip shikuesve e dëgjuesve të emisioneve?

Ka shpërthyer një vërshim i pafrenueshëm i fjalëve të huaja të panevojshme, shtimi i termave të huaj në vend të termave shqip që përdorshin normalisht. Le ta fillojmë me një nga “prurjet” më të freskëta. Gjithë këto ditë të nxehta sa herë flitet për zjarret që kanë rënë në Jug e në Veri thuhet “Të gjithë jemi në alert”. Edhe një emision famëkeq në një nga televizionet ka titullin “Alert”. Gjatë ditëve të pandemisë, sikur të mos mjaftonin frika dhe shqetësimi e dhimbja për sasinë e madhe të njerëzve që ndahen nga jeta prej covid-19, na duhej të durojmë edhe ployën e fjalëve **alert**, **alertohtet** (në vend të alarm, alarmohet); **hospitalizohet** (në vend të shtrohet në spital), si dhe i shumë foljeve të tjera të krijuara pa asnjë nevojë, si **komisonohet** (në vend del para komisionit mjeko-ligjor). Gjithmonë është thënë e shkruar nga shqiptarët: “merrem vesh, bëj marrëveshje”. Po shohim të shkruar në faqet zyrtare apo në postime on-line të shtetarëve, si dhe në publikime të shkruara e në faqet zyrtare, foljet *dakordësoj*, *dakordësohem* dhe emrat e formuar prej tyre si *dakordësim*, *dakordësi*, të cilave u janë qasur me dashuri donkishoteske gati të gjithë zyrtarët shqiptarë, që nga kryeministri e ministrat, si dhe prej tyre te mediat e shkruara e të folura. Zot na ruaj nga fjalëkrijuesit megalomanë si shtetarët tanë! E pse na u dashka që, pa asnjë arsye as kuptimore, as stilistike të lëmë pa përdorur flalët shqipe *merrem vesh*, *marrëveshje* apo *mosmarrëveshje*. Ismail Kadareja, i cili ka shkruar edhe një libër të tërë me titullin *Mosmarrëveshja* as që e ka ndier nevojën ta përdorë, qoftë edhe një herë të vetme “mosdakordësinë” apo “dakordësinë”. Tmerri veshgjerrës i fjalëve *fokus*, *fokusohem* e *fokusim*, si dhe i reklamave ku nuk mungojnë *limit*, *limtoj*, *i limituar* na shoqëron çdo ditë, qëkur hapim televizorin për të dëgjuar lajmet e deri në emisionet e orëve të vona të mbrëmjes, ku “vringëllojnë shpatat” e analistëve dhe jo pak “analfabetëve me diplomë”, që për fjalët e ndyra dhe zotësinë e sharjeve, ua kalojnë edhe ngjellkave më gojështhurura të lagjeve anësore të qyteteve shqiptare. Gjithandej në rrethet e politikanëve, të analistëve dhe të masës së gjerë të shkruarve ka një “ethe” për të përdorur fjalë të huaja të reja, po edhe për t’u rikthyer në fjalë të huaja të vjetra, të cilat tashmë ishin zëvendësuar me mjaft

sukses. Kështu, krahas *kombëtar*, po rishfaqet dendur *nacional*, madje edhe *nacion* për *komb-i*, në vend të *ndërkombëtar-e* po rikthehet *internacional-e* etj. *Kjo dukuri e shëmtuar dhe e dëmshme është tregues i qëndrimit të papërgjegjshëm të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare ndaj gjuhës.* Me keqardhje shohim se është zbehur ose edhe mungon kujdesi apo disiplina gjuhësore e shtetit dhe e institucioneve arsimore e kulturore. Në të gjithë botën gjuha mbahet gjallë dhe përpunohet nëpërmjet shkollës dhe institucioneve kulturore, ku tradicionalisht kanë luajtur rol të madh letërsia artistike dhe teatri e, mbi të gjitha, gjuha e zyrave të shtetit dhe institucioneve zyrtare. Edhe tek ne për shumë vjet radhazi në këtë drejtim është punuar dhe ka pasur suksese të ditura. Në kohët e reja, sidomos në fund të shekullit që u mbyll e në ditët tona, rolin e dorës së parë përta i takon modelit gjuhësor e kanë marrë mediat e shkruara (gazetat, revistat, interneti) dhe të folura (televizioni, radio dhe cd-të). Për gjuhën e shkrimit, pas viteve të shkollës, njerëzit kanë si model kryesor atë që gjejnë në gazetatat dhe revistat që lexojnë përditë, ndërsa për gjuhën e folur, natyrisht, ndikojnë fuqishëm gjuha e radios dhe e televizionit dhe, viteve të fundit, blogjet e faqet zyrtare on-line. Me fjalë të tjera, mediat, qofshin të shkruara, qofshin të folura, ditë për ditë, me atë që shkruajnë e thonë, o ndreqin o prishin diçka në gjuhë.

Me keqardhje shohim se *është zbehur ose edhe mungon kujdesi apo disiplina gjuhësore e shtetit dhe e institucioneve arsimore e kulturore.* Në të gjithë botën gjuha mbahet gjallë dhe përpunohet nëpërmjet shkollës dhe institucioneve kulturore, ku tradicionalisht kanë luajtur rol të madh letërsia artistike dhe teatri e, mbi të gjitha, gjuha e zyrave të shtetit dhe institucioneve zyrtare. Edhe tek ne për shumë vjet radhazi në këtë drejtim është punuar dhe ka pasur suksese të ditura. Në kohët e reja, sidomos në fund të shekullit që u mbyll e në ditët tona, rolin e dorës së parë përta i takon modelit gjuhësor e kanë marrë mediat e shkruara (gazetat, revistat, interneti) dhe të folura (televizioni, radio dhe cd-të). Për gjuhën e shkrimit, pas viteve të shkollës, njerëzit kanë si model kryesor atë që gjejnë në gazetatat dhe revistat që lexojnë përditë, ndërsa për gjuhën e folur, natyrisht, ndikojnë fuqishëm gjuha e radios dhe e televizionit dhe, viteve të fundit, blogjet e faqet zyrtare on-line. Me fjalë të tjera, mediat, qofshin të shkruara, qofshin të folura, ditë për ditë, me atë që shkruajnë e thonë, o ndreqin o prishin diçka në gjuhë. Kam thënë gjithnjë dhe po e përsëris: shoqëria shqiptare dhe kombi shqiptar u detyrohen mjaft shtypit dhe radio-televizionit për sukseset që kemi arritur në gjuhën letrare të njësuar. RTSH-ja dhe radiot e televizionet private kanë pasur e

kanë mjaft folës e redaktorë të mirë, që e kanë shqiptuar e intonuar bukur shqipen dhe kanë dhënë modelin e të folurit të mirë për masën e gjerë të dëgjuesve e shikuesve. Dikur bëhej shumë kujdes nga autorët dhe redaktorët, po kishte edhe një korrektor gjuhësor për çdo gazetë. Edhe fjalimet apo artikujt e raportet më të rëndësishme të personaliteteve politike të asaj kohe, cilido që të ishte autori, përfshirë edhe udhëheqësit kryesorë të Partisë-shtet, po të kishin gabime drejtshkrimore, nuk lejoheshin të dilnin ashtu, por korrektoheshin e ndreqeshin. Periudha ka qenë ajo që e dimë, por përvoja e saj për sa i takon gjuhës ka qenë e mirë dhe nuk ka pse të mos zbatohet.

Ruajtja dhe mbrojtja e gjuhës shqipe letrare nuk është censurë, por detyrim zyrtar për secilin institucion që shkruan e boton. Kjo duhet bërë si-domos në titujt e gazetave e revistave, në përkthimet me shkrim të filmave, në reklamat e faqet popullarizuese etj. Të ndjekim shembullin e Francës dhe të vendeve të tjera të Evropës së qytetëruar, të cilat punojnë shumë për mbrojtjen e gjuhës amtare si tipar i përbashkësisë dhe i njëjtësisë së kombit. Në Francë revista "Defence organisée de la langue française" (Mbrojtja e organizuar e gjuhës frënge) vazhdimisht boton artikuj e studime "contre le franglais" (= kundër fjalëve të huaja nga anglishtja). Edhe në Itali, çdo të shtunë e të diel, në RAI-1 mbahet rubrika "Prontosoccorso linguistico" (Ndihma e shpejtë gjuhësore), si dhe punohet me kujdes për cilësinë e të gjitha llojeve të botimeve zyrtare.

Tek ne, për dëm e turp të madh, shqipja po dëmtohet nga mungesa e kujdesit prej atyre që shkruajnë e botojnë, nga programet shkollore të pamira e ku, gjuha shqipe ka pësuar dëmtim të madh nga heqja e pamotivuar e të nxënit të saj si lëndë më vete në shkollat e mesme. Po ashtu rendja pas së huajës ka prurë (dhe vazhdon të sjellë) në gjuhën e shkruar e të folur edhe shumë fjalë e shprehje të huaja nga ato që janë krejtësisht të panevojshme. Nuk flasim për huazime, sepse huazime shqipja ka pasur e do të ketë edhe në të ardhshmen, por për barbarizma, shkurtesa e sajesa të huaja, të shëmtuara e të papranueshme. Disa politikanë, si dhe jo pak gazetarë, njerëz të zyrave dhe të mjeshtërive të tjera, kujtojnë se pa fjalë të huaja (të pakuptueshme e të panevojshme) nuk mund të quhen të mençur e të përgatitur. Shihni se si është mbushur ligjërimi i reklamave dhe i rubrikave të radiotelevizioneve shqiptare me titujt të huaj, kryesisht nga anglishtja, si *Love story*, *Top Story*, *Big-Brother*, *Dancing with me*, *Got talent*, *Why not*, *Fan - Club* etj. Kjo është me të vërtetë një sëmundje ngjitëse, që mund të marrë

përmasat e një epidemie gjuhëvrasëse. Kemi shkruar e folur shpesh për këtë gjendje të pamirë të shkrimit e përdorimit të shqipes në zyrat e shtetit, në botimet dhe në institucionet arsimore e kulturore dhe, sidomos në reklamat e televizioneve e në ligjërimin e politikanëve. Ka ardhur koha që të marrin fund shkeljet kaq të rënda e të padurueshme të normave të gjuhës letrare zyrtare. Shteti dhe të gjitha institucionet zyrtare duhet të veprojnë ashtu siç veprohet në çdo vend të qytetëruar, duke mos lejuar botime e shkresa që nuk i zbatojnë rregullat e gjuhës letrare kombëtare. Fjalët e huaja dhe mënyrat e të thënit në kundërshtim me rregullat e natyrën e shqipes vijnë e bëhen si orteku që zbret nga malet e nuk mund të ndalet më. Fill mbas pushtetarëve për “zellin” e rendjes pas fjalëve të huaja të panevojshme e të pakuptueshme vijnë gazetarët, folësit e radios e të televizionit, sidomos ideuesit dhe realizuesit e reklamave, përkthyesit dhe botuesit etj. Të kënaqur me lirinë që kanë për të shkruar çfarë të dëshirojnë (dhe kjo është gjë e mirë), shtrihen edhe aty ku nuk u takon, d.m.th. edhe të shkruajnë e të flasin si t'u vijë, mbarë e mbrapsht, pa pyetur as për rregullat e drejtshkrimit, as për natyrën e shqipes, as për ndonjë farë kujdesi për t'i ndërtuar drejt fjalitë, pa folur këtu për hapjen e portave katërcipërisht ndaj fjalëve bombastike e të huaja, frazave të gjata kilometrike, që shpesh janë si ato të Don Kishotit “arsyeja e mosarsyes, ma dobësoi aq fort arsyen”. Kjo na kujton sa thoshte Faik Konica për analfabetët me diplomë: “Po sot shoh një turmë të errët prej analfabetësh me diplomë në xhep, që po i vërsulen shqipes dhe duan t' i vënë thikën në kurriz, që ta gdhendin pas formës që u pëlqen atyre; se të gJORËT kujtojnë që gjuha është një copë dru pa shpirt. Nuk dinë që është jo vetëm e gjallë, po dhe shumë e hollë, aq sa, po i shtrembërove pakëz një nyjë a një dell, trupi i tërë i tronditet, vuan dhe humb forcën bashkë me bukurinë”. Nga shtetarët shqiptarë, për kujdesin që tregon për rregullat e shqipes së njësuar, dallohet ish-Presidenti A. Moisiu. Në disa intervista dhe në kujtimet e tij ka gjetur rastin të japë edhe mbështetjen e tij për domosdoshmërinë e zbatimit të rregullave të shqipes së njësuar. Në librin *Kujtime*, vëll. 2, f. 77 zoti A. Moisiu shkruan: “Patjetër që gjuha duhet ruajtur, sepse sot, te ne, ka një trend të çuditshëm, sidomos nga politikanët që përdorin vend e pa vend e me shumicë fjalë të huaja, të cilat i kanë sinonimet e tyre në gjuhën tonë dhe këtë gjë e bëjnë më tepër për të treguar “diturinë” e tyre. Jo vetëm kaq, por kohët e fundit po vihen re disa tendenca për të ndërhyrë në mënyrë brutale në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Kjo bëhet, gjoja për të shmangur vendimet e marra në vitin 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës

Shqipe, duke i quajtur ato vendime si komuniste. Në përfundime të tilla arrihet vetëm nga presioni që mund të bëjnë politikanë jonormalë në gjykimin se “gjithçka që vjen nga e kaluara duhet ndryshuar”. Zoti e ruajt këtë vend nga budallallëqe të tilla, të cilave u duhet kundërvënë fuqishëm”. (Alfred S. Moisiu, *Kujtime*, 2, Toena, f. 77).

Së pari (e kryekreje), në tubimin e sotëm (po edhe sa herë të flitet për raportin *gjuhë shqipe-kulturë shqiptare*) duhet të theksohet e argumentohet se gjuha shqipe, si çdo gjuhë tjetër e kombeve të qytetëruara, i pasqyron trysnitë e zhvillimeve të gjithanshme gjeopolitike dhe ekonomiko-shoqërore e sidomos arsimore e kulturore të shoqërisë shqiptare. Gjuha shqipe, ashtu si çdo gjuhë letrare kombëtare e popujve të qytetëruar, është pasqyra më e qartë e kombit, si dhe e kulturës së tij të përbashkët. Gjuha e një populli shpreh kulturën dhe i jep atij njësi (unitet) komunikimi, duke e lehtësuar edhe njësinë politike e truallësore (territoriale). Për këtë arsye *gjuha* (e shkruar dhe e folur) *përbën elementin më të përdorur në identifikimin e popujve e të shtrirjes së tyre gjeografike e dialektore*. Përfillja e gjuhës si tipar themelor tregues i një populli është gjithandej më e fortë dhe më e plotvlershme, sesa kufijtë politikë apo shtetërorë të një vendi. Rasti më i qartë është ai i mospërputhjes së kufijve gjuhësorë të shqipes në trojet shqiptare ballkanike me shtrirjen e shtetit të sotëm shqiptar. Mjerisht, për sherr të synimeve grabitqare të shteteve fqinje, Fuqitë e Mëdha, më 1913, bënë një ndarje shumë të padrejtë të trojeve e të popullit shqiptar, duke i aneksuar përkatësisht ish-Jugosllavisë (d.m.th. Malit të Zi, Serbisë dhe Maqedonisë) e Greqisë pothuajse gjysmën e popullsisë e të trojeve shqiptare, ku brez pas brezi është folur e flitet shqip dhe ku banorët e mbajnë veten me krenari se janë shqiptarë. Nëpërmjet gjuhës transmetohet në kohë pasuria e përbashkët kulturore e një populli, ruhen traditat dhe zhvillohet më tej kultura kombëtare, duke i dhënë edhe homogjenitetin e duhur bashkësisë etnike e kombëtare përkatëse. Njerëzit janë të interesuar që gjuha dhe kultura e tyre tradicionale të mësohen, të trashëgohen e të mbrohen nga fëmijët e tyre për të siguruar trashëgiminë e kulturës e të traditave të tyre kombëtare në brezat pasardhës. Porse kjo nuk ka qenë kurdoherë dhe kudo e mundshme. Kanë vepruar e vepronjë edhe sot forca e faktorë të hegjemonisë ekonomike, politike, ushtarake, diplomatike etj. dhe, nëpërmjet tyre, edhe kultura e gjuha e popujve të ndryshëm kanë ndjerë e pësuar, kur më shumë e kur më pak, trysninë e kulturave dhe të gjuhëve të pushtuesve, të kolonizatorëve, të misionarëve, tregtarëve etj. Ashtu si po e ndiejmë aq vrullshëm trysninë e

anglishtes në të gjithë praktikën shkrimore, botuese, në reklamat e mbishkrimet e udhëve, shesheve e qendrave tregtare a sipërmarrjeve, sepse mendësia e sotme i identifikon “modernen e modernizmin” (po deshët edhe zhvillimin e përparimin(?!) me atë që vjen nga jashtë, me atë që vjen nga Amerika e nga anglishtja si gjuha e dytë kryesore edhe e komunikimit në Bashkësinë Evropiane. Gjuha shqipe, si çdo gjuhë tjetër e kombeve të qytetëruara, i pasqyron trysnitë e zhvillimeve të gjithanshme gjeopolitike dhe ekonomiko-shoqërore e sidomos arsimore e kulturore të shoqërisë shqiptare. Jam ithtar i thënies urtate të Atë Justin Rrotës se “*gjuha shkon tue bamë ato ndryshimet e veta*” si dhe i konceptit të shëndoshë se çdo njeri “*mundet me e dredhe g-juhën*” sipas rasteve dhe mjediseve të caktuara. Prurjet nga krahinat nuk e prishin gjuhën, ato vetëm e begatojnë dhe e përtërijnë forcën shprehëse e kumtuëse të shqipes. Sigurisht, edhe ajo që vjen prej dialekteve, kur pranohet në standard duhet t’u përshtatet rregullave të drejtshkrimit të njësuar. Siç shprehej aktori i shquar italian Vittorio Gazman, *secili njeri mendon në dialekt, por shprehet në gjuhën e përbashkët e të njësuar*. Qysh në lashtësi, ka mbetur proverbi *Caesar non supra gramaticos* (Cezari nuk është përmbi gramatikanët).

Kemi pasur e kemi probleme jo me gjuhën e normat e saj, por me mungesën e kulturës dhe me mungesën e dëshirës për ta nxënë e për ta shkruar e folur shqipen; ka mjedise që nuk i zbatojnë rregullat e drejtshkrimit e normat morfo-sintaksore, ashtu si nuk i zbatojnë as rregullat e mirësjelljes gjuhësore. Ngjashëm me shoferët që nuk i zbatojnë rregullat e qarkullimit rrugor dhe dihet se sa veta humbin jetën ose gjymtohen për sherr të tyre.

Për këtë dukuri, si dhe për shumëçka tjetër që lidhet me shqetësimet dhe detyrat e sotme të bashkësisë shoqërore e sidomos të detyrave që u dalin strukturave shtetërore e pubike sapo kam botuar këto ditë librin *Kultura e gjuhës sot* (Botimet Pegi, 2022). Në krerët apo sythat e tij shqyrtohen raste të shumta të sinkretizimit (në fakt të varfërimit) të shprehjes në emër të “modernitetit”, si p.sh. fillimi i letrave dhe i “letrave on-line” (E-mail-eve) me fjalën e paadresuar dhe krejt të përgjithshme: “Përshtëndetje”, në vend të asaj game të gjerë të përshtëndetjeve të bukura me mbiemra cilësorë, që ka pasur shqipja e shkruar në traditën e saj, qysh kur ka filluar të shkruhet, dhe që janë edhe sot të gjalla në gjuhën e folur: *i nderuari, i ndershmi, i dashuri, i paharrueshmi, i përndritshmi, i shtrenjti* etj. Gjuha e reklamës po i eklipson fjalët e bukura duke i zëvendësuar me fjalë të huaja, apo me elemente të zhargonit të pakrehur e të papranueshëm, ku zotërojnë fjalë me

kuptime të ndryshuara, si *çmendur* (i,e) për i *mirë*, *shumë i mirë* apo i *lirë*, *shumë i lirë* (i *çmime të çmendura*), *çmenduri* për *gjë e bukur*, veprimi a kujtimi më i bukur (*cila është çmenduria më e madhe që ke bërë?*); folja *rrëmbej* me kuptimin *fitoj*, *marr*, *meritoj* (*rrëmbeu çmimin*, *rrëmbeu medaljen*) dhe *kjo*, *madje*, edhe në një reklamë televizive për një lloj ëmbëlsirë (*Rrëmbe një Snikers*) etj. I shqetësuar del në rrugë e menjëherë përballesh me emra lokalesh e reklamash, në pjesën dërmuse në gjuhë huaja, aq sa të krijohet ndjesia se ndodhesh në të njëjtën kohë në shumë vende të huaja. Hap televizorin dhe përballesh me një shqipe që po shndërrohet në një gjuhë që nga dita në ditë po bëhet gjithnjë e më shumë e mbushur me shumë fjalë të huaja e prurje të ligjërimeve sektoriale dhe dialektore të pamira për shqipen standarde. Televizionet të duket se janë vënë në garë kush e kush të zëvendësojë fjalë të bukura shqipe me fjalë të huaja madje të vështira në shqiptim (aq sa shpesh shqiptohen gabim). Kishim (dhe e kemi, por padrejtësisht po e shmangim) emrin e një dite përkujtimore për të vdekurit *SHÛMAT (T')* f. *Shumshejt* ose dita e shumë shenjtorëve, ditë përkujtimore e të vdekurve që kremtohet më 1 nëntor dhe në zonën e Valëshit të Shpatit, porse njihet edhe në krahina të tjera, si p. sh. në Kastrat të Mbishkodrës, ku quhet *t'shumat* ose *për t'shuma* dhe si ndajfolje *t'shumash*. Ditë përkujtimore e të vdekurve, që bie në fillim të tetorit. Në vend të saj, me një vrull djallëzor, i janë kapur emërtimit të kësaj dite me termin anglisht *Halloween*, që shumica e shqiptarëve nuk dinë as ta shkruajnë, as ta shqiptojnë dhe, mbi të gjitha, as se çfarë përfaqëson, por shohin se si maskohen e vishen me të zeza fëmijë e të rinj, duke bredhur shkallëve të pallateve si të ndërkyer, kurse nëpër televizione reklamat mbushen me figura vampirësh me dhëmbë jashtë e me tërfurqe në duar. Pra, *kemi probleme me kulturën, me mungesën e kulturës, me mosnjohjen e vlerave të kulturës shqiptare* e të gjuhës shqipe dhe, mbi të gjitha, *me raste të shpërfilljes e mënjanimit të padrejtë të vlerave të mira etnokulturore e gjuhësore të popullit tonë, gjoja në emër të "modernitetit" e me parapëlqime të pamotivuara e të panevojshme të së huajës. Në libër sjellim, gjithashtu, fakte dhe shqyrtime të nxjerra nga përvoja dhe praktika konkrete e të drejtuarit me shkrim e studentëve ndaj pedagogëve të tyre, ku shihet qartë se, edhe në mjediset universitare, që duhet të kishin shprehjet dhe mënyrat e të drejtuarit më të zgjedhura e më të bukura, karakterizohen nga *prirja e një sinkretizimi varfërues e që duhet të na shqetësojë*. Si pa gjë të keq, studentët e pasuniversitarët i drejtohen pedagogut me *Ti* e jo me *Ju*, a thua se e kanë*

mik e shok, apo sikur ia kanë prerë kërthizën në ditën e lindjes, për të mos përmendur rendin e të folurit, që shpërfillet në mënyrën më të palejueshme.

Së dyti, në kumtesën time dua të theksoj se gjuha letrare e njësuar (apo gjuha shqipe standarde a varieteti i shqipes standard) është përvijuar e formësuar në mënyrë të atillë, të arrirë e të plotvlershme, saqë të përbëjë atë sfond të përbashkët e të domosdoshëm për diferencimin stilistikor të varieteteve të tjera gjuhësore që përdoren në jetën e përditshme të njerëzve (të shqiptarëve dhe të arbëreshëve) dhe që, pa dyshim, si të tilla, ashtu si çdo dukuri tjetër e jetës shoqërore dhe e shpirtit njerëzor, nuk mund të përjashtohen e të mos u bëhet vend edhe në veprat letrare, qoftë për ngjyresën e nevojshme të mjedisit e të kohës, qoftë edhe për karakterizimin, tipizimin apo individualizimin e personazheve. Lidhur me këtë anë, marr lejen e të pranishmëve të kësaj Konference të mos zgjatem shumë, meqë, prej vitesh, qoftë në librin tim *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran* (Tiranë 1988), në ligjëratat universitare, në tekstin e *Sociolinguistikës*, qoftë edhe në kumtesa e artikuj të ndryshëm, dhe, së fundi në përmbledhjen *Kultura e gjuhës sot* besoj se, jo vetëm e kam thënë, po edhe ta kem argumentuar, se gjuha letrare e njësuar është sfondi kryesor, është varieteti më i parapëlqyer, *por nuk është dhe nuk mund të jetë as vetëm një dhe as i vetmi varietet, as për një bashkësi të gjerë kombëtare në përgjithësi, as për gjuhën e letërsisë artistike në veçanti*. Kam mendimin se kjo rrethanë duhet të merret parasysh më shumë e më mirë edhe nga shkolla shqiptare, në mënyrë që, në të gjitha nivelet e saj, larmia dhe gjerësia e varieteteve të gjuhës shqipe, të gjejnë hapësirën e vet dhe të jenë kurdoherë si gurra të pasurimit e freskisë shprehëse. Sociolinguistika e sotme, po edhe dialektologjia tradicionale apo "gjeografia gjuhësore" kanë dëshmuar bindshëm se sa të shumta kanë qenë e janë kudo në botë, pra edhe tek ne, përthyerjet e degëzimet krahinore të gjuhës, po edhe se krahas dialekteve territoriale ka pasur edhe degëzime apo dialekte sociale, lindja dhe mbijetesa e të cilave ka të bëjë me faktorë të ndryshëm të ndarjes dhe të diferencimit shoqëror, si: seksi, mosha, besimi fetar, mjeshtëria apo profesioni, arsimi dhe edukata, mjedisi apo vendi ku kryhet komunikimi e deri edhe gjendja shpirtërore apo humori i folësit në çastin e ligjëritimit. Nuk është aspak e rastit që sociologu amerikan Joshua Fishman, sot i mirënjohur kudo si themelues i një disipline të re e të tumiruar, siç është sociolinguistika, në vitet '50 të shekullit të njëzetë pushtoi zemrat e mendjet e studiuesve të shkencave shoqërore me formulimin e tij, tashmë lapidar, të ndryshimeve të panumërta e të

gjithllojshme gjuhësore e stilistike në gji të çdo bashkësie kombëtare, sipas kriterit-çelës: *Who speak, with whom, where, why and in what language variety?* (= “Kush flet, me kë, ku, përse dhe në çfarë varieteti gjuhësor.”) (J. Fishman, në revistën *La Linguistique*, 2, 1965.)

Së mbrami, po ritheksoj se kam qenë e jam mbrojtës i shqipes së njësuar e të përbashkët, sepse e konsideroj si mbërritje me vlerë të shënueshme kombëtare dhe historike të kombit shqiptar, por, ndërkaq, kam qenë e jam i bindur se gjuha shqipe, si çdo gjuhë tjetër e kombeve të qytetëruara, shkon duke bërë edhe zhvillimet e veta, ndien dhe pasqyron edhe trysnitë e zhvillimeve të gjithanshme gjeopolitike dhe ekonomiko-shoqërore e sidomos arsimore e kulturore të shoqërisë shqiptare në kushtet e sotme të ecjes drejt Evropës e nën trysninë e globalizmit. Kam qenë e mbetem ithtar i thënies urtake të Atë Justin Rrotës se “gjuha shkon tue bamë ato ndryshimet e veta” si dhe i konceptit të shëndoshë të atij studiuesi se njeriu sipas rasteve e rrethanave “mundet me e dredhë g-juhën” duke iu përshtatur rrethanave dhe mjediseve të caktuara. Pra, të njëjtit njerëz, edhe sot e gjithë ditën, sipas nevojës e rrethanave të shprehjes, mund të shkruajnë e të flasin në shqipen standarde, të cilën e nxënë në shkollë, po edhe në të folmen a dialektin e vendlindjes përkatëse. Midis shqipes së shkruar e të njësuar (që duke zbatuar terminologjinë e sociolinguistikës bashkëkohore quhet “standard”) vepron *parimi i enëve komunikuese*: dialektet marrin nga shqipja standarde terma, fjalë e mënyra të thëni dhe kështu zhvillohen e përparojnë; edhe gjuha standarde përthith e pranon vazhdimisht edhe prurje nga krahinat e dialektet dhe, ndonëse në fillim ato sjellin një farë turbullimi, me kohë tretën e bëhen pronë e shqipes standarde, por edhe mund të mbetën jashtë saj. Prurjet nga krahinat nuk e prishin gjuhën, ato vetëm e begatojnë dhe e përtërijnë forcën shprehëse e kumtuëse të shqipes. Sigurisht, edhe ajo që vjen prej dialekteve, kur pranohet në standard duhet t’u përshtatet rregullave të drejtshkrimit të njësuar.

Dr. Mehmet HALIMI
Anëtar korrespondent i ASHAK-ut

RESPEKTIMI I ELEMENTEVE PËRBËRËS TË KULTURËS GJUHËSORE NË RADIOTELEVIZION

“Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture”¹

(E. Çabej)

Gjuha është muzikë. Ajo përbëhet nga këto elemente përbërës ka: *ritmin, pauzën, intonacionin, shprehësinë, intensitetin, ngjyrën e zërit, njerëzshmërinë dhe muzikalitetin radiofonik.* Elemente këto, që dëshmojnë për muzikalitetin e gjuhës.

Ligjërimi me tinguj shqiptuar këndshëm, me ritëm e me pauza të natyrshme, me fjalë e fjali akustike, me respektim të intonacionit dhe interpunkcionit – përfaqëson një ligjërimit integral, joshës e simpatik, duke e shquar dhe theksuar bukurinë e natyrës së gjuhës së njësuar të standardizuar kombëtare letrare të folësit në radiotelevizion.

Këtu e kemi fjalën për kultivimin e kulturës së gjuhës së standardizuar letrare kombëtare në radiotelevizion si medium informativ, i cili ushtron një ndikim të ndjeshëm e të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të teleshikuesit e të teledëgjuesit, jo vetëm shqiptarë, por edhe të shqipfolësit e huaj, duke ngrehur atë në një nivel të lartë të përsosmërisë së saj si gjuhë e kulturës, shkencës, e artit dhe teknikës.

Para se të thellohem në analizën e gjuhës së radiotelevizionit si medium masiv gojor, do të përpiqemi t’u përgjigjemi tri çështjeve:

1. *Mjetet e informimit audiovizuel si mjete integruese të kulturës së gjuhës së njësuar të standardizuar kombëtare;*

2. *Përmasat e ndikimit të saj në rrafshin ndërkombëtar.* Paraqitja e

¹ E. Çabej, Për pastërtinë e gjuhës, Çështje të normës letrare, Prishtinë, 1980, f. 5.

kulturës gjuhësore, jo vetëm te shqipfolësit shqiptarë, por edhe te shqipfolësit e huaj (njohës të gjuhës shqipe);

3. *Kultivimi i normave drejtshqiptimore*, duke respektuar elementet përbërëse të një ligjërimi melodik te folësit të radiotelevizionit, siç janë *tempi e ritmi, pauza e intonacioni, shprehësia e intensiteti i zërit, respektimi i theksit e ligjërimi i ngrohtë e njerëzor dhe muzikaliteti i këndshëm akustik radiofonik tërheqës e simpatik*.²

Sepse për teledëgjuesin, siç dihet, nuk ka rëndësi vetëm si është hartuar e si është shkruar një lajm nga ana drejtshkrimore, por edhe si kumtohet ky lajm nga ana drejtshqiptimore. Ligjërimi që i përmbushë kushtet në dy rrafshë, në rrafshin drejtshkrimor dhe në rrafshin drejtshqiptimor, është më i pranueshëm dhe më i kuptueshëm për teledëgjuesit. Sepse ndër gjuhëtarët tanë është bërë dukuri obliguese gjuha e standardizuar letrare kombëtare të studiohet vetëm nga ana e rrafshit drejtshkrimor, duke lënë anash ose duke i kushtuar shumë pak kujdes rrafshit drejtshqiptimor.

Radiotelevizioni, si mjet i informimit gojor, është njëri ndër kultivuesit dhe standardizuesit më të rëndësishëm të zbatimit praktik të normës së gjuhës së standardizuar letrare kombëtare. Pikërisht për këtë arsye meriton të vëzhgohet e të studiohet në mënyrë më sistimore, të nxirren problemet, të bëhen përgjithësime të mëtejshme dhe mbi këtë bazë të ndihmohen punonjësit e të gjitha redaksive për të zotëruar në shkallë më të lartë e në mënyrë më besnike normën letrare dhe pasurinë leksikore të gjuhës sonë amtare.

Qartësimi i normës letrare si dhe zbatimi i saj i gjerë në trajtën e shkruar, mundëson vështrimin e duhur edhe të anës së saj të folur³ drejtshqiptimore.

1. *Radiotelevizioni emisionet e veta i realizon me anë të ligjërimin (spikerimin të folësit)*, prandaj, ai përbën mjetin integruar të kulturës së gjuhës së njësuar standarde letrare. Përveç procesit mësimor universitar, në shkolla

² Ndonëse për këto çështje unë kam shkruar para dyzet vjetësh (shih Për një ligjërim të drejtë në radiotelevizion në Çështje të normës letrare, Prishtinë 1980, f.114-120 dhe në Shkëndija, në Rilindja dhe Zëri, etj), por meqë këta elementë përbërës sot në Radiotelevizion nuk po respektohen fare, ndaj po dëgjojmë një ligjërim të vrazhdë, tepër të ngutshëm, të sakatosur e të përçudnuar, që nuk i ngjan fare gjuhës sonë të ëmbël amtare e muzikale shqipe. Është koha që kësaj dukurie të shëmtuar t'i prehet hovi.

³ A. Kostallari, Fjala e mbylljes, Gjuha letrare kombëtare dhe epoka e saj, Tiranë 1988, f.16.

tetëvjeçare e në shkolla të mesme, në teatër e në tubime shkencore si dhe në konferenca publike, ku me ngulmë e me vetëdije të lartë, bëhen përpjekje të vazhdueshme që të zbatohet varianti ligjërimitor e drejtshqiptimor i normës letrare, shtysë e fuqishme dhe mbështetje solide, në këtë drejtim është gjuha e radiotelevizionit si medium i drejtpërdrejtë informativ. Si i këtillë ky institucion kulturor e informativ është rrezatues kryesor i kristalizimit dhe i zbatimit të normave drejtshqiptimore të shqipes së standardizuar letrare, prandaj ai duhet të synojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të bëjë përpjekje për rrafshimin e dallimeve dialektore e provinciale në unifikimin e tyre në një variant të përbashkët gjuhësor të të gjitha moshave.⁴ “Pak muaj, më parë u Krijua Këshilli NdërkademiK Kosovë-Shqipëri për një shqipe standarde. Të dy akademitë duke pasur parasysh se gjuha shqipe është tipari kryesor i kombësisë shqiptare, mjeti themelor që siguron ndërlidhjen shpirtërore ndërmjet hapësirave kombëtare e vendeve ku flitet shqip, synojnë që zotërimi dhe përvetësimi i shqipes standarde të jetë objekti themelor i brezave të ardhshëm”, “Kryeministri duhet të kërkojë falje për shpikjen e termit “Kombi kosovar”, sepse shqiptarët kanë një gjuhë, një gjak, një komb”⁵.

Mjetet e informimit gojor duhet të bëhen gjithashtu fokus rrezatues i përbashkët për shqipfolësit e të gjitha viseve shqiptare etnike mbarëkombëtare, duke u shtrirë kështu edhe në trevat e diasporës, por njëkohësisht të ushtrojë ndikim të fuqishëm edhe ndër mërgimtarët tanë me qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm. Kështu shqipja letrare kombëtare nëpërmjet valëve të radios dhe të televizionit arrinë shtrirje evropiane e tejoqeanike të dëgjuesit e teleshikuesit shqiptarë në mbarë rruzullin tokësor, do të thotë me anë të radiotelevizionit, gjuha letrare kombëtare gamën e rrezatimit të vet e shtrinë edhe jashtë trojeve shqiptare. Në këtë mënyrë, falë të arriturave teknike, shqipja letrare kombëtare ushtron ndikim të shqipfolësit anëmbanë botës. Nga ky realitet rezulton se roli i radiotelevizionit në kultivimin e kulturës gjuhësore ndër masat shqipfolëse është shumë i madh. Prandaj, duke pasur parasysh rolin e madh të tij, duhet të kemi parasysh se edhe përgjegjësia për zbatimin korrekt të kulturës gjuhësore në emisionet radiotelevizive është

⁴ Mehmet Halimi, Mjetet e informimit gojor – kultivues e standardizues të rëndësishëm të gjuhës letrare. Rev. Shkëndija, NR.1-2, janar 1985, f.11.

⁵ Fran Gjoka, gazeta Nacional, e shtunë 15 tetor 2022, f.30.

e madhe dhe përcakton një ndërgjegjje të lartë gjuhësore, sepse duke ofruar fizionominë besnike të gjuhës letrare kombëtare, ndihmohet vitaliteti e rivaliteti i saj i pandërprerë që si një ind i përhershëm lidh e ndër lidh, i afron dhe i bashkon të gjithë shqipfolësit në një variant të përbashkët të komunikimit gjuhësor ndërvëllazëror, duke i bërë ata ballëlartë e krenarë për një gjuhë amtare të përsosur, i respekton dhe i nderon ata kudo që gjenden në botë. Në këtë mënyrë gjuha letrare kombëtare bëhet kurorë e integritit kombëtar, shenjë e shenjues me të cilin na njeh bota si popull dhe si komb i qytetëruar dhe i kulturuar. Këtë e dëshmon emisioni shumë i qëlluar i mërgimtarëve tanë, që emetohet për çdo të shtune, i emërtuar “Fol shqip!”, i cili tubon jo vetëm atëdhetarët shqiptarë, por edhe dashamirët tanë e të gjuhës shqipe të përkatësive të gjuhëve të tjera të Evropës. *“Mallkuar qoftë ai bir shqiptari/ Që këtë gjuhë të perëndisë,/ Trashëgim që na i la i pari / Trashëgim nuk ia le fëmisë.”* (Gj. Fishta)

Përpyekja për t’ia kundërvënë gjuhës së njësuar letrare kombëtare një variant dialektor për të bashkëvepruar e bashkëjetuar me të, e cila ka nxjerrë krye edhe nga një numër minor diletantësh të gjuhës në Kosovë, me tendencë të krijimit të një kombi të imagjinuar “kosovar”, përbën një rrezik me prapavijë dhe me pasoja të përçarjeve rajonale, që shpiejnë jo vetëm drejt divergjencave dhe çintegritit gjuhësor, por ç’është edhe më tragjike dëmtojnë e shpartallojnë edhe unitetit kombëtar, kulturor, arsimor e shkencor, që është ngritur me aq mund e përpjekje, me lot e me gjak. Gjuha është pronë shpirtërore e mbarë një populli dhe një kombi. Ajo është vlera më e shenjtë dhe më e shtrenjtë kombëtare. Shumë të rralla janë rastet në botë, ku një popull apo një komb të ketë dy gjuhë letrare.

“Nga Bostoni i Amerikës, Konica shprehej: “Erdhi më në fund edhe për gjuhën shqipe koha e lulëzimit, koha plot shpresë! Në të katër anët, një zjarr i bukur zien në zemër të djalërisë, dhe plot me dëshirë, trimoshët e dheut tanë po përpiqen për zbukurimin e shqipes. I vlerësojmë, i pranojmë dhe i respektojmë vlerat gjuhësore e kulturore të popujve të tjerë. Dhe respekti për të tjerët ka vlerë e besueshmëri, kur në radhë të parë respekton vlerat e kombit tënd”⁶ Ndaj, me përgjegjësinë më të madhe mund të themi

⁶ Fran Gjoka, gazeta Nacional, 15 tetor 2022, f.30.

se gjuha e njësuar dhe e standardizuar letrare kombëtare është vepra më madhore e historisë sonë kombëtare, është fortifikata më e qëndrueshme, më e pranueshme, më e nevojshme dhe më e domodoshme gjuhësore, e cila vijimisht duhet të latohet e plotësohet, të pasurohet e të zbukurohen muret e saja nga jashtë, por kurrësi të dëmtohen nga themeli e të shemben nga brenda.

Qysh në Konsultën gjuhësore, mbajtur në Prishtinë, më 23 prill 1968 u mor vendim i prerë: Një komb – një gjuhë, që u përligj edhe në Kongresin e Drejtshkrimit, më 1972, organizuar në Tiranë. Gjuha letrare kombëtare, që përbën kështjellën e kulturës gjuhësore, nuk mund të shembet e të kërcënohet për teke e qëllime tendencioze të disa individëve të caktuar, të vetmuar si një zë i ngjirur në shkretëtirë. Gjuha e njësuar letrare është synim shekullor, ashtu siç ishte Kongresi i alfabetit shqip në Manastir më 1908, i realizuar me përpjekje, me djers e gjak të këtij kombi. Siç dëshmon rasti i Petro Nino Luarasit: “*Më vrisni, por lejoni që gjaku im t’u shërbejë për ngjyrë që t’i shkruani shkronjat e alfabetit shqip*”

Që të jemi sa më afër njëri-tjetrit edhe si vëllezër edhe si shqipfolës duhet të komunikojmë në një gjuhë të vetme letrare kombëtare.

Kultura e të folurit, duhet të ketë qëllim parësor afrimin e shqipfolësve në një pikë të përbashkët, e kurrësi t’i largojë ata në të folme dialektore, lokale e provinciale, ndonëse këto të folme do të fliten edhe një kohë të gjatë nga pjesëtarët e saj. Sikur shqipfolësit të imitonin natë e ditë njëri-tjetrin, duke mësuar ligjërimin e një të folmeje dialektore, atëherë nuk do të ekzistonte *kultura e të folurit* të një gjuhe të njësuar letrare kombëtare. Mirëpo, folësit e një të folmeje dialektore, duke iu shmangur dhe larguar të folmes së tyre dialektore, nga njëra anë, dhe duke bërë përpjekje të vazhdueshme t’i afrohen gjuhës së përbashkët letrare kombëtare, nga ana tjetër, ata në këtë nderje dhe në këtë kapërcyell, krijojnë *kulturën e të folurit në gjuhën letrare kombëtare*. Folësi (spikeri) i radiotelevizionit nuk ka të drejtë t’i drejtohet teleshikuesve dhe teledëgjuesve në të folme dialektore, sepse kështu do të krijojë pika larguese ndërmjet shqipfolësve të trevave të tjera që kanë tjetër të folme, ai bën një akt të pakulturuar ndaj telespektatorëve të vet. Duhet të kihet gjithmonë parasysh qëllimin e afrimit të teleshikuesëve nga treva të ndryshme dialektore. Kështu, duke dëgjuar emisionet radiotelevizive në gjuhën e normuar e të standardizuar letrare, dëgjuesit radiotelevizivë

afrohen në një pikë të përbashkët të kulturës së të folurit në gjuhën e njësuar letrare kombëtare.⁷ Çdo kthim prapa paraqet një anakronizëm të zhvillimit historik, kulturor e gjuhësor, me përmasa të dëmshme, të pariparueshme e çintegruese për unitetin kombëtar.⁸ Sepse proceset e kryera nuk kanë kthim prapa. Ato janë kryer njëherë e përgjithmonë (si Alfabeti i Gjuhës Shqipe), rikthim e përsëritje nuk mund të ketë, por mund të ketë plotësime e freskime përkryerje e përsosje të këtyre proceseve.

2. *Përmasa në rrafshin ndërkombëtar të gjuhës shqipe dhe kulturës së saj.*

Përhapja e kulturës gjuhësore me anë të radiotelevizionit bëhet edhe ndër shqipfolës, të cilët shqipen nuk e kanë gjuhë amtare. Pra, sot shqipja mësohet e flitet edhe nga të huajt. Në këtë drejtim veprojnë e punojnë shumë katedra e lektorate albanologjike, ku mësohet e flitet shqipja si gjuhë joamtare, si p.sh. *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Këto institucione kanë shënuar dhe po shënojnë rezultate të dalluara. Këtë e dëshmon numri i madh i veprave të botuara nga numri i konsiderueshëm i albanologëve të shquar, siç janë: *H. Pedersen, G. Meyer, N. Jokl, W. Fiedler, Oda Buchholz, B. Sokolova, A. Desnickaja* e shumë të tjerë, të cilët kontribuan edhe në kurorëzimin e gjuhës së sotme letrare kombëtare. Dikur qendrat e shkencave albanologjike ekzistonin dhe vepronin jashtë trojeve etnike shqiptare, ku flitej shqipja. Sepse populli shqiptar vuante nën robërinë e Perandorisë Osmane dhe pushtuesve serbosllav. Sot ato janë zhvendosur në qendrat universitare të truallit shqiptar: në *Tiranë*, në *Prishtinë* e në *Tetovë* e së fundmi edhe në *Shkup*. Në këto qendra universitare, pavarësisht nga të folmet dialektore të vendit, që fliten nga shqipfolësit e këtyre trevave, mësimi në këto qendra universitare zhvillohet në gjuhën e

⁷ M. Halimi, *Kultura e të folurit*, në *Çështje të normës letrare*, Prishtinë 1980, f.116.

⁸ Disa procese jetësore nuk kanë kthim prapa, si p.sh. plaku nuk bëhet më fëmijë, ekzistojnë periudhat kohore nëpër të cilat ka kaluar ai: *fëmijëria, rinia, djalëria, burrëria e pleqëria*; Drithi bëhet miell, mielli brumë e brumi bukë, por buka nuk bëhet më kurrë drith. Apo qumshti bëhet kos e djath, ajkë e gjalp, por nuk bëhet më qumësht. Lumi sado i vogël në rrjedhën e vet, fryhet e rritet, por nuk kthehet prapa, ai shkon drejt rrjedhës së vet. Gjuha jonë e njësuar letrare kombëtare ka marrë drejtimin e vet, ajo do të zhvillohet në rrjedhën e vet përkundër dëshirës e synimeve të disa individëve të pakënaqur.

përbashkët letrare kombëtare. Madje, edhe arsimi fetar, ndonëse është injoruar e është mënjeluar nga pushteti i atëhershëm monist, kur u mbajtë Konsulta Gjyhësore në Prishtinë (1968) dhe Kongresi i Drejtshkrimit, në Tiranë (1972), me kohë edhe institucionet fetare e përfaquan vullnetarisht gjuhën e njësuar letrare kombëtare, qoftë në shkolla fetare, e fakultete, qoftë në tekste të përkthyer të librave të shenjtë të *Biblës* dhe të *Kuranit*. Kështu sot, ylemaja myslimane dhe kleri katolik e ortodoks shqiptar në predikimet e tyre fetare, në të shumtën e rasteve, përdorin gjuhën e njësuar letrare kombëtare.⁹ Divergjencat gjuhësore në plan kombëtar ka kohë që janë zhdukur. Ndërkaq, ato që sot kanë qitë krye, pavarësisht nga qëllimi i tyre, nuk ndjellin erë të mirë në kultivimin e kulturës gjuhësore.

Sot, një numër i konsideruar radiostacionesh të botës, në emisionet e tyre, përdorin gjuhën e njësuar letrare kombëtare shqipe. Të gjitha këto qendra radiotelevizive për gjedhe të gjuhës letrare, në emisionet e rregullta, kanë radiostacionet televizive të qendrave shqiptare, kryesisht Radiotelevizionin e Tiranës. Sado që folësit e këtyre radiostacioneve të huaja përpiqen të shqiptojnë besnikërisht shqipen letrare, ata i tradhëton ndikimi i madh i theksit të gjuhës së tyre amtare dhe ne me rastin e dëgjimit mund të konstatojmë se cili radiotelevizion i huaj po transmeton lajmet informative. E kjo hetohet me shqiptimin e fjalëve shqipe, por me: *theks e ritëm, tempo e intonacion e ngjyrim të zërit* të gjuhës së tyre amtare përkatëse: *anglishtes, gjermanishtes, frëngjishtes, italishtes, rusishtes, kinezishtes* etj. Sepse spikeri nuk mund të ikë prej vetvetes, nuk mund t'i largohet muzikalitetit e theksit të gjuhës së vet amtare. Kjo është krejt e natyrshme. Një model të shqipes origjinale, të gjuhës letrare kombëtare, këto radiostacione të huaja mund ta mësojnë dhe përvetësojnë vetëm nga ushtrimi i qendrave radiotelevizive shqiptare. Prandaj, folësit e këtyre radiotelevizioneve shqiptare kanë për detyrë, jo vetëm të realizojnë besnikërisht anën drejtshkrimore, por të zbatojnë me përpikëri edhe anën drejtshqiptimore, duke iu përmbajtur *tempit interpunksional*,

⁹ Një kontribut të madh, që nga viti 1980-1995 kam dhënë edhe unë, duke lekturuar revistën Dituria Islame, Takvimin dhe tre kuranët e përkthyer nga: Sherif ef. Ahmeti, Prof. dr. Feti Mehdiu dhe Myderriz ef. Hasan Nahi, duke përkthyer edhe unë vetë tri vepra nga boshnjakishtja në shqip; Fuqia e besimit – përsosmëri e shpirtit, Jeta familjare në Islam dhe Përgjigjet Islame, kur askush prej intelektualëve shqiptarë nuk donte të bashkëpunonte me institucionet fetare.

*theksit radiofonik e melodik, sepse gjuha në natyrën e saj ka ngjyrën e zërit, forcën e lartësinë, ritmin e melodinë, intensitetin e muzikalitetin e saj. Pra, duke pasur parasysh këto elemente të zëna nga goja, mund të themi me plot të drejtë se **gjuha është muzikë**. Ashtu si në muzikë, ku për të realizuar një melodi të caktuar, duhen respektuar notat muzikore, pikërisht siç veprojmë duke shtypur shkronjat përkatëse në makinën e shkrimit, formojmë fjalën e dëshiruar. Pra, edhe në emetimin e lajmeve informative duhet të përmbushen dhe realizohen kriteret drejtshqiptimore radiofonike e melodike, me një shqiptim të natyrshëm e muzikal, përvetësues e njerëzor, ku frymon kultura e njerëzishmërisë, saktësia kuptimore e bukuria ligjërimore gjuhësore. Respektimi i përpikët i këtyre elementeve nga ana e spikerëve shqiptarë, dëshmon për shkallë të lartë të përgjegjësisë dhe të ndërgjegjës gjuhësore dhe të kultivimit të kulturës ligjërimore (të spikerimit) në radiotelevizion. Po nuk u respektuan elementet drejtshqiptimore në frymën e natyrës muzikale të shqipësisë letrare kombëtare, ajo nuk mund t'i përngjajë më gjuhës sonë amtare, por mund të duket si një shqipe artificiale, e folur si nga ndonjë shqipfolës i pangritur dialektor ose nga ndonjë shqipfolës joshqiptar. Ky është edhe njëri ndër faktorët kombëtar që ne si popull e si komb paraqitemi para botës me një gjuhë të njësuar letrare kombëtare, e jo me dy variante rivale, ndonëse në mungesë të ndonjë zgjidhjeje më të mirë, çdo e folme dialektore apo dialekt do të mund të ngrihej në normë të gjuhës letrare, por elita intelektuale mori këtë vendim dhe në *Konsultën Gjuhësore – Një komb një gjuhë* (1968) dhe në *Kongresin e Drejtshkrimit* (1972), bëri këtë zgjidhje si njëra nga zgjidhjet më të mira dhe më të drejta. Ndaj, botës së qytetëruar duhet t'i tregojmë se njësimi i gjuhës i paraprinë edhe njësimin kombëtar e shtetëror, sepse “*trupit pa gjymtyrë dhe gjymtyrët pa trup nuk mund të jetojnë e të zhvillohen ndaras, por vetëm të bashkuar si një trup dhe si një tërësi mund të zhvillohen e të përparojnë, duke ndërtuar: jetën, kulturën, artin, pra edhe gjuhën e tyre si pronë dhe mjet komunikimi të përbashkët kombëtar.*”¹⁰ Kështu gjuha letrare kombëtare fiton edhe një dimension në rrafshin ndërkombëtar të komunikimit dhe të kultivimit e të avancimit të saj drejt një gjuhe të përkryer dhe të përsosur, duke zënë vend në gjirin e gjuhëve më të zhvilluara e më të afirmuara botërore.*

¹⁰ Mehmet Halimi, *Vështrime gjuhësore*, Prishtinë, 1983, f. 106.

3. *Kultivimi i normave drejtshqiptimore* dhe respektimi i elementeve përbërës, që e ngrenë kulturën gjuhësore të radiotelevizionit në shkallë më të lartë të estetikës akustike e bukurtingëllimit radiofonik, siç janë: *tempi, ritmi, pauza, intonacioni, shprehësia, intensiteti i zërit, respektimi i theksit, ngjyra e zërit* (butësia e vrazhdësia e zërit), *njerëzishmëria dhe muzikaliteti radiofonik*. Sado që këto elemente ligjërimore është vështirë të ndahen njëri prej tjetrit, për t'i pasur më të qartë, ne do të bëjmë fjalë, duke i analizuar e trajtuar veç e veç secilin prej tyre. Kështu duke bërë një analizë të hollësishme të kulturës së gjuhës, që zbatohet (përdoret) në radiotelevizion, do të përpiqemi të arrijmë disa rezultate sintetizuese të kultivimit gjuhësor në mjetet informative të radiotelevizionit.

Tempi - ka rëndësi të dorës së parë si në ligjërimin e përditshëm bisedor, e aq më tepër në ligjërimin informativ, që ushtron në ekranet televizive. Njeriu mendon në vetvete, përmbajtjen e këtij mendimi e koncepton për vete, por meqë flet para të tjerëve, ai duhet të shpreh atë mendim sa më qartë e sa më saktë, duke përdorur një temp të qëndrueshëm në ligjërim. Prandaj edhe folësi (spikeri) kur flet para ekranit televiziv duhet të ketë parasysh se në ç' masë mund ta kuptojë dhe ta pranojë mesazhin e caktuar teleshikuesi, dëgjuesi ose bashkëbiseduesi. Në qoftë se nga tërësia e fjalëve të shprehura nuk kuptohen së paku 40% të tyre nga teleshikuesi, atëherë tempi i ligjërimin të folësit është tepër i shpejtuar. Spikeri duhet të ketë parasysh se teleshikuesi (teledëgjuesi) nuk është ndonjë kanal mikrofoni që mund t'i regjistrojë dhe t'i kuptojë të gjitha fjalët e shqiptuara me një shpejtësi aq të rrufeshme. Nuk mund të pranohet për pesë minuta ajo që duhet të absorbohet për gjysmë ore.¹¹ Unë po shoh dhe po dëgjoj për çdo ditë se si spikerët e Radiotelevizionit të Kosovës gjatë transmetimit të lajmeve po përdorin një shpejtësi marramendëse, duke përdorë gjuhën para mendimit, "*Gjuha nuk duhet të kalojë mendimin*" (Hillon), duke mos i shqiptuar as tingujt e as fjalët të plota, duke mos menduar se ç'po thonë edhe vetë, po bëhen të pakuptueshëm. Sepse të flasësh pa menduar është si të qëllosh pa shenjuar. Përse kjo nguti? Nëse gjuha është mjet për marrëveshje ndërmjet njerëzve, atëherë kur ajo që

¹¹ Ivo Škarić, ligjëratat e mbajtura në Seminarin IX Ndërkombëtar për kulturën e gjuhës në Primoshten të Kroacisë prej 17-31 janar 1974; (shih edhe Mehmet Halimi, Të folurit në Radiotelevizion, Rilindja 17.XII.1977, 14 dhe në artikullin Kultura e të folurit botuar në Çështje të normës letrare, Prishtinë, 1980, f. 114-120.

thuhet turravrap, sikur të ndjek dikush, apo sikur nuk ke kohë ta thuash qartë mendimin tënd, ajo bëhet gjuhë dhe mjet i mosmarrëveshjes. E pra, cili është roli dhe qëllimi i radiotelevizionit marrëveshja apo mosmarrëveshja?! Nëse lajmet televizive kanë numër të madh të informatave, atëherë teledëgjuesi humbë interesimin dhe nuk i ndjek fare lajmet me kureshtje dhe interesim. Radiotelevizioni si mjet informimi, ka qëllim që për një kohë sa më të shkurtër, dhe në të njëjtën kohë të dëgjohet nga një numër sa më i madh tele-shikuesish, sepse ky medium dëgjohet drejtpërsëdrejti. Prandaj, mund të thuhet se veçori e të folurit është të shfrytëzohet koha, kurse veçori e të shkruarit është të shfrytëzohet sipërfaqja-hapësira. Mënyra e komunikimit me anë të shkrimit nuk merr parasysh faktorin kohë, por cilësinë dhe përsosmërinë e tekstit. Gurgdhendjes së skulpturës në gurë, në dru etj. Poetit nuk i intereson sa kohë zgjatë vepra e tij, por sa larg depërton në masë dhe në ardhmëri, prandaj, investimi i kohës këtu çmohet më tepër. Në këtë rast ndeshim kundërthëniet ndërmjet dy formave të mesazhit ligjërimit.¹²

Tempi i të folurit, shqiptimi i drejtë i fjalëve dhe i fjalive zgjojnë interesim dhe kureshtje te teledëgjuesi. Sepse fjalia është një peshojë ndërmjet subjektit dhe predikatit, ata përplotësojnë njëri-tjetrin. Fjalia duhet të ketë një organizim të thukët strukturor me qëllim që të përmbledh kohën momentale në një interval të caktuar kohor. Formulimi i informacioneve duhet të organizohet në fjali të shkurtëra, të përmbledhura, të sakta e të qarta për teledëgjuesin. Sepse “*Mendimet e larta gjenden në fjalitë e shkurtëra*” (Sami Frashëri). Sa më të ngritur intelektualisht të jenë teledëgjuesit aq më të gjata mund të përdoren fjalitë. Çdo fjali për t’u shprehur mund të zgjasë maksimum pesë sekonda. Nëse folësit (spikerët) e Radiotelevizionit i shqiptojnë fjalitë me temp më të shpejtuar, duke tejkaluar normën e caktuar kohore, ata më nuk e përjetojnë fjalinë si tërësi kuptimore, por interpretimin e tyre natyror e artificializojnë, duke interpretuar gjërat në mënyrë mekanike, sepse kur folësi flet shpejtë e pa pauza, duket sikur nuk mendon se ç’flet. Ky lloj leximi i folësve të Radiotelevizionit kushtëzon gabime eventuale të folësve, që e iritojnë teledëgjuesin. Kumtimi i lajmeve për të qenë sa më i bindshëm për teledëgjuesin duhet të ketë temp të natyreshëm të leximit apo ligjërimit,

¹² Ivo Škarić, po aty.

sepse tërë ajo që lexohet (spikerohet) dhe që kalon nëpër *filtrin gojor*, pa varësisht sa thellohet spikeri në përmbajtjen e saj, duhet të japë pamjen dhe bindjen se e tërë kjo të duket sikur po kalon edhe nëpër *filtrin mendor*. Ndaj jemi dëshmitar se Radiotelevizioni i Kosovës dhe Radiotelevizionet private nuk po i përfillin këto kritere, por me kopjimin e imitimin e dukurisë së ngutjes ata po e bastardhojnë, po e sakatojnë dhe po e shëmtojnë gjuhën tonë të bukur e të ëmbël amtare.

Ritmi – Si çdo gjuhë tjetër e botës, edhe gjuha shqipe ka ritmin e vet specifik e të veçantë. Ritmi është i domosdoshëm gjithkund në jetë, në natyrë, në gjithësi, pra edhe në gjuhë. E tërë gjuha është e ritmizuar. Ligjërimi ynë, ligjërimi i fëmijëve, cicërima e zogjve, fërfëllima e erës, pra edhe ligjërimi i folësve (spikerëve) në Radiotelevizion. Ekziston ritmi i rrokjeve, ritmi i fjalëve dhe i fjalive dhe ritmi i gjuhës në përgjithësi.¹³ Në ritmin e fjalëve vijimisht ndikojnë elemente të nduarduarta. Kështu, te folësit mund të ushtrojnë ndikim të vazhdueshëm edhe të folmet dialektore, ku një zanore mund të zgjatet ose të shqiptohet më e shkurtër se ç’duhet shqiptuar, apo një bashkëtingëllore të shqiptohet jobesnikërisht dhe jo natyrshëm, duke prishur, jo vetëm ritmin e fjalës dhe të fjalisë, por duke sjell edhe ngatërtime kuptimesh. Në ligjërimin e përgjithshëm të folësit radioteleviziv, ndeshim ritmin e fjalës dhe ritmin e fjalisë. Për ligjërimin mund të thuhet se është ritmizimi edhe ushtrimi i muskujve të të folurit, ku nëpërmjet këtij ritmi, folësi përvetëson një të folur ritmik e të natyrshëm. Ligjërimi është shumë më i gjerë se tërësia e thellësia kuptimore e shprehjes sonë, sepse në ligjërim përdoren të gjitha mjetet shprehëse gjuhësore e leksikore, ku ndërliidhen edhe elementët jashtëleksikore, siç janë: *intonacioni, intensiteti, tempi i fjalisë, pauza dhe gjestet*. E tërë kjo zgjeron kuptimin më shumë seç zakonisht mund të kuptohet pa i zbatuar këta elementë. Njeriu është krijues dhe zotërues i fjalës, i cili përveç kuptimit parësor që ka fjala, mund t’i japë edhe kuptime tjera sipas dëshirës jashtëgjuhësore e jashtëleksikore me anë të *tempit, ritmit, intonacionit, ngjyrës së zërit pauzës, gjesteve e mimikës*. Të folurit është fenomen individual dhe kolektiv. Kultura e të folurit nuk duhet kuptuar vetëm si një akt ligjërimi, sepse gjuha e folur në jetën e përditshme mund të kuptohet si e folme

¹³ Rexhep Munishi, Ritmi në recitimet-numërore popullore të fëmijëve, Bukju, 22 qershor 1996, f.11.

dialektore. Janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme nga e folmja e shkruar dhe e folmja e folur. Kjo vërehet edhe te pjesa dërrmuese e intelektualëve, të cilët kur flasin në stilin e tyre bisedor, komunikojnë në të folmen dialektore, ndërsa kur shkruajnë respektojnë normat e gjuhës letrare.¹⁴ Përkundër respektimit të pasurisë leksikore hetohet shqiptimi dialektor, i cili nuk lejohet të bëhet dukuri e folësve të radiotelevizionit. Nga kjo rezulton se gjuha amtare ka ritmin dhe ngjyrën e zërit specifik, që dallohet nga gjuhët tjera. *Ritmi i gjuhës* është i natyrshëm dhe original, i cili paraqet anën estetike, melodinë e muzikalitetin e kulturës gjuhësore. *Ritmi përfaqëson artin e shprehur në fjalë, sepse edhe ligjërimi i folësit është një lloj arti.* Çdo gjë në natyrë zhvillohet sipas një ritmi: *ritmi i frymëmarrjes dhe i pulseve të zemrës dhe i qarkullimit të gjakut.* Edhe në poezi edhe në prozë ekziston ritmi. Profesor Petar Guberina thotë: “*Ekziston një ind që ndërton bazën arkitekturore. Ky ind në të vërtetë është ritmi. Dhe ky ritëm do të shprehet domosdo nëpërmjet notave muzikore*”¹⁵, sepse në muzikë çdo notë, në pikturë çdo vijë, në valle çdo lëvizje, janë fjalë të shprehura me *ritmin e zërit, të ngjyrave ose të kërcimit ritmik.* Karakteristikë e çdo ligjërimi është ritmi. Ritmi është ndërmjetësues ndërmjet skajeve të fjalës, sepse organet ritmike janë mushkëritë dhe zemra. Zemra harmonizon këto skaje. Ndërsa truri është polistatik dhe qendror i njeriut, kurse jeta është rezultat i pandërprerë i forcës ritmike, që nuk shuhet. Prandaj, të dijsh të flasësh e të shqiptosh drejt fjalët, do të thotë, jo vetëm t’i zbatosh drejt ato, por edhe të shijosh bukurinë akustike të ritmit muzikor të gjuhës. Këtë duhet ta zbatojnë, në radhë të parë, folësit e radiotelevizionit, sepse televizioni është medium masiv gojor sot në botën moderne. Këta (folësit) mund të kultivojnë kulturën e tyre gjuhësore me anë ushtrimesh të vazhdueshme. Të dëgjosh vetveten, do të thotë të kontrollosh, ta analizosh, prandaj folësi (televiziv) është me rëndësi të dëgjojë vetveten, të ndikojë në reprodukim. Ligjërimi është dinamikë e pandërprerë, ndaj me anë

¹⁴ Madje kohëve të fundit me kryeneçësi disa individë, shoqata e ndërmarrje, po shkruajnë në dialekt, duke arsyetuar faktin: unë dua të flasë siç ka folë nëna e babai im, ndonëse ata ishin analfabetë, ndaj ndeshim format: *punë t'mbarë, n'konak, kena (kemi), me msu, gru, mu,* etj. Ky është një anakronizëm, një regres kulturor.

¹⁵ Petar Guberina, Ligjëratë në Seminarin IX Ndërkombëtar organizuar nga Universiteti i Zagrebit, mbajtur në Primoshten të Kroacisë më 21 janar 1974 (shpikësi i AUVGS-metodës audiovizuele-globale-strukturale).

të vibratorit, folësi mund të kultivojë bukurinë ritmike të zërit. Ritmi ka rëndësi të veçantë në gjuhë, sepse edhe jeta e njeriut është krijuar sipas ritmit, pra edhe ne krijojmë sipas këtij ritmi jetësor. *Ritmi gjuhësor realizohet nga një grup faktorësh kohor, si melodik po ashtu edhe dinamikë. Çdo veprim varet nga frymëmarrja dhe rrahjet e zemrës, që është një veprim i kontrolluar si në valle, në muzikë, në të ecur dhe në të folur, ku cilësohet një ritmizim i qëndrueshëm. Ritmi i gjuhës është i kushtëzuar neurobiologjikisht. Pra, ritmi i të folurit përbëhet nga aspekti gjuhësor dhe biologjik. Ritmi vepron edhe në nivelin fonologjik. Ritmin mund ta ngadalësojë prania e grupeve të shumta të bashkëtingëlloreve, që ndodhen para një pauze. Në bazë të përdorimit të ritmit të shpejtë, normal dhe të ngadalësuar, kemi tre lloje spikerimi: të ngadalësuar, të moderuar dhe të shpejtuar, të cilët varen nga ritmizimi dhe izokronizimi i gjuhës (shqipe)”. (Shih, Irena Sawicka, **Izokronizimi në gjuhën shqipe**, Ligjëratë e mbajtur në ASHAK, më 22 nëntor 2022). Pa ritëm nuk do të kishte as jetë as ligjërim. Gjithçka lëvizë e vepron dhe sipas një ligji të caktuar qarkullon. Ritmi realizohet e jetësohet në lëvizje, kurse ligjërimi në të folur.*

Pauza – është një harmonizim ndërmjet logjikës dhe leximit ose ligjërimimit. Nëse spikeri flet me ritëm tepër të shpejtuar dhe pa respektuar pauzat (pushimet) logjike, që përfaqësojnë interpunksionin, kemi përshtypjen se ai njeri nuk mendon fare kur flet dhe nuk është i vetëdijshëm se çka flet. Kështu ngjanë edhe me disa folës (spikerë) të Radiotelevizionit të Kosovës, të cilët flasin aq shpejt e ngutshëm, duke i hëngër shkronjat e duke përdhunuar pauzat, që na duket se e kanë mësuar tekstin përmendësh. Pauzat qëllimore, krijojnë përshtypje sikur diç po mendojnë derisa flasin, nga njëra anë dhe se pas çdo pauze fillon një mendim i ri, nga ana tjetër. Pra, pauza shënon mbarimin e një mendimi dhe fillimin e një mendimi tjetër. Pauza ka qëllimin e ndërmjetësimin-ndarjen dhe njëkohësisht thellimin e një mendimi të ri. Ndërkaq, disa folës të tjerë bëjnë pauzë pa nevojë, e kur nuk duhet, sepse pas kësaj pauze ligjërimore, pason diç krejtësisht e parëndësishme, që nuk sjell asgjë të re, që nuk është aspak informative, ndaj kjo fjalë mund të thuhej edhe pa pushim, do të thotë pa pauzë. Këtu, në këtë rast pushimi (pauza) është artificializuar, është përdorur pa vend. Gjithmonë, në fillim paralajmërohet tema ose një problem, me një fjalë të vetme, e pastaj kjo dendet me informacione të hollësishme. Duke respektuar pauzën, është parapëlqyer leximi (spikerimi) as i shpejtë as i ngadalshëm. Leximi i shpejtë

vështirëson vëllimin e të kuptuarit, ndërsa leximi tepër i ngadalshëm bëhet monoton e i panatyrshëm dhe zvogëlon shkallën e interesimit. Kur respektohen pushimet, ne e kuptojmë më mirë një tekst të lexuar. Sepse me këtë rast informacionet ofrohen si pija ose ushqimi në gota e në pjata më të vogla, që mund të pihen ose të gëlltiten më lehtë. Pra, ashtu edhe një tekst i lexuar me pauza interpunksioni mund të kuptohet më lehtë, më mirë e më drejtë. E nëse shpejtohet ritmi, pa respektuar pauzat (pushimet), pason diskontinuiteti, duke hepuar mendimet e idetë me diç krejtësisht tjetër, që nuk ka të bëjë me ligjërimin e spikerit. Integrimi i një fjalie ndërlidhë të gjitha fjalët në një intonacion e informacion tërësor.

Intonacioni – Folësi në radiotelevizion duhet të respektojë edhe intonacionin e zërit me të cilin i drejtohet teleshikuesve dhe teledëgjuesve. Intonacioni ka rëndësi të veçantë në shqiptimin e fjalëve dhe në kumtimin e një informacioni të caktuar. Fjalët nuk janë vetëm njësi semantike ose nocione kuptimore, që shprehin mendimin fjollë në vijë të drejtë, por ato janë të ngjyrosura me shprehësi dhe me disponim shpirtëror e me ngrohtësi njerëzore. Prandaj, ka shumë rëndësi se si kumtohet një informacion (një lajm) dhe çfarë intonacioni i japim: *Intonacion i rëndomësisë, i habisë, i frikës, i kureshtjes, i urrejtjes, i gëzimit e i hidhërimit apo i pikëllimit, i mallëngjimit e i nostalgjisë*. Të gjitha këto momente shpirtërore mund të shprehën me fjalë të rëndomta, por me intonacion të jashtëzakonshëm.¹⁶ Nëpërmjet intonacionit, njeriu modelon fjalë, duke u dhënë kuptime të mirëfillta fjalëve përkatëse, ai mënjanon kuptimin arbitrar, që fjalës së caktuar mund t'i japin leksikografët. Nëpërmjet gjesteve dhe intonacionit, ne mënjënojmë arbitraritetin e fjalëve. Ndërsa sipas dëshirës sonë i japim kuptim të caktuar. Falë intonacionit, ne udhëheqim me ligjërimin tonë. Në bazë të intonacionit përcaktohet edhe kuptimi e domethënia e caktuar e fjalës përkatëse. Sepse vetë njeriu është timonier, krijues dhe zotërues i fjalës, me anë të intonacionit ai i jep kuptim fjalës sipas dëshirës së vet e sipas qëllimit semantik.

Shprehësia – Nëpërmjet intonacioneve të nduarduarta me efekte të ndryshme, ne mund të ndryshojmë strukturat semantike të fjalisë. Fjalja, përveç intonacionit vertikal e horizontal, ka intensitetin dhe shprehësinë e

¹⁶ M. Halimi, *Rëndësa e intonacionit në të folur*, Shkëndija, nr.2., 15 janar 1977, f.13.

vet. Në këtë denduri krijuese të shprehjeve, çdo fjalë që në aspektin leksikologjik nuk është shprehëse, mund të shndërrohet në kuptim shprehës. Këtë mundësi mund ta emërtojmë *shprehësi leksikore*. Në qoftë se themi: “*Po kjo qenka gjë e tmerrshme!*”, kur kemi dhembje, ndonëse është fjalë e mundshme, sepse fjala *dhembje* si njësi leksikore ka shprehësi më të ulët se fjala *tmerrshme*. Vlen të theksojmë se përdorimi i dimunitivit dhe augmentativit bartin në vete kuptime shprehëse. Shprehësia shfaqet edhe me përdorimin e interpunksionit. Për shembull, *Nuk dua të mësoj, sepse më dhembë koka. Apo Mëso, si baba gomar mos u bën!* Dhe duke ia ndërruar vendin presjes, do të thotë pauzës: *Mëso si baba, (e)gomar mos u bën*”. Pra, dihet mirëfilli se shprehësia nuk qëndron vetëm në kuptimin leksikor të fjalëve, por në vetë njeriun, në vetë folësin, i cili ka mundësinë e të shprehurit të lirë, në mënyra të nduarduarta. Folësi ka rezerva të mëdha dhe mundësi të gjera për të shprehur mendimet e veta në mënyrë, jo vetëm të saktë, të qartë, por edhe në mënyrë të civilizuar, duke kultivuar kulturën gjuhësore në shkallë të lartë të përsosmërisë të kulturës së gjuhës letrare kombëtare, që mund të bëhet model edhe për folësin e rëndomtë. Në këtë mënyrë folësi plotëson dy kritere: *respekton normën letrare, nga njëra anë, por njëkohësisht respekton edhe teleshikuesit (teledëgjuesit), nga ana tjetër*. Baza e çdo shkrimi është ligjërimi. Ndonëse, shkrimi nuk mund të shënojë besnikëriht çdo ligjërim, sepse përkundër shenjave të pikësisimit, si: *presjes, pikëpresjes, pikëpyetjes, pikëçuditëses*, etj., nuk shënohet gjatësia e zanoreve, e tempit, e ritmit, e intonacionit, dmth., mungon theksi i ligjërimin besnik. Përkundër kësaj, folësi shqiptar, tekstin në fjalë e lexon dhe e shqipton drejt e me lehtësi, sepse ajo për të është gjuhë amtare. Ligjërimi i paraprinë shkrimin. Nuk ekziston lexim pa shkrim. Folësi (spikeri) në televizion lexon atë që është shkruar. Duhet të mësohet leximi besnik edhe i fjalëve në gjuhë të huaja si dhe të respektohet ana shprehëse në kumtimin drejtshqiptimor të informacionit. Gjuha mësohet edhe nëpërmjet shprehësisë. Fëmijët, të cilët nuk e mësojnë gjuhën amtare në gjirin familjar, kurrë nuk do ta mësojnë mirë drejtshqiptimin e fjalëve, por do të kenë probleme të vazhdueshme gjatë tërë jetës së tyre. Gjuha e huaj mësohet artificialisht, kurse gjuha amtare mësohet natyrshëm, duke dëgjuar e shijuar dhe duke folur vijimisht në ambientin e gjirin intim familjar. Nëse gjuha nuk pasurohet vijimisht, ajo do të mplaket dhe do të zhduket si çdo organizëm tjetër i gjallë. Nëse gjuha nuk flitet një kohë të gjatë, shumë fjalë

veniten e zbehen, harrohen e zhduken. Kështu ka ndodhur me *leksikun e pasivizuar*, ku shumë fjalë, përveç pasivizimit, janë zhdukur krejtësisht. Shprehësia është e lidhur ngusht me intensitetin e zërit.

Intensiteti i zërit – Si përbërës qenësor i kulturës së gjuhës, konsiderohet edhe *intensiteti i zërit*, i cili shquhet me veçori të ndryshme me përmasa të elementeve tjera.¹⁷ Prandaj, kërkohet t’i kushtohet kujdes edhe intonacionit, ndërrimit të zërit, lartësisë në forcë e në ritëm, që nuk janë gjithnjë të natyrshme. Kjo vërehet në shkallë të ndryshme të përdorimit të elementeve në fjalën te folësit e çdo emisioni.¹⁸ Fjala në radiotelevizion është shtyp i folur, kur folësi lexon, por sipas sintaksës së konceptuar mendimore ai është mendim i artikuluar me fytyrë radiofonike drejtshqiptimore të gjuhës letrare kombëtare.

Respektimi i theksit – Intensiteti i zërit përbëhet nga theksimi i rrokjeve. Gjuha ka rrokje të theksuara dhe të patheksuara në *fjalë* dhe fjalë të theksuara në *fjali* e fjali të theksuara në *tekst gojor* dhe në atë shkrimor. Shpesh në emisionet televizive ndeshim mosrespektimin e theksit, si për shembull te përdorimi i fjalëve të huaja, të cilat shqiptohen gabimisht *tabllo* për *tablló*, *kálcium* për *kalciúm*; *Kóman* për *Komán*; *Líverpul* për *Liverpúl*; *kompjutér* për *kompjúter*; *Ankárë* për *Ankará*; *Kanadë* për *Kanadá*, etj. Mirëpo, ndjehen edhe luhataje te fjalët: *e diéle* për *e díel*; *herét* për *héret*; *i sigúrt* për *i sígurt*¹⁹, ose *drenicásit*, *prishtínásit* e *vendásit* në vend të: *drenícásit* (Drenicë), *prishtínasit* (Prishtinë), *véndasit* (vënd) apo *Zhegër* e *Ferizáj* në vend të: *Zhégër* e *Ferízaj* (nga Feriz).²⁰ Shih edhe *Skenderáj* për *Skénderaj*, *Vúshtrri* për *Vushtrrí*.

Ngjyra e zërit – Çdo folës ka veçoritë e ngjyrës së zërit. Çdo folës ka organitetin e vet individual e origjinal, ndaj flet e sillet sipas tij, duke i shprehur tiparet e tij në të folur: *ngjyrën e zërit*, mungesën ose praninë e *nazalitetit* (hundësimit), madje shpesh tepër të theksuar në tinguj të caktuar, vrazhdësia e zërit dhe njerëzishmëria e muzikaliteti radiofonik.

¹⁷ M. Halimi, Kultura e të folurit, Çështje të normës letrare, f.14

¹⁸ Engjëll Angoni, Rreth gjuhës në radio e në televizion, botim në rev. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Tiranë 1988, f.488.

¹⁹ E. Angoni, vep. e cituar.

²⁰ M. Halimi, Për një ligjërim më të drejtë, në rev. Zëri i rinisë, nr. 11, 14 mars 1981, f. 15.

Nazaliteti i theksuar është cilësi negative dhe tepër antipatike (folës *ndërhundës, nërhunç, hunç e hunaç*, krahaso me *thuthaç*, ai që flet me maje të gjuhës e që i shqipton të gjithë tingujt të ngjyrosur me timbrin e bashkëtingëllores *th*). Folësi, që shqipton zanoret tepër të hundorëzuara, i tëhuaj dhe i largon teledëgjuesit, i iriton dhe i nevrikos, bëhet antipatik dhe jo i dëgjuar me ëndje.

Vrazhdësia e zërit – shkakton te teledëgjuesit e te radiodëgjuesit antipati e indiferentizëm. Vrazhdësia e zërit shkakton në zonën e veshit frekuencë të madhe auditive, për këtë arsye shkakton nervozizëm te teleshikuesit dhe te radiodëgjuesit. Ligjërimi me zë të ngjriur, me zë të spirruar ose me zë tepër të thekshëm, më tepër frikëson sesa të tërheq. Në këto raste më tepër na tërheq vëmendjen ngjyra e stërkequr e zërit të pazakonshëm e të panatyrshëm e karikaturist, sesa përmbajtja e tekstit. Prandaj, një zë i tillë, një zë i vrazhdë, vështirëson përcjelljen dhe të kuptuarit e drejtë të përmbajtjes së mesazhit.²¹ Edhe ligjërimi i ngadalësuar e zvarritës (zhagitës) është antipatik. Ky ligjërim merr kuptim ironik e karikaturistik, veçanërisht ligjërimi i artistëve në skenë teatrore apo i filmave, i cili siç dihet në raste gjegjëse ka për qëllim të thumbojë ose të ironizojë e të karikaturizojë e të përqeshë një individ ose një dukuri shoqërore negative.

Kultura e ligjërimit – butësia e zërit varet nga shkalla e kulturës së folësit (spikerit), nga shkalla e intensitetit të zërit. Zëri i lartë, jo vetëm që mund të konsiderohet si imponim, por shpesh merr ngjyrim të tonit kërcënues.²² Leximi i fjalëpërfjalshëm është lexim i dobët, i mërztishëm dhe mënjanon njerëzishmërinë, dhe si i tillë është përdhunim i gjuhës, është i panjerëzishëm dhe i panatyrshëm,²³ që u mungon kultura gjuhësore. Ana drejtshkrimore ofron edhe anën drejtshqiptimore, mirëpo në disa treva gjuhësore mungojnë fonemat *q,gj*, sepse këto qiellzore grykore kanë kaluar dhe shqiptohen si afrikate paraqiellzore *ç,xh*, ndaj mund të ndodh ngatërimi

²¹ Krahaso gjendjen e ftohjes nga rrufa (flama) kur zëri i ngjirur e i marrur, më tepër ia tërheq vërejtjen bashkëbiseduesit sesa vetë përmbajtja e bisedës.

²² M. Halimi, *Çështje të normës letrare*, Prishtinë 1980, 114-120.

²³ Siç po ndodh sot te folësit e radiotelevizionit të Kosovës, ku po inkuadrohen njerëzit pa kurrëfarë kriteri të pangritur në aspektin e kulturës gjuhësore, ndaj spikerimi i tyre është tepër i dobët i panatyrshëm, e ligjërimit të tyre, me raste përjashtuese, u mungon kultura gjuhësore.

ndërmjet fjalëve *qaj*, *qarë* (lotoj, qaj me lot) dhe *çaj*, *çarë* (dru, rrugën) në vetën e parë²⁴, si dhe mosshqiptimi i *h*-së nistore si: *ëna*, *ëngra* etj., në vend të *hëna*, *hëngra*,²⁵ dhe në pozicion mestor *koa*, *haet*, etj, në vend të *koha*, *hahet*. Duhet të kihet kujdes gjithashtu në nyjtimin dialektor të disa tingujve. Kështu kemi hetuar se shumë anëtarë e folës nga Shqipëria e Jugut dhe në Kosovë (Pejë) nuk i dallojnë mirë tingujt *r* dhe *rr*; shqiptohen me *r* fjalët: *rafsh* i *rallë*, *rebish*, *regull*, *resht* për: *rrafsh* i *rrallë*, *rrebish*, *rregull*, *rresht*, përkundrazi aty ku nuk duhet të shqiptohen me *rr*, fjalët: i *rrafinuar*, *rrebel*, *rracë*, *rraport*, etj në vend të : i *rafinuar*, *rebel*, *racë*, *raport*. Në Radiotelevizionin e Tiranës dëgjova shqiptimin me shkronjër *rr* për Presidentin *Rugova*, që nuk tingëllonte fare natyrshëm, sepse ngatërrohej me foljen *rrugova*, *rrugëve*, *rrugoj*, etj. Këtë dukuri e ndeshim edhe në të folmen e qytetit të Pejës. Përdorimi i pavend i numërorit themelor *tre* e *tri*, si: *tre javë*, *tre herë*, *tre parti*, etj., në vend të: *tri javë*, *tri herë*, *tri parti*.²⁶ Sepse i vetmi numëror themelor që ka gjini, femërore e mashkullore është numri *tre* e *tri*. Në kohët e fundit, veçanërisht në periudhën e tranzicionit demokratik kanë filluar të vërshojnë një numër i madh fjalësh të huaja në mënyrë të pakontrolluar, si: *eviniment*, *verdi*, *balotazhë*, *dikaster*, *departament*, *flesh*, *kesh*, *divorc*, etj: në vend të fjalëve thjesht shqipe, me brumë të gjuhës amtare, që nuk i mungojnë asaj. Ndaj, duke vërejtur këtë dukuri të shëmtuar, akademik Shaban Demiraj tërheq vërejtjen: “*Të gjithë ata që shqipen e quajnë gjuhë të tyre të nënëns, të mos heqin dorë nga mbrojtja e saj...*”²⁷

Njerëzishmëria – Ligjërimi i folësit të radiotelevizionit duhet të shquhet edhe nga cilësia e njerëzishmëria, nga butësia e ngrohtësia e zërit, afërsia intime e njerëzore. Ligjërimi që përmban sa më tepër që është e mundshme zë të këndshëm, *ritëm*, *pauzë*, *shqiptim* e *diksion* të *kumbueshëm*, duke respektuar njëkohësisht shenjat e pikësimit (interpunksionin), bëhet më i pranueshëm dhe do të ketë dëgjueshmëri më të madhe. Njeriu e gjejmë në të folur, e jo në gjuhë. “*Fjala është forcë e madhe, ajo bind, shndërron, detyron*” (Emerson). Gjuha jeton në njeriun, pra S-ja (përfaqëson subjektin-njeriun), kurse P-ja

²⁴ Sh. Berani, *Çështje të normës letrare*, f.165

²⁵ Gjovalin Shkurtaç, *Gjuha e teatrit dhe e kinematografisë*, GJKEJ, Tiranë 1988, f. 499

²⁶ M. Gjevori – M. Halimi, *Rreth përdorimit të numërorëve tre e tri*, në gazetën Bujku, 19 qershor 1996, f.8

²⁷ Shaban Demiraj, në gazetën Bujku, 10 maj 1996

(kallëzuesin, predikatin, veprimin), kurse $S^2 - P^2$, subjekti jep predikatin. S^2 do të thotë se njeriu shqipton fjalët (subjekti-njeriu është krijues, ndaj gjuha jeton në të, në subjekt). Prandaj, me rastin e pranimit të folësve radiotelevizivë, duhet pasur parasysh në radhë të parë, zërin *melodik* e *akustik* dhe *estetik* e *artistik*. Zëri që i plotëson këto cilësi e kritere, zëri që është më i kumbueshëm, më i ngrohtë e më i njerëzishëm, më i kultivuar e më akustik, më estetik e më i bukur, është më i pranueshëm e më i parapëlqyeshëm nga teleshikuesit e teledëgjuesit. Disa folës kanë zë të natyrshëm, të lindur. Çdo shqipfolës nuk mund të bëhet spiker dhe interpretues i mirë i radiotelevizionit. Prandaj, në kultivimin e kulturës gjuhësore në televizion ndikojnë edhe faktorët e zënë ngoje. Gjuha e standardizuar letrare kombëtare duhet të bëhet trajtë e motivuar për të gjithë, e afërt e dashur për të gjithë shqipfolësit e saj. Ashtu siç ka spikerë me prirje të talentuar për të ligjëruar mirë, ka edhe teledëgjues e simpatizues kureshtarë e të talentuar për të dëgjuar me ëndje të madhe rregullisht emisionet radiotelevizive. Ai bëhet ushqim shpirtëror e mendor për teledëgjuesit e rregulltë. Shtimi i numrit të tyre varet nga spikerët e mirë radiofonikë. Kultivimi i kulturës gjuhësore në radiotelevizion obligon dhe kutivon edhe kulturën e teledëgjuesve për të dëgjuar me kureshtje, me kënaqësi e interesim të veçantë folësit e tij mediaticë. Sepse *ashtu si toka pjellore që nuk jep frytë pa e punuar, po ashtu edhe gjuha nuk përsoset pa e kultivuar kulturën e saj gjuhësore*. Ndaj, *ne kulturën e të folurit e mësojmë nëpërmjet gjuhës së njësuar letrare kombëtare*, e cila është gjuhë e standardizuar, jo vetëm për shqipfolësit brendakombëtarë, që shqipen e kanë gjuhë të nënës, por edhe për shqipfolësit, teleshikuesit e radiodëgjuesit, për shqipfolësit ose shqipkuptuesit e simpatizuesit ndërkombëtarë anembaë botës që si model kanë *gjuhën tonë të njësuar letrare kombëtare*, e cila është ndërtuar nga të folmet tona dialektore. Mendimin dhe qëndrimin tim për lidhjet e ngushta të gjuhës letrare me të folmet popullore, unë para katër dekadash i kam krahasuar si lidhjet ndërmjet qumështit dhe ajkës (mazës). Sepse ashtu siç nuk mund të ekzistojë ajkë (mazë) pa qumësht, nuk mund të ekzistojë as gjuhë letrare pa të folme e pa dialekte. Vetëm në saje të ekzistimit të qumështit ekziston edhe ajka (maza) e tij, por edhe qumështi pa ajkë (mazë) nuk ka cilësi të lartë. Pra gjuha popullore, do të thotë të folmet dhe dialektet ofrojnë lëndën e parë, pasurinë gjuhësore e leksikore, kurse gjuha letrare e standardizuar kombëtare bënë finalizimin e saj, duke krijuar rregulla dhe norma gjuhësore të përgjithshme

dhe të përbashkëta, ajo e standardizon dhe e kodifikon gjuhën popullore në një gjuhë të kulturës dhe të shkencës e teknikës. Pra, *“Të folmet popullore dhe gjuha letrare kombëtare janë të ndërlidhura si qumështi e ajka. Njëra pa tjetrën as nuk kanë vlerë as nuk mund të ekzistojnë, por njëra-tjetrën e ushqejnë dhe e ndërplotësojnë”* (M. Halimi, *E folmja e Karadakut*, Prishtinë, 2008, f. 11) Gjuha letrare falë lidhjeve të pandërprera me të folmet popullore, ajo gjithnjë nëpërmjet kapilarëve të saj është ujitur e selitur, është freskuar e pasuruar nga të folmet popullore dhe ka arritur të bëhet *Gjuhë letrare kombëtare e standardizuar, forma më e përsosur e gjuhës sonë amtare, të ëmbël, melodike e muzikale, të cilën e flet dhe e kultivon, e ruan me nostalgji, e do dhe e çmon me dashuri të madhe si gjënë më të shenjtë dhe më të shtrenjtë kombëtare.*

Prof. Dr. Mimoza KORE

Universiteti i Tiranës

NORMA DHE PRIRJE TË GJUHËS SË SOTME STANDARDE

Bashkësia shqipfolëse, e këtu e kemi fjalën për të gjitha ata që gjuhë amtare kanë shqipen brenda e jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, bën pjesë sot në bashkësitë e zhvilluara, që ka prioritet komunikimin e gjerë e të saktë e që për këtë ka krijuar varietetin letrar të gjuhës që të gjithë sot e quajmë, *shqipja standarde*. Në këto pesëdhjetë vite ky varietet ka reflektuar stabilitet dhe rritje të funksioneve të tij, duke u bërë gjuha e shtetit, e medias, e shkollës, e auditorëve dhe e të gjithë atyre që mëtojnë të kenë status të lartë në punë e në shoqëri etj.

Sot gjithmonë e më shumë është shtuar numri i bartësve ligjërimitorë të gjuhës standarde, të cilët nuk zotërojnë në mënyrë krejt të ngurtë vetëm gjuhën standarde, por ata mund të kalojnë pa shumë mundim nga një regjistër gjuhësor në tjetrin, në varësi të rrethanave ligjërimitore e sociolinguistike.

Krijimi i *gjuhës letrare, gjuhës letrare kombëtare* apo i *gjuhës standarde*, koncepte këto që sot përdoren si sinonime të njëra-tjetrës, por që kanë në fakt kuptim të diferencuar siç i shpjegojnë qartë Sh. Sejdiu¹, R. Ismajli² ka qenë një proces i hershëm e plot vështirësi dhe zgjedhja e normës ishte proces i gjatë e që nuk përfundon kurrë. Ndërsa vendimi për statusin shtetëror të një gjuhe është kryesisht politik, vendosja e rregullave dhe rregulloreve gjuhësore, pra norma dhe kodifikimi i saj kërkon përpjekjen e gjuhëta-

¹ Sh. Sejdiu: “Termtat që më dëndurisht dilnin në Kongres, ishin *gjuhë letrare kombëtare, gjuhë letrare shqipe, gjuhë e shkrimit, gjuhë e përbashkët e shkrimit dhe e literaturës, ...* Të gjithë u përdorën pra në atë Kongres për të shënuar referentin e gjuhës standarde „, në “Diçka rreth gjuhës (shqipe), gjuhës letrare (shqipe) dhe gjuhës standarde (shqipe)“, Seminari 20/1, Prishtinë, 2001.

² R. Ismajli, “Gjuha standarde nuk përputhet domosdo me *gjuhën letrare*, as me *gjuhën letrare kombëtare*... Megjithatë, edhe sot e kësaj dite të dy këta terma përdoren si sinonime të njëri-tjetrit dhe si sinonime të termit *gjuhë standarde*.” në *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005, f.35.

rëve. Edhe pse statusin e gjuhës standarde shqipja e fitoi zyrtarisht me Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, gjuhëtarët shqiptarë zbatuan, pa i ditur në atë kohë, metodat moderne që ndeshim në literaturën e sotme. Sipas Haugen katër janë fushat e identifikuara të standardizimit gjuhësor: përzgjedhja, kodifikimi, përpunimi dhe zbatimi³. Kjo rrugë u ndoq edhe për standardizimin e shqipes. Pasi u bë përzgjedhja ajo u ndoq nga procesi i kodifikimit i cili ka për funksion të çimentojë format e përzgjedhura standarde. Kjo u arrit përmes hartimit të fjalorëve dhe gramatikave, pra nuk bën të mundur përfshirjen gjithmonë të shqiptimit. Normimi dhe kodifikimi janë procese që përfundimisht përcaktojnë se çfarë është e saktë dhe çfarë nuk është brenda standardit – kjo e bën kodifikimin shpatën e prescriptivistit, që do të thotë se kodifikimi përdoret për të argumentuar se cila është mënyra e duhur për të përdorur gjuhën.

Po çfarë përfitohet nga normimi e kodifikimi? Normimi i gjuhës nga gjuhëtarët është i domosdoshëm, sepse zbulon rregullsi të trupit kryesor të gjuhës; rihvendos njësitë e vjetruara; krijon modele të reja të të folurit; përmirëson mënyrat e zbatimit të gjuhës standarde; mbron gjuhën letrare nga përdorimi i përbashkët e i përgjithshëm spontan. Gjithashtu norma dhe kodifikimi çojnë drejt drejtshkrimit të njësuar i cili ka rëndësi themelore si në aspektin thjeshtgjuhësor, ashtu edhe në aspektin kulturor e shoqëror. Në aspektin gjuhësor, njësimi i drejtshkrimit ka rëndësi, sepse është një proces ligjësor dhe vulos njësimin strukturor të gjuhës letrare të përbashkët për të gjithë popullin tonë. Në aspektin kulturor e shoqëror, drejtshkrimi i njësuar ka rëndësi, se ndihmon gjuhën kombëtare t'i kryejë më mirë funksionet shoqërore.

Vështruar nga distanca e 50 vjetëve të jetëgjatësisë së normës së gjuhës sonë zyrtare mund të konstatojmë edhe disa tipare të saj që janë përvijuar me kohë dhe gjatë zbatimit të saj. Gjatë kësaj periudhe prej pesë dekadash konstatojmë dy prirje të normës që duket se bien ndesh me njëra-tjetrën, por në fakt janë komplementare dhe e bëjnë atë më të zbatueshme e më të pranueshme nga bartësit e saj. Para së gjithash ajo është konservatore, një karak-

³ Haugen, Einar Ingvald. 1983, *The Implementation of Corpus Planning: Theory and Practice*. In *Progress in Language Planning: International Perspectives*.

teristikë domethënëse e normës e cila e ndihmon atë të kapërcejë paqëndrueshmërinë dhe ndryshueshmërinë e përdorimit dhe të pranojë vetëm ato elemente të reja të përdorimit që nuk bien ndesh me rregullsitë themelore të sistemit gjuhësor. Kjo do të thotë që edhe pse gjuha zhvillohet dhe ndryshon me kohën, kodet që përcaktojnë rregullat e standardit nuk mund të ndryshojnë kaq shpejt. Standardi duhet të ketë qëndrueshmëri të vijueshme. Por praktika e çdo gjuhe ka vërtetuar se norma dhe rregullat mbi të cilat një gjuhë standarde zbatohet duhet të karakterizohen edhe nga një stabilitet fleksibël. Kjo do të thotë që një gjuhë standarde duhet së pari t'iu referohet kerkesave për t'u stabilizuar nga një kodifikim i përshtatshëm, por ky kodifikim e normëzim nuk duhet të jetë i mbyllur, përgjithmonë i pandryshueshëm në çështje të veçanta e që paraqesin vështirësi zbatimi, por duhet të lejojë me kohë modifikime sipas ndryshimeve historike e kulturore, të cilat edhe për shoqërinë shqiptare kanë qenë të pranishme në pesë dekada.

Gjuha standarde me kalimin e kohës evoluon sipas rregullave të saj të brendshme, ashtu sikurse ndodh me çdo gjuhë. Nga distanca kohore e 50 viteve mund të vërehen si të sigurta disa dukuri inovative të saj. Kështu gjithmonë e më shumë është vënë re një bjerje e vazhdueshme e numrit relativisht të lartë të dysorëve të shumësit të emrave, të cilët sot janë reduktuar në rreth 30 të tillë⁴. Edhe pse në shumë nga tekstet normative disa fjalë janë pranuar me dy trajta shumësi, sot po vihet re gjithmonë e më tepër se përparësinë po e merr njëra trajtë. Sipas prof. Sh. Demirajt në këto raste ...*ky qëndrim duhet çuar më tej, duke ngritur në normë trajtën më të markuar në ato raste, kur kemi dysorë.*⁵ Kështu, në brezin e ri nuk parapëlqehen shumësat: *byreq~e, hendeq~e, jastëq~e*, por, kemi vënë re se, përdorin më shumë shumësin me ~ë. Kësaj i janë nënshtruar edhe fjalë të huazuara së fundi, p.sh.: janë veshje të ditës që mund të shiten nëpër *butikë*. Kemi vënë re se edhe kur ka dysorë të këtij tipi, ndonjë prej tyre po merr funksion të ri e diferencues, duke shprehur një kuptim leksikor të ndryshëm, p.sh: *oxhakë* të *uzinave* dhe *oxhaqe* të *mëdha*, kjo e dyta me kuptimin e familjeve me emër, ose *trafikë* të

⁴ M. Kore, "Për një përmirësim të normës morfologjike në standard" mbajtur në Konferencën *Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Durrës, 15-17 Dhjetor, 2010, botuar nga QSA Tiranë, 2011.

⁵ Sh. Demiraj, *Prirje kryesore në strukturën morfologjike të shqipes së sotme letrare*, Gjuha Jonë, 1, 1985, f. 58

qyteteve, dhe *trafiqe të paligjshme*. Pikërisht për këtë arsye të fundit, nuk pajtohemi me mendimin e dhënë në *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, (Tiranë, 2011)⁶ për të mbajtur vetëm trajtat *oxhakë*, *trafikë*, *kolltukë*. Prania e dysorëve në standard, e këtu nuk e kemi fjalën vetëm për rastin e mesipërm, është e pashmangshme e duhet të vijojë të ruhet veçanërisht kur kanë marrë edhe një shtesë semantike.

Duket se po përvijohet një prirje për të njësuar shumësin e disa emrave që mbarojnë me zanore të theksuar me trajtën e numrit njëjës. Dikur këta emra e formonin shumësin me mbaresën *-ra*, kurse sot formime me këtë mbaresë kanë marrë ngjyrim stilistik: do bënte ca *shaká* me miqtë që shtohen⁷; këto *s'janë shaká* akoma⁸; di të bëjë *shaká* dhe madje nga *ato* pa kripë⁹ krahas rasteve të rralla: *këto s'janë shakára*, po halle të rënda ... (lir. pop.); Janë 12 *kalá*, të cilat ofrojnë... (jo *kalára*); në disa *kafené* është rritur; ...gjenden në rrugë, *kafene*, makina... (jo *kafenéra*)¹⁰ etj.

Kemi vënë re se sot po ndodh një dukuri nga përdoruesit e standardit për të mos zbatuar shkrimin sipas parimit historik të fjalëve *brryl*, *brruc*, *grrryej*, *krrus*, *krrabë* të cilat drejtshkrimi ka vendosur t'i shkruajë sipas traditës së rrënjësor *bërryl*, *bërruc*, *gërrryej*, *kërrus*, *kërrabë* etj. Për këto fjalë gjuhëtarët kanë pasur parasysh në shkrimin e ë-së paratheksore edhe faktin se bashkëtingëlloret *b-*, *g-*, *k-* ndiqen prej *-rr*. Me këta shembuj, po për shkak të parimit historik, kërkohet nga rregulla të shkruhet dhe (i) *dëllirë*, *këqyr*, *mbikëqyr*, *mëtoj* etj. Në këto të fundit, duke pranuar parimin fonetik, ë-ja edhe mund të mos shkruhet jo vetëm se nuk shqiptohet, por dhe nuk prish strukturën e fjalës duke u pajtuar kështu me dukurinë që vihet re. Gjuha ndjek zhvillimin dhe nuk mund mbetet peng, në disa raste si këto, e traditës shkrimore.

Pajtohemi me prirjen e sotme, por edhe me një propozim të *Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe* për heqjen e ë-së fundore tek emrat e gjinisë mashkullore *ujë*, *ballë*, *brumë*, *gjalpë*, *dhjamë*, *drithë*, *djathë*, *burrë*

⁶ A. Dhimo dhe R. Memushaj, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011.

⁷ Prizrenpress, B. Fevziu, 23. 0. 2023

⁸ <https://sq.almancax.com> › forum

⁹ *Eduasportin*, 14, 06 2018.

¹⁰ *Anabel*, 12.03.2020

etj. Kjo rregullë, është e trashëguar qysh nga Komisia Letrare Shqipe në Shkodër¹¹ ku u vendos të shkruhej ë-ja fundore *atje ku e lypë etimologjia e ku shqyptohet në toskënishte, si te emrat femërorë në fund të fjalës dhe te disa emra mashkullorë me zanore me gjatësi të mesme në rrokjen parafundore, si: burrë, grunë, djalë, djathë, gjalpë, lumë*. Nga gjuhëtarët kjo u konsiderua si bashkëveprim i parimit etimologjik - historik me parimin morfologjik që synon të ruajë njësinë e trajtave, strukturën morfologjike të fjalës, si dhe pjesët përbërëse të saj¹², por në shqipen e sotme këta emra janë të gjinisë mashkullore, si rrjedhim, zanorja -ë nuk ka funksion morfologjik. Veçanërisht të huajt që mësojnë gjuhën shqipe kanë vështirësi në përcaktimin e gjinisë në emrat që s'kanë gjini biologjike siç është ky tip emrash. Me këtë mendim janë pajtuar edhe A. Dhrimo dhe R. Memushaj në *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, (2011). Nga ana tjetër ka dhe gjuhëtarë¹³ që e kundërshtojnë heqjen e -ë-së fundore në fjalë si *ballë, lumë* me arsyetimin se nuk do të shkruajmë më *ballëlart apo lumëmadh*, por *ballart, lummadh*. Raste të tilla përfshijnë një numër të vogël e të papërfillshëm e mund të përbëjnë një rregullë përjashtimore.

Këto raste e shumë të tjera, kur dhe gjuhëtarë nuk bien në një mendje, flasin qartë për nevojën e diskutimeve, rrahjes së mendimeve për të arritur në zgjidhje objektive në të mirë të përdorimit drejt e të gjithëpranuar. Kjo mund të arrihet vetëm kur diskutimet shkencore të nisin kur të përcaktohen qartë fillimisht parimet mbi të cilat do të mbështeten e duke shmangur qëndrimet subjektive e partikulariste.

Emrat që mbarojnë më -o të theksuar të tipit: *depo, Koço, pallto* etj rregulla drejtshkrimimore ka vendosur të shkruhen *depoja, Koçoja, palltoja*.

¹¹ *Lajmet e Komisis letrare shqipe në Shkodër* nr. 1, 1918 dhe në gazetën *Posta e Shqypnies* nr. 95, 3 nëntor 1917.

¹² Shih më gjerë, S. Mansaku, Rreth parimeve të drejtshkrimit të Komisisë Letrare Shqipe në Shkodër, botuar në *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër. - Me rastin e 80-vjetorit - (1916 – 1996)*. *Studime Shqiptare* 8. Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Sektori Shkencor i Albanologjisë. Shkodër, 1997, 120 f. 51-57.

¹³ A. Omari, Disa mendime për propozimet për reformë drejtshkrimore, botuar në *Studime Albanologjike*, 2014, 1, Viti XIX, Tiranë 2015, f. 53-60; Xh. Lloshi, *E duam drejtshkrimin si gjithë Europa*, Shkup Konica 2022.

Duket se ky përdorim nuk po zë vend në ditët e sotme. Të ndërgjegjshëm që nuk duhet të përdorin as *depu*, *Koçua*, instiktivisht gjuha e të rinjve është përgjigjur me një formë të ngjashme me njëjës in e pashquar, p.sh: *Nasho* tha.; *depo* e armatimit ishte larg...etj.

Përveç prirjeve që nuk e prishin tipologjinë e shqipes dhe mund të gjejnë pasqyrim në tekstet normative, vihen re dhe përdorime të gabuara, të cilat i ndeshim edhe te intelektualë e gazetarë që njohin rregullat e gjuhës standarde e denduria e përdorimit të së cilave po rritet. Sigurisht për hir të kësaj nuk mund të bëhen pjesë e rregullsive që karakterizojnë një gjuhë standarde. Spontaniteti duhet t'i nështrohet rregullsive dhe jo e kundërta. Kemi vërejtur se po pëlqehet gjithmonë e më shumë femërorizimi i disa përemrave dëftorë e pronorë: *kjo* mund të duket si një problem teknik; Nga hetimet e kryera deri më tani, rezultoi se *këto* shtetas; Shqetësimi *jonë* mbeten amnistia fiskale dhe pasaportat e arta; Rikthimi i sovranitetit dhe referendumit, qëllimi *jonë* kryesor...¹⁴Pëlqimi në përdorim i gjinisë femërore të këtyre përemrave duhet të ketë një shkak, i cili ndoshta mund të jetë dhe jashtë-gjuhësor.

Te brezi i ri vërehet një lloj theksimi i disa emrave të përveçëm, kryesisht të huaj jo sipas tipologjisë së gjuhës sonë: Élion, Énea, Mártin, Élena etj. Këta lloj emrash, pavarësisht theksit që kanë në gjuhën dhënëse, duhet t'i përshtaten theksit të gjuhës shqipe.

Rregullat e gjuhës mund të mos jenë plotësisht të fiksuara në manualët akademike e autoritare, domethënë të detajuara plotësisht në gramatikat, fjalorët e veprat e tjera normative, por zbatimi i standardit në shoqërinë shqiptare ka shënuar një arritje edhe në një plan tjetër. Ajo çka bie ndesh me të dhe natyrën e gjuhës sonë perceptohet lehtë nga bartësit e saj e kjo shënon një arritje në zbatimin drejt të këtij varieteti gjuhësor.

Nën ndikimin e gjuhëve të huaja si anglishtja apo gjermanishtja shpesh fjalitë fillojnë me përemrin vector, një përdorim që ndihet i huaj: *Ne jemi* shumë të mirë *në* artin e mashtrimit të vetvetes; *Unë premtoj* se do të vazhdoj trashëgiminë tuaj (Gaz. Shqiptare 23 prill, 2021); *Ne vendosëm* që *në* këtë intervistë ta pyesnim...(Balkanweb, 10 Prill, 2020) etj.

¹⁴ Panairi - Shija e vrarë e librit, Balkanweb 19 nëntor, 2022, balkaweb, 23 shtator, 2022, Shqiptarja.com. 14 dhjetor, 2022, News 24, Jul 25, 2022.

Kritikat që bëhen në lidhje me përdorimet e gabuara të shqipes standarde sot nuk duhet të përligjen me marrëdhëniet e standardit me dialektet apo të folmet e veçanta, por me paaftësinë e institucioneve arsimore për t'u mësuar nxënësve shqipen standarde në nivel të mirë, sikurse lidhen edhe me nevojën, ende të shpërfillur, për t'u mësuar nxënësve jo vetëm gjuhën standarde si tërësi rregullash formale, por edhe rregullat e përdorimit të diferencuar të kësaj gjuhe, sipas konteksteve të ndryshme sociale. Pra duhet vetëm të dimë, në cilën situatë ta përdorim gjuhën letrare e në cilën dialektin, ashtu sikur nuk vishemi njësoj për raste të ndryshme. Në vendet e tjera në të cilat mosha e gjuhës standarde është më e hershme se e gjuhës sonë dhe hendeku që ka krijuar me dialektet dhe të folmet është më i madh, i ka çuar gjuhëtarët përpara dy alternativave: format gjuhësore të standardit duhet të “vernakularizohen”, pra të bien në nivelin e dialektit, apo format dialektore “të valorizohen”, pra të vlerësohen duke marrë statusin e gjuhës standarde e duke iu nështruar rregullave të kësaj të fundit duhet të përfshihen në standard? Të gjithë bien në një mendje që rruga e dytë është e duhura. Ngritja në normë e prurjeve dialektore duhet bërë pa prishur e prekur rrafshet e sistemit të gjuhës të konsoliduara tashmë. Disa zhvillime që vihen re sot në gjuhën standarde vijnë edhe si rezultat i kontakteve që kjo e fundit ka pasur me varietetin dialektor të shkruar të Veriut si me veprat e M. Camajt, Gj, Fishtës, Benardin Palajt etj, vepra që nuk ishin mundësuar të njiheshin më parë. Si ndikim nga gegërishtja ndeshim shpesh shembuj të mospërputhjes së kohëve të foljes, çka e ka vënë re dhe S. Mansaku¹⁵, psh: *Sot shkova te blej nje shurup kolle në vend të shkova të bleja...*; *Edhe pse i pelqyen, ai nuk preferoi t'i vlerësojë në vend të nuk preferoi t'i vlerësonte*; *Pak para se të niset në Uashington, Vuçiç ishte takuar në Beograd...* në vend të *para se të nisej*. S. Mansaku këtë mospërputhje e shpjegon me faktin se *lidhorja e tashme në këto raste funksionon si një paskajore* (pask.gege me punu. pra *shkova me ble*, nuk preferoi me i vlerësu, pak para se me unisë shën. ynë) dhe i pranon si ndërtime që në shqipen standarde me kohë duhet të bëhen normative e të zënë vend.

Po shihet se është mjaft e përhapur dukuria e zëvendësimit të kohës

¹⁵ S. Mansaku, Prije të zhvillimit të shtrukturës sintaksore të shqipes së sotme standard, në Seminarin 20./1 *Gjendja në përdorimet publike të shqipes standarde sot*, Prishtinë, 2001, f. 324.

së kryer të thjeshtë me kohën e kryer: Trupa tetorore *ishte* në turne, i cili *ka zgjuar interesim* të madh (zgjoi); Moti i keq që gjatë ditës së djeshme *kaploi* Veriun e vendit, *ka përmbytur* gjithçka (përmbyti); Harxhi *theksoi* se foltorja e S. Berishës *ka zgjuar* shpresat e demokratëve (zgjoi); *akuzohet se ka marrë pjesë* etj. Përdoruesit e kësaj kohe duket se duan të theksojnë më tepër veprimin e foljes, dinamikën e ngjarjeve dhe të ndikimit të tyre, por në fakt shkaktojnë mospërputhje të kohëve foljore.

Nga na tjetër vihet re gjithmonë e më tepër përdorimi i shprehjeve dhe ndërtimeve të reja që po e ngrëne nivelin e gjuhës standarde. Por intelektualizimi me kohë i gjuhës duhet të bëhet sipas modifikimit të sistemit të gjuhës standarde dhe të sigurojë zhvillim nga gjuha e folur, por pa u shkëputur e krijuar hendek të thellë me gjuhën popullore me të cilën standardi ynë është i lidhur ende fort. Në zhvillimin e hapur dhe dianamik, në të cilin është përfshirë fuqishëm gjuha e sotme standarde, si dhe në kontaktet e hapura e të pandërprera me gjuhët e huaja, sepse vështirë të gjenden sot në botë shoqëri të izoluara, vihen re ndërtime të reja madje edhe si imitime të modeleve të gjuhëve të tjera. Ato duhen pranuar me kujdes dhe vetëm kur nuk prishin tipologjinë e gjuhës shqipe, kur nuk ndihen fallco e si mish i huaj në të. Kanë zënë vend në gjuhë dhe nuk bien ndesh me strukturën e saj togjet e fjalëve: *hark kohor*, *shtet i së drejtës*, *dimension njerëzor*, *ridimensionim i qëndrimit*; *ndaj të njëjtin mendim* etj. Të pranueshme janë dhe shprehjet: *dorëhiqet kryeministri* (dha dorëheqjen); *ndërhyrja erdhi si rezultat*; *është bërë pjesë e konferencës*; *ndihmon në zgjidhjen e problemit*, *mori pjesë në punimet e konferencës* etj.

Edhe puna e bërë apo që vijon të bëhet nga gjuhëtarët tanë me synimin e saktësisimit, lehtësisimit dhe modifikimit të problemeve të veçanta që paraqet zbatimi i standardit, duhet bërë duke gjetur zgjidhjet në vetë standardin e shqipes. Duhet rishikuar parimet e tij. Në fillim, qysh në punimet e Kongresit u theksua si parësor parimi fonetik, por kjo u bë dhe duhet kuptuar, siç shprehet R. Memushaj,¹⁶ *që shkrimi i fjalëve në shqipe do të mbetet sa më afër përbërjes fonemore të tyre*, pra u kuptua që drejtshkrimi të ndiqte drejtshqiptimin. Sipas mendimit tonë, kjo është një fazë e tejkaluar. Pesha e

¹⁶ R. Memushaj, *Për shqipen standard I, çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore*, Infobotues, Tiranë, 2012, f.109.

parimit morfologjik është rritur dhe ndryshimet apo rregullimet që kërkohen të bëhen, duhet ta kenë parasysh këtë. Gjuha e shkrimit duhet të jetë ajo që do të përcjellë në breza kulturën, traditën në të gjitha trevat ku flitet shqip e ajo duhet të jetë sa më e unifikuar.

Bibliografia

- Demiraj, Shaban (1985), *Prije kryesore në strukturën morfologjike të shqipes së sotme letrare*, Gjuha Jonë, 1.
- Drejtskrimi i gjuhës shqipe (1973), Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë.
- Dhramo, Ali & Memushaj, Rami, (2011) *Fjalor drejtskrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë.
- Haugen, Einar Ingvald (1983), *The Implementation of Corpus Planning: Theory and Practice*. In *Progress in Language Planning: International Perspectives*.
- Ismajli, Rexhep, (2005) *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë.
- Kore, Mimoza, *Për një përmirësim të normës morfologjike në standard mbajtur në Konferencën Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Durrës, 15-17 Dhjetor, 2010, botuar nga QSA Tiranë, 2011.
- LLoshi, Xhevat, (2022) *E duam drejtskrimin si gjithë Europa*, Shkup Konica.
- Mansaku, Seit, (1997) *Rreth parimeve të drejtskrimit të Komisionit Letrare Shqipe në Shkodër*, botuar në Komisionin Letrar Shqipe në Shkodër. - *Me rastin e 80-vjetorit - (1916 – 1996)*. Studime Shqiptare 8. Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Sektori Shkencor i Albanologjisë. Shkodër.
- Mansaku, Seit, (2001) *Prije të zhvillimit të shtrukturës sintaksore të shqipes së sotme standard*, në *Seminari 20/1* botuar si akte konference në Gjendja në përdorimet publike të shqipes standarde sot, Prishtinë.
- Memushaj, Rami, *Për shqipen standard I, çështje të normës morfologjike dhe drejtskrimore*, Infobotues, Tiranë, 2012.
- Omari, Anila (2014) *Disa mendime për propozimet për reformë drejtskrimore*, botuar në *Studime Albanologjike*, 1, Viti XIX, Tiranë.
- Sejdiu, Shefki, (2001) *Diçka rreth gjuhës (shqipe), gjuhës letrare (shqipe) dhe gjuhës standarde (shqipe)*, *Seminari 20/1*, Prishtinë.

Prof. Dr. Berton SULEJMANI
Universiteti i Tetovës

GJUHA SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT SOT (shqipja standarde dhe statusi i pabarabartë i shqipes me maqedonishten)

Në këtë kumtesë shkencore do t'i trajtojmë arritjet dhe problemet e gjuhës standarde shqipe në institucionet shtetërore dhe private të Maqedonisë së Veriut që nga Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe e deri më sot (1972 – 2022). Pjesë e kumtesës do të jetë edhe statusi i pabarabartë i shqipes me maqedonishten. Me ndryshimet e fundit kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në gazetën zyrtare të 14 janarit 2019 u shpall edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Sipas këtij ligji, madje, po të krahasohet me ligjet paraprake, përkatësisht, nga pavarësimi i shtetit 1991 (emërtimi i mëparshëm: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) e deri me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës (17 qershor 2018) mes IRJM-së dhe Greqisë, përdorimi i gjuhës shqipe ka një ngritje, por nuk është plotësisht e barabartë me maqedonishten. Me fjalë të tjera, gjuha shqipe është në përdorim zyrtar, por jo zyrtare. Gjuha shqipe vetëm në dy shtete të Ballkanit është gjuhë zyrtare, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, ndërsa në Maqedoninë e Veriut gjuha shqipe është pjesërisht zyrtare. Me përpyekjet e fundit të shqiptarëve në Mal të Zi, gjuha shqipe tashmë është bërë gjuhë zyrtare në dy komuna - në komunën e Ulqinit dhe në atë të Tuzit.

Fjalë çelësa: shqipja standarde, planifikimi dhe politika gjuhësore, gjuhë zyrtare, gjuhë në përdorim zyrtar.

1. Korniza ligjore. Ligji për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Statusi i komuniteteve në shtetet multietnike, dallon sikurse në aspektin juridik-kushtetues, gjithashtu edhe në atë praktik. Diversiteti duhet pranuar si vlerë, e jo vështirësi e funksionimit të shteteve bashkëkohore, bazuar në faktin e numrit të madh të etniteteve të cilat ekzistojnë dhe gjuhëve të ndryshme. Përdorimi i lirshëm i gjuhës, është një e drejtë elementare që mund t'i garantohet një komuniteti¹. Ndërsa, në Maqedoninë e Veriut, krahas etniteteve pakicë (turq, boshnjakë, serbë, romë, etj.) etniteti maqedonas dhe ai shqiptar përbëjnë grupet më të mëdha në shtet. Ky i fundit (pra etniteti shqiptar) përbën mbi 35% të popullatës në vend.

¹ Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, f. 230, Prishtinë, 2011.

Me ndryshimet e fundit kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në gazetën zyrtare të 14 janarit 2019 u shpall edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Sipas këtij ligji, madje, po të krahasohet me ligjet paraprake, përkatësisht, nga pavarësimi i këtij shtetit 1991 (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, në vazhdim: IRJM) e deri me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës (17 qershor 2018) mes IRJM-së dhe Greqisë, përdorimi i gjuhës shqipe ka një ngritje, por jo plotësisht të barabartë me maqedonishten. Me fjalë të tjera, gjuha shqipe është në përdorim zyrtar, por jo gjuhë zyrtare. Gjuha shqipe vetëm në dy shtete të Ballkanit Perëndimor është gjuhë zyrtare, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, ndërsa në Maqedoninë e Veriut gjuha shqipe është pjesërisht zyrtare.

Përpjekja e fundit për avancimin e përdorimit të gjuhës shqipe është bërë më 11 janar 2018, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Ky ligj ka bërë emërtimin në kllapa “gjuha shqipe” (edhe pse në tekst akoma mbetet “gjuha të cilën e flasin 20% e qytetarëve”) dhe e ka zgjeruar përdorimin e saj zyrtar në organe të pushtetit presidencial, ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, lokal, si edhe në komunikim ndërkombëtar, në ushtri, në polici dhe në monedha, por edhe në veprimtari të tjera (i mbikëqyrur për herë të parë nga institucione për mbrojtjen e gjuhës). Edhe në këtë ligj mbetet formulimi “pranë gjuhës maqedonase”, që nënkupton se statusi i maqedonishtes ka mbetur “kodi i vetëm i komunikimit të shtetit”, sipas asaj që është projektuar në KAÇKM² (Kuvendi Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Maqedonisë), dhe që vazhdon, kjo për shkak të politikës së bartësit kryesor të sovranitetit të shtetit. Po të bëjmë një krahasim me shtetin e dytë të shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor (*Ballkani Perëndimor është një shprehje që është përdorur në Bashkimin Evropian që nga fillimi i shekullit 21 për të shënuar kryesisht territoret e shteteve të Ballkanit (me përjashtim të Turqisë)*) jo anëtarë të asaj organizate. Për më shumë shih

² Që nga mbledhja e KAÇKM-së (*Kuvendi Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Maqedonisë*), e mbajtur më 2 gusht 1944 në manastirin “Prohor Pçinski”, kur u vunë themelet e shtetësisë së Maqedonisë, aty në nenin 1 të *Vendimit të Kuvendit Antifashist të Çlirimit Popullor të Maqedonisë* u vendos që: “*Në shtetin maqedonas si gjuhë zyrtare vendoset gjuha popullore maqedonase*”. (Службен весник на Федерална Единица на Македонија, бр. 1, 1945. / *Gazeta Zyrtare e Njësisë Federale të Maqedonisë*, nr. 1, 1945).

në https://sq.wikipedia.org/wiki/Balkani_Per%C3%ABndimor), pra me Republikën e Kosovës, ku popullata serbe me rreth 3% të popullatës së përgjithshme, shohim se përdorimi i gjuhëve të komuniteteve në Republikën e Kosovës ka përmasa shumë më të gjera dhe si e drejtë elementare ushtrohet në përmasa shumë më të gjera, vështruar në aspektin krahasimtar, me sistemet e ndryshme kushtetuese, të cilat nivelin e garantimit të kësaj të drejte në ushtrimin e saj e kanë shumë më të ulët, zakonisht në nivelin e përdorimit zyrtar të gjuhës³. Në raport me sistemet e ndryshme kushtetuese, qartë shihet shtrirja e gjerë e përdorimit të gjuhëve të komuniteteve në Republikën e Kosovës. “Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj”⁴. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton përdorimin e gjuhës serbe në tërë vendin dhe gjuhëve të komuniteteve tjera në nivel komunal në harmoni me ligjet në fuqi⁵.

2. *Gabimet drejtshkrimore në mbishkrimet publike e private në qytetin e Shkupit e Gostivarit*. Mënyra se si shkruhen emrat e lokaleve, dyqaneve, rrugëve dhe gjithçkaje tjetër ka dy vlera. E para është ajo se çfarë do të thotë ky fjalim dhe e dyta se si thuhet ai. Në rastet kur në emërtimet, por edhe në fjalimet publike përdoren terma të gabuar apo të huaj, edhe lexuesit kanë të drejtë ta marrin si të mirëqenë atë fjalë dhe ta përdorin në të ardhmen, edhe pse ajo mund të jetë gabim. Andaj është i nevojshëm korrektori letrar, i cili do të ketë për detyrë që ta përpunojë dhe ta kthejë fjalimin e dikujt në formën e duhur, sipas rregullave të drejtshkrimit sot. Duket që në qendër të vëmendjes të qëndrojnë gjuha e shkruar. Besoj që secili nga ju pajtohet me ne se gabimet e llojit **Maqedonisht Operës dhe Baletit* (në maqedonisht Македонска Опера и Балет) në vend të *Teatri i Operës dhe i Baletit në Ma-*

³ Po aty.

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5, 2008.

⁵ Jusuf Zejneli, *Sfidat e Zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup *Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*, f. 158, Shkup, 2021.

qedoninë e Veriut, nuk mund të vijë nga një shqiptar, qoftë edhe pa shkollim adekuat.



Ajo që bie në sy nga materiali i grumbulluar është se të gjitha bizneset private të qytetarëve maqedonas, por edhe institucione arsimore e bankare në qytetin e Shkupit e Gostivarit (i kemi marrë këto dy qytete, edhe pse gabime e mosrespektim kemi vërejtur edhe në qytete të tjera) në përgjithësi, por edhe në komunat tjera nuk respektojnë gjuhën shqipe. Mbishkrimet e vendosura në ndërmarrjet apo institucionet e tilla janë të shkruara në gjuhë të ndryshme, duke sjellë në laramani dhe kaos i përgjithshëm. Në disa prej tyre dominon vetëm gjuha maqedonase, ndërsa në disa prej tyre ka vend për gjuhën angleze dhe jo për gjuhën shqipe, edhe pse popullsia dominuese në këtë komunë është ajo shqiptare. Në çdo anë ku janë të pranishme dyqanet apo lokalet e ndryshme me pronarë maqedonas shihet që nga largësia shkrimi cirilik i reklamave, duke mos përmbajtur asnjë fjalë shqipe. Për fat të keq kjo gjendje është edhe tek disa pronarë shqiptarë.

3. Norma drejtshkrimore e toponimeve shqipe në tabelat rrugore në RMV sot.

Përpjekje për të vënë sadopak rend në përdorimin e emrave të përveçëm të vendeve në tabelat rrugore në Maqedoninë e Veriut prora kanë ekzistuar. Madje, krahas gjithë këtij kaosi gjuhësor që ka ndodhur te ne, si-



domos nga viti 1991 e deri më sot, këto përpjekje kryesisht kanë qenë individuale e kolektive (katedrat e gjuhës shqipe Shkup e Tetovë). *Andaj, nevoja e hartimit të një politike gjuhësore zyrtare në Maqedoninë e Veriut*

siç ndodhi me themelimin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve, e cila tashmë është në një fazë të re, pra në fillimet e punës së saj, është për t'u përshëndetur, sepse puna e angazhimi i gjuhëtarëve dhe dashamirëve të gjuhës nuk mund t'i tejkalojë të gjitha këto probleme gjuhësore, por domosdo duhej të krijohej një institucionin që do të merrej me këto çështje.

Mjafton të udhëtoni nëpër qytetet, fshatrat e lagjet e kryeqytetit, veçanërisht në vendbanimet shqiptare, qoftë me mjetet e transportit publik, qoftë me ato private gjithçka do ta keni të qartë, sepse numri më i madh i emrave të vendit në tabelave rrugore është vetëm në gjuhën maqedonase. Megjithatë, me ndryshimet e fundit kushtetuese, tabelat rrugore, i gjejmë edhe në gjuhën shqipe, por një pjesë e tyre edhe me gabime drejtshkrimore.

Ja disa nga luhatjet kryesore:

Nga ana tjetër, autobusët e ndërmarrjeve private të qytetit të Shkupit, aspak s'e përdorin gjuhën shqipe, sikur ata nuk e kanë obligim, (shih fotografinë e mëposhtme).



Edhe në qytetin e Gostivarit vërejmë gabime në shkrimin e toponimeve në tabelat e rrugës. Nga fotografia mëposhtme vërejmë se emri i fshatit *Vrapçisht* është shkruar gabimisht **Vrapçishte* (sigurisht, duke u mbështetur në emërtimin e të njëjtin fshat në gjuhën maqedonase e turke). Në gjuhën shqipe duhet të shkruhet: *Vrapçisht*, ndërsa në trajtën e shquar bën *Vrapçishti*. Sepse, po ta lëmë ashtu siç e kemi të shkruar gabimisht në tabelë, **Vrapçishte*, në trajtën e shquar do të duhej t'i thoshim **Vrapçishta*. Banorët

shqiptarë të këtyre trevave asnjëherë nuk i kanë thënë kështu, por prorre i kanë thënë Vrapçisht, ~i.

Njëjtë qëndron puna edhe me trajtën e gabuar drejtshkrimore të oikonimit *Lagja e Re që mund ta shihni në tabelën e mëposhtme. Norma e shqipes standarde kërkon që ky emër të shkruhet *Lagja e Re*⁶.



4. Propozime se në ç'mënyrë do të duhej të shkruheshin toponimet shqipe në RMV. Propozimet për standardizimin dhe drejtshkrimin e toponimeve shqipe në RMV do t'i mbështesim në toponimet e Komunës së Butelit (pjesë e Qytetit të Shkupit). Komuna e Butelit është komunë në kuadër të Qytetit të Shkupit. Është themeluar më 12 prill 2005. Është komuna e katërt për nga madhësia në Shkup,

ndërsa e teta për nga numri i banorëve. Komuna e Butelit shtrihet në një sipërfaqe prej 60.79 km², numri i banorëve të saj është 36.154. Përbërja etnike e komunës është si vijon: maqedonas 22.506 (62,25%); shqiptarë 9,107 (25.19%); turq 1,304 (3.61%); romë 561 (1,55%); vllah 120 (0.33%); serb 1,033 (2,86%); boshnjakë 970 (2.68%) dhe të tjerë 553 (2.46%)⁷.

Pjesë e kësaj komune janë 3 fshatra (Lubanca, Vizbegu dhe Loboteni) dhe 5 lagje (Buteli 1, Buteli 2, Shkup-Veriu, Radishani dhe Udha e Luboteni).

⁶ Këtu kemi vërejtur edhe një gabim drejtshkrimor në gjuhën maqedonase, jo Ново мало siç është në tabelle, por duhet: Ново маало.

⁷ Попис на населението, домаќинствата и становите во Република Северна Македонија, 2021 - прв сет на податоци. Државен завод за статистика на Македонија. Shikuar më 30 mars 2022.

Pjesë e hulumtimit tonë do të jenë pikërisht këto emërvende të fshatrave dhe të lagjeve të kësaj komune. Qëllimi ynë është që të tregojmë rregullat e standardizimit dhe njëherazi edhe të drejtshkrimit të këtyre emërvendeve. AZGJ-ja (Agjencia e Zbatimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut) veçse ka formuar një ekip gjuhëtarësh të cilët janë duke u marrë me toponiminë. Andaj, e kam thënë edhe në ndonjë punim timin, por më duhet ta ritheksoj se hartimi i një politike gjuhësore zyrtare në Maqedoninë e Veriut siç ndodhi me themelimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve është një ogur i bardhë dhe shumë i nevojshëm, sepse përpjekjet individuale e kolektive (katedrat e gjuhës shqipe, Shkup e Tetovë, e herë-herë edhe përpjekjet e dashamirësve të gjuhës shqipe) ishin shumë dobiprurëse në të kaluarën, por jo të mjaftueshme. Ndërsa, stafi akademik i këtyre katedrave që nga themelimi kanë qenë, janë dhe do të duhej që të jenë krah i djathtë i agjencisë.

Nëpërmjet disa shembujve të fshatrave e lagjeve të komunës së Butelit, të sjellim disa propozime, eventualisht përfundime të cilat do të ndihmonin në tejkalimin e zgjidhjen e këtyre vështirësive që po na ndodhin prore. Ja disa nga propozimet tona. Po shkojmë me radhë:

1. Emri i fshatit *Љубаница* – në shqip do të duhej të jetë *Lubancë*, ~a, e jo të shkruhet *Ljubancë*, ~a. Nuk duhet të mbështetemi në traditën e mbrapshtë siç ka ndodhur në të kaluarën, por edhe që herë-herë po ndodh me emrat e mbiemrat e shqiptarëve në dokumentacionet personale, si, p.sh.: Ljulzim nga *Љуљзим*, Ljuljeta nga *Љуљјета*, Sullejmani nga *Суљјемани*, Ljamalari nga *Љамалари* etj., në shqip duhet të shkruhen: Lulzim, Luljeta, Sulejmani e Lamalari. E nga kjo edhe: *Lubancë*, *Luboten* etj.
2. Emri i fshatit *Љуботен* – në shqip do të duhej të jetë *Luboten*, ~i;
3. Emri i fshatit *Визбегово* – në shqip do të duhej të jetë *Vizbeg*, ~u;
4. Emri i lagjes *Бутел I* – në shqip do të duhej të jetë *Butel 1*, ~i; *Buteli 1*;
5. Emri i lagjes *Бутел II* – në shqip do të duhej të jetë *Butel 2*, ~i; *Buteli 2*;
6. Emri i lagjes *Радишани* – në shqip do të duhej të jetë *Radishan*, ~i, e jo siç e gjejmë edhe sot e kësaj dite, edhe pse në vitin 2020 e kam përmendur dhe është botuar në përmbledhjen e kumtesave të AZGJ-së⁸, se emri i kësaj

⁸ Berton Sulejmani, Toponimia shqiptare në tabelat rrugore në Maqedoninë e Veriut, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, punimet e konferencës, Konferenca shkencore

lagjeje është shkruar gabim, përkatësisht në mbishkrimin e autobusit me numër 57 është shkruar **Radishanë*, pra me -ë në fund. Ky toponim duhet të shkruhet pa -ë, pra *Radishan*, ~i, sepse në këtë lagje jetojnë shqiptarë dhe çdoherë kanë thënë *Radishan*, *Radishani*, si: *Po shkoj te një shok imi në Radishan. Radishani qenka lagje e qetë.*

7. Emri i lagjes *Сконје-север* – në shqip do të duhej të jetë *Shkup-Veri*, ~u; toponim i cili është përkthyer nga trajta e gjuhës maqedonase (МКД. Сконје-север). Meqenëse edhe shqiptarët dy dekadat e fundit i thonë kështu, pra *Shkup-Veri*, ose vetëm *Veri*, mendojmë që në tabelat e mbishkrimeve të ndryshme të shkruhet si i tillë, e në asnjë mënyrë **Skopje-sever*.

8. Emri i lagjes *Люботенски нам* – në shqip do të duhej të jetë *Udha e Lubotenit* që e ka kuptimin udha që të shpie në Luboten.

Për t'i standardizuar këto emërvende në gjuhën shqipe duhet të kemi parasysh edhe këtë gjë: në emrat e vendeve të tipit (të cilat eventualisht do të ndesheshin me këtë formë edhe në këtë komunë), si: maqed. Копачин Дол, Ново Село, Ново Лисиче, Гази Баба, Кисела Вода, Крива Паланка etj., nuk do të duhej që në gjuhën shqipe të shkruhen ndaras, pra në dy pjesë siç janë në maqedonishte, por në një vend. Pra, nuk do të duhej të shkruheshin: **Kopaçin Doll*, **Novo Sellë* (shih fotografinë e mësipërme ku ky toponim është shkruar gabimisht), **Novo Lisiçe*, **Gazi Babë*, **Kisella Vodë*, **Kriva Pallankë* etj., sepse do të binim në kundërshtim me traditën e shkrimeve të emrave të vendeve në gjuhën shqipe. Forma e drejtë e shkrimit të emrave të mësipërme do të duhej të ishte: *Kopaçindoll*, ~i, *Novosellë*, ~a, *Novolisiçe/e*, ~ja, (në këtë lagje jetojnë edhe shqiptarë, andaj do të duhej që të dalim në terren dhe t'i konsultojmë banorët shqiptarë të kësaj lagjeje se si e quajnë ata këtë lagje. Kam përshtypje se ata e quajnë vetëm *Lisicë* e lagjen e re *Lisicë e Re*, herë-herë e dëgjojmë edhe **Dhelpra e Re*), *Gazibabë*, ~a, *Kisellavodë*, ~a, etj. Ndërsa emrat, si *Крива Паланка*, *Ѓорче Петров*, *Демир Хисар*, *Македонска Каменица*, *Македонски Брод* do të duhej të shkruheshin *Kriva-Pallankë*, ~a, *Gjorçe-Petrov*, ~i, *Demir-Hisar*, ~i, *Makedonska-Kamenicë*, ~a, *Makedonski-Brod*, ~i, etj., e jo: **Kriva Pallankë*, **Gjorçe Petrov*, **Demir Hisar*, **Makedonska Kamenicë*, **Makedonski*

Brod. Mendoj se kjo do të ishte zgjidhja më e mirë, sepse edhe në “*Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës Shqipe*” (Tiranë, 1976) gjejmë *Dimitrovgrad*, ~i, *Shëngjin*, ~i, *përkatësisht Novi-Sad*, ~i, *Shën-Naum*, ~i.

5. *Përfundim*. Krejt në fund, pasi jemi në vitin jubilar të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, jua bëj të ditur qëndrimin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut lidhur me standardin e gjuhës shqipe se shqiptarët e këtyre trevave, para 50 vjetëve, ashtu si edhe të gjithë shqiptarët e tjerë, njësimin e gjuhës shqipe e pritën dhe e pranuan me entuziazëm. Ishin edhe pjesëmarrës (Petro Janura, Remzi Nesimi dhe Sefedin Sulejmani) në këtë ngjarje të rëndësishme për kombin tonë.

Për gjithë këto vite, nga njësimi e deri më sot, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut standardin e shqipes e çmojnë si një nga vlerat më të mëdha gjithëkombëtare dhe prandaj standardi nuk u kontestua asnjëherë as nga gjuhëtarët, as nga intelektualët dhe as nga masat e gjera, jo sepse e përvetësojmë dhe e zbatojmë lehtë apo sepse e idealizojmë, por sepse jemi të vetëdijshëm për rolin e tij gjuhësor dhe jashtëgjuhësor.

Literatura e shfrytëzuar:

ASHSH, IGJL, (1973). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë.

Bajrami, Arsim, (2011). *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, Prishtinë.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 nëntor 1991 (me amendamentet kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, (“Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr.7, të datës 14.1.2019).

Çeliku, Mehmet, *Çështje të shqipes standarde*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2006.

Ibrahimi, Mustafa & SULEJMANI, Berton, (2016). “*Gjuha e firmave dhe mbishkrimet publike në qytetin e Shkupit*”, Shkup.

Ibrahimi, Zeqirija, (2021). *Politikat gjuhësore europiane në përfaqje me politikën gjuhësore në RMV*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup “*Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*”, f. 154-168, Shkup.

Ismajli, Rexhep, (1998). *Në gjuhë dhe për gjuhë*, “Dukagjini”, Pejë.

Krasniqi, Haxhi (1983). *T'i shkruajmë drejt firmat nëpër institucionet e sektorit shoqëror dhe në shitoret private*. Në “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, Prishtinë.

Munishi, Shkumbin, (2013). *Probleme të shqipes standarde në Kosovë*, ZeroPrint, Prishtinë.

Rugova, Bardh, (2021). *Ideologjia e gabimit gjuhësor*, ASHAK, Prishtinë.

Sulejmani, Berton, (2021). *Toponimia shqiptare në tabelat rrugore në Maqedoninë e Veriut*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare

mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup “*Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*”, f. 58-61, Shkup.

Sulejmani, Berton & Durmishi, Izmit, (2022). *Arritjet dhe problemet e zbatimit të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore dhe private të Maqedonisë së Veriut*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare, Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan – arritje dhe perspektiva, f. 61 – 75, Korçë.

Shkurtaj, Gjovalin (2003). *Sociolinguistikë*. Tiranë.

Zejneli, Jusuf, (2021). *Sfidat e Zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup “*Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*”, f. 239-252, Shkup.

Dokumente dhe vegëza interneti:

Службен весник на Федерална Единица Македонија, бр. 1, 1945.

Попис на населението, домаќинствата и становите во Република Македонија, 2002, книга X.

https://sq.wikipedia.org/wiki/Ballkani_Per%C3%ABndimor

Dr. Ardian DOKA
Universiteti i Tiranës

SHQIPJA STANDARDE MES JAKOBINIZMIT DHE LIBERALIZMIT GJUHËSOR

Shteti shqiptar i pasluftës së dytë botërore e shfaqti shpejt parapëlqimin e vet në punë të gjuhës. Në emisionin e parë të pullave postare, hedhur në qarkullim që në nëntor të vitit 1945, mbishkrimet e njohura *Posta Shqiptare* dhe *Postat Shqiptare*, të cilat mund t'i kishin shërbyer fare mirë edhe regjimit të ri, u zëvendësuan me *Qeveria Demokratike e Shqipnis*. Dy muaj më vonë, pas shpalljes së Republikës më 11 janar 1946, pullat ekzistuese do të mbishtypeshin me mbishkrimin *Republika Popullore e Shqipërisë* dhe me çmimin në lek. Më vonë do të qarkullonin emisione të tjera pullash postare me të njëjtin mbishkrim deri më 1976, vit në të cilin, me miratimin e kushtetutës së re, Shqipëria do të shndërrohej në një republikë popullore socialiste.

Në kartëmonedhat e para të emetuara nga qeveria e Hoxhës, në vitin 1947, mbishkrimi *Banka Kombëtare e Shqipnisë* u ndryshua në *Banka e Shtetit Shqiptar* (ngaqë edhe institucioni u ripagëzua ashtu), ndërsa te diçiturat me të cilat pajiseshin kartëmonedhat, siç pati vënë re njëzet vjet më parë Gianni Belluscio¹, në vend të formave geqe të deriatëhershme: *Të pagueshëme* në të pame pruesit** dhe *Ligji dënon fabrikatorët dhe shpërndarësit* e biletave të fallsifikueme* hasen gjegjësisht format toske *I paguhen prurësit me të parë dhe Ligja* dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të*

¹ Shih Gianni Belluscio, *Drejtime të politikës gjuhësore të monarkisë dhe të republikës në dokumente zyrtare të shtetit shqiptar (Kartëmonedhat dhe pullat postare)*, Gjuha Jonë, 1-2, 2002, ff. 66-76.

* Të vihet re përdorimi i *ë*-së mbështetëse. (Shënimi im. A.D.).

* Të vihet re përdorimi i zanores *-ë* me vlerën e një shenje diakritike, për të treguar gjatësinë e zanores së theksuar. (Shënimi im. A.D.).

* Të vihet re përdorimi i zanores *-ë* me vlerën e një shenje diakritike, për të treguar gjatësinë e zanores së theksuar. (Shënimi im. A.D.).

* Toskërishtja e ka këtë emër të gjinisë femërore, *ligjë/a*, ndërsa gegërishtja e ka të gjinisë mashkullore *ligji/i*. Në të folmet arbëreshe edhe sot haset ndërtimi *ke ligjë* me kuptimin 'ke të drejtë'. (Shënimi im. A.D.).

falsifikuara. Fjala është për dy kalke nga italishtja; i pari, që vjen prej *Pagabili a vista al portatore*, na thotë se prurësi, zotëruesi i kartëmonedhës, mund ta paraqiste atë në bankë dhe të merrte menjëherë në këmbim vlerën e saj të vërtetë në ar ose argjend, ndërsa i dyti, i cili vjen prej *La legge punisce i fabbricatori e gli spacciatori di biglietti falsi*, paralajmëronte se ata që prodhonin e shpërndanin kartëmonedha false do të dënoheshin nga ligji, ndonëse për ne nuk ka qenë e lehtë ta kuptonim kësisoj, meqë shqipja, ndryshe nga italishtja, nuk e ka fjalën biletë edhe me kuptimin kartëmonedhë. Në një kartëmonedhë njëfrangëshe, të emetuar në maj të vitit 1924, prej Bashkisë së Vlorës, i kam gjetur diçiturat e mësipërme me trajtat *Paguhet me t'u paraqitur dhe Falsifikonjësit dënohen pas ligjit*. Por, po aty nuk mungon as mbishkrimi *Sigurohet me pasunit' e pa tundeshme* të Bashkisë*. Siç mund të shihet, tek i njëjti dokument bashkëjetojnë format gjuhësore toske me ato gege, çka dëshmon jo vetëm për liberalizmin gjuhësor që karakterizonte shqipen e shkruar në dhjetëvjetëshat e parë të shekullit XX, por edhe për ndikimin që kishte nisur të ushtronte 'elbasanishtja e Komisisë', edhe ndër përdoruesit toskë të shqipes.

Këto hollësi, në dukje të parëndësishme, meqë "... duhet thënë se kush përdor kartëmonedha, monedha dhe pulla poste, pas kontaktit të parë vështirë se kthehet të lexojë dhe të vëzhgojë ç'është shkruar ose paraqitur mbi to"² tregojnë se shteti shqiptar i pasluftës nuk mënoi ta jetësonte zgjedhjen e tij. Nuk është e rastit që edhe Kushtetuta e vitit 1946 është shkruar në toskërishte, ndryshe nga Statuti Themeltar i Mbretnisë Shqiptare, i vitit 1929, i shkruar në gegërishte.

Në kushtet kur shqipja e komunikimit publik nisi të anonte nga toskërishtja letrare, ndërsa gegërishtja letrare po zhvendosej gjithnjë e më shumë në periferi të këtij komunikimi, ngjan e përlijtur dilema e gjuhëtarit elbasanas, Kostaq Cipos, ministër Arsimit në vitet 1945-1946, i cili në një autorecension për 'Gramatikën' e tij, të botuar nga Instituti i Shkencave, më

* Këtu na del një -e mbështetëse. Nëse nuk është fjala për një gabim njerëzor, kemi të bëjmë me luhatje që vinin nga ngulitja e pamjaftueshme e asaj që njëhej si normë. (Shënimi im. A.D.).

² Gianni Belluscio, *Drejtime të politikës gjuhësore të monarkisë dhe të republikës në dokumente zyrtare të shtetit shqiptar (Kartëmonedhat dhe pullat postale)*, Gjuha Jonë, 1-2, 2002, f. 73.

1949, shkruan: “... kur u ftuash nga Instituti i Shkencave të punoja një gramatikë... pyetja e parë që i bëra vetes sime ka qënë kjo: e në ç’ dialekt do ta punoj unë gramatikën?”³ Nuk ma do mendja që prof. Cipoja do të mëdyshej njësoj, nëse ftesën për të hartuar gramatikën do ta kishte marrë, pak kohë më parë, nga Instituti i Studimeve Shqiptare. Gjithsesi, e vërteta është se ai dilemën e vet e zgjidhi në favor të toskërishtes, ngaqë “toskërishtja që po zhvillohet në kryeqytet, do të fitojë tërë ç’i duhet për të shkrirë në njësi harmonike divergjencat që lindin nga zhvillimet gjuhësore.”⁴

Viti 1952 u shenjua prej dy konferencave që trajtuan problemet e formimit të shqipes së përbashkët letrare. Ndonëse në terma të rezultateve praktike ato nuk i dhanë frytet e pritura, arsye për të cilën vite më vonë i kanë cilësuar si të parakohshme,⁵ rëndësia e tyre nuk është e vogël. Ato treguan se në mendimin tonë gjuhësor qenë përvijuar dy rryma: njëra që kërkonte kodifikimin sa më shpejt të një letrarishteje me bazë toske, meqë, sipas përfaqësuesve të saj më në zë (Shuteriqit, Malëshovës, Xhuvanit) tashmë qenë pjekur kushtet për diçka të tillë; dhe tjetra që thoshte se duhet të prisnim ende për t’u lënë kohë koineve letrare të shqipes të ecnin edhe më në rrugën e konvergjencës. Tërheqin vëmendjen mendimet e shfaqura nga prof. Çabej, sipas të cilit “me formimin e shtetit shqiptar edhe gjuha shqipe ka marrë dhe ka për të marrë edhe më shumë një zhvillim tjetër, një zhvillim konvergjent të dialektevet. Dhe kjo rrugë duhet të ndiqet, sepse një shtet unitar nuk mund të kuptohet pa një gjuhë unitare. Këtu s’e kam fjalën për një gjuhë letrare të vetme, sepse shkrimtarët mund të vazhdojnë të shkruajnë në dialektin e tyre, por është puna për një gjuhë n’administratë, nëpër tekstet shkollore e tjerë.”⁶ Mandej ai e vë gishtin në plagë kur thotë: “Sa kohë që problemi i zhvillimit të një gjuhe të përbashkët është i lidhur me punën e të dy dialektevet, unë e

³ Cituar sipas Emil Lafes, në *Nga liberalizmi gjuhësor te shqipja standarde*, ligjeratë e mbajtur në Konferencën e mësuesve të gjuhës amtare shqipe, 15-16 maj 2007, Landskronë, Suedi.

⁴ Cituar sipas Emil Lafes, në *Nga liberalizmi gjuhësor te shqipja standarde*, ligjeratë e mbajtur në Konferencën e mësuesve të gjuhës amtare shqipe, 15-16 maj 2007, Landskronë, Suedi.

⁵ Shih Emil Lafe, *Nga liberalizmi gjuhësor te shqipja standarde*, ligjeratë e mbajtur në Konferencën e mësuesve të gjuhës amtare shqipe, 15-16 maj 2007, Landskronë, Suedi.

⁶ Eqrem Çabej, *Detyrat e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare e probleme të tjera*, Buletin për Shkencat Shoqërore IV, Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1952, f. 119.

shoh punën të pazgjidhshme, pa u studjuar më parë mirë dialektet e shqipes. Si do vemë ne për bazë njerin nga të dy dialektet, kur nuk janë studjuar mirë as njeri, as tjetri?”⁷ Për prof. Çabejin të shkruarit në dy variante të ndryshme dialektore nuk duhej parë si fatkeqësi, por si *diversité dans l’unité*.

Edhe pse u deshën njëzet vjet për të mbërritur te Kongresi i Drejtshkrimit, dhe koha i dha pjesërisht të drejtë prof. Çabejit, lidhur me studimet që duheshin kryer për t’i çelur udhën njësimimit të njëmendët të shqipes së shkruar, prof. Kostallari nuk ngurron t’i etiketojë pikëpamjet e tij si ‘teori e pritjes’ dhe si ‘anakronizëm shkencor’⁸.

Konsulta e Prishtinës, e prillit të ’68-s, e cila miratoi projektin e rregullave të drejtshkrimit, hartuar që më 1967-n, shënon një hap të madh përpara në procesin e standardizimit të shqipes së shkruar. Me të, për shumëkënd, edhe për mua, shqipja letrare i kapërceu kufijtë e një koineje lokale për t’u shndërruar në një koine gjithëkombëtare. Slogani i njohur jakobin, *një territor, një shtet, një gjuhë*⁹, i cili në shqipe, për arsye të kuptueshme, mund përkthehej vetëm si *një komb, një gjuhë*, kumboi së pari në Prishtinë. Nga ana tjetër, kjo arritje i dha mundësi Enver Hoxhës të deklaronte, katër vjet para Kongresit të Drejtshkrimit, që “Shqipëria nuk është më ajo e para, – as ekonomia e saj, as kultura, as arësimi; as *gjuha*, as regjimi, as politika, as ideologjia.”^{10*}

Në vitin 1972 gjuhëtarëve shqiptarë u binte barra të përligjnin një zgjedhje që në të vërtetë qe bërë vite më parë. Për ta përmbushur këtë detyrë duhej paraqitur toskërishtja si akrolekt, ndërsa gegërishtja si basolekt. Lidhur me këtë prof. Kostallari shkruan: “Koineja letrare jugore e kishte zgjeruar edhe më tepër përhapjen e saj, ndër dy bashkëvariantet veriore ai i mesmi

⁷ Eqrem Çabej, *Detyrat e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare e probleme të tjera*, Buletin për Shkencat Shoqërore IV, Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1952, f. 119.

⁸ Shih Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, NISH “Mihal Duri”, Tiranë, 1973.

⁹ Vittorio Dell’ Aquila, Gabriele Iannàccaro, *La pianificazione linguistica*, Carocci editore, Roma, 2004, f. 35.

¹⁰ Enver Hoxha, *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë*, Tiranë, 1968, f. 37; cituar sipas Androkli Kostallarit, në *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, NISH “Mihal Duri”, Tiranë, 1973, f. 86.

* Korsivi është imi. A.D.

kishte arritur gjithashtu një rritje sasiore e cilësore të ndjeshme, ndërsa rrethi i veprimit i bashkëvariantit letrar veriperëndimor ose i së ashtuquajturës ‘shkodranishte letrare’ ishte ngushtuar aq shumë, sa edhe pushtuesit fashistë, me gjithë kërkesën e urdhrave katolike, që ishin një mbështetje e vjetër e tyre në Shqipëri, nuk pranuan ta përdornin si gjuhë themelore të organeve të tyre, por ju drejtuan kryesisht koinesë letrare jugore dhe variantit letrar verior të mesëm, duke shpresuar se kjo do t’ua lehtësonte përhapjen e ideve të tyre në të gjithë Shqipërinë.”¹¹ Prof. Xhuvani, njëri prej misëve korrespondentë të Komisionit, në vitin 1952 qe shprehur “... që nga formimi i Shtetit Shqiptar ase ma mirë që nga Kongresi i Lushnjës deri në kohët e vona, në shtyp zotnonte ma fort toskënishtja, kurse n’administratë, n’arësim, si në tekste shkollore, etj., etj. ... e kishte epërsinë gegënishtja. Madje gjatë regjimit fatzi të Zogut gegënishtja me epërsin e saj kishte marrë rrugën për t’u-ba si bazë e gjuhës së përbashkët letrare...”¹² Nga ana tjetër, prof. Ajeti më 1952 pati thënë se “përpjekja e disave me kërkue shqipen letrarishte në nëndialektin e Elbasanit ka përfundue pa dhanë ndonji rezultat të dobishëm, sepse në këtë dialekt nuk qe shkrue ndonji letërsi me vleftë”¹³.

E kjo ndodhte në debatin shkencor, ndërsa në praktikë “... më 1945 gegërishtja letrare filloi të hiqej nga shtypi, kurse më 1946 edhe nga librat shkollorë. Më 1951 Ministria e Arsimit mori vendimin që në klasat e para të shkollës fillore në Veri mësimi të bëhej në toskërisht. Po kjo vërtetohet edhe përmes pohimeve të bëra në Konferencën e vitit 1952 ku, ndër të tjera thuhej se me ndërhyrje nga lart u vendos që fjalorët, përkthimet marksiste-leniniste, tekstet, gjuha e administratës, e shtypit, e radios etj. të bëheshin në dialektin jugor.”¹⁴ Kësaj politike të re gjuhësore do t’i shërbente, pa dyshim, edhe përjashtimi i autorëve më të zëshëm gegë të paraluftës (Fishta, Koliqi, Arapi) nga historia e letërsisë shqipe, (pra, edhe nga librat e shkollës) me pretekstin

¹¹ Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, NISH Mihal Duri, Tiranë, 1973, f. 27.

¹² Cituar sipas Rexhep Ismajlit, në *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, ASHSH – ASHAK, Tiranë, 2005, f. 131.

¹³ Cituar sipas Rexhep Ismajlit, në *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, ASHSH – ASHAK, Tiranë, 2005, f. 90.

¹⁴ Bahri Beci, *Historia e standardizimit të shqipes, politikat e planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Shblsh e Re, Tiranë, 2010, ff. 174-175.

se kishin bashkëpunuar me pushtuesit, ose thjesht pse cilësoheshin shkrimtarë reaksionarë.

Në vitin 1974, me një vendim të Këshillit të Ministrave, u bë i detyrueshëm përdorimi i “drejtshkrimit të njësuar dhe i normave të gjuhës letrare kombëtare” në të gjitha botimet, aktet juridike e shkresat zyrtare dhe në veprimtarinë e institucioneve kulturore që kishin të bënin me formën e folur të gjuhës.

Në vazhden e përpjekjeve për të përligjur zgjedhjen e bërë ka disa syresh që meritojnë vëmendje të posaçme. E para ka të bëjë me kundrualësinë letrarishte toske e njësuar *versus* letrarishte gege e copëzuar. Lidhur me këtë prof. Beci thotë: “Në këto rrethana është e vështirë të përligjet pretendimi i përfaqësueseve të gjuhësisë zyrtare shqiptare të pasluftës mbi praninë e ‘një koineje letrare gjithëjugore me një bazë të gjerë’ dhe me ‘një nivel të lartë të njësimi’. Përkundrazi të dhënat nga gjuha e veprave të letërsisë artistike provojnë se deri në vitin 1944, në sistemin e toskërishtes letrare ishin përvijuar dy variante themelore të toskërishtes letrare, ai i Fra-shërllinjve dhe ai i Konicës.”¹⁵ Ndërsa pak më tutje shton: “Proza e Naimit bashkë me atë të Vretos, të Mitkos e të tjerëve shkrimtarë toskë të Rilindjes, shkruante Aleksandër Xhuvani, formon *toskërishten e vjetër*, kurse ajo e mbas kësaj periudhe formon *toskërishten e re...*”^{16*} E dyta ka të bëjë me fshehjen e bazës dialektore të standardit, gjë për të cilën prof. Kostallari është munduar jo pak. “Prerja horizontale e strukturës së gjuhës sonë letrare të sotme dëshmon se kjo nuk është ndërtuar mbi një bazë të ngushtë njëdialektore. Ndër të tjera ajo tregon se mendimi i shfaqur më përpara se gjuha letrare e sotme është toskërishtja letrare, e ngritur drejtpërdrejt në shkallën kombëtare, nuk i përgjigjet së vërtetës shkencore.”¹⁷ Dhe, nga ana tjetër, “... gjuha letrare kombëtare shqipe është formuar e po përfundon kristalizimin e

¹⁵ Bahri Beci, *Mbi disa pikëpamje për shqipen e shkruar*, ligjëratë e mbajtur në Konferencën e mësuesve të gjuhës amtare shqipe, 15-16 maj 2007, Landskronë, Suedi.

¹⁶ Cituar sipas Bahri Becit në *Mbi disa pikëpamje për shqipen e shkruar*, ligjëratë e mbajtur në Konferencën e mësuesve të gjuhës amtare shqipe, 15-16 maj 2007, Landskronë, Suedi.

* Kursivi është imi. A.D.

¹⁷ Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, NISH Mihal Duri, Tiranë, 1973, ff. 41-42.

saj si një koine letrare *sui generis*, e cila ngërthen në strukturën e saj elementet themelore të përbashkëta të shqipes dhe elemente të rëndësishme dalluese të të dy dialekteve, të thithura nga ish-variantet letrare ose drejtpërdrejt nga dialektet në raporte herë të barasvlershme herë jo të barasvlershme.”¹⁸ E treta ka të bëjë me atë që prof. Kostallari e quan prirje, kurse për mua përbën *parimin drejtues*¹⁹ të normës së sotme, *të ruhet sa më e plotë struktura morfologjike dhe fjalëformuese e fjalës shqipe*, i cili duhet dalluar nga *parimet operative* (parimi fonetik, morfologjik, historik e simbolik). Pesha specifike e *parimeve operative*, e kuptuar si numër zgjidhjesh drejtshkrimore, mund të ndryshojë me kalimin e kohës, pa e rrezikuar funksionimin e normës, ndërsa cenimi i *parimit drejtues* e vë në pikëpyetje ekzistencën e saj. Ja ç’shkruan prof. Kostallari lidhur me ‘prirjen’ e lartpërmendur: “Duke u kristalizuar në vijën e bashkëveprimit ndër dialektor, sistemi fonetik i shqipes së sotme letare e ka thelluar edhe më tej një prirje shumë të rëndësishme, që u duk e çeli rrugë që gjatë Rilindjes – struktura fonetike e marrë në kuptimin e saj më të gjerë, jo vetëm të mos e errësojë, por ta ruajë sa më të qartë strukturën morfologjike-fjalëformuese, pra motivimin semantik të fjalës.”²⁰

Tashmë ka fituar terren teza sipas së cilës standardizimi bazohet në “përzgjedhjen midis mundësive izofunkionale” të cilat, megjithëse janë identike nga pikëpamja sistemore, prapëseprapë “kanë vlera të ndryshme simptomatike.”²¹ Ecuria e këtij procesi, veçanërisht për sa i takon zgjedhjes e pranimit, edhe në rastin e shqipes, tregon se janë vlerat e ndryshme simptomatike (ose simbolike, po të duam) të cilat ne si përdorues ua veshim varianteve të repertorit, ato që kanë në dorë fatin e gjithë procesit. Jam prej atyre që besojnë se nuk ka variant gjuhësor ‘të mirë’ ose ‘të keq’.²² Nga kjo

¹⁸ Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, NISH Mihal Duri, Tiranë, 1973, f. 42.

¹⁹ Shih Gian Luigi Beccaria (a cura di), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Einaudi, Vicenza, 2004, f. 785.

²⁰ Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, NISH Mihal Duri, Tiranë, 1973, f. 35.

²¹ José Pedro Rona, *A structural view of sociolinguistics*, cituar sipas Janet Byron-it, në *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera*, Dituria, Tiranë, 2012, f. 11.

²² Shih Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 1997.

pikëpamje cilido prej varianteve të një repertori mund të ngrihet në normë. Në të vërtetë, janë rrethanat jashtëgjuhësore ato që përcaktojnë ecurinë e procesit të standardizimit, i cili, siç dihet, ka fillim, por nuk ka fund. E kjo lidhet me faktin që gjuhët ndryshojnë (prandaj mund të ndryhojë edhe norma). Po të pranojmë se lidhja që bashkon shenjuesin me të shënuarin është arbitrare, d.m.th. e pamotivueshme me logjikë, atëherë nuk kemi pse kërkojmë një shenjues ‘më të mirë’ ose më ‘të keq’ për të njëjtin të shënuar. Për këtë arsye ndryshimi gjuhësor nuk ka karakter evolutiv dhe as devolutiv, çka e bën gjuhën dukuri shoqërore të një lloji të veçantë.

Bibliografia

- Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, NISH “Mihal Duri”, Tiranë, 1973.
- Bahri Beci, *Mbi disa pikëpamje për shqipen e shkruar*, ligjëratë e mbajtur në Konferencën e mësuesve të gjuhës amtare shqipe, 15-16 maj 2007, Landskronë, Suedi.
- Bahri Beci, *Historia e standardizimit të shqipes, politikat e planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Shblsh e Re, Tiranë, 2010.
- Emil Lafe, *Nga liberalizmi gjuhësor te shqipja standarde*, ligjëratë e mbajtur në Konferencën e mësuesve të gjuhës amtare shqipe, 15-16 maj 2007, Landskronë, Suedi.
- Eqrem Çabej, *Detyrat e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare e probleme të tjera*, Buletin për Shkencat Shoqërore IV, Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1952.
- Gian Luigi Beccaria (a cura di), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Einaudi, Vicenza, 2004.
- Gianni Belluscio, *Drejtime të politikës gjuhësore të monarkisë dhe të republikës në dokumente zyrtare të shtetit shqiptar (Kartëmonedhat dhe pullat postare)*, Gjuha Jonë, 1-2, 2002.
- Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 1997.
- Janet Byron, *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera*, Dituria, Tiranë, 2012.
- Rexhep Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, ASHSH – ASHAK, Tiranë, 2005.
- Vittorio Dell’ Aquila, Gabriele Iannàccaro, *La pianificazione linguistica*, Carocci editore, Roma, 2004.

Prof. Dr. Shkumbin MUNISHI

Anëtar korrespondent i ASHAK-ut

MBI NEVOJËN E MODERNIZIMIT TË GJUHËS SHQIPE

HYRJE

Në fillim dua të theksoj se ky punim imi është më shumë një punim i natyrës teorike dhe programatike dhe trajton një dimension të caktuar të planifikimit të gjuhës, atë të modernizimit, i cili këtu lidhet me çështjet aktuale të planifikimit të shqipes në përgjithësi.

Studimet dhe diskutimet teorike e sociolinguistike në fushën e planifikimit të gjuhës, të nisura aty nga mesi i viteve të gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar, kanë vënë në pah një gamë të gjerë dukurish dhe tiparesh të cilat e karakterizojnë procesin e planifikimit gjuhësor ose, thënë ndryshe, procesin e standardizimit të gjuhëve. Këto studime kanë arritur që procesin e planifikimit të gjuhës ta përshkruajnë brenda parametrave empirikë e shkencorë, duke e zhveshur atë nga cilësimet e ndryshme dhe nganjëherë të panevojshme ideologjike që i kanë shoqëruar përpjekjet për standardizimin e gjuhëve, varësisht prej etapave historike në të cilat janë formuar ato. Pikërisht kjo qasje e ndërtuar në këto studime ka mundësuar që problemet dhe çështjet që e shoqërojnë ecurinë e standardizimit të gjuhës të trajtohen pa ndonjë dozë të sentimentalizmit subjektiv, i cili mund të jetë i pranishëm në këto studime.

Përndryshe, lëmi i planifikimit të gjuhës si disiplinë sociolinguistike ka formësuar kuadrin e tij në saje të disa trajtimeve e diskutimeve thelbësore të shtruar në punimet e disa nga autorëve tashmë klasikë të kësaj fushe, siç janë: Ferguson (1959 dhe 1968), Sloka Ray (1963), Haugen (1966), Neustupny (1968 dhe 1974), Fishman (1968, 1974a, 1974b), Garvin (1974), Karam (1974), Tauli (1970, 1974), Cobarrubias (1983) etj. Në punimet e këtyre autorëve gjejmë të trajtuara shumë tipare, aspekte dhe etapa që shoqërojnë procesin e planifikimit gjuhësor dhe që vejnë në pah dimensionet sociolinguistike të tij. Për fat të keq, hiç përjashtimeve të rralla sikur të Byron

(1976) dhe Ismajli (1978, 1991), këto studime e pikëpamje të shprehura nga këta autorë themeltarë të fushës së planifikimit gjuhësor për dekada me radhë nuk janë marrë në konsideratë në kuadrin e studimeve në fushën e historisë së standardizimit të shqipes dhe të aspekteve të planifikimit të saj, madje në raste të caktuara janë hedhur poshtë *a priori* në saje të paragjytimeve ideologjike të kohës.

Pikëpamjet shprehura nga autorët e përmendur lidhur me dimensionet dhe tiparet specifike të aspekteve të planifikimit gjuhësor paraqesin pikënisje e udhërrëfim qendror për t'i trajtuar çështjet që lidhen me formimin e gjuhëve standarde dhe me aspektet e tjera sociolinguistike që lidhen me to. Në vazhdim do të përmendi vetëm disa nga këto pikëpamje që mendoj se janë me rëndësi për çështjet që dua t'i trajtoj.

Në fillim është me rëndësi të theksohet se procesi i planifikimit të gjuhës është kundruar si një proces që e përcjell zhvillimin e gjuhës dhe i cili e rregullon atë (Ferguson 1996). Vetë termi planifikim i gjuhës është sajuar nga Charles A. Ferguson, i cili ka dalluar tri dimensione të planifikimit të gjuhës d.m.th. grafizimin si zhvillim i gjuhës së shkruar, standardizimin si zhvillim i një norme që i mbizotëron dialektet regjionale dhe shoqërore dhe modernizimin si zhvillim i paralelizmit të mundësive shprehëse me gjuhët e tjera dhe zhvillimin e një game diskursesh. Aspekti i fundit, pra modernizimi, shihet si proces që e bën një gjuhë të barabartë me gjuhët e tjera dhe të përshtatshme si një medium komunikimi (Ferguson 1974). Në kuadër të procesit të modernizimit, Ferguson dallon dy aspekte: zgjerimin e leksikut të një gjuhe me fjalë e shprehje të domosdoshme për t'i rritur mundësitë e shprehjes së koncepteve të reja dhe zhvillimin e stileve dhe të formave të reja të diskurseve (Ferguson 1974). Në kuptim të zhvillimit të këtyre dimensioneve të zhvillimit gjuhësor, mund të thuhet se përderisa grafizimi dhe standardizimi mund të konsiderohen si zhvillime deri diku më statike dhe përmbyllëse, dimensionin e modernizimit të gjuhës është një ndër mekanizmat kryesorë sociolinguistikë që e bën planifikimin gjuhësor proces dinamik. Ndryshe, Cooper (1989: 153) e sqaron më tej konceptin e modernizimit, duke e përshkruar atë si një sërë procesesh që lejojnë një gjuhë të përmbushë funksione të reja komunikuese, ose funksione të reja për komunitetin, ose funksione të përmbushura më parë në atë komunitet nga një gjuhë tjetër. Për të përmbushur kërkesat e reja që i shtrohen, fjalori i një

gjuhe të modernizuar zgjerohet dhe përdoruesit e saj zhvillojnë stile, zhanre dhe regjistra të rinj. Për më tepër, në rrafshin e implikimeve shoqërore, modernizimi shihet si proces që është komplementar me format e tjera të modernizimit socio-kulturor brenda një bashkësie shoqërore të caktuar. Ky dimension i gjerë kuptimor dhe funksional është arsyeja kryesore që këtë aspekt të planifikimit të gjuhës ta trajtojmë në kuadër të zhvillimeve gjuhësore aktuale në shqipe.

Duhet përmendur se në rrafshin e trajtimit të pikëpamjeve për aspektet e planifikimit të gjuhës, po ashtu është me rëndësi të përmenden edhe etapat e planifikimit të gjuhës të përcaktuara nga Haugen (1966). Ky autor ka dalluar përzgjedhjen e normës, kodifikimin e formës, shtjellimin e stileve funksionale dhe pranimin (implementimin) si etapat kryesore të standardizimit të gjuhës. Dy etapat e para janë padyshim veprimtari standardizuese e normative, ndërkaq elaborimi është etapë që nënkupton procesin e shtjellimit të stileve funksionale, e cila është e komplementare me atë të modernizimit. Ky model i Haugenit lë përshtypjen e një modeli të shkallëzuar, por statik dhe duket se këtë fakt e ka parasysh Karam kur thekson se, ndërsa gjuha dhe kultura pësojnë ndryshime gjatë një periudhe kohore, cikli përsëritet ndërsa norma përsëri identifikohet, kodifikohet dhe shpërndahet (Karam 1974: 110). Prandaj, siç thekson D'souza (1986: 463), modernizimi është një proces, i cili është dinamik dhe është mënyra me të cilën një gjuhë bëhet e aftë për t'u përballur me situata të reja dhe për të zgjeruar rolet e saj funksionale duke zhvilluar fjalorin e nevojshëm në fusha si administrata, gjyqësori, gazetaria, transmetimi, arsimiti i lartë, kërkimi, etj.

Modernizimi si dimension i munguar në planifikimin e shqipes

Duke u nisur nga konceptet e përmendura sipër të autorëve Ferguson dhe Haugen, tani do t'i them disa fjalë për disa karakteristika të përgjithshme të studimeve lidhur me çështjet e shqipes standarde të cilat i gjejmë në literaturën linguistike në gjuhën shqipe. Nëse do të bënim një përshkrim të studimeve mbi shqipen standarde të kryera që nga fillimi i viteve të shtatëdhjeta të shekullit XX, që kur ka marrë fund një proces i standardizimit të shqipes, deri në ditët tona, do të vërejmë se pjesa me e madhe e diskutimeve lidhet me çështjet e përzgjedhjes së normës dhe të kodifikimit dhe me

rishqyrtimin eventual të këtyre dy proceseve. Përzgjedhja arbitrare e bazës dialektore të shqipes standarde nga elita politike dhe kulturore e kohës, përkatësisht miratimi dhe kontestimi i kësaj përzgjedhjeje mbeten çështje që asnjëherë nuk kanë gjetur as terren për kompromis, as ndonjë dozë pajtueshmërie në studimet albanistike edhe sot e gjithë ditën. Për më tepër, edhe diskutimet lidhur me normimin e shqipes dhe me karakteristikat strukturore e tipologjike të këtij procesi, të cilat do të duhej të ishin diskutime të natyrës krejtësisht shkencore, nuk kanë mundur t'u ikin konotacioneve politike dhe ideologjike. Përrjashtimet nga trajtimet e tilla kanë qenë të pakta si në rastet e Byron (1976) dhe Ismajli (1978, 1991) që u përmendën sipër. Pikërisht këto dy dimensione të etapave të planifikimit të gjuhës të përshkruara nga Haugen d.m.th. përzgjedhja dhe kodifikimi në një periudhë të caktuar gjatë viteve '70-'80 të shekullit XX janë anatemuar si tema diskutimi dhe më pas, pas viteve '90 të shekullit XX janë bërë objekt kundërshtish e mospajtimesh. Diskutimi i tyre ka marrë gjithmonë konotacione politike dhe ideologjike të papajtueshme. Në thelb, trajtimi i koncepteve të ndryshme lidhur me shqipen standarde është bërë brenda një kuadri të tepruar ideologjik (Munishi 2018) dhe mbi bazën e një qasjeje të plotë preskriptiviste (Rugova 2021).

Ky diskutim i ndërtuar mbi premisat e kundërshtive të papajtueshme, shpeshherë pa pasur asnjë mbështetje shkencore të shtjelluar, jo vetëm që ka ndikuar që gjuha standarde shqipe të kuptohet si një varietet rigjid e i mbyllur, por njëkohësisht i ka ngulfatur edhe hapësirat për diskutime të tjera që lidhen me aspektet e funksionalitetit dhe të zbatimit të gjuhës standarde. Për më tepër, aspekti i elaborimit të stileve funksionale, por edhe dimensionin e modernizimit të gjuhës, ka mbetur nën hijen e diskutimeve lidhur me çështjet kryesisht të natyrës historike të përzgjedhjes dhe të kodifikimit.

Prandaj, duke e parë dimensionin e modernizimit të gjuhës si një proces dinamik dhe gjithëpërfshirës të planifikimit gjuhësor, konsideroj se aktualisht shqipja ka nevojë që në suazat e planifikimit të saj, fokusi i përpjekjeve planifikuese të vihet pikërisht në dimensionin e modernizimit të shqipes. Ky dimension i planifikimit gjuhësor është mjeti i vetëm që do të mund të ndihmonte në rigjallërimin e procesit të planifikimit të shqipes në kontekstin e sotëm socio-kulturor, politik e ekonomik.

Duhet pasur parasysh se modernizimi i gjuhës është një proces të cilin e gjejmë edhe në të kaluarën në historinë e zhvillimit gjuhëve të ndryshme. Në këtë kuptim, Fishman thekson se të gjitha llojet e planifikimit të modernizimit përfshijnë një shfrytëzim të pjesshëm të së kaluarës si dhe një fabrikim/ krijim të pjesshëm të asaj të shkuare (Fishman 1974b: 89). Për shkak të karakterit dinamik dhe trysnive jashtëgjuhësore, gjuhët ndryshojnë dhe evoluojnë në kohë dhe në hapësirë. Për më tepër ndikimet e ndërsjella kulturore, përparimet teknike dhe teknologjike dhe ndryshimet shoqërore ndikojnë që në gjuhë të futen fjalë dhe shprehje të reja, prandaj gjuha është e detyruar të përshtatet dhe të zhvillohet me rrethanat e reja. Në këtë kuadër, i tërë ky evolucion është thelbësor për të siguruar që gjuha të mbetet e rëndësishme dhe e dobishme për folësit e saj. Në rastin e shqipes, një proces i njohur i modernizimit të shqipes ka ndodhur në periudhën e Rilindjes Kombëtare në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në periudhën e parë të shekullit XX. Ky proces është nisur nga rilindësit të cilët donin që shqipja t'i ikë ndikimit oriental dhe për këtë arsye ata promovuan një politikë gjuhësore puristë, e cila në esencë konsistonte në krijimin e fjalëve të reja nga rilindësit për të shprehur koncepte të cilat njiheshin pak nga popullata shqipfolëse. Në fillim të shekullit XX shprehja e koncepteve të reja në shqipe u bë kryesisht nëpërmjet futjes së huazimeve nga gjuhët neolatine.

Modernizimi i gjuhës zakonisht është i lidhur me ndryshimet socio-kulturore dhe ekonomike-politike që ndodhin në kohëra të caktuara. Në këtë kuptim nuk bën përjashtim as rasti i gjuhës shqipe. Ndryshimet e tilla shoqërore dhe kulturore pas vitit 1990 kanë qenë mjaft dinamike gjithandej nëpër botë, por edhe në hapësirat shqipfolëse në Ballkan. Pa dyshim, këto ndryshime kanë pasur dhe janë duke pasur ndikime në zhvillimet e shumta gjuhësore dhe sociolinguistike brenda gjuhës shqipe. Ky dinamizëm i proceseve sociolinguistike që po ndodh në shqipen e sotme dhe implikimet gjuhësore që ka ai është përshkruar gjerësisht nga Ismajli (2019). Mbi të gjitha, përshkrimet e zhvillimeve gjuhësore në hapësirat gjuhësore në Ballkan dhe në diasporë të bëra nga Ismajli mbështesin nevojën për ndërmarrjen e hapave të planifikimit gjuhësor për shqipen dhe varietetet e saj. Në këtë kuadër, një prej komponentëve të rëndësishëm të planifikimit aktual të shqipes do të ishte modernizimi.

Procesi i modernizimit të shqipes do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e saj, pasi do të ndikonte në përmirësimin e komunikimit dhe do t'i rriste kapacitetet shprehëse të gjuhës. Bota në të cilën jetojmë sot është bërë multikulturore dhe dinamika e komunikimit midis njerëzve anekënd botës është shtuar në përmasa të jashtëzakonshme. Në këtë kuadër, modernizimi i gjuhës do të ndikonte në konsolidimin e kuptimeve të fjalëve dhe shprehjeve të ndryshme, si dhe përkthyeshmërinë adekuate të tyre. Së këndejmi, komunikimi midis folësve të shqipes dhe me folës të huaj do të ishte me efektiv. Një zhvillim i tillë do të ishte i rëndësishëm për zhvillimet kulturore, ekonomike, politike, madje edhe për diplomacinë ndërkombëtare, pasi pengesat gjuhësore dhe pamundësia e shprehjes dhe e përputhjes së koncepteve të caktuara nga njëra gjuhë në tjetrën do të mund të kishin ndikim në negociata dhe komunikim.

Po ashtu, në rast se bëhet në mënyrë të planifikuar dhe nga ekspertët e gjuhës, modernizimi i gjuhës do të ishte një faktor i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit kulturor të shqipes, sepse gjuhët e kanë historinë dhe kulturën e tyre, e cila do të duhej të ruhej me çdo kusht. Prandaj, duke e bërë në njëfarë mënyre përditësimin dhe modernizimin e gjuhës ruhen rëndësia, funksionaliteti dhe tiparet kulturore që i ka gjuha. Procesi i modernizimit të gjuhës do të ndihmonte gjithashtu që të ruhej lidhja gjuhësore midis brezave, në kuptimin që brezat e ardhshëm do ta kishin më të lehtë ta kuptonin gjuhën e brezave paraprakë.

Megjithatë, procesi i modernizimit të gjuhës i ka problemet e veta, të cilat do të duhej të merreshin në konsideratë gjatë këtij procesi. Njëri nga problemet kryesore është ruajtja e vazhdimësisë së kuptimeve midis fjalëve dhe shprehjeve ekzistuese dhe atyre të reja. Kjo do të ndikonte që tiparet e gjuhës të ruhen dhe të përshtaten në përputhje me rrethanat e reja. Prandaj, do të ishte e arsyeshme që në procesin e modernizimit të gjuhës krijimi i neologjizmave dhe shprehjeve të reja të mbështetej në rifunksionalizimin e njësisive leksikore të marra nga varietetet e shqipes, në karakteristikat fjalëformues të shqipes dhe në rastet kur këto burime janë të pamjaftueshme, në huazimet eventuale nga gjuhët e tjera. Për t'u ndjekur kjo rrugë, modernizimi i shqipes do të duhej të ishte pjesë e një planifikimi të qëllimshëm dhe të vetëdijshëm, i cili do të udhëhiqej nga ekspertët e gjuhës. Në rast se nuk do të ndiqej një rrugë e tillë, atëherë futja e huazimeve nga gjuhët e tjera,

sidomos nga anglishtja, do të bëhej në mënyrë të pakontrolluar, siç ka ndodhur me shqipen edhe në të kaluarën.

Një sfidë tjetër e madhe e modernizimit të gjuhës është edhe ruajtja e balancit midis identitetit kulturor të gjuhës dhe nevojave që ajo t'u përshtatet ndryshimeve të reja kulturore dhe shoqërore, prandaj është me rëndësi që të ruhen dhe të vihen në pah vlerat utilitare të shqipes duke ruajtur rrënjët e saj kulturore dhe historike.

Modernizimi i gjuhës do të ndikonte edhe në aspekte të ndryshme të komunikimit, si p.sh. në fushën e arsimit dhe të teknologjisë. Futja e fjalëve dhe e shprehjeve të reja do të ndikonte në rritjen e kuptueshmërisë së koncepteve të reja nga nxënësit, ndërsa në rrafshin teknologjik modernizimi do të ndikonte në kuptimin dhe përshkrimin e proceseve dhe të pajisjeve të reja teknologjike, të cilat përveç se po e vërshtojnë tregun çdo ditë, po ndikojnë gjithashtu të gjitha format e komunikimit tonë.

Në përgjithësi, modernizimi i gjuhës shqipe si proces me rëndësi është thelbësor për sigurimin e komunikimit efektiv në botën moderne në të cilën po jetojmë. Përfitimet nga ky proces janë të shumta, pasi prekin përmirësimin e komunikimit, ruajtjen e identitetit kulturor dhe rritjen e qasjes në arsim dhe teknologji

Modernizimi i gjuhës shqipe tani është bërë domosdoshmëri e kohë sonë dhe nënkupton zhvillimin e shqipes në mënyrë që ajo përshtatet me zhvillimet në botën bashkëkohore. Ky proces nënkupton futjen e fjalëve dhe shprehjeve të reja, madje edhe formave sintaksore të reja. Për shkak të përparimeve teknologjike dhe duke qenë se procesin i globalizimit ecën tutje me përplot risi kulturore, modernizimi i gjuhës shqipe duhet të kundrohët si një aspekt thelbësor për t'ia përshtatur shqipen komunikimit në një shoqërinë moderne.

Ky proces i modernizimit të shqipes do t'i nënkuptonte së paku katër aspekte. E para, do të nënkuptonte zhvillimin e një politike gjuhësore konsensuale brenda shoqërisë shqiptare, e cila do të reflektonte kuadrin e ri ideologjik që sot është mbizotërues në hapësirat shqiptare dhe i cili është në përputhje me ideologjitë progresiste perëndimore. Modernizimi ideologjik do të ndikonte që çështjet e modernizimit të shqipes të mos kundroheshin nën prizmin e dyshimeve të ngulitura nga e kaluara.

Një politike e tillë do të duhej t'i përfshinte katër parime të përgjithshme, të cilat i vë në pah Neustupny (1968). Ato janë: zhvillimi, demokrazizimi, uniteti dhe raportet e jashtme, gjegjësisht kjo do të nënkuptonte që politika e re gjuhësore të garantonte se tiparet e saj do të ndikonin në zhvillimin gjuhësore, në krijimin e kushteve të barabarta për përdoruesit e gjuhës, në sigurimin e unitetit gjuhësor brenda bashkësisë shoqërore që e përdor gjuhën dhe në mënjanimin e pengesave në komunikim me të tjerët.

E dyta, modernizimi i shqipes do të duhej të ishte pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për planifikimin e shqipes. Kjo do nënkuptonte që ky proces do të duhej të udhëhiqej nga një organ ekspertësh të gjuhës, të cilët do ishin përgjegjës për të gjithë hapat që do të ndërmerreshin në këtë përpjekje dhe të cilët do ta kishin mbështetjen e plotë të institucioneve. Modernizimi i gjuhës edhe në të kaluarën ka qenë component i planifikimit gjuhësor. Në rastin e zhvillimeve të hebraishtes në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, modernizimi i hebraishtes jo vetëm që është bërë për t'i rritur kapacitetet shprehëse, por edhe për ta bërë atë një gjuhë të gjallë për komunikim të përditshëm (Cooper 1989). Ndërkaq, në rastin e kinezishtes dhe të varieteteve të saj, modernizimi ka qenë i lidhur ngusht me veprimtaritë standardizuese (Youguang 1986).

Aspekti tjetër i modernizimit të shqipes, i cili është dimension i karakteristik dhe qendror i këtij procesi, është pasurimi i formave gjuhësore, sidomos i leksikut, për t'i shprehur konceptet e reja të cilat është e nevojshme të shprehen me mjetet e shqipes ose me huazime. Nuk duhet harruar që ky dimension i modernizimit në shqipe e ka zanafillën që nga Rilindja Kombëtare. Nëpërmjet shtytjes së politikave puriste në raporte me huazimet nga gjuhët orientale dhe me përpjekjet për të krijuar fjalë të reja me mjetet e shqipes, por edhe duke huazuar fjalë kryesisht nga gjuhët neolatine, rilindësit bënë përpjekje që ishin në funksion të modernizimit të shqipes. Një prej gabimeve më të mëdha që është bërë në etapat e kaluara të planifikimit të shqipes pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë pikërisht kufizimi i fondit leksikor të Fjalorit shpjegues të shqipes të vitit 1954 brenda një baze dialektore. Kjo qasje ka ndikuar që leksikut të shqipes i është pamundësuar pasurimi me njësi nga varieteti i Veriut qoftë nëpërmjet prurjeve të drejtpërdrejta, qoftë nëpërmjet modeleve fjalëformuese që i ka ky varietet. Edhe në këtë rrafsh vërehet sheshazi mënyra krejtësisht e gabuar dhe politike

e kundrimit të gjuhës standarde si një varietet i mbyllur nga establishmenti komunist i kohës. Aktualisht, mendoj se ka një iluzion që konsiston në idenë se shqipja e ka vitalitetin e nevojshëm dhe mjetet e duhura leksiko-semantike për ta përcjellë procesin e zhvillimeve të koncepteve e dukurive të reja socio-kulturore e politike-ekonomike, të cilat do të duhej të shpreheshin me mjete gjuhësore përkatëse. Trysnia aq e madhe e zhvillimeve që lidhen me globalizimin, por edhe proceset e tjera të ndikimeve gjuhësore, janë faktorë që ndikojnë me shpejtësi të madhe në zhvillimet gjuhësore në shqipe, sidomos duke pasur në konsideratë realitetet e ndryshme socio-politike, kulturore e administrative në të cilat jetojnë shqiptarët në Ballkan dhe gjetkë në botë. Fjalori i tanishëm shpjegues i shqipes, i ribotuar më 2006, është dëshmia më e mirë se sa të pamjaftueshme janë kapacitetet leksikore të shqipes në rrethanat e tanishme. Aq më tepër, paralajmërimet e bëra publike në opinion për hartimin e një fjalori tjetër me një fond prej 160.000 fjalësh dëshmojnë se as këto nisma nuk e kanë mjaftueshmërinë e nevojshme që do të duhej të ishte e pranishme me rastin e ndërmarrjes së hapave të tillë që lidhen me modernizimin e fjalësit të shqipes. Si shembull po përmendim se në rastin përpjekjeve për modernizim në Indonezi, siç citon D'souza (1986), sipas Alisjahbana 1977 ka tashmë rreth 400,000 terma "modernë" në indonezishte. Prandaj, është e nevojshme të ndërmerren hapa për pasurimin e leksikut të shqipes me fjalë e shprehje të reja. Planifikimi i leksikut mund të bëhet sipas modaliteteve që i ka përkruar Tauli (1970). Në përgjithësi, ky pasurim mund të bëhet nëpërmjet krijimit të fjalëve të reja me mjetet fjalëformuese që ka shqipja standarde. Mënyra e dytë është marrja e fjalëve nga varietetet e tjera të shqipes, por edhe e mënyrave të fjalëformimit. Në këtë kontekst, duhet përmendur se mundësia që shqipja standarde të pasurohet nga e ashtuquajtura 'baza popullore' është përmendur edhe nga Kostallari (1990), ndonëse ai këtë mundësi eventuale e sheh vetëm brenda parametrave të rifunksionalizimit të njësive leksikore dialektore në gjuhën standarde. Së fundi, mënyra e tretë është huazimi nga gjuhët e tjera, sidomos në ato raste kur për konceptet e caktuara nuk mund të sajohen fjalë në dy mënyrat e përmendura paraprakisht.

Aspekti i katërt i modernizimit të gjuhës ka të bëjë me shtjellimin e stileve funksionale dhe të diskurseve përkatëse që do të shpreheshin me to.

Në gjithë këto dekada që kur funksionon si kod i përbashkët, shqipja standarde ka arritur që në masë të konsiderueshme t'i zhvillojë stilet e caktuara të shprehësisë. Por, meqë, siç thamë sipër, gjuha standarde është konceptuar si një kod i mbyllur, kjo ka ndikuar që marrja e burimeve gjuhësore nga varietetet e shqipes që do të ndikonte në zgjerimin e kapaciteteve të stileve funksionale të saj të jetë e kufizuar dhe rrjedhimisht pasurimi i stileve funksionale ka qenë i kufizuar. Edhe sa u përket stileve funksionale dhe moskonsolidimit të tyre, duhet përmendur konstatimet e Kostallarit sipas të cilit stilet gjuhësore, nuk janë bërë ende ndër ne objekt studimesh të thellura, por duke theksuar se mund të thuhet se tashmë në gjuhën tonë letrare dallohen qartë stili zyrtar, publicistik, shkencor dhe artistik (Kostallari 1983: 27). Naryrisht, ai sheh zhvillimin e stileve funksionale vetëm përbrenda strukturës së gjuhës standarde, por edhe aty vëren që nuk ka ndodhur shtjellimi i plotë. Por, për të ndodhur shtjellimi i mëtejshëm dhe zgjerimi i shprehësisë së stileve funksionale të shqipes, gjuha standarde duhet të hapet plotësisht ndaj prurjeve të varieteteve të tjera të shqipes. Këto prurje vetëm sa do t'i pasuronin mjetet shprehëse të shqipes.

Përfundime

Modernizimi i gjuhës është një aspekt shumë i rëndësishëm i planifikimit gjuhësor. Ky proces ndikon që gjuha ta ruajë vitalitetin e shprehësisë dhe vlerat e dobishmërisë në kohë dhe në hapësirë. Në qendër të procesit të modernizimit qëndron përpjekja e vetëdijshme shoqërore për të krijuar fjalë e shprehje të reja, në mënyrë që të shprehen konceptet e ndryshme socio-kulturore dhe teknologjike të krijuara rishtas. Rrjedhimisht, modernizimi ndikon në mënyrë thelbësore dhe domethënëse në përmirësimin e komunikimit dhe në ruajtjen e vlerave kulturore dhe shprehëse të gjuhës.

Zhvillimet aktuale që po ndodhin në botë në fushën e inovacioneve kulturor edhe teknologjike e kanë bërë të domosdoshme që të nisim përpjekjet planifikuese edhe për modernizimin e gjuhës shqipe. Trysnia e shfaqjes së koncepteve të reja ekonomike, kulturore e teknologjike që po shfaqen në një botë të mbizotëruar nga proceset e globalizimit dhe nga ndikimi i anglishtes, i kanë bërë të domosdoshme dhe të nevojshme përpjekjet për modernizimin e shqipes.

Procesi i modernizimit të shqipes do të duhej të ishte pjesë e një procesi të vazhdueshëm dhe të organizuar në mënyrë institucionale, i cili do të udhëhiqej nga ekspertët e gjuhës. Ky proces do të përfshinte miratimin e politikave gjuhësore të cilat do të kishin për qëllim nxitjen e aktiviteteve planifikuese për shqipen, duke përfshirë këtu edhe aktivitetet planifikuese për modernizimin e saj. Më tej, i tërë aktiviteti për modernizimin e shqipes do të duhej të zhvillohej si një aktivitet i planifikimit gjuhësor i udhëhequr nga ekspertët.

Këto dy kushte që u përmendën pak më parë do të mundësonin zhvillimin e aktivitetit kryesor në fushën e modernizimit të shqipes që do të nënkuptonte krijimin dhe futjen në shqipe të fjalëve dhe të shprehjeve të reja me të cilat do të shpreheshin konceptet e reja dhe të panjohura deri tani në shqipe. Zhvillimi i suksesshëm i këtij procesi do të ndikonte jo vetëm në përmirësimin e kuptueshmërisë dhe shprehjen e koncepteve të reja, por edhe në rritjen e vlerave socio-kulturore të shqipes, në përmirësimin e dimensioneve të caktuara didaktike-arsimore dhe në përcjelljen e përditësimeve në fushën e teknologjisë dhe shprehjen e tyre në gjuhën shqipe.

Krejt në fund, mendoj se në kuadër të këtij procesi duhet shtuar edhe një aspekt tjetër planifikues që ka të bëjë me shtjellimin e stileve funksionale të shqipes. Një zgjerim i tillë, do të krijonte hapësira të mëdha për përfshirjen dhe elaborimin e varieteteve të shqipes dhe kjo do të ndikonte në zgjerimin e kapaciteteve të shprehësisë të gjuhës shqipe, pra jo vetëm të varietetit standard, por edhe të varieteteve të tjera sociale e gjeografike.

Referencat

- Byron, J. L. (1976). *Selection Among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian*. Mouton The Hague. Paris.
- Cobarrubias, Juan (1983). *Language Planning: The State of the Art*. Progress in Language Planning. International Perspectives. Edited by Juan Cobarrubias and Joshua A. Fishman. Mouton Publishers. Berlin. New York. Amsterdam.
- D'souza, Jean (1986). *Language Modernization in a Sociolinguistic Area*. Anthropological Linguistics. Vol 28, No. 4. Winter. pp. 455-471.
- Ferguson, Charles A. (1959). Diglossia. *Word*. 15:2. pp. 325-340.
- Ferguson, Charles A. (1968). *Language Development*. Language Problems of Developing Nations. Edited by Joshua A. Fishman, Charles A. Ferguson, Jyotirindra Das Gupta. John Wiley & Sons, Inc. New York. London. Sydney. Toronto.

- Ferguson, Charles A. (1996). *Sociolinguistic Perspectives. Papers on language in society, 1959 – 1994*. Edited by Thom Huebner. Oxford University Press. New York. Oxford.
- Fishman, Joshua A. (1974a). *Language Planning and Language Planning Research: the State of the Art. Advances in Language Planning*. Edited by Joshua A. Fishman. Berlin, Boston: De Gruyter Mouton. pp. 15-34.
- Fishman, Joshua A. (1974b). *Language Modernization and Planning in Comparison with other Types of National Modernization and Planning. Advances in Language Planning*. Edited by Joshua A. Fishman, Berlin, Boston: De Gruyter Mouton. pp. 79-102.
- Garvin, Paul L. (1974). *Some Comments on Language Planning. Advances in Language planning*. Edited by Joshua A. Fishman. Berlin. Boston: De Gruyter Mouton. pp. 69-78.
- Haugen, Einar (1966). *Dialect, Language, Nation. American Anthropologist* 6. pp. 922- 935.
- Ismajli, Rexhep (1979). *Mbi normën gjuhësore. Përparimi. Prishtinë*
- Ismajli, Rexhep (1991). *Gjuhë dhe etni. Rilindja. Prishtinë*.
- Ismajli, Rexhep (2019). *Bashkësi gjuhësore, njësi, varietet. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Prishtinë*.
- Kostallari Androkli (1983). *Përsosja e sistemit të gjuhës sonë letrare kombëtare dhe tiparet themelore të normës së sotme. Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe (Simposium shkencor i mbajtur në Prishtinë më 15, 16 dhe 17 dhjetor 1980). Prishtinë*.
- Kostallari, Androkli (1990). *Baza popullore e gjuhës letrare shqipe dhe i ashtuquajtimi purizëm. Studime filologjike* 3. Tiranë.
- Munishi, Shkumbin (2018). *Language and Ideology in the Context of Language Policy of Albanian Language. Journal of Educational and Social Research. Volume 8: Issue 2. pp. 125-132*.
- Neustupný, J. V. (1968). *Some General Aspects of “Language” Problems and “Language” Policy in Developing Societies. Language Problems of Developing Nations*. Edited by Joshua. A Fishman, Charles A. Ferguson, Jyotirindra Das Gupta. John Wiley & Sons, Inc. New York. London. Sydney. Toronto.
- Neustupný, J. V. (1974). *Basic Types of Treatment of Language Problems. Advances in Language Planning*. Edited by Joshua A. Fishman, Berlin, Boston: De Gruyter Mouton. pp. 37-48.
- Ray, Punya Sloka (1963). *Language Standardization: Studies in Prescriptive Linguistics. (Janua Linguarum, Series Minor, 29). The Hague: Mouton and Co. pp. 160*.
- Rugova, Bardh (2021). *Ideologjia e gabimit gjuhësor. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Prishtinë*.
- Tauli, Valter (1970). *Vocabulary Planning. Babel* 16:1. pp. 21- 24.
- Tauli, Valter (1974). *The Theory of Language Planning. Advances in Language Planning*. Edited by Joshua A. Fishman. Berlin. Boston: De Gruyter Mouton. pp. 49-68.
- Youngang, Zhou (1986). *Modernization of the Chinese Language. International Journal of sociology of language* 59. pp. 7-23.

Aleksandër RUSAKOV

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Qendra e Botimeve Albanologjike dhe Enciklopedike

Maria MOROZOVA

Akademia e Shkencave e Rusisë, Instituti i Studimeve Linguistike

STRUKTURA FJALËFORMUESE E LEKSIKUT TË SHQIPES
(Rreth anotimit të korpusit elektronik të gjuhës shqipe)

1. Hyrje

Vendimet e Kongresit të drejtëshkrimit (1972) janë deri tani objekt diskutimi të gjerë si midis gjuhëtareve dhe në qarqe të gjera të shoqërisë shqiptare. Pa dashur të hyjmë në diskutime mund të vërejmë vetëm se stabilizimi i normës gjuhësore është një etapë e domosdoshme në zvillimin e çdo gjuhe standarde. Nga kjo pikëpamje Kongresi i drejtshkrimit ka qenë ngjarje, rëndësia e së cilës s'mund të jetë e mbivlerësuar. Përveç pasojeve të tjera stabilizimi i normave gjuhësore hapi një rrugë të gjerë për studimin e gjuhës shqipe me ndihmën e metodave moderne, përfshirë ato të gjuhësisë së korpusave.

Në këtë artikull paraqesim përpjekjen tonë për krijimin e anotimit fjalëformues për Korpusin elektronik të gjuhës shqipe. Krijimi i këtij anotimi synon të mundësojë studimin e mëtejshëm të strukturës fjalëformuese të leksikut të trashëguar dhe të huazimeve që u përkasin periudhave të ndryshme kohore.

2. *Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe*

Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe (angl. Albanian National Corpus, ANC, <http://albanian.web-corpora.net/>) u krijua në vitin 2012 nga albanologët prej Akademisë së Shkencave të Rusisë (Sankt-Petërburg) dhe specialistëve në fushën e gjuhësisë kompjuterike (Moskë) dhe vazhdon të zhvillohet këtë e tutje. Sot ai përmban më shumë se 30 milionë fjalë. Projekti synon përfaqësimin sa më të gjerë jo vetëm të teksteve të shkruara bashkëkohore të zhanreve të ndryshme, por edhe teksteve të krijuara në periudha

të ndryshme historike dhe teksteve dialektore që përfaqësojnë format joletrare të gjuhës së sotme shqipe. Deri më tani Korpusi plotësohej kryesisht me tekstet origjinale dhe të përkthyer në prozë (veprat letrare, joletrare, shtypi), të cilat pasqyrojnë gjuhën letrare shqipe që nga vitet 1970, dhe me tekstet poetike nga fillimi i shekullit XX (shih Tabelën 1).

Tabela 1. Përbërja e Korpusit elektronik të shqipes (ANC, dhjetor 2022)

Nënkorpus	Numri i fjalëve	% i Korpusit
Shtypi (Shqipëri, Kosovë, Maqedonia e Veriut)	23.4 mln	75.2%
Veprat joletrare (esetë dhe kujtimet, tekstet fetare, tekstet shkencore, tekstet zyrtare)	4.3 mln	13.8%
Veprat letrare	3.2 mln	10.3%

Tekstet e Korpusit pajisen me **anotimin morfologjik**, i cili përfshin shënimet, ose tag-ët që i atribuohen secilës forme të fjalës. Anotimi bëhet automatikisht dhe përfshin lematizimin, përcaktimin e pjesës së ligjëratës dhe anotimin e të gjitha veçorive fjalëndryshuese të fjalëve. 93.9% të fjalëve në Korpus kanë të paktën një analizë. Homonimia gramatikore nuk është zgjidhur, prandaj fjalët mund të kenë më shumë se një analizë pavarësisht nga konteksti real i përdorimit. Secili tekst ka dhe **anotimin metatekstual** që përmban titullin, emrin e autorit (ose titullin e gazetës, për shtypin), vitin e krijimit (ose datën e saktë, në rastin e gazetave) dhe zhanrin ose tipin e tekstit.

3. Anotimi fjalëformues: parime kryesore, dizajni i përgjithshëm.¹

Në zhvillimin e anotimit fjalëformues (si edhe në punën mbi Korpusin në përgjithësi) ne bazohemi në dy parime kryesore. Nga njëra anë ky anotim duhet të jetë adekuat nga pikëpamja e realitetit gjuhësor, dmth. të pasqyrojë sa më saktë sistemin fjalëformues të gjuhës shqipe. Nga ana tjetër ai duhet t'u përshtatet mundësive të përpunimit automatik. Në punën tonë ne përpiqemi të balancojmë njërin parim me tjetrin.

¹ Konceptimi i anotimit fjalëformues dhe etimologjik është përpiluar nga M. Morozova dhe A. Rusakov, fjalësi i Korpusit është anotuar nga M. Morozova.

Anotimi fjalëformues realizohet nga viti 2022 në fjalësin e Korpusit i cili përmban më shumë se 50 mijë fjalë dhe është në plotësim e sipër. Për përpilimin dhe plotësimin e fjalësit janë përdorur në etapa të ndryshme fjalori i L. Njumarkut (Newmark 1998) dhe botime të ndryshme të Fjalorit të shqipes së sotme prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Kostallari 1984, 2002). Anotimi fjalëformues bëhet paralelisht me anotimin “etimologjik” që ka për qëllim shënimin dhe studimin statistikor të leksikut të trashëguar, të huazimeve të ndryshme dhe të derivateve të këtyre fjalëve. Për këtë anotim përdoren si burime parësore fjalorët etimologjike të E. Çabejt (Çabej 1976–2017) e K. Topallit (Topalli 2017).

Fjalët e trashëguara pajisen me tagun *alb*. Për fjalët e huazuara përdoren tagët *lat, slav, greek, turk, rus, germ, hung, fr, it, en, rum, arum, rom, inter* – sipas origjinës së tyre. Disa pika janë për t’u theksuar në lidhje me përcaktimin e etimologjisë së fjalëve.

1) Përcaktohet vetëm burimi i drejtpërdrejtë i fjalës. P.sh. huazimet moderne me burim prej greqishtes, të cilat kanë depërtuar në gjuhën shqipe nëpërmjet gjuhëve neolatine, konsiderohen si romanizma të rinj (*rom, new*).

2) Specifika e punës mbi korpusin nuk na lejon të bëjmë vetë analizën etimologjike për secilin fjalë. Në shumicën dërrmuese të rasteve kemi ndjekur zgjidhjet etimologjike të paraqitura në fjalorët e Çabejt dhe të Topallit, duke përzgjedhur vetëm një etimologji më të arsyetuar në rast mospajtimi midis këtyre dy burimeve. P.sh. foljet si *dvar, davarit* i konsiderojmë të trashëguar në përputhje më (Topalli 2017: 361), ndërsa Çabej (2017 (1987): 176) i lidh me huazimet sllave si *daris, darovis, darovë*, ku mungojnë lidhjet kuptimore. Në rastet e pakta të huazimeve, të cilat sipas të dy autorëve mund të kenë hyrë nëpërmjet dy burimesh të ndryshme, japim etimologjitë alternative: *greek/it* për ndonjë fjalë si *aromë* që mund të rrjedh nga gr. e re *ἀρομα* në zonat e Jugut, ku kjo fjalë është më e përhapur, dhe nga it. *aroma* në Veri, ku përdoret më shumë *erë* në vend të saj (Topalli 2017: 122).

3) Shumë i veshtirë është përcaktimi i burimit etimologjik të huazimeve moderne. Në rastet kur burimet etimologjike përcaktojnë me pak a shumë siguri prejardhjen e saktë të këtyre fjalëve, shenojmë këtë prejardhje duke shtuar tagun *new*. Kështu p.sh. mund t’i dallojmë huazimet e vjetra dhe të reja nga italishtja, khs. fjalën *bandjerë* nga it. *bandiera* që dëshmohet së

pari te Buzuku (*it*) dhe huazimin e ri *arrestoj* nga *it. arrestare (it, new)*. Në rastet kur nuk dihet prejardhja e saktë e fjalës së re në gjuhën shqipe, ajo pajiset me tagun *inter* (ndërkombëtarizëm, internacionalizëm). P.sh. na u desh të bëjmë kështu në rastin neologjizmave të tilla si njësitë e matjes me prapashtesa e sindajshitesa ndërkombëtare dhe emërtimet internacionale të mineraleve (*barium*), si dhe në rastin e disa fjalëve të tjera (*bankomat*, fjalë ndërkombëtare me burim nga gjermanishtja). Duhet vënë re këtu se në rastin e fjalëve të shumta me prapashtesat *-ik*, *-ist*, *-an*, *-izëm* kemi ndjekur qasjen e Topallit i cili i interpreton shpeshherë si huazime të reja nga gjuhët romane. Shih. p.sh. fjalën *ide* (nga *it. idea*, *fr. idée*, me burim prej *gr. ιδέα*) dhe rrjedhojat e saj *ideal*, *idealist*, *idealizëm*, që mund të kenë huazuar nga ndonjë gjuhë romane (Topalli 2017: 651). Fjalët e tilla i kemi pajisur me tagët *rom*, *new*, pasi nuk dihet me saktësi nga ç'gjuhë romane vjen huazimi; tagun *inter* ose ndonjë etimologji tjetër që mungonte në burimet tona parësore nuk i kemi përdorur për arsyet e paraqitura në pikën 2.

Në fjalësin e Korpusit tërë informacioni fjalëformues dhe etimologjik jepet në rreshtin gramatikor të përshkrimit të lemma-s:

```

sqi_lexemes_N - Блокнот
Файл Правка Формат Вид Справка
trans_en: agar

-lexeme
lex: agave
stem: agava.|agave.|agavej.|agavj.
gramm: NOUN,f,inanim,bovr,rom,new
paradigm: 3b
paradigm: 5a
trans_en: agave

-lexeme
lex: agër
stem: agrë.|agër.|agr.
gramm: NOUN,m,anim,alb
paradigm: 1b
paradigm: 5a
trans_en: donkey

-lexeme
lex: agërinjë
stem: agërinja.|agërinjë.|agërinj.
gramm: NOUN,f,anim,alb,deriv
paradigm: 3a
paradigm: 5a
trans_en: female donkey
  
```

Стр 4544, стр 6 1 100% Windows (CRLF) UTF-8

4. Disa probleme të lidhura me anotimin fjalëformues

Gjatë anotimit fjalëformues kemi hasur disa probleme në lidhje me interpretimin e fjalëve të shqipes si fjalë të parme apo të prejardhura.

4.1. Problemi i konversionit

Siç dihet, në gjuhën shqipe kemi raste të shumta të konversionit, apo kalimit të fjalëve nga një pjesë të ligjëratës në një pjesë tjetër (shih trajtimin e hollësishëm të këtij problemi të shqipes në (Paçarizi 2015, 2017)). Shih, p.sh., fjalën *acar* që mund të përdoret si mbiemër, emër dhe ndajfolje:

aca'r

II§ *adj* **1** bitterly cold **2** [*Fig*] rough, cruel, nasty **3** icy pure, limpid; clean and neat (especially in dress) **4** [*Fig*] clever, sharp

III§ *nm* **1** bitter cold, frosty cold; wintry season, frosty period **2** [*Fig*] enervating fear **3** severity, roughness;

anger **4** [*Old*] steel = **çeli'k**

IV§ *adv* **1** purely; neatly **2** roughly, gruffly, harshly (Newmark 1998).

Dallimi i fjalës që mund të quhet e parme dhe i derivateve, apo fjalëve të motivuara prej saj në këtë rast do të ishte e dobishme, p.sh., për një studim statistikor të përhapjes së konversionit si mekanizëm në sistemin leksikor të shqipes. Megjithatë duhet të shënojmë se përcaktimi i drejtimit të procesit derivativ të konversionit është një problem i veçantë ku mund të ketë më shumë se një rrugë zgjidhjeje në rastin konkret dhe vështirë të zgjidhet vetëm njëra.

Prandaj në rastin e konversionit ne nuk pasqyrojmë dallimin i fjalëve të parme dhe të prejardhura në anotimin tonë fjalëformues. Kjo do të thotë se lemma-t *acar* do të kenë vetëm tagun “etimologjik” si *alb* (për leksikun e trashëguar), ndërsa derivatet normalisht kanë edhe tagun *deriv*. Kjo për arsye se, derisa të hiqet homonimia, pjesët e ndryshme të ligjëratës nuk mund të dallohen nga parser-i i Korpusit, d.m.th. çdo përdorim të trajtës si *acar* vazhdon të ketë më shumë se dy analiza:

-lexeme
 lex: acar
 stem: acar.
 gramm: A,alb
 paradigm: adj-3-1
 trans_en: bitterly cold

-lexeme
 lex: acar
 stem: acar.
 gramm: ADV,alb
 paradigm: unchangeable
 trans_en: purely; harshly

-lexeme
 lex: acartë
 stem: acartë.|acart.
 gramm: A,alb,deriv
 paradigm: adj-2-1
 trans_en: icy, frosty

lexeme
 lex: acar
 stem: acar.
 gramm: NOUN,m,inanim,alb
 paradigm: 1a
 trans_en: frosty cold

-lexeme
 lex: acaruar
 stem: acaruar.|acaruar.
 gramm: A,alb,deriv
 paradigm: adj-2-2
 trans_en: strained, inflamed

4.2. Fjalët e përngjitura dhe fjalët me sindajshtesa e ndajshtesa

Një problem tjetër lidhet me trajtimin e fjalëve të përngjitura (*afërmendsh, vetëmohim*) dhe fjalëve me sindajshtesa e ndajshtesa ndërkombëtare (shih Çepani 2005). Në interpretimin e këtyre fjalëve veprojmë sipas qasjes së propozuar në gramatikën e Njumarkut me bashkautorë (Newmark et al. 1982: 173 etj.). Njësitë si *super-*, *ultra-*, *a-* dhe *anti-* nga një anë, ashtu edhe *geo-*, *poli-*, *aero-*, *auto-*, *bio-* nga ana tjetër konsiderohen ndajshtesa dhe sindajshtesa të huaja të shqipes kur nuk bëjnë pjesë të fjalëve të huazuara si një e tërë, p.sh. *bibliotekë* (gr. *biblios* + *thēkē*, *agronomi* (gr. *agros* + *nomos*)):

-lexeme
 lex: agronomi
 stem: agronomi.
 gramm: NOUN,f,inanim,borr,it,new
 paradigm: 3d
 paradigm: 5b
 trans_en: agronomy

Rastet kur ato përdoren në fjalët që janë formime vetjake të shqipes (*automjet, superprodhim*) apo kalke nga gjuhët e ndryshme (*mikrovalë* < it. *microonda*) do të konsiderohen si fjalët e derivuara, por

jo të huazuara. Kjo për arsye se shumica e këtyre afikseve dhe afiksoideve të huazuara patjetër janë të ngulitura mirë në sistemin leksikor të shqipes, edhe për arsye se në qasjen tonë etimologjia e fjalës gjithmonë përcaktohet sipas burimit të rrënjës:

```
-lexeme
lex: automjet
stem: automjete.|automjet.
gramm: NOUN,mf,inanim,alb,deriv
paradigm: 1a
paradigm: 5a
trans_en: vehicle
```

Për sa u përket fjalëve si *afërndenjës* dhe *vetëmohim*, elementet *afër-* dhe *vetë-* mund të identifikohen përkatësisht si ndajfolje dhe si përemër vetor, pra fjalët në vëzhgim janë kompozita, apo fjalë të përbëra dhe anotohen si fjalët e derivuara (*deriv*):

```
-lexeme
lex: afërndenjës
stem: afërndenjës.|afërndenjës.
gramm: NOUN,m,anim,alb,deriv
paradigm: 1a
paradigm: 5c
trans_en: neighbour
```

Vlen përmendur se prejardhja e të dy përbërësve shënohet nëse ata kanë burime të ndryshme, si te *babamadh* ku *-madh* është i trashëguarm ndërsa *baba-* rrjedh prej turqishtes:

```
-lexeme
lex: babamadh
stem: babamadhë.|babamadh.
gramm: NOUN,m,anim,alb,borr,turk,deriv
paradigm: 1a
paradigm: 5a
trans_en: grandfather (on the father's side)
```

4.3. Trajtimi i fjalëve dhe ndajshitesave të huazuara

Për sa i përket trajtimit të fondit leksikor të huazuar, dalin disa probleme të tjera në lidhje me interpretimin e huazimeve të shumta të shqipes dhe derivateve të tyre, për shembull çështja e trajtimit të fjalëve me prapashtesat e origjinës turke *-xhi/-çi*, *-llëk* si huazime apo formime

të brendshme të shqipes. Çabej (1976a) shkruan për prapashtesën *-llëk/-llik/-lluk/-lik* që “[k]jo prapashtesë e turqishtes ka hyrë në shqipet sëpari në fjalë krejt turke, pastaj nëpërmes të tyre edhe në fjalë shqipe, duke formuar emra konkretë, abstraktë, etnika dhe emra vendi”. Duke u bazuar në trajtimin e tij, ne interpretojmë të gjitha emrat turqishte (me rrënjët turke) si huazimet, ndërsa emrat me rrënjët shqipe (apo jo-turke) duhet të interpretohen si derivatet e fjalëve të shqipes në të cilat përdoret ky afiks i huaj, por i ngulitur në sistemin fjalëformues të gjuhës shqipe:

-lexeme
lex: aga
stem: agallarë. |aga. |agaj.
gramm: NOUN, m, anim, borr, turk
paradigm: 1a
paradigm: 5a
trans_en: aga, Ottoman nobleman; rich man

-lexeme
lex: fshatar
stem: fshatarë. |fshatar.
gramm: NOUN, m, anim, alb, deriv
paradigm: 1a
paradigm: 5a
trans_en: villager, peasant

-lexeme
lex: agallëk
stem: agallëqe. |agallëk.
gramm: NOUN, mf, inanim, borr, turk
paradigm: 2a
paradigm: 5a
trans_en: the state of being or living like an aga

-lexeme
lex: fshatarllëk
stem: fshatarllëqe. |fshatarllëk.
gramm: NOUN, m, inanim, alb, deriv
paradigm: 2a
paradigm: 5a
trans_en: provinciality

Së fundi, do të përqendrohemi tek problemi i dallimit të ndërkom-bëtarizmave të huazuar dhe fjalëve të ngjashme të formuara brenda shqipes (*abstraksionizëm, akrobatik*, etj.). Ky problem ka rëndësi të veçantë për trajtimin e neologjizmave të shumta të shqipes të cilët kanë hyrë në përdorim në dhjetëvjetorët e fundit në fushën e teknologjisë, administrimit dhe në mjetet elektronike të informimit. Thelbi i problemit lidhet me faktin që gjatë shekujve të fundit në gjuhën shqipe kanë depërtuar shumë fjalë nga gjuhë të ndryshme bashkë me prapashtesat e tyre të cilat mund të kenë ngulitur mirë në sistemin e fjalëformimit të shqipes. Prandaj në trajtimin e neologjizmave me prapashtesa të ngjashme është vështirë të përcaktojmë a kemi të bëjmë me një fjalë që hyri në gjuhën shqipe si një e tërë ose me një formim vetjak të shqipes prej neologjizmi të huazuar. P.sh. prapashtesa *-ik* në fjalët shqipe, sipas Çabejt, mund të ketë burimin sllav, pra, është relativisht i vjetër (“Me qenë se fjalët shqipe me *-ik* janë të Veriut të Shqipërisë, e toponimet shumica janë prej burimi sllav, e me qenë se funksioni i prapashtesës *-ik* në

serbokroatishtet i afrohet atij të shqipes, mund të thuhet se kjo prapashtesë është e gurrës sllave” (Çabej 1976a: 238). Nga ana tjetër, prapashtesën (fonetikisht) të ngjashme kanë dhe gjuhët romake (it. *-ico*, fr. *-ique*), prandaj ndërkombëtarizmat e shumtë të shqipes që përmbajnë prapashtesën *-ik* mund të trajtohen si huazime apo si formime të brendshme. Siç u vu në dukje më sipër, në etimologjitë e neologjizmave ne bazohemi në fjalorin e Topallit i cili në shumicën e rasteve preferon qasjen e parë. Shih., p.sh. fjalët si *akrobat*, *akrobatik*:

AKROBÁT m. “gjimnast cirku, pehlivan”. Huazim i ri nga it. *acrobata*, me burim prej gr. ακροβάτης, me emrin άκρον “majë” dhe foljen βαίνω “eci” me kuptimin e parë “ai që ecën në majë të gishtave”. Me këtë fjalë lidhen: *akrobaci* nga it. *acrobazia*, *akrobatik* (*ushtrime akrobatike*) nga it. *acrobatico* (Topalli 2017: 86):

·lexeme

lex: akrobat

stem: akrobatë, |akrobat.

gramm: NOUN,m,anim,borr,it,new

paradigm: 1a

paradigm: 5a

trans_en: acrobat

-lexeme

lex: akrobatik

stem: akrobatik.

gramm: A,borr,it,new

paradigm: adj-3-2

trans_en: acrobatic

Zgjidhja e çështjes a mund të ketë formuar shqipja fjalën *akrobatik* nga huazimi *akrobat* me anë të prapashtesës së vjetër *-ik* kërkon një trajtim më të thellë, që shkon përtej detyrave parësore të punës mbi anotimin fjalëformues të Korpusit.

5. Konkluzione

Siç thamë më sipër, puna mbi anotimin fjalëformues të Korpusit elektronik të gjuhës shqipe është tani në vazhdim dhe, pa asnjë dyshim, anotimi mund të modifikohet dhe të thellohet. Bie fjala, për shembull, për krijimin e mundshme të mjeteve për kërkimin e fjalëve sipas temës së përbashkët (mund të jetë tema fjalëformuese që shërben si bazë a burim për formimin e fjalëve të reja ose, kur fjala e parme mungon në gjuhën e sotme, një temë që zgjidhet konvencionalisht për të mundësuar kërkimin). Ky lloj anotimi mund të jetë i dobishëm për studimin e disa problemeve të fjalëformimit të gjuhës shqipe.

Duhet të theksojmë se zvillimi i sistemit të anotimit të Korpusit nuk kufizohet me krijimin e anotimit fjalëformues dhe etimologjik. Në planet e mëtejshme janë përpillimi i *anotimit semantik* (klasifikimi sipas fushave semantike: taksonomia, mereologjia, topologjia, vlerësimi, etj.) dhe i *anotimit sintaksor* që do të lehtësojë veçanërisht kërkimin e trajtave analitike të foljeve.

Literaturë

- Albanian National Corpus (ANC). URL: <http://albanian.web-corpora.net/>
- Çabej E. 1976a. Prapashtesat // Çabej E. *Studime gjuhësore* III. Prishtinë: Rilindja. F. 191-302.
- Çabej E. 1976b. Studime etimologjike në fushë të shqipes [Etymological studies in Albanian]. Bleu 2: A–B. Tiranë: Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Çabej E. 1996. Studime etimologjike në fushë të shqipes [Etymological studies in Albanian]. Bleu 4: DH–J / përgat. për shtyp dhe pajisur me treguesit e fjalëve nga S. Mansaku dhe A. Omari. Tiranë: Akademia e Shkencave e R.Sh., Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Çabej E. 2002. Studime etimologjike në fushë të shqipes [Etymological studies in Albanian]. Bleu 6: N–RR / përgat. për botim S. Mansaku, A. Omari dhe B. Çabej. Tiranë: Akademia e Shkencave e R.Sh., Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Çabej E. 2006. Studime etimologjike në fushë të shqipes [Etymological studies in Albanian]. Bleu 7: S–ZH / përgat. për botim S. Mansaku, A. Omari dhe B. Çabej. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Çabej E. 2014. Studime etimologjike në fushë të shqipes [Etymological studies in Albanian]. Bleu 5: K–M / përg. për botim B. Çabej, A. Omari, S. Mansaku. Tiranë: Botime Çabej.
- Çabej E. 2017 (1987). Studime etimologjike në fushë të shqipes [Etymological studies in Albanian]. Bleu 3: C–D / përgat. S. Mansaku dhe A. Omari. Ribot. anastatik. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Çepani A. 2005. Rreth problemit të sindajshitesave në gjuhën shqipe // *Studime filologjike*. Nr. 3-4. F. 141-159.
- Kostallari A. (kryered.), Thomaj J., Samara M., Kole J. *Fjalor i shqipes së sotme*. Me rreth 34.000 fjalë. Tiranë, 1984.
- Kostallari A. (kryered.). *Fjalor i shqipes së sotme*. Botimi i dytë i ripunuar (me rreth 35.000 fjalë). Tiranë, 2002.
- Newmark L. 1998. *Oxford Albanian-English Dictionary*. Oxford: Oxford University Press.
- Newmark L., Hubbard Ph., Prifti P. 1982. *Standard Albanian. A Reference Grammar for Students*. Stanford: Stanford University Press.
- Paçarizi Rr. 2015. Konversioni në gjuhën shqipe. Prishtinë.
- Paçarizi Rr. 2017. Konversioni dhe tema fjalëformuese në gjuhën shqipe // *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Vëll. 36(1). F. 15–30.
- Topalli K. 2017. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Jozef.

Prof. dr. Tomorr PLANGARICA
Universiteti i Elbasanit – INALCO, Paris

MBI NEVOJËN E SHQYRTIMIT TË DUKURIVE LIGJËRIMORE TË SHQIPES SË SOTME PËRTEJ GJUHËSISË SË SISTEMIT, PËRMES KONCEPTVE E METODOLOGJIVE TË PËRFTUARA NË SHKENCAT E LIGJËRIMIT

Shqyrtimin e dukurive të ndryshme ligjërimore që formësojnë statusin e shqipes në etapën e tanishme e shohim të lidhur ngushtë me përdorimet e shqipes standarde, por edhe format e tjera të aktualizimit të gjuhës që mundësojnë komunikimin në situatat nga më të ndryshmet komunikative; të lidhur me subjektet folëse që po ashtu u përkasin bashkësive a komuniteteve të ndryshme diskursive; të lidhur me tematikat e larmishme që u përkasin sferave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, me përditshmërinë e individëve, me nevoja nga më të ndryshmet në stadin e sotëm të zhvillimeve të gjithanshme kulturore, shkencore, teknologjike, letrare etj., apo kërkesave aq të veçanta, ndërsa komunikimi ka fituar forma e mundësi shumë më të efektshme se disa dhjetëvjeçarë më parë. Është ky kontekst që na nxit të parashtrojmë nevojën për shqyrtime përtej *gjuhësisë së sistemit*, madje edhe përtej kufijve të *sociolinguistikës*, për të arritur në një hapësirë studimi ndërdisiplinare.

Nga ky pikëvështrim, shqipen standarde e parakuptojmë, pra, si një formë të aktualizimit të shqipes (apo varietet të përfutur ndërkohë në gjuhën shqipe), që përmbush funksione të gjera në procesin e komunikimit, e cila është një mënyrë e identifikimit të folësit të sotëm si pjesëtar i bashkësisë gjuhësore që ka pranuar tashmë këtë formë aktualizimi. E parakuptojmë si varietet që ka historinë e përvijimit e krijimit të tij, që bën jetën e tij në realitetin përdorimor të shqipes, i lidhur me situatat formale ose, më së shumti, i përdorur në komunikimin publik, që shfaqet si një formë aktualizimi e normëzuar në realitetin shkrimor të përdoruesve të shqipes, me një normë preskriptive të pasqyruar në fjalorë, gramatika a manuale të shumta meta-gjuhësore (i pranishëm edhe në formën e folur, sidomos në situatat formale,

me gjithë luhatjet dhe pasiguritë që e shoqërojnë); një varietet që prirret drejt zbatimit sa më të saktë të normës nëpërmjet një kontinuumi të përftuar nga përdorimet në distancë (të karakterizuara nga një konceptualizim stilistik, ku gjuhësisht zbatimi i normës preskriptive është i plotë) drejt një poli në skajin tjetër të aksit përdorimor të një komunikimi në atypëratyshmëri (ku nxitet një tjetër formë konceptualizimi stilistik, që në lidhje me normën preskriptive të të folurit ndjehet më i çliruar, duke i mëshuar faktorëve të tjerë në konceptualizim të mesazhit, që lidhen me ndjenjën, emocionin, intimitetin në komunikim etj). Pra një formë aktualizimi e gjuhës që ka vendosur lidhje me varietetet e tjera të shqipes, të përfuara sipas variacionit diatopik, diastratik, diafazik apo diakronik, dhe që gëzon përkrahjen njëherazi të pushtetit dhe të institucioneve shkencore, sociale e kulturore në hapësirën shqipfolëse të gjuhës shqipe.¹

Duke parakuptuar në emërtimin e kësaj konference (*Shqipja standarde sot*) shqyrtimin e gjendjes reale të përdorimit të shqipes në variantin e standardit në etapën e tanishme (pra, edhe aftësinë apo kompetencën komunikative² të përdoruesve të sotëm të standardit për të përmbushur të gjitha

¹ Parashtrimet në lidhje me çështjet e standardit në etapën e tanishme nga pikëveshtrimet e gjuhësisë variacioniste a sociolinguistikës variacioniste nuk janë në të njëjtën hulli me ata që kundërshtojnë standardin; në fakt, prania e varieteteve të tjera në repertorin gjuhësor të folësit merr kuptim veçse me referencë të varieteti i standardit, i formësuar ndërkohë, i pranuar dhe i nxënë nga folësit, të cilët i drejtohen atij natyrshëm duke vlerësuar në atë formë prestigjin social të bartur dhe plotësimin e nevojave për komunikim në sfera më të gjera të veprimtarisë shoqerore. Nga gjuhëtarët që i qasen shqyrtimit të gjuhës nga pikëveshtrimi i gjuhësisë variacioniste rëndom pohohet se “studimi i variacionit merr kuptim veçse në prani të ekzistencës së një norme të referencës, në kuptimin që njohja e variacionit të parakuptojë domosdoshmërisht një bashkëveprim të normave të larmishme përballë një norme prekriptive që do të duhej të ishte e përbashkët – dhe mbiemri *preskriptiv* ka në këtë rast një rëndësi të veçantë.” (shih Corinne Mence-Caster, *L’invisibilisation de la variation dans certaines théories linguistique*, në Archipelies, 8/2019, en ligne, konsultuar në 14 shtator 2022.)

² I përftuar nëpërmjet prurjeve shkencore të N. Chomsky-t në mendimin gjuhësor, nocioni i *kompetencës gjuhësore* ka evoluar drejt *kompetencës së komunikimit* (a kompetencës komunikative) me përcaktimin e D. Hymes-it e përpunimin e modeleve të ndryshme që zbërthenin këtë koncept, që përgjithësisht parakuptojnë si përbërës katër nënkompetenca: *kompetenca gjuhësore*, *kompetenca socialinguistike*, *kompetenca diskursive* dhe *kompetenca strategjike* a *vepruese*. Në *Aspect of the Theory of Syntax* të N. Chomsky-it (1965), kompetenca gjuhësore tregon aftësinë konjitive të lindur dhe universale të çdo subjekti

nevojat e komunikimit përmes gjuhës në përditshmërinë e tyre, në të gjitha aspektet, sociale e krijuese), na shfaqet natyrshëm pyetja: *në ç'aspekte duhet ngulmuar për të zgjeruar e bërë më funksionale qasjet shkencore që shpjegojnë veçantitë e këtij varietetit në etapën e tanishme dhe sa ndihmon mendimi gjuhësor i sotëm në formimin e kompetencës komunikative të folësit të sotëm të shqipes në një shoqëri tejet më të zhvilluar se ajo e katër a pesë dhjetëvjeçarëve më parë?*

Ndërsa *lënda* (praktikat reale ligjërimore në shqipe) të cilën rrekemi ta shndërrojmë në *objekt studimi* i është përgjigjur situatave të reja jashtë-gjuhësore që ndikojnë në përfitim e veçantive ligjërimore në një etapë të caktuar, a po përdoren konceptet, metodologjitë, dijet e përshtatshme për këtë brendi të re që shfaqin profile të caktuara të këtij objekti? A po krijohet në mendimin tonë gjuhësor një dije sistemore *përtej* gjuhësisë së sistemit që shqyrton dukuritë përdorimore të standardit në etapën e tanishme? A po ndihmon kjo dije plotësimin e thellimin e kërkimeve sociolinguistike (që shfaqet si fusha më e lëvruar në këtë lëmë të dijes në mendimin tonë gjuhësor), në debatin e duhur shkencor për të arritur më pranë së vërtetës në interpretime? Dhe a janë të mjaftueshme prurjet e sociolinguistikës, apo duhen plotësuar e bashkërenduar ato me prurjet dhe zgjidhjet edhe në fusha a disiplina të tjera të shkencave të ligjërimit?

Duke e kuptuar të tillë këtë marrëdhënie mes objektit të studimit dhe qasjeve metodologjike të shqyrtimit të tij, do të përpiqemi të sjellim përgjigje

njerëzor (“folës-dëgjues-ideal”) për të prodhuar dhe kuptuar një numër të pakufizuar frazash, [...] çka përbën faktorin parësor shpjegues të funksionimit të ligjërimit. [...] Kompetenca e komunikimit paraqet një hap më tej drejt një konceptimi të kontekstualizuar të aftësive (të grupeve dhe të individëve) të përfshira në komunikimin njerëzor. Ajo ka të bëjë me gjithçka që subjekti folës ka nevojë për të marrë pjesë në një veprimtari ligjërimore të lidhur ngushtë me një kontekst të caktuar: si të marrë pjesë në bashkëbisedim, cilit i drejtohet dhe në ç'mënyrë, kur duhet të flasë ose të heshtë, kur i duhet të marrë fjalën, si të kërkojë apo të marrë informacion, me ç'burime (gojore dhe të shkruara, gjuhësore dhe jogjuhësore), si të pyesë, të japë ndihmë ose jo etj.? [...] Sipas përkufizimit më përgjithësues që D. Hymes-i propozon më 1984, kjo kompetencë është një entitet që përmbledh të bashkuara në mënyrë dialektike katër klasat e elementeve përbërëse të “styleve” ose “mënyrave të të folurit (ways of speaking): mjetet e të folurit; ekonominë e të folurit; qëndrimet, vlerat, opinionet; mënyrën vetjake të të shprehurit, zërin e folësve (Shënimi është mbështetur në Patricia Lambert, *Compétence de communication*, në *Langage et société*, 2021/HS1 (Hors série), faqe 58).

për hipotezën e mëposhtme: *Shqyrtimi i veçantive dhe i problemeve që shfaq nxënia, përvetësimi e përdorimi i shqipes standarde në etapën e tanishme do të jetë më i plotë dhe më i vlefshëm, nëse qasjen tonë shkencore do ta zgjerojmë duke shkuar përtej gjuhësisë së sistemit, drejt së ashtuquajturës gjuhësi e jashtme, duke plotësuar e thelluar më tej pikëvështrimet e natyrës sociolinguistike, nëpërmjet një tërësie më të gjerë dijeje me natyrë ndërdisiplinare, përmes koncepteve, metodologjive dhe dijeve të përpunuara edhe në teoritë e enoncacionit, pragmatikën gjuhësore, gjuhësinë e diskursit dhe atë tekstore; më thjesht, duke u endur më të sigurt në hapësirat e gjera të shkencave të ligjërimit.*

E ngremë këtë hipotezë duke qenë të bindur se, nëse qasjet nëpërmjet dijeve të përpunuara në shkencat e ligjërimit nuk do të zhvendosen në skaje të interesimeve (ndërkohë që vendin qendror e kanë zënë kryesisht çështjet e normës gramatikore e drejtshkrimore), entitete dhe kategori të ndryshme që ndihmojnë shqyrtimin e përvetësimit dhe përdorimit të standardit do të merrnin vëmendjen e duhur dhe do të vlerësoheshin me përparësi; kështu, për shembull, krahas normës gjuhësore, do të shqyrtohej me të njëjtën vëmendje edhe ajo sociolinguistike, krahas kompetencës gjuhësore, edhe ajo komunikative, krahas normativizimit a përzgjedhjes leksikore, edhe përzgjedhja e disiplinimi i dijeve në lidhje me tipat e llojet e diskursit, krahas normës sintaksore, edhe ligjet e ngjizjes së diskursit e akteve të të folurit, krahas diskutimeve për variacionet e natyrës diatopike, diastratike e diafazike, edhe diskutimi i problematikës së variacionit diamezik etj. Pra, norma dhe variacioni do të vështroheshin në një dinamikë që do t'i përgjigjej vetë realitetit që ka përvijuar përdorimi i shqipes standarde në etapën e tanishme dhe prirjeve që nxisin zhvillimet në vijimësi të vetë gjuhës shqipe.³

Dhe nëse kjo problematikë do të përthithte shumë më tepër vëmendje dhe energji nga ana e studiuesve tanë që i kanë objekt të tyre studimi dukuritë

³ Pa iu shmangur kontekstit tonë të shqyrtimit, e vlen të theksojmë, gjithashtu, se shembujt e pranishëm në përvoja të ndryshme studimore në Europë e më gjerë, që lidhen me krijimin e varieteteve paralele të standardit në hapësira të caktuara folese të së njëjtës gjuhë apo përdorime të vernakularit në situata edhe përtej atyre joformale, janë shembuj që vijnë nga kontekste jo të ngjashme me ato të shqipes, në bashkësi gjuhësore të cilat karakterizohen nga dygjuhësia apo diferenca të theksuara të natyrës kulturore e të mentalitetit.

ligjërimore që shfaqen përgjatë përdorimit të gjuhës, e veçanërisht të standardit, edhe ndikimi në nxënien, përvetësimin dhe përdorimin e efektshëm të këtij varianti do të ishte më i madh dhe më funksional.

Në funksion të hipotezës së ngritur më lart, mendojmë që na vijnë në ndihmë disa argumente:

Së pari, nëse flasim për shqipen standarde në etapën e tanishme, faktori KOHË na detyron të nxjerrim në pah veçantitë me të cilat shfaqet përdorimi i standardit në një etapë të caktuar; ndërkohë që lidhur ngushtë me proceset përdorimore në atë etapë, do të duhet pashmangshëm të verifikohet përshtatshmëria e dijeve gjuhësore të përpunuara dhe të përcaktohen strategji të përshtatshme shqyrtimi për profilet e reja të shfaqura.

Përse nxitemi nga kjo premisë logjike që e vlerëson faktorin KOHË si nxitje për trajtim?

Dihet tashmë se bota shqiptare, si pasojë e zhvillimeve të dy-tre dhjetëvjeçarëve të fundit shfaqet edhe me një sërë veçantish të tjera në krahasim me një periudhë pararendëse, si pasojë e shndërrimeve të rëndësishme politike, ideologjike, madje edhe sociale e kulturore që ndodhën në tërë hapësirën e saj: dikur, me shumë më pak mundësi për të funksionuar si një e tërë, dhe tani, e prirur drejt zhvillimeve bashkëkohore, pa ato pengesa të periudhës së mëparshme. Për më tepër, teknologjitë e reja të komunikimit u kanë krijuar mundësi kontakti përmes gjuhës folësve të shqipes edhe në distanca shumë të largëta, dhe kjo e ka përforcuar nevojën për përdorimin sa më të njësuar të mjetit të komunikimit, nevojën për përdorimin e standardit (për pasojë, zotërimin dhe aftësimin për përdorimin e tij).

Por, njëherazi, të njëjtat kushte nxisin dhe mundësojnë edhe praninë e variacionit gjuhësor për nevoja të folësit a grupeve të folësve për të shprehur sa më plotë e më qartë individualitetin a veçantinë e tij/të tyre, me kërkesën e natyrshme që këto tipare të kuptohen e dallohen edhe nga mesazhmarrësi/-t (çka parakupton gjithashtu edhe njohjen e varianteve, kodeve e normave të tjera gjuhësore e socio-kulturore).

Shfaqen, pra, natyrshëm probleme të shumta që lidhen me normën/ -at, variacionin/variacionet, variantin a variantet e tjera gjuhësore, format e llojet e ndryshme të praktikave ligjërimore/diskurseve, tipat e teksteve, veçantitë që mesazhet tekstore fitojnë në formën e folur, por edhe të shkruar

etj. Në mënyrë më të thjeshtë mund të theksojmë se shfaqet një problematikë që lidhet me raportet e *të thënit si proces – sistemit gjuhësor – normës*, përkatësisht *normave - variacionit* - dhe, lidhur ngushtë me to e në ndihmë të shqyrtimit të brendisë së këtyre nocioneve, nevoja për dijet e përfutuara jo vetëm në gjuhësinë e njëjësive të sistemit, por sidomos të dijeve në shkencat e ligjërimit që ndriçojnë më qartë e në një spektër më të gjerë procesin e komunikimit dhe kompetencën ligjërimore.

Së dyti, baza konceptuale e shqyrtimit të dukurive përdorimore të gjuhës ka ndryshuar, me pasurimin e mendimit gjuhësor me kahet e studimit a gjuhësitë me qendër SUBJEKTIN FOLËS; për pasojë, problemet e përdorimit të gjuhës shfaqin edhe profile të tjera, përtej saktësisë në zbatimin e normës gramatikore; është një univers i tërë problemesh të vëna në dukje në dhjetëvjeçarët e fundit, të cilat shqyrtimet tona do të duhet t'i marrin parasysht.

Faktori KOHË e bën të detyrueshëm ndriçimin e kontekstit teorik të shqyrtimit të problematikës së standardit në etapën e tanishme, ndërsa në mendimin gjuhësor janë përvijuar një sërë qasjesh teorike që kanë shndërruar shumëçka në lidhje me objektin e gjuhësisë, sidomos qysh prej gjysmës së dytë të shekullit XX, ndërsa vëmendja u drejtua te *subjekti*, i përjashtuar deri në atë kohë si objekt studimi i gjuhësisë nga qasja strukturaliste, me një evoluim të shpejtë prej një subjekti ideal (N. Chomsky) drejt atij real, në kompetencën gjuhësore të të cilit ndikonin situatat e komunikimit (teoritë e enoncacionit, pragmatika gjuhësore, analiza e diskursit, sociolinguistika etj.); ndërsa përftoheshin modelet shpjeguese të standardizimit të gjuhëve e planifikimit gjuhësor (me E. Haugen-in, etj. pas viteve 1960, 1970); ndërsa, ndërkohë, u njiheshin përdorimeve gjuhësore një sërë funksionesh, përtej atyre paraqitës a informues; ndërsa vetë kuptimi i mesazheve nuk vërehej më si i parakuptuar para procesit të komunikimit, i bartur në njësitë gjuhësore që do ta formësonin atë, por pikërisht përgjatë komunikimit, si ndërtim i vijueshëm mes folësit dhe bashkëfolësit, përkatësisht thëniepërfutuesit (enonciateur) dhe bashkëthënësve (co-enonciataire) në atë proces komunikimi.

S'mund të pritej të ishin të pranishme këto qasje në shpjegimet teorike në lidhje me standardin në ato kohë të para kur flitej për gjuhën shqipe të përbashkët, gjuhën letrare kombëtare a shqipen standarde (ngaqë ato ishin në lindje e sipër edhe në Europë e SHBA, ose kërkonin kohën e duhur e të

mjaftueshme për t'u përvetësuar; por, edhe në rastet kur njiheshin, nuk ishte e lehtë të përdreshin në argumentime e parashtrime teorike, si pasojë e kufizimeve jashtëshkencore që impononte mjedisi ideologjik i atyre viteve, sidomos në Shqipëri). Mungesa e pranisë së tyre në mendimin tonë gjuhësor në atë kohë ndikoi për një lloj njëtrajtshmërie në shqyrtimin e problematikës së standardit, që vijoi më tej, si inerci, edhe më vonë, në një pjesë të trajtimeve tona: më së shumti të ngarkuara edhe me paragjykime ideologjike sesa shqetësim e dyshim shkencor.

Problemet e lidhura me zotërimin e përdorimin e suksesshëm të standardit, do të mund të dallohen, trajtohen e zgjidhen, nëse inkuadrohen e shqyrtohen edhe në kontekstin e kësaj gjuhësie tjetër, që arriti t'i kapërcejë kufijtë e distribucionalizmit e strukturalizmit, madje përmes një evoluimi të brendshëm në vijimësi, fazë pas faze, duke kaluar nga "Gjuhësia e UNË", ose "gjuhësia e subjektit folës" te "Gjuhësia e UNË dhe TP" ose "gjuhësia e komunikimit", drejt "Gjuhësisë së UNË – TP" ose "gjuhësisë së dialogëve", ku thënësi 'UNË' dhe bashkë-thënësi 'TI' hyjnë në ndërveprim; ku, në fakt, thënësi 'UNË' duhet të rregullojë a përshtasë të thënët e tij në funksion të bashkë-thënësit 'TI', dhe ku ky i fundit, nga ana e tij duhet të rregullohet a përshtatet me thënësin dhe mundet eventualisht të ndryshojë rolin e tij të bashkë-thënësit, për të marrë, nga ana e tij, rolin e thënësit".⁴ Dhe i gjithë ky proces është i kushtëzuar nga një sërë faktorësh gjuhësorë, por njëherazi edhe socialë, psikologjikë, kulturorë, të situatave, konteksteve të procesit të thënës etj.

Mbështetja më e plotë teorike në shpjegimin e dukurive të standardit, pozicionimi në shpjegime në prurjet e reja shkencore po mundëson tani që të riinterpretohen edhe më plotë tezat që kishin krijuar një lloj tradite në shpjegimet e dukurive, por pohimet e të cilave shfaqeshin më tepër në formën e klisheve, të tilla, si: standardi të jetë një sistem i hapur; standardi duhet të pasurohet prej bashkëveprimit me dialektet; edhe vetë dialektet të përfitojnë prej standardit etj.

Gjithsesi, në etapën e tanishme është përfutur një përvojë e vlefshme, e mbështetur në dijet e sotme të shkencave të ligjërimit, e cila duhet të

⁴ Shih më gjerë Jean-Pierre Desclés, Gaëlle Guibert, *Le dialogue, fonction première du langage, Analyse énonciative de textes*, Honoré Champion, Paris, 2011, faqe 98.

ndikojë më shumë në shqyrtimet e sotme, të zgjerohet e thellohet më tej. Gjuhëtarët që ranë më shpejt në kontakt me gjuhësinë variacioniste, socio-linguistikën variacioniste, stilistikën gjuhësore e pragmatikën gjuhësore e të diskursit kanë mundësuar që çështjet e përdorimit të shqipes standarde dhe formave të tjera të aktualizimit të gjuhës të ndriçohen e interpretohen përgjithësisht me ato metodologji dhe koncepte që përdoren në etapën e tanishme në mendimin gjuhësor në Europë dhe SHBA.

Por mbetet sfidë jo e lehtë për t'u përballur, zhvillimi i kompetencës komunikative të folësit, krahas asaj gjuhësore; është një sfidë që parakupton kapërcim të vështirësive në lidhje me nxënien, përdorimin sa më të mirë të shqipes standarde dhe zhvillimin e aftësisë së përzgjedhjeve gjuhësore prej varieteteve të tjera në përputhje me situatat e komunikimit. Përzgjedhja e mjeteve në repertorin gjuhësor të folësit/shkruesit kushtëzohet nga pasuria e atij repertori. Zotërimi në një masë të konsiderueshme i shqipes standarde, mund të mos jetë garanci suksesi në komunikim në situata të caktuara që kërkojnë e parakuptojnë edhe mjetet e tjera të repertorit të shqipes, pronë e varieteteve përtej shqipes standarde.

Shfaqet në këtë mënyrë nevoja për një qasje ndërdisiplinare për njohjen e gjendjes reale të përdorimit të shqipes në etapën e tanishme; për më tepër, në shqyrtimin e praktikave ligjërimore, ku produktet ligjërimore të shqyrtohen në aspektin gjuhësor, sociolinguistik, pragmatik, diskursiv etj.

Së treti, ndërsa e quajmë tejet të domosdoshëm shqyrtimin e praktikave ligjërimore të sotme në shqipe, materialin konkret për shqyrtim ende e kemi jo të bollshëm, por edhe gjuhësinë e korpusit ende të papërvijuar sa dhe si duhet.

Në lidhje me ndërtimin e korpusit të shqipes së sotme, ritmi është ende jo ai i duhuri, madje vërehet edhe një lloj pavëmendjeje ndaj punës së bërë ndërkohë nga individë apo ekipe studiuesish të kësaj fushe; pavëmendja shkaktohet, ndoshta, edhe nga lëvrimi i pamjaftueshëm i dijeve në kahe të caktuara të shkencave të ligjërimit në funksion të proceseve përdorimore të gjuhës, nëpërmjet të cilave do të ndikohej për ritme më të shpejta në regjistrimin e praktikave të larmishme ligjërimore dhe disiplinimin përmes kritërësh shkencore në mbledhje e shqyrtim.

Prania e një korpusi të shqipes së sotme, i ndërtuar sipas parimeve të përvijuara qartë tashmë në gjuhësinë e korpusit, ndoshta do të sillte qasje të tjera, tonat, do të ndikonte, pse jo, për shikim e rishikim tezash, opinionesh, qëndrimesh.

Në mungesë të këtij korpusi gjuhësor, për më tepër edhe të përvijimit të plotë të një gjuhësie të korpusit, parashtrimet tona mbeten, në të shumtën e herëve, të një natyre teorike e parashtruese, në pamundësi të analizave të mbështetura në të dhëna konkrete që nxjerrin në pah probleme të shqipes standarde sot. Për më tepër, me pasurimin e formave të komunikimit (edhe atij elektronik), kanë dalë në pah një sërë çështjesh të papranishme më parë, që lidhen me mediumet, ngjizjen e transmetimin e mesazheve, me gjinitë a llojet e diskursit, statusin e pjesëmarrësve në ndërkëmbimet ligjërimore etj.

Nga ana tjetër, ndërtimi i korpusit gjuhësor të shqipes së sotme do të na detyronte të zgjeronim e thellonim njohuritë apo interpretimet përmes koncepteve të përpunuara ndërkohë në shkencat e ligjërimit, hapësirë në të cilën përlindin vijimisht koncepte që mundësojnë vështrime në entitetet qoftë socio-ligjërimore, qoftë të natyrave të tjera gjuhësore: për shembull, prej bashkësisë gjuhësore, mund të shkojmë në atë të komunitetit a bashkësisë diskursive, prej kompetencës gjuhësore, mund të shkojmë gradualisht në kompetencën komunikative, duke parakuptuar si pjesë përbërëse edhe kompetencën sociolinguistike, edhe atë diskursive; prej procesit të të thënit, rimarrim e rikuptimësojmë konceptet diskurs, akt i të folurit, etj., etj.

Për më tepër, dijet e përfutuara në këto disiplina do të orientonin dhe ndihmonin në punën për krijimin e korpusit, në bërjen e regjistrimeve me synime të caktuara, në përzgjedhjen e subjekteve a bashkësive diskursive.

Së katërti, prurjet e sotme të mendimit tonë gjuhësor mundësojnë zgjerim të dijes edhe në hulli të tjera të saposhkelura a ende të pashkelura, veçse kërkohet vëmendje më e madhe ndaj së resë në kërkimin shkencor në këtë hapësirë të gjuhësisë.

Jemi të prirur ta shohim me entuziazëm situatën e shqyrtimeve tona në studimin e standardit, t'i konsiderojmë të natyrshme edhe polemikat, kundërqëndrimet, në përgjithësi debatin shkencor; në fund të fundit, "inteligjenca është zonë e furtunave", do të shpreheshim përmes (filozofit) Bernard

Levy-së. Por na duket se ngadalëson ritmet e zhvillimit mungesa e vëmendjes ndaj prurjeve të reja në këtë fushë dhe mungesa e nxitjes së atyre studiuesve që kanë guxuar të prirën e të shkelin në hulli të reja.

Kjo vjen si pasojë e “leximit” jo të njëjtë të këtyre prurjeve, ngaqë në mjedisin tonë shkencor ende nuk po arrihet që të përftohet *rezultantja* e dijeve të larmishme që vijnë nga shkolla të ndryshme gjuhësore, me të cilat studiuesit janë në kontakt dhe prej të cilave marrin më tepër mbështetje teorike në shqyrtime.⁵

Ka dije të cilat edhe pse të rëndësishme për t’u pranuar e përdorur nga një masë e gjerë specialistësh, por edhe përtej tyre (sidomos nga mësuesit e gjuhës dhe të letërsisë në cikle të ndryshme shkollimi) mbeten në komunikim të ngushtë ose thjesht si kureshti intelektual në mjedisin shkencor. Ndoshta ndikon veçantia e koncepteve të përdorura në to (domethënia dhe vlera e të cilave mund të kapen veçse në kontekstin më të gjerë të dijes sistimore në të cilën ato janë të pranishme); ndoshta disa prej atyre dijeve do të duhet t’i përcillen lexuesit të transpozuar në aspektin didaktik; por ndoshta, herë të tjera, ndikojnë edhe ndërlikueshmëria e dijeve dhe fluiditeti apo papërcaktueshmëria e nocioneve me të cilat operohet, ... apo edhe faktorë të tjerë. Gjithsesi, kjo mungesë në komunikimin e dijes krijon vonesa edhe në zgjidhjen e problemeve.

Na duket se një vonesë të tillë po shfaqin disa kahe të rëndësishme të shkencave të ligjërimit në mendimin tonë gjuhësor, qysh nga teoritë e enoncacionit të gjuhësia e analiza e diskursit, që për vendin që zënë sot në mendimin gjuhësor evropian e më gjerë meritojnë të bëhen më të pranishme edhe në shqyrtimet tona. Mungesa e trajtesave të mbështetura edhe në këto

⁵ Që të lexuarit të jetë ndërtues, do të duhet familjarizim me konceptet, kategoritë a dijet e fushës së caktuar. Diçka jo e lehtë, por që mundësohet me ndihmën e veprave që fitojnë vlerë të veçantë reference a të ashtuquajturave tekste konstituante/ zanafillore në lidhje me dijen përkatëse. Për problematikën që diskutojmë, këtë rol mund t’ia njohim prurjeve shkencore e më drejtpërdrejt veprës *Bashkësi gjuhësore, njësi, varietet*, Prishtinë, 2019, të Rexhep Ismajlit, botim i ASHAK-ut; apo prurjeve shkencore e më drejtpërdrejt veprës *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, me disa ribotime më tej, e Xhevat Lloshit; po ashtu në dobi të këtij leximi ndërtues e familjarizimi me konceptet, kategoritë e dijet në fushën e sociolinguistikës, veprës *Leksikon i termave të sociolinguistikës*, Prishtinë, 2020, me bashkautorë Rexhep Ismajli, Bardh Rugova, Shkumbin Munishi, botim i ASHAK-ut.

kahe të dijës gjuhësore ndikon në mosvlerësimin a keqvlërësimin (jo pak herë) edhe të parashtrimeve në fushën e sociolinguistikës, pragmatikës gjuhësore etj., edhe pse operohet me terma funksionalë të *kontinuumit në komunikim*, të *diamezisë*, *kompetencës sociolinguistike* apo asaj *diskursive*, *pasigurisë gjuhësore* etj., etj.

Së pesti, në hapësirën e shkencave të ligjërimit janë përpunuar koncepte që mundësojnë qëndrime më të drejta edhe në lidhje me përdorimin e standardit. Ato duhet të bëhen të njohura dhe vepruese në studim përmes shqyrtimit të gjendjes konkrete dhe të dhënave të vjela nga realiteti i sotëm i përdorimit të shqipes.

Siç theksuam, koncepte të tilla, si diskurs, komunitet diskursiv, kompetencë gjuhësore/ligjërimore e kompetencë komunikative, variacion diamezik (krahas diakronik, diastratik, diatopik e diafazik), që burojnë a përftohen nëpërmjet dijeve në sociolinguistikë, etnologjinë e të folurit apo analizën e diskursit, meritojnë një vend më të rëndësishëm në shqyrtimet e praktikave ligjërimore të folësve të shqipes së sotme. Brenda e nocioneve të tilla orienton më qartë në shqyrtimin e problematikës së standardit, e sidomos ndikon më shumë në nxitjen e studimeve që ndihmojnë në përvetësimin dhe përdorimin e gjuhës në situata nga më të larmishmet në të cilat ky varietet shfaqet i përdorur në ditët tona.

Le të marrim si shembull nevojën për përkujdesje më të madhe ndaj “kompetencës komunikative” të folësve të shqipes, ndërsa diskutojmë për nxënien, zotërimin e përdorimin e suksesshëm të standardit dhe formave të tjera të aktualizimit të shqipes.

Zgjerimi kuptimor i nocionit të kompetencës gjuhësore drejt asaj sociolinguistike e diskursive ndikon natyrshëm në qartësimin e qëndrimeve tona në procesin e përthithjes së njohurive dhe interpretimit të tyre në komunikimin e drejtpërdrejtë apo përmes të të lexuarit.

Ka disa arsye që na shtojnë të ngulmojmë në trajtimin e konceptit të “kompetencës komunikative” kur diskutohet për gjendjen e sotme të shqipes dhe përdorimin e standardit në komunikimin e sotëm publik ose jo. Janë arsye që nxiten nga vëzhgimet e drejtpërdrejta në ligjërimin e folur dhe atë të shkruar, nga folësit e zakonshëm apo ata publikë; por, më së shumti, edhe nga vëzhgimet në punët me shkrim të nxënësve në nivele të ndryshme shkollimi apo grupmosha të caktuara.

Nxitemi, gjithashtu, edhe nga prania jo aq sa duhet e këtij koncepti (dhe problematikës që lidhet me të) në mendimin tonë gjuhësor, çka ka krijuar një trajtim të shpërpjesëtuar në lidhje me pasqyrimin e çështjeve që lidhen me përvetësimin e sidomos përdorimin e standardit në etapën e tani-shme. I është kushtuar (me të drejtë) vëmendje përvetësimit të normës drejtshkrimore, problemeve që lidhen me normën fonetike e gramatikore; por, ndërkohë, kompetenca gjuhësore është vetëm njëri prej treguesve të kompetencës komunikative, pra jo e vetmja. Për më tepër, që për përvetësimin e kësaj norme janë shpenzuar e vijojnë të shpenzohen energji me tepri, duke lënë në skaje të shqyrtimit e interpretimit interesimet për kompetencën sociolinguistike e diskursive të shqipfolësve; ndërsa dimë, gjithashtu, që zotërimi i këtyre kompetencave ndihmohet shumë më pak ose aspak nga risitë në teknologjitë e reja, të cilat i vijnë në ndihmë kompesimit të mangësive të kompetencës gjuhësore të shkruesve përmes programeve e korrektorëve të ndryshëm automatikë të shkrimit edhe në gjuhën shqipe (në një të ardhme të afërt, shpresojmë, do t'i vijnë në ndihmë edhe më shumë).

Nuk themi të neglizhojmë kërkesat për përvetësimin e normës drejtshkrimore ose asaj gramatikore, përvetësim që paraqitet ende me shumë mangësi kur vërejmë punët me shkrim të nxënësve; por duhet të punojmë që të mënjanojmë edhe ato mangësi (po ashtu të shumta) që shfaqen në realitetin shkrimor (edhe më shumë në atë të folur), që vjen si pasojë e moskonceptimit në një gamë të gjerë pikërisht të kompetencës komunikative. Madje një situatë e tillë e paqartë në lidhje me normën komunikative ka shkaktuar edhe një sërë treguesish të tjerë të natyrës normative, siç janë mbikujdesja normative (duke rënë sërish në shmangie nga norma), pasiguria gjuhësore e lidhur ngushtë me të, mospërshtatja me situatat e komunikimit dhe përzgjedhja e pasuksesshme leksikore nga moskuptimi i situatave përkatëse; etj. etj.

Ligjërimit i shkruar s'mund të shqyrtohet vetëm nga përvetësimi i normave drejtshkrimore e gramatikore. Për më tepër, që ka zotërues shumë të mirë të normave të standardit (atyre në të shkruar), por jo të një kompetence komunikative në të njëjtat nivele. Dijet e sotme në shkencat e ligjerimit na drejtojnë në profile të tjera të ligjërimit të shkruar, ndërsa në mendimin gjuhësor drejtohet vëmendja në anën subjektive të folësit. Ndërkohë qasja thjesht strukturaliste mbetet e pamjaftueshme, dhe teoritë e enonciacionit, ato pragmatike, ato që lidhen me gjuhësinë e tekstit dhe të diskursit plotësojnë

pikërisht këtë hapësirë ende të pazënë; janë prurje shkencore që i kushtojnë kujdes të veçantë të thënit si proces dhe diskursit si entitet i formësuar nga bashkëveprimi i formave gjuhësore me faktorët e natyrës jashtëgjuhësore.

Qasja diskursive çon në një pikëvështrim të ndryshëm edhe në lidhje me problematikën e standardit, edhe në lidhje me kompetencën komunikative, e cila duhet të mundësojë dallimin e aftësimin për realizimin e akteve të ndryshme të të folurit, për situatat e ndryshme të komunikimit, për menyrat e ndryshme të organizimeve diskursive; dhe për ta formësuar këtë kompetencë komunikative, do të duhet të punojmë me koncepte përtej gjuhësisë së frazës, me dije ndërdisiplinare, ku qasjet sociolinguistike, pragmatike e diskursive dalin në pah më dukshëm.

Mendojmë që nuk është e udhës të presim që të përsoset përvetësimi i normës drejtshkrimore të të gjithë shqipfolësit, qoftë edhe të një brezi më të ri me ndikim të madh nga shkolla, e pastaj të angazhohemi në problemet e formësimit sa më të plotë të kompetencës së tyre komunikative.

Dhe nëse e gjykojmë që vërtet i duhet kushtuar vëmendje kompetencës komunikative dhe aftësisë për të përdorur standardin në përputhje me situatat, synimet, përmes një bashkëveprimi në diskurse e akte ligjërimore në fusha të ndryshme të veprimtarisë sociale, atëherë është e ngutshme që dijet e përpunuara në disiplinat e ndryshme të shkencave të ligjërimit, veçanërisht në gjuhësinë e diskursit, analizën e diskursit, pragmatikën diskursive, teorinë e enoncacionit etj. të mos mbeten në skajet e mendimit tonë gjuhësor, por të fitojnë rolin që po luajnë edhe në përvojat e ndryshme të gjuhësisë në Europë e më gjerë.

Së gjashti, *ndërsa u kushtojmë vëmendje teorive të sotme në lidhje me shqyrtimin e standardit, për kujdesemi më pak për shqyrtimin e vetë jetës së standardit të përvijuar tashmë përmes një historie prej disa dhjetëra vitesh.*

Do të duhet të marrim parasysh e njohim sa më plotë prurjet e tashme në përdorimin e shqipes standarde, veçantitë e përfutuara, prirjet e zhvillimit dhe dinamikën e marrëdhënieve normë-variacion në produktet ligjërimore në fusha të ndryshme të veprimtarisë, në kategori të ndryshme tekstore a forma aktualizimi me shkrim e me gojë. Dhe në këtë rast, përparësi merr shqyrtimi i produkteve ligjërimore të përdoruesve të spikatur në

fusha të ndryshme të veprimtarisë, qysh nga ato të përftuara në letërsinë artistike, por edhe sfera të tjera të veprimtarisë sociale, në shkencë, teknologji, jurisprudencë, publicistikë, administratë, e deri në fushën e besimit.

Është funksionalizimi gjithnjë e më i plotë i shqipes standarde në këtë periudhë jo të gjatë të jetës së saj që është produkt i procesit përdorimor në këto sfera të veprimtarisë shoqërore, ku janë përftuar tashmë modele të një diskursi funksional, ku ndërkëmbehen përzgjedhjet e njësisve të të gjithë sistemit. Këto modele përdorimi nuk janë të tilla thjesht ngaqë pasqyrojnë një normë drejtshkrimore, gramatikore a leksikore, por ngaqë karakterizohen nga përpunime gjuhësore të nxitura nga vetë kërkesat e fushës së veprimtarisë në të cilën ato përvijohen. Janë modele të mundësuar nga kompetenca e zhvilluar komunikative e prodhuesve të tyre; dhe, në këtë mënyrë, ato modele bëhen nxitje për formësimin e kësaj kompetence edhe te receptuesit e tyre. Sa më të shumta të jenë këto modele në fushat e ndryshme të veprimtarive shoqërore, aq më intensiv bëhet edhe zhvillimi i kompetencës komunikative të folësve e shkruarve të shqipes standarde (sigurisht veçantitë e përfutimit të tyre në këtë ndërkohë janë të lidhura edhe me literaturën shkencore gjuhësore që po shoqëron ecurinë e këtij zhvillimi, si fjalorët, gramatikat, manualët e ndryshme të natyrës metalinguistike etj.).

Në një vështrim të përgjithshëm të moshës së varieteteve gjuhësore, një periudhë prej katër a pesë dhjetëvjeçarësh nuk është një kohëzgjatje e mjaftueshme për spikatje të dukshme të veçantive në raport me fazën filletare të jetës së standardit. Por në lidhje me shqipen standarde, dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI, në raport me sferat e përdorimit të gjuhës, teknologjitë e reja në komunikim dhe nevojat për të përballuar zhvillimet e vrullshme, shënojnë një etapë krejt të veçantë në të cilën meritojnë të mos shpërfilllet shqyrtimi i faktorëve të tillë, si:

- zgjerimi i hapësirës së përdorimit të gjuhëve të specialitetit në fusha të tilla të veprimtarisë të lidhura me teknologjitë e reja të komunikimit, si pasojë e zhvillimeve të informatikës, komunikimit digjital, të biznesit, publicitetit etj.;

- qasjet e reja jo thjesht ideologjike, por në shumë aspekte mirëfilli konceptuale në sfera të tilla të veprimtarisë që lidhen me jurisprudencën dhe

sistemin juridik në tërësi, gazetarinë dhe produktin mediatik në mediat e natyrave të ndryshme, të shkruara ose pamore e dëgjimore etj.;

- mundësimi i praktikave publike fetare, si pasojë e lirisë së besimit në fe, çka solli nevojën për të bashkëkohëzuar mjetet gjuhësore përmes të cilave do të ngjizeshin mesazhet përgjatë predikimit në praktika të ndryshme a ceremoniale fetare, por edhe përfitim të versioneve të reja në gjuhën shqipe të literaturës shoqëruese të tyre;

- kërkesa për të pasur të pranishme në vijimësi njohuritë e reja, enciklopedike apo të fushave të veçanta, në tekstet shkollore të cikleve të ndryshme të shkollimit apo në literaturën shkencore a popullarizuese të fushave të ndryshme të shkencës, teknologjisë e veprimtarisë kulturore.

- Etj.

Është përftuar një realitet gjuhësor/ligjërimitor që kërkonn shqyrtime, përkujdesje dhe interpretime nga profile të ndryshme të shfaqjes së tij, për të cilat disiplina të ndryshme të gjuhësisë së gjuhës dhe asaj të diskursit mund të ndihmojnë; është një realitet që kërkonn domosdoshmërisht zgjerimin e qasjeve përtej gjuhësisë së njësive të sistemit, madje edhe përtej atyre të sociolinguistikës, duke plotësuar gjithnjë e më shumë një pamje ndërdisiplinare në shqyrtim. Vërtet mendimi gjuhësor përshkruan dhe interpreton pa censuruar format e aktualizimeve gjuhësore, por njëherazi me ato interpretime dallon në fillesë risitë, prirjet dhe kahet e zhvillimeve, përgjithëson nga përvojat e gjuhëve që funksionojnë nën trysninë e zhvillimeve edhe më të vrullshme sociale, shkencore e teknologjike dhe, në këtë mënyrë, ndikon dhe lehtëson prirjet pozitive dhe përshpejton formësimin e tyre; në fund të fundit, mundëson përhapjen e modeleve funksionamle dhe nxënien e përveçësimit të risive.

Në mbyllje

Kushtet e sotme të komunikimit ndikojnë që të përftohen dukuri të njëjta a të përafërta mes folësve nativë në gjuhë të ndryshme dhe përvojat e shqyrtimit më të avancuara në një të tjetër gjuhë të mund të shfrytëzohen për të arritur ritme më të shpejta shqyrtimi në të tjerat. Jetojmë në një epokë kur ngadalësia në kapjen e trajtimit të dukurive që lidhen me procesin e komunikimit përmes gjuhës shkakton prapambetje shumë më të ndjeshme

se më parë. Ndaj edhe përgjegjësia e studiuesve të këtyre fushave është a duhet të jetë edhe më e madhe.

Prof. dr. Mimoza PRIKU
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

DISA MODELE TË REJA NË FJALËFORMIMIN E SHQIPEN STANDARDE DHE SHTRIRJA E TYRE

Hyrje

Shqipja standarde karakterizohet në fushë të fjalëformimit nga dy drejtime kryesore: nga njëra anë forca e saj për ruajtjen e modeleve tradicionale fjalëformuese dhe nga ana tjetër, duke qenë një gjuhë e hapur dhe në kontakt me gjuhët e tjera, ka arritur që të pranojë e të përshtasë prej tyre edhe modele të reja në formimin e fjalëve. Studiuesit në këtë fushë kanë vënë re se “struktura leksikore dhe ajo e fjalëformimit janë strukturat më të hapura dhe më dinamiket e gjuhës, të cilat në sajë të ndjeshmërisë së tyre reflektojnë më shpejt se të gjitha strukturat e tjera gjuhësore transformimet që ndodhin në jetën shoqërore. Në kushtet e një jete më sociale e më dinamike procesi i pasurimit të leksikut të shqipes me fjalë të reja duke i marrë nga gjuha e folur e popullit ose duke i krijuar me anë të mënyrave fjalëformuese është mjaft i vrullshëm.”¹

Gjuhëtari Selman Riza në shkrimin “Disa teza mbi teorinë dhe praktikën të analizës morfologjike përshkruese shqipe”, i botuar relativisht vonë, ishte mjaft modern edhe në koceptet e tij morfologjike. Ky linguist ishte i qartë në ndarjen e proceve fjalëformuese nga proceset flektive apo formëformuese dhe në lidhje me to Riza vëren se “brenda fjalëndërtimit dhe formëndërtimit, analiza gjenetike simbas ndjenjës gjuhësore (pak a shumë të lavruar” së një shqipfolësi bashkëkohor duhet dalluar nga analiza gjenetike simbas njohurivët (pikërisht hipotetike) të specialistëve për historinë dhe parhistorinë të gjuhës.”²

¹ L. Buxheli, Fjalëformimi në gramatologjinë shqiptar, *Studime gramatikore*, Tiranë, 2017, 137.

² S. Riza, Disa teza mbi teorinë dhe praktikën të analizës morfologjike përshkruese shqip, në *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f. 43.

Megjithëse sot ekzistojnë një varg teorish që përpiqen ta shohin fjalëformimin në dritën e teorive moderne, duhet theksuar fakti se një trashëgimi të sigurt në çështjet e fjalëformimit i kemi falë punës së shkollës strukturaliste, pa lënë jashtë F. de Saussure që përgjithësisht njihet si parastrukturalist.

Strukturalizmi për problemet që kishin të bënin me fjalëformimin, u përqendrua më së shumti në metodën e segmentit të fjalëve në unitete më të vogla. Këtë orientim teorik kanë ndjekur kryesisht edhe studimet për fjalëformimin e shqipes deri në fillim të viteve '90. Pas kësaj etape kërkimet në këtë fushë përqafuan qasje të natyrave të ndryshme. Gjithsesi duhet pranuar fakti se kontributi i Strukturalizmit edhe në këtë fushë kërkimore mbetet qenësor dhe ka gjetur mjaft vlerësime nga gjuhësia e mëvonshme. Sipas gjuhësisë bashkëkohore: “Është e drejtë të thuhet se shkollat strukturaliste kanë dhënë një kontribut të madh në analizën e strukturës elementare të fjalëve. U përpunuan koncepte themelore për analizimin e strukturës së brendshme të fjalëve dhe rolin e tyre në kombinimin e fjalëve me fraza dhe fjali. Falënderojmë qasjet strukturaliste për koncepte të tilla si morfemë bazë, morfemë derivacionale dhe flekstive, morfemë e ndërprerë dhe morfemë e lirë dhe e lidhur. Bloomfield-i Harris-i dhe Hockett-i kanë ndihmuar shumë për këto rezultate. Do të ishte e pamundur të imagjinohej kërkimi modern në morfologji dhe fjalëformim pa punën paraprake të strukturalistëve”³.

Fjalëformimi është një fushë kërkimore ku studimet albanistike kanë arritur rezultate të kënaqshme⁴. Shqipja e sotme paraqet disa risi në fushë të

³ “It is fair to say that structuralist schools have made great contributions to the analysis of the elementary structure of words. Fundamental concepts were worked out for analyzing the internal structure of words and their role in the combination of words to phrases and sentences. We thank structuralist approaches for concepts such as stem morpheme, derivational and inflectional morpheme, discontinuous morpheme, and free and bound morpheme. Bloomfield, Harris and Hockett contributed greatly to these results. It would be impossible to imagine modern research in morphology and wordformation without the preliminary work of the structuralists” (W. Motsch, “Word-formation in structuralism”, *Word-Formation: An International Handbook of the Languages of Europe*, Volume 1 edited by P. O. Müller, I. Ohnheiser, S. Olsen, F. Rainer; Berlin, München, Boston: De Gruyter Mouton, 2015, pp. 52-66. <https://doi.org/10.1515/9783110246254-006>).

⁴ Përmendim disa botime: A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, *Buletin për Shkencaat Shoqërore*, 1954 (4), f. 66-103; A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962; *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë,

fjalëformimit, prandaj, qëllimi ynë është identifikojë disa prej këtyre prirjeve të kësaj gjuhe përmes të dhënave të siguruar nga fjalorët e shqipes standarde, Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe, medias së shkruar e asaj elektronike etj., por edhe të përcaktojë, aq aq sa është e mundur, shtrirjen a ndikimin që këto modele kanë pasur në disa fusha, si politikë, ekonomi, sport, teknologji etj. Modelet fjalëformuese në shqipen e sotme standarde, procese të ndikuara herë-herë edhe nga gjuhët e tjera, kryesisht nga anglishtja do jenë në vëmendjen tonë gjatë parashtrimeve.

Fokusi ynë do të përqendrohet në formimet me prapashtesën *-ajë/-najë*, *-inë*, si dhe formimet me elementin *euro-*, *mega-*, *super-*, *hiper* etj.

1.1.a. Formimet me prapashtesën *-ajë/-najë*

Kjo prapashtesë sipas studimit të Xhuvanit e Çabejt “u ngjitet emrave, duke formuar emra kolektivë, që më të shumtën kanë edhe përdorim topik”⁵. Kjo ndajshitesë zakonisht bashkohet me një bazë emërore për të krijuar sërish një emër tjetër. Mund ta paraqesim me skemën:

[X]_E+ ndajshit.*-ajë/-najë*]_E

Ajo ka krijuar zakonisht, emra të cilët mund të jenë konsideruar si përmbledhës, por sot nuk e gëzojnë më atë status dhe pak prej tyre vazhdojnë të

IGJL, Tiranë, 2002; *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, II, III (Tiranë, 1972, 1989); *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1975; Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës shqipe* (dispenë), Tiranë, 1960; M. Camaj, *Albanische Wortbildung. Die Bildungsweise der älteren Nomina*, Wiesbaden, Harrassowitz, 1966; E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, IGL, Tiranë, 2004; J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006; M. Halimi, *Çështje të fjalëformimit në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1996; A. Kostallari, *Vepra III. Studime për fjalëformimin dhe leksikon*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2017; A. Kostallari, *Vepra V. Histori e gjuhësisë së përgjithshme; Fjalëformimi i shqipes; Gjuha e sotme letrare shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2018; L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën shqipe*, Tiranë 2008; L. Buxheli, *Fjalët e përmgjitura në gjuhën shqipe*, Tiranë 2009; N. Veseli, *Rreth formësimit të emërtimit të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2014; Rr. Paçarizi, *Konversioni në gjuhën shqipe*, Parnas, 2015; Rr. Paçarizi, *Fjalëformimi ndajshitesor i shqipes*, Prishtinë, 2020 etj.

⁵ A. Xhuvani - E. Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, në A. Xhuvani: *Vepra I*, Tiranë, 1980, f. 431.

ndjehen të tilla. Këto fjalë shënojnë emra pemësh (*lisnajë, pyllnajë, pishnajë, frashnajë* etj.); dukurish a fenomesh atmosferike (*bornajë* (borë e madhe), *mjegullnajë, tymnajë*); tërësi vendesh: *arnajë* (vend me ara); *ferrnajë gardhnajë; gjethnajë krenajë*⁶, *vishkullajë*; prodhime (*groshnajë, grunajë*) etj. ***Si trajtohet ky formant në gramatikën e shqipes standarde?*** Po t'i referohemi tekstit të *Gramatikës* gjejmë këtë përcaktim: “Me kuptimin e prapashtesës -ishte përdoret edhe prapashtesa -ajë (-najë), e cila ka një shtrirje dialektore: *dushkajë* (dushk), *lisnajë* (lis), *ujnajë* (ujë), po që ka nisur të hyjë edhe në gjuhën letrare: *akullnajë*” (*Gramatika* I, 2002:138, shën. 1). Më këtë frymë është trajtuar ky mjet fjalëformues edhe në studimin e M. Genesin - J. Mazinger. Sipas tyre:

“-ajë (in most cases the derivatives are restricted to the Gheg dialectal area), e. g., *kren-ajë* ‘peak of a hill or mountain’ ← *krye* ‘head’, *lug-ajë* ‘deep, wide and long valley’ ← *lug* ‘dale’” (M. Genesin & J. Mazinger, 2016: 3128).

Për të parë në vështrim retrospektiv se çfarë statusi kishte më parë kjo ndajshesë së pari evidentojmë se ky është mjet i hershëm i shqipes që e ndeshim që në librin e parë të shqipes, “Meshari” i Gjon Buzukut (1555) me emrin *Ërshajë*;⁷ së dyti do t'i referohemi vetëm “Fjalorit të Ndre Mjedës” të përgatitur nga Kolë Ashta (dorëshkrimi, proces botimi):

ARNAJË-A: emën, “*nd’arnaje brî lumit mâ t’Madh*” (Mikut tēm. 2); shumë ara bashkë.

BUNGAJË-A: emën, “*lëni n’bungaje - spatat e ngulme*” (Scodra VIII, 6); pyje bungash [pyje me një lloj lisi të quajtur **bungë**].

KANDRRAJË-A: emën, “*kah ndertimi i shtatit kacaleci nuk ka shoq kerkând. Do kandrraje qi shifen me shumicë rrugës e nëpër fushë, janë si me thânë, zhgati i këtij kómbit*” (K. II, 132, 22); gjith kandrart.

[MURAJË-A]: emën, “*sogjetarë të patundshem si murrjë ruejshin Ilirsit per atdhë bâ flije*” (Lissus II, 7); mur + ajë; grumbull gurësh per kujtim t’atij qi u vra aty.

Pra, kemi të bëjmë me një formant të hershëm e që kishte një shtrirje goxha të gjerë sidomos në dialektin gegë, gjë që mund të dëshmohet më gjerësisht përmes krijimtarisë së pasur jo vetëm të Mjedës, por edhe të shumë autorëve të tjerë.

1.1.b. Statusi i sotëm ndajshesave *ajë/-najë*

⁶ *krenájë*, -a f. sh. -a(t) 1. maja më e lartë e një mali a varg majash. 2. pjesa e sipërme, kryet e diçkaje; kreu: kr (FGJSH, 2020:355).

⁷ Thoma Qendro, *Fjalor i shqipes së Gjon Buzukut*, Tiranë, 2013, f. 99.

Pas këtyre parashtrimeve natyrisht lind një pyetje e cila hap gjithashtu për diskutim çështjen: *Cili është statusi ka sot kjo prapashtesë? Deri në ç' masë ka arritur kjo prapashtesë të ngrihet në normë?* Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve kemi parë fillimisht korpusin e fjalëve të ndërtuara me këtë ndajshitesë në fjalorët normativë të shqipes⁸ dhe mbi këtë bazë kemi ndërtuar tabelën e mëposhtme:

Fjala	1980	2006	2020
akullnajë	+	+	+
arnajë	+	+	+
blinajë	+	+	+
bornajë	+	+	+
drithnajë	+	+	+
floknejë	+	+	+
frashnajë	+	- (franshërishtë/e)	- (franshërishtë/e)
fushnajë	+	+	+
gardhnajë	+	+	+
groshnajë	+	+	+
grunajë	+	+	+
gjethnajë	+	+	+
kërpnajë	+	+	+
krenajë	+	+	+
ledhnajë	+	+	+
lisnajë	+	+	+
lugajë/lugnajë	+	+	+
lulnajë	+	+	+
lumnajë	+	+	+
oriznajë	+	- (orizore)	- (orizore)
pishnajë	+	+	+
pyllnajë	+	+	+
rrungajë	+	+	+
shkurrajë/shkrurnajë	+	+	+
tymnajë/tymtajë	+	+	+
vishkullajë	+	+	+

Tabela nr. 1

Nga 26 fjalët e marra në shqyrtim vërejmë se vetëm dy prej tyre nuk janë më pjesë e fjalorëve pas viteve 2000, por kanë mbetur vetëm tek ai i vitit 1980. Bëhet fjalë për emrat *frashnajë* që del me një prapashtesë tjetër (*franshërishtë/e*) dhe *oriznajë* - *orizore*, ndërsa pjesa tjetër vazhdojnë të jenë aktive me ndajshitesën *-ajë/-najë* apo edhe mund të shfaqen me variante me

⁸ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 1980; *Fjalor i gjuhës shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 2006; *Fjalor i gjuhës shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 2020.

prapashtesën *-ishtë* ose *-ore* p. sh.: *blinajë/ blinishtë; groshnajë/ groshore; grunajë/ grunore; kërpajë/ kërpore; ledhnajë/ ledhishte; drithnajë/ drithërishtë; shkurrajë/ shkurrishtë.*

Le të marrin disa shembuj nga Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe duke krahasuar shkrimtarë që megjithëse i përkasin kohëve të ndryshme, përdorin fjalë me këtë ndajshitesë:

- a. Eh... na s'po dijmë si me ia ba grunit qi po hup n'**grunajë**, jo ma me u kujdesue për kollo-moqin qi s'i dihet... (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur,)
- b. Dy zogj ungritën nga një ferrë dhe duke ndjekur njëri-tjetrin humbën në një **grunajë** (Naum Prifti, Yjet ndritin lart', 2002).

Fjalët me këtë ndajshitesë nuk janë të pakta as në leksikon e shkrimtarit Ismail Kadare ku gjejmë emrat: *plehnajë, qyqnajë, yllnajë* etj. Vetë ai ka krijuar me këtë mjet dhe ndonjë fjalë të re, siç është emri “thashethemnajë”.⁹

Në vijim të parashtrimeve të mësipërme, mund të pohojmë se ka mjaft fjalë të formuara me këtë mjet që gjallojnë ende sot dhe një pjesë e tyre e ka gjetur vendin e vet në fjalorët normativë, por më e rëndësishmja ka të bëjë me faktin se ajo ende konsiderohet si ndajshitesë aktive në shkrimtarinë e autorëve të njohur, pra pavarësisht burimit të tij, jemi të bindur që tani nuk kemi të bëjmë me një ndajshitesë me shtrirje vetëm dialektore, por me një formant të shqipes standarde¹⁰.

1.2. Formimet me prapashtesën *-inë*

Një tjetër mjet i përcaktuar si dialektor është formanit *-inë*. Sipas gramatikës së shqipes *-inë* është një “prapashtesë dialektore që ka fituar një farë përhapjeje edhe në gjuhën letrare.” (*Gramatikë*. I, 2002:138). Ajo është një prapashtesë relativisht produktive. Sipas studimit të Xhuvanit dhe Çabejt “me këtë prapashtesë janë formuar emra prej emrash, mbiemrash e foljesh me

⁹ Shih: T. Çausi - Gj. Shkurtaj, *Kadareja dhe fjala shqipe*, Tiranë, 2004.

¹⁰ Jo rrallë këtë ndajshitesë e ndeshim edhe në fjalorët dygjuhësh. Kështu Pavli Qesku në *Fjalor shqip-anglisht* ka regjistruar edhe emrin *sharmajë* 1)-Emër cay; 2)-Emër ref., Tiranë, 1999, f. 419.

kuptime të ndryshme”¹¹. Zakonisht kjo ndajshitesë i prapavendoset një teme emërore, foljore, mbiemërore dhe mjaft rrallë një teme ndajfoljore.

“Me prapashtesën *-inë* janë formuar pak emra vendesh sipas një cilësie që shënon tema fjalëformuese [...]; *çmendinë* (çmend), *kthinë* (kthej), *kodrinë* (kodër), *luginë* (lug-u), *rrafshinë* (rrafsh), *rrethina-t* (rreth), *zallinë* (zall), *greminë* (gremis) etj. (*Gramatika I*, 2002:138) dhe më rrallë ndeshemi me formime të tipit *siprinë* (sipër), *kundrinë* (kundër)¹².

Po t’i referohemi fjalorëve të shqipes gjejmë një sërë krijimesh me prapashtesën *-inë*, si: *ançinë*¹³, *luginë*, *tharptinë*, *rruginë*, *djerrinë*, *krahinë*, *cekëtinë*, *balturinë*, *deltinë*, *djerrinë*, *ngrehinë*, *ballinë*, *shpellinë*, *siprinë*, *pullazinë*, *shpatinë* etj. dhe është shtrirë edhe në onomastikë, si *Prishtinë*, *Rrogozhinë*, *Smokthinë* etj.¹⁴

Sipas modelit të mësipërm është krijuar edhe toponimi *Rrethinat*, emërtim i një njësie administrative në Shkodër p. sh.: “*Në njësinë administrative Rrethina janë të përmblytura 70 Ha tokë*” (Sot, 23. 3. 2018). Në ligjërime janë krijuar me këtë formant edhe fjalë me ngarkesa ironizuese apo pejorative, si *biondinë* p.sh.: “*Biondina e bukur ka deklaruar se...*” (Zëri, 20.10. 2013).

Edhe kjo ndajshitesë ka zënë vend në krijimtarinë e Kadaresë duke fituar qytetari (*vathinë*, *mjegullinë* etj.), po e gjejmë edhe në vepra të autorëve të tjerë të letërsisë artistike, si: “*pasqyrë prej mogano, që në mjegullinë*” (Mira Meksi, Misteri letar i pasqyrave, Tiranë, 2010).

2. Formime e krijuara sipas modeleve të gjuhëve të huaja

Shqipja standarde e sidomos shqipja e përdorur në media, ka ndikuar e po ndikon vazhdimisht për krijimin e strukturave e skemave të reja në procesin e fjalëformimit. Shqipja në tërësinë e vet ka evoluar, por një ndryshim më të dukshëm ngjan të ketë pasur komunikimi mediatik sidomos pas viteve ’90. Ky komunikim nisur edhe nga qëllimi e misioni që ka për të ndikuar tek audienca është i shpejtë, fleksibël dhe më i ndjeshëm nga modele të

¹¹ A. Xhuvani - E. Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, në A. Xhuvani: *Vepra I*, Tiranë, 1980, f. 495.

¹² E. Hysa, *vep. e cit.* f. 177.

¹³ *ançinë/ë, -a f. sh. -a(t)* anë mali, zakonisht e zhveshur, FGSB, 2006, f. 41.

¹⁴ Xhuvani - Çabej, *vep. e cit.* f. 497.

tjera, edhe në fjalëformim. Për folësin e shqipes fjalë të krijuara me elementin *euro-*, *mega-* *super-* janë më të kapshme, sepse i ka të dëgjua apo të njohura më parë nga një gjuhë tjetër, kryesisht anglishtja. Disa prej këtyre ndërtimeve po i marrim që t'i shqyrtojmë në vijim.

2.1. Formimet me elementin *euro-*

Fjalorët e shqipes elementin *euro* e kanë shënuar zakonisht si një emërtim për monedhën europiane, por jo si ndonjë ndajshitesë, pra është konsideruar si një temë fjalëformuese. Për të gjejmë këtë përcaktim: “éuro, -ja f. sh. -(t) njësia monetare bazë në disa vende të Europës, kryesisht të Bashkimit Europian” (FGJSH, 2021:181). Fjalët e krijuara me këtë komponent janë në numër të konsiderueshëm, si: *euroatlantik*, *euroçek*, *eurodeputet*, *eurolindor*, *europarlamentar*, *europërëndimor*, *europol*, *eurovizion*, *eurozonë* etj. Por në media gjejmë edhe *euro-integrim*, *euro-skeptik*, *euro-socialist* p. sh.:

“Zgjedhjet problematike me ndikim në **euro-integrimet**” (gazeta Koha 18. 05. 2011).

Megjithëse elementi *euro-* ndeshet edhe si një formë e lirë, duke u përdorur gjithnjë e më shpesh në ndërtime komplekse, ai po merr trajtat e një afiksoidi. Ai ka fituar edhe njëfarë abstragimi e po shërben biles si një model fjalëformues.

2.2. Formimet me elementin *mega*¹⁵

Formimet me elementin *mega-* do t'i grupojmë në dy kategori, në të parën do të veçonim fjalët të cilat janë bërë me kohë pjesë e fjalorëve të shqipes standarde, si: *megaherc*, *megametër*, *megavat* etj.; dhe në të dytën do të dallojmë disa ndërtime të reja brenda shqipes, shpesh në formën e kalkimit që janë bërë pjesë e gjuhës së sportit apo modës, si: *megaofertë*, *mega-transferim*, *megabrends*, *megastore* etj. Këto të fundit, duke qenë krijime të reja paraqiten edhe me luhatje drejtshkrimore, siç na e vërtetojnë shembujt në vijim: “**Megaofertë për Paulo Dibalën** (Panorama Sport, 15 tetor 2020)”, “**Mega-oferta e Realit për Nejmarin**” (Panorama Sport, 22 gusht 2019), “**Mega-operacioni**” i Raiolës” (Panorama Sport, 25 nëntor 2019); “*Mbyllet*

¹⁵ *mega-* fjalëform. spec. pjesë e parë e fjalëve të përbëra, që ka kuptimin “një milion më i madh”; “që ka një milion njësi”; “shumë i madh” (FGJSH 2020, 429).

mega-transferimi” (Panorama Sport, 1 gusht 2018); “Gati “*megaprojekti*” për Teutën” (Panorama Sport, 13 qershor 2017) etj.

Këto variacione drejtshkrimore vërtetojnë një farë mënyre edhe brishtësinë që kanë këto formime në gjuhën shqipe.

I pasur me formimet me elemenin euro- është komunikimi mediatik ku ndeshim: megalajm, megaafërë, mega-goditje, mega-jahti, mega-goditje, mega-operacioni, megaprocesi, mega-organizatë, megavjedhje p. sh.: “do të fshehë megaafërën e tij” (Panorama, 18 korrik 2022); “megaskandal me leje” (Panorama, 17 korrik 2022); “megaoperacioni i SPAK” (Panorama, 19 maj 2022) etj.¹⁶

Mjaft diskutime kanë ngjallur këto formime edhe nga pikëpamja teorike. Sipas kolegut Rr. Paçarizi kemi të bëjmë me një “parashtesë të huazuar kuantifikuese, me të cilën formohen kuptime të stërmadhësisë së kuptimit që ka tema motivuese” (Rr. Paçarizi, 2020: 137). Por, mungesa e kodifikimit të një pjese të madhe të tyre, na bën të mendojmë se kemi të bëjmë më së shumti me një ndajshitesë, e cila shpejt mund të fitojë statusin e një ndajshitesë parashtesore.

2.3. Formimet me ndajshitesën *super-*

Parashtesa *super-* është një ndajshitesë që u jep fjalëve një kuptim superlativ, “mbi”; “shumë i lartë”¹⁷. Ajo është “me origjinë nga gjuhët neolatine, ka hyrë në shqipe bashkë me një numër fjalësh të huaja, e më rrallë bashkohet me një temë shqipe”¹⁸. Me këtë ndajshitesë kanë hyrë në gjuhën shqipe mjaft fjalë që konsiderohen si ndërkombëtarizma. Numri i ndajshitesave të huaja në shqipen standarde deri para viteve ’90 ka qenë më i kufizuar, madje për disa prej tyre janë propozur edhe zëvendësime me elemente brenda shqipes (si *anti-/kundër-*). Sipas gramatikës së gjuhës shqipe “Në disa fjalë mund të veçohet edhe ndonjë parashtesë e huaj, si **ultra-**: *ultra-tingull*, **a-**: *asimetri*, *aritm*; **anti-**: *antifashist*, *antifetar*, *antifeudal*; **super-**: *superfuqi*, *superprodhim*, *superstrukturë*.” (Gramatikë I, 2002:146).

¹⁶ Nga fusha e biznesit ndeshim edhe me emërtimet: *Megatek*, *megaPranverë*, *megacard* etj.

¹⁷ Shih. FGJSH, Tiranë, 2020, f. 697.

¹⁸ E. Hysa, *vep e cit.*, f. 99.

Zakonisht tema me të cilën bashkohet kjo parashtesë i përket klasës së emrit, por edhe fjala e re i përket kësaj klase. Por sipas gramatikës së shqipes më rrallë e gjejmë në disa mbiemra të huazuar p.sh.: *supermodern, superpersonik*.”

Studiuesi E. Hysa në studimin e tij Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe (Tiranë, 2004) vëren në lidhje me këtë ndajshitesë se ajo “del në gjuhën e përditshme ose në stilin e poezisë e në krijimet e rastit, por jo jetëgjata, si *supershtet* etj.” (E. Hysa, 2004:99). Por ne vërejmë se situata gjuhësore ka ndryshuar dhe një pjesë e këtyre krijimeve jo vetëm kanë fituar qëndrueshmëri, por edhe janë bërë pjesë e fjalorëve normativë. Kështu në FGJSH 2020 ndeshemi me fjalët: *superçmim, supermarket, superstradë*. Ndërsa një pjesë tjetër e këtyre formimeve ka gjetur shtrirje në fusha e stile të caktuara, po pa u standardizuar akoma. Fushës së sportit i përkasin emrat: *superliga, superkupa, supergol* etj., p.sh.: “*shtang portierin me një supergol*” (Panorama Sport, 30 qershor 2022); por ka edhe nga sfera e modës, si: *superformë, supermodele* etj.

Në lidhje me këtë formant mund të themi përmbledhtas se megjithëse është një ndajshitesë që ka hyrë relativisht herët në gjuhën shqipe (kujtojmë me këtë rast emrin *superfuqi*), si model fjalëformimi është bërë shumë intensiv vitet e fundit, ngjan se ai po bëhet gjithnjë e më mbizotërues sidomos në gjuhën e sportit.

Formimet me elementin *hiper-*

Elementi *hiper-* nuk është veçuar si mjet fjalëformues në gramatikën e shqipes standarde, ndërsa në fjalorët e shqipes gjejmë këtë përkufizim: “*hiper-* fjalëform. libr. pjesë e parë e fjalëve të përbëra (kryesisht të huazuara), që tregon një shkallë të lartë ose teprim të asaj që shënohet nga pjesa e dytë” (FGJSH, 2020, 277), duke shënuar edhe rolin e saj jo si ndajshitesë, por si temë fjalëformuese. Gjuhëtari K. Topalli e ka lënë të papërcaktuar funksionin e saj në fjalëformim. Ai shënon: “Element fjalëformues i huaj, me burim prej gr. *ὑπέρ* “mbi, tepër, shumë”, me të cilin janë krijuar ndër-kombëtarizma të fushës shkencore e letrare, që kanë hyrë në gjuhën shqipe

prej latinishtes ose prej gjuhëve romane”¹⁹. Rr. Paçarizi e rreshton atë përkrah parashtesave kuantifikuse, siç i përcakton vetë ai. Në fjalorin e shqipes numri i fjalëve me këtë element është i kufizuar (p. sh. *hipertrofi*), por nuk ngjan e tillë situata në ligjërimin mediatik ku gjejmë mori krijimesh: *hiperaktiv*, *hiperaktivitet*, *hipermarket*, *hiperinfacion*, *hiperprodhim*, *hiperko-rrekt*, *hipersensibilitet*, *hiper-realitet*, *hiper-patritizëm*, *hi-per-globalizim*, *hi-per-gol*, *hiper-moderne*, *hiper-sonike*, *hiperimune*, *hiperseksualiteti*, *hiper-pegmentim*, *hipermetropia* p.sh.: “Në njëbisedë për Autocar, drejtori i Ferrari për zhvillimin e teknologjisë së prodhuesit, Michael Leiters, tha se në kompani po mendohet për **hiper-automobilin e ri**” (ATSH, 10 maj 2017)²⁰; “**Hiperaktiviteti** (Attention Deficit/Hiperactivity Disorder-ADHD) si term po gjen përdorim gjithnjë e më të shpeshtë për të cilësuar një sjellje të caktuar të fëmijës” (<https://telegrafi.com/>, 19.08.2013); “Sipas mjekut, **hiperpegmetimi** i lëkurës në këtë periudhë të vitit lidhet me ekspozimin ndaj diellit” (<https://www.gazetatema.net>, 16 gusht 2020); “SPAR Albania hap rrjetin e supermarketeve dhe **hipermarketeve**” (Panorama, 06.10. 2016) etj.

Këto formime dalin në konkurrencë me fjalët e formuara me parashtesën *super-*, si: *hiperprodhim-superprodhim*, *hipermoderne-supermoderne*, *hiper-gol-supergol* etj., ky mjet del mbizotërues në terminologjinë e psikologjisë (*hiperaktiv*, *hiperaktivitet* etj.) apo të mjekësisë (*hiperimune*, *hiperseksualiteti*, *hipertension*, *hiperpegmentim* etj.).

Në gjuhën shqipe kanë hyrë edhe formime të tjera që meritojnë vëmendje, si krijimet me web- zakonisht nga fusha e teknologjisë, si *website*, *webkamera*²¹, por edhe *webfaqe* e *faqe web* dhe me këtë model është krijuar edhe kompozita BalkanWeb p.sh. “Komuna e Prishtinës në **web-faqen** e saj ka përshkruar në vija të holla shefin e saj.” (Zëri, 23. 3. 2013).²² Më të reja

¹⁹ K. Topalli, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2017, 636.

²⁰ Aktorja problematike është tërbuar e tëra pasi mjekët ia kanë marrë pilulat e qetësimit Ad derall, edhe pse ajo thotë se ato i përdor për shkak të **hiper-aktivitetit**”, Zëri, 13. 09. 2011),

http://albanian.web-corpora.net/albanian_corpus/search

²¹ Shih. Nebi Caka- Agni Dika -Seb Rodiqi, *Fjalor i informatikës*, Prishtinë, 2005; ku autorët kanë bërë mjaft propozime për shqipërimin e këtyre termave të hyra nga anglishtja, si *webphone- telefon ueb*, *webcater- uebshpërhapës* etj.

²² http://albanian.web-corpora.net/albanian_corpus/search

ngjajnë hyrjet e kalkuara apo edhe ndonjë formim sipas këtij modeli me formantin *nano-*, si: *nanoteknologji*, *NanoALb*, *nanoshkenca* etj. Një trend të ri paraqesin edhe formimet me *e- fjalë* të cilat i kemi trajtuar më herët²³, si: *e- Albania*, *e-posta*, *e-libri*, *e-karriera* etj.

Si përfundim mund të themi se modelet fjalëformuese të marra në shqyrtim dhe mjaft të tjera të patrajtuara këtu, kërkojnë sot një vëmendje dhe studime të hollësishme. Vështirësia qëndron në faktin se produktiviteti i këtyre ndërtimeve mund të ndiqet deri në një pikë të caktuar, po frekuenca e denduria e përdorimit është e pamundur të matet pa një korpus të plotë. Shqyrtimi i tyre brenda korpusit do të na jepte të dhëna jo vetëm për modelet mbizotëruese në fjalëformimin e shqipes, por këto dëshmi mund të jenë me interes edhe për planin pragmatik, sociolinguistik etj. të gjuhës. Nismat për studimin e paraqitjen e gjendjes reale të fjalëformimit të shqipes standarde, do të ndihmonin edhe në përditësimin e teksteve që trajtojnë këtë problematikë.

Bibliografi

- ASHTA, Kolë, *Fjalori i Ndre Mjedës*, (dorëshkrim, proces botimi).
- BUXHELI, Ludmilla, *Studime gramatikore*, Tiranë, 2017.
- CAKA, Nebi & DIKA, Agni & RODIQLI, Seb, *Fjalori i informatikës*, Prishtinë, 2005.
- ÇAUSHI, Tefik & SHKURTAJ, Gjovalin, *Kadareja dhe fjala shqipe*, Tiranë, 2004.
- GENESIN, Monica & MAZINGER, Joachim “Albanian”, in *Word-formation. An international handbook of the languages of Europe*, Volume 5; edited by Peter O. Müller, Ingeborg Ohnheiser, Susan Olsen dhe Franz Rainer, Berlin, München, Boston: De Gruyter Mouton, 2016, pp. 3124-3137.
- Gramatika I* (grup autorësh), Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002.
- HYSA, Enver, *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2004.
- MOTSCH, Wolfgang, “Word-formation in structuralism”, *Word-Formation: An International Handbook of the Languages of Europe, Volume 1*; edited by Peter O. Müller, Ingeborg Ohnheiser, Susan Olsen and Franz Rainer, Berlin, München, Boston: De Gruyter Mouton, 2015, pp. 52-66, <https://doi.org/10.1515/9783110246254-006>.
- PAÇARIZI, Rrahman, *Fjalëformimi ndajshesor i shqipes*, Prishtinë, 2020.

²³ M. Priku, Disa kahe të reja në fjalëformimin e shqipes, në konferencën shkencore Fjalëformimi në dritën e qasjeve dhe prirjeve bashkëkohore, organizuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 17 dhjetor, 2021.

QENDRO, Thoma, *Fjalor i shqipes së Gjon Buzukut*, Tiranë, 2013.

RIZA, Selman, “Disa teza mbi teorinë dhe praktikën të analizës morfologjike përshkruese shqipe”, në *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f. 43-45.

Fjalor i gjuhës së sotme shqipe (grup autorësh), Tiranë, 1980.

Fjalor i gjuhës shqipe (grup autorësh), Tiranë, 2006.

Fjalor i gjuhës shqipe (grup autorësh), Tiranë, 2020.

TOPALLI, Kolec, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2017.

XHUVANI, Aleksandër & ÇABEJ, Eqrem, “Prapashtesat e gjuhës shqipe”, në A. Xhuvani: *Vepra I*, Tiranë, 1980.

Burime

<http://www.panorama.com.al/>

http://albanian.web-corpora.net/albanian_corpus/search (aksesuar së fundi nëntor, 2022)

<https://sot.com.al>

<https://telegrafi.com/>

<https://www.gazetatema.net>

Prof. dr. Rrahman PAÇARIZI,
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

STANDARDIZIMI I SHQIPES SI PROCES - PASKAJORJA DHE PJESORJA E SHKURTUAR

Abstrakt

50 vjet pas miratimit të Rregullave të Drejtshkrimit, shqipja vazhdon me qenë një gjuhë e cila nuk e ka kryer procesin e standardizimit, pasi nuk janë përfillur fazat e pranimit dhe të shqyrtimi të varietetit standard. Në këtë punim janë listuar disa nga problemet më të rëndësishme që po e përndjekin standardin aktual të shqipes, ndër të cilat janë: Rregullat e shumta dhe përjashtimet që vetvetiu janë rregulla; Tejdomenializimi i varietetit standard; Eliminimi i paskajores së tipit me+pjesorja; Shpërfillja e inovacionit përmes shkurtimit të pjesores; Metodologjia e hartimit të fjalorëve; Mungesa e gramatikës deskriptive dhe mungesa e vullnetit për t'i trajtu këto problematika.

50 vjet pas miratimit të rregullave të drejtshkrimit të shqipes, kur sentimentet e atëhershme janë venitë, qasja shkencore, bëhet e domosdoshme, me qëllim të përmbylljes së standardizimit të shqipes si proces. Kjo, për shkakun se shqipja nuk e ka përjetu standardizimin dhe Kongresi i Drejtshkrimit të Shqipes i vitit 1972 ka kulmuar vetëm me përzgjedhjen e bazës dialektore të shqipes së përbashkët dhe mbi këtë bazë janë hartuar rregullat e drejtshkrimit, që janë përmbledhur në libra dokumentarë (Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe 1973), fjalorë normativë (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1973, Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës shqipe 1976 dhe Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe 1980), si dhe gramatika preskriptive të shqipes (Gramatika e Gjuhës shqipe 1 dhe Gramatika e Gjuhës shqipe 2, 1976, 1995, 2002). Kjo domethënë se shqipja nuk i ka kaluar fazat e tjera të standardizimit, pasi standardizimi nuk është akt, por proces. Siç e përshkruan Haugen (1966:934), standardizimi i gjuhës është proces që kalon nëpër katër faza: Përzgjedhja, kodifikimi, elaborimi dhe kodifikimi. Mirëpo, siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme, përzjedhja dhe ranimi i takojnë shoqërisë, ndërsa kodifikimi dhe elaborimi kanë të bëjnë me gjuhën si të tillë.

	Forma	Funksioni
Shoqëria	Përzgjedhja	Pranimi
Gjuha	Kodifikimi	Elaborimi

Shqipja një herë e kishte përzgjedhë bazën dialektore për gjuhën e saj standarde përmes një procesi (Komisia Letrare e Shkodrës, 1916) që ishte formalizuar në Kongresin Arsimor të Lushnjës më 1920 dhe miratuar nga “Qeveria Shqiptare në janar 1923” (Ismajli 2005:53), dhe ky proces i kishte kalu të gjitha fazat përveç pranimit që është një proces më i gjatë. Përzgjedhja dhe kodifikimi ishin kryer nga Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës dhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës, ndërsa elaborimi i bazës dialektore të përzgjedhur (dialekti i Elbasanit) ishte bërë nga Gjergj Pekmezi dhe Rajko Nachtigal pas një ekspedite shkencore të ndërmarrë enkas për këtë (Munishi 2016: 21-29). Ndonëse, kjo normë e shqipes e kishte përjetu edhe fazën e imponimit, pasi ishte bërë gjuhë e administratës shtetërore, e shkollës e në një masë edhe e medias së kohës, ndryshimi i pushtetit në Shqipëri, pas Luftës së Dytë Botërore kishte ndiku që të niste puna për ndryshimin e bazës dialektore të shqipes standarde, punë kjo që nisi menjëherë. Qysh më 1947 Manol Konomi kryetar i Institutit të Studimeve në fjalën inauguruese kishte thënë se se “Gjuhë letrare, gjuhë e përbashkët kombëtare duhet të jetë ajo e masave të popullit që përfaqësojnë pjesën më progresive të vëndit tonë. Rrugova që e çeli populli me luftën e tij duhet të jetë rruga që duhet të ndjekë edhe në gjuhë në zhvillimin e saj” (Ismajli 2005:117). Pastaj, Lirak Dodbiba bashkëpunëtor i Institutit të Shkencave kishte theksuar se “Fakti që fjala e Partisë sonë të Punë, gjatë luftës nc.çl. u tha në toskërisht dhe gjithë masat e popullit tonë punonjës, gegë e gtoskë, me këto fjalë u ngritën të gjithë nën udhëheqjen e saj në luftë për të çliruar vëndin e për të marrë pushtetin në dorë ... vetë këto fakte tregojnë se populli ynë me gjithë dialektet që flet, ka një gjuhë kombëtare të përbashkët që përfaqësohet prej toskërishtes” (Ismajli 2005:124). Qoftë edhe vetëm këto dy fjalime militante dhe të pambështetura në hulumtime e matje shkencore, tregojnë për natyrën ideologjike të përzgjedhjes së bazës së re dialektore për shqipën standarde, e cila u përcaktua në sistemin socialist, siç kishte konstatuar edhe studiuesja amerikane Janet Byron (1976).

Më pas u mbajtën Konsultat e 1952 në Tiranë e në Prishtinë ku u kundërshtu ndryshimi i baës dialektore të shqipes standarde, por më 1968 në

Konsultën e Prishtinës u arrit pajtueshmëria për ndryshimin e bazës dialektore dhe Kosova hoqi dorë nga ruajtja e gegërishtes letrare.

Ndonëse shoqëria shqiptare nuk ishte e përgatitur për një ndërmarrje të tillë (shkalla e analfabetizmit në Kosovë ndërmjet viteve 1961 e 1971 ishte ndërmjet 43.9% e 32%), sipas Ismajlit 2005), për shkak të rrethanave socio-politike, miratimi i rregullave të drejtshkrimit u konsideru e arritur aq e madhe sa folësi u vu në shërbim të saj, me gjithë qenien – herë për interesa nacional-identitare (në ish-Jugosllavi), e herë për interesa ideologjike (në Shqipëri).

“Gjurmë të bardha” është një film i bërë nga Kosovafilmi i Prishtinës në vitin 1980. Personazhet janë sharraxhinj e fshatarë nga fshatrat e Rugovës së Pejës. Ata synojnë me folë varietetin standard të shqipes. Në filmat e Kinostudios “Shqipëria e re” personazhet pozitive (fshatarë e punëtorë) flisnin varietetin standard, ndërsa personazhet negative (mësues e mjekë) gegërishten. Vehbiu (2011) vëren se lëvizjet politike ndër të tjera janë identifikuar me një formë specifike të gjuhës, duke e projektuar ideologjinë në gjuhë: “Rilindja zgjodhi të fliste një shqipe të qëruar nga turqizmat dhe greqizmat; regjimi i Zogut e kërkoi legalitetin në elbasanishten; komunistët standardizuan toskërishten, duke i mveshur gegërishtes attribute të ligjërimit të Tjetrit, ose të armikut Përtej. Në filmat me spiunazh të Kinostudios Shqipëria e Re, ky armik shquhej menjëherë nga zhargoni gjeografik, i mishëruar në idiolektin e Ndrek Lucës, të filtruar përmes ajrit malor të Alpeve, ose të shpellave ku fshiheshin diversantët.”

Dhe, jo vetëm atëherë. Në variantin shqip të filmit të vizatuar “Shrek” që pati dalë më 2001, kryeheronjtë Shrek dhe princeshë Fiona flisnin varietetin standard, ndërsa personazhi negativ, mbreti Farquad flet tironçe. Oksimoroni është se gjuha e përqeshur ishte ajo e mbretit dhe e kryeqytetit. Le ta imagjinojmë situatën kur anglishtja e mbretit a dialekti i Parisit kishin me u vënë në funksione të tilla. Në teorinë psikolinguistike ‘baby talk’-un fëmijët e përjetojnë si përqeshje dhe ndëshkim, ndërsa të rriturit besojnë se po solidarizohen me fëmijën.

Në këtë punim, kam listu disa nga problemet më të rëndësishme që po e përndjekin standardin aktual të shqipes:

- Rregullat e shumta dhe përjashtimet që vetvetiu janë rregulla;
- Tejdomenializimi i varietetit standard;

- Eliminimi i paskajores së tipit me+pjesorja;
 - Shpërfillja e inovacionit përmes shkurtimit të pjesores;
 - Metodologjia e hartimit të fjalorëve;
 - Mungesa e gramatikës deskriptive;
- dhe, më e rëndësishmja,
- mungesa e vullnetit për t'i trajtu këto problematika.

Tejdomenializimi i varietetit standard

Shembulli i filmit “Gjurmë të bardha” (i realizuar nga “Kosovafilmi”) është domethënës për tejdomenialitetin e varietetit standard. Jo se “Qortimet e vjeshtës” (i realizuar nga “Kinostudio Shqipëria e re”), ku shkodranët e flasin varietetin standard 30 vjet para Kongresit të Drejtshkrimin, është shembull më pak domethënës, por se për dallim nga Shqipëria, ku Këshilli i Ministrave i kishte dhënë udhëzimet e qarta që varieteti standard të përdorej edhe në film e teatër (Studime filologjike 2/1974:3-6, cituar sipas Ismajli 2005:21-22), në Kosovë nuk kishte një udhëzim të tillë. Këtu veprime vullnetarisht, pasi standardi ishte karta e identitetit nacional. Natyrën identitare të gjuhës e shpjegon Rexhep Ismajli te “Gjuhë standarde dhe histori identitetesh”. Prandaj, shumë autorë i përkthyen në standard veprat e tyre të shkruara para ’72-shit, jo për ta zgjeru audiencën, por për t’u pozicionu nacionalisht identitarisht.

Sociolinguisti Richard Hudson, duke elaboruar funksionet e varietetit standard të një gjuhe, thotë se “është e mundur të përdoret varieteti i përzgjedhur në të gjitha funksionet e ndërlidhura me qeverinë qendrore dhe dhe me të shkruarit: për shembull në parlament, në gjykata, në dokumentet e natyrës byrokratike, arsimore dhe shkencore dhe natyrisht në forma të ndryshme të letërsisë” (Hudson, 1996:33). Në të vërtetë, përdorimi i varietetit gjuhësor në letërsi është çështje e zgjedhjes a vendimit të autorit në raport me audiencën dhe me elementet stilistike të nevojshme, ashtu si edhe filmi e teatri. Mirëpo, në Shqipëri, aparati shtetëror kishte arritë me e përveçësuar edhe letërsinë, edhe filmin, edhe teatrin, si medime të përhapjes së këtij varietetit. Sociolinguistët standardin gjuhësor e shohin si konspiracion të vetëdijshëm të elitave politike që zbatohet përmes elitave kulturore, tekfundit. Në pozita të tilla, letërsia, filmi e teatri nuk i kryenin funksionet e

tyre, por e promovonin një varietet gjuhësor të kultivuar, ndërkohë që arsimit është domeni i përdorimit të gjuhës, ku zakonisht promovohet varieteti standard. Hudson thotë se arsimit ka një marrëdhënie shumë të veçantë me gjuhën standarde si kanali kryesor i transmetimit të brezave të ardhshëm. Në bashkësitë diglotike si gjermanishtja në Zvicër apo në shumicën e botës arabishtfolëse, standardi është gati ekskluzivisht i lidhur me arsimin, pasi askush nuk e përdor standardin në shtëpi” (Hudson 2009)

Në Kosovë e Shqipëri ka ndodhë pothuajse e kundërta – standardit më shumë i është kushtuar rëndësi në përdorim letërsi, teatër e film, sesa në arsim, pasi, përjashto lëndën e gjuhës shqipe, ku bëhen pak përpjekje për përdorimin e varietetit standard, lëndët e tjera, sipas hulumtimeve të kemi bërë, shpjegohen në varietetet dialektor. Tani, kur varieteti standard nuk promovohet mjaftueshëm aty ku e ka vendin për t’u promovuar, por bëhet tejudomenial dhe përdoret detyrimisht në letërsi, në teatër e film, ai varietetet fiton njëfarëllëj prestigji, me ç’rast folësi i pakultivuar vihet në pozita inferiore dhe më shumë i kushton kujdes formës sesa përmbajtjes. Hiperkorreksioni është i pashmangshëm, prandaj.

Eliminimi i paskajores së tipit me+pjesorja

Eliminimi i paskajores del ndër problemet kryesore që e ka penguar akceptimin e varietetit standard.

Paskajorja e tipit me+pjesore është në natyrën e shqipes, apo të paktën në natyrën e njërit prej dy dialekteve të mëdha të saj. Paskajorja, abstrahon vetat, prandaj është e rëndësishme, pragmatike dhe ekonomike për gjuhën.

Në përpjekjen për ta eliminuar paskajoren gege, janë bërë edhe hile - forma “do me thënë” shkruhet bashkë vetëm për t’i humbë gjurmët e paskajores. Pastaj, dikush u kujdes që të ketë edhe një shkurtësë të vështirë për t’u shkruar ‘d.m.th.’, por jo edhe ‘d.t.th.’. Po kështu, paskajorja vërehet edhe në lokucione lidhëzore si “meqenëse”, prapë e shkruar bashkë. Në këto formime paskajorja gege është e konsoliduar edhe në toskërishten.

Mahmet Elezi vëren se paskajorja del edhe te Konica jugor, te Mihal Grameno e te disa këngë beratare e korçare.

Pra, paskajorja do të mund të zinte vend në strukturën e varietetit standard të shqipes, pa e pasë rreziku sistemin foljor të saj.

Eliminimi i paskajores, kështu, e ka privu edhe toskërishten nga përdorimi i saj, ndonëse përpak sa s'që legjitimu në normë, e përdorur në një rast nga Enver Hoxha.

Në tjetër anë, ekzistenca e paskajores mohore e dëshmon pamundësinë e heqjes së trajtës bazë. Kjo do me thënë se nuk mund të ketë mohore pezull, pa e pasë një trajtë të cilën e mohon, së cilës i kundërvihet, me të cilën ndërton çiftin, strukturalisht.

Folësi i gegërishtes, duke e pasë paskajoren në mentalitetin e tij/saj gjuhësor, vështirë se ka me funksionu lirshëm pa të. Zëvendësimi çon drejt kurthesh (a)gramatikaliteti. Më gjerësisht gramatikalitetin dhe ideologjinë e gabimit gjuhësor e ka trajtu Bardh Rugova te “ideologjia e gabimit gjuhësor”. (Rugova, 2022)

Në një hulumtim me 80 respondentë për nevojat e këtij punimi, ata, nxënës klasash të larta të shkollës së mesme, janë lutur ta kthejnë në standard moton e një fushate eventuale: “*Për me u dobësu nuk është mirë më mbajtë dietë, por është mirë me vrapu*”

80 subjekte nga të cilat është kërku që ta kthejnë në shqipen standarde, kanë dhënë përgjigje të ndryshme. 24 subjekte referencën vetore të lidhores e kanë përqendru te veta e dytë njëjës e lidhores; 12 subjekte kanë përdorë vetën e dytë shumës të lidhores (*Për t'u dobësuar nuk është mirë të mbani dietë...*); 13 subjekte referencën vetore e kanë përqendru te veta e parë shumës e lidhores (*Për t'u dobësuar nuk është mirë të mbajmë dietë...*), 6 subjekte të tjera, në pjesën e parë kanë përdorë referencë vetore të vetës së parë shumës, ndërkaq në pjesën e dytë kanë përdorë paskajoren hibride (*Për t'u dobësuar nuk është mirë të mbajmë dietë, por është mirë për të vrapuar*). Vetëm 4 nga subjektet kanë përdorë trajta joveprorë. Kujdes: joveprorë për veprimin (*Për t'u dobësuar nuk është mirë të mbahet dietë, por është mirë të vrapohet*), 2 subjekte kanë përdorë mënyrën urdhërore (*Për t'u dobësuar mos mbaj dietë, por vrapo*) ndërsa 3 subjekte i kanë zëvendësu foljet me emra (*Për t'u dobësuar nuk është e mirë dieta, por vrapimi*).

Rregullat e shumta dhe përjashtimet që vetvetiu janë rregulla

Sipas rregullave të drejtshkrimit, folësi i shqipes duhet ta mësojë përmendësh se shumësi i fjalës ‘mollë’ bën ‘mollë’ e shumësi i fjalës ‘dardhë’ bën ‘dardha’ – ky folës duhet të tregojë se ka ble mollë e dardha. Folësi duhet ta dijë se kur përdoret vit e kur vjet, për ta shkru vit/vite, fjalës iu prapavënëka një përcaktor me kusht që t’i paraprijë një ndajfolje sasive a numëror, etj etj.

Kështu, u përmbys rendi funksional i gjuhës: në vend se gjuha më qenë në shërbim të folësve, folësit u vunë në shërbim të gjuhës.

Pjesorja e shkurtuar – modeli i foljeve apofonike me temë më l, ll, rr

Pjesorja është një trajtë foljore fort e rëndësishme pasi është stemi për ndërtimin e kohëve të përbëra të foljeve: *kam punuar, kam dalë, kisha punuar, kisha dalë, pata punuar, pata dalë*. Mospranimi i pjesores së shkurtuar si element inovativ në shqipen ka qenë dhe mbetet vendim kundër rrjedhës së zhvillimit të natyrshëm të gjuhës. Modeli i foljeve apofonike me mbaresë të temës më **l**, **ll**, **rr** mund t’i shërbejë shqipes për ta pranuar inovacionin e shkurtimeve të pjesores. Folësi mesatar nuk arrin, nuk do, apo nuk ka nevojë ta përfillë këtë rregull. Rrjedhimisht, pjesorja ose shkurtohet përgjithësisht ose ka një hiperkorreksion enorm. Në televizionet e Kosovës janë të rregullta e të përditshme përdorimet hiperkorrektive si “*përcjellur, dalur, marrur*”. Po flasim për folje që përdoren përditë e gjithë ditën, e lëre kur e analizojmë përdorimin e foljeve *vjelë, mjelë, mbjellë, ndjellë*, që janë specifike për domenin.

Nga 80 nxënës të shkollës së mesme të lartë në Prishtinë e Gjakovë, asnjë nuk e ka ditë rregullën e drejtshkrimit për foljet apofonike që dalin me mbaresë të temës më l, ll, rr.

Në televizionet e Shqipërisë, tash kur pjesëmarrësit nuk kontrollohen ideologjikisht, ka vërshim përdorimi të pjesores së shkurtuar. E ndoqa një shoë televiziv “Më lër të flas” në Top Channel. Me siguri që përzgjedhja do të kontestohet mbi ndonjë observim të papjekur akademik, por po flasim për gjuhën në përdorim (deskriptivizmin) e jo për gjuhën se si u dashka të jetë (preskriptivizmin). Në vetëm pak minuta të këtij emisioni, moderatorët dhe mysafirët përdorën të paktën 20 herë pjesoren e shkurtuar.

Metodologjia e hartimit të fjalorëve

Fjalorët e shqipes janë bërë në atë mënyrë që e stigmatizojnë gjuhën e natyrshme, duke u vënë fjalëve të caktuaratribute si ‘krahinarizëm’, ‘lokalizëm’, ‘fjalë dialektore’ etj., me çka fjalët e shqipes i vënë në garë të pabarabartë përdorimi, duke e latentizuar një fond të tërë leksikor të shqipes, thu se dialektet e shqipes nuk janë të shqipes. Shqiptarët hezitojnë me përdorë foljen kqyrë, ndonëse shkalla e intencionalitetit të kryerjes së veprimit dallon shumë nga foljet e së njëjtës tufë semantike ‘shoh’ e ‘shikoj’. Folësit hezitojnë me e përdorë foljen ‘mshel’ pasi nuk është fare në fjalor e kështu me radhë.

Mungesa e gramatikës deskriptive

Gjithashtu, në favor të pjesores së shkurtuar shkojnë edhe të ashtuquajturat forma të mbindërtuara të foljeve, të cilat edhe janë shpërfillë, për të mos leju krijimin e idesë për pragmaticitetin e trajtës së shkurtër të pjesores. Gramatika normative është kujdesë që folësi i shqipes të mos i përdorë në shkrim kohët e mbipërbëra të foljeve: të *tashmen e aktualizuar*: "**Po mësohem** qysh me i bërë numrat në shtyllë se nesër kam test; të *stërshkuarën*: “E **kisha pasë harru** krejt atë grua; të *stërstërshkuarën*: “Verën e kalume **pata me shku** n’pushime po ra ky virus e meta”; të *stërtejshkuarën*: “Kur **kisha me bo** punime rrijsha deri vonë; të *tejtejshkuarën*: “A e din ti që kur **kam pasë punu** n’Prishtinë hala 18 vjet s’i kam pasë, etj.

Përfundimet

Shqipja dhe shqiptarët nuk janë ata/ato të para 50 vjetësh. Gjatë kësaj kohe kanë ndryshu njerëzit dhe rrethanat:

1. po ndodh komunikimi i intensiv dhe i papenguar ndërmjet folësve të shqipes me origjinë të ndryshme dialektore, në situata formale dhe joformale;
2. ka ndodhë relativizimi i pengesave dhe orientimeve ideologjike;
3. ka ndodhë qasja e papenguar në shkencën moderne dhe po mbizotëron deskriptivizmi;

4. po ndodh qasja dhe prania joselektive në medime si gazetaria e letërsia.

5. ka medime alternative – radio, tv, gazeta, portali, libri

Kjo do me thënë se tek tash shqipja e ka arritë fazën e pjekurisë. Rritja e komunikimit intensiv, formal dhe joformal ndërmjet shqiptarëve, do të na e japë një ide më të qartë për t’iu qasë seriozisht fazës së rishikimit të varietetit standard.

Shkenca moderne e diskuton varietetin standard mbi modelin e së natyrshmes kundrejt të së kultivuarës (nature vs. nurture). Edhe pse i kultivuar varieteti standard nuk duhet të jetë i privuar nga të drejtat që i kanë varietetet e tjera gjuhësore, dialektet e të folmet. Varieteti standard ka kuptim vetëm nëse nuk kryhet me përzgjedhjen e bazës dialektore të tij (sado e kontestueshme a jo të ketë qenë ajo përzgjedhje) – standardizimi është proces e jo vendim. Shqipja standarde, vetëm sa është normu, i janë përcaktu rregullat e drejtshkrimi, por nuk nuk ka shku më tej. Më tej e kemi ndërtu kultin e shqipes standarde, madje edhe duke e quajhtë me emra kultpërforcues si ‘shqipe e përbashkët’ a ‘shqipe e njësuar’, si dhe ‘shqipe letrare’ në përpjekjen koxha të suksesshme për t’ia siguru letërsinë si medium zhvillimi. As termi gjuhë e normuar nuk është i saktë, pasi norma reale është gramatikalitet e norma e propaganduar është konvencë - konvenca jo patjetër është e mbështetur në gramatikalitet.

Kjo qasje ka ndërhy për të pengu rrjedhën normale të tij si proces, duke i dalë cung m’udhë secilës përpjekje shkencore për ta bë varietetin standard të përdorshëm dhe në shërbim të folësve të të gjithë shqipes, natyrisht në domenet ku i ka hije.

Literatura

- Agalliu et.al. (1976, 1995, 2002) Gramatika e Gjuhës shqipe1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë
- Agalliu et.al. (1976, 1995, 2002) Gramatika e Gjuhës shqipe 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë
- Byron, Janet (1976). *Selection among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian*, Berlin, Neë York: De Gruyter Mouton,
- Haugen E (1966) Dialect, Language, Nation. *American Anthropologist*, Neë Series, Vol. 68, No. 4 922-935. Blackëell Publishing on behalf of the American Anthropological Association

- Hudson, Richard. (1996). *Sociolinguistics* (second edition). Cambridge University Press, Edinburgh
- Hudson, Richard. (2004). "Ëhy education needs linguistics (and vice versa)". *Journal of Linguistics* 40(1), 105-130
- Hudson, Richard. (2009). Norm, standard, deviation (draft July 2009)
<https://dickhudson.com/papers/>
- Ismajli Rexhep (2005) *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë
- Munishi Shkumbin (2016) *Vështrime sociolinguistike për shqipen standarde*. Zero print. Prishtinë
- Vehbiu Ardian (2011) *Zhargoni antikomunist*. (<https://www.arkivalajmeve.com/-Zhargoni-antikomunist.1047151637/>)
- Libra normative:
- Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe 1973
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1973
- Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës shqipe 1976
- Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe 1980

Prof. dr. Aljula JUBANI
Universiteti i Tiranës

INTEGRIMI NË BE DHE MUNGESA E NJË UDHËRRËFYESI PËR NORMËSIMIN TERMINOLOGJIK NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Bashkimi Evropian është një bashkim i madh shtetesh me një korpus të vetëm legjislativ, i cili aplikohet në shumë fusha. Legjislacioni i BE-së përkthehet dhe përshtatet në ligjin kombëtar dhe zbatohet në gjuhën zyrtare të çdo vendi, edhe të atyre që mëtojnë hapjen e negociatave apo anëtarësimin.

Kjo kërkon kompetencë gjithëpërfshirëse të përkthimit, në qendër të së cilës qëndron kuptimi dhe aftësia për të sjellë dukuri dhe koncepte specifike. Nga këndvështrimi i përkthimit, terminologjia konsiderohet një mjet për zgjidhjen e problemeve të veçanta, ndërsa në terminologji, dokumentet e përkthyer mund të shërbejnë si burim për nxjerrjen e termave kur nuk ka tekste origjinale mbi një temë të caktuar në gjuhën në të cilën përkthehen.

Kumtesa analizon tekste të përkthyer në Shqipëri dhe Kosovë, duke krahasuar nivelin e normativizimit terminologjik dhe saktësisë gjuhësore në përkthimin e këtyre dokumenteve. Çështja kryesore që mbetet për t'u zgjidhur janë strukturat që mund të sigurojnë këtë standardizim dhe si vullneti shtetëror e bën të mundur këtë.

Një dokument i rëndësishëm, në lidhje me përdorimin e shqipes me funksione zyrtare ruhet në arkivin e shtetit. Është një “Lajmërim i Kryesisë së Përkohshme të Vlorës”, drejtuar nga Ismail Qemali, mbi përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në të gjithë vendin, botuar në *Perlindja e Shqipërisë*, 13. 08. 1913, “Duhet që të gjithë ta dinë mirë se ç’është ditën fatbardhë që kur Shqipëria doli më vehte, gjuha shqipe u bë gjuha zyrtare e vendit.”

Veçanërisht Lidhia Drejtësore Drita 1 ka për me vepëru këto qëllime:

-Të futurit e gjuhës shqip midis anëtarëve të saj, ashtu që ç’do anëtar të dijë të shkruajë dhe të ligjërojë gjuhën shqip sa më mirë e pa të metë.

- Të formuarit të skanjeve teknike të gjyqësiës e të përdorurit e të zbatuarit në gjyqësië të gjuhës shqip ligjore pas rregullave letrale.

- Të çpikurit e Kanuneve të nevojshëm për Shqipëriën apo të përkëthyerit në gjuhën shqip Kanunet e botës qytetëruar...

¹ AQSH, “Kryesia e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës”- F. 145, D. XIII-1- Lidhja gjyqësore “Drita”, fl. 1-12

№-1/5258

REGULLIMI
I
LIDHIES DREJTESORE
"DRITA."

Pacëllënie.

Duk me u-ndarë Shqipëria prej Turqisë, për të qënë një Shtet i veçantë e Europian, e, duk me u-parrë nevojën për një rojtje me përparim e qytetërimin një-rëzit e Drejtësisë të ndodhur në Vlorë, në këtë Kryeqytet të përtashëm të Shqipërisë, edhe duk me lidhur bërë shqipëtarisht, biseduar e vëndosën të bashkohën me shoqi-shogrin duk me formuar një lidhje të fortë, për përparimin e mburrimin e gjyqësisë në Shqipëri;

2)

edhe përgjithësisht përparimin e Kombit me anën e Drejtësisë. Përandaj, për të vepëruar regullisht, ngrejtin e nxuar në dritë këtë regullim.

I
FORMIMI E QËLLIMI I
LIDHIES DREJTESORE.

Art. I. Formohet një lidhje drejtësore ndënjë emërin "DRITA", me qëndrim të përkohshëm Vlorën si Kryeqytet. Këjo shogëri, më tutje do t'a ketë qëndrimin në atë vënd që do të quhet Kryeqytet i Shqipërisë i gjyqësor.

Art. II. Qëllimi i Kësaj lidhje është përgjithësisht — të përhapurit, të per-

3)

Krahurit e drejtësisë — në Shqipëri, me që farë do mënyrë legale, e më tëpër — me anën e gjuhës Kombëtare Shqipe — të mburruarit e anëtarëve të lidhies, me që do masë ligjore, si dhe përparimin e Kombit shqipëtar me anë të drejtësisë.

Veçanërisht, lidhja drejtësore "DRITA", ka për me vepëru këto qëllime:

I. Të futurit e gjyqësorisë shqip midis anëtarëve saj, ashtu që që do anëtar të dijë të shkruajë dhe të ligjërojë gjyhen shqip sa më mirë e për të meti.

II. Të formuarit të shkruajëve teknike të gjyqësisë e të përdorurit e të sbotuarit në gjyqësi të gjuhës shqip ligjore, pas

4)

regullare letrale.

III. Të gjukurit e Komunëve të nevojshëm për Shqipëriën apo të përkëthyerit në gjyhen shqip Komunët e botës qytetëruar, edhe për të përhapurit që të vijen këto në ruzë, e të sbotohen pas njëftjes të vërtetimit tyre nga qarket që janë të zotërit.

IV. Të përhapurit e drejtësisë në Shqipërië, me që farëdo masë legale, edhe më fort, me shkrues, libra, monografi, artikuj, meetinge ligjore, a që do masë gjuhë të pëllqyer e me udhë për stërvitien e Shqipëtarëve që të rrijnë midis tyre, si komp i qytetëruar me paqë e me drejtësië.

V. Të përkraturit e a-

Në zhvillimet e mëpastajme shtetërore, edhe me qeveri të huaja, ka pasur sistematikisht vendimmarrje të rëndësishme për gjuhën. Por, siç vë në dukje prof. Ismajli: “Krijimi i shtetit kombëtar për vetëm gjysmën e kombit më 1912 dhe mbetja e gjysmës tjetër nën pushtime të huaja sollën zhvillime të kundërthënshme dhe të ndërlymta. Për gjysmën brenda shtetit shqiptar kjo ishte një nxitje e re në drejtim të arritjeve kombëtare, por ambivalente: jo rastësisht atëherë lindi sllogani: “Shqipëria u bë, të bëjmë shqiptarët”. Kjo ishte po ashtu një shtysë për ndërmarrje me peshë dhe me vlerë në fushën e gjuhës. Kongresi i Manastirit në prag të krijimit të shtetit shqiptar rrezatonte ide dhe mesazhe bashkimi, njësie, ndërmarrjesh të rëndësishme në rrafshin kombëtar. Pastaj vijnë ndërmarrjet, idetë dhe mesazhet në emër të bashkimit e të njësisë, por efektivisht në radhë të parë për gjysmën brenda.”²

Kështu, në Komisinë Letrare në Shkodër një rëndësi të madhe patën edhe vendimet që lidheshin me toponomastikën dhe antroponiminë, terminologjinë e administratës etj.

Po në të njëjtin vit me themelimin e Komissisë Letrare në Shkodër, u ngrit edhe zyra lokale statistikore, drejtuar nga Franz Seiner, për t’u marrë me përgatitjen e regjistrimit të popullsisë në zonën austro-hungareze dhe në vijim të kësaj nisme të ndërmarrë, në vitin 1918, u botua prej Shtypshkronjës Françeskane “Fjalori i emrave të vendeve në Shqipërinë Veriore dhe të Mesme ku shtrinte pushtetin administrativo-ushtarak Komanda e trupave austro-hungareze”³.

Pjesa më e madhe e atyre vendimeve shërbyen si bazë edhe për shqipen zyrtare të kodifikuar në Kongresin e Drejtshkrimit, duke qenë se gjeti një zgjidhje shkencore problemeve themelore të drejtshkrimit të shqipes dhe parimeve teorike mbi të cilat duhet të mbështetej ai. ...e vërteta asht se ma

² Ismajli, R. (2005), Drejtshkrimet e shqipes, ASHAK, Prishtinë, f. 142

³ Seiner, F. (1918), *Ortschaftsverzeichnis für das von den k. u. k. Truppen besetzte Gebiet Albaniens. Zusammengestellt auf Grund der von den k. u. k. Bezirkskommandos vorgelegten Bezirks – Ortschaftsverzeichnisse und der Erhebungen des Landesstatistischen Amtes.* Herausgegeben vom Landesstatistischen Amte des k. u. k. XIX Korpskommandos in Albanien / Direktor: Franz Seiner. - Shkodra (Skutari): Verlag des k. u. k. XIX. Korpskommandos, – XV + 90 f., 20 cm. (Franziskanerdruckerei Shkodra; Shtypshkroja Franciskane)

shum ka bamë në tri vjet Komisia Letrare e Shkodrës se qeveritë shqiptare në njëzet vjet⁴.

Komanda austro-hungareze, pak vite me pas, lejoi përdorimin e simboleve kombëtare, si: flamurin, njohu gjuhën shqipe si gjuhë mësimi e, krahas saj, gjermanishten. U pranua festimi i 28 Nëntorit si festë kombëtare dhe u nxit përpunimi i terminologjisë shqipe të administratës, por dhe asaj arsimore në veçanti.

“... Por, tash, mbas dyë vjetsh të ndëjunit nde ne, prej vedit i epet nierit me pvetë: e po kjo ushtri, e cilla aq me zemer të mirë kje pritë prej Shqyptarve, a bâni gjâ ajo, per me çue në vend idealet e një palve e me vue nevojët e tjervet?...Mjetet mâ të parat, qi nepër gjak, histori e interese të përbashkshme, me u organizue një kom m'vedi e si vehtje morale m'shekull janë:

- a) gjûha komtare,*
- b) guvernimi ase mashtrimi komtar,*
- c) shkolla komtare;*

e të trija kto sende ushtrija p. e rr. i ka qitë në pûnë nder né. Sa hîni në Shqypni, urdhni mâ i parë, nder urdhne mâ të parë qi dha, kje ky, qi gjûha shqype t'njifej per gjûhë zyrtare nder të gjitha zyret e guvernimit civil në Shqypni. E jo veç dha urdhen, qi gjûha shqype t'u njihite per gjûhë zyrtare, por mâ teper urdhenoj, qi të gjith zyrtarët do t'a dijshin me e kndue e me e shkruie ket gjûhë, po deshten me hî nëpûnës nder zyre të Shqypnis ... S'mramit kemi shkollen. Dihet pa dyshim, qi nieri i gjytenuem, per kahë ndiesit shpirtnore, âsht â fort biir i shkollës, kû âsht rritun, se i komit, në të cillin ka lè ... Mirë tue e dijtë, pra, ket punë e Nalta Komandë e ushtris p. e rr. në Shqypni, se pa shkollë komtare s'ka kom Shqyptar, kshtû ka urdhnie, qi në Shqypni t'u çilshin afër 200 shkollash, por ka urdhnie edhe qi në kto shkolla msimi t'ipej në gjûhë shqype e vetem në gjûhë shqype.⁵

Po sot, kur ne jemi duke përpjekur të arrijmë standardet e BE-së dhe të bëhemi pjesë e saj, cilat janë politikat e kujdesit për gjuhën? Çfarë pune

⁴ Kruja, M. (1949) *Mendime mbi trajtimin e gjuhës shqipe*, Shkëndija, Tiranë, XVIII, nr. 2, f. 5 (cituar sipas T. Osmanit, Shekulli i Komisisë..., f. 104).

⁵ Ushtrija austro-ungare e të mkâmunt e Shqypnis. Posta e Shqypnis, 8. Maj 1918, f. 1

bëhet për standardizimin e kësaj terminologjie? Cili është institucioni përgjegjës në shtetet tona?

Ndër prioritetet e Bashkimit Evropian qëndron, vlerësimi dhe promovimi i diversitetit kulturor, si një tipar i rëndësishëm i trashëgimisë materiale dhe imateriale të vendeve anëtare të tij.⁶ Ky parim i rëndësishëm gjen shprehje të drejtpërdrejtë edhe përmes traktateve të ndryshme. Kështu, Neni 165, Pika 2, i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE) thekson se *"Veprimtaria e BE-së do të synojë zhvillimin e dimensionit evropian në arsim, veçanërisht nëpërmjet mësimin dhe përhapjes së gjuhëve të Shteteve Anëtare"*, duke respektuar plotësisht diversitetin kulturor dhe gjuhësor. Ndërsa Neni 342, i po të njëjtit Traktat, sqaron se Neni 342 (TKE) *"Pa cenuar dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, normat që rregullojnë përdorimin e gjuhëve në institucionet e Bashkimit i vendos me unanimitet Këshilli përmes rregulloreve."*

"Në shumë raste, vetë tekstet legjislative të BE-së pasqyrojnë marrëveshjet ndërkombëtare të negociuara më parë dhe kjo do të thotë se përveç terminologjisë së BE-së dhe asaj kombëtare duhet të merret shpesh parasysh terminologjia e teksteve ndërkombëtare, të cilat janë pranuar nga palët brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian. Ky reflektim çon në mendimin se terminologjia mund t'i nënshtrohet një sërë ndikimesh dhe presionesh, që vijnë nga drejtime të ndryshme dhe se mund të ketë një ndikim në kuptimet dhe interpretimet që duhen dhënë, të cilat mund të ndryshojnë në mënyra delikate në varësi të kontekstit. Terminologjia mund të shihet si ekzistuese brenda një lloji 'matrice' të ndërlidhjes së dokumenteve juridikë (e drejta kombëtare, ligji i BE-së, e drejta ndërkombëtare) dhe më pas luan rol të rëndësishëm për gjykatat dhe gjyqtarët që ndjekin procese gjyqësore përmes kësaj edhe interpretimit të kësaj matrice, si edhe zbatimin e tyre në çështjet e paraqitura për zgjidhje, - shkruan Robertson⁷

Vendet e Ballkanit Perëndimor, në këtë rrugëtim, kanë hapësira të shumta për të punuar së bashku për ndërtimin e politikave më të mira të bashkëpunimit në këtë fushë dhe, përmes tyre, për zhvillimin e kompetencës

⁶ Korniza strategjike për kulturën: <https://culture.ec.europa.eu/policies/strategic-framework-for-the-eus-cultural-policy>

⁷ Robertson, Collin (2011) Multilingual Legislation in the European Union. EU and National Legislative-Language Styles and Terminology, Research in Language, vol. 9.1, f. 52

gjuhësore të folësve të tyre, në mënyrë të veçantë në konsolidimin e terminologjisë juridike, ekonomike, politike e kulturore, në dritën e një mendësie komunitare e të një demokracie të konsoliduar që sjellin si model vendet e BE-së.

Marrëdhënia ndërmjet përkthimit dhe terminologjisë është trajtuar nga autorë të ndryshëm si në fushën e përkthimit, ashtu edhe të terminologjisë. Terminologjia i shërben përkthimit si një mjet, ndërsa në terminologji, dokumentet e shkruara në një fushë të caktuar mund të shërbejnë si burim për nxjerrjen e termave. Kur mungojnë tekste origjinale me terminologjinë e një fushe, apo mungojnë termat, përkthyesve u duhet shpesh të punojnë për krijimin e një terminologjie të veçantë. E këtu i kthehemi sërish pyetjes së hershme të Ciceronit kur më së pari përkthen ligjëratat e Dimostenit dhe të Eskinit dhe ngre një çështje themelore teorike që ka dominuar përkthimin për dy mijë vjet: nëse përkthyesi duhet t'i jetë besnik fjalëve apo mendimit që përcjell teksti. Zgjidhja që propozon Cicero tashmë përbën parim themelor: "Unë i përgatita duke u sjellë jo si përkthyes i thjeshtë [ut interpretes], por si shkrimtar [sed ut orator], duke respektuar strukturën e fjalive, me figura fjalësh apo mendimesh, duke përdorur, gjithsesi, terma të përshtatshëm me praktikën tona latine. Kështu, nuk e kam konsideruar të nevojshme të përkthej çdo fjalë me një fjalë [verbo verbum reddere]; e megjithatë kam ruajtur të paprekur kuptimin thelbësor dhe vlerën e të gjitha fjalëve. [...] Sepse në të vërtetë lexuesit duhet t'i interesojë – sipas meje – që t'i ofrohet, nga këto fjalë, jo numri i fjalëve, por pesha e tyre."⁸

Në procesin e punës që përkthyesi kryen, e përdor terminologjinë, por edhe synon të përmbushë nevojat terminologjike të përkthimit.

Me këtë të fundit lidhet edhe më shumë puna e përkthyesve për përkthimin e dokumentacionit të BE-së.

Siç sqaron edhe Cabré, problemet mund të lidhen me arsye të ndryshme, si:⁹

⁸ Cituar sipas: Mouinin, Georges (2006), *Teoria e storia della traduzione*, Einaudi Editore, Torino, Itali, f. 31

⁹ Cabré, M. Teresa (2010) *Terminology and translation*, *Handbook of Translation Studies* (Volume 1), Edited by Yves Gambier and Luc van Doorslaer, John Benjamins Publishing Company Amsterdam/Philadelphia, f. 359

– *Mosnjohja e plotë ose e një pjese të një termi, kuptimi, përdorimi gramatikor ose vlera pragmatike në gjuhën burimore.*

– *Pasiguria nëse në gjuhën në të cilën përkthehet ekziston një njësi e leksikalizuar semantike dhe pragmatikisht ekuivalente me termin e përdorur në tekstin origjinal.*

– *Dyshimi nëse një njësi e caktuar, e gjuhës në të cilën përkthehet, është ekuivalenti më i përshtatshëm i huazuar midis alternativave të gjetura.*

– *Mosnjohja ose pasiguria për frazeologjinë e përdorur në një fushë të caktuar.*

– *Pamundësia për të gjetur një njësi (term) leksikore, sepse specialistët nuk e përdorin këtë për të komunikuar mbi një temë të caktuar.*

– *Mungesa e një njësie leksikore të kënaqshme nga pikëpamja gjuhësore, sepse specialistët përdorin sistematikisht huazimin.*

– *Mungesa e një njësie të standardizuar, për të cilën të jetë rënë dakord nga specialistët apo të sanksionuar nga organet e standardizimit apo normalizimit.*

Për këtë është domosdoshmëri krijimi i një baze të dhënash nga komunikimi i gjallë, me tekste të fushës, të cilat duhet të jenë një - dy - apo - shumëgjuhëshe.

Ashtu si në parimin themelor mbi përkthimin, të shkruar nga Ciceroni, pika më e rëndësishme mbetet që konceptet themelore gjuhësore të kuptohen kudo në të njëjtën mënyrë, në zbatimin e të njëjtave akte ligjore, në të gjitha shtetet dhe në të gjitha gjuhët e Bashkimit Evropian. Kjo mund të bëhet vetëm duke pasur një terminologji të standardizuar dhe të unifikuar. Çka kërkon një strategji shtetërore, e cila duhet të shoqërohet me një plan konkret veprimi dhe ngritjen e infrastrukturës së nevojshme. Duke parë, në mënyrë të shpejtë, se si veprojnë institucionet evropiane për realizimin me sukses të një sipërmarrjeje me përmasa të jashtëzakonshme, mund të shërbejë si model për çfarë duhet bërë në Shqipëri dhe Kosovë.

Për këtë qëllim është ngritur edhe IATE (Inter-Active Terminology for Europe)¹⁰, databaza e terminologjisë ndërinstitucionale e BE-së. Projekti u shpall në vitin 1999, me synimin për të ofruar një infrastrukturë të bazuar

¹⁰ <https://www.europarl.europa.eu/translation/en/terminology/about-iate>

në web për të gjitha burimet terminologjike të BE-së, për të përmirësuar disponueshmërinë dhe standardizimin e informacionit.

Versioni i ri aktual i IATE-s u publikua më 7 nëntor 2018, pas një rindërtimi të plotë të sistemit me teknologjitë më të fundit, standardet më të fundit të zhvillimit të softuerit, praktikat më të mira mbi përdorueshmërinë dhe aksesin. Baza e të dhënave administrohet nga Grupi i Menaxhimit IATE me përfaqësues nga institucionet e mëposhtme:

Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, Gjykata Evropiane e Auditorëve, Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social, Komiteti i Rajoneve, Qendra e Përkthimit për Organet e Bashkimit Evropian, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve.

Në zbatim të kësaj nisme, edhe vendet tona të rajonit patën nisur një projekt të përbashkët, i cili është ende i konsultueshëm on line. Krijimi i kësaj baze të dhënash u bë në kuadër të projektit Mbështetje për Ministrinë Shqiptare të Integritimit Evropian (SMEI II)¹¹. Ky projekt financohej nga Bashkimi Evropian (IPA 2008) dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë (BMZ) dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Por informacioni mbi përditësimin e të dhënave për shqipen është i pamjaftueshëm.

Kjo bazë të dhënash u shoqërua edhe me një doracak, udhëzues për përdorimin e tij, financuar nga GIZ. Një nismë shumë e rëndësishme në rrugëtimin tonë evropian e që është nevojshme të rifreskohet. Për gjuhën shqipe ajo përmban 18316 njësi terminologjike, kurse për serbishten 54310 njësi.

Së pari, vlen të theksohet se dyja shtetet tona, Shqipëria dhe Kosova, janë në proces të përafrimit me standardet e BE-së dhe kemi të njëjtën gjuhë standarde. Gjithsesi, sa i përket punës për përkthimin dhe përshtatjen e legjislacionit, ka nevojë për një koordinim e standardizim më të mirë, si sa i takon secilit shtet, por edhe mes të dyja shteteve. Për të analizuar cilësisht përshtatjen terminologjike të dokumenteve të BE-së, kemi marrë në shqyrtim disa prej tyre, por këtu do të ndalemi veçanërisht në Marrëveshjet

¹¹ <http://albania.anyterm.info/index.php?jezik=shqip>

e Stabilizim Asociimit për Shqipërinë dhe Kosovën, e duke i krahasuar ato me origjinalet në anglishte. Shqyrtimi i këtyre dy dokumenteve na ndihmon edhe për përjasjen mes terminologjisë së përdorur në Tiranë dhe në Prishtinë, duke qenë se tekstet origjinale janë thuajse të njëjta.

Po rendisim në vijim vetëm disa prej problematikave të shfaqura nga shqyrtimi i teksteve të përkthyer:

1. Shpesh përkthimi kryhet si një kalkim, apo përkthim *ad literam*, çka bën që struktura e fjalisë, pra, edhe mendimi të ndërtohet si në gjuhën prej nga është marrë teksti dhe në shqip.

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOSOVËS, NË NJËRËN ANË, DHE BASHKIMIT EUROPIAN DHE KOMUNITETI EUROPIAN TË ENERJISË ATOMIKE, NË ANËN TJETËR		MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOMUNITETEVE EUROPIANE E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	
the relevant preferential treatment of the product(s)	...trajtimin privilegjues të produktit/produkteve përkatës në përputhje me këtë nen.	...relevant preferential treatment of the product(s) concerned in accordance with this Article	Pala e prekur mund të pezullojë përkohësisht trajtimin privilegjues të produktit/produkteve përkatës në përputhje me këtë nen.
Kosovo shall endeavour to ensure that its existing law and future legislation will gradually be made compatible with the EU <i>acquis</i> .	Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me acquis-in e BE-së.	Albania shall endeavour to ensure that its existing laws and future legislation shall be gradually made compatible with the Community <i>acquis</i> .	Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me acquis e Komunitetit.

2. Të kuptuarit e terminologjisë në mënyra të ndryshme dhe përdorimin e gjegjëseve të ndryshme në shqipe, çka lidhet me mungesën e standardizimit dhe harmonizimit të terminologjisë.

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOSOVËS, NË NJËRËN ANË, DHE BASHKIMIT EUROPIAN DHE KOMUNITETI EUROPIAN TË ENERGIJË ATOMIKE, NË ANËN TJETËR		MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOMUNITETEVE EUROPIANE E SHTE-TEVE TË TYRE ANËTARE DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	
“Establishment” means the right to take up economic activities by means of the setting up of companies including subsidiaries and branches in the EU or in Kosovo respectively;	"Themelimi" nënkupton të drejtën për të zhvilluar një veprimtari ekonomike duke themeluar kompani ...	‘Establishment’ shall mean:	"Ndërmarrje" nënkupton:
“EU national” and “citizen of Kosovo” means respectively a natural person who is a national of a Member State or a citizen of Kosovo;	"Shtetas i BE-së" dhe "Qytetar i Kosovës" nënkuptojnë një person fizik i cili është shtetas i Shtetit Anëtar apo qytetar i Kosovës	‘Community national’ and ‘Albanian national’ shall mean a natural person who is a national of one of the Member States or of Albania respectively.	"Shtetas Komunitar" dhe "shtetas shqiptar" nënkuptojnë përkatësisht një person fizik i cili është shtetas i një prej Shteteve Anëtare ose i Shqipërisë.

3. Të kuptuarit në mënyrë të gabuar dhe tjetërsim të konceptit në përkthim.

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOSOVËS, NË NJËRËN ANË, DHE BASHKIMIT EUROPIAN DHE KOMUNITETI EUROPIAN TË ENERGIJË ATOMIKE, NË ANËN TJETËR		MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOMUNITETEVE EUROPIANE E SHTE-TEVE TË TYRE ANËTARE DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	
Either Party may denounce this Agreement by notifying the	Secila Palë mund të shpall të pavlefshme këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën	Either Party may denounce this Agreement by notifying the	Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën

other Party. This Agreement shall terminate six months after the date of such notification	veshje duke njoftuar Palën tjetër. Kjo Marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.	other Party. This Agreement shall terminate six months after the date of such notification	tjetër. Kjo Marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.
The General Secretariat of the Council of the European Union shall be the depositary of this Agreement	Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian do të jetë depozitari i kësaj Marrëveshje.	The Secretary-General of the Council of the European Union shall be the depositary of this Agreement.	Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian do të jetë visari i Marrëveshjes.

4. Mosrespektim të normës gramatikore dhe drejtshkrimore, çka, veç të tjerash, mund të shkaktojë edhe pasaktësira përmbajtëso-re. Kjo është një problematikë e ndeshur me një denduri të madhe.

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOSOVËS, NË NJËRËN ANË, DHE BASHKIMIT EVROPIAN DHE KOMUNITETI EVROPIAN TË ENERGJISË ATOMIKE, NË ANËN TJETËR	MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOMUNITETEVE EUROPIANE E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
	e vendet e Europës juglindore
e kësaj Marrëveshje	
ky proces do të shpie	
në Kopenhagë	
për t'i kontribuar	për të kontribuar
sistem shumë partiak	
kjo marrëveshje do të krijon/ të bashkëpunoj, të veproj	
	në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut
elementët thelbësorë	elementët thelbësorë
ato nuk e kanë ndërmarr,	
	Konçesione
	të gjithë instrumentet e tjera

dialogjet politike dhe dialogjet për politika	
zotimet e saja	zyrat e saja
Kosova do të vazhdon të zbatoj	
	për tu siguruar,
produkteve tjera/ çështje tjera	
masat e miratuara mbrojtëse duhet të konsistojnë me pezullimin...	
Në rast se BE-ja ose Kosova ju nënshtrihen ...	
i transferuar brenda korporatës	"i transferuar brenda-kompanisë" - An 'intra-corporate transferee'
Dallimi në trajtim nuk e tejkalon atë që është e domosdoshme për shkak të dallimeve legjislative ose teknike	
Kosova angazhohet që t'iu përmbahet çdo konvente	
pa cenuar	Pa çenuar paragrafin 1
	parimit të mos-diskriminimit
	Neni 122: Parlamenti Evropian Parlamenti Europian Parlamenti shqiptar Parlamenti Shqiptar
Neni 74.2. në tërë elementët e <i>acquis</i> -it të BE-së të cekura në këtë Marrëveshje	
Neni 74.3. do të përqendrohet në elementet thelbësorë të <i>acquis</i> -it të BE	
Neni 86 Kosova do t'i jap të drejta reciproke shtetasve të BE-së ...	
Neni 140 mos-pajtueshmërisë	
shtojca 1, Tarifatat koncesionare të Kosovë	Shtojca 1, TARIFAT E KONCESIONEVE SHQIPTARE

Kroacia perktheu 8700 faqe legjislacion parësor (traktate, etj) dhe 123.400 faqe dytesor (rregullore e direktiva). Kostoja totale ishte rreth 10-12 milione euro. Duhet theksuar qe kjo ishte para 15 vitesh dhe që atëherë volumi i faqeve të *acquis* dytesor është dyfishuar. Vetëm në dy dekadat e fundit konsiderohet se është prodhuar më shumë se 200.000 faqe *acquis*. Në

total, që nga fillimi i projektit evropian, vetëm 26% e legjislacionit të prodhuar është sot ende në fuqi, pasi ai është zëvendësuar vazhdimisht me legjislacion të ri. E gjitha kjo na dëshmon se çfarë pune të madhe duhet të nisim e me ngut, për të siguruar cilësinë e përkthimit, ekonomizimin e energjive njerëzore dhe reduktimin e kostove financiare.

“Tekstet e *acquis communautaire*, të njohura gjithashtu si tekste institucionale-ligjore të BE-së (në vijim të referuar si 'dokumentet e BE-së'/tekstet e BE-së), janë dokumente ligjore mbikombëtare të hartuara në sfondin e dallimeve socio-kulturore midis shteteve anëtare individuale të BE-së. Për atributet e tyre specifike, të cilat duhet të merren parasysh në përkthimin e tyre shumëgjuhësh për të mundësuar komunikimin në një botë panevropiane. Në natyrën e tyre, dokumentet e BE-së janë instrumente serioze ligjore, të cilat transpozohen në legjislacionet kombëtare të Shteteve Anëtare përkatëse. Përkthimi i *acquis communautaire* për të gjitha vendet kandidate përpara anëtarësimit të tyre në BE përbën projektin më të rëndësishëm të përkthimit të materializuar ndonjëherë në historinë e përkthimit të specializuar. Përpara zgjerimeve të 2004 dhe 2007 të Bashkimit Evropian, të gjitha vendet kandidate ishin të detyruara të përkthenin të gjithë legjislacionin e BE-së në gjuhët e tyre amtare, të cilat përfaqësonin përkatësisht pothuajse 90,000 dhe 120,000 faqe (Bednárová-Gibová, 2015, f. 43). Këto shifra e bëjnë përkthimin e *acquis* një rekord të pashembullt në përkthimin e specializuar dhe dëshmojnë për pafundësinë e kulturës përkthimore panevropiane.”¹²

Kjo parashtrësë synonte, që, përmes paraqitjes së problematikave gjuhësore, të mbërrijë atje ku qëndron burimi i zgjidhjes së problemit, krijimi i strukturave institucionale me angazhimin e përkthyesve, gjuhëtarëve e veçanërisht terminologëve, specialistëve të teknologjisë së informacionit dhe ekspertëve të integritit evropian, për ta orientuar si duhet kontributin tonë në këtë proces shumë të rëndësishëm për të gjithë ne dhe që, me hyrjen në BE, sigurisht që për përkthimin shqip do të kemi një sportel të përbashkët.

¹² Bednárová-Gibová, Klaudia (2016), *Acquis communautaire as supranational legal texts and their interlingual reproduction across multilingual Europe*, në *Procedia - Social and Behavioral Sciences* 236, f. 162

Dr. Elsa SKËNDERI
Universiteti i Tiranës

IDEOLOGJIA NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT GJUHËSOR (*RASTI I KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT*)

Abstrakt

Qëllimi i kësaj kumtese është të trajtojë ndikimin e ideologjisë në politikën gjuhësore gjatë komunizmit, në Shqipëri. Pa mëtuar të korrigjojmë, ca më pak shterueshëm, qasjet idealizuese, që thuajse janë kalcifikuar në diskursin tonë metalinguistik, mbi rëndësinë dhe produktet e planifikimit gjuhësor gjatë diktaturës, që kulmojnë me Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1972), synojmë të hedhim dritë mbi praninë e skajshme të ideologjisë, qoftë si ideologji politike ashtu edhe si ideologji për gjuhën e njësuar letrare. Në rastin e shqipes së njësuar, *ideologjia e gjuhës standarde* nisi të përhapet që përpara Kongresit të Drejtshkrimit dhe u përforcua me anë të tri argumenteve kryesore: a) nevoja praktike për një gjuhë të njësuar në gjithë gamën e veprimtarive shtetërore, botuese dhe shkollore, që do t'i shërbente edhe unitetit kombëtar; b) njësimi i shqipes letrare si vepër e Partisë së Punës e produkt i Shqipërisë së re; c) argumenti i dakordësisë me Kosovën, (në kuadër të Konsultës së Prishtinës), i përmendur në vijimësi për të nënvizuar karakterin mbarëkombëtar të vendimeve të Kongresit. Gjurmët e ideologjisë duken qartë, që në diskutimet njëzet vite para Kongresit të Drejtshkrimit, të paraqitura në Buletinin e Shkencave Shoqërore (1952), ku vihet re: a) Ndikimi i tezave staliniste për gjuhën, si kornizë teorike e ideologjike për të orientuar vendimmarrjen rreth gjuhës së njësuar (letrare) kombëtare; b) Ballafaqimi i dy tezave për ngritjen e gjuhës së njësuar mbi bazën e njërit prej dialekteve, ku mbizotërojnë qëndrimet në mbështetje të dialektit tosk; c) gjuhësia preskriptive “e kolltukut” dhe Enver Hoxha si autoritet gjuhësor e folës model. Më tej, në këtë kumtesë procesi i planifikimit gjuhësor gjatë regjimit komunist zbërthehet sipas ‘skemës vlerësuese’ të gjuhëtarit R. Cooper, duke u ndalur sidomos te motivet e planifikimit gjuhësor. Për fund, kumtesa trajton çështjen e politikave gjuhësore implicite të sotme dhe prijet bashkëkohore për të zbatuar ato politika, që nuk i imponojnë nga lart-poshtë, por i reflektojnë realitetet gjuhësore konkrete.

Fjalët çelës: *Ideologji, diskurs metalinguistik, Kongresi i Drejtshkrimit, politikë gjuhësore, planifikim gjuhësor.*

I. Ideologjia e gjuhës dhe planifikimi gjuhësor

Qëndrimet gjuhësore, praktikat gjuhësore dhe planifikimi gjuhësor janë përherë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me ideologjinë. Termi ideologji sipas një përkufizimi denotativ shënjon *këndvështrimet për botën*, ndërsa për T. Van Dijk-ut (1993), *ideologji* konsiderohet tërësia e përfaqësimeve dhe sjelljeve të organizuara në mënyrë skematike, në lidhje me aspekte të caktuara të botës shoqërore. Megjithatë, ideologjia ka shpesh përdorime dhe konotacione negative, sidomos në shoqëritë që kanë një të shkuar diktatoriale, sepse në funksion të saj shpesh është cenuar dhe tjetërsuar liria dhe thelbi i natyrshëm i shumë veprimtarive e praktikave shoqërore. Në shoqëritë me të shkuar komuniste, Bermel (2007, 28) thotë se, termi ideologji përdoret si sinonim i gjysmë të vërtetave dhe i deklaratave të pasakta. Me këtë kuptim fjalën ideologji e hasim shpesh në ligjërimin publik në Shqipëri.

Koncepti i ideologjisë është mjaft i përhapur në studimet e shkencave humane dhe gjerësisht i përdorur edhe në studimet gjuhësore, sidomos në lëmi si sociolinguistika, antropologjia gjuhësore dhe analiza kritike e diskursit. I pari, që mendohet se bën bashkë ideologjinë dhe gjuhën në një term, është M. Silverstein (1978), i cili e përdor termin ideologji gjuhësore për të shënuar tërësi besimesh për gjuhën, të artikuluar nga përdoruesit si arsyetim ose justifikim për të përdorur apo perceptuar një strukturë gjuhësore. Ndërkaq, në korpusin e studimeve gjuhësore termi ideologji shfaqet në mënyra të larmi-shme: *ideologji puriste*, *ideologji e gjuhës*, *ideologji e standardizimit* (shih për këto terma Woolard 1992, 236), *ideologji e dialektit* (Watts 1999) etj.

Sa i takon çështjes së planifikimit gjuhësor, J. Bloomaert (1999) thekson se studimi i rolit të ideologjisë në procesin e planifikimit gjuhësor është mjaft i rëndësishëm, sepse shpesh planifikimi gjuhësor është trajtuar “duke idealizuar efektshmërinë e vendimeve politike ndaj ndryshimeve sociale. Shpesh përdoret një model linear, sipas të cilit ndryshimet shoqërore nxiten nga vendimet politike të mbështetura nga ekspertët (dhe shpesh të ndërmjetësuar nga institucione eksperte). Pak hapësirë i lihet rezistencës kulturore apo shoqërore kundër vendimeve të tilla dhe efekti i nxitur i ndryshimit të gjuhës mbivlerësohet së tepërmi (30)”. Sipas Bloomaert-it studimi i ideologjisë gjuhësore është i rëndësishëm për t’i korrigjuar qasjet idealizuese edhe ndaj planifikimit gjuhësor.

Në këtë shkrim nuk mëtojmë të korigjojme, ca më pak shterueshëm, qasjet idealizuese, që thujse janë kalcifikuar në diskursin tonë shkencor gjuhësor mbi rëndësinë dhe produktet e planifikimit gjuhësor gjatë diktaturës, që kulmojnë me Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1972), por synojmë të hedhim dritë mbi praninë e tejskajshme të ideologjisë qoftë si ideologji politike ashtu edhe si ideologji për gjuhën e njësuar letrare apo si ideologji standardizimi.

II. Objektiviteti (i pretenduar) i diskursit shkencor linguistik

J. Blommaert (1996) e konsideron traditën e planifikimit gjuhësor si diskurs për gjuhën dhe shoqërinë. Ai thotë se në planifikimi gjuhësor është në mënyrë të pashmangshme i ngarkuar ideologjikisht dhe ndërtohet mbi supozime implicite rreth asaj se çfarë është një “shoqëri e mirë”, çfarë është gjëja më e mirë për njerëzit, për mënyrën në të cilën gjuha dhe komunikimi janë pjesë e kësaj tabloje dhe për mënyrën se si planifikimi gjuhësor ndikon progresin shoqëror e politik (215). Ndonëse planifikimi gjuhësor, si diskurs për gjuhën dhe shoqërinë mbart ngarkesa të pashmangshme ideologjike, ai shpesh sendërtohet nga një tjetër diskurs, që duhet të jetë ontologjikisht sa më objektiv, që është diskursi shkencor.

Diskursi shkencor është diskurs i një lloji të mëvetësishëm, ndryshe nga diskurset e tjera, pikërisht për shkak të mënyrës se si prodhohet, verifikohet dhe shpërndahet e ashtuquajtura dije shkencore. Gjithsesi, shumë shpesh diskursi shkencor e gjen rrugën e vet në diskurset e tjera, te të cilat shpaloset në formën e një dijeje metashkencore, duke bërë të mundur kështu qarkullimin e dijes shkencore në ligjërimin joshkencor; rasti tipik është përhapja e informacioneve shkencore përmes ligjëritimit mediatik. Si pasojë e “rrjedhjes” së diskursit shkencor në diskursin joshkencor dija shkencore ndodh të modifikohet e tjetërsohet në këtë proces përcimi nga një lloj i ligjëritimit të tjetri dhe nga një instancë e prodhimit të dijes te një tjetër instancë e perceptimit të saj.

Çështja e modifikimit dhe e tjetërsimit të dijes shkencore vjen e ndërlikohet, kur bëhet fjalë për shkenca humane, që janë më afër dijes së përgjithshme dhe përvojës jetësore të publikut. I tillë është për shembull rasti i dijes gjuhësore, që lidhet me tema si gjuha standarde, raportet mes dialekteve, norma gramatikore e drejtshkrimore, kontaktet mes gjuhëve etj. etj.

Dija shkencore gjuhësore, përveç “risqeve” të çdo dijeje shkencore për t’u tjetërsuar në ligjërimin e përgjithshëm publik, shoqërohet edhe me “risqe” shtesë që mund ta cenojnë *shkencoren* në këtë dije. Së pari, për shkak të karakterit publik të gjuhës (më saktësisht të të folurit, që përbën edhe objektin e gjuhësisë) çdokush mundet fare mirë të ketë një ‘opinion’ dhe qëndrim gjuhësor (*language attitude*), me të cilin të vërë në diskutim argumentin shkencor.

Së dyti, në rrjedhë të historisë së gjuhësisë, janë të dëshmuara rastet e shumta kur ideologjia (lingvistike dhe/ose ekstralingvistike) kanë ndikuar drejtpërdrejt atë që është konsideruar si “qëndrim shkencor” zyrtar – i pranuar nga “praktika sociokulturore e institucionit (shkencor)” (për t’u orientuar rreth këtyre hallkave, shih modelin e N. Fairclough-it në fig. nr. 1), që lidhet me kushtet e prodhimit dhe të interpretimit, në këtë rast, të diskutit shkencor gjuhësor.

Së treti, vetë procesi i standardizimit të një gjuhe dhe i përzgjedhjes së politikave gjuhësore, është i kushtëzuar nga faktorë ekstralingvistikë (politikë, ideologjikë, ekonomikë, socialë etj.), për pasojë ekstrashkencorë, faktorë të cilët e bëjnë përsëri të diskutueshme shkencoren e dijes gjuhësore, ndonëse kjo dije mund të jetë prodhuar në institucione me natyrë shkencore, siç është rasti i Akademive të shkencave, kongreseve e tubimeve shkencore etj. Në mënyrë të veçantë, aktorët që në vetvete janë ekstralingvistikë, i ndikojnë politikat gjuhësore.




Figura 1 Korniza e analizës kritike të diskutit, sipas N. Fairclough-it (1995)

III. Diskursi metalinguistik për gjuhën letrare të njësuar

Është i njohur fakti që krahas politikës gjuhësore ndërtohet e përpunohet në vijimësi edhe një komunikim publik me funksion ideologjik, një diskurs metalinguistik, për të legjitimuar varietetin e ngritur në standard. Në rastin e shqipes së njësuar, *Ideologjia e gjuhës standarde* (e quajtur gjuha e njësuar letrare) nisi të përhapet që përpara Kongresit të Drejtshkrimit (1972) dhe u përforcua me anë të tri argumenteve kryesore që ishin ngushtësisht të lidhur me njëri-tjetrin:

Së pari, *nevoja praktike* për një gjuhë të njësuar në gjithë gamën e veprimtarive shtetërore, botuese dhe shkollore, që do t'i shërbente edhe unitetit kombëtar.

Së dyti, *njësimi i shqipes letrare u konsideruan si vepra të Partisë së Punës, produkt i Shqipërisë së re*. I gjithë diskursi shkencor i kohës ishte i mbingopur me ideologjinë marksiste-leniniste dhe prijëse e çdo disipline shkencore konsiderohej shkenca marksiste: “Shkenca jonë e re ka fatin e mirë të ketë shkencën sovjetike, shkencën pararojë shëmbull të shkëlqyer në rrugën e zhvillimit të saj. [...] Duke marrë shembull nga shkenca sovjetike nënë udhëheqjen e Partisë sonë njerëzit tanë t shkencës po përpiqen ta vënë gjithë dijen e tyre në shërbim të ndërtimit të socializmit në vendin tonë” (Pollo *et al.* 1952).

Në këtë frymë, Mahir Domi do të shprehej (1952, 85) “me që konditat të gjitha na i ka krijuar sot Pushteti dhe Partia, nuk duhet të lëmë që gjuha jonë të zhvillohet në mënyrë anarqike, por të ndërhyjmë e të vëmë gjithë kujdesin tonë, që të gjejmë zgjidhje të drejta, të ndihmojmë në pasurimin e gjuhës sonë, në kristalizimin e formave gramatikore, n’unifikimin e përcaktimin e terminologjisë e në zgjidhjen e problemeve t tjera të shumta, që i dalin përpara gjuhësisë sonë për ta bërë kështu gjuhën shqipe një mjet të fuqishëm të revolucionit kultural në vendin tonë”.

Të njëjtin qëndrim e gjejmë në shumë prej studiuesve të periudhës para Kongresit të Drejtshkrimit, si për shembull në rastin e Dh. Shuteriqit (1952), i cili nënvizonte “Të mos harrojmë gjithashtu se ne kemi një tjetër fat shumë të madh, që ndonjë i paku e ka pasë n’Evropë: gjuha jonë kombëtare letrare po e kryen procesin njëzim të saj gjatë ndërtimit të socializmit

në Shqipëri, d.m.th. në kohën kur sheshohen ndarjet krahinore, kur njëzimi i kombit tonë, gjer dje i pamjaftueshëm, po kryhet me hape të shpejta, kur kemi mundësinë ta drejtojmë punën tonë mbi gjuhën sipas teorisë gjeniale staliniane” (Shuteriqi, 1952, 23). Ndërsa në shkrimin ku njoftohet mbajtja e Kongresit të Drejtshkrimit në revistën Nëndori (1973 nr. 1), E. Lafe shkruan: “Vlerësimi i lartë që i bëri shoku Enver Kongresit të drejtshkrimit si një fitore e pallogaritshme në mes të aq fitoreve të tjera madhështore që ka korrur populli ynë me luftë, me përpjekje e me zotësi është një frymëzim i madh për punonjësit e gjuhësisë, të shkollës, të letërsisë e të shtypit shqiptar” (Lafe 1973, 5).

Gjuhëtari i mirënjohur në fushë të studimeve për planifikimin gjuhësor, R. Cooper (1989) thekson se planifikimi gjuhësor nuk kryhet asnjëherë për hir të planifikimit, por në fakt për të arritur qëllime jolinguistike. Të njëjtin qëndrim kanë edhe Milroy dhe Milroy (1999), të cilët theksojnë se standardizimi si proces është në radhë të parë i motivuar nga nevoja të ndryshme shoqërore, politike dhe komerciale “dhe promovohet në mënyra të ndryshme, përfshirë përdorimin e sistemit shkrimor, që standardizohet relativisht lehtë, por standardizimi i një gjuhe të folur nuk arrihet kurrë (e vetmja gjuhë plotësisht e standardizuar është një gjuhë e vdekur)” (19). Standardizimi është më tepër mëtim teoriko-ideologjik se sa realitet i arritshëm objektivisht.

Në rastin e shteteve diktatoriale qëllimet ideologjike të nismës për të njësuar gjuhën janë lehtësisht të lexueshme. Për të hequr paralele, mjafton të shohim qëndrimin e regjimit fashist në Itali, gjatë të cilit u sanksionuan politika gjuhësore thellësisht puriste, por edhe tepër represive, veçanërisht sa i takonte përdorimit të gjuhëve të huaja e sidomos të minoriteteve, por edhe ndaj dialekteve. Çdo shfaqje gjuhësore që cenonte integritetin kombëtar dhe unitetin kulturor ishte e ndaluar. Prirja shtrënguese e njësuese, shkoi deri në absurditet, sa kërkonte deri edhe ndryshimin e mbishkrimeve të varreve, nëse nuk ishin në përputhje me normën gjuhësore zyrtare. Sidoqoftë, politikat gjuhësore të fashizmit, ndonëse skajshmërisht shtrënguese, shprehen studiuesit, nuk sollën ndryshime të mëdha në përdorimin e gjuhës, përveçse konsoliduan paragjykimet dhe stigmatizimin rreth përdorimit të varieteteve gjuhësore të konsideruara jostandarde (Blackwood, Tufi 2016, 26).

Në rastin e Shqipërisë diktatoriale, nëse shihen nga afër diskutimet e

kryera njëzet vite para Kongresit të Drejtshkrimit, të paraqitura në botimin e Buletinit të Shkencave Shoqërore (1952) vihet re lehtësisht prania e theksuar e ideologjisë së regjimit komunist dhe e ideologjisë së gjuhës së njëzuar:

- *Ndikimi i tezave staliniste për gjuhën*, si kornizë teorike e ideologjike për të orientuar vendimmarrjen rreth gjuhës së njëzuar (letrare) kombëtare. I gjithë argumentimi në diskutimet e vitit 1952, për çështjen e *gjuhës nacionale*, mbështetej mbi qëndrimet e Stalinit për gjuhën nacionale. “Shoku Stalin thotë se “një nga dialektet mund [...] të shërbejë si bazë për formimin e kombit” dhe nuk e thotë këtë si kusht të domosdoshme që në çdo gjuhë të nacionales të shërbejë si bazë një dialekt” (Pollo 1952, 73).

- Ballafaqimi i dy tezave për ngritjen e gjuhës së njëzuar mbi bazën e njërit prej dialekteve, ku mbizotërojnë *argumentet që i mëshojnë nevojës për ta ngritur toskërishten në bazë të gjuhës së njëzuar* (Shuteriqi 1952, Malëshova 1952, Xhuvani 1952¹), ndonëse aty-këtu hasen edhe zëra që kërkojnë studime konkrete gjuhësore, të fondit të fjalorit, sistemit gramatikor, sintaksës, historisë së gjuhës etj. (Mark Gurakuqi² 1952, Ll. Siliqi 1952, L. Dodbiba 1952³) Për shembull, në diskutimin e tij Llazar Siliqi, vëren:

“Flitet për një gjuhë letrare kombëtare me dialektin e toskënishtes në bazë, nënvizojmë bazë, sepse na e dijmë se gjuha letrare kombëtare e një populli asht shumë ma e gjanë e e pasun e e përsosun se dialekti që ajo ka në bazë, se vetë fakti që ajo vihet në bazë do të thotë se e destinon vehten që

¹ Çdo dialekt e ka fuqinë, i ka cilësitë për t'u-bamë gjuhë e përbashkët shkrimi për një popull, por rrethanat shoqërore e bien punën që vetëm një dialekt prej shumë dialekteve të një vendi të dalë sipër të tjerëve e të bahet gjuh'e përbashkët letrare, gjuhë kombëtare[...]Shokë! Kujtoj se nuk duhet të skandalizohet kush me këtë mënyrë të zgjidhjes së problemit gjuhësor me anë të toksënishtes.(Xhuvani 1952, 73).

² “Asnjë nuk mund të provojë sot se ky ose ay dialekt duhet vënë në bazë të gjuhës letrare kombëtre, pa bërë studime të thella mbi ligjet e brëndëshme të gjuhës, pa provuar në mënyrë bindëse shkencore se ky apo ai dialekt ka një sistem gramatikor, më të përkryer, se fondi kryesor i fjalëvet dhe vetë fjalori i tij është m’i pasur se ai i një dialekti tjetër.” (Gurakuqi 1952, 84).

³ Dialekti i mesëm është më i aftë për të zgjidhur problemin e unjimit të gjuhës dhe t’asimilimit ndër-dialektor të leksikut. Asnjë dialekt nuk mund të arrijë këtë aqë mirë sa ç’ë bën dialekti i mesëm. Me Shqipërinë e mesme mund të bëhet më lehtë depërtimi nga Jug dhe Veriu, kurse me elementin toskërisht si bazë, dera e huazimit nga Veriu ngushtohet shumë. (Dodbibaj 1952, 75).

të pësojë ndryshime të mëdha, por deri më sot ka pasë ma shumë mendime për ta çpallë toskërishten si gjuhë kombëtare letrare, për ta konsiderue atë të tillë qysh tashti, dhe jo tue vu atë në bazë, për të drejtue të gjitha përpjekjet tona për krijimin e gjuhës sonë letrare kombëtare shqipe. Kjo asht reflektue edhe në punën e shkrimtarëve që shkruajnë në toskënisht dhe që, fatkeqësisht, nuk kanë ba pothuajse kurrfarë përpjekje jo vetëm për t'u afrue me gegënishten, tue marrë ç'ka ajo, gegënishtja, e ka të mirë e toskënishtes i mungon [...]” (Siliqi 1952, 87).

Në këtë hulli diskutimesh për dialektin që duhej të vihej në bazë të gjuhës letrare të njësuar, bie në sy qëndrimi i përpiktë i Eqerem Çabejt, i cili parashtron se çështja e gjuhës së përbashkët të shkrimit, mund të zgjidhet vetëm pasi të jenë kryer studimet e nevojshme me karakter shkencor. Për këtë, Çabej thotë se dy detyrat kryesore që i dalin para gjuhësisë (së kohës) janë mbledhja e materialit të gjuhës dhe studimi i këtij materiali. Për Çabejn nuk mund të kuptohet zgjidhja e çështjes së ortografisë pa studiuar historinë e shkrimit shqip, historinë e gjuhës shqipe dhe pa kryer hulumtime të natyrës dialektologjike.

Qëndrimet e Çabejt për këtë çështje i kanë rezistuar kohës dhe shfaqen çuditërisht pa ngjyresat ideologjike tipike që i hasim te studiuesit e tjerë. Madje, Çabej thekson se të shkruarit në dy forma dialektore të ndryshme nuk duhet konsideruar si ndonjë fatkeqësi, por si “*diversite dans l’unité*”, madje për të shkrimtarët mund të vijojnë të shkruajnë në dialektin e tyre. “Me formimin e shtetit shqiptar edhe gjuha shqipe ka marrë dhe ka për të marrë edhe më shumë një zhvillim tjetër, një zhvillim konvergjent të dialektevet. Dhe kjo rrugë duhet të ndiqet, sepse një shtet unitar nuk mund të mendohet pa një gjuhë unitare. Këtu s’e kam fjalën për një gjuhë letrare të vetme, sepse shkrimtarët mund të vazhdojnë të shkruajnë në dialektin e tyre, po është punë për një gjuhë të n’administratë, nëpër tekstet shkollore e tjerë” (Çabej 1952, 119). Gjithsesi ai qartësisht nuk mbështet qasjen e *gjuhësisë së kolltukut*⁴, por

⁴ Fillmore (1992, 35), jep një përkufizim parodizues për gjuhësinë e kolltukut duke thënë se kjo gjuhësi nuk ka emër të mirë në disa qarqe gjuhësore. “Një karikaturë e gjuhëtarit të kolltukut është diçka e tillë: ai ulet në një kolltuk të thellë, të butë e të rehatshëm, me sytë mbyllur dhe me duart e mbërthyera pas koke. Herë pas herë hap sytë, brof papritur duke thirrur: “Ua, çfarë fakti i saktë”, kap lapsin dhe shkruan diçka. Pastaj vjen rotull për disa orë me emocionin se i është afruar edhe më të njohurit se si është gjuha me të vërtetë”.

kërkon mbledhje të të dhënave në terren për të dy dialektet. “Sa kohë që problemi i zhvillimit të një gjuhe të përbashkët është i lidhur me punën e të dy dilekteve, unë [...] e shoh punën të pazgjidhshme, pa u studjuar më parë mirë dialektet e shqipes. Si do vemë ne për bazë njerin nga të dy dialektet, kur nuk janë studjuar mirë as njeri as tjetri?”. Gjithsesi, në pikëpamje të hartimit të ortografisë së gjuhës unitare, Çabej është i mendimit se duhet ndjekur pari i afrimit sa më të madh të dy dialekteve me shkrim.

- *Gjuhësia preskriptive “e kolltukut” dhe Enver Hoxha si folës model.*

Në ilustrimet e dhëna gjatë diskutimeve për përparësitë e toskërishtes ndaj gegërishtes, si dialekt me përdorim më të gjerë në praktikën shkrimore prej Rilindjes, ajo që bie në sy janë shembujt të pashkëputur nga praktika ligjërimore, as nga ndonjë e dhënë dialektologjike në terren, por të përzgjedhura nëpër introspeksionit dhe intuitës si konstrukte të përshtatshme nga vetë gjuhëtari. Kështu për shembull, në një rast, Shuteriqi (1952) tek rreket të argumentojë se “gjuha letrare e shkruar në bazë të dialektit jugor është gjuha e jonë kombëtare letrare sot” (40) dhe “se bashkëpunimi ndër dialektor është kusht i domosdoshëm për zhvillimin në mëtejshëm të gjuhës sonë letrare kombëtare (42-50), kur ndalet te infinitivi parafratik”, pohon se: “Dialekti jugor i folur nuk e ndjen nevojën e infinitivit të llojit **me ndërtue**, [...] Humbja e tij në toskërishtet nuk duhet të shihet pra si një fatkeqësi e si varfërim” (45-46); megjithatë, me një qëndrim kryekëput preskriptiv, Shuteriqi thotë se në gjuhën letrare duhet futur forma e infinitivit substantival, meqë edhe shoku Enver e ka përdorur atë formë në shkrimet e tij.

“N’atë mënyrë sidomos e përdor edhe shoku Enver atë lloj infinitivi në shkrimet e tij. [...] Në të katër rastet që shoku Enver ka përdorë n’infinitiv një folje të llojit **me ndërtue**, ai ka përdorë trajtën pa diftong: **me drejtu**, **me organizu**, **me bashku**. Le të vëmë re edhe përdorimin e trajtave **me gjete**, **për të gjete**, e jo të trajtave **me gjetun**, **për të gjetur**. **Gjetë**, si ç’do ta shohim më poshtë, nuk është një trajtë karakteristike vetëm e gegërishtes, po dhe e toskërishtes në të folmen e saj labe. Të pesë herët që shoku Enver ka përdorë infinitivin e llojit **me ndërtue**, katër herë ai e ka përdorë në rolin e tij substantival.” (Shuteriqi 1952, 46).

Ky shembull tregon më së miri përpjekjen për të justifikuar shkencërisht e shndërruar në model gjuhësor, me një lëvizje preskriptive, deri edhe

përdorime të caktuara gjuhësore të Enver Hoxhës. Në këtë rast diktatori, konsiderohet edhe *autoritet gjuhësor*, ndonëse në literaturë me autoritet gjuhësor kihen parasysh institucionet rregullatore të gjuhës, si p.sh. akademitë.

Së treti, argumenti i dakordësisë me Kosovën. Argumenti i përdorimit të rregullave të miratuara nga Konsulta e Prishtinës (22, 23 prill 1968) është përmendur ndër vite në literaturë, si një kartë për të nënvizuar karakterin mbarëkombëtar të vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit. E. Lafe (1973) në artikullin për mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit, botuar në revistën *Nëndori*, nënvizon “Që nga prilli i vitit 1968, me vendim të Konsultës gjuhësore të përfaqësuesve të të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, ky projekt⁵ po zbatohet me sukses në të gjitha botimet e atjeshme”. Qëndrime të ngjashme gjejmë te Kastrati (2000, 64), i cili shprehet “Më 1968 atje (*lexo në Kosovë*) u bë realitet përdorimi i normës së përbashkët letrare. Pra, në Kosovë u vu në jetë përpara se të zbatohet tërësisht në Shqipëri. Kështu u veprua edhe në Maqedoni në procesin e njësimin të shqipes letrare.”, Demiraj (2000)⁶, Ajeti, Lafe (2000)⁷, Samara (2005) etj.

Kur shtrohet argumenti i bashkëpunimit a dakordësisë me Kosovën, ajo çka shpesh anashkalohet ose lihet të kuptohet mes rreshtash është që, në fakt, Konsulta e Prishtinës vendosi të zbatohet *Projekti për Rregullat e Drejtshkrimit të Shqipes*, i vitit 1967, projekt ky, gjithsesi që nuk mund të hartohet dhe as të mendohet si i shkëputur nga tradita e shkencës dhe e gjuhësisë marksiste. Gjurmët e ideologjisë së regjimit janë qartësisht të dukshme që në parathënien e këtij botimi, ku shkruhet:

⁵ Fjala është për Rregullat e Drejtshkrimit të Shqipes (Projekt), i vitit 1967.

⁶ Për këtë çështje Demiraj (2000, 41) nënvizon: “Prandaj nuk më duket e panevojshme të ritheksoj se shqipja e sotme letrare *nuk u krijua* 25 vjet më parë, kur u mor vendimi historik për përdorimin e saj si gjuhë letrare e përbashkët për të gjithë shqiptarët. Madje për të qenë më të saktë, duhet rikujtuar se një vendim i tillë, në të vërtetë, ishte marrë qysh katër vjet më parë në Konsultën e Prishtinës të vitit 1968”.

⁷ “Në prill të 1968 u zhvillua në Prishtinë Konsulta e njohur gjuhësore, vendimet e së cilës përmblihdhen në përcaktimin një komb- një gjuhë letrare, një drejtshkrim. Katër vjet e gjysmë që kaluan që nga ajo konsultë deri në mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit, dëshmuon se edhe në Kosovë, në Maqedoni e në Malin e Zi zbatimi i normës së njësuar letrare nuk kishte ndeshur në probleme të pakapërcyeshme, përkundrazi arritjet ishin të shënueshme” (Ajeti, Lafe 2000, 19-20).

Zhvillimi që ka marrë gjuha shqipe letrare në këta njëzet e sa vjet të ndërtimit të shoqërisë socialiste në Shqipëri është një nga treguesit e shumtë të lulëzimit të pashembëllt e të pandalshëm të kulturës së popullit tonë nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë. Ky zhvillim kulturor kërkon që norma e sotme letrare të jetë sa më e njësuar. Shprehja e parë dhe më e dukshme e këtij njësimi është vendosja e normave të njëjta e të qëndrueshme drejtshkrimore. Përparimi i madh që është arritur në kristalizimin e normës letrare kombëtare dhe kujdesi i veçantë që ka treguar Partia e pushteti popullor për zhvillimin e gjuhësisë shqiptare e kanë bërë plotësisht të mundshme zgjidhjen e kësaj detyre në kohën tonë (Kostallari *et al.* 1967, 3).

Në gjykimin tonë, përdorimi i shqipes së njësuar kudo ku ka shqiptarë, është vlerë dhe shenjë e kombit, ndaj edhe në të gjitha kohët, përpjekja për t'u bashkuar me anë edhe të një varieteti standard të njësuar, është në të mirë të unitetit kombëtar. Siç shprehet R. Ismajli (2006 [2013, 140]): “Gjuha letrare/standarde njësore nuk mund të jetë mjeti që do t'i përçajë shqiptarët në ‘gegë e toskë apo sipas kufijve politikë’, sepse ajo ka lindur si rrjedhojë e nevojave për bashkim, ndërsa ndarjet “në gegë e toskë apo sipas kufijve politikë” kanë ekzistuar para krijimit të shqipes standarde dhe vazhdojnë të ekzistojnë pavarësisht nga ajo si dimensione të ndryshme nga ajo”. Gjithsesi, sot 50 vite pas Kongresit të Drejtshkrimit argumentet duhen risjellë duke u hedhur dritë të gjitha arsyeve për përzgjedhjen e varietetit standard ekzistues. M. Samara (2005) e pranon trysninë e ideologjisë komuniste në të gjitha nismat e planifikimit gjuhësor të kohës: “Është e vërtetë se në atë Kongres u mbivlerësua madje u lavdërua roli i politikës gjuhësore të partisë atëherë në pushtet, duke e politizuar kështu, bile duke e kompromentuar suksesin e arritur në Kongres, sikur ai të ishte rezultat vetëm i kësaj politike dhe jo i përpjekjeve të mbarë shqiptarëve të disa brezave brenda e jashtë Shqipërisë” (139).

Arsyet e përqafimit të Projektit (1967) nga Konsulta e Prishtinës janë të njohura, por përmbledhtas ato i cek Bajçinca (2000), kur shprehet “[...] njësimi i shqipes letrare (ne nuk duam të hyjmë e të shtrojmë e të rrahim për të studiuar me qëllim që të nxjerrim në shesh trysnitë e dhunës -në thonjëza, që edhe mund të jenë bërë-, të cilat, megjithëkëtë as që mund të krahasohen me trysnitë e me dhunën që ushtrohej, tash pa thonjëza, mbi intelektualët e shkrimtarët e studiuesit shqiptarë të Kosovës që të mos pranonin kursesi

njësimitin e shqipes letrare” (53). R. Ismajli (2021, 103-105) gjithashtu pohon se me anë të Konsultës, shqiptarët e Kosovës e të ish-Jugosllavisë po kundërshtojnë “planifikimin separat të çështjeve themelore për kombin në tërësi siç është gjuha”, kështu ata po shprehin vullnetin e tyre për t’u bërë pjesë e këtij procesi planifikimi të një shkalle gjithëkombëtare dhe po tregojnë identitetin e tyre kombëtar shqiptar, “njësinë kombëtare me shqiptarët përtej kufirit prej të cilëve i kishin ndarë padrejtësisht”. Krahas kësaj, Ismajli (2021, 144) argumenton se shqiptarët e ish-Jugosllavisë kishin nevojë që të përdornin një gjuhë të njësuar, të cilën nuk mund ta zgjidhnin vetëm të mbështetur mbi kosovarishten, pasi do të ishte e pamundur që këtë standard t’ua impononin gegëve të Shqipërisë.

Planifikimi gjuhësor sipas skemës së R. Cooper-it

Për të kuptuar më mirë procesin e planifikimit gjuhësor gjatë regjimit diktatorial, proces që kulmoi me Kongresin e Drejtshkrimit (1972), do të zbrërthojmë këtu “skemën vlerësuese” të gjuhëtarit Robert Cooper-it (1989: 89), i cili shprehet se për të analizuar planifikimin gjuhësor duhen hetuar tetë përbërës:

Cilët aktorë synojnë të ndikojnë cilat *sjellje* të cilëve *njerëz*, për çfarë *motivesh*, në çfarë *kushtesh*, me çfarë *mjetesh*, përmes ç’*procesi vendim-marrës*, me çfarë *efekti*? (Cooper-it 1989:89).

Skema e Cooper-it, është marrë më tej dhe është shtjelluar edhe nga studiues të tjerë si: D. Ager (2001) dhe N. Bermel (2007). Ager-i në mënyrë të detajuar merret me çështjen e motivimit, të cilën do ta shqyrtojmë në vijim të këtij artikulli.

Tri llojet e aktorëve zakonisht dallohen si relevantë ndaj çështjeve planifikimit të gjuhë janë: *Individët, komunitetet, shteti*. Në rastin e Kongresit të Drejtshkrimit si një dhe produkt planifikimi gjuhësor, rolin kyç e luajti shteti dhe ndikim patën tërthorazi e më tepër formalisht, ndonëse për ç’arsye dhe në ç’rrethana e kemi trajtuar tashmë, edhe komunitetet e shqiptarëve jashtë Shqipërisë shtetërore. Një tjetër komunitet, që luajti rol, në Kongresin e drejtshkrimit që ai i përbërë prej individëve studiues, kryesisht i atyre brenda vendit, të angazhuar pranë institucioneve akademike e universitare.

Mosndërhyrja në çështje të zhvillimit të gjuhës dhe mosmarrja përsipër e rolit “të arbitrit;- edhe kur ta jep lejen historia e gjuhës” konsiderohej e paarsyeshme për Dh. Shuteriqin (1952). Ndërsa ndërhyrja në zhvillimin e gjuhës ishte diçka e domosdoshme sipas Mahir Domit (1952), sepse “me që konditat të gjitha na i ka krijuar sot Pushteti dhe Partia, nuk duhet të lëmë që gjuha jonë të zhvillohet në mënyrë anarqike, por të ndërhyjmë e të vëmë gjithë kujdesin tonë, që të gjejmë zgjidhje të drejta, të ndihmojmë në pasurimin e gjuhës sonë, në kristalizimin e formave gramatikore, n’unifikimin e përcaktimit e terminologjisë e në zgjidhjen e problemeve të tjera të shumta, që i dalin përpara gjuhësisë sonë për ta bërë kështu gjuhën shqipe një mjet të fuqishëm të revolucionit kultural në vendin tonë” (85).

Shpesh, pas viteve ’90, kanë qarkulluar ide që i kanë veshur autorësinë e vendimeve të Kongresit, një njeriu të vetëm, Androkli Kostallarit. Për rolin e tij në planifikimin e gjuhës, R. Ismajli (2021, 108), pohon se “nga viti 1955 e tëhu, sidomos pas vitit 1967 ka qenë shumë i rëndësishëm”. Megjithatë, fragmentet e diskursit shkencor gjuhësor, të cilëve iu jemi referuar gjatë këtij shkrimi, tregojnë qartë që ideologjia e gjuhës letrare të njësuar kishte nisur të përhapej që dy dekada para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit. Në përhapjen dhe përforcimin e kësaj ideologjie aktorët lipsej me doemos të ishin të shumtë në numër. Beci (2000) shprehet se në diskutimet për bazën dialektore të gjuhës shqipe, gjerësisht të reflektuara në *Buletini për shkencat shoqërore* (1952), u lanë në dorë të njerëzve që ishin më pak të aftë profesionalisht: “trajtimi i problemeve që kishin të bënin me këtë aspekt të politikës gjuhësore nuk iu besua gjuhëtarëve më të mirë të kohës, Xhuvanit, Çabejt etj., po njerëzve më të indoktrinuar të partisë e të shtetit, të cilët pasi i akuzuan ata për antipatriotizëm etj. etj. në një mënyrë ose tjetër, i vunë para faktit të kryer.

Rasti i politikës gjuhësore në Shqipëri gjatë komunizmit

I. Aktorët	Shteti	Shteti shqiptar diktatorial
	Komuniteti	Komuniteti i shqiptarëve nga Kosova dhe Trojet (Ndikim i pretenduar nga regjimi)
	Individët	Individët (studiuësit, gjuhëtarët, “gardianët” gjuhësorë)

II. Sjellja gjuhësore	<p>A. Tiparet gjuhësore (strukturore të sjelljes së planifikuar)</p> <p>B. Qëllimet/ funksionet për të cilat do të përdoret sjellja e planifikuar</p> <p>C. Niveli i dëshiruar i përshtatjes</p>	<p>Njësim – njëtrajshmëri në përdorimin e gjuhës në të gjithë vendin</p> <p>Në shkollë</p> <p>Në botimet artistike, literaturë</p> <p>Në shtyp</p> <p>Vetëdije e lartë gjuhësore</p> <p>Vlerësim i gjuhës së njësuar.</p> <p>Rritje e shkallës të përdorimit.</p>
III. Njerëzit	<p>A. Lloji i popullatës</p> <p>B. Mundësia e popullatës për të mësuar sjelljen e planifikuar</p> <p>C. Stimujt e popullatës për ta mësuar/ përdorur sjelljen e planifikuar</p> <p>D. Stimujt e popullatës për ta refuzuar sjelljen e planifikuar</p>	<p>Individë/ komunitete</p> <p>Përmes shkollave në mbarë vendin.</p> <p>Servirja e normës drejtshkrimore si produkt i partisë dhe me rëndësi politike.</p> <p>Jo të një nivel për t'u përgjithësuar, sidomos brenda kufijve të Shqipërisë diktatoriale.</p> <p>Tjetër mund të ketë qenë situata në Kosovë.</p>
IV. Motivet	<p>Të hapura (Të lidhura me sjelljen gjuhësore)</p> <p>Të fshehta (Të palidhura me sjelljen gjuhësore por që synojnë interesa të tjerë)</p>	<p>Të lidhura me nevojat praktike.</p> <p>Të lidhura me ideologjinë e partisë-shtet, të lidhura me imazhin e vendit, të lidhura me nacionalizmin etj.</p>
V. Kushtet	<p>A. Të lidhura me situatën (ngjarje, kushte të përkohshme)</p> <p>B. strukturore (1.politike, 2. ekonomike, 3. sociale/demografike/ekologjike)</p> <p>C. kulturore (norma të regjimit, norma kulturore, shoqërizimi i autoriteteve)</p> <p>D. mjedisore (ndikimet nga jashtë sistemit)</p> <p>E. e informacinit (të dhënat që duhen për një vendim të mirë)</p>	<p>Ardhja në pushtet e Partisë Komuniste</p> <p>Zhvillimet politike në Kosovë</p> <p>Gjendja politike – shteti diktatorial që kishte nevojë për një politikë gjuhësore që të legjitimonte dhe ushtronte pushtetin e vet</p> <p>Mungesë e kulturës së reagimit, si pasojë e mungesës së lirisë së fjalës.</p>
VI. Mjetet	<p>Autoriteti, forca, promovimi, bindja</p>	<p>Klima politike marksiste (Vendimmarrje nën ndikimin e politikave gjuhësore marksiste)</p> <p>Të kufizuara (Pak punë në terren për mbledhjen e të dhënave dialektologjike)</p> <p>Autoriteti i pushtetit diktatorial.</p> <p>Forca – imponim detyrues përmes mekanizmave të shtetit</p> <p>Promovimi – përmes shtypit, shkollave përhapjes së udhëzimeve pas Kongresit të Drejtshkrimit</p> <p>Autoriteti shkencor i delegatëve të Kongresit</p>

VII. Procesi i vendimarrjes	A. formulimi i problemit/synimit	Diskutimet në qarqe të studiuësve
	B. formulimi i mjeteve	Projektet e rregullave të Drejtshkrimit/ Diskutimi i tyre Mbledhje, tubime Kongresi i Drejtshkrimit
VIII. Efektet		Ngritja e një varieteti (të pretenduar nga planifikuesit gjuhësorë si mbidialektor) në gjuhë të njësuar, Kufizimi i fushës së përdorimit të dialekteve (kryesisht i gegërishtes, si pasojë e udhëzimit për të përdorur veçanërisht në botime, vetëm gjuhën standarde). Stigmatizimi i folësve të të folmeve më periferike.

Tabela 1 Paraqitje skematike e politikës gjuhësore në Shqipëri gjatë komunizmit, sipas modelit të R. Cooper-it

Në tabelën e mësipërme nuk mëtohet të jenë paraqitur shterueshëm të gjitha shfaqjet dhe ilustrimet për secilin element përbërës, por gjithsesi vlen për të paraqitur përmbledhtas rastin e politikës gjuhësore në Shqipëri gjatë komunizmit.

Mirëpo është pikërisht angazhimi i tyre direkt në problemet e planifikimit gjuhësor të toskërishtes letrare që luajti një rol gati përcaktues në procesin e zgjerimit të funksioneve të toskërishtes letrare dhe të ngritjes së saj në nivelin e gjuhës standarde kombëtare” (Beci 2000, 30). Një tjetër argument në mbështetje të faktit që autorësinë e vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit nuk mund t’i ketë marrë një njeri i vetëm, as edhe Kostallari, e jep Ismajli (2021, 124), i cili e vë theksin te aspekti teknik i përzgjedhjes së kodit dhe te mëtimet se studiuësit e përfshirë në këtë veprimtari kanë qenë të shumtë.

Që para Kongresit të Drejtshkrimit, por edhe pas tij, madje deri edhe sot lëvrimi, pasurimi dhe ruajtja e gjuhës letrare të njësuar iu është ngarkuar shkrimtarëve, punonjësve letrarë, enteve të botimit, institucioneve shkencore e shkollore, shtypit, deri dhe “masave punonjëse”, te të cilët ideologjia e gjuhës së njësuar u pasua si porosi e madhe me rëndësi mbarëkombëtare, duke i shndërruar ata në *gardianë* të gjuhës. Për shembull, Gosturani (1988), flet për rëndësinë e brumosjes gjuhësore të brezit të ri përmes zotërimit të

normës letrare; Demiraj (1995) njeh dhe pohon rëndësinë e punës së gjuhëtarëve, por duke e vënë theksin te roli i shkrimtarëve: “Përsosja e mëtejshme e shqipes letrare kërkon përpjeke nga të gjithë njerëzit e penës e në radhë të parë nga shkrimtarët tanë, që ta pasurojnë atë vazhdimisht [...] (35)”, të njëjtin qëndrim e gjejmë edhe te Kostallari (1982), Agalliu (1995), Xhuvani (1990) etj.

Në tabelën nr. 1 janë paraqitur mekanizmat e politikës gjuhësore, sipas R. Cooper-it dhe ilustrimi i tyre me ato tipare që vihen re në politikën gjuhësore në Shqipëri gjatë komunizmit. Dy kolonat e para të tabelës përmbajnë skemën *vlerësuese* sipas Cooper-it, dhe janë pozicionuar në atë formë për lehtësi paraqitjeje, ndërsa kolona e tretë përmban komentimin përkatës për rastin e politikës gjuhësore në Shqipëri gjatë komunizmit.

Për të shmangur përsëritjet, nga sa kemi trajtuar më lart, po ndalemi për të trajtuar më gjerësisht mjetet e përdorura për planifikimin gjuhësor dhe procesin e vendimmarrjes, referuar anotimit, që kemi paraqitur në tabelën nr. 1 dhe në vijim do të trajtojmë çështjen e motivimit, duke shkuar edhe më përtej skemës vlerësuese të Cooper-it.

Mjetet

Vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit u vendos që të zbatoheshin përmes një Urdhri të Ministrisë të Arsimit dhe të Kulturës (Urdhri nr. 4, datë 26.12. 1972) që iu nis Shkollave të larta dhe Instituteve, Ndërmarrjeve nën vartësinë e Ministrisë së Arsimit (Kinostudios, Shtëpisë Botuese të Librit Shkollor, Shtëpisë Botuese “Naim Frashëri”, Teatrit të Operës e Baletit, Shtëpisë Qendrore të Krijimtarisë Popullore, Institutit të Studimeve Pedagogjike, NISH Mjeteve Mësimore, NISH Shtypshkronjës “Mihal Duri”, Galerisë së Arteve Figurative) etj.; Në këtë urdher shkruhet:

Përfundimet e Kongresit të gjuhës shqipe të njihen plotësisht nga të gjithë punonjësit e arsimit, të kulturës e të artit, në mënyrë që vendimet që ai mori të vihen shpejt dhe mirë në jetë. Për këtë qëllim të merren masat përkatëse që Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe të punohet, brenda muajit janar 1973, me punonjësit e çdo instituti arsimor, kulturor e

artistik të vendit tonë. [...] Vëmendje e veçantë t'i kushtohet marrjes së masave konkrete për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes në gjuhën e folur e të shkruar.

Urdhri me trembëdhjetë pika, detajon të gjitha mjetet dhe veprimtaritë që duhej të bëheshin për zbatimin me sukses të vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit, që konsiderohet si ngjarje e shënuar për historinë e kulturës kombëtare dhe me rëndësi të veçantë politike.

Sakaq, një mjet që funksionoi veç autoritetit të Partisë dhe të udhëheqësit të saj E. Hoxha, ishte edhe mjeti i autoritetit shkencor të delegatëve të Kongresit. Ministri i Arsimit dhe i Kulturës, i kohës, para mbajtjes së Kongresit të drejtshkrimit do të shkruante: “Delegatët e kongresit do të jenë ndër specialistët më të përgatitur në fushën e gjuhësisë, në mënyrë që punimet e kongresit të zhvillohen në një plan rreptësishtë shkencor e në nivel të lartë. Kështu vendimet e kongresit do të kenë vulën dhe autoritetin e forcave më të mira shkencore të vendit tonë” (Thoma Deliana, maj 1972).

Procesi i vendimmarrjes

Sa i takon procesit të vendimmarrjes dhe mënyrës si u përvijua politika gjuhësore që prej ardhjes në pushtet të partisë komuniste, shumë prej çështjeve i kemi cekur edhe në këtë shkrim, por me interes për të hedhur dritë në procesin e vendimmarrjes janë tri dokumente: dy dokumente të Ministrisë të Arsimit dhe Kulturës, “Informacion mbi Kongresin e Drejtshkrimit nga Ministria e Arsimit” dhe një dokument tjetër që mban autorësinë e Androkli Kostallarit “Informacion mbi zhvillimin e Kongresit të Drejtshkrimit”. Në dokumentin e parë të Ministrisë të Arsimit dhe të Kulturës (shih shtojcën në fund të këtij botimi), thuhet se Projekti i Rregullave të Drejtshkrimit të shqipes (1976), është bërë objekt i “një diskutimi të gjatë popullor” dhe se Komisioni i drejtshkrimit, ka organizuar në 14 rrethe të vendi, diskutime me arsimtarë, punonjës të sektorëve të kulturës, botimeve etj., “për të njohur drejtpërdrejt mendimet, vërejtjet dhe dëshirat e masës rreth këtij projekti”. Ndërsa në dokumentin e dytë, datë 9. v. 1972, paraqitet plani i detajuar rreth mbajtjes së Kongresit dhe mënyrës si do të zhvillohen punimet e tij, delegatët nga vendi, nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshët e Italisë, madje paraprakisht jepen dhe informacione rreth përmbajtjes që do të

ketë rezoluta: “Në rezolutën e tij kongresi do t’u bëjë thirrje gjithë institucioneve shtetërore, shoqërore, kulturore etj. që të zbatojnë rregullat e drejtshkrimit të ripunuara sipas vendimeve të kongresit”.

Në dokumentin datë 6.X.1972, që mban emrin e Androkli Kostallarit, në emër të Komisionit organizues të Kongresit të Drejtshkrimit, paraqitet informacion paraprak për *qëllimin dhe përmbajtjen e Kongresit*, për të cilin thuhet se “do të jetë kongresi i aprovimit dhe i vendosjes “de jure” të një gjuhe të vetme letrare kombëtare për të gjithë shqiptarët, brenda e jashtë kufijve të Shqipërisë”; për çështjet organizative si pjesëmarrësit në Kongres (delegatë e të ftuar), koha e mbajtjes, mënyra e zhvillimit të punimeve; për Komisionet e Kongresit (komisioni organizues me 18 anëtarë, komisionet e seksioneve dhe komisioni i rezolutës); për dokumentet e Kongresit. Edhe në këtë dokument, ende pa u zhvilluar kongresi, shprehet se “Në rezolutë Kongresi do t’u bëjë thirrje shkollës, organeve botuese, organeve të administratës shtetërore, të organizatave shoqërore e të gjithë punonjësve, gjithë popullit shqiptar për zbatimin e plotë dhe të përgjithshëm të drejtshkrimit të njësuar, duke e vlerësuar atë si një shfaqje të rëndësishme të kulturës sonë kombëtare”.

Në mënyrë të veçantë roli i shkollës përmendet vazhdimisht si mjet për ngulitjen e normës gjuhësore. “Shkolla jonë, vatra kryesore ku përvetësohet tërë sistemi i gjuhës letrare e në radhë të parë norma gjuhësore, ta thellojë më tej gjithë punën e asaj për zotërimin e gjuhës së normëzuar nga brezat e rinj *në luftë me kundërnormën*, e cila vepron gjithashtu në një masë a në një tjetër në mjediset e ndryshme gjuhësore e shoqërore.” (Kostallari 1984, 52).

Një tjetër mjet për përhapjen e ideologjisë së gjuhës së njësuar, krahas ideologjisë së partisë (dhe për edukimin komunist), ishte shtypi. Një fragment ilustrues për këtë e gjejmë te Thomai (1984): “Gazetari, thotë shoku Enver ‘më shumë se kushdo tjetër duhet të ecë me kohën dhe bile më shpejt se koha, duke përshkruar vështrimin e tij jo vetëm në të tashmen or edhe në të ardhmen. Kjo i kërkohet gazetarit edhe në luftën për gjuhën letrare kombëtare, të kuptuar shkencërisht e politikisht, për zhvillimin, pastrimin e pasurimin e saj, për të shpalosur ato bukuri shprehëse....” (106).

Sa iu takon *efekteve* të planifikimit gjuhësor, duhet theksuar veçanërisht kufizimi i skajshëm i fushave të përdorimit të varieteteve të tjera gjuhësore jostandarde, Thomai (1984), teksa trajton çështjen e tipareve të gjuhës së shtypit, shkruan: “Edhe shtypi ynë është dëshmi e atij hapi që u hodh, e që shkoi më tej sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit, në njësimin e plotë e në përgjithësimin e normave të gjuhës sonë letrare; *u kapërcye shpejt ajo gjendje kur ndonjë gazetë lokale (pjesërisht edhe në gazeta qendrore) shkruhej në ligjërim dialektor*, kishte lëkundje të ndjeshme të normës (madje edhe shkelje ose përzierje të saj) në fonetikë, në leksik e në sintaksë (109)”. Tepër i skajshëm dhe thuajse apokaliptik ngjan ideja e Kostallarit (1984, 31) kur flet për shuarjen e dy varianteve letrare të mëparshme, “por jo zhdukjen e dialekteve”. Ai thotë se dialektet e shqipes, ashtu si edhe të gjuhëve të tjera, në kohën tonë janë kategori mbeturinore në rrugën e shuarjes, por ato si variante të gjuhës së folur, kanë një qëndrueshmëri relative mjaft të madhe. Gjuha letrare ndikon gjithnjë më fuqishëm e më thellë mbi to, ua ngushton truallin gjeografik e shoqëror dhe ua dobëson jetësinë, por edhe ndikohet prej tyre”. Për Kostallarën, këtë luftë për hapësirë do ta fitojë gjuha letrare dhe kjo fitore patetikisht përshkruhet si vendosje e një rendi imagjinar ideal: “Ky është një proces dialektik, që, pa dyshim, do të çojë dalëngadalë e shkallë-shkallë në një epokë kur në jetën e popullit do të zotërojnë në qytet e në fshat vetëm gjuha letrare, me sistemin e pasur të stileve të saj” (Kostallari 1984, 31).

(Shtatë) Motivet e planifikimit gjuhësor

Siç e përmendëm më lart, skema e Cooper-it është zbrëthyer edhe nga studiues të tjerë të planifikimit gjuhësor dhe politikave gjuhësore. Në mënyrë të veçantë D. Ager (2000) merret me çështjen e motiveve për planifikim gjuhësor. Ager-i thekson se nuk mund të ketë planifikim gjuhësor që kryhet për një motiv të vetëm dhe se shpesh motivet nuk mund të jenë tërësisht të zbrëthyeshme. Gjithsesi shpesh synimi i politikave gjuhësore lidhet me politikat kombëtare. Për Ager-in motivimi për ndjekjen dhe zbatimin e një politike të caktuar gjuhësore lidhet me disa elemente si qëllimet, sjelljet dhe motivet. Ai shprehet: “Ka rreth shtatë motive për planifikimin gjuhësor dhe veprimet e politikës gjuhësore: *identiteti, ideologjia, krijimi i imazhit, pasiguria, pabarazia, integrimi me një grup të caktuar, dhe motivet instrumentale për përparim*” (Ager 2000, 9).

Identiteti lidhet me kombësinë, unitetin dhe nacionalizmin etnik, që shpesh simbolizohet nga gjuha ose religjioni. Si i tillë ai shndërrohet në motiv për politikën gjuhësore. Motivi i identitetit kombëtar, pra i gjuhës së njësuar si shenjë e identitetit kombëtar ka, qenë qendror në zbatimin e politikës gjuhësore gjatë komunizmit dhe atë e gjen të shprehur në çdo artikull të diskursit shkencor apo politik të kohës. Androkli Kostallari, në emër të komisionit organizues të Kongresit, në dokumentin me titull “Mbi qëllimet kryesore dhe rëndësinë e kongresit të drejtshkrimit (Përkujtesë orientuese për organet e shtypit)”, datë 5.9.1972, shkruan: “Ideja themelore që përshkon Rregullat e drejtshkrimit është ideja që ne kemi sot një gjuhë letrare, e cila në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore kryen funksionet e gjuhës letrare kombëtare të normuar dhe që njësia e gjuhës t’i shërbejë fuqimisht njësisë së kombit tonë socialist, zhvillimit të tij të mëtejshëm politik, shoqëror e kulturor. Përpjekjet për një drejtshkrim të njësuar janë pikërisht pjesë përbërëse e luftës për një gjuhë të vetme letrare shqipe. Ky motiv vijon ende sot të jetë ndër motivet kryesore për zbatimin e një politike gjuhësore tanimë implicite. Motivi i identitetit merr domethënie të shtuar për ata që argumentojnë se një gjuhë standarde e përbashkët në Shqipëri dhe Kosovë e përforcon dhe e ruan identitetin kombëtar.

Elementi i *ideologjisë*, ka të bëjë me qëndrimet ideologjike të një partie të caktuar, për të vendosur rolin dhe vendin që duhet të ketë gjuha standarde në shoqëri, sidomos në institucionet arsimore. Siç e kemi trajtuar, gjatë këtij shkrimi ideologjia e partisë komuniste, qëndrimi stalinist, kanë qenë thelbësore në politikën gjuhësore gjatë komunizmit. Vetë Ministri i Arsimit dhe i Kulturës, i kohës e quante mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit si aksion të rëndësishëm “politik e kulturor”. Androkli Kostallari, në shkrimin e tij “*Mësimet e shokut Enver Hoxha – baza e politikës gjuhësore të Partisë dhe të shtetit tonë socialist*”, e pranon hapur se në bazë të politikës gjuhësore të shtetit, qëndrojnë mësimet ideologjike të shokut Enver. Ai thotë se, ndërhyrjet në ecurinë e gjuhës letrare bëhen për ta vënë atë në shërbim të nevojave të shoqërisë. Pikërisht ky është edhe burimi i politikës gjuhësore ku “pasqyrohen qëndrimet e ndryshme të forcave shoqërore ndaj gjuhës e kulturës kombëtare. Siç dihet, vetë gjuha nuk ka karakter klasor, klasave brenda vendit, edhe synimet e shteteve të mëdha e të forcave por politika gjuhësore ka karakter klasor; në të pasqyrohet edhe lufta e shoviniste për të

nënshtuar e asimiluar popujt duke u imponuar gjuhët e kulturat e veta, edhe lufta e kombeve dhe e shteteve kombëtare për të mbrojtur e për të zhvilluar gjuhët amëtare, për të mbrojtur e për të përfortuar lirinë e pavarësinë e vet” (Kostallari 1985, 60).

Lloshi (1995), kur flet për rrethanat e krijimit të gjuhës standarde, e thekson faktin se ideologjia e regjimit totalitar depërtonte çdo aspekt të jetës politike, ekonomike e shoqërore dhe këtu përjashtim nuk mund të bënte as gjuhësia. “Kërkesat e partisë-shtet për të standardizuar gjithçka në përputhje me ideologjinë e saj ndikonte drejtpërdrejt edhe në politikën gjuhësore. Kështu, duhet të pranojmë se pati një bashkëpërkim të dy prirjeve: nga njëra anë, ishte zhvillimi i brendshëm i gjuhës letrare; nga ana tjetër, njësimi i shqipes letrare i përshtatej vijës së përgjithshme ideologjike e kulturore të regjimit në fuqi” (Lloshi 1995, 79). Më tej Lloshi thekson se “kjo nuk do të thotë se shqipen standarde e ka konceptuar, e ka krijuar dhe e ka imponuar ai regjim. E vërteta është se në rrugën e saj janë ndeshur prirje e drejtime të ndryshme, kanë ndikuar faktorë politikë e shoqërorë, njerëz të veçantë dhe grupime kulturore e krahinore”.

Ky qëndrim i tij i fundit është, në optikën tonë, tepër relativizues për ndikimin që mund të kenë pushtetet diktatoriale dhe specifikisht për ndikimin që ka pasur pushteti monist në vendin tonë. Mjafton të rikujtojmë këtu se pushteti përdori çdo mjet të mundshëm dhe nuk e kurseu as përfshirjen e drejtpërdrejtë qeveritare (siç e tregon Urdhri i Ministrisë të Arsimit dhe të Kulturës), për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit dhe të politikës gjuhësore zyrtare. Lloshi e vijon qëndrimin e tij duke theksuar se edhe “në të ardhmen mbi gjuhën standarde do të vijojnë të ndikojnë faktorë të ndryshëm, si për të gjitha dukuritë dhe institucionet sociale”, çka është argument që qëndron, pasi siç e thamë që në nisje të këtij shkrimi, ideologjia është e pashmangshme nga praktikat e planifikimit gjuhësor, por roli i ideologjisë (diktatoriale) komuniste nuk ka të krahasuar nga niveli i dogmatizmit me ideologji të tjera që mund të kenë lindur apo të lindin në vijim.

Imazhi ka të bëjë, sipas Ager-it, me një lloj diplomacie kulturore që vendet bëjnë duke synuar të projektojnë një imazh sa më pozitiv të “historisë, traditave, produkteve kulturore, fesë dhe mënyrave të ekzistencës, ndaj vendeve të tjera. Në këtë kuptim, projektimi i imazhit është në të njëjtën

kohë edhe projektim i synuar i identitetit kombëtar. Ndaj, shprehet Ager-i (2000, 75), “politikëbërësit e gjuhës zyrtare, përpiqen të krijojnë përshtypjen më të favorshme për produktin e tyre dhe e bëjnë këtë gjë, fillimisht duke synuar të përhapin sa më shumë dijen e gjuhës së tyre”.

Në rastin e politikës gjuhësore gjatë komunizmit, çështja e imazhit ka qenë e një rëndësie të veçantë. Për këtë mjafton t'i referohemi qëndrimit të Ministrisë të Arsimit dhe Kulturës, Th. Deliana, kur shprehet: “Populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar dhe me një shkallë të tillë zhvillimi që e vë atë përfundimisht në radhët e gjuhëve të përparuara, të cilat pasqyrojnë të gjitha arritjet e qytetërimit të sotëm botëror”. Qëndrim të ngjashëm, që e ngre lart imazhin e vendit, nëpërmjet lavdërimit të politikës gjuhësore, e gjejmë shumëkund nëpër artikujt e revistës “Studime filologjike”. Për shembull, Kostallari (1984,32) shkruan: “Zbatimi i gjuhës letrare të njësuar shqipe në Kosovë e në viset e tjera të banuara nga shqiptarët në Jugosllavi është quajtur një arritje që ‘në kohën moderne nuk gjen në Evropë asnjë paralele’”.

Pasiguria, për Ager-in duhet kuptuar si frikë ndaj të jashtmit. Qeveritë të ndjera të kërcënuara nga sulmet nga jashtë, kanë drojë se sulmi ndaj tyre prej jashtë, mund të jetë një sulm aq i efektshëm sa të shkatërrojë identitetin që është ndërtuar. Kërcënimi nga jashtë mund të jetë i natyrës politike, ekonomike dhe komunikative (kur mungon filli lidhës afektiv mes anëtarëve të një bashkësie). Në fakt regjimi diktatorial shqiptar është njohur për një paranojë dhe frikë ndaj të jashtmit, mjafton të kujtojmë këtu bunkerët e panumërt të ndërtuar, praktika të “popullit ushtar”, zbori e të tjera si këto. Në pikëpamje të politikave të gjuhës, një aspekt që reflekton frikë nga ndikimi i huaj, për Ager-in është prirja puriste ndaj gjuhës. Një ndër “porositë” që e has sa në diskursin politik aq edhe në atë shkencor gjuhësor është ajo për pastrimin e gjuhës shqipe. Në një artikull të E. Lafes (1984) të titulluar “Luf-ta për pastërtinë e gjuhës letrare shqipe në kohën tonë”, gjejmë esencën e ndërthurjes së nismave puriste, që konsiderohen produkt i planifikimit gjuhësor, me ideologjinë e kohës: “Pas Çlirimit, me përkrahjen e Partisë e të pushtetit popullor, u krijuan për herë të parë kushtet e vërteta që puna për pastërtinë e gjuhës të zhvillohet në mënyrë të vijueshme, të organizuar e sistematike” (Lafe 1984, 80).

Më tej, Lafe shprehet se kërkesa për pastërtinë e gjuhës është detyrë e rëndësishme që lidhet me demokratizimin e arsimit e të kulturës, ndonëse mes “pastërtisë së gjuhës” dhe demokratizimit, vështirë të ketë një lidhje shkakësore. Për ta bërë edhe më të qëndrueshëm argumentin e tij, Lafe citon një shkrim të Leninit “Për pastrimin e gjuhës ruse”, ku ky i fundit shprehej se “përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja më zemëron, sepse kjo e vështiron ndikimin tonë mbi masën”, ndaj i duhej shpallur luftë përdorimit të panevojshëm të fjalëve të huaja. Vula e autoritetit ideologjik ndaj nismës puristë, vihet pikërisht kur autori sjell në vëmendje qëndrimin e Enver Hoxhës: “Kujdesi dhe vëmendja që i kanë kushtuar vazhdimisht Partia dhe shoku Enver zhvillimit të gjuhës letrare, kanë qenë një ndihmë e madhe e drejt-përdrejtë edhe në punën për pastrimin e gjuhës. [...] Ai ka porositur ‘... ta pasurojmë gjuhën shqipe dhe ta pastrojmë atë nga fjalët e panevojshme të huaja. Tani kur gjuha është më e përparuar dhe më e përcaktuar, duhet të shkruhet dhe të shqiptohet drejt e pastër, pastaj edhe të pasurohet vazhdimisht... detyra jonë është t’i gjejmë fjalët përkatëse dhe, po të mos i gjejmë, atëherë të formohen fjalë të reja për to sipas natyrës së gjuhës sonë” (Lafe 1984, 81). Qëndrime të ngjashme ndaj nevojës për pastrimin e gjuhës i gjejmë thuajse në çdo artikull të botuar për gjuhën e njësuar kombëtare/gjuhën standarde si para edhe pas rënies së regjimit komunist.

Pabarazia, si element motivues për politikën gjuhësore, sipas Ager-it ka të bëjë me përpjekjet e qeverisë për të korrigjuar pabarazitë në shoqëri. Këtë mëtim e kishte dhe politika gjuhësore komuniste, e cila synonte që përmes gjuhës së njësuar të rrafshonte edhe të gjitha ndryshimet mes formacioneve shoqërore. Për këtë çështje Kostallari (maj 1972) shkruan: “Gjuha letrare shqipe e kohës sonë ka hyrë tashmë në fazën më të lartë të zhvillimit të saj. Thelbin e kësaj faze e përbën procesi i kristalizimit përfundimtar. Sistemi i ri shoqëror ka bërë një përqendrim e rrafshim ekonomik, politik e kulturor të paparë në historinë e Shqipërisë dhe i dha gjithë jetës së vendit ritme të jashtzakonshme zhvillimi [...]. Ai po zvogëlon vazhdimisht ndryshimet midis qytetit e fshatit, midis njeriut të punës mendore e fizike. Ky zhvillim ka sjellë një evolucion shumë dinamik të gjuhës letrare drejt njësimi e pasurimit “.

Kësaj ideje, Kostallari i ka mëshuar në mënyrë të vazhdueshme, siç duket edhe në raste të tjera kur shprehet se: “Mbi bazën e njësisë ekonomike,

nën udhëheqjen e Partisë është arritur një njësi e kompaktësi ideologjike e politiko-shoqërore jo vetëm e paparë në historinë e Shqipërisë, por e rrallë edhe në historinë e zhvillimit të kombeve të tjera socialiste” (Kostallari 1968, 50), apo se “Procesi i thellë i “qytetarizimit” të fshatit ia ka ndërruar atij fytyrën dhe e ka lidhur drejtpërdrejt me jetën e shumanshme të gjithë vendit, duke e bërë edhe atë një qelizë të organizimit të madh shoqëror e kulturor, që përpunon e përhap normën letrare” (Kostallari 1973, 76).

Integrimi dhe instrumentalizimi. Integrimi ka të bëjë me përpjekjen për të integruar folësit dhe instrumentalizimi me përdorimin e gjuhës si mjet për të arritur synimet e politikëbërësve dhe përdorimin e gjuhës nga folësit konkretë për të pasur sukses në veprimtaritë shoqërore dhe/ose për t’u integruar.

Në rastin e politikës gjuhësore komuniste koncepti i integritit lidhet më tepër me përpjekjen për të bërë bashkë nën ombrellën e gjuhës së njësuar, shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë shtetërore. Për këtë çështje, A. Kostallari do të shkruante: “Një veçori që e karakterizon procesin origjinal të gjuhës shqipe të njësuar është se njësimi i saj u arrit në kontekste të ndryshme shtetërore e shoqërore. Krahas punës së gjerë e sistematike që është kryer në RPS të Shqipërisë, përpjekje të rëndësishme janë bërë edhe nga shqiptarët që banojnë në Jugosllavi, - në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. [...] Ajo (*Konsulta e Prishtinës*) u nis, në radhë të parë, jo nga gjendja e nga veçoritë e këtij ose të atij varianti letrar dialektor, por nga shkalla *më e përparuar*, d.m.th. edhe *më e njësuar* që kishte arritur *objektivisht* në atë kohë gjuha letrare në rrafshin *kombëtar*.” (Kostallari 1984, 32, *të pjerrëtat të tijat*).

Më herët, Lafe (1982) do të shprehej se Gjuha letrare kombëtare e njësuar në Kosovë “mësohet me zell nga rinia shkollore, bëhen përpjekje këmbëngulëse për zbatimin sa më të përpiktë të saj në shtyp, në botime e në veprimtari të tjera. Për këtë një ndihmë të veçantë japin studimet e gjuhëtarëve kosovarë lidhur me çështjet e normës letrare e të kulturës së gjuhës. Dhuna e vrazhdë e shovinizmit serbomadh nuk do të mundë t’i asgjësojë këto arritje, pasi ato kanë rrënjë të thellë anë vetëdijën e lartë kombëtare të vëllezërve tanë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi.” (Lafe, 1982, 8-9).

IV. Politika gjuhësore implicite pesë dekada pas Kongresit të Drejtshkrimit

Një standard i ri? Shumë nga përbërësit e skemës së Cooper-it, që zbërthym më lart, kanë ndryshuar sot 50 vite pas Kongresit të Drejtshkrimit. Gjithsesi planifikimi gjuhësor, që ka kulmuar me Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe i ka dhënë rezultatet e efektet e veta, sepse siç Cooper-i thekson, që diçka e tillë të ndodhë, “norma e parashkruar duhet të jetë pranuar, përdorur dhe të jetë në fuqi derisa një tjetër normë tjetër ta zëvendësojë. Një tipar i zakonshëm, në mos absolutisht thelbësor, është kodifikimi, që tipikisht u referohet rregullave të shkruar” (Cooper 144).

Në rastin e shqipes standarde është e qartë që norma është pranuar, përdorur dhe, pavarësisht diskutimeve rreth saj, ende nuk është zëvendësuar nga një tjetër normë. Gjasat që kjo të ndodhë brenda një apo dy dekadash janë të pakta, veçanërisht brenda territorit të shtetit shqiptar. E bëjmë këtë pohim për disa arsye: Politikat gjuhësore aktualisht në vendin tonë janë implicite dhe kanë qenë të tilla, qysh prej rënies së regjimit diktatorial, në 1990-n. Një politikë gjuhësore implicite është ajo ku nuk ka nisma sistematike për planifikimin e gjuhës në rrugë zyrtare, por ideologjia e gjuhës përhapet dhe konsolidohet përmes kujdesit dhe vëmendjes ndaj shkollës dhe politikave arsimore. Po të shohim skemën e E. Shohamy-t (2006), për përdorimi *de facto* i gjuhës ndikohet nga një sërë aktivitete që janë reflektim i ideologjive gjuhësore. Në vendet me politika gjuhësore eksplicite/ të deklaruara të gjithë mekanizmat, e paraqitur në ilustrim, funksionojnë.




Figura 2 Lista e mekanizmave mes ideologjisë dhe praktikës (Shohamy 2006, 58)

Në këtë paraqitje skematike *ligjet dhe rregulloret* u referohen në tërësi ligjeve, rregullave e rregulloreve që kanë të bëjnë me çfarë cilësohet gjuhë standarde dhe zyrtare. Nga ana tjetër testimet gjuhësore, konsiderohen si një mjet i politikave gjuhësore dhe një degë e edukimit gjuhësor që, ka ndikimin më të madh në praktikën gjuhësore. Siç shihet, gjuha në hapësirën publike është po ashtu një mekanizëm i politikës gjuhësore. Ndërsa *ideologjia* lidhet me besimet për gjuhën, që siç thotë Shohamy, nuk mund të ndahen nga ideologjia politike e shtet-kombit, të besuarit në faktin që gjuhët dhe kombet janë identike, apo besime të tjera që mund të lidhen me varietete që gëzojnë prestigj krahasuar me disa të tjera. Te mitet përfshihen konceptet për *gjuhën e drejtë, gjuhën e mirë, gjuhën gramatikore* etj. (*shih më tej* Shohamy 2006: 130-133).

Ndërhyrja në rrugë zyrtare, qoftë edhe përmes një ligji për mbrojtjen e gjuhës, për të cilin është diskutuar vitet e fundit, gjithsesi nuk do të mund të diktonte një varietet standard kryekëput të ri, por në rastin më të mirë rishikimin e disa rregullave të drejtshkrimit. Në praktikën e shkrimit dhe të botimit, variantet jostandarde kanë fituar përdorim përherë e më të gjerë, çka prej aktorëve të kampit purist a gardian të gjuhës është interpretuar si një kakografi, ndërsa prej të tjerëve si larmi pasuruese, që iu jep të drejtën e mohuar për t'u lëvruar me shkrim edhe varieteteve, që e humbën formalisht këtë të drejtë gjatë viteve të zbatimit të politikës gjuhësore komuniste.

Studimet gjuhësore bashkëkohore dhe në mënyrë të veçantë studimet në fushë të politikave gjuhësore e kanë treguar se prirja sot është për të zbatuar ato politika, që reflektojnë realitete gjuhësore dhe jo për të imponuar politika të paarrtshme. Shohamy (2015, 156-157), shprehet se nëse deri së voni me politikë gjuhësore janë pasur parasysh vetëm politikat nga lart-poshtë, të krijuara nga qeveritë, parlamentet dhe ministrinë e arsimit dhe shumë shpesh të diktuar nga ideologjitë politike, përmes ligjeve dhe rregullave, sot prirja është për të marrë në konsideratë qëndrimet e komuniteteve dhe të aktorëve nga poshtë-lart, me synim respektimin e të drejtave të tyre dhe të përfshirjes së praktikave të tyre gjuhësore. “Aktualisht bëhen thirrje për politikë gjuhësore të mbështetur në negociatat mes agjentëve nga lart-poshtë dhe atyre nga poshtë-lart, për të përcaktuar politikat gjuhësore që janë të përshtatshme për kontekste specifike dhe për të kundërshtuar politikat kombëtare

uniforme të tipit “një masë për të gjithë”, në kushtet e diversitetit të komuniteteve, globalizimit dhe imigrimit (Davis, 2014; Menken, Garcia, 2010) (Shohamy 2016, 156).

Komuniteti i gjuhëtarëve dhe i studiuesve shqiptarë sot, 50 vite pas Kongresit të Drejtshkrimit, është më i vetëdijesuar se detyra e gjuhëtarit nuk është të ruajë gjuhën, as të parashkruajë rregulla rreth saj, por ta përshkruajë atë, pa e parë të izoluar prej komunitetit të folësve që e flet, që nuk është më ai i para pesë dekadave. Mbi të gjitha, e rëndësishme është të kihet parasysh se “të gjitha gjuhët dhe varietetet kanë boshllëqe në sistemet e tyre” (Milroy, Milroy 1999,12) dhe se diskutime të tipit gegërishtja vs. toskërishtja si dialekte më të mira apo më pak të mira, që do ta meritonin më shumë a më pak statusin e gjuhës standarde, janë të një niveli parashkencor dhe mund të kenë ekzistuar në kohët, kur ideologjia politike diktonte ideologjinë për gjuhën e njëjësuar. Ager (2000, 129) kur diskuton për shkallën e ekselencës së një gjuhe, thekson se ekselencia e saj, superioriteti apo inferioriteti si mjetet të komunikimit, thjesht nuk mund të maten objektivisht. Te kjo ide, intuitivisht apo tërthorazi, kishin arritur edhe gjuhëtarët që diskutonin për çështjen e planifikimit gjuhësor gjatë regjimit komunist në Shqipëri, sidomos në periudhën e hershme të instalimit të atij regjimi. Diskursi metalinguistik për gjuhën e njëjësuar kombëtare, dy dekada para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit shfaqet më tepër polifonik, ndonëse gjithsesi nën ndikimin e parimeve të shkencës staliniste.

Në këtë diskurs ideologjia për gjuhën e njëjësuar kombëtare zë dhe bëhet thujtë e pandashme me ideologjinë dhe propagandën politike të regjimit komunist. Figura kyçe frymëzuese si autoritet gjuhësor dhe folës model bëhet Enver Hoxha. Diskursi shkencor, ndonëse i prodhuar nga institucione shkencore të rëndësishme dhe nga aktorë jo pa kompetencë shkencore, është tërësisht i ideologjizuar dhe gëlon me idhujtari ndaj mësimëve të Partisë e të diktatorit.

Dija metalinguistike që qarkulloi për pesë dekada rreth Kongresit të Drejtshkrimit ka bërë që edhe në ligjërimin publik ende të hasen ide sipas të cilave gjuhëtarët duhet ta pasurojnë dhe ta ruajnë gjuhën “letrare/ standarde”, e cila po “shkatërrohet” nga “përdorimet e papërgjegjshme”. Këto tipare të diskursit metalinguistik për gjuhën letrare dhe veçanërisht roli i ideologjisë

komuniste në politikat gjuhësore dhe në procesin e planifikimit gjuhësor janë shfaqur edhe në vende të tjera me një të shkuar komuniste (Bremel 2007).

Ndërkaq, gjuhëtarëve të sotëm e të ardhshëm, u bie për detyrë (ironikisht dhe ky formulim i kalcifikuar nga koha e regjimit diktatorial), që tek-sa shoqëria modifikon vetveten dhe ideologjitë mbizotëruese ndryshojnë, të prodhojnë sa më tepër diskurs shkencor objektiv, larg preskriptivizmit, duke u mbështetur në atë që Eqrem Çabej, që përpara shtatëdhjetë vitesh do ta kërkonte si parakusht për çdo nismë planifikimi gjuhësor, mbledhja dhe studim i materialit gjuhësor.

Referencat

- Agalliu, Fatmir. 1995. *Fan Noli dhe gjuha letrare e kohës sonë*. Në: Gjuha jonë, Viti XV, nr. 1, f. 36-40.
- Ager, Dennis Ernest. 2001. *Motivation in language planning and language policy*. Vol. 119. Multilingual Matters,.
- Ajeti, Idriz. Lafe, Emil. 2000. Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit, 25-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit 1972-1997. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: Shtëpia botuese Shkenca, f. 39-43.
- Bajçinca, Isa. 2000. Rreth disa problemeve të shqipes letrare të kohës sonë në Kosovë. 25-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit 1972-1997. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: Shtëpia botuese Shkenca. f. 51-58.
- Beci, Bahri. 2000. Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri. Pejë: Shtëpia botuese Dukagjini.
- Bermel, Neil. 2008. Linguistic authority, language ideology, and metaphor. In *Linguistic Authority, Language Ideology, and Metaphor*. De Gruyter Mouton.
- Blommaert, Jan. 1996. Language planning as a discourse on language and society: the linguistic ideology of a scholarly tradition. *Language Problems and Language Planning* 20, f. 199–222.
- Blommaert, Jan. 1999. The debate is open. Në Blommaert, Jan (red.), *Language Ideological Debates*. Berlin/New York: Mouton de Gruyter, 1–38.
- Çabej, Eqrem. 1952. Detyrat e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare e probleme të tjera.
- Davis, Kathryn A. 2014. Engaged language policy and practice. *Language Policy*, 13(4), 83–100. DOI: 10.1007/s10993-013-9296-5.
- Demiraj, Shaban. 2000. Shqipja e sotme letrare në prag të shekullit XXI, 25-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit 1972-1997. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: Shtëpia botuese Shkenca. F. 39-43.
- Dodbibaj, Lirak. 1952. Rreth gjuhës letrare kombëtare. *Buletin për shkencat shoqërore IV*. Instituti i Shkencave, Tiranë. fq. 84-87.
- Domi, Mahir. 1952. Në *Buletin për shkencat shoqërore IV*. Instituti i Shkencave, Tiranë.

- Fairclough, N. 1995. *Media Discourse*. Londër: Edward Arnold Garrett.
- Fillmore, Charles. 1992. Corpus linguistics or computer-aided armchair linguistics. Në: *Directions in corpus linguistics. Proceedings of Nobel Symposium* (Vol. 82, fq. 35-60).
- Ismajli, Rexhep. 2006 [2013]. Gjashtë pyetje për akademik Rexhep Ismajlin. Në: Shala, Kujtim. M. (2013) *Portret Semiologu në rini*. Prishtinë: Buzuku. Fq. 139-156.
- Ismajli, Rexhep. 2020. Drejtshkrimet e gjuhës shqipe. Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Kastrati, Jup. (2000). Konvergenca gjuhësore nga Komisija letrare te Kongresi i Drejtshkrimit. *25-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit 1972-1997*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: Shtëpia botuese Shkenca. f. 59-64.
- Kostallari, Androkli, Çabej, Eqerem, Domi, Mahir. 1967. Rregullat e Drejtshkrimit të Shqipes (Projekt). Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë: Shtypshkronja Mihal Duri.
- Kostallari, Androkli. 1968. Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe. Në: *Studime Filologjike*. 1968, nr. 2.
- Kostallari, Androkli. 1973. Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj. Në *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe*. Nëntor 1972, V. 1, Tiranë.
- Kostallari, Androkli. 1982. Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare. Në: *Studime Filologjike*. 1982, nr. 2, fq. 3-36.
- Kostallari, Androkli. 1984. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Në *Studime filologjike*, viti 1984, nr. 4, f. 25-58. Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Kostallari, Androkli. 1985. Mësimet e shokut Enver Hoxha – baza e politikës gjuhësore të Partisë dhe të shtetit tonë socialist. Në *Studime filologjike*, viti 1984, nr. 2, f. 59-102. Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Lafe, Emil. 1982. Kongresi i gjuhës letrare kombëtare të njësuar (Me rastin e 10-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, Në *Studime filologjike*, viti 1982, nr. 4, f. 4-9. Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Lafe, Emil. 1984. Lufta për pastërtinë e gjuhës letrare shqipe në kohën tonë, Në *Studime filologjike*, viti 1984, nr. 4, f. 79-102. Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Malëshova, Sejfulla. 1952. Mbi gjuhën letrare kombëtare. *Buletin për shkencat shoqërore IV*. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë. f. 113-114.
- Menken, Kate, García, Ofelia. 2010. Negotiating language policies in schools. *Educators as Policymakers*. New York etc.: Roudledge.
- Pollo, Stefanaq, Xhuani, Aleksandër, Domi, Mahir, Buda, Aleks, Islami, Selim. 1952. Shkenca sovjetike – Dritë për shkencën tonë të re. *Buletin për shkencat shoqërore III*. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë. f. 3-5.
- Samara, Miço. 2005. Historia e gjuhës shqipe standarde. Tiranë.
- Siliqi, Llazar. 1952. Rreth gjuhës letrare kombëtare. *Buletin për shkencat shoqërore IV*. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë. f. 84-87.
- Silverstein, Michael. 1979. Language structure and linguistic ideology. Në *The elements: A parsession on linguistic units and levels.*: Chicago Linguistic Society.
- Shuteriqi, Dhimitër. 1952. Mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe. Në *Buletin për shkencat shoqërore IV*. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë. f. 3-55.

- Tufi, Stefania, Blackwood, Robert J. 2016. *The linguistic landscape of the Mediterranean: French and Italian coastal cities*. Springer.
- Thomai, Jani. 1984. Tipare të gjuhës së shtypit në kohën tonë, *Studime filologjike*, viti 1984, nr. 4, f. 103-118. Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Van Dijk, T. A. 1993. *Principles of critical discourse analysis*. *Discourse & society*, 4(2), 249-283.
- Watts, Richard. 1999. The ideology of dialect in Switzerland. Në Blommaert, Jan (red.), *Language Ideological Debates*. Berlin/New York: Mouton de Gruyter, faqe 67–104.
- Woolard, Kathryn A. 1992. *Language ideology: Issues and approaches*. *Pragmatics* 2, no. 3 (1992): f. 235-249.
- Xhuvani, Aleksandër. 1952. Fjala e hapjes (Sesioni i dytë shkencor për vitin 1952). *Buletin për shkencat shoqërore* IV. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë. f. 65-73.
- Xhuvani, Aleksandër. 1990. *Vepra* (2). Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Prof. Dr. Abdulla REXHEPI
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

FORMIMI I NJË GJUHE STANDARDE SIPAS SAMI FRASHËRIT: RASTI I SHQIPES

Abstrakt

Në këtë kumtesë trajtohen idetë dhe qasjet e Sami Frashërit në lidhje me formimin dhe kodifikimin e gjuhës. Ndryshimet e paradigmave shkencore dhe filozofike në Evropë, të cilat patën ndikuar edhe studimet gjuhësore, Sami Frashërit i ndihmuan që të strukturojë ide, koncepte dhe definicione të reja për gjuhën, saktësisht për gjuhët turke dhe shqipe. Në disa shkrime, Samiu, duke e parë gjuhën si faktorin kryesor për ruajtjen e njësisë të një populli dhe shteti, analizon dhe propozon mendime të reja rreth domosdoshmërisë së normimit dhe kodifikimit të gjuhës. Duke i paraqitur qëndrimet shkencore të Samiut ndaj zhvillimit të një gjuhe, idetë e tij mbi formimin e gjuhës së folur dhe të shkruar do të vihet në pah ndërmarrja e Sami Frashërit për formimin e gjuhës standarde.

Fjalë çelësa: Sami Frashëri, gjuha, gjuha standarde, shqipja, turqishtja

Hyrje

Samii Frashëri në Stamboll vepronte brenda një qarku intelektual që ishte i preokupuar me probleme qenësore të Perandorisë Osmane, dhe që çdo ditë po përballlej me rrënimin e saj. Sipas disa prej këtyre ideologëve dhe mendimtarëve, prapambeturia në rrafshin e shkencave dhe dijeve moderne ishte faktori kryesor që Perandorinë po e çonte drejt shkatërrimit. Shumica prej tyre të shkolluar në Paris dhe me literaturë moderne perëndimore, ishin të mendimit se nëse duam shkollimin dhe arsimimin e popullit me dijet e fundit, puna e parë që duhet të bëjmë është formimi i një gjuhe të unifikuar, e cila mund të kuptohet nga të gjithë. Në krye të kësaj lëvizjeje qëndronte Hoxha Tahsini, i cili shkruante: “Duhet të hapim një tryezë konsultimi dhe të mendojmë për reformimin e gjuhës sonë. Të përsërisim se reforma e gjuhës është obligimi individual i secilit prej nesh. Nëse gjuha nuk reformohet, atëherë do të ngelim pa zhvillim në fushat e ndryshme shkencore. Si të mos ngelim pas kur përparimi bëhet me arsim? Arsimi bëhet me libra. Ndërsa libri kuptohet me gjuhë të sistematizuar”.¹

¹ Hoxha Tahsini (2013). Vepra 2, Tiranë, Onufri. f. 297.

Më vonë edhe Sami Frashëri, për të njëjtin problem, në një shkrim të botuar në gazetën Hafta shprehej:

“Një popull e komb që do të përparojë dhe të qytetërohet, gjëja e parë që duhet të mendojë është çështja e përhapjes së artit të shkrimit e leximit në një shkallë sa më të gjerë të të gjithë pjestarët e popullit. Pasi të bëhet kjo, përhapja dhe përgjithësimi i dijeve dhe shkencave të ndryshme do të jetë një rezultat i natyrshëm. Te ne, shkak i mosdhënies së fryteve sipas përpjekjes që është bërë në mënyrë shtetërore (Perandoria Osmane, a.r.) për përhapjen e domosdoshme të dijes dhe shkencës, qëndron nga fakti se nuk është punuar për shkaqet e përhapjes së artit të shkrimit e leximit, që është baza e të gjitha dijeve dhe shkencave.”²

Sipas Tahsinit dhe Frashërit, përparimi dhe zhvillimi i një shoqërie arrihet vetëm me përhapjen dhe masivizimin e dijeve, ndërsa kjo nismë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një gjuhe të standardizuar e cila mund të kuptohet nga të gjithë.

Për këtë arsye dhe Samiu duke e ditur rëndësinë e gjuhës në jetën e njeriut dhe zhvillimit të tij, një pjesë të konsidereueshme të veprimtarisë shkencore ia ka kushtuar gjuhës dhe gjuhësisë. Pikëpamjet e tij për gjuhën në përgjithësi, si dukuri shoqërore me rëndësi dhe për shumë gjuhë veç e veç (për shqipen, turqishten, arabishten, persishten, frëngjishten, latinishten, greqishten etj.), Samiu i kishte shprehur qysh në fillim të veprimtarisë së tij në gazeta e revista të kohës,³ në parathëniet e fjalorëve të tij të mirënjohur,⁴ sidomos në parathënien e fjalorit normativ të gjuhës turke, *Kamus-i Turki*⁵, në enciklopedinë e tij 6 vëllimore, *Kamus al-a’lam*⁶, në polemika e debate

² Shemsedin Sami (1881). Okuyup yazmak, revista Hafta, Istanbul, Adet 5, 1298 (1881), s. 65-69.

³ Ağâh Sırrı Levend (1969). Şemsettin Sami, Ankara, f. 106-112.

⁴ *Kamus-i Fransevi: Fransızcadan Türkçeye lugat* (Fjalori Turqisht-frëngjisht), Istanbul, 1299 h./1883; është ribotuar edhe tri herë, gjithnjë i plotësuar: 1889, 1902, 1905; *Kamus-i Fransevi: Türkçeden Fransızcaya lugat* (Fjalori Turqisht-frëngjisht), Istanbul, 1885; *Kamus-i Arabi: Arapçadan Türkçeye lugat* (Fjalori Arabisht-turqisht), Istanbul, 1898 etj.

⁵ *Kamus-i Türki*, Istanbul, 1317h./1900.

⁶ *Kamus al-a’lam*, I-VI, Istanbul, 1889-1898. Shih Mehdi Polisi, *Kamus al-a’lami i Sami Frashërit vepër me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 23/1, Prishtinë, 2004, f. 51-62.

që ka zhvilluar ai për probleme të ndryshme gjuhësore⁷ etj.. Problemeve të gjuhës e të gjuhësisë, Samiu u ka kushtuar një vend të gjerë edhe në revistën *Hafta* (Java).⁸ Në këtë revistë shkruan një artikull të gjatë, në 6 vazhdime⁹, për prejardhjen, klasifikimin gjenealogjik të gjuhëve në familje, grupe e nëngrupe, për marrëdhëniet në mes tyre etj. Edhe studimi “Historia e shkrimeve” botuar këtu (nr.12, f.181-186) është me mjaft interes. Në revistën “Hafta” ka edhe artikuj të tjerë për gjuhën. Por, megjithatë, për probleme të përgjithshme, teorike të gjuhës, në mënyrë më të hollësishme, Samiu është shprehur në librin *Lisan* (Gjuha)¹⁰, i cili u botua në kuadër të serisë “Biblioteka e xhepit.” Edhe vepra e fundit e kësaj serie është e Samiut: *Usul-i Tenkit ve Tertip* (Shenjat e pikësimit dhe radhitjes),¹¹ po ashtu një vepër që trajton probleme gjuhësore.¹²

Shkrimet dhe hulumtimet e Samiut për gjuhën dhe gjuhësinë paraqesin një qasje mjaft bashkëkohore dhe një rigorozitet të madh në aplikimin e metodologjive shkencore të kohës. Siç pohon edhe Riza, “për më tepër qoftë vetë Kristoforidhi si pararendës qoftë gramatikanët e mëvonshëm Anton Xanon, Aleksandër Xhuvani, Ilija Dilo, Sheperi, Cipoja nuk e kanë pasur as intuitën historike dhe talentin analitik, as gjerësinë e gjykimit dhe sigurinë e metodës të Sami Frashërit”.¹³ Pikëpamjet e Samiut për përkufizimin e gjuhës, për zanafillën e shfaqjes së saj, për përcaktimin e emrave, për zhvillimin e saj paralel me zhvillimin e shoqërisë njerëzore, për dallimin e tingullit (britmës) nga zëri i artikuluar, për klasifikimin e gjuhëve nga aspekti tipologjik dhe gjenealogjik, për kriteret që duhet mbajtur gjatë klasifikimit

⁷ A.S.Levend, vep. e cit. f. 127 – 142.

⁸ Revista *Hafta* ka qenë revistë javore: letrare, shkencore dhe artizanale. Është botuar në turqishten osmane më 1298h./1881 në Stamboll. Kanë dalë 20 numra; çdo numër përbëhet nga 16 faqe, pra gjithsej 320 faqe. Përmban tema të llojllojshme: gjuhësore, letrare, shkencore, edukative, kulturore etj. Ajo që është e rëndësishme të thuhet është fakti se të gjithë artikujt e botuar në këtë revistë janë shkruar nga Sami Frashëri.

⁹ Hafta, *Lisanların insab ve taksimati* nr. 1, f. 11-14; nr. 2, f. 29-31; nr. 4, 60-62; nr. 5, f. 76-78; nr. 109-110; nr. 8, 122-126.

¹⁰ Sami Frashëri, *Lisan*, Istanbul, 1303h./1886. Është shkruar në turqishten osmane.

¹¹ Sami Frashëri, *Usul-i Tenkit ve Tertip*, Istanbul, 1303h./1886.

¹² Për më tepër shih: Mehdi Polisi (2014). Sami Frashëri në fushën e gjuhësisë, në revistën *Hikmet*, nr. 6, qershor, f. 43-76

¹³ Selman Riza (2004), *Vepra 4*, Prishtinë: ASHAK, f. 227.

dhe ndarjes së gjuhëve, për krahasimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve jo vetëm të gjuhëve të të njëjtit grup, por edhe të grupeve të ndryshme, të dëshmuara e të argumentuara dhe me shembuj të mjaftueshëm e të përshtatshëm, i ka shpjeguar e argumentuar në baza plotësisht shkencore dhe nuk lë vend për hamendësime.¹⁴

Aplikimi i metodës shkencore në gjuhësi, por dhe njohuritë e gjëra dhe të thella për gjuhësinë e kohës dhe gjuhët e Lindjes dhe Perëndimit, Samiut ia krijuan mundësitë të shkruante një gramatikë shqipe, e cila në shumë aspekte ende është e patejkalueshme për mësimin e gjuhës shqipe. R. Ismajli shkruan: “në gjendjen e sotme vlera e gramatikës së Samiut del qartë edhe po ta lëmë anash rolin që luajti ajo në kulturën tonë gjatë një shekulli jete dhe vetëm po ta përafrojmë me gramatikat e sotme të ngjashme, me ç’rast do të hetojmë të shpesh të më tepër precizime dhe saktësime sesa korrigjime pikëpamjesh, e më shumë gati aspak ndryshim metode. Shpesh madje do të na bjerë në sy se këto tendenca drejt precizimeve edhe si konfeksionime dhe kështu ta nxjerrin çështjen më pak të ndritur, pikërisht për shkak të mungesës së asaj gjerësie të frymës që e karakterizonte Samiun”.¹⁵

Qëllimi dhe ndërmarrja për zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë nëpërmjet përhapjes së dijeve bashkëkohore, e që një gjë e tillë mund të realizohej vetëm me krijimin e një gjuhe standarde që mund të kuptohej nga të gjithë, si dhe aplikimi i metodologjive dhe teorive më të fundit shkencore në fushën e gjuhësisë, Sami Frashërin e bëjnë tepër të rëndësishëm për historinë e gjuhës dhe gjuhësisë shqiptare.

Përpyekjet e Samiut për formimin e një standardi për shqipen

Edhe para Perandorisë Osmane, midis shqiptarëve ekzistonin dy variatete të shqipes letrare, mirëpo prestigji i tyre ishte shumë i vogël në raport me prestigjin e lëvizjeve të mëdha shoqërore siç ishte Rilindja dhe periudha pas saj. Sipas Ismajlit, sikur edhe “neve të na kish ndodhur t’i kishim polifunksionalizuar më shumë variantet e shkruara në sh. 16-17, të kishim vazhduar t’i përdorim ato pa ndërprejten që krijuan pushtimet turke,

¹⁴ Polisi, f. 48.

¹⁵ Rexhep Ismajli, (1999), Gjuhë dhe etni, Prishtinë: Rilindja, f. 218-219.

dhe ne sot do të kishim problem të ngjashme. Pa to nuk jemi as ne edhe në këtë gjendje, sepse, megjithatë, edhe te ne ekzistonin dy variante të gjuhës letrare qysh mjaft herët dhe për një kohë të gjatë,...”¹⁶ Kështu dhe Samiu ishte prej atyre që ngulte këmbë në njësimin dhe bashkimin e dy dialekteve dhe krijimin e një gjuhe standarde shqipe. Samiu i shkruante De Radës se shqiptarët kishin nevojë për një shkrim të njësuar të gjuhës shqipe, sepse mendonte se Shqipëria nuk mund të krijohej shtet duke pasur disa gjuhë dhe dialekte të ndryshëm. Ai shkruan:

“Vërtet sot kemi disa djalekta, po këto nukë janë të huaja njera nga jatera; po ca nga fraset edhe nga fjalët e gjuhësë kanë humburë më ca anë të Shqipëris’e të kolonivet e kanë rojturë më ca anë të tjera, shumë fjalë, pase e mbujtime të fjeshta e të mira që rojnë në Shqipëri janë humburë nëpër kolonit, shumë të tjera janë humburë në Shqipëri e rojnë nëpër koloni (a kolonjat), kshu edhe në mest të Gegërisë e të Toskërisë edhe të gjithë këtyre fjalëve e fraseve bashkë, edhe gjuha shqip do të bëhetë e begatë (riche), e gjerë e do të shpëtonjë nga të pasurit nevojë më fjalë të huaja, edhe gjithë djalektatë do të gjendenë të gjitha të bashkuara e të përzejera.”¹⁷

Ndërmarrje të tilla të Samiut po përcaktonin plane dhe programe në fushën e gjuhës shqipe. Munishi mendon se “në synimet e Samiut e të rilindësve të tjerë zë fill ideja për një politikë gjuhësore kombëtare në një formë shumë të përgjithësuar, jo konkrete. Në kohën kur kishin marrë hov idetë atdhetare të rilindësve, ata u përqendruan në tri çështje kryesore: krijimi i një alfabeti të përbashkët, pastrimi i shqipes nga barbarizmat e panevojshme dhe formimi i neologjizmave, si dhe prirja për konvergencë të elementeve gjuhësore drejt krijimit të një sistemi gjuhësor të përbashkët që do të kishte si rezultat të fundit krijimin e një gjuhe standarde gjithëkombëtare.”¹⁸

Këtë nismë Samiu e kishte filluar duke normuar dialektin toskë, si entitet më i vogël i gjuhës shqipe. "Kur thuhet toskërishtja e folur dhe e shkruar, natyrisht nuk nënkuptohet një korpus monolit e uniform, por ajo

¹⁶ Ismajli, ibid, f. 322.

¹⁷ Cituar sipas Shkumbin Munishi (2013). Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe. Prishtinë: AIKD-99.

¹⁸ Shkumbin Munishi (2013). Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe. Prishtinë: AIKD-99. F. 26-27.

paradigmë që përbëhet nga të tre nëndialektet, m'atë kohë po ashtu të folura e të shkruara (pa zënë ngoje variantet arbërishte, edhe këto letrare), të cilat duke u lënë veçmas e në punë të vet, do të vinin duke u larguar gjithnjë e më fort, duke bërë kështu edhe më të mundimtë punën për një shqipe të përbashkuar."¹⁹ Ndërsa Selman Riza shkruan "...dy djalektet t'ona ishin bamë gjuhëna shkrimi para se ta kishim një gjuhë t'përbashkët letrare"; ndaj ky përshtkallëzim i Frashërit nga më e vogla drejt më së madhes, është një hap i saktë - sa modern aq edhe pragmatik."²⁰

Sami Frashëri gjithashtu i kushtonte rëndësi të konsiderueshme hartimit të fjalorit të një gjuhe dhe rregullave gramatikore të saj. Në parathënien e fjalorit të turqishtes (Kamus-i Turki), Samiu shkruan: "Gjuha e cila nuk ka fjalor dhe rregulla gramatikore asnjëherë nuk mund të llogaritet si gjuhë letrare. Fjalori dhe gramatika janë bazat e letërsisë (...) Një popull që do ta ruajë gjuhën e pastër dhe të pasur, duhet të ketë një fjalor të pasur dhe libra morfologjike e sintakse të mira".²¹ Në kuadër të ndërmarrjes së tij për normativizimit të gjuhës shqipe, ai shkroi tekstin Alfabetares së gjuhësë shqipe (1879), në të cilin hodhi kërkesën e tij për një alfabet latin për gjuhën shqipe, më pas shkroi Abetares së gjuhësë shqipe (1886) ku zhvilloi edhe më tej mësymjen e parë të tij dhe në fund hartoi gramatikën Shkronjëtoe e gjuhësë shqip (1886), dhe në këtë mënyrë përbushu qëllimin e tij për një shqipe standarde.

Këtë gramatikë Samiu e shkroi me një terminologji shqipe, të cilën kjo gjuhë nuk e pati para tij, dhe siç thotë dhe Ismajli, "... një numër jo i vogël zgjidhjesh të shtruar atje mbeten të pranuar edhe sot, mbas një shekulli".²² Në këtë gramatikë ai i vendosi për herë të parë në gjuhën shqipe një numër konceptesh dhe kategorish gramatikore. Samiu gjithashtu në këtë tekst ka shprehur pikëpamje origjinale për strukturën fonetike dhe morfologjike të shqipes, disa prej të cilave përdoren edhe sot. Dhe nëse nisemi nga përkufizimi i Rexhep Ismajlit se "gramatikat e një gjuhe, qofshin shkollore e normative apo të tjera, mund të vlerësohen nga dy aspekte barabar të

¹⁹ Ledi Shamku-Shkreli (2015). *Modernija e Samiut – ajo që na duhet*", revista Hikmet, nr. 10, Prishtinë, f. 86.

²⁰ Riza, *ibid*, f. 228.

²¹ Sami Frashëri, *Parathënia e Kamus-i Turki (Fjalori i turqishtes)*, f. 3.

²² Ismajli, *po aty*, f. 218.

rëndësishme: nga aspekti i konsistencës së tyre teorike-shkencore dhe nga aspekti i rëndësisë së tyre për historinë e kulturës së një popullit që flet atë gjuhë”²³, atëherë mund të pohohet se Gramatika e Samiut i ka plotësuar të dy këta aspekte, gjithnjë duke pasur parasysh edhe rrethanat e kohës kur është shkruar si dhe zhvillimit të kësaj dijeje në vitet pas tij.

Ndërsa sa i përket varietetit të shqipes së Samiut, Demiraj mendon se “në veprën “Shqipëria ç’a qënë, ç’është dhe ç’do të bëhetë”?, Samiu “ka përdorur një gjuhë që, nga njëra anë, mbështetet shumë në shqipen e folur të Shqipërisë jugore dhe, nga ana tjetër, ndjek traditën e shkrimit, që në shekullin XIX nisi me Naum Veqilharxhin dhe mori një formë më të kristalizuar me shkrimet e K. Kristoforidhit, të S. Frashërit, N. Frashërit, etj.”²⁴

Në kohën e tij, Samiu dhe bashkëmendimtarët e tij u përballën me një mendësi statike, e cila mendonte se fenomenet, ndër to dhe një gjuhë e caktuar, ishin krijuar apo kishin dalë në pah vetëm një herë në të kaluarën dhe kështu do të mbesin deri në pafundësi. Kurse Sami Frashëri, mbron qëndrimin se gjuha është një dukuri shoqërore, ajo lind bashkë me shoqërinë, zhvillohet dhe përsoset paralel me zhvillimin dhe përsosjen e saj, dhe shkruan “Gjuha është një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut; vetëm njeriu është zotëruar i gjuhës; gjuha shërben për komunikim”.²⁵ Samiu në librin e vet “Gjuha” pohon se “Gjuha ka jetën e vet. Ashtu si njeriu, lind, jeton dhe vdes”²⁶, thotë Samiu. Ky koncept i tij ishte mbështetur në pikëpamjet e natyralistëve evropianë. Gjithashtu edhe ideja e Samiut se për gjuhësinë, gjuha e folur duhet të ketë rol parësor në krahasim me gjuhën e shkruar, shenjon një depërtim mjaft origjinal të tij para gjuhësisë moderne. Përa të dhe Shamku-Shkreli mendon se "roli themelor që Sami Frashëri i caktoi këtu e 125 vjet të shkuara gramatikës funksionale, si pasqyrim i ligjësive të gjuhës së folur, në praktikën e normimit gjuhësor nuk paraqitet vetëm në ushtrimin e mësipërm praktik. Atë e gjejmë të formuluar edhe si teori gjuhësore të mëvetësishme tek studimi i tij “Gjuha”, i cili u hartua në të

²³ Ismajli, po aty, f. 218.

²⁴ Shaban Demiraj, (1978). “Disa shënime të përmledhura rreth gjuhës së veprës”, në Sami Frashëri, Vepra 2, Prishtinë: Rilindja, f. 111.

²⁵ Po aty, f. 13.

²⁶ Po aty, f. 73.

njëjtin vit me “Shkronjëtoeren”.²⁷ Pra sipas Samiut, i cili punoi mbi normimin e një gjuhe, shqipes dhe turqishtes, gjuha evoluon, ashtu siç evolon dhe njeriu, prandaj dhe ne duhet të jemi të gatshëm për zhvillimin e normave dhe standardeve të gjuhës.

Përfundim

Në këtë kumtesë u trajtuan idetë dhe qasjet e Sami Frashërit rreth formimit dhe nevojës së kodifikimit të një gjuhe. I njohur me zhvillimet e fundit të fushës së gjuhësisë në Evropën e asaj kohe, Samiu mbronte idenë se për edukimin dhe zhvillimin e një shoqërie duhet pasur një gjuhë standarde, të cilën do të mund ta kuptonin të gjithë. Për atë dhe një pjesë të veprimtarisë së tij shkencore ia kushtoi gjuhës dhe gjuhësisë, veçanërisht gjuhës turke dhe shqipe. Samiu gjithashtu ishte i mendimit se njësimi i dy dialekteve të shqipes do të ndihmonte në bashkimin e shqiptarëve dhe kështu do të krijohej Shqipëria unike. Në këtë mënyrë, ai hartoi abetare dhe gramatikë për gjuhën shqipe. Në shumë aspekte, gramatika e Samiut dhe konceptet gramatikore të saj, edhe sot e kësaj dite janë të përdorueshme. Samiu gjithashtu ka mbrojtur idenë se gjuhët, njëjt sikur njeriu, lindin, zhvillohen dhe vdesin. Njohja e shumë gjuhëve të Lindjes dhe Perëndimit, rezultuan që depërtimet dhe qasjet e tij për gjuhën dhe gjuhësinë të jenë origjinale dhe me saktësi të lartë shkencore.

Literatura:

Agâh Sırrı Levend (1969). Şemsettin Sami, Ankara.

Hoxha Tahsini (2013). Vepra 2, Tiranë: Onufri.

Ledi Shamku-Shkreli (2015). Modernija e Samiut – ajo që na duhet, revista Hikmet, nr. 10, Prishtinë.

Mehdi Polisi (2004). Kamus al-a’lami i Sami Frashërit vepër me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën , Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 23/1, Prishtinë.

Mehdi Polisi (2014). Sami Frashëri në fushën e gjuhësisë, revista Hikmet, nr. 6, qershor, Prishtinë.

Rexhep Ismajli (1999), Gjuhë dhe etni, Prishtinë: Rilindja.

Selman Riza (2004). Vepra 4, Prishtinë: ASHAK.

²⁷ Shkreli-Shamku, ibid. 86.

- Shaban Demiraj, (1978). Disa shënime të përmladhura rreth gjuhës së veprës, në Sami Frashëri, *Vepra 2*, Prishtinë: Rilindja.
- Shemsedin Sami (1881). *Okuyup yazmak*, revista *Hafta*, Istanbul, Adet 5, 1298 (1881).
- Shemsedin Sami (1883). *Kamus-i Fransevi: Fransızcadan Türkçeye lugat* (Fjalori Turqisht – frengjisht), Istanbul, 1299h./1883.
- Shemsedin Sami (1885). *Kamus-i Fransevi: Türkçeden Fransızcaya lugat* (Fjalori Turqisht – frëngjisht), Istanbul, 1885.
- Shemsedin Sami (1898). *Kamus-i Arabi: Arapçadan Türkçeye lugat* (Fjalori Arabisht – turqisht), Istanbul, 1898.
- Shemsedin Sami (1898). *Kamus al-a'lam*, I – VI, Istanbul, 1889 – 1898.
- Shemsedin Sami (1900). *Kamus-i Türki*, Istanbul, 1317h./1900.
- Shemsedin Sami *Hafta*, *Lisanların insab ve taksimati* nr. 1, f. 11-14; nr. 2, f. 29-31; nr. 4, 60-62; nr. 5, f. 76-78; nr. 109-110; nr. 8, 122-126.
- Shemsedin Sami (1886). *Lisan*, Istanbul, 1303h./1886.
- Shemsedin Sami (1886). *Usul-i Tenkit ve Tertip*, Istanbul, 1303h./1886.
- Shkumbin Munishi (2013). *Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe*. Prishtinë: AIKD-99.

Dr. Shpëtim ELEZI
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

RRETH THJESHTIMIT TË RREGULLAVE NË NORMËN E SHQIPES STANDARDE

Abstrakt

Me kohën një gjuhë standarde zhvillohet në përputhje me zhvillimet dhe kërkesat shoqërore e politike dhe me vetë zhvillimet e përgjithshme gjuhësore. Kësisoj, në periudha të caktuara kohore, siç është tashmë edhe ky 50-vjetor i funksionimit të gjuhës standarde shqipe, edhe gjuha standarde shqipe ka nevojë t'i nënshtrohet një shqyrtimi shkencor lidhur me funksionimin dhe zhvillimin e saj, në një anë, duke pasuruar dhe duke zgjeruar mjetet dhe kapacitetet e saj shprehëse dhe, nga ana tjetër, duke thjeshtuar e lehtësuar rregullat dhe duke eliminuar përjashtimet që vështirësojnë zbatimin e tyre. Rezultati i këtij procesi është një normë standarde e përpunuar që lehtëson komunikimin duke përmbushur sa më mirë nevojat komunikuese të përdoruesve të saj në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe natyrshmërisë në komunikim. Ky proces në fakt rregullon vitalitetin dhe funksionalitetin e shqipes standarde. Nëpër këtë proces ka kaluar çdo gjuhë standarde, prandaj këtyre kritereve e nevojave nuk mund t'u shmanget as gjuha standarde shqipe. Në këtë kuadër, ky punim trajton disa nga çështjet që kanë të bëjnë me normën e shqipes standarde, siç janë shkrimi dhe shqiptimi i ë-së së patheksuar, çështja e temave të shumësit me formantet *-ë* dhe *-nj*, paskajorja e tipit *me integru(e)*, shkrimi i emrave të huaj të përveçëm, shkrimi i datave dhe problemi i normës leksikore. Gjithsesi, normimi i tyre nevojitet të jetë rezultat i një diskutimi shkencor mbi bazën e vëzhgimeve sistematike në bashkësitë folëse që e përdorin shqipen standarde dhe mbi bazën e një analize shkencore të gjetjeve në terren.

Fjalët çelës: Gjuhë standarde shqipe, normë e shqipes së shkruar dhe të folur, thjeshtim, *ë* e patheksuar, formantet e shumësit *-ë* dhe *-nj*, paskajorja *me integru(e)*.

1. Hyrje

Varieteti standard i një gjuhe zhvillohet në vazhdimësi, në një anë, duke *u pasuruar* me mjete të reja që shkojnë në funksion të zgjerimit të kapaciteteve të tij shprehëse dhe, nga ana tjetër, duke *i thjeshtuar* rregullat e tij me qëllim që ai varietet të zbatohet sa më lehtësisht në domene të ndryshme arsimore, shkencore, politike, administrative, mediatike etj. dhe të pranohet në një masë sa më të madhe nga bashkësia e caktuar folëse. Pra, zhvillimi i një gjuhe

standarde që nënkupton edhe thjeshtimin e rregullave të normës së saj bëhet me qëllim që ai varietet të jetë sa më i përshtatshëm e më i natyrshëm dhe sa më funksional për të përmbushur në mënyrë efektive nevojat komunikuese të përdoruesve të bashkësisë gjuhësore që e përdor atë. Nga ky proces nuk bën përjashtim as gjuha standarde shqipe, nevoja për zhvillimin e së cilës është shtruar vazhdimisht që nga themelimi i saj deri më sot, ashtu siç është paraparë edhe në vetë Kongresin e Drejtshkrimit (1972), në të cilin u vendos norma e shqipes standarde: *“struktura e sotme e gjuhës sonë letrare është e hapët e do të mbetet e tillë. Përndryshe zhvillimi i gjuhës letrare do të ndërpritej. Ai që ne quajmë ‘kristalizimi përfundimtar i normës’ në të vërtetë nuk është kurrë përfundimtar, i përjetshëm, statik; ai duhet kuptuar si vendosje e një qëndrueshmërie tipike, por relative të normës, e cila është dinamike, zhvillohet e përsoset.”*

Standardizimi i një gjuhe nuk është një akt i njëtrajtshëm e statik që kryhet aty për aty dhe njëherë e përgjithmonë atë ditë kur vendoset norma e një gjuhe standarde, por është një proces kompleks e dinamik që zhvillohet në përputhje me vetë zhvillimet shoqërore dhe me kërkesat e vazhdueshme të grupeve të ndryshme të asaj bashkësie gjuhësore që e përdor atë varietet. Faktorët jashtëgjuhësorë janë përcaktues në procesin e standardizimit të një gjuhe dhe, më tej, në procesin e zhvillimit, d.m.th. të rishikimit e të përmirësimit të normës së saj. Madje për shkak të ndikimit të këtyre faktorëve, të dyja këto procese bëhen të ndërlikuara e të ndjeshme dhe shpesh prihen nga diskutime kundërthënëse e polarizuese jo vetëm brenda grupit të gjuhëtarëve, të cilët, sipas disa teoricienëve (Haugeni e të tjerë), në radhë të parë janë ata që duhet të merren me këtë çështje, por edhe në mesin e të gjitha grupeve shoqërore brenda asaj bashkësie folëse që kanë interes që mjetin e tyre të punës ta bëjnë sa më funksional dhe sa më të përshtatshëm. Ky polarizim mendimesh në mesin e gjuhëtarëve dhe grupeve të tjera është i kuptueshëm edhe për faktin se gjuhëtarët dhe të tjerët janë njerëz të shtresave të caktuara, me interesa të caktuara, me moral dhe ideologji të caktuar (shih Ismajli 1991: 305). Për më tepër, do pasur parasysh se “me normimin e gjuhës nuk bëhet vetëm një ndërhyrje konkrete në strukturën, në kanalizimin e një përdorimi të

caktuar të gjuhës, po në radhë të parë ndërhyrje në organizimin shoqëror të folësve të asaj gjuhe. Pra, normimi do të duhej të shihet si veprim konfrontativ i forcave të caktuara në shoqërinë konkrete, të cilat nganjëherë arrijnë të prodhojnë edhe argumentim të caktuar lingvistik, si prodhim ideologjik” (Ismajli 1991: 305). Dhe, këto interesa shoqërore dominojnë gjatë gjithë procesit të standardizimit dhe të rishikimit të normës dhe si të tilla ato ndryshojnë me ndryshimin e raporteve midis grupeve shoqërore dhe me epërsinë që kanë ato në raport me njëra-tjetrën (shih Munishi 2016). Procesi i standardizimit të një gjuhe kalon nëpër disa faza, duke i përbrendësuar e duke i përditësuar gjurmët e secilës fazë nëpër të cilën kalon dhe, njëkohësisht, duke u përshtatur me karakteristikat gjuhësore e sociopolitike të çdo faze të re.

Gjuha standarde shqipe ka kaluar tashmë faza të tilla standardizimi, siç janë: 1) *zgjedhja e normës* – përzgjedhja dhe përcaktimi i një varianti standard, 2) *kodifikimi i formës* – standardizimi i formave të caktuara gjuhësore në të gjitha sistemet që përcillet nga hartimi i drejtshkrimeve, fjalorëve dhe gramatikave normative, 3) *elaborimi i funksioneve* – përdorimi i asaj gjuhe standarde në domene të ndryshme, si shkolla, qeveria, shkenca, kultura, 4) *pranimi* – përdorimi i gjuhës standarde në masë sa më të madhe nga bashkësia e caktuar folëse dhe 5) *zbatimi a imponimi i normës* – që nëpërmjet aparatit shtetëror, arsimor-kulturor dhe medieve bëhet në mënyrë të vendosur, të natyrshe e sistematike dhe me një qasje liberale ndaj folësve dhe varieteteve të tjera regjionale e sociale me të cilat gjuha standarde është e nevojshme të bashkëjetojë (Fishman 1964; Haugen 1966; 1983; Munishi 2016). Sa i përket *imponimit të normës* së shqipes standarde, ndër të tjerash, në raste ekstreme është propozuar edhe ligj për mbrojtje të gjuhës standarde, por një masë e tillë hyn në kuadër të imponimeve urdhëruese, kufizuese e përjashtuese që para së gjithash kufizon a cunگون vetë zhvillimin e normës dhe ngulfat përdoruesit e saj, e kjo për më tepër mund të nxitë refuzimin e asaj norme, si një masë edhe johumane që cenon lirinë e individit e të grupeve të ndryshme shoqërore.

Por, nga ana tjetër, duke qenë se në terren studimet kanë gjetur një nivel jo aq të mirë në punë të zbatimit të normës së shqipes standarde, pikërisht në ato institucione nëpërmjet të cilave synohet të

imponohet norma, si administrata, mediet, shkolla etj., (për nivelin e shqipes standarde në shkollë shih Elezi & Pllana-Elezi 2021), është e nevojshme të ndërmerren hapa të caktuar që në një formë a tjetër e ndihmojnë këtë proces të zbatimit më konsekuent të normës së shqipes standarde dhe, për më shumë, e imponojnë natyrshëm atë në një masë sa më të gjerë. Megjithëse në domenet publike synohet që të zbatohet norma e shqipes standarde, studimet kanë gjetur jo pak edhe përdorime jonormative. P.sh., një gjendje e tillë vihet re në shkresa zyrtare dhe në njoftime publike administrative, në tabela zyrtare, ashtu dhe në komunikimin publik të politikanëve dhe të njerëzve të kulturës, të arsimit e të shkencës, si dhe në medie, veçmas në portale. Si shembull tipik mund të merret rasti i një akademiku në Kosovë, i cili në një postim të shkurtër në vitin 2022 kishte bërë më shumë se 100 gabime gjuhësore. Duke lënë mënjanë tash për tash problemet e vetë normës, për disa prej të cilave do të diskutohet më poshtë, duhet thënë se kjo gjendje pjesërisht vjen si rezultat i moskompetencës së duhur gjuhësore të përdoruesve të saj, gjë që është pasojë direkte e formimit të tyre jo të mirë në shkollë dhe pjesërisht edhe si pasojë e një moskujdesi institucional dhe elitare që ka reflektuar në një masë më të gjerë. Elitat kulturore dhe politike, që u takojnë shtresave të caktuara, që kanë një kompetencë dhe formim të caktuar gjuhësor e kulturor, por edhe interesa e ideologji të caktuara, jo rrallë dëshmohen të jenë jo modeli më i mirë i përdorimit të shqipes standarde, për më tepër, ka dhe raste kur mbi këtë sfond sociopolitik, kulturor e regional tentojnë ta bëjnë qëllimshëm të kundërtën duke qenë përdorues jokonsekuentë të saj dhe duke imponuar kështu mosrespektim të varietetit standard në një masë më të gjerë. Natyrisht, kjo ndikon në uljen e prestigjit të gjuhës standarde, tipar që ajo e ruan edhe si rezultat i këtij përdorimi nga elita dhe, si pasojë, edhe në humbjen e kujdesit të përgjithshëm për respektim e zbatim të saj. Në këtë drejtim, hartimi i politikave arsimore që çojnë në ngritjen e nivelit arsimor jo vetëm për punë të nxënies së normës së shqipes standarde dhe ngritjes së nivelit të kompetencës gjuhësore, por në përgjithësi në punë të nxënies së kompetencave dhe shkathtësive në të gjitha fushat, në një anë, dhe përcaktimi për punësim të lektorëve dhe të redaktorëve gjuhësorë në institucionet përkatëse (administratë e medie), nga ana

tjetër, janë hapa të duhur që mund të ndikojnë në nivelin e përdorimit të shqipes standarde në një shkallë më të gjerë.

Por, përtej kësaj, gjuha standarde shqipe, si një varietet i njësuar që i ka kaluar tashmë pesë fazat e standardizimit që u përmendën më lart, për t'u siguruar se i përmbush në mënyrë sa më funksionale dhe sa më të përshtatshme nevojat komunikuese të përdoruesve të saj, është e nevojshme që t'i nënshtrohet tashmë procesit tjetër që është *vlerësimi* i vazhdueshëm i *pranueshmërisë*, i *zbatueshmërisë* dhe i *efikasitetit* të normës gjuhësore të saj. Nëse nga ky vlerësim rezulton se norma ka nevojë për t'u plotësuar me mjete të reja gjuhësore apo edhe për të bërë ndryshime të rregullave të saj në aspekt të thjeshtimit të tyre, në kuadër të planifikimit gjuhësor bëhen të nevojshme aktivitete të tjera standardizuese, siç janë *rishikimi*, *përmirësimi* apo *rikonstruktimi* i normës së saj, gjë që bëhet në përputhje me zhvillimet brendagjuhësore dhe me rrethanat jashtëgjuhësore sociopolitike, ekonomike, administrativo-juridike, kulturore dhe historike. Ky është një proces rregullues i normës që bëhet me qëllim që gjuha standarde të vazhdojë t'i ruajë *vitalitetin*, *adekuacitetin*, *përbashkësinë*, *racionalitetin* dhe *efikasitetin* e vet *elastik* dhe, për rrjedhojë, *të kultivohet* e *të zhvillohet* më tej për t'i përmbushur sa më mirë nevojat e përdorimit të saj në kohë dhe në hapësirë (shih për këto koncepte Sloka Ray, cit. sipas Byron 1976; Haugen 1966; Byron 1976; Doënes 1984; Ismajli 1991; Munishi 2016).

Të kihet parasysh gjithashtu se ndonëse norma e gjuhës standarde dhe rregullat e saj janë të fiksuara që si të tilla imponohen që të përdoren me përpikëri, zbatimi praktik i tyre në kohë dhe hapësirë përcakton përdorimin konsekuent ose jo të tyre. Në këtë aspekt, mosvitaliteti dhe mosifikasiteti i normës shpesh nxjerrin në sipërfaqe probleme të zbatimit të saj e kjo çon në mospranim të asaj norme dhe të rregullave të saj. Kësisoj, bëhet e nevojshme ndërhyrja e normuesve për përafrim të normës me përdoruesin me qëllim që të pranohet ajo normë dhe të arrihet efekti i lehtësimit në komunikim. Ndryshe, nëse nuk ndërhyhet në këtë proces, rreziku është që ajo gjithnjë e më shumë të bëhet diçka e largët për folësin, pasi vetë gjuha e folësit u nënshtrohet ndryshimeve të vazhdueshme nën ndikimin e faktorëve jashtëgjuhësorë. Në raste ekstreme flitet edhe për ndërrim të bazës dialektore të një gjuhe standarde.

Kështu, në periudha të caktuara kohore, siç është tashmë edhe ky 50-vjetor i funksionimit të gjuhës standarde shqipe, gjithnjë në përputhje me zhvillimet dhe kërkesat shoqërore e politike dhe me vetë zhvillimet e përgjithshme gjuhësore e me gjendjen e saj faktike të përdorimit në terren, shqipja standarde ka nevojë t'i nënshtrohet një shqyrtimi shkencor lidhur me funksionimin dhe me zhvillimin e saj, në një anë, duke pasuruar dhe duke zgjeruar mjetet dhe kapacitetet e saj shprehëse dhe, nga ana tjetër, duke thjeshtuar e lehtësuar rregullat dhe duke eliminuar përjashtimet që vështirësojnë zbatimin e tyre. Rezultati i këtij procesi është një normë standarde e përpunuar që lehtëson komunikimin duke përmbushur sa më mirë nevojat komunikuese të përdoruesve të saj në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe natyrshmërisë në komunikim. Ky proces në fakt rregullon vitalitetin dhe funksionalitetin e shqipes standarde. Nëpër këtë proces ka kaluar çdo gjuhë standarde, prandaj këtyre kritereve e nevojave nuk mund t'u shmanget as gjuha standarde shqipe. Fundja, thjeshtimi i rregullave në shqipen standarde është proces që shkon në përputhje me vetë prirjen e sinkretizimit që e karakterizon gjuhën shqipe në tërë sistemin e saj gjuhësor, siç është së fundmi rasti me format përemërore të dhanores *neve* e *juve* që po përdoren në tërë paradigmen e tyre.

Kësisoj, për të thjeshtuar e për të lehtësuar rregullat dhe për të eliminuar përjashtimet që vështirësojnë zbatimin e tyre, në vazhdim punimi trajton çështje të tilla si:

- ë-ja e patheksuar,
- format e shumësit me formantet *-ë* dhe *-nj*,
- shkrimi i emrave të huaj të përveçëm,
- shkrimi i datave,
- norma leksikore,
- paskajorja e tipit *me integr(u)*.

Këto çështje kanë qenë objekt trajtimi e diskutimi vazhdimisht që nga Kongresi i Drejtshkrimit (1972) e më pas në botime të veçanta, në artikuj revistash e në përmbledhje punimesh, si dhe në organizime të ndryshme, mjaft herë në punimet e Seminarit të Prishtinës, e në mënyrë të veçantë në Konferencën e Durrësit (2010) dhe posaçërisht në takimet e vazhdueshme të Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, i cili ka

nxjerrë një udhëzues me rekomandime për përmirësimin e normës (2016). Por një trajtim më i plotë i çështjeve të trajtuara në këtë punim është gjithnjë me dobi për të argumentuar ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në strukturën e shqipes standarde.

2. Zanorja ë e patheksuar

Një ndër problemet më të mëdha në normën e shqipes standarde është *ë*-ja e patheksuar dhe rregullat e përdorimit të saj në pozicion paratheksor dhe në pozicion pastheksor jofundor e fundor. Sipas rasteve, shkrimi i saj mbështetet në tri parime: fonetik, morfologjik dhe tradicional-historik. Për këtë arsye përdorimi i saj si në të shkruar dhe në të folur ka krijuar vështirësi mjaft të mëdha. Edhe hulumtimet kanë gjetur se *ë*-ja e patheksuar del si përdorimi jonormativ më i shpeshtë. Thjeshtimi i rregullave në përdorimin e *ë*-së së patheksuar mund të bëhet si në rastet në vijim.

2.1. *Ë*-ja paratheksore (kënaq) dhe pastheksore fundore (lumë)

Zanorja *ë* e patheksuar mund të thjeshtohet kur shkruhet sipas parimit historik-tradicional në këto dy pozicione:

- a) në pozicion paratheksor, si në shembujt: *bërryl, fëmijë, argëtoj, gëzim, këmishë, kënaq, këpucë, këqij (të), këqyr, kësaj, këshill, këtu, mëdhenj (të), mësyj, pështyj, thërrime* etj.
- b) në pozicion pastheksor fundor në rastin e disa emrave mashkullorë dhe një grupi emrash burimisht asnjanes, si në shembujt: *atë, burrë, djalë, gjalmë, gjumë, kalë, lëmë, lumë, ballë, brumë, djathë, drithë, dyllë, dhallë, dhjamë, gjalpë, mjaltë, ujë* etj. Shkrimi i këtyre emrave mashkullorë me *ë* fundore, e cila në shqipen standarde ka fituar rolin e një elementi kompensator për gjatësinë e zanores së temës (*dja:l, gju:m*), ka krijuar një tip të ndryshëm emrash nga paradigma e emrave mashkullorë që përgjithësisht përfundojnë me bashkëtingëllore tematike (*lis, gur*).

Në të dyja rastet *ë*-ja shkruhet sipas traditës së shkrimit, por sipas normës ortoepike ajo reduktohet deri në shkallë të plotë, si: *brryl, fmij, argtoj, gzim, knaq, kpuc, kqij (të), kqyr, ksaj, msyj, pshtyj, thrime; át,*

burr, djal, gjum, lum, ball, djath, mjalt etj. Por pikërisht si ndikim i formës së shkruar hetohen rastet e hiperkorrektizmit shqiptimor me ë (*kËqyr, kËsaj*), gjë që përbën shqiptim jonormativ. Në këto dy raste, brenda normës së shqipes standarde, shkrimi i ë-së është zgjidhur sipas një parimi tjetër (tradicional) dhe shqiptimi i këtyre rasteve sipas një parimi tjetër (fonetik). Kjo natyrisht që e ka komplikuar problemin dhe për pasojë ka krijuar vështirësi në përdorim, pasi përdoruesi është i detyruar që këtë numër të kufizuar fjalësh ta regjistrojë disi përmes vizualizimit a tjetër (pra, ta mbajë mend) për ta përdorur në mënyrë korrekte. Prandaj njësimi i rregullës duke u përdorur të dyja rastet sipas parimit fonetik e thjeshton problemin, sepse si në të folur, ashtu edhe në të shkruar paraqiten njësoj: *kqyr, ksaj, lum, uj* etj., sado që do pasur parasysh që kjo ka implikim në shqiptimin e zanores së gjatë në rastet *kal, uj*. Për më tepër, fakti që në këto dy pozicione nuk shqiptohet dhe nuk ka funksione gramatikore ose fonetike (si element lehtëshqiptues) e bën më të lehtë ndërhyrjen në sistem.

2.2. **Ë-ja paratheksore në rastet armiqësi dhe fajësoj**

Thjeshtimi i rregullës së përdorimit të ë-së së patheksuar mund të bëhet edhe në rastin e fjalëve të prejardhura prej temash që mbarojnë me bashkëtingëllore si *miq, faj* dhe nga prapashtesat emërformuese *-si, -zi, -ri* dhe foljeformuese *-so, -zo, -ro*, të cilat, si rrjedhojë e kësaj ortografie dalin me variantet *-ësi, -ëzi, -ëri; -ëso, -ëzo, -ëro*, ku thuhet se zanorja *ë* është si *zanore mbështetëse*, megjithëse në kufij të tillë morfematikë, sipas analizës sonë nga aspekti shqiptimor e rrokjesor, nuk del që krijohet ndonjë efekt i zorshëm shqiptimi dhe prandaj ndër kallja e saj në këto raste është e tepërt (shih dhe Topalli 2011). Fjala është për shembuj të tillë, si:

- a) *emra me prapashtesat -(ë)si/-(ë)zi/-(ë)ri: armiqësi (armiq + si); bujqësi (bujq); fajësi, pafajësi (faj); fshatarësi (fshatar); gjakësi, gjakësor (gjak); kombësi (komb); ligësi (i lig); madhësi, madhështi, madhështor (i madh); malësi, malësor (mal); miqësi, miqësor, miqësisht (miq); mjekësi, mjekësor (mjek); pleqësi (pleq); shëndetësi (shëndet); shtetësi, shtetëror (shtet); vazhdimësi (vazhdim); edhe: krejtësi-sht (krejt); djallëzi*

(*djall + -zi*); *besnikëri* (*besnik + -ri*); *mbretëri* (*mbret*); *pleqëri* (*pleq*), *robëri* (*rob*); *Shqipëri* (*shqip*); *trimëri* (*trim*) etj.

- b) *folje me prapashtesat -(ë)so/- (ë)zo/- (ë)ro*: *fajësoj, fajësim* (*faj + -so*); *keqësoj, keqësim* (*keq*); *miqësoj, miqësim* (*miq*); *pakësoj, pakësim* (*pak*); *shfrytëzoj, shfrytëzim* (*sh- + fryt + -zo*); *kryqëzoj, kryqëzim, kryqëzor* (*kryq*), *vargëzoj, vargëzim* (*varg*); *lajmëroj, lajmërim* (*lajm + -ro*); *lavdëroj, lavdërim* (*lavd*); *hapëroj, hapërim, hapësirë* (*hap*); *plehëroj, plehërim* (*pleh*); *pletëroj, pletërim* (*plet*); *qytetëroj, qytetërim* (*qytet*); *robëroj, robërim* (*rob*); *shkrifëroj, shkrifërim* (*shkrif*); *shqipëroj, shqipërim* (*shqip*); *trimëroj, trimërim* (*trim*) etj.

Siç shihet, kjo ë nuk lidhet as me temën fjalëformuese (*miq, besnik; faj, lajm*) dhe as me formantin (*-si, -ri; -so, -ro*). Prandaj shkrimi i këtyre rasteve pa ë e lehtëson drejtshkrimin, por edhe drejtshqiptimin, pasi edhe këto fjalë, sipas disa vëzhgimeve të rastit të folësve publikë nga puna me studentë, jo rrallë shqiptohen me ë nga ndikimi i formës së shkruar të tyre (*miqËsi, besnikËri; fajËsoj, lajmËroj*).

2.3. Ë-ja paratheksore te formimet me prapashtesën -tar

Shkrimi i ë-së paratheksore paraqitet edhe më i komplikuar te rastet e formimeve me prapashtesën **-tar**, për shkrimin e të cilave *Drejtshkrimi* ka 4 si rregulla:

- te temat me ë fundore, ë-ja shkruhet sipas parimit morfologjik si element fundor i temës: *anëtar, armëtar, udhëtar, rrogëtar*;
- te disa tema me ë fundore, ë-ja nuk shkruhet, bazuar në një traditë shqiptimi e shkrimi: *amtar, fillestar, furratar, kishtar, lojtar, meshtar, nevojtar, ngatërrestar, pishtar, rojtar, zyrtar* (*lojë, furrë, meshë*);
- kur në kufijtë morfematikë kemi dy bashkëtingëllore, ë-ja nuk shkruhet si zanore mbështetëse: *arsimtar, gjyqtar, flamurtar, kujdestar, oborrtar, shkaktar, shqiptar, tregtar* etj.;
- kur në kufijtë morfematikë kemi tri bashkëtingëllore, ë-ja shkruhet si zanore mbështetëse: *harkëtar* (*hark + -tar*), *kombëtar, ndërkombëtar* (*komb*); *lajmëtar* (*lajm*); *vargëtar* (*varg*) etj.

Siç shihet, kemi 4 rregulla të bazuara në tri parime për një paradigmë formimi fjalësh me strukturë të ngjashme fonetike e

morfologjike. E para, *ë*-ja në rregullën e katërt nuk ka ndonjë rol mbështetës, sepse ajo nuk realizohet dhe, e dyta, duke lënë mënjanë traditën tek *amtar* dhe parimin morfologjik tek *armëtar*, në praktikë është zor të kuptohet pse *armëtar* shkruhet me *ë* dhe *amtar* pa *ë*, aq më tepër që të dyja temat janë emra të gjinisë femërorë që përfundojnë me *ë* (khs. *amë* – *armë*). Prandaj njëjtësimi i rregullës duke i shkruar të gjitha rastet pa *ë* e thjeshtëson problemin dhe lehtëson shkrimin dhe shqiptimin normativ, sipas të cilit *ë*-ja reduktohet edhe aty ku është element fundor i temës. Pra shkruajmë dhe shqiptojmë: *armtar*, *amtar*, *arsimtar*, *lajmtar* bazuar vetëm në një parim, në parimin fonetik.

Duke pasur parasysh sa u tha më sipër, është e nevojshme që në mënyrë të veçantë në punë të shkrimit të *ë-së* së patheksuar në këto tri rastet e trajtuara më lart, por edhe në të tjera raste, ka nevojë për rishqyrtim të mëtejshëm të rregullave të shkrimit të shqiptimit të saj me qëllim njësimin e tyre dhe shmangien e konflikteve të krijuara si pasojë e zbatimit të dy e ndonjëherë të tri parimeve të ndryshme njëherësh (fonetik, morfologjik, historik), që vijnë dhe e komplikojnë punën edhe më shumë në punë të shkrimit, në një anë dhe në punë të shqiptimit, në anën tjetër. Përdorimi i saj në të folur e në të shkruar duke u bazuar vetëm në parimin fonetik mendoj që e thjeshton problemin si rregull dhe, rrjedhimisht, si praktikë përdorimi. Një parimi të tillë të thjeshtimit të rregullave i është lënë hapësirë edhe në vetë Kongresin e Drejtshkrimit, ku në parashtresën e Komisionit të Seksionit B thuhet: “Çështjet drejtshkrimore të shikohen brenda sistemit, në mënyrë që të mënjanohen zgjidhje të ndryshme për probleme të ngjashme.”

3. Format e shumësit me formantet *-ë* dhe *-nj*

Në sistemin morfologjik, siç është diskutuar dhe është propozuar shpesh, shqyrtimi i formave të shumësit të emrave, duke thjeshtuar më tej aspektin paradigmatic të tyre, me synimin për njësim dhe shmangie të përjashtimeve të shumta, sidomos në punë të shumësive me *-ë* dhe atyre me *-nj*, i ndihmon përdorimit sa më konsekuent të tyre.

3.1. Shumësi me formantin *-ë*

Format e shumësit të disa emrave të gjinisë mashkullore me formantin *-ë* përbëjnë njërën prej çështjeve të diskutueshme dhe problematike në normën morfologjike të shqipes standarde. Fjala është për shumësa të tillë, si: *shofer – shoferë, karrocier – karrocierë, sportist – sportistë, afarist – afaristë, guralec – guralecë, majmun – majmunë* etj. Formanti *-ë* në atë pozicion fundor është element i patheksuar, kështu që, sipas hulumtimeve, përdorues me kompetencë jo të mirë gramatikore temat e shumësit të tillë shpesh i shkruajnë pa *-ë*. Kjo vihet re veçmas te folësit e gegërishtes që në të folmet e tyre shumë nga këto raste i përdorin me *-a*. P.sh., në një hulumtim të realizuar me mësues të ciklit fillor në Kosovë ka dalë që formën e shumësit *studentë* 70% ose 46 mësues të anketuar e kanë përdorur jo saktë (*student, studenta*) dhe vetëm 30% ose 20 prej tyre e kanë përdorur saktë (*studentë*) (shih Elezi & Pllana-Elezi 2021).

Nga ky tip emrash të gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me këtë formant veçohen dy grupe: a) emrat me një paradigmë shumësi dhe b) emrat me dy paradigma shumësi. Më tej, brenda dy grupeve, duke u bazuar në kriterin tematik, dallohen nëngrupe të ndryshme, si në tabelat 1 e 2.

tema me fundoret	formë e standardizuar me <i>-ë</i>	formë e dëshmuar / e propozuar me <i>-a</i>	mbetet me <i>-ë/-e</i>
-ek	<i>byrekë, fishekë, hendekë</i>	<i>byreka, fisheka, hendeka</i>	por <i>mjekë</i>
-en	<i>kapitenë, legenë, sejmenë</i>	<i>kapitena, legena, sejmena</i>	
-ik	<i>ibrikë</i>	<i>ibrika</i>	por <i>historikë</i>
-ist	<i>futbollistë, specialistë, turistë,</i>	<i>futbollista, specialista, turista,</i>	
-er	<i>inxhinierë, menaxherë, oficerë, parukierë, portierë, shoferë</i>	<i>inxhiniera, menaxhera, oficera, parukiera, portiera, shofera</i>	por <i>kantiere</i>
-or	<i>ambasadorë, drejtorë; doktorë, profesorë</i>	<i>ambasadora, drejtora; doktora, profesora</i>	por <i>punëtorë</i>
-ar	<i>anëtarë, armëtarë, udhëtarë; lojtarë, rojtarë, zyrtarë; arsimtarë, gjyqtarë, shqiptarë; harkëtarë, kombëtarë, lajmëtarë</i>	(nuk ka përdorime me <i>-a</i>)	
-osh	<i>mjekroshë, trimoshë</i>	<i>mjekrosha, trimosha</i>	

-an	<i>kazanë, shandanë, tiganë</i>	<i>kazana, shandana, tigan</i>	
-ir	<i>vampirë, zinxhirë</i>	<i>vampira, zinxhira</i>	
-ol	<i>gogolë, kaqolë</i>	<i>gogola, kaqola</i> etj., ashtu si mashkullorët e standardizuar me <i>-a</i> : <i>sokola, qafola</i>	
-oll	<i>pinjollë, kunatollë,</i>	<i>pinjolla, kunatolla</i>	
-on	<i>avionë, kamionë, kampionë, bidonë, timonë, vagonë, kuponë</i>	<i>aviona, kamiona, kampiona, bidona, timona, vagona</i> etj., ashtu si mashkullorët e standardizuar me <i>-a</i> : <i>napolona, telefona, gramafona, diktafona, mikrofona</i>	
-un	<i>majmunë, pirunë, spiunë</i>	<i>majmuna, piruna, spiuna</i>	

Tabela 1. Emrat me një paradigmë shumësi

tema me fundoret	formë e standardizuar me <i>-ë</i> kur shënon frymorë	formë e dëshmuar / e propozuar me <i>-a</i> për frymorë	formë shumësi që mbetet me <i>-e</i> (a me <i>-a</i>) kur shënon jofrymorë
-al	<i>admiralë, gjeneralë, vandalë</i>	<i>admirala, gjenerala, vandala</i>	<i>festival – festivale, kanale, karnavale</i>
-el	<i>dembelë, kriminelë, teveqelë</i>	<i>dembela, kriminela, teveqela</i> , ashtu si shumësat e standardizuar për frymorë e jofrymorë: <i>harabela, gjela, bela, çengela</i>	<i>hotele, motele, tunele, zabele</i>
-il	<i>civilë, katilë, kopilë</i> (por <i>bilbila</i>)	<i>kopila, katila</i> , ashtu si shumësat për jofrymorë: <i>fitila, kandila, karafila, trëndafila</i> (por <i>civil – civilë</i>)	<i>idil – idile</i>
-at	<i>argatë, delegatë, kroatë, diplomatë, vlonjatë</i>	---	<i>aparate, atentate, fate, fosfate, shpate, pallate</i>
-et	<i>atletë, deputetë</i> (por <i>personalitete</i>)	---	<i>fakultete, marifete, qytete, shtete, tërmete</i> (por <i>magnetë, planetë</i>)
-it	<i>gjirokastritë, libohovitë</i>	---	<i>boksite, deficite, grafitë, pirite</i> (por <i>satelitë, shiritë</i>)
-id	<i>invalidë</i>	<i>invalida</i>	<i>hibride, okside, acide</i>

-ant	<i>elefantë, gjigantë, laborantë, maturantë</i>	<i>aspiranta, elefanta, gjiganta, laboranta, maturanta</i>	<i>deodorante, diamante, restorante, variante</i>
-ent	<i>agjentë, asistentë, elementë, studentë</i>	<i>agjenta, asistenta, docenta, elementa, studenta</i>	<i>aksidente, argumente, dokumente, elemente, monumente, komente</i>
-ont	<i>kontë, rinoqerontë</i>	<i>konta, rinoqeronta</i>	<i>fonte, fronte, horizonte</i>
-az	<i>xhambazë, matrapazë</i>	<i>xhambaza, matrapaza</i>	<i>gjimnaze, kafaze, pullaze</i>
-ez	<i>anglezë, borgjezë, francezë, kongolezë</i>	---	<i>qymeze, sofrabeze, trapeze (por breza)</i>
-oz	<i>bajlozë, karagjozë, marangozë, tifoze</i>	<i>bajloza, karagjoza, marangoza, tifoza, ashtu si shumësat e standardizuar për jofrymorë: kavanoza, mitraloza, rrogoza (por lloz – lloze)</i>	

Tabela 2. Emrat me dy paradigma shumësi¹

Nga sa mund të shihet në *Tabelën 1*, pjesa më e madhe e emrave mashkullorë me fundoret e caktuara tematike (13 nga 14 tipa) dëshmohen në përdorim me formantin *-a*, si: *byreka, kapitena, ibrika, sportista, traktorista, socialist, inxhiniera, kamariera, profesora, mjekrosha, jorgana, vampira, gogola, pinjolla, kamiona, kampiona, majmuna, piruna* etj. Përrjashtim bëjnë vetëm emrat me fundoren *-ar*, të formuar me prapashtesën *-tar*, si: *anëtarë, lojtarë, arsimtarë, ndërkombëtarë* dhe vetëm ndonjë rast nga tipat e tjerë tematikë si: *mjekë, punëtorë*, që megjithatë nuk dëshmohen të përdorur me *-a*.

Edhe në *Tabelën 2* shihet se 9 nga 13 tipat e emrave me fundoret e caktuara tematike përdoren me formantin *-a* kur shënojnë frymorë, si: *gjenerala, dembela, kopila, invalida, maturanta, studenta, rinoqeronta, matrapaza, tifoza* etj. Përrjashtim bëjnë vetëm 4 tipa të emrave me fundoret *-at, -et, -it, -ez*, që nuk dëshmohen me *-a*. Por edhe një numër emrash jofrymorësh nga *Tabela 2*, që e formojnë shumësin me

¹ Këta emra që dalin me fundoret e dhëna tematike në shqipen standarde e formojnë shumësin me *-ë* kur shënojnë frymorë dhe me *-e* (disa me *-a*) kur shënojnë jofrymorë.

formantin *-e*, dëshmohen në përdorim me *-a*, si: *aparata, diamanta, restoranta, dokumenta, kafaza, qymeza, sofrabeza, trapeza* (ashtu si *breza*), *satelita* (ashtu si *shirita*) etj.

Nga ana tjetër, duke qenë se në shqipen standarde ka dhe mjaft forma normative me *-a*, si: (m.) *bishtaleca, karkaleca, sokola, qafola, napolona, telefona, mikrofonta, trekëndështa* etj.; (f.) *mënyra, thika, pje-shka, dardha* (por edhe *dardhë* dhe *mollë*) etj., kjo dysi formash krijon edhe më shumë dilema në përdorim, aq më tepër që kemi mjaft raste fjalësh tematikisht të njëjta (*vagon, napolon*), që janë standardizuar në dy mënyra në shumës, një grup me *-ë* (*vagonë*) dhe grupi tjetër me *-a* (*napolona*), si në Tabelën 3.

tema me fundoret	me -ë	me -a
-on	<i>avionë, kamionë, kampionë, bidonë, timonë, vagonë, kuponë</i>	<i>napolona, telefona, gramafona, diktafona, mikrofonta</i>
-ol	<i>gogolë, kaqolë</i>	<i>sokola, qafola, bobola,</i>
-ec	<i>kastravecë, burrecë, bythecë, buburrecë, gardhecë, dordolecë</i>	<i>bishtaleca, karkaleca, gërreca, gërdeca</i>
-er	<i>inxhinierë, menaxherë, oficerë, parukierë, portierë, shoferë</i>	<i>kompjutera, postera, mastera,</i>

Tabela 3. Emra tematikisht të njëjtë të standardizuar me dy forma shumësi

Mbi këtë bazë këta shumësia të standardizuar me *-ë* mund të normëzohen me *-a*, çka do ta njësonte rregullën dhe do ta lehtësonte përdorimin. Në aspektin praktik, *a*-ja si formant më i fuqishëm shqiptimor dëgjohet në atë pozicion të patheksuar, prandaj dhe shkruhet, khs. *studentë [student] – studenta [studenta]* etj. Duke u formuar shumësi me formantin *-a*, do të dallohej më qartë forma e njëjësit nga e shumësit, gjë që është brenda një zhvillimi të përgjithshëm morfologjik të formimit të shumësive me *-a* në gjuhën shqipe. Të kihen parasysh këtu rastet e tilla të përdorimit, si: *mësuesia, nxënësa, nëpunësa, grushta, lëmsha, boshta, gjysha, nipa* etj., që po ashtu mund të standardizohen me formantin *-a*.

Për më tepër, kjo gjen mbështetje edhe në përdorim, meqë kjo është një prirje e përgjithshme e përdorimit të këtij lloji shumësi jo vetëm nga folës të arealit gegë, por edhe më gjerë në disa të folme toske (Xhaferi 1990; Balla

2007)², si dhe në domene të ndryshme të komunikimit publik. Edhe sipas Haxhit dhe Osmanit, “këtë shumës e ndeshim edhe në të folme të tjera, në disa raste në grupe fjalësh të veçanta, si në të folmet e Myzeqesë, të Semanit, të Devollit etj. Janë shumë të shpeshta rastet e shumësit me *-a* të këtyre fjalëve: *oficera, shofera, nxënësa, studenta, doktora, nënpunësa* etj. Forma të tilla drejtshkrimi ynë nuk i pranon, ndërkohë që në përdorimin e përditshëm, e jo vetëm në të folur, ato kanë fituar të drejtën e qytetarisë” (Haxhi & Osmani 2011). Këtë e pohon edhe Shkurtaj, kur thotë: “Nuk mund të mos i bëjmë udhë shtimit të shumësit me *-a* (*mësuesja, studenta, profesora, shofera, oficera* etj.) që vjen nga arealja gege, por që po gjen përdorim të gjerë e pëlqehet si një shumës më i qartë ndaj formave përkatëse me *-ë*... Tashti edhe toskët nuk i shqiptojnë më me *-ë* ato fjalë, prandaj edhe në praktikën shkrimore të sotme gjithandej po shtohen "gabimet" drejtshkrimore pikërisht për kategori të tilla” (Shkurtaj 2009: 43).

Prandaj, nga sa u tha më lart, sipas parimit të thjeshtimit të rregullës dhe parimit të praktikitetit, shumësat e tillë që janë me *-ë* në shqipen standarde, mund të standardizohen me *-a*.

3.2. Shumësi me formantin -nj

Kurse sa i përket shkrimit të shumësit me *-nj* a me *-j*, kjo çështje del e diskutueshme që në punimet e Kongresit dhe që atëherë nga shumica e gjuhëtarëve pjesëmarrës, por edhe më pas, është propozuar standardizimi i këtij tipi me formantin *-j* (Çabej 1972; Demiraj 1973; Topalli 1973, 2011; Bajçinca 1973; Çeliku 1995, 1998, 2011; Hysa 2002; Likaj 2003, 2011; Shkurtaj 2009; Veselaj 2002, 2009; Haxhi & Osmani 2011; Fiedler 2011; Badallaj 2011; Karagjozi-Kore 2007, 2011; Hamiti & Qamili 2011; Elezi

² Shih H. Xhaferi, *E folmja e Tomoricës*, në Dialektologjia shqiptare, nr. 6, Tiranë, 1990, f. 334, ku theksohet se shumë emra të gjinisë mashkullore e formojnë shumësin me formantin *-a*, si: *mësuesja, inxhiniera, oficera, bilbila, çengela* etj. Shih dhe Migena Balla, *Disa veçori gramatikore të emrit në të folmen e Vlorës*, në Seminari 26/1, Prishtinë, 2007, ff. 292-298, ku thuhet: “Vihet re përdorimi gjithnjë më i dendur i shumësit me *-a* në vend të atij me *-ë* për disa emra, si: *limon – limona, grusht – grushta, fitil – fitila, katil – katila, shofer – shofera, skafist – skafista, kamarier – kamariera*”.

2011). Në aspektin praktik hulumtimet kanë gjetur se shumësi me këtë formant është nga problemet më të mëdha. P.sh., në të njëjtin hulumtim të realizuar me mësues të ciklit fillor në Kosovë ka dalë që formën e shumësit të standardizuar *shkopinj*, 83% ose 55 mësues e kanë përdorur gabim (*shkopinjë, shkopinjët, shkopi*) dhe vetëm 17% ose 11 prej tyre e kanë përdorur korrekt *shkopinj* (shih Elezi & Pllana-Elezi 2021).

Këtu është fjala për disa emrave mashkullorë që mbarojnë me zanoret e theksuara *-i, -e, -o, -u* dhe me togun *-ua*, si: *ari-nj, shalqi-nj, mi-nj, penj, hero-nj, dru-nj, kërcu-nj, ftua – ftonj, përrua – përrenj, patkua – patkonj* etj., si dhe për shumësin e disa mbiemrave mashkullorë që mbarojnë me zanoren tematike *-i*, si: *i ri – të rinj, i zi – të zinj* etj., por edhe për disa emra e mbiemra që në shumës marrin prapashtesat *-enj* dhe *-inj*, si: *lumë – lumenj, shkëmb – shkëmbinj, budalla – budallenj, fukara – fukarenj, prift – priftërinj, shkop – shkopinj, gisht – gishtërinj, i madh – të mëdhenj* etj.

Ka disa arsye pse këto tema të shumësit duhet të standardizohen me *-j*, si:

- a. shtrirja territoriale dhe prirja e përdorimit e njëres trajtë ndaj tjetres në raste dysorësh (formanti *-j* del në gegërishten dhe edhe në disa të folme toske);
- b. konvergjenca në sistem që përfshin disa klasa fjalësh: emrat: *thoj*, mbiemrat: *të zij* dhe foljet: *punoj*;
- c. thjeshtimi fonetik që ndihmon për lehtëshqiptim dhe ndikon në denazalizim (khs. *drunj – druj*);
- d. thjeshtimi i sistemit paradigmatic brenda strukturës morfologjike: *druj, ullij* ashtu si *kufij, të këqij/të këqija, kroje* (edhe *gjuj – sepse gjunjë* është një hipertoskizëm i normuar);
- e. thjeshtimi i rregullës drejtshkrimore, duke njësuar dhe duke shmangur përjashtimet e dubletet e shumta;
- f. praktikiteti: bëhet më i lehtë shkrimi dhe shqiptimi i tyre (khs. *drujtë, hujtë, të rihtë, të mëdhejtë – drunjët, hunjë, të rinjë, të mëdhenjë*);
- g. ekonomizimi gjuhësor (shih për më shumë Elezi 2011).

Një problem shfaqet te fjalët që mbarojnë me zanoren e theksuar *-i* (*ulli-j, të zi-j*), tek të cilat, për shkak të ngjashmërisë shqiptimore të zanores

i me sonanten *j*, mund të kemi forma shumësi, si: *ulli, të zi*, për çka indikacione përdorimi kanë dhënë shumësat *kufij [kufi:]* dhe *të këqij [tkqi:]*. Kjo çon në njëjtësim të formës së shumësit me të njëjësit, gjë që shkon kundër prirjes së përgjithshme të shqipes për ta dalluar temën e shumësit nga tema e njëjësit, khs. *mal – male, kec – keca, arrë – arra, ujë – ujëra*; por dhe: *mollë – molla, mësu(e)s – mësu(e)sa* njësoj si *çelësa; shpi – shpia* etj., sado që ka dhe raste kur këto dy tema dalin të njëjta (*lule – lule, rugovas – rugovas, sy – sy, muaj – muaj, radio – radio*).

4. Shkrimi i datave dhe i emrave të huaj të përveçëm

Më lehtë mund të përmirësohet çështja e shkrimit të datave, edhe ashtu e zgjidhur nga praktika, norma ndërkombëtare dhe interneti, por edhe çështja e shkrimit të emrave të huaj. P.sh., rregulla se disa emra të huaj të përveçëm që kanë traditë përdorimi shkruhen ashtu siç shqiptohen dhe disa të tjerë që kanë traditë më të vogël me grafi origjinale, krijojnë shumë probleme. Çka të quajë përdoruesi traditë të madhe dhe çka të vogël? Shkrimi me grafi origjinale e zgjidh çështjen duke dhënë për herë të parë në kllapa edhe mënyrën se si shqiptohet në gjuhën shqipe. Edhe në këtë pikë tradita e përdorimit, siç po praktikohet gjithnjë e më shumë në medie dhe norma ndërkombëtare e ruajtjes së autenticitetit, i ka paraprirë kësaj pune.

5. Çështja e leksikut

Në punë të leksikut, siç edhe është vlerësuar në vazhdimësi, leksiku i shqipes standarde nevojitet të jetë i hapur ndaj prurjeve nga dialektet dhe nga autorët e traditës letrare. Në këtë aspekt, qasja e hapur ndaj leksikut krijon lehtësi komunikimi. E kundërta, siç kemi parë shpesh, kufizim dhe shtrëngesa në komunikim, e kjo shpesh ka çuar në paragjykim e stigmatizim të fjalëve edhe aq të përdorshme, si *këqyr, narth, katund, çel, çikë, krye* etj. Në punë të leksikut norma nuk është norma e gjuhës standarde, e cila sanksionon çka të përdoret e çka jo, por stilet funksionale dhe domenet e përdorimit që përcaktojnë përzgjedhjen leksikore të përdoruesit. Kjo nevojitet të jetë norma, e cila në këtë mënyrë mënjanon kufizimet komunikative.

6. Paskajorja me integru(e)

E fundit, por jo për nga rëndësia, është edhe shqyrtimi i mundësisë së integritit të paskajores gege në standardin e shqipes, për çka ‘heshtat’ janë përplasur më së shumti. Integrimi i saj si formë alternative e formave ekzistuese me cilindo variant që vendoset, (shpesh janë propozuar si zgjidhje të tilla: *me matë, me korrë, me marrë, me hapë, me pasë, me qenë, me pi, me ditë, me thënë, me punu(e)* etj.), mendoj se e pasuron gjuhën standarde, e lehtëson dhe e funksionalizon më shumë komunikimin, e ekonomizon shprehjen dhe ndikon që folësit gegë të ndihen më të përfaqësuar në varietetin standard dhe, njëkohësisht, vetë këtë varietet ta ndiejnë më për afër (Për më shumë shih Veselaj 2006; Bokshi 2011; Munishi 2011; May-Kolgjini 2011).

7. Përfundim

Si përfundim, siç u tha në fillim, me kalimin e kohës, zhvillimi i normës së gjuhës standarde është një proces i vazhdueshëm në raport me zhvillimet dinamike sociopolitike dhe gjuhësore. Rezultati i këtij procesi është norma standarde e përpunuar në aspekt të përmbushjes së funksioneve të saj dhe lehtësimit në komunikim. Ky proces në fakt rregullon vitalitetin dhe funksionalitetin e saj. Në këtë kontekst duhen parë edhe këto rekomandime që u përmendën më lart, normimi i të cilave nevojitet të jetë rezultat i një diskutimi shkencor mbi bazën e vëzhgimeve sistematike në bashkësitë folëse që e përdorin shqipen standarde dhe mbi bazën e një analize shkencore të gjetjeve në terren.

Referencat

- ASHSh (1973). Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë.
- Badallaj, I. (2011). Sa dhe si realizohet shqipja standarde në shkollë dhe në universitet. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Bajçinca, I. (1973). Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20-25 nëntor 1972). Diskutimi i Isa Bajçincës, f. 649, në: *Nga diskutimet në seksionin B*, Tiranë.
- Balla, M. (2007). Disa veçori gramatikore të emrit në të folmen e Vlorës. Në: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 26/1, ff. 292-298. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Bokshi, B. (2011). Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Byron, J.L. (1976). Selection Among Alternates in Language Standardization: The case of Albanian. Mouton The Hague. Paris.
- Çabej, E. (1972). Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes. “Mësuesi”, 1972, Tiranë. Cituar sipas Studime gjuhësore V, ff. 220 – 228, 1988, Prishtinë: Rilindja.
- Çeliku, M. (1995). Probleme të diskutueshme rreth Drejtshkrimit të gjuhës shqipe të vitit 1973. Seminarin XV Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, Tiranë: Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Tiranës.
- Çeliku, M. (1998). Kongresi i drejtshkrimit dhe norma gramatikore në gjuhën e sotme letrare. Gjuha jonë, 1-4. Tiranë.
- Çeliku, M. (2011). Për një përmirësim të mëtejshëm të shqipes standarde: mbi ndryshimin e disa rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Demiraj, Sh. (1973). Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20-25 nëntor 1972). Diskutimi i Shaban Demirajt, f. 649, në: *Nga diskutimet në seksionin B*, Tiranë.
- Downes, W. (1984). Language and society. Fontana Paperbacks. London.
- Elezi, Sh. & Pillana-Elezi, V. (2021). The use of standard Albanian language by primary school teachers. *Orbis Linguarum*. Vol. 19, Issue 3. pp. 59-70. Bulgaria: South-West University “Neofit Rilski”. In: <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=995682>
- Elezi, Sh. (2011). Çështja e shumësit me -nj, -enj, -inj në sistemin emëror të shqipes standarde. *Albanologji*, nr. 2, ff. 325-336. Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Fiedler, W. (2011). Tendencat e formimit të shumësit në shqipen e sotme. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Fishman, J. A. (1972). The Relationship between Micro – and Macro-Sociolinguistics in the Study of Who Speaks What Language to Whom and When. *Sociolinguistics*. Edited by J.B. Pride and J. Holmes. Ringwood. Victoria. Australia.
- Hamiti, A. & Qamili, A. (2011). Shtirija dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Haugen, E. (1966) *Dialekt, Language, Nation, Sociolinguistics – selected readings*. Editors: J.B. Pride and Janet Holmes. Penguin books. Ringwood. Victoria. Australia. 1972.
- Haugen, E. (1983). *Progres in Language Planning; International Perspectives*. Edited by Juan Cobarrubias, Joshua A. Fishman. Walter de Gruyter & Co. Berlin.

- Haxhi, A. & Osmani, T. (2011). Forma të shumësit në rrafshin e planifikimit gjuhësor të shqipes. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Hysa, E. (2002). Rreth prirjeve në formimin e shumësit të disa emrave. Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Ismajli, R. (1991). Gjuhë dhe etni. Prishtinë: Rilindja.
- Karagozi-Kore, M. (2007). Disa vërejtje për shumësin e emrave në shqipen standarde. Seminari 26/1. ff. 467 – 472. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Karagozi-Kore, M. (2011). Për një përmirësim të normës morfologjike në standard. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Likaj, E. (2003). Për dysorët morfologjikë dhe format jonormative. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 21/2, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Likaj, E. (2011). Morfologjia e shqipes standarde dhe zhvillime të reja. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- May-Kolgjini, J. (2011). Mundësia e përdorimit të paskajores në standardin e gjuhës shqipe. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Munishi, Sh. (2011). Mbi mundësinë e integritit të paskajores në gjuhën standarde shqipe. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Munishi, Sh. (2016). Shkrime sociolinguistike për shqipen standarde. Prishtinë: ZeroPrint.
- Shkurtaj, Gj. (2009). Marrëdhëniet e gjuhës së shkruar apo standardit me gjuhën e folur dhe dialektet sipas një ideje të hershme të Selman Rizës: “Parimi i enëve komunikuese”. “Profesor Selman Riza dhe albanologjia”. Korçë: Universiteti “Fan Noli”.
- Topalli, K. (1973). Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20-25 nëntor 1972). Diskutimi i Kolec Topallit, f. 643, në: *Nga diskutimet në seksionin A*, Tiranë.
- Topalli, K. (2011). Drejtshkrimi i shqipes si sistem. “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Totoni, M. (1971). Vëzhgime rreth të folmes së Kurveleshit. “Dialektologjia shqiptare”, nr. 1, Tiranë.
- Veselaj, N. (2002). Përpunimi i normës letrare kusht për kristalizimin e mëtejshëm të shqipes standarde kombëtare. “Studime”, nr. 8-9, f. 127-128, Prishtinë; Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Veselaj, N. (2006). Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe. Prishtinë.
- Veselaj, N. (2009). Shumësi dhe shquarsia e emrave në shqipen standarde. Prishtinë. Në: https://www.nuhiveselaj.com/librat_gjuhesore/rreth%20shquarsis%C3%AB%20dhe%20sp.pdf
- Xhaferi, H. (1990). E folmja e Tomoricës. Në: Dialektologjia shqiptare, nr. 6, Tiranë.

Prof. as. dr. Rozana RUSHITI
Universiteti i Tiranës

ÇËSHITJE TË ZBATIMIT TË NORMËS SINTAKSORE NË ADMINISTRATË

Abstrakt

Diskutimet rreth përdorimit të gjuhës standarde kanë kohë që kanë mbërthyer jo vetëm qarqet shkencore e akademike, por edhe forume të ndryshme për çështje të gjuhës shqipe. Është e vërtetë që sot ndeshemi me një gjuhë që ka probleme me përdorimin në sfera të ndryshme shoqërore që shpesh vjen nga kultura e mangët gjuhësore. Shmangie nga përdorimi i normës gjuhësore vihen re edhe te përfaqësues të medias, politikanë, nëpunës të administratës shtetërore, të cilët me këtë shkujdesje ndaj gjuhës, ushtrojnë trysni të vazhdueshme me vetëdije apo pavetëdije duke shkelur e deformuar normat gramatikore e drejtshkrimore të shqipes standarde.

Në optikën e këtij punimi do të jetë pikërisht veprimtaria ligjërimore shkrimore e këtij grupi të veçantë përdoruesish, të shkolluar e të veshur me statusin e nëpunësit, që reflektojnë dallime dhe ndryshime të dukshme në përdorimin e standardit e konkretisht në zbatimin e normës sintaksore. Çështje të përdorimit jonormativ të gjuhës standarde do të vihen në dukje duke u mbështetur në një korpus paraprak të përgatitur posaçërisht me shkresa e dokumente zyrtare, botime e afishime të organeve qeveritare të institucioneve të ndryshme. Gjuha e këtyre botimeve zyrtare është sa e varfër në mënyrën e të shprehurit dhe të lidhurit të fjalëve, aq edhe e pasur me gabime të natyrave të ndryshme. Në punim do t'u kushtohet gjithashtu rëndësi përfundimeve të diskutimeve të miratuara si propozime të grupeve të punës të Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe si organizëm me autoritet shkencor për shqyrtimin e të gjitha çështjeve që lidhen me përdorimin dhe zhvillimin e shqipes standarde.

Në mbyllje do të sillen në vëmendje propozimet dhe masat e ndërmarra (shtimi i redaktorëve gjuhësorë në çdo institucion) nga shteti dhe institucionet shqiptare për përmirësimin e kësaj gjendjeje, si dhe ide e propozime konkrete të parashtruara nga specialistët në aktivitete shkencore të lidhura ngushtësisht me këtë temë.

Fjalët çelës: standard, zbatim, normë sintaksore, administratë, shmangie

Nga ata që janë në këtë sallë, firmëtarë dhe dëshmitarë të asaj kohe për këtë ngjarje të shënuar të gjuhës shqipe dhe të kulturës sonë kombëtare,

pjesëmarrës të brezit tim, që nuk kishim lindur ende, mund të themi me bindje se kemi njëherësh krenarinë e këtij Kongresi historik, bashkë me qëndrueshmërinë e përdorimit të standardit prej gjysmë shekulli. Ky fakt, si element përbashkues i gjithë shqipfolësve në Shqipëri e rreth e rreth saj në shtete të ndryshme, ka përvijuar identitetin kombëtar dhe e ka afruar gjuhën tonë me gjuhët e lëvruara të Europës, sidomos me treguesit që kërkohen në ditët tona të integritit politik dhe ekonomik në Europën e Bashkuar. Pa u marrë në këtë punim me vendosjen e standardit gjuhësor, që është një arritje e ëndërruar prej aq e aq brezave intelektualësh prej më se një shekulli e këndej, duam të nënvizojmë se diskutimet për të kanë treguar edhe forcën dhe bazën shkencore të tezave të aprovuara 50 vjet më parë, mbasi shqipja i ka kryer dhe po i kryen të gjitha funksionet si gjuhë shoqërore, administrative dhe letrare, në të tëra stilet. Nuk kanë munguar gjatë kësaj kohe vepra që nga botimet akademike, librat shkollorë si dhe hartimi i studimeve të thelluara diakronike e sinkronike nga gjuhëtarët tanë, ku vendin kryesor e zë *Gramatika e gjuhës shqipe*,¹ shoqëruar edhe me botime të tjera e artikuj të shumtë, që kanë qenë tregues për kujdesin, mbrojtjen dhe pastërtinë e gjuhës shqipe, sipas modeleve të traditave të vendeve të tjera perëndimore. Është me vend të kujtojmë se në Kongresin e Drejtshkrimit u theksua se rruga ku ka ecur drejtshkrimi i shqipes “është progres, ose, sidoqoftë, jo regres”, sepse lejon që në të ardhmen, mbi bazën e drejtshkrimit të qëndrueshëm që do të miratojë ky Kongres, të bëhen përmirësime të mëtejshme,...siç ka thënë me të drejtë J.Vandriesi, përpjekjet për të zhdukur të metat e drejtshkrimit “nuk mund të shihen veçse me miratim”, sepse “ne nuk ndërhyjmë në jetën e gjuhës duke ndrequr drejtshkrimin e saj; ne vetëm e shpëtojmë atë nga një sëmundje që e bren.”²

Për gjuhën e administratës shtetërore dhe shkresat zyrtare, siç quhen, ka pasur dhe ka literaturë shkencore prej vitesh, në Tiranë e në Prishtinë, pa lënë jashtë edhe Shkupin e Tetovën, si: veprat e Jani Thomait, prej të cilave, *Teksti dhe gjuha*³ (për stilin dhe tiparet e gjuhës së shtypit), Xhevat Lloshi, në një sërë veprash, por sidomos në librin universitar *Stilistika e gjuhës*

¹ AShSh, *Gramatika e gjuhës shqipe I, II* (grup autorësh), Tiranë, 1995, 1997.

² Androkli Kostallari, *Gjuha letrare e sotme shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973, f. 84-85.

³ Jani Thomai, *Teksti dhe gjuha*, ShBLU, Tiranë, 1991.

shqipe dhe pragmatika,⁴ Qemal Murati *Gjuha e mediave*,⁵ Dhimitri Samara, *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe* -Vështirim leksikologjik e leksikografik,⁶ jo të gjitha të drejtpërdrejta për veçori të gjuhës së administratës shtetërore, siç kemi teori dhe modele për t'u ndjekur nga teksti mësimor i prof. Xh. Lloshit,⁷ apo edhe nga manuali i vëllimshëm *Si të shkruajmë shqip*⁸ - pjesa e përshtatur për gjuhën tonë po prej këtij gjuhëtari. Para disa vitesh janë marrë disa masa qeveritare, deri edhe VKM për redaktorë e korrektorë gjuhësorë në dikastere të larta shtetërore, në ministri dhe gjykata e prokurori, për të punësuar specialistë të aftë të gjuhës shqipe, por nuk i është shkuar deri në zgjidhje këtij problemi; prandaj dhe norma gjuhësore është shkelur në segmente të saj, që nga shmangiet drejtshkrimore, deri edhe në struktura sintaksore, për të cilat do të flas para jush. Kemi sjellë këtu një frazë nga shkresa e një institucioni të lartë shtetëror e shkencor për kriteret ku do të mbështeten botimet me intestimet e tyre:

*“Duke pasur parasysh se dokumenti bazë për të përcaktuar kriteret të pranuar ndërkombëtarisht për botimet shkencore, është Manuali Frascati: Frascati Manual: Proposed Standard Practice for Surveys on Research and Experimental Development, hartuar nga OSCE Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, i cili përkufizon kërkimin shkencor si “punë krijuese që kryhet në mënyrë sistematike për të rritur e zgjeruar bagazhin e dijes, përfshirë njohuritë e njeriut, kulturës dhe shoqërisë dhe përdorimin e këtyre njohurive për realizimin e aplikimeve të reja”, përcakton nocionet e kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar (paragrafi 64), si dhe aktivitetet që duhen përjashtuar nga nocionet e kërkimit dhe zhvillimit (paragrafi 66), në mënyrë që të bëhet dallimi i tyre nga aktiviteti i vërtetë shkencor”;*⁹

- duket qartë se struktura e frazës së përbërë nuk është shqipe, është e papërfunduar logjikisht, pasi ndërtime të tilla me përcjelloren *duke* + lokucionin *kam parasysh*, kanë prirje për një ngarkesë varg përbërësish

⁴ Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012.

⁵ Qemal Murati, *Gjuha e mediave*, Prishtinë, 2008.

⁶ Miço Samara, *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008.

⁷ Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012, Kreu XIII, f. 203-216.

⁸ Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip*, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2010.

⁹ Shih: *Kriteret për botim në ASH*, shkresë me nr. prot. 425, datë 19.11.2018, f. 2.

predikativë -fjali, të cilët duhen mbyllur si pjesë arsyetimi, më tepër kërkojnë një “duhet”; përveç kësaj, destinatorit i jepet të pyesë: duke pasur parasysh *këto e këto e ato*,... çfarë duhet bërë ?? Frazja të tilla e përhumbin mendimin dhe vështirë të ndiqet mesazhi i emetuesit! Ato janë kryesisht ndikime të sintaksës të gjuhëve neolatine – modele që jo rrallë i shohim në përkthimet e shumta që bëhen në ditët tona, pa shumë *censurë gjuhësore*.

Në përmbajtje të punimit tonë është pikërisht *veprimtaria ligjërimore shkrimore e një grupi të veçantë përdoruesish, të shkolluar e të veshur me statusin e nëpunësit* që reflektojnë dallime dhe ndryshime të dukshme në përdorimin e standardit, konkretisht në zbatimin e normës sintaksore. Theksojmë se pranimi i nëpunësve të tillë, jo vetëm që duhet bërë me devizën e meritës, por dhe duhen kontrolluar, sidomos në fillimet e punës së tyre, pse jo edhe duhen testuar për njohuritë gjuhësore që mbartin. Kjo do të shmangte rastet e keqkuptimit, të interpretimit të gabuar, arbitrar, ndoshta, edhe të qëllimshëm, të përmbajtjes së teksteve dokumentare a shkresave e urdhëresave. Në këtë vështrim, duhet ditur se norma sintaksore është më e vështirë të zotërohet dhe të përfillet kënaqshëm për arsye se ajo shfaqet me varacione stilistike strukturore, varësisht nga përdoruesit që e zbatojnë. Në vëzhgim kemi në një korpus të përgatitur posaçërisht me shkresa e dokumente zyrtare, botime e afishime të organeve qeveritare të institucioneve të ndryshme. Tekstet e përdorura nga këta ligjërues dhe zgjedhja e tyre duhet t’i nënshtrohen një parimi drejtues organizimi që gjuhëtari Lloshi e trajton si standardizim të përfunduar dhe sa më të lartë¹⁰. Në rast se standardi nuk respektohet, ka mjaft gjasa që teksti i shkruar të quhet i pavlefshëm për qëllimin e dhënë, ndaj rëndësi marrin modelet ku duhet të mbështeten shkresat zyrtare në të gjitha institucionet shtetërore, të cilat duhet të jenë të njësuar dhe me modele të paracaktuara. Përmendim konkretisht modelet e miratuara në vitin 2017, si pjesë e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë, të miratuar nga Këshilli i Lartë i Arkivave dhe të botuar në fletoren zyrtare¹¹. Nga ana tjetër, sot mjaft marrëveshje e dokumente ndërtohen sipas modeleve të përcaktuara në

¹⁰ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, f. 206.

¹¹ Vendimi nr. 4 i KLA-së, 2017.

praktikën ndërkombëtare. Nëpunësit administrativë shpesh kthehen në plotësues modeli, roli i tyre në komunikim zvogëlohet dhe kjo shfaqje e shtrëngesës gjuhësore i dallon këto dokumente nga akte të tjera të të shkruarit.

Stili i përdorur në shkresa synon që strukturat sintaksore të jenë të plota, me paraqitje objektive, pa emocionalitet, të sistemuara e të njëtrajtëshme. Struktura e sintaksës librore përmban dhe ndërtohet përmes fjalive të mëvetësishme, por të rënduara me lidhje të veçuara e me prani të përbërësve të palidhur gramatikisht. Gjithashtu, nuk është në praktikën e punës prania e frazave mungesore¹². Por pavarësisht këtyre kërkesave të domosdoshme, gjuha e dokumenteve zyrtare, pjesë përbërëse e korpusit tonë, është sa e varfër në mënyrën e të shprehurit dhe të lidhurit të fjalëve, aq edhe e pasur me gabime të natyrave të ndryshme.

Në vijim, po sjellim edhe njëherë në vëmendje disa luhatje, shkelje të normës së shkruar, në përdorimin e disa strukturave të tilla, të pranishme në gjuhën e administratës, që vijnë si pasojë e trysnisë së gjuhëve pa eptim e si:

1. *përdorimi i shkurtesave* për emërtimet e institucioneve dhe të organizatave qeveritare e joqeveritare, shoqata, parti, prania e të cilave shfaqet si një prirje e natyrshme për të lehtësuar tekstin administrativ në trajtë të pashquar dhe pa tregues rasorë: *DAP mbështet vazhdimisht; dokumentacioni do të përfitohet nga KSHB; 600 aplikime të paraqitura pranë DPT, nga anketimet e bëra nga INSTAT; bazuar në standartet e BE; dosjet e kandidatëve do të studiohen bashkërisht nga INSP dhe ONF; vendimin e Bordit Udhëheqës të CEPOL; OBT konfirmon Shqipërinë me një rritje 19% krahasuar me vitin 2019* etj. E gjithë kjo vjen në kundërshtim me strukturën gramatikore të shqipes, por edhe me drejtshkrimin e grupshkronjave si shkurtime. Siç dihet, kjo dukuri e shfaqur, së pari, në përdorimin në struktura të shqipes të emrave të huaj, po pasqyrohet edhe në moslakimin e emrave vetjakë, në onomastikë ku toponimet po paraqiten në trajtë të pashquar, sidomos kur ato përbëhen nga dy gjymtyrë. Në lidhje me këto shmangie e çrregullime që nuk dihet se si do të shtrihen më tej, akademiku Likaj,¹³ është i mendimit se mund të jenë edhe paraprirëse të reduktimeve të mëtejshme të

¹² Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f. 207.

¹³ E. Likaj, *Prirje të gjuhës shqipe në globalizëm*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2008, f. 205.

morfolojisë eptimore, që shkon me prirjen e përgjithshme drejt tipit analitik gjuhësor.

2. Analitizimi vihet re edhe në zëvendësimin e ndërtimeve sintetike me analitiket, me përdorimin e sintagmave parafjalore në vend të sintagmave emërore, pavarësisht se ç'nevojë ka folja si valencë apo në zëvendësimin e ndajfoljeve, të mbiemrave me sintagma parafjalore etj., si në segmentet e mëposhtme:

të ardhurat do të shkojnë për personat (= Të ardhurat do t'u shkojnë personave);

është masa që mund të vendoset ndaj të miturit (= është masa që mund t'i vendoset të miturit);

trafikimi me qenie njerëzore (=trafikimi i qenieve njerëzore);

përcakton në mënyrë të qartë (= përcakton qartë/qartazi);

moszbatimi në mënyrë të hapur i dispozitave ligjore (=moszbatimi hapur i dispozitave);

përdorimi në mënyrë të përsëritur (=përdorimi i përsëritur) etj.

Ndërtimet emërore e bëjnë më dinamik ritmin e frazës, por jo rrallë kur përdoren me tepri e pa vend i japin fjalisë a frazës një pamje artificiale¹⁴. Nga ana tjetër, duhet të pohojmë se shtimi i numrit të parafjalëve dhe i lidhëzave në një strukturë komunikative, dëshmon për intelektualizëm dhe saktësim, shfrytëzim sa më të saktë dhe të mirë të *sinonimisë sintaksore*¹⁵, që lidhet me *procesin e intelektualizmit të mëtejshëm të gjuhës*¹⁶ e rrit në përmasa më të mëdha fuqinë e mundësitë shprehëse të saj. Kështu, krahas zhvillimit të strukturës sintaksore të fjalisë nëpërmjet krijimit të një sistemi të pasur parafjalësh e lokucioneve parafjalore, shkon edhe zhvillimi i strukturës së frazës, nëpërmjet krijimit të një numri të madh lidhëzash e lokucioneve lidhëzore nënrenditëse.

¹⁴ S. Mansaku, *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, në SF, 2002, 3-4, f. 54.

¹⁵ S. Mansaku, *Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare*, Gjuha jonë, 1, 1985, f. 133.

¹⁶ M. Domi, *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, në SF, 4, 1984, f. 60.

3. Qëndrimet e gjuhëtarëve kundrejt strukturave të caktuara sintaksore që konsiderohen si zhvillime të saj, si p.sh. *ndërtimet emërore* në vend të *ndërtimeve foljore*; *strukturat pësore* përballë *strukturave veprorë* duhet të përdoren me vend; një pjesë e studiuesve i trajtojnë si shmangie, si struktura me ndikim nga gjuhët e huaja, që mbizotërojnë dukshëm në botime të tilla, si: në Fletoret Zyrtare, në kodet ligjore, rregulloret e në udhëzimet, sidomos strukturat me emra veprimi kundrejt ndërtime me forma foljore, p.sh. në dy fragmentet e shkëputura nga dy dokumente:

1- *Janë shkelje shumë të rënda: mospërmeshja e rëndë e detyrave; mosrespektimi i përsëritur i afateve në përmeshjen e detyrave...; moszbatimi në mënyrë të hapur i dispozitave ligjore, fshehja, ndryshimi ose asgjësimi i dokumenteve zyrtare; me qëllim krijimin e përfitimeve për vete dhe të tjerët; shkelje e përsëritur e rregullave të etikës; dëmtimi, keqpërdorimi i pronës, përfitimi i padrejtë, rishikimi i programit të transparencës, prezumimi, zbatimi korrekt i ligjit etj.*

2- *Centralizmi i procesit të planifikimit në turizëm, reformim i institucioneve, agjencive që merren me turizmin.*

Vendosje e rregullt në treg e të gjithë operatorëve ekonomikë në fushën e turizmit (agjenci, operatorë turistikë, udhërrëfyes dhe struktura mikpritëse).

Përmirësimi i legjislacionit do të shoqërohet edhe me përmirësimin e të dhënave si mjeti kryesor për matjen ekonomike të turizmit.

Mobilizim i aktorëve që merren me turizmin dhe komunikim të vazhdueshëm me komunitetin.

Kontroll i cilësisë dhe i standardeve në strukturat mikpritëse etj.

Zbatimi dhe format shprehëse të gjuhës nëpërmjet normës nuk mund të jenë të njëjta për të gjitha stilet, në ndonjë stil thyerjet janë të lejueshme, madje edhe të nevojshme, sepse norma në vetvete është një sistem me variante stilistike dhe funksionale. Gjuha e veprimtarisë shtetërore në kohët e sotme është e ndikuar nga publicistika dhe shkenca, prandaj shumë stilema të tyre bashkë me veçoritë që bartin depërtojnë edhe në tekstet e kësaj fushe. Nga ana tjetër, përpjekja për të mënjanuar ambiguitetet e gjuhës së zakonshme gjen zgjidhje të caktuara gjuhësore, të cilat shkojnë deri te mënyrat artificiale ose të huazuara. Ndërkaq shumë formulime gjuhësore i

nënshtrohen një prove të gjatë, si p.sh. modelet e shkresave dhe të urdhrave e udhëzimeve, kur pas një prove të gjatë, formulimet marrin qëndrueshmëri kthehen në standarde që me vështirësi pranojnë edhe ndryshimin më të vogël të paraqitjes gjuhësore.

4. Ajo që nxit reagimin tonë është shmangia që vazhdon të bëhet në gjininë e mbiemrave dhe të përemrave, në disa rasteve edhe të vetë emrave, *ndryshe përshtatja e gabuar e fjalëve përcaktuese me emrat në numrin shumës*, kryesisht të emrave ambigjenë:

Të gjithë dokumentet e lëshuara nga administrata shqiptare (= të gjitha dokumentet...); Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 11. 11. 2022 në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore këto dokumenta... (= këto dokumente);

i instrumentëve ligjorë (=i instrumenteve ligjore);

shihet se përbëhet nga tre fusha kryesore të produktit (=nga tri fusha);

shkeljen e ligjeve tatimore nga subjektet tatimpagues të regjistruar (=nga subjektet tatimpaguese të regjistruara);

Shqipëria ofron tre vende të Trashëgimisë Botërore (=tri vende)

apo përshtatje të gabuara të përemrave pronorë e vetorë me emrat që u referohen:

Ky trajnim teknik i kushtohet kandidatëve të specializuar (= ... u kushtohet kandidatëve);

Pjesëmarrësve në këtë trajnim i kërkohet domosdoshmërisht (= pjesëmarrësve u kërkohet...);

autoritetet dhe rrethanat të cilave administrata tatimore duhet t'iu ofrojë (= të cilave duhet t'u ofrojë);

në përgjigje të shkresës tuaj (=në përgjigje të shkresës suaj)

5. Përsëritja e morfemave trajtëformuese përpara përbërësve homogjenë, *rasti i nyjave përpara emrave e sintagmave emërore*. Parim është prania e zakonshme e tyre, duke qenë se ato janë pjesë përbërëse e nevojshme e shprehjes së dukurisë së homogjenitetit. (Në tekstet administrative, shkresa, udhëzime etj. ndeshen shumë gjymtyrë homogjene për shkak të enumeracioneve të kërkuara nga pesha e argumentimit) pavarësisht se në kuadrin e shprehjes së njëjtë të tyre krijohen mundësi për t'i nënkuptuar ato

pa asnjë vështirësi. Veprimi i ligjit të ekonomisë gjuhësore sjell që në kushte të caktuara të lihen pa u përsëritur nyja e gjinore, parafjala e njëjtë, pjesëza trajtëformuese e fjalëformuese e në një masë më të vogël foljet ndihmëse e gjysmëndihmëse¹⁷. Kjo prirje s'mund të përgjithësohet, kur nuk lejohet mospërdorimi i nyjës së përparme *të/së* para një emri të rasës gjinore, kur ai vjen pas një emri tjetër të rasës gjinore, të trajtës së shquar, numri njëjës:

Ekspert Ndërkombëtar mbi zhvillimin e metodologjisë dhe mjeteve të trajnimit (= ...mbi zhvillimin e metodologjisë dhe të mjeteve të trajnimit);

një mjedis të sigurt për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë (= për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë); etj.

Mungesa nyjash, sidomos në emërtimet e institucioneve të ndryshme apo në kokat e shkresave zyrtare. Të gjithë këta emra duhet të përdoren në të shumtën e rasteve me nyje të përparme, sidomos, kur përdoret e ndryshme: *Ministrja e Energjisë dhe Infrastrukturës* (=ministrja e Energjisë dhe e Infrastrukturës); *Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë* (=Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë); *Ministria e Financave dhe Ekonomisë* (=Ministria e Financave dhe e Ekonomisë); *Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve* etj. Sipas Çelikut, kjo shmangie e të ashtuquajtura “nyja të përparme”¹⁸ u kundërvihet kodeve ekzistuese duke shprehur një prirje të re në gjuhë. Disa janë të hershme, madje takohen edhe në variantet letrare, disa janë lëvizje të reja në gjuhë, ndonjëherë ndikim i gjuhëve të tjera; ndonjë mund të takohet edhe në letërsinë artistike.

Faktet që sollëm më lart, por edhe të tjera që nuk i përmendëm, dëshmojnë, nga njëra anë, se sa është zhvilluar struktura e shqipes, konkretisht gjuha e administratës, duke përfaqësuar një shkallë të lartë zhvillimi, si shprehje edhe e zgjerimit të veprimtarisë politike-shoqërore¹⁹, por ndërkaq nxjerr në pah edhe deformimet që ka pësuar apo të ashtuquajtura “barbarizma sintaksore”²⁰, çka dëshmon për kulturë të pamjaftueshme gjuhësore,

¹⁷ Mahir Domi, *Përsëritja a mospërsëritja e disa fjalëve dhe mjeteve trajtëformuese përpara gjymtyrëve homogjene*, Gjuha jonë, 1986, 3, f. 29.

¹⁸ M. Çeliku, *Shmangie në fushë të gramatikës e të drejtshkrimit në shqipen standarde (në medie)*, në Çështje të shqipes standarde, Tiranë, 2000, f. 250.

¹⁹ Jani Thomai, *Teksti dhe gjuha*, shblu, Tiranë, f. 174.

²⁰ Qemal Murati, *Gjuha e mediave*, Prishtinë, 2008.

mangësi të kompetencës gjuhësore, devijansa të normës ku, sigurisht, “kontributin të madh” e japin nëpunësit e administratës publike, politikanët, qeveritarët, të cilët jo vetëm e errësojnë shprehjen përmbajtësore, por shtrembërojnë strukturën sintaksore dhe e bëjnë atë të paqartë e të palogjikshme. Në literaturën tonë shkencore mungon një manual normativ kodifikues të plotë për normën sintaksore²¹, siç ekziston ai për Rregullat e Drejtshkrimit, pohuar (ky fakt) dhe i pranuar edhe në materialin e përgatitur nga grupi i punës i sintaksës, ngritur nga Këshilli Ndërakademik i Gjuhës Shqipe (KNGjSh). Kjo ka bërë që të ngjasin shmangie normative dhe të biem në modelet e sjella më sipër.

Mendojmë se hulumtimet dhe vëzhgimet që sollëm në vëmendje shprehin qartë ekzistencën e dukurive, shpesh të pranuar si shmangie apo prirje të përdorimeve të sotme të strukturave sintaksore. Studiuesi T. De Mauro ka këshilluar e sqaruar se një verifikim i kujdesshëm i disa përdorimeve të sotme të shqipes standarde mund të ndihmojë të kuptojmë më mirë problemet dhe të gjejmë zgjidhjet më të mira të mundshme²². Por duhen bërë më shumë kërkime e studime për të parë dendurinë e përdorimit, duhen realizuar projekte të mbështetura në metoda statistikore e sasiore që mund të qartësojnë dhe të sjellin përgjigje e rekomandime të sakta. nëse një ndërtim i caktuar sintaksor është vërtet prirje e gjuhës në një kohë të caktuar apo jo. Kjo lidhet me faktin se, siç e theksuam edhe më lart, sintaksa e *struktura e saj është e hapur*; ajo pasurohet me prurje të reja nga dialektet e të folmet e ndryshme, megjithëse nëse u referohemi prurjeve nga dialektet, studimet për sintaksën dialektore megjithëse jo të shumta në numër nuk dëshmojnë dallime të rëndësishme midis dialekteve të shqipes. Edhe Kostallari²³ më herët ka pohuar se dallimet dialektore në lëmin e sintaksës në shqipe janë relativisht të vogla. Nga ana tjetër, përfshirja e shqipes në atë që etiketohet si epoka e globalizimit, në komunikimin global e ballafaqon dhe e bashkëvepron atë me strukturat e gjuhëve të tjera, duke u ndikuar shpesh prej tyre, megjithëse prof. Lloshi shprehet me të drejtë se pavarësisht se shqipja u

²¹ Materiali i sintaksës, 2014.

²² T. De Mauro, *Mbi gjuhën dhe edukimin gjuhësor* në Dukuri të shqipes bashkëkohore, 5-8 tetor 2005, cituar nga sipas Sh. Rrokaj në *Çëshje të gjuhësisë III*, Tiranë, 2014, f. 83.

²³ Androkli Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, në *Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj*, f. 67.

është nënshtruar ndikimeve prej gjuhëve të tjera nëpër shekuj të gjatë, ajo ka mbetur e mëvetësishme në palcën e saj”. (Lloshi: f. 10).

Në të vërtetë, *kristalizimi përfundimtar i normës, sidomos i normës sintaksore, nuk është kurrë i përfunduar, i përrjetshëm, statik, por duhet kuptuar si vendosje e një qëndrueshmërie tipike, të normës, e cila është dinamike, zhvillohet e përsoset. Kjo bëhet edhe më e rëndësishtme, duke e lidhur me faktin se në rrafshin ndërkombëtar ku Shqipëria, por edhe Kosova priten të hyjnë në BE, i gjithë dokumentacioni evropian duhet të jetë në gjuhën shqipe. Politikat integruese sollën vullshëm futjen dhe përdorimin e anglishtes a të ndonjë gjuhe tjetër të vendeve të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht që rritën mundësinë e përfshirjes së strukturave të huaja në gjuhën shqipe. Është plotësisht e kuptueshme se shqipja do të huazojë fjalë të reja, të cilat nuk ekzistojnë në fjalorin e saj dhe më pas ato do t’i përshtaten duke u dhënë tipare gramatikore që janë në pajtim me rregullat e gramatikës së saj. Kjo nënkupton edhe njëherë se gjuha dhe struktura e saj nuk është statike. Ajo ndryshon dhe zhvillohet njëkohësisht me ndryshimet dhe zhvillimet të cilat ndodhin në shoqëri.*

Edhe për gjuhën e administratës, për gjuhën e përdorur në shkollë e në media, kërkohen studime e projekte kombëtare e mbarëkombëtare, të mbështetura në korpuse gjuhësore, të mbështetura në tri shtylla të gjuhës standarde: në shkollë, në media e në administratë, që të shihet prirja e sotme për të bërë më pas propozime për modele që do të sjellin edhe shmangien e problematikave me të cilat përballlet standardi i sotëm. Krijimi i tyre nuk është punë e lehtë, nuk mund të realizohen nga një a dy studiues, por duhet të angazhohen grupe studiuesish, specialistë nga të gjitha trevat shqipfolëse e padyshim kërkohet mbështetje financiare nga institucionet përgjegjëse.

Mospërdorimi i drejtë i standardit gjuhësor në institucionet shtetërore është edhe rrjedhojë e papërgjegjësisë së shtetit për këtë vlerë të lartë të kulturës dhe të identitetit kombëtar sikundër është gjuha standarde.

Konsiderojmë se, në interesin e përdorimit të drejtë të gjuhës standarde, institucionet shkencore e akademike dhe studiuesit e gjuhës, duhet ta zgjerojnë dhe ta thellojnë veprimtarinë hulumtuese edhe në pragmatikën gjuhësore të institucioneve shtetërore në veçanti në pikëpamjen e zbatimit të

drejtë të gjuhës standarde, të përdorimit të polisemisë dhe të sinonimisë gjuhësore, të pasurimit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të saj.

Prandaj, përpara institucioneve shtetërore e shkencore shtrohet si detyrë shumë e rëndësishme që kësaj çështjeje, përdorimit të drejtë të gjuhës standarde, t'i kushtohet vëmendje shumë më e madhe në të gjitha nivelet e arsimit.

Literaturë:

AShSh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (grup autorësh), Tiranë, 1995.

AShSh, *Gramatika e gjuhës shqipe II* (grup autorësh), Tiranë, 1997.

Çeliku, M.: *Shmangie në fushë të gramatikës e të drejtshkrimit në shqipen standarde (në medie)*, në “Çështje të shqipes standarde”, Tiranë, 2000.

De Mauro, T.: *Mbi gjuhën dhe edukimin gjuhësor* në Dukuri të shqipes bashkëkohore, 5-8 tetor 2005, cituar nga sipas Sh. Rrokaj në “Çështje të gjuhësisë III”, Tiranë, 2014, f. 83.

Domi, M.: *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, në Studime Filologjike, 4, 1984.

Domi, M.: *Përsëritja a mospërsëritja e disa fjalëve dhe mjeteve trajtëformuese përpara gjymtyrëve homogjene*, Gjuha jonë, 1986, 3.

Likaj, E.: *Prirje të gjuhës shqipe në globalizëm*, “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2008.

Lloshi, Xh.: *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012.

Kane, S., Th.: *Si të shkruajmë shqip*, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2010.

Kostallari, A.: *Gjuha letrare e sotme shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë.

Kostallari, A.: *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë* në “Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj.

Mansaku, S.: *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, në Studime filologjike, 2002, 3-4, f. 54.

Mansaku, S.: *Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare*, Gjuha jonë, 1, 1985.

Murati, Q.: *Gjuha e mediave*, Prishtinë, 2008.

Qendra e Studimeve Albanologjike, IGjL, *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.

Samara, M.: *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008.

Thomai, J.: *Teksti dhe gjuha*, ShBLU, Tiranë, 1991.

Prof. dr. Linda MËNIKU
Universiteti i Tiranës

VËSHTRIM KRAHASUES I (DREJT)SHKRIMIT TË FJALËVE TË AUTORËT E VJETËR DHE NORMATIVAVE DREJTSHKRIMORE NË SHEKULLIN XX

Dokumentet e para të shqipes janë jo vetëm dëshmi e traditës së shkrimit në gjuhën shqipe, por në një farë mënyre dhe e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës në faza të hershme të shkrimit. Sikurse thekson studiuesi Ismajli: “Është krejt normale që proceset e vendosjes së rregullave të drejtshkrimit të shqipes t’i kërkojmë në praktikat e shkrimit të autorëve të ndryshëm në kohë, sepse ato ndërlidhen drejtpërsëdrejti me mënyrat e analizës gjuhësore të strukturës së fjalës.”¹

Nisur nga kjo qasje, në këtë punim do të trajtohet tradita e shkrimit të fjalëve në gjuhën shqipe, sikurse dokumentohet në disa nga tekstet e para të shqipes², në përqasje me normativat drejtshkrimore në shekullin XX e në mënyrë të veçantë me rregullat e drejtshkrimit të përcaktuara nga Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972, me synimin që të nxirret në pah në mënyrë më të detajuar se ç’është bërë deri më sot e se në ç’raport qëndrojnë variantet e hershme letrare të shqipes me normën e sotme e në ç’masë janë ruajtur ose shmangur disa nga tiparet më karakterizuese drejtshkrimore

Normativa drejtshkrimore e gjuhës shqipe konsiderohet si një arritje e

¹ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*. Përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.9.

² “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555), botim kritik nga Eqrem Çabej, Tiranë, 1968; *Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra. Mbi botimin kritik të varianteve dorëshkrim e të shtypur të veprës “E mbsuame e krështerë”* (1592), Matteo Mandala, 2013; Svane G. (ed.), *Peter Budi, Dottrina Christiana* (1618). With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institute for Linguistics, Aarhus Universitet. Aarhus, 1985; *Dictionarium latino-epiroticum* (1635), botim kritik përgatitur nga Bardhyl Demiraj, Shkodër, 2008; *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*, përgatitur nga Anila Omari, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005; *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*. Anila Omari, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2016.

një periudhe më shumë se njëshekullore. Rregullat e drejtshkrimit dhe të normës gramatikore janë sintezë e një pune të filluar me Komisinë Letrare të Shkodrës (1916-1918), e cila është një nga ngjarjet më të rëndësishme të zhvillimit të kulturës dhe të gjuhës shqipe, në fillimshekullin e njëzetë.

Sipas Ismajlit: “Derisa në pjesën e parë të sh. 20 kemi dy ndërmarrje kolektive me peshë në fushën e planifikimit gjuhësor (Kongresi i Manastirit dhe Komisija Letrare), në pjesën e dytë të këtij shekulli kjo punë u intensifikua: u hartuan Ortografitë 1948-1951, 1956, 1967 e 1973 në Tiranë, ndërsa më 1952, 1957 dhe 1964 në Prishtinë [...]”³

Por për të mbërritur në këtë rrugëtim të normativës drejtshkrimore, sigurisht që fillesat janë në traditën shkrimore të autorëve më të vjetër të shqipes. Tekstet e para të shqipes kanë qenë gjithnjë në qendër të vëmendjes së studiuesve shqiptarë dhe të huaj, pasi përmes këtyre teksteve, studiuesit janë përpjekur të shpjegojnë ndryshimet që kanë ndodhur në gjuhë, duke vënë në pah zhvillimet e brendshme gjuhësore dhe format e ndryshme që kanë ardhur prej kontaktit me gjuhët e tjera.

Tekstet e vjetra janë konsideruar nga studiuesit si materiale shumë të rëndësishme për dokumentimin e mënyrës së shkrimit të fjalëve në gjuhën shqipe, si dhe për ndjekur zhvillimet diakronike të tyre.

Duke iu referuar tekstit të parë të gjuhës shqipe, Çabej thekson: “Është ruajtur në transkribim një normë ortografike, e cila shihet se është zbatuar dhe në tekstin origjinal. Ky riprodhohet kështu me ortografinë e sotme të gjuhës, po pa u prekur fytyra e tij fonetike. Një e tillë normë ortografike, normë njëkohësisht e vjetër, e re, është e mundur të vendoset, sa kohë që ortografia e shqipes dhe me këtë edhe gjuha vetë në këtë hapësirë kohe që nga shekulli i XIV. e gjer sot nuk ka pësuar ndonjë ndryshim qenësor.”⁴

Që në Komisinë Letrare (1917) u përcaktua se “Orthografija e gjuhës do të jetë, për sa të mundet, fonetike; d.m.th. gjuha do të shkruhet ashtu si flitet sot prej popullit.” Parimi fonetik u përcaktua si parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes dhe në Kongresin e Drejtshkrimit në vitin 1972.

³ Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), punuar nga Eqrem Çabej. Tiranë, 1968, f.9.

⁴ Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), punuar nga Eqrem Çabej. Tiranë, 1968, f.63.

Në vështrim diakronik, në lidhje me mënyrën e shkrimit të fjalëve nga autorët e veprave të para të dokumentuara në gjuhën shqipe, do t'u referoheshim vlerësimeve të Selman Rizës.

Riza thekson se “Buzukun e ka preokupuar pa krahasim më fort qëllimi praktik imediat i lexueshmërisë së saktë të çdo fjale nga ana e lexuesve, sesa detyrat shkencore mediate e një pasqyrimi sa më të përpiktë të çdo vlere fonetike nga ana e tij.” Duke e konsideruar Lekë Matrëngën “si pionier i shkrimit të shqipes në variantin jugor”, Riza gjykon se merita madhore e tij “qëndron në prirjen e tij drejt një ortografie sa më fonetike”. Përsa i përket Pjetër Budit, Riza gjykon se: “Është fakt se Budi ka shkëlur rëndë parimin më elementar të çdo ortografie, e pikërisht parimin e shkruarjes veçan të fjalëve të veçanta. Por nëse me këtë shkëlje Budi ka vështirësuar së tepërmi leximin e veprave vetjake, ai kurrësesi e kurrësesa nuk e ka cenuar strukturën gjuhësore të shqiptimit real”.

Drejtshkrimi i zanoreve

Komisia Letrare e Shkodrës vendosi disa rregulla bazë për shkrimin e zanoreve; një numër rregullash ky në dukje shumë më i vogël nga rregullat për shkrimin e zanoreve të përcaktuara në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972. Por edhe pse jo të përcaktuara si rregulla më vete, nga përqsaja e listës së fjalëve të botuara në Radhue fjalësh, “U caktuene këta terma për gjyqje e administrata” si dhe në Skaje gramatike, të Komisisë Letrare, është e dukshme që një pjesë e mirë e normativës drejtshkrimore të shkrimit të zanoreve, përcaktuar në Kongresin e Drejtshkrimit, është e bazuar pikërisht në mënyrën e shkrimit të tyre nga Komisia Letrare.

Por për të kaluar nga Komisia Letrare e Shkodrës e deri në Kongresin e Drejtshkrimit, sikurse e përmendëm, ka pasur dhe disa përpjekje të tjera për normativizimin e normës drejtshkrimore, respektivisht në vitet 1948, 1956 dhe 1964. Më poshtë do të trajtojmë në mënyrë krahasuese rregullat e drejtshkrimit të zanoreve nga Komisia Letrare e deri në Kongresin e Drejtshkrimit, duke i parë dhe në vështrim diakronik krahasues dhe me mënyrën e shkrimit të fjalëve në tekstet e para të shqipes.

Zanorja *e*

Rregulla e parë për drejtshkrimin e zanoreve, e përcaktuar nga Kongresi i vitit 1972, ka të bëjë me shkrimin e zanores *e* të theksuar: “Shkruhen me *e* (dhe jo me *ë*) fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndiqet ose ka qenë ndjekur në të kaluarën nga një bashkëtingëllore hundore (*m, n, nj*). Me *e* shkruhen gjithashtu fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit.”⁵

Nga krahasimi i listës së fjalëve të përzgjedhura si shembuj për mënyrën e shkrimit të zanores *e* të theksuar, me listat e fjalëve të dhëna nga Komisia Letrare shihet qartë që pjesa më e madhe e shembujve të dhënë në Drejtshkrimin e vitit 1973, të theksuara me shkronja të zeza, janë fjalë të përcaktuara që do të shkruhen me *e* nga Komisia Letrare, sigurisht duke mbajtur parasysh këtu luhatjet e tjera në mënyrën e shkrimit të tyre, si p.sh. *gemb-gjemb*. Ndër to përmendim:

*gemb-mbi, mbrenda, rremb-mbi, mend-ndja, gjendë (me, m 'u)*⁶, *rremb-i, shembull, shembë (me), i shtrembë(t) (i, e), trembë (me), thember-mbra, kuvend, kuvendue-mu, mendue me, nder, pendë, pendesë, rend, shend, send, vend, rend, vendim*.

Në ortografitë e gjuhës shqipe të vitit 1948 dhe 1964, mungon një rregull specike për mënyrën e shkrimit të zanores *e* të theksuar, por nga shqyrtimi i shembujve të marrë për rregullat e tjera, vihet re se një pjesë e mirë e fjalëve të mësipërme vijnë të shkruhen me *e*, si p.sh.:

Ortografia, 1948: *femën, gdhend, mbrenda, i mbrendshëm, qengj, thembër, vend, zemër*

Ortografia, 1964: *femër, i mbrendshëm, mbrenda, e premtë, thembra, vendas, zemër, zemëroj*

Kurse në Ortografinë e vitit 1956 ka një formulim të ngjashëm me atë të Drejtshkrimit të vitit 1973 për shkrimin e zanores *e* të theksuar: “Fjalët që shqiptohen ku me e e ku me ë të theksuar përpara një bashkëtingëlloreje hundore, do të shkruhen me *e* dhe jo me *ë*. P.sh. *gjemb, zemër, zemërim, zemërohem, brenda, dhen-dhentë, kuvend, kuvendoj, mend, mendje, mendohem, femër, gdhend, qen, qentë, e premtë, thembër, e enjte* (dhe jo: *gjëmb, zëmër, zëmërohem, brënda, kuvënd, dhëntë* etj.). Me *e* do të shkruhen në të gjitha

⁵ Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë, 1973, f.39.

⁶ *Gjendje* në Drejtshkrimin e vitit 1973.

trajtat dhe fjalët si: *dre, fre, pe, ve, fle* etj. (dhe jo drë-drëri, pë, vë, flë).”

Në një vështrim diakronik, mund të themi që këtë mënyrë shkrimi të këtyre fjalëve e gjejmë që në veprën e parë të shqipes së shkruar.

Këtu duhet vënë në dukje, së pari, sqarimi që Çabej ka dhënë në botimin kritik të Mesharit në lidhje me sistemin grafik të Buzukut: “Sikundër dihet, grafia e tekstit nuk bën dallim midis tingujvet *e* dhe *ë*, duke i dhënë të dy me *e*, transkribimi i fjalëve që përmbajnë këtë germë ngrë një radhë probleme. Në zgjidhjen e këtyre ndihmon nganjëherë vepra e Bogdanit, i cili dihet se është i pari që dallon në shkrim – me gjithë se jo në mënyrë konsekuente –ë-në nga *e*-ja duke e shënuar atë me një *è*.”⁷

Çabej, më pas, specifikon se: “Në pajtim me shqiptimin e gegërishtes janë transkribuar me *e* ato fjalë që përmbajnë sot ose qëmoti grupin *e + n*, si *mende, vend, prendëvera, Tenezonë* (khs. *I patenzonë*), *se, përse, fle*.”⁸

Jo vetëm Buzuku, por dhe Budi e Bardhi “nuk e kanë dalluar grafikisht zanoren e radhës së mesme /*ë*/. Grafema <*e*> tek ata autorë mund të interpretohet fonetiki sipas rastit [*e*] ose [*ë*], në bazë të kriterëve që përcaktojnë botuesit e tyre. Këto kriterë e mënyra interpretimi nuk kanë qenë të njëjta te studiues të ndryshëm, gjë që flet për vështirësinë e interpretimit të saktë të vlerave fonetike të këtyre zanoreve në shqipen e shekujve XVI-XVII.”⁹

Sipas Omarit, “i pari ndër autorët e vjetër të shqipes që dalloi grafikisht zanoren /*ë*/ nga /*e*/-ja duke e paraqitur me digramën <*aë*> ishte arbëreshi Lekë Matrënga, që përfaqëson dialektin e Jugut.” Kurse ndër autorët e Veriut, i pari “që bëri përpjekje për të dalluar në shkrim zanoren /*ë*/ nga /*e*/, nëpërmjet përdorimit të theksit të rëndë mbi grafemën <*e*> [...] ishte Bogdani.”¹⁰

Duke iu referuar teksteve të transkriptuara të autorëve të vjetër, haset e njëjta mënyrë shkrimi me *e* e fjalëve të përfshira në rregullën e parë të Drejtshkrimit të vitit 1973, sikurse shihet në shembujt e paraqitur më poshtë (në renditje kronologjike: Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi, Bogdani):

⁷ Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555), punuar nga Eqrem Çabej. Tiranë, 1968, f.69.

⁸ Ibid. F.70.

⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*, përgatitur nga Anila Omari. Tiranë, 2005, f.38.

¹⁰ Ibid.

BUZUKU: *engjëllinë, mbrenda, mend, mendjet, ndenjun, qendra, qengji, shembëlltyrë, të shembellenjë, shenjtë, shenjtëtë, shenjtëni, i shenjtënuom, tremb, vend*

MATRËNGA: *engjëllit, mentë, shejti, shejt, shemull, të shejtërojsh, vend*

BUDI: *i denjë, engjëlli, mend, mendja, përmbrenda, shemëllëtyrë, shenjt, e shtrembënë, vend*

BARDHI: *brendë, drë, engjëllë, kuvend, mend, mbrendë, përmbrenda, pendë, qen, shenj, (me) u trembunë, i tremshim, vendi*

BOGDANI: *brenda, i denjë, dhen, gemb, qen, qendisin, shembëlltyrë, shembyllyem, shenj, tremb, trembja, thembër, vend, vendas, zemërë, zemëruem*

Zanorja ë

Më poshtë do të trajtojmë rregullat e drejtshkrimit për zanorën *ë* në pozicion të theksuar, paratheksor dhe pastheksor, në një analizë diakronike.

Zanorja *ë* e patheksuar

Komisia Letrare e Shkodrës (1917) përcaktoi se zanorja *ë* mund të shkruhet në mes të fjalëve “aty ku e lypë etymologjija e ku shqyptohet në tosknishte; për shembull: shëndet, rrëfye, këndue etj.”

Kjo rregull mungon në Ortografinë e vitit 1948, por rimerret e riformular dhe më e plotë në Ortografinë e gjuhës shqipe të vitit 1956, ku është përcaktuar se “Ë-ja paratheksore do të ruhet në shkrim në këto raste, ku ndihet në shqiptim: në fjalë të parme si: *arësye, fëmijë, kënaq, këndoj, këpus, kushëri, vëlla* etj., në fjalët e prejardhura prej tyre: *arësej, arësim, arësimtar, i kënaqur, kushërirë, vëllazëroj* etj., dhe në fjalët të tjera të prejardhura si: *gëztoj, gëzim, dënoj, dënim* etj.”¹¹

Të njëjtat rregulla përcaktohen dhe nga Ortografia e gjuhës shqipe 1964 (vetëm e gegnishtes), që sikurse thekson Rexhep Ismajli ishte shumë e afërt me Ortografinë e vitit 1956:

“Ë-ja paratheksore duhet të shkruhet në këto raste: a) në fjalë të parme, si: *këmishë, kënaq, këndoj, këpucë, kësulë* etj.; b) në fjalë të prejardhuna prej tyre, si: *i kënaqun, këndim, këputje* etj. c) në fjalët të cilat me të shpërngulun të theksit e kanë reduktue zanoren e trupit të fjalës në *ë*, si: *gaz-gëzim, gëztoj,*

¹¹ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*. Përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.279.

gëzue; i madh-të mëdhenj, të mëdha; i keq-të këqij, të këqija, këndoj, këndue, dënoj, dënue, dënim etj.”¹²

Kjo rregull është ruajtur dhe nga Kongresi i Drejtshkrimimit i vitit 1972, ku është përfshirë në grupin e rregullave për shkrimin e zanores ë paratheksore “në fjalët e parme e në të gjitha fjalët ku ajo i takon rrokjes së parë, si edhe në fjalët e formuara prej tyre”.

Sikurse u theksua më lart, Buzuku Budi e Bardhi “nuk e kanë dalluar grafikisht zanoren e radhës së mesme /ë/”. I pari ndër autorët e Veriut, “që bëri përpjekje për të dalluar në shkrim zanoren /ë/ nga /e/, nëpërmjet përdorimit të theksit të rëndë mbi grafemën <e> ishte Pjetër Bogdani [...]”, ndërsa i pari ndër të gjithë autorët e vjetër që dalloi këto dy zanore nga ana grafike ishte Lekë Matrënga.

Në botimin kritik të Mesharit, Çabej ka argumentuar se “për vendosjen e ë-së në transkribim më fort se kriteret dialektgjeografike peshojnë disa arsye të rendit historik. Këtu hyjnë së pari ato fjalë, në të cilat zhdukja e mëpastajme e këtij tingulli në më të madhen pjesë të Gegërisë dëshmon për praninë e tij dikur: *fëtyrënë, mënyrë, mishërër, shenjtënuom, Tinëzot, të vëjyemitë, i vogël etj.*; [...] Ndrimi *a: ë* sqaron të tilla transkribime si *bari: bëruo, faj: fëjyem, latin: lëtishtë, lavd: lëvduom, qandërë: qëndronj, lat. Sacrare: e shëkruome.* [...]”

Të njëjtën logjikë ka ndjekur dhe Anila Omari në transkriptimin e veprës *Cuneus Prophetarum*: “Nuk është e vështirë të vendoset për leximin e transkriptimit [ë] në ato pozicione ku në gegërishten e sotme veriore ë-ja e patheksuar ka rënë, p.sh. *Pealumba* [Pëllumba] [...]”¹³

Nga vëzhgimi i teksteve të vjetra të shqipes, mund të thuhet se përdorimi i zanorës ë në rrokjen e parë, si dhe në fjalët e formuara prej tyre është një dukuri mbizotëruese të të pestë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe, sikurse mund të shihet nga shembujt e mëposhtëm.

BUZUKU: (*me*) *dëftuom, dëlirunë, të dëlirë, dënuom, dëshiri, (me) u gëzuom, këlysh, këndej, këndova, kënduosi, këqyr, të këqiat, lëshoj, mëndyrë, pëllas, pëllumbi, pësoj, rëzoi, sëmundë, të sëmunëtë, shëndet, shkëndijë, shtëpi*

¹² Ibid. F.325.

¹³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*, përgatitur nga Anila Omari. Tiranë, 2005, f.40.

MATRËNGA: *dëftona, dëftuarë, së këqiashit, lëfdoi, të mbëdhenj, mbëson, ndlëgon, ndëljësë, shërbes, thërres, vëlla*

BUDI: *të dëlirë, dënoj, të dënuomitë, dëshërojnë, dëshuir, (tue) dëshmuom, gjëmoj, fëmii, kënaqe, të këqivët, kësaaj, këto, të lëvdojmë, lëvdoj, lëshuom, lëshoj, të lëmshënavet, mbëriim, të mëdhaa, mbëriinjë, mbëriini, mëngjes, i mëshërërshimi, ndëgjonetë, ndëgjuom, ngushëllim, ngushëlluom, pëllumbi, (me) pësuom, përraalla, (me) qëndruom, rrëfyem, të rrëzuomitë, rrëzuom, i sëmuunë, shërbëtyrë, (me) shpëtuom, thëresënë, vëllai*

BARDHI: *arësye, bërryl, dëlir, të dëlirë, të dëlirëtë, dëftues, dëshmi, dëshir, (me) dëshëruem, fëmija, fëshitir, (me) gënjyem, gërshanë, (me) u gëzuem, gëzof, këcim, i këmbiyem, këpuca, këlqereja, këlysh, këmbona, (me) e këqyrinë, këshill, këshill, (me) lëbduem, lëkurë, (me) e lëkundënë, lëmshëna, me lëpym, (me) ndëguem, ndëgues, (me) ndërruom, e rëgjuem, (me) pëlqyem, pëllas, pëllamba, pëllumb, përralla, përrue, pësim, (me) pështym, rëfyes, rëxuem, sëmunda, i sëmutë, thëngjill, vëlla*

BOGDANI: *bërryl, dëftoj, i dëlirë, i dënuem, dëshir, i fëlliqunë, fëmij, gërryem, gëzim, kallëzoj, këlqere, këmbiyem, këmill, (me) kënduom, këpucë, (me) këqyrinë, kësulë, kësissh, lëkund, lëkurë, lëmuem, lëngim, lëshoj, mbërrim, mbështjellë, mëndyrë, ndëshkim, pëllhurë, pëlqim, pëllambë, pëllumb, përrallë, pësim, (me) pësuem, përrue, rrëfyej, rrënim, rrëzonj, shpëtoj*

Po ashtu, te të gjithë këta autorë, bie në sy mungesa e zanores *ë* në rrokje të parë te fjalë si: *mpsoj, mkat*:

BUZUKU: *të mpsuomit, mpsoj,*

MATRËNGA: *mkatë, të mbsuame, mbsonjënë, i mbsuam*

BUDI: *mpsuumi, mpkati, mpsone, të msuomitë, msoj*

BARDHI: *me mbsuem, mkat*

BOGDANI: *mpakt, mpsoj*

Kongresi i Drejtshkrimit përcaktoi si një nga rregullat e rëndësishme për zanoren *ë*, shkrimin e saj “*në fjalë të prejardhura, të formuara nga një temë më -ë me anë prapashtesash që nisin me bashkëtingëllore, dhe në fjalë të përbëra e të përngjitura që kanë si pjesë të parë një temë të tillë më -ë, të ndjekur nga një temë që nis me bashkëtingëllore*”.¹⁴ Një pjesë e shembujve të dhënë për këtë rregull në botimin *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* (1973) janë fjalë që gjenden të shkruara në këtë mënyrë që në listat e hartuara nga Komisia Letrare, ndonëse atje nuk është dhënë si rregull specifike për shkrimin

¹⁴ Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë, 1973, f. 42.

e fjalëve të përbëra. Përmendim këtu fjalët: *dorëzanës, dorëzanija, drejtësim, drejtësoj, hollësi*, të cilat vijojnë të shkruhen në të njëjtën mënyrë edhe sot.

Në Ortografinë e gjuhës shqipe të vitit 1948, ka një pikë të veçantë, ku trajtohet shkrimi i zanores ë në “emnat femnorë derivatë”: *“Emnat femnorë derivatë me prapashtesën -i, -trë, -inë (-ri, -si, -sirë, -sinë, -tinë, -tirë) në toskënishtet e ruejnë -ë, -n protonike në trup të fjalës, qoftë kjo mbaresa e fjalës primitive, si te fjalët: mbarësi, mirësi, burrëri, vajzëri, mbretëri, errësirë, ngordhësirë etj. [...]”*¹⁵

Ndërsa në Ortografinë e vitit 1956, formulimi i rregullës së shkrimit të zanores -ë te fjalët e prejardhura dhe të përbëra, është shumë i ngjashëm me atë të Drejtshkrimit të vitit 1973: *“Ë-ja paratheksore do të ruhet në shkrim në këto raste, ku ndihet në shqiptim: në fjalë të prejardhura, emra, mbiemra, folje, fjala e parme e të cilave mbaron me -ë: p.sh. anëtar, anëtarësi (anë); burrëri (burrë; butësi (butë), copëtoj, copëzoj (copë); dobësoj, (i dobë, i dobët); gjithësi, përgjithësoj (gjithë); mbarësi (i mbarë); pjesëtoj, pjesëtim, përpjesëtim (pjesë); punëtor, punëtori-a (punë); shpronësoj, shpronësim (pronë); vjershëtoj (vjershë).”*¹⁶

Në Ortografinë e vitit 1964, ka disa rregulla për shkrimin e zanores ë në fjalët e prejardhura dhe të përbëra, një pjesë prej të cilave janë në vijimësi të rregullave të ortografive të mëparshme. Kështu, ka dy rregulla shumë të ngjashme me rregullën e Ortografisë së vitit 1948 për “emnat femnorë derivatë”:

- a) për ruajtjen e zanores -ë: *“n’emna të prejardhun prej mbiemrave që kanë para ë-së dy bashkëtingëllore; p.sh.: drejtësi, lehtësi, naltësi, rreptësi, shpejtësi, shkathësi etj.”*,
- b) si dhe rregulla: *“Emnat e prejardhun me mbrapashtesën -si duhet ta ruejnë ë-në e temës sa herë që para mbrapashtesës ndodhen dy a ma shumë bashkëtingëllore; p.sh.: randësi (e jo*

¹⁵ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*, përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f. 9.

¹⁶ Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. *“Meshari” i Gjon Buzukut (1555)*, punuar nga Eqrem Çabej. Tiranë, 1968, f.63.

randsi), mundësi, nxehtësi, saktësi, mësheftësi, fatbardhësi, ftoftësi, aftësi, shterpësi etj.”

Po ashtu, në këtë Ortografi është lejuar një normativë e dyfishtë për shkrimin e emrave me prapashtesën -si: “*Emnat e prejardhjen me këtë -si që dalin prej fjalëve që kanë vetëm një bashkëtingëllore para mbrapashtesës mund të shkruhen pa -ë të temës; pra: gjuhsi, mirsi, mbarsi, gjithsi, dobsi, butsi, ngutsi, thellsi [...], por mund të shkruhen dhe me -ë të temës, pra: gjuhësi, mirësi, mbarësi, gjithësi, dobësi, ngutësi, thellësi [...].”*

Duke e parë çështjen e fjalëformimit në vështrim diakronik, do t’i referohemi së pari, trajtimit që i bën Çabeji transkriptimit të kompozitive nominale në veprën *Meshari* të Buzukut. Çabej ka zbatuar dhe për kompozitat normën e ortografisë moderne të gjuhës, duke specifikuar se “kur në një par fjalësh lidhur sintaktikisht në mes tyre me një funksion formativ, lakohet e dyta, kemi të bëjmë me një kompozitë; kur lakohet e para, kemi dy fjalë më vete. Në bazë të këtij kriteri gramatikor janë kompozita në tekstin tonë ndër të tjera *manemjedhëratë* e pas asaj dhe e pashquara *manemjedhëra pl., kac adrenjtë, bākeqi, bākëqitë, kujtuokeqi, mjesëdita, ndë mjesënatët, motëmotit, bregdetit, përbrendësat, Gojëarti, hūrplota, e pāligjeja*, po ashtu si si verbet *u zemërmirne, të zemërkeqī [...].”*¹⁷

Ndër fjalët e formuara me anë të prejardhjes, në veprën e Buzukut, Çabeji përmend si kalk gjuhësor, mes të tjerash, dhe fjalën *rogëtari* “mercenarius” dhe si formim të ri, që është ende në përdorim në gjuhë: *ditë punëtore*.¹⁸ Sikurse shihet, këto fjalë ruajnë zanoren *ë* në fund të temës së parë. Zanorja *ë* ruhet dhe në fjalë të tjera të prejardhura, si: *gojëtareja, pjesëtarë, ndimëtār*.

Sipas Omarit, në veprën e Bogdanit, hasen “*kompozita e fjalë të përngjitura, disa nga të cilat janë të gjuhës popullore e disa të tjera janë formuar prej tij në bazë të modeleve të shqipes. [...] Bogdani përdor për herë të parë në letërsi formimet e përbëra, mjaft të ngjeshura semantikisht [...]* i gjithë-

¹⁷ Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555), punuar nga Eqrem Çabej. Tiranë, 1968, f. 97.

¹⁸ Ibid.

pushtueshim ‘omnipotente’, *i gjithëherëshim* ‘i përjetshëm: it. perpetuo, i vazhdueshëm: it. contunuo’, *hanëplote* ‘plenilunio’, *jetëgiatë* ‘di più longavita’ [...] *parëbijënt* ‘gjendja ose të qenit i parëlindur: it. primogenitura’ [...]”¹⁹

Ndër neologjizmat e veprës së Bogdanit, Omari²⁰ përmend fjalët: *bashkëri*, *shëjtënim*, *bijënt*, si dhe fjalë të krijuara sipas modelit prapashtesor me *-tar*, si: *fqinjëtar*, *gjuhëtar*, *landëtar*, *rrezmëtar*. Omari liston dhe fjalë të tjera të formuara me anë të prapashtesës *-në*: *amënt*, *burrënt*, *padekënt*, *shtâsënt*, *vajzënt*, *zonjënt*. Sikurse shihet nga shembujt e dhënë, zanorja *-ë* ruhet në fund të temës së parë në fjalët e përbëra dhe në fund të temës/ rrënjës në fjalët e prejardhura. Vihet re, po ashtu, se ruhet tradita e shkrimit të disa prej këtyre fjalëve me *ë*, nga autori i parë, Buzuku, e në vijim te autorët e tjerë: *pjesëtarë*, *ndimëtâr*, *rogëtar*, *punëtore* etj.

BUZUKU: *gojëtareja*, *ndimëtâr*, *pjesëtarë*, *punëtore*, *rogëtar*, *ujënatë*,

BUDI: *fajëtorë*, *flokëgjatë*, *gojëplot*, *grykësia*, *ndimëtorëtë*, *piesëtari*, *piesëtarëtë*, *punëtorit*, *rogëtarit*, *trimënia*

BARDHI: *arkëtuer*, *buzëmadh*, *derëtâr*, *fëdigëtar*, *kambësuer*, *kangëtuer*, *luftëtâr*, *ndimëtâr*, *rogëtar*, *punëtuer*, *udhëtâr*, *ushtëtorëvet*, *vërshëtâr*, *vozëtâr*

BOGDANI: *dvekëtar*, *fjalëtâr*, *fqinjëtâr*, *gjuhëtâr*, *jetëgiatë*, *jetëgiatë*, *kankëtar*, *landëtar*, *lavdëri*, *mballëfaqe*, *mirëfilli*, *mishënuem*, *parëbijënt*, *parëbiri*, *i parëlem*, *prapështazë*, *punëtuer*, *punëtore*, *udhëtâr*

Zanorja *ë* fundore

Një nga çështjet e trajtuara më gjerësisht në Drejtshkrimin e vitit 1973, është shkrimi i zanores *ë* fundore. Sipas pikës 8: “*Shkruhet ë-ja fundore te fjalët me theks që në krye të herës në rrokjen e parafundit, duke u ruajtur ajo edhe në trajtat e tyre ku s’është më fundore. Kështu, shkruhen me -ë: emrat femërorë si bukë, fjalë-fjalës, fjalën, fjalët, fjalësh [...].*”²¹

Kjo rregull ka një formulim të ngjashëm me rregullën e përcaktuar nga Komisia, sipas së cilës: “*Të gjithë emnat femërorë, qi nuk mbarojnë me*

¹⁹ Rregulla mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkrueme të vendosuna prej Komisis Letrare. Shkodër, 1917, f. 5.

²⁰ Riza S. *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*. Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 53.

²¹ Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë, 1973, f.51.

zanore e qi janë njirokkësh ase qi kanë theksën mbi rrokjen e mbrame, marrin ndë rasën emnore të paskajueme të veçorit nji ‘ë’ në fund; për shembull: punë, mollë, lopë, derë, luginë, pelhurë, parmendë, ndigjesë, gjarpnushë etj.”²² Në Ortografinë e gjuhës shqipe të vitit 1948, e njëjta rregull rimerret e riformuluar: “Gjithë emnat femnorë paraoksitonë që të pashquem mbarojnë në ë e ruejnë këtë zanore me gjithë rasët e njëjësit e të shumësit; p.sh. fjalë, fjalën, fjalësh, fjalëve. Kështu edhe: bukë, flakë, hundë, kambë a këmbë, lugë, punë etj.”²³

Ndërsa, në Ortografinë e vitit 1956 specifikohet fakti që kjo zanore ë fundore do të shkruhet, pavarësisht mënyrës së shqiptimit të saj: “Emrat femërore me theksin në rrokjen e parafundit, që në trajtën e pashquar mbarojnë më -ë, pavarësisht në se ndihet kjo ë apo jo në të folur, p.sh. bukë, fjalë, flakë, hundë, lugë, punë.”²⁴

Ortografia e vitit 1964 e rimerr si rregull, duke përcaktuar se: “Emnat femnorë paraoksitonë duhet të shkruhen me ë në fund në trajtën e pashqueme; p.sh.: bukë, fjalë, hundë, lopë, punë etj. dhe këtë do ta mbajnë gjatë lakimit.”²⁵

Shkrimin e zanores ë fundore e hasim gjerësisht që në veprat e para të shqipes. Anila Omari në botimin kritik të *Çetës së profetëve* thekson faktin se “Nga shqyrtimi i gjithë tekstit të CP mund të përcaktohet njëfarë rregullsie në përdorimin e kësaj grafeme. Përgjithësisht ajo vendoset në fund të fjalës, pavarësisht nga vlera fonetike /e/ apo /ë/. Në të shumtën e rasteve shenja grafike përkon me vlerën fonetike /ë/, pasi me -ë përfundon një numër shumë i madh fjalësh në gjuhën shqipe, sidomos në shqipen e vjetër, kur -ë-ja fundore ruhej shumë më mirë se sot.”²⁶

BUZUKU: amë, barkë, besë, bombullimë, botë, brinjë, bukë, buzë, cohë, darsmë, ditë, dorë, dritë, erë, farë, fjalë, festë, forcë, fqinjë, gojë, govadë, jetë, kafshë, kambë, klishë, krypë, mortajë, napë, natë, ndimë, pasëqyrë, pikë, punë, pelë, pergullë, pjesë, rasë, shëmbëlltyrë, shumicë, triesë, thikë, unazë, udhë, vashë, vneshtë

²² Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtskrimet e gjuhës shqipe*, përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.229.

²³ Ibid. F.234.

²⁴ Ibid. F.286.

²⁵ Ibid. F.326.

²⁶ Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*, përgatitur nga Anila Omari. Tiranë, 2005, f.39.

MATRËNGA: *besë, botë, dit(ë), ëmë, meshë, pjesë, gjellë, natë, kambë, pjese, pashkë, perëndeshë, vashë*

BUDI: *anë, barkë, besë, cokëllimë, darsmë, dëshiurrë, dërsë, ditë, dorë, dhuunë, gozhdë, grykë, gjaakafshë, gjamë, gjymtyrë, fjalë, gojë, ferrë, fjalë, forcë, frikë, herë, hiurrë, jetë, kafshë, kankë, kishë, kreshmë, kunorë, luftë, natë, natyrë, nevojë, meshë, punë, orë, pikë, plakë, peendesë, pesë, sqimë, shkepëtimë, shpëresë, uratë, zyrë,*

BARDHI: *amë, anë, armë, baltë, banjë, barkë, barrë, bashtinë, besë, bдорë, bukë, buzë, copë, curlë, detyrë, ditë, dardhë, dritë, dhünë, erë, fëllaza, frymë, fletë, fushë, furrë, gogësimë, goshdë, gramatikë, groshë, gurrë, gjellë, gjigjerë, gjurmë, e hanë, herë, hundë, hurdhë, jetë, kafshë, kambë, kangë, kartë, kësulë, kështenjë, kishë, kohë, kollë, kordhë, kupë, lëkurë, logjikë, lugë, meshë, mollë, natë, ndi(h)më, nevojë, pendë, peshë, pjesë, pikë, plagë, sobë, sukë, shegë, shpatë, shtasë, trumbë, tryesë, tufë, udhë, ulërimë, urë, ullishtë, unazë, vetëtimë*

BOGDANI: *anë, apostullë, arë, arkë, armë, ashtë, baltë, barkë, barrë, bashtinë, baticë, besë, bijë, bigë, bjeshkë, bletë, borë, botë, brinjë, britmë, bukë, bumbullimë, buzë, copë, darkë, darsmë, dборë, dekë, derë, detyrë, dërrasë, ditë, dokë, dorë, drekë, dritë, dhunë, ërë, farë, festë, figurë, fqinjë, frymë, furrë, fushë, giobë, giuhë, gojë, gozhdë, gramatikë, gropë, gjellë, gjymtyrë, harresë, javë, kafshë, kambë, kashtë, kishë, kohë, kunatë, kupë, lëkurë, ligjëratë, lopë, luftë, murtajë, natyrë, ndihmë, nevojë, Pashkë, pemë, pëllambë, pikë, punë, piramidë, pishinë, pjesë, pëlhurë, pëllambë, plakë, plagë, pronë, pushkë, rrasë, qafë, Sinagogë, shëplakë, shkallë, shpellë, shpinë, shqerrë, shtambë, shtyllë, tryesë, thikë, udhë, vajzë, valë, vathë, zanë, zonjë, zyrë*

E njëjta rregull, e formuluar ndryshe, është përcaktuar si nga Komisia Letrare dhe nga Kongresi i Drejtshkrimit në lidhje me shkrimin e zanores -ë fundore tek disa emra mashkullorë. Kështu, sipas Komisisë Letrare “*Ketë rregull e ndjekin edhe disa të pakë emra mashkullorë, -të cilët kanë zanorën e rrokjes së përparshme sasije të mesme: për shembull: burrë, grunë, djalë, djathë, gjalpë, në vend qi: kal, mall, tall, etj.*”²⁷ Sipas Drejtshkrimit të vitit 1973: “[...] shkruhen me -ë: disa emra mashkullorë dhe shumica e emrave mashkullorë që përdoren edhe si asnjans: atë, burrë, djalë, gjalmë, gjumë, kalë, lëmë, lumë; ballë (balli, ballët), brumë (brumi, brumët), djathë (djathi, djathët), drithë, drithëra, dyllë, dhallë, dhjamë, gjalpë, mjaltë, ujë, ujëra etj.”²⁸

Të njëjtën rregull e ruajnë dhe Ortografitë e vitit 1948, 1956 dhe 1964:

²⁷ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*, përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.229.

²⁸ Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë, 1973, f.51.

Ortografia, 1948: “Ata emna mashkullorë që mbarojnë më *ë* n’emnore e pashqueme të njëjësit në toskënishtet, do të shkruhen me këtë trajtë edhe në gegënishtet; emna të tillë janë këta: *burrë, kalë gjymë*. Këtu hyjnë dhe ata emna mashkullorë që në trajtën e shqueme marrin -a si Gegë, Toskë, babë, lalë, bacë. [...] Në këtë kategori hyjnë edhe emnat asnjans: *ujë, mjaltë, dyllë, drithë, ballë, gjalpë, djathë*, që do të shkruhen po me këtë trajtë në të dy dialektet, edhe atëherë kur përdoren në gjini mashkullore; p.sh. *ujë-ujë, drithë-drithi* etj.”²⁹

Ortografia, 1956: “Do të shkruhen me *ë* në fund, në emëroren e kallëzoren e trajtës së pashquar:

a) emrat që në përgjithësi tregojnë lëndë, si atëherë kur përdoren në gjininë asnjansë: *ujë-ujët*, ose *ujë-ujë, djathët* ose *djathi*; po kështu: *brumë, drithë, dyllë, grurë, gjalpë, mjaltë*; b) emrat mashkullorë që në trajtën e shquar marrin njëjën *a* dhe shkojnë pas lakimit të emraves femërorë, p.sh. *babë, bacë, gegë, Kolë, Kostë, lalë, Lekë, Llukë, toskë* etj. c) disa emra mashkullorë, si: *burrë, ballë, djalë, gjymë, kalë, lëmë*.”³⁰

Ortografia, 1956: “[...] duhet të shkruhen me *ë* në fund edhe emrat mashkullorë që në trajtën e shqueme marrin njëjën *a* dhe lakohen si emnat femnorë; p.sh.: *babë, Gegë, Toskë, Kolë, Llukë, Nikollë* etj. [...] Me *ë* në fund shkruhen edhe emnat e gjinisë asnjansë, qofshin në trajtën e gjinisë asnjansë qofshin n’ate të mashkullores; p.sh.: *ujë-ujët, djathë-djathët, djathë-djathi; mjaltë-mjaltët, mjaltë-mjalti; brumët-brumë; brumë-brumi; drithë-drithët, drithë-drithi; dyllë-dyllët, dyllë-dylli; gjalpë-gjalpi* etj. [...] Të shkruhen me *ë* në fund emnat mashkullorë që shqiptohen me *ë* në toskënisht e me zanore të gjatë në gegnishtet: p.sh. *burrë, djalë, gjumë, kalë, vjamë* etj. Por *lum*”.³¹

Të njëjtën mënyrë shkrimi gjejmë dhe në tekstet e para të shqipes.

BUZUKU: *ujë, mjaltë, djalë, burë, drithë*

MATRËNGA: *atë*

BUDI: *burrë, papë, mjaltë, djalë*

BARDHI: *ballë, ujë, kalë diathë, atë, gjumë, burrë, mialtë, ungjë, dyllë*

BOGDANI: *atë, ballë, brumë, burrë, djalë, drithë, dyllë, gjumë, mjaltë*

Në Drejtshkrimin e vitit 1973, është përcaktuar si një rregull më vetë shkrimi i zanores *ë*-fundore tek mbiemrat dhe ndajfoljet “me theks që në krye të herës në rrokjen e parafundit, duke u ruajtur ajo edhe në trajtat e tyre ku s’është më fundore.”; një rregull ky i ngjashëm me rregullën e Komissisë

²⁹ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*, përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.234.

³⁰ Ibid. F.288.

³¹ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*, përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.326.

Letrare, sipas së cilës: “*Të gjithë adjektivat e pjesësit (participat) qi kanë një formë për të dy gjinit e qi mbarojnë me një a ma tepër bashkzanore e me rrokje të theksueme e të mesme marrin një “ë” në fund; kështu: i butë e butë; i mirë e mirë; i gjatë e gjatë; i shpejtë e shpejtë; i vobekë e vobekë; i shpërvjeltë e shpërvjeltë; i shëndoshtë e shëndoshtë.*” Madje dhe shembujt kryesorë që janë dhënë nga Komisia Letrare dhe Drejtshkrimi (1973) janë të njëjtët: *i butë, butë; i mirë, mirë; i gjatë, gjatë, i lehtë.*”

Duhet theksuar fakti se ka një dallim në lidhje me mënyrën e shkrimit të ndajfoljes *shpejt*, e cila është përcaktuar të shkruhet pa *-ë* fundore sipas Drejtshkrimit të vitit 1973. Po ashtu, vihet re se ndarja në mënyrën e shkrimit të disa mbiemrave sipas gjinisë. Rregulla e Komisisë: *disa të pakë adjektiva, sidomos prej atyne qi rrjedhin nga verbat e qi mbarojnë me rrokje të theksueme e të gjatë, marrin ë-n vetëm ndë gjinin femnore për shembull: i fort e fortë; i lir e lirë; i that e thatë; e ndonii tjetër*”, është njëtrajtësuar në Drejtshkrimin e vitit 1973, duke përdorur formën me *-ë* fundore për të dyja gjinitë: *i, e fortë, i, e lirë i, e thatë.*

Në Drejtshkrimin e vitit 1948 sqarohet se: “Mbiemrat që dalin nga emna oksitonë dhe tregojnë landë marrin mbaresën *-të*, p.sh., *ar-i artë, dhi-i dhirtë a i dhintë, lesh-i lehtë, pambuk-i pambuktë* etj. [...]”. Kurse, për ndajfoljet është dhënë vetëm mënyra e shkrimit të tyre, pa u dhënë specifikime përkatëse. Ndër ndajfoljet që shkruhen me *ë* fundore përmendim: *përinjeherë, menjjherë, kurdoherë, shpeshherë, rrallëherë, sakaqëherë, prëmë, mbramë, rrallë, shumë, dalëngadalë*. Sipas rregullave të Ortografisë së vitit 1956, zanorja *-ë* fundore shkruhet te numërorët rreshtorë (i dytë, i tretë, i pestë, i dhjetë etj.), te disa mbiemra që vijnë nga foljet: *i ftohtë, i ngrohtë, i nxehtë, i metë, i zbetë, i mbitë, i ndytë*. Përsa i përket shkrimit të ndajfoljeve, është përcaktuar se “Ndajfoljet e mënyrës që u përgjigjen mbiemrave më *-të* e disa mbiemrave të tjerë, shumica shkruhen me *ë* në fund e vetëm disa pa *ë*: Kështu: (i butë) *butë*, (i gjatë) *gjatë*, (i gjerë) *gjerë*, (i fshehtë) *fshehtë*, (i lehtë) *lehtë*, (i mirë) *mirë*, (i ngushtë) *ngushtë*, (i qartë) *qartë*, (i trashë) *trashë*, (i mbarë) *mbarë*, (i prapë) *prapë*, (i rrallë) *rrallë*, (i urtë) *urtë*. Por shkruhen pa *ë*: *drejt* (i drejtë), *shpejt* (i shpejtë), *thjesht* (i thjeshtë), *ligisht* (i ligishtë), *fort* (i fortë), *kot* (i kotë), *plot* (i plotë), *lart* (i lartë), *mjaft* (i mjaftë), *vërtet* (i vërtetë). Po ashtu *shkurt* (nga e shkurtër).

Kjo rregull është rimarrë plotësisht dhe në Ortografinë e vitit 1964, me ndryshimin e vetëm që është dhënë varianti geg i mbiemrit dhe i ndajfoljes i *gjerë* (*gjerë*), përkatësisht i *gjanë* dhe *gjanë*.

Në Ortografinë e vitit 1964 janë dhënë disa rregulla që përcaktojnë shkrimin e zanores *ë* në fund të mbiemrave: a) “Ata mbiemra që përftohen nga emna njirrokësh, si edhe prej emnash shumrrokësh të theksuem në rrokjen e fundit, që në të shumtën tregojnë landë, marrin mbrapashtesën -të, bë fjala: *ar-i, i artë; gur-i, i gurtë, dhi-a, i dhintë; dyllë-i, i dylltë; elb-i, i elbtë; li-ni, i lintë; grunë-i; i gruntë* (i gryjtë a i grytë); *lesh-i, i leshtë, presh-i; i preshtë, pambuk-i, i pambuktë, argjend-i, i argjentë etj.*” b) “Numrorët sosin me -të p.sh.: *dy-i dytë, tre-i tretë, pesë-i pestë.*” c) “Ata mbiemra që dalin nga folja me temë më *a, e, i, o, y*, do të shkruhen me të, p.sh.: *tha(j)-i thatë, me(j)-i metë, zbe(j)-i zbetë, mpi(j) i mpitë; ndy(j)-i ndytë [...]*”.

Në këtë Ortografia bie në sy rregulla për shkrimin e ndajfoljes *shumë* pa *ë* fundore, pra *shum*, dhe shkrimi me *ë* fundore i ndajfoljeve si: *përherë, përnjiherë, nganjihërë, kurdoherë, sakaqherë, atëherë, atëbotë, gjithmonë, gjithherë, shpeshherë, rrallëherë*.

Anila Omari në *Leksikun e veprës së Pjetër Bogdanit*³², thekson se: “Në shqipen e vjetër, të shekujve XVI-XVII, në kushtet e një përdorimi të mangët e jokohorent të nyjës, shfaqen rrethana sintaksore ku nga një anë kemi përkimin në formë morfologjiksht të ndajfoljes me mbiemrin dhe nga ana tjetër të pjesores me mbiemrin”.

Pa dashur t’i hyjmë analizës së kategorizimit të fjalëve të mëposhtme, pasi sikurse thotë Omari: “për vlerësimin kategorial të të cilave gramatikanët e shqipes nuk janë në një mendje”, po japim vetëm mënyrën e shkrimit të tyre me -ë *fundore*, sikurse dokumentohet në veprat që kemi marrë në shqyrtim.

BUZUKU: *bashkë, gjallë, jashtë, mirë, përherë, poshtë, shumë, urtë; të bardhë, i begatë, i butë, e denjë, i dërejtë, së glatë, të gjallë, e ligë, e mjerë, i mirë, i shenjtë, e thatë, i thellë, e verdhë, i urtë*

MATRËNGA: *bashkë, më parë, shpejto, shumë; të butë, e mirë, të shpejtë, e urtë, i vërtetë*

BUDI: *bashkë, jashtë, mbarë e mrapë, mbarë e hollë, mbraamë, mirë, ndeevonë, shumë; së Bardhë, i begatë, të denjë, e gjallë, i, e gjatë, të lirë, i mirë, të plotë, i urtë, të zotë*

³² Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*. Përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.279.

BARDHI: *gjymsë, vonë; e bardhë, i begatë, i butë, i denjë, i fortë, i gjallë, i hollë, i naltë, i njomë, i randë, të rashë, i shëndoshë, i verdhë*

BOGDANI: *bashkë, butë, jashtë, mbarë, mirë, parë, përditë, përgjymcë, sëmutë; i çelë, i dalë, i gjallë, i nuanë, i nxehtë, i plotë, i tretë, i urtë*

Është për t'u theksuar fakti që te Bardhi dhe Bogdani shihet mënyra e shkrimit të ndajfoljeve *shpejt* dhe *fort* pa ë fundore dhe të mbiemrave përkatës me ë:

BARDHI: *çpejt, fort, plot; i çpejtë, i forte;*

BOGDANI: *çpejt, fort, plot; i çpejtë, i fortë, i plotë*

Në mënyrë specifike në rregullat e Drejtshkrimit të vitit 1973 janë përcaktuar rastet e shkrimit të zanores -ë fundore në format e ndryshme foljore. Këtu duhet theksuar se rregulla e shkrimit të foljeve me temë në zanore në vetën e parë dhe në vetën e tretë të shumësit të së tashmes dëftore është e ngjashme me rregullën e përcaktuar nga Komisia Letrare “*fjalë qi mbarojnë me rrokje të mesme të theksueme e me një a ma tepër bashkzanore marrin një ‘ë’ në fund; për shembull: shkojmë, bajmë*”. Të njëjtën rregull e gjejmë dhe në Ortografitë e vitit 1956 dhe 1964:

Ortografia, 1956: Foljet e kësaj kategorie në vetën e parë e të tretë të shumësit shkruhen me ë në fund: *shkruajmë* (gegër. *shkruejmë*), *shkruajnë* (gegër. *shkruejnë*), *lyejmë, lyejnë; ziejmë, ziejnë; kthejmë, kthejnë*.³³

Ortografia, 1964: Foljet e kësaj kategorie, si edhe deri tash, në vetën e parë dhe të tretë të shumës shkruhen me ë në fund: *shkruejmë, shkruejnë, blejmë, blejnë, ziejmë, ziejnë* etj.³⁴

Ethem Lika në studimin e tij për *Zhvillimin e eptimit në gjuhën shqipe*, e shpjegon formimin e vetës së parë të shumësit përmes formës së vetës së parë të njëjësit, përmes shtimit të mbaresës -**më** (<*-mes/ *-mus); pra, *banj+më* > **banjmë**. Sipas tij, te “Buzuku ndërmjet formës -temë *banj-* dhe mbaresës -më është shfaqur edhe një zanore mbështetëse -ë- (*banj-ë-më*). Sot kjo formë ka evoluar në *bajmë/bëjmë* (<*banjëmbë/bënjëmbë*).” Mbaresa -më ruhet në vetëm e parë të shumësit ruhet te të gjithë autorët e vjetër të shqipes.

BUZUKU: *besojmë, bajmë, pushojmë*

MATRËNGA: *mbsonjëne, huanjëne, psonjëne, të trashëgonjëne, vinjëne*

³³ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*. Përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.301

³⁴ Ibid. F.350.

BARDHI: *dëftonjënë, këndonjënë, mbsonjënë ndëglonjënë, shërbenjënë*

BUDI: *të bajmë, çmojnë, dëshërojnë, të (mos) dëshmojmë, festojmë, t'i kundrështojmë, kungojmë, të lëvdojmë, liurojmë, lundrojnë, majshtrajmë, mbesojnë, meritojmë, ndëjejmë, nkthejmë, punojnë, qëndrojmë, shaajnë, urojmë, vejnë*

BOGDANI: *bajnë, banjmë, besojmë, besojnë, besonjinë, çtojnë, çojnë, forcojnë, gëzojnë, gjëllinë, hinjëmë, hinjinë, këndojnë, këndojmë, linjë*

Sipas një rregulle të Drejtshkrimit të vitit (1973) “shkruhet me -ë trajta e vetës së tretë njëjës e mënyrës lidhore të gjitha foljet, duke përfshirë edhe ato me tog zanor, ku -ë-ja shkruhet për arsye morfologjike”. Në rregullat e Komisionit Letrare mungon një rregull për shkrimin e foljeve të mënyrës lidhore, në vetën e tretë, ndërsa në Ortografinë e vitit 1948 ka dy rregulla drejtshkrimore për shkrimin e lidhore, sipas të cilave: a) “Veta e tretë e njëjësit të lidhore të foljevet më -aj, -ej, oj, -ij, -yj, do të shkruhen më -ë në fund në të dy dialektet: ai të lajë, të blejë, të punojë, të fshijë, të fryjë, kurse atyne që mbarojnë me -uaj a -ej, -yej, do të shkruhet pa -ë: ai të shkruaj, të ziej, të lyej.”; b) “Veta e tretë e njëjësit të lidhore së foljevet që mbarojnë me bashkëtingëllore do të shkruhet me -ë ose -ij në toskënishtet: të lidhë a të lidhij, të hapë a të hapij, të flasij etj.”³⁵

Në Ortografinë e vitit 1956, është përcaktuar se do të shkruhet me ë në fund “veta e tretë e njëjësit të lidhore të foljet në -aj, -ej, -ëj, -oj, -yj, -ij: të lajë, të punojë, të blejë, të bëjë, të fryjë.” E njëjta rregull është rimarrë në Drejtshkrimin e vitit 1964.

Në parathënien e botimit kritik të *Mesharit*, Çabej ka shpjeguar se “Po ashtu me -e janë dhënë pastaj format e lidhore së tanishme të vetës së tretë njëjës të dije, të nderje, të pije, të gjalla edhe sot në gegërishten lindore, e që me të droe, të hae, të pie, të die, të doe, të rie etj., forma më të shpeshta e pa -j- kundra hiatit, dëshmojnë për praninë e -e-së e jo të -ë-së; kanë një përdorim më të hapët, sepse përveçse te Budi e te Bogdani (të rrie, t i die DC 176b, të rie, të pie, të hae, të ja mbae I 73 25; 58, 11; 64, 10; 86, 2) çfaqen dhe në shqipen e Siqelisë, te Kamarda (II) do të rie ‘vuol stare’. Lidhoret e sotme më -jë ende nuk dalin te ky tekst, po na paraqiten aty me trajtën e vjetër më -një, ta ngjanjë, të lëftonjë, ashtu edhe të blerë etj.”³⁶

³⁵ Ibid. F.247.

³⁶ Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), punuar nga Eqrem Çabej. Tiranë, 1968, f.69.

Sikurse shihet nga shembujt e mëposhtëm, shkrimi i zanores -ë fundore në vetën e tretë të lidhores haset që te autorët e vjetër.

BUZUKU: *të banjë, të bjerë, të dalë, të flasë, të lëshonjë, të thoetë, të mbaronjë, të sjellë*

MATRËNGA: *të vdesë, t' e shohë, t' e trashëgonjë, të vinjë*

BUDI: *të nxërrë, të largonjë, të n-apë, të paguonjë, të jeetë*

BOGDANI: *të banjë, të gjanjë, të huanjë, të marrë, të vejë, të zanë*

Grupi *ie*

Në rregullën 6 të Komisionit Letrarë është përcaktuar që “dizanoret *ie, ue, ye* të cilat në dialekt t’Elbasanit janë përmbledhun në zanoret e gjata *í, ú, ý, (qill, dill, shtill; thú, ftú, punú, mú; krŷ, lý. rrefŷ* etj.) do të shkruhen të plota ashtu si janë në dialekt tosknisht e në disa nendjalekte gegnishte (*qiell, diell, miell, shtuell; thue, ftue, shkue, punue, mue; krye, lye, rrëfye* etj)”.

Vetëm shkrimi i grupit zanor *-ie* është ruajtur saktësisht kështu dhe në rregullën 13 të Drejtshkrimit të vitit 1973, ku është përcaktuar se do të shkruhen me *-ie*: “emrat, tek të cilët ky grup zanoresh ndiqet nga një bashkëtingëllore e lëngët (l, ll, r) dhe të gjitha fjalët e formuara prej tyre: *e diel, diell, miell, qiell, fier* etj.; *diellor, piermiell, miellzim, qiellor, fierishtie* etj.”

Në Ortografinë e vitit 1948 është dhënë kjo rregull: “Foljeve me *-iej* mund t’u bjerë theksa me *i-n* ose me *e-n* e pra mund të shkruhen, si mbas shqiptimit: *ziej a zjeje, ndiej a ndjeje*, etj.”

Në Ortografinë e vitit 1956 dhe të vitit 1964 është dhënë e njëjta rregull për mënyrën e shkrimit të grupeve zanore *ie, ye*:

Ortografia, 1956: Grupet zanore *ie, ye*, do të shkruhen të plota jo në formën e ndryshuar që kanë në disa të folme. P.sh. *diell-i, miell-i, lyej, thyej, fyell-i, kërcyell-i* (as mjell, lyj etj.) [...] Nga foljet me *ie*, ato që kanë një bashkëtingëllore të lëngët *l, ll* ose *r, rr* pas këtij grupi zanor, do të shkruhen me *je*, kurse foljet e tjera me *ie* ose *je*. Pra: *vjel, mjel, mbjell, pjell, nxjerr* [...] dhe *ziej a zjeje, përziej a përzjeje*.³⁷

Ortografia, 1964: Emnat me togun zanor *ie* në trup do të shkruhen gjithnji me kët tog, p.sh. *diell-i, miell-i, qiell-i* etj. Foljet me grupin zanore *ie* që mbarojnë me bashkëtingëllore ne temë

³⁷ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*. Përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.278.

do të shkruhen me *je*; p.sh.: *djeg, çjerr, hjedh, mbështjell, mbjell, mjel* [...], kurse në raste të tjera me *-ie* p.sh.: *ziej, përziej, ndiej* [...]³⁸

Sipas Eqrem Çabejt: “Gjuha e tij na paraqitet me disa tipare, që njëkohësisht duke qenë të një shkalle të mëparme të gegërishtes, e afrojnë me ligjërimet e toskërishtes e shpeshherë me ato të kolonive të Greqisë e t’Italisë me Lekë Matrangën në krye. Hyjnë aty ndër të tjera si dukuri konservacioni në sistemin fonetik nga vokalizmi ndërdrimet (alternancat) e gjatësisë, *ë*-ja e pathekse në pozicione të ndryshme, diftongje e grupet vokalike *je ie ye ui ae oe* dhe *n*-ja silabike nistore (inicialet) nga *en-*; në konsonantizëm palatalet okluzive e nazale *q, gj e nj* në vend të më të pastajmevet *ç xh* (ose *ć ğ*) e *j, h*-ja fundore në vend të *-f-së* (njoh), grupet *mb nd ngj* të paasimiluara, po ashtu dhe grupet: *kl, gl e shq* e ndonjë tjetër.”³⁹ Sikurse shihet nga shembujt e mëposhtëm, grupi *ie* ruhet i plotë te të gjithë autorët e vjetër, në veprat e marra në shqyrtim.

BUZUKU: *qiellet, dielli, të dieltë, miell*

MATRËNGA: *e përzierë, qielë, qiell,*

BUDI: *bie, të dielë, diellit, të përziemtë, qiellë, shtie, shpie, përziem,*

BARDHI: *diell, e diel, miell, të përziem, të përziemtë, (me) përziem, me ziem*

BOGDANI: *diell, qiell, miell, ndiejmë, përziej, i përziem*

Grupet *mb, nd*

Shkrimi i plotë i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng, ngj* (përkatësisht rregulla 30 e Drejtshkrimit të vitit 1973) është përcaktuar si i tillë që nga Komisia Letrare. Në rregullën 5 të parimeve dhe rregullave për ortografinë e gjuhës shqipe, përcaktohet shprehimisht: “Tufat e bashkzanorevet *mb, nd e ngj*, të zbrujtuna në djalekt t’Elbasanit, do të shkruhen e të shqyptohen ndër formën e vjetër të ruejtun ma mirë në dialektin tosknisht e në disa nendjalekte gegnishte; për shembull *nder, ndrikull, rend, mbret, mbathë, mbushë, kâmbë, ungjill, engjëll* etj.” Në mënyrë të veçantë tërheq vëmendjen shkrimi i fjalës *engjëll* me e nistore, formë me të cilën është futur në gjuhën standarde.

³⁸ Ibid. F.323.

³⁹ Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), punuar nga Eqrem Çabej. Tiranë, 1968, f.69.

E njëjta rregull është rimarrë në Ortografitë e vitit 1956 dhe 1964:

Ortografia, 1956: “Grupet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng, ngj*, që në disa krahina janë asimiluar në *m, n, nj*, do të ruhen të plota në shkrim. P.sh. *mbaj, mbaroj, ndër, këndoj, ngarkoj, ngërthej, ngjalë, ngjall, ngjan* (dhe jo: maj, nër, knoj, a kënooj, narkoj, njall etj.)”⁴⁰

Ortografia, 1964: “Grupet bashkëtingëllore **mb, nd, ng, ngj** do të ruhen të plota në shkrim, p.sh.: *mbaj, mbret, mbën, mbasi, mbyll, ndaj, ndër, këndoj, këndeje, andej, ngarkoj, ngërthej, ngjall, ngjalë, ngjan* etj. (e jo maj, mret, min, a bin, masi, myll; naj, nër, knoj a kënoj, kënej, anej, narkoj, nërthej, njall, njalë, njan etj.).”⁴¹

Në botimin kritik të Mesharit Çabej thekson se: “Grupet *mb nd ng ngj* teksti i ka zakonisht kështu të plota, po ka vise ku gjejmë një okluziv të thjeshtë, shumë herë krah për krah me grafitë normale: *baroime, scabneh, [...]; medure* “mënyrë”, *mude, deign, hi [...]*.”⁴² Çabej mendon se shfaqja e dendur e këtyre mënyrave të shkrimit, nuk mund të jetë gabime shtypi, por “Kemi të bëjmë ose me një mënyrë grafike të kohës, ose me një hollësi shqiptimi më vete, ose me një kombinim të së dy mundësive. Rrethana që nëpër shkrime joshqip të kohës nuk mungojnë të tilla grafi, do të fliste në të mirë të mendimit të parë.”⁴³

Omari, po ashtu, pohon se “Grupet e formuara me to me mbylltore /mb/, /nd/, /ngj/ ruhen mirë edhe te Bogdani: *shkambi II 13 7, sot në geg. Veriore shkam, -i ‘stol’; gamba II 87 11, sot gem-i ‘degë’; mbë, përmbi, mbarre, sot në geg.ver. marre; mboh nuk ‘i bije Të Primitë, f.XV, sipas Majerit nga skr. Bah [...]*”⁴⁴

Sikurse shihet nga shembujt e mëposhtëm, të njëjta grupe fjalësh janë të shkruara me grupin *mb, nd* nga të pestë autorët e vjetër të shqipes:

BUZUKU: *e amblë, kamba, katund, këndova, mbahetë, u mbajta, mbrenda, mend, mendjet, ndenjun, ndima, ndimuom, ndimëtār të mbaronjë, mbiell, ndenjun, përmbra, pëllumbi, përmbi, randuom, sëmundë, shembëlltyrë, shembellenjë, shkamb, shkëndijë, tande, tremb, vend*

⁴⁰ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtskrimet e gjuhës shqipe*. Përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005, f.278.

⁴¹ Ibid.

⁴² Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë e i Gjuhësisë. “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), punuar nga Eqrem Çabej. Tiranë, 1968, f.83.

⁴³ Ibid.

⁴⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*, përgatitur nga Anila Omari. Tiranë, 2005, f.68.

MATRËNGA: *dhëmbura, glëmbash, mbahetë, mbsonjë, mbet, mbë, mbësua, të mbëshuarë, mëndë, ndert, nderturë, ndihnjë, të pa ndlëguashëmitë, perëndeshë*

BUDI: *end, kambëtë, krymbi, mbahetë, të mbetunë, i mbërthyenë, mend, mbarë, mbëriim, mbraamë, mend, mendja, mbërthyem, mbuloj, mbush, ndëgjuom, ndoonjë, njëqind, pëllumbi, përbmë, të përmendunë, permbrenda, me qëndruom, e shtrembënë*

BARDHI: *brendë, dhambë, dhemb, hundë, kambë, kambësuer, katund, katundas, këmbona, i këmbuem, këndonjë, krymb, kuvend, me e lëkundënë, mbasandaj, mbasi, (me) mbërshelë, (me) mbliuem, (me) mbuluem, me mbushunë, mbrapa, (me) mbytunë, mend, mbë, mbrendë, ndershimit, ndë, ndimë, me ndërruem, ndimëtar, ndonja, ndriçim, me ndritunë, përmbrenda, me u trembunë, pendë, pëllamba, pëllumb, përmbrenda, sëmunda, me u trembunë, trumbë, thembra, vendi*

BOGDANI: *brenda, bumbullimë, gemb, hambar, katund, këmbuem, kënduem, krymb, mbahetë, mbajtunë, me mbështjellë, mbramje, mbrapa, mbrenda, me mbushunë, me mbyllunë, mëndyrë ndërment, ndërkaq, ndërëqunë, ndërtuem, ndërshkim, ndodhi, ndonjë, ndoshta, ndriçoj, ndrydhunë, i ndryshkunë, pëllambë, pëllumb, plumb, qendis, shembëlltë, shembëlltë, shembyllyem, shtambë tremb, thembër, vend, vendas*

Përfundime

Në këtë punim, u trajtuan disa nga rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në vështrim krahasues me mënyrën e shkrimit të fjalëve, si dokumentohen në tekstet e para të shqipes, si dhe në përjasje me normativat e tjera drejtshkrimore në shekullin XX. Sikurse shihet nga shembujt e paraqitur, në thelb, disa nga parimet dhe rregullat kryesore të miratuara në Kongresin e Drejtshkrimit janë në fakt një rimarrje e rregullave të miratuara nga Komisia Letrare e Shkodrës. Prandaj Komisia Letrare është një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e standardizimit të gjuhës shqipe. Por nga ana tjetër, mund të flasim dhe për një traditë shkrimi të fjalëve, e cila mund të jetë e ndryshme sot në dialektet e shqipes, por që ruhet në standard, në shkrimin:

e zanores *e* të theksuar: *mend, vend* etj.

e zanores *ë* të patheksuar, kur ndodhet në rrokje të parë: *dëllirë, bërryl, dëshirë* etj.

e zanores *ë* në fjalë të prejardhura, të formuara nga një temë më -ë me anë prapashtesash që nisin me bashkëtingëllore, dhe në fjalë të përbëra

e të përngjitura që kanë si pjesë të parë një temë të tillë më -ë, të ndjekur nga një temë që nis me bashkëtingëllore: *pjesëtar, punëtor (punëtuer)* etj.

e zanorës *ë* fundore: a) në emrat e gjinisë femërore: ditë; pjesë etj. b) në emrat e gjinisë mashkullore: bur(r)ë, mjaltë etj. c) te mbiemrat dhe ndajfoljet: i mirë, bashkë, etj. në foljet e vetës së tretë njëjës të mënyrës lidhore: të banjë etj.

e grupit *ie*: *diell, qiell(ë)*

e grupeve *mb, nd*: *kambë, mend* etj.

Në punime në vijim do të trajtohen dhe çështje të tjera të normativës drejtshkrimore të sotme, në lidhje me shkrimin e bashkëtingëlloreve dhe të emrave vetjakë, pasi, ashtu sikurse e thekson Martin Camaj në letërkëmbimin e tij me Arshi Pipën, kur diskuton për çështjen e gjuhës së njësuar dhe mundësinë e ndryshimeve: “*se na duhet të kthejmë pakëz mbrapa, te autorët e vjetër të cilët janë fort ma afër tosknishtes apo gjuhë sbazë (allgemeinalbanisch) [...]*”⁴⁵

Bibliografia

- Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. *Drejtshkrimet e gjuhës shqipe*. Përgatitur nga Rexhep Ismajli. Prishtinë, 2005.
- Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë, 1973.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*, përgatitur nga Anila Omari. Tiranë, 2005.
- Demiraj, B. *Dictionarium Latino-Epiroticum* (Romae 1635), Bot. Françeskane, Shkodër 2008.
- Letërkëmbimi Camaj-Pipa: 1959-1992*, përgatitur nga Irena Buzi. Botimet Princ, Tiranë, 2022.
- Ismajli R. *Tekste të vjetra*. Dukagjini, 2000.
- Mandala M. *Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra. Mbi botimin kritik të varianteve dorëshkrim e të shtypur të veprës “E mbsuame e krështerë” (1592)*, Ombra GVG, Tiranw, 2013.
- Omari A. *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit. Qendra e Studimeve Albanologjike*. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 2016.

⁴⁵ *Letërkëmbimi Camaj-Pipa: 1959-1992*, përgatitur nga Irena Buzi. Botimet Princ, Tiranë, 2022, f.307.

Rregulla mbi ortografin e gjuhës shqipe të shkrueme të vendosuna prej Komisis Letrare. Shkodër, 1917.

Riza S. *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe.* Botimet Toena, Tiranë, 2002.

Svane G. (ed.), *Peter Budi, Dottrina Christiana* (1618). With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institute for Lingvistik, Aarhus Universitet. Aarhus, 1985;

Prof. as. dr. Teuta TOSKA

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

PËRKTHIMET NË SHQIP TË TEKSTEVE FETARE (BIBLA DHE KURANI) DHE ÇËSHTJET E PARIMIT SIMBOLIK TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES

Liria e besimit dhe e shprehjes së besimit fetar, ashtu si edhe kalimi nga sistemi monopartiak në pluralizëm pas viteve '90, solli ndryshime të pritshme madhore në jetën shoqërore dhe shpirtërore të shqiptarëve. Përkthimi dhe botimi i letërsisë fetare pas viteve '90 e deri më sot është në fazën e vet më prodhimitare, jo vetëm për shkak të zhvillimit global kulturor dhe teknologjik. Vetëm pas viteve '90 Bibla e Kurani u përkthyen dhe u botuan në shqip në mënyrë të plotë. Duke shtuar këtu edhe një shumëllojshmëri letërsie fetare, si komentare, predikime, përkthime tekstesh teologjike, jetëshkrime, studime për çështje fetare, fjalorë termash, e cila gëlon gjithnjë e më shumë vit pas viti, mund të themi se shqipja në regjistrin fetar është hapësira me po aq intensitet përdorimi, sa edhe në sektorë të tjerë të rëndësishëm të komunikimit publik. Sot kemi në shqip 4 versione përkthimi integral të Biblës (është në proces i pesti) dhe 4 versione të përkthimit të Kuranit. Cila është problematika kryesore me të cilën përballen përkthyesit e shkrimeve të shenjta? A ka një çështje më kritike, për të cilën është diskutuar herët dhe për të cilën përkthyesit, me një marrëveshje të heshtur, kanë vendosur të mos e zbatojnë kodin drejtshkrimor të 1972-it? Çfarë duhet bërë veçanërisht me rregullin 75 dhe 82 të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe? Të ndryshojmë rregullin apo shembujt?

Në këtë studim do të hetojmë kryesisht përkthimet në shqip të Biblës, zgjedhjet gjuhësore që përkthimet (disa botime nuk e shfaqin emrin e përkthyesit/ve) kanë bërë për çështje që lidhen kryesisht me parimin simbolik të drejtshkrimit (parimet dhe rregullat e kapitullit 6 të Drejtshkrimit të shqipes), do ta zgjerojmë hetimin edhe me përkthime nga Kurani (shembuj nga ky tekst) dhe në fund do të bëjmë rekomandime për ndryshime të nevojshme (e të domosdoshme) në rregullat e drejtshkrimit të shqipes.

Përdorimi i shkronjës së madhe lidhet vetëm me sistemin shkrimor të një gjuhe. Nëse rregullat e tjera të drejtshkrimit lidhen me dukuri dhe veçori (dhe problematika) të pasqyrimin të folurit në një sistem shkrimor, rregullat e shkronjës së madhe nuk kanë ndonjë realitet në të folur. Rregullat

synojnë të përcjellin shenjat e një sistemi tjetër (të dytë, pra) në mënyrën e perceptimit të mesazhit gjuhësor. Kështu, nëse rregullat e kapitujve të tjerë lidhen me receptimin edhe vokal të mesazhit prej lexuesit, me përmasën fonike/fonetike të gjuhës, kundërvënia shkronjë e madhe/shkronjë e vogël ka të bëjë me imazhin dhe me interpretimin që vjen prej shkrimit si një imazh për t'u interpretuar (si çdo imazh tjetër: fotografi, ikonë, pikturë, figura gjeometrike, grafikë, simbole matematikore etj.). Prandaj thuhet se shkronja e madhe drejtohet nga një parim tjetër i drejtshkrimit: parimi simbolik. Kjo kundërvënie gjithsesi përcjell një tipar gjuhësor, që lidhet me kuptimin, dhe jo vetëm gramatikor, por edhe me tipologji të tjera të kuptimit, siç do të shohim më poshtë. Por jo vetëm kapitulli i përdorimit të shkronjës së madhe ka të bëjë me një sistem tjetër në Drejtshkrimin e Shqipes. Kështu, nga një përlllogaritje që kam bërë, nga **104** rregullat e drejtshkrimit, **65** rregulla (62.5 %) lidhen me raportin gjuhë (e folur) / shkrim, ndërsa **39** (37.5%) rregullat e tjera nuk kanë lidhje me realitetin e folur të gjuhës (kam numëruar këtu përdorimin e apostrofit; shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes; shkronjat e mëdha; shkrimin e datave dhe ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit).

Në këtë pikëpamje, shkronja e madhe sjell në ligjërimin e shkruar kuptime që shkojnë përtej përmasës fonetike/fonologjike të gjuhës (që në natyrën e vet është e folur). Përdorimi i shkronjës së madhe shënon në teori dy koncepte semantike-gramatikore (i përgjithshëm / i përveçëm dhe i numërueshëm / i panumërueshëm), pra shërben për të krijuar një kundërvënie gramatikore (sistimore), e cila në të folur mund të realizohet me kundërvënien mbaresë e shumësit / mbaresë e njëjësit (*zot / zota / zotërinj*). Folësi mund të zgjedhë ta sjellë në përmasën e folur shkronjën e madhe duke treguar se nuk po i referohet një emri të përveçëm nëse e emfatizon përdorimin në shumës, ose në mënyrë metagjuhësore e përmend shkronjën e madhe me fjalë (*Zot, me Z të madhe, ë?*), siç e bën në disa kultura edhe me thonjëzat (me gjeste).

“Shkronja e madhe përdoret për të dalluar emrat e përveçëm dhe emërtimet e barasvlershme me ta nga emrat e përgjithshëm.”¹ Ky është

¹ Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f. 142.

rregulli 70 (i kapitullit 6), që në fakt ndryshon në tipologji nga rregullat e tjerë, të cilët ndiqen nga shembuj të zbatimit të rregullit. Ky rregull nuk ndiqet nga shembuj, por nga rregulla të tjerë. Në fakt është një parim (“*kriteri bazë*”² e quan Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit, 1972) që i drejton rregullat e gjithë kapitullit. Së bashku me kapitullin 7 (Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, rregulli 96), ky është rasti i veçantë midis gjithë rregullave të drejtshkrimit: kemi një parim të përgjithshëm, që drejton të gjithë rregullat e kapitullit. Këtë parim mund ta vlerësojmë pak më hollësisht.

Në pamje të parë, i formuluar kështu, duket se parimi i vetëm i përdorimit të shkronjës së madhe në shqipe është një çështje thjesht gjuhësore, si e përmendëm më sipër, semantike dhe sintaksore: ndryshimi “*i përveçëm - i përgjithshëm*” në shqip është, më së pari, semantik dhe pastaj, koncepti i “*emërtimeve të barasvlershme*” parakupton identifikimin e ndërtimeve të caktuara sintaksore si të barabarta nga ana funksionale dhe semantike me një emër të përveçëm.

Mirëpo, nëse e shqyrton me kujdes kapitullin, vë re se nuk është i vetmi parim që drejton përdorimin e shkronjës së madhe. Kështu, veçanërisht në emërtimet e institucioneve shtetërore dhe të organizatave shoqërore ndërfutet në përdorimin e shkronjës së madhe edhe një parim jo aq gjuhësor: parimi është simbolik, edhe ky, por parakupton përdorimin e shkronjës së madhe si “shenjë”/simbol, imazh të hierarkisë shtetërore. Kështu kjo shfaqet në Rregullin 74³, me përdorimin e cilësorëve “*më të larta*” dhe më tej në Rregullin 80⁴ me përdorimin e fjalëve “*të shtetit e të partisë*” dhe “*kryesore*”.

Jemi kështu në “zemrën ideologjike” të Rregullave, pra në kapitullin më të përfshirë politikisht dhe më të ideologjizuar, pasqyrë e sistemit kur u

² Po aty, f. 24.

³ “Emërtimet e funksioneve zyrtare e shoqërore **MË TË LARTA**, titujt **MË TË LARTË** të nderit në RPSH dhe emërtimet e urdhrave e të medaljeve shtetërore shkruhen me shkronjë të madhe (të gjitha fjalët që hyjnë në përbërjen e tyre, me përjashtim të nyjave); po kështu veprohet edhe në rastet e ngjashme në kumtimet e në dokumentet zyrtare...” (f. 145)

⁴ “Emërtimet zyrtare (të sotme ose historike) të institucioneve të **SHTETIT E TË PARTISË** të vendit tonë, si edhe emërtimet e organizatave shoqërore e të njëjësive ushtarake **KRYESORE** shkruhen me shkronjë të madhe (me përjashtim të nyjave dhe të fjalëve shërbyese); po kështu veprohet edhe në rastet e ngjashme në kumtimet e në dokumentet zyrtare”

prodhuan këta rregulla. Dhe është e natyrshme. Me këtë kriter tjetër që shtohet, ose “simbolikë e simbolizuar” sipas prof. Remzi Përnaska⁵, shkronja e madhe shërben për të treguar jo vetëm raportin i përgjithshëm / i përveçëm, por njëherazi me këtë edhe konceptin **E AUTORITETIT**, e më tej të **HIERARKISË** së shoqërisë, të organizimit të shtetit dhe të mënyrës se si konceptohet dhe duhet të receiptohet autoriteti. Duke qenë se është kaq i përfshirë në mënyrën e organizimit të botës dhe shoqërisë njerëzore, ai është edhe vetë si kapitull një “shenjë” e kohës se si shihej bota dhe shteti prej autorëve të “Rregullave”, të cilët nga ana e tyre përfaqësonin vetë diktuesit, agjencinë me autoritet gjuhësor.

Le të shohim më konkretisht se si është organizuar i gjithë kapitulli 6, duke e parë si hartë të mënyrës se si është organizuar bota për hartuesit e Rregullave të 1973: në fillim vijmë **a)** njerëzit, identiteti dhe funksionet e tyre (rregulli 71, 72, 73, 74, 75, 85, 86, 87, 91); pastaj **b)** kafshët (rregulli 76); më tej **c)** trupat qiellorë (rregulli 77); **ç)** hapësira, pra toka dhe njësiti e dallueshme gjeografike, d.m.th. aty ku njeriu jeton (rregulli 78, 88, 89, 90); pastaj është **d)** koha, pra ngjarjet historike që i krijon (shenjon) njeriu (rregulli 79, 81, 92); **dh)** institucionet shtetërore (rregulli 80, 81, 84); **e)** festat (rregulli 82); dhe së fundi, **ë)** veprimtaria krijuese e njeriut (rregulli 83) dhe këtu do të përfshij edhe rregullat për shkrimin e shkrimit (rregulli 93, 94, 95).

Pas viteve 90, kapitulli i shkronjës së madhe është reformuar vetiu në një pjesë të konsiderueshme nga masa e madhe e shkruesve profesionalë, ndryshime që i kemi bërë me dije në një kumtim tonin në vitin 2014⁶. Ribotimi i “Rregullave të drejtshkrimit”, nëse do të ndodhë ndonjë ditë (dhe e urojmë), do të sjellë domosdo një redaktim cilësor të këtij kapitulli. Nuk

⁵ Remzi Përnaska, *Përdorimi i shkronjave të mëdha në emërtimet e institucioneve shtetërore dhe të organizatave shoqërore*, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1973, f. 407-415. Kjo “simbolikë e simbolizuar” mbetet gjithsesi sa kohë që shenja e hierarkisë shënohet mes “më të larta” me “më të ulëta” (e cila mungon në tekst, por nënkuptohet. Profesor Përnaska është duke i bërë kritikë një zgjedhjeje që u shmang me rregullat e 1973. Por parimi mbeti gjithsesi. Si edhe T.Toska, Remzi Përnaska – personalitet i gjuhësisë shqiptare, *Shkrimi si një sistem tjetër në konceptin e normës në punimet e prof. Përnaskës*, Rama graf, 2015, f.151-153.

⁶ T.Toska, *Shkronja e madhe: rregullat, propozimet e KNGJSH-së dhe realiteti*, Studime albanologjike 2014/1, Viti XIX, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë 2014.

duhet lënë mënjanë se trysnia e anglishtes ndihet e fortë edhe këtu, sa kohë që ajo përdor dy stile shkrimi me një përhapje tashmë globale (AP Stylebook dhe Chicago Manual of Style) dhe këto dy manuale duhen marrë parasysh në diskutimin për përmirësimin e rregullave në shqip, kryesisht të atyre që lidhen vetëm me shkrimin.

Dhe nga propozimet për ndryshime që janë bërë dhe diskutuar nga Këshilli Ndërademik për shkronjën e madhe, tri duket se janë pranuar pa kundërshti: “...të shkruhen me shkronjë të madhe emrat Allah, Perëndi, Zot, ashtu si në gjuhë të tjera”⁷ dhe “Të shkruhen me shkronjë të madhe emrat e festave fetare: Bajram, Pashkë, Krishtlindje etj.”⁸. Po në këtë listë propozohet “Të shkruhen me shkronjë të madhe emrat e përveçëm të botës fetare dhe të disa ofiqeve...”, këtu përveç emrit të Zotit, janë përfshirë edhe titujt fetarë.

Siç shihet edhe nga ajo pasqyrë e botës që na rrëfen “kapitulli 6” dhe nga propozimet për ndryshim, aspekti i munguar e perceptimit të botës për njeriun e 1972-it është e mbinatyrshmja, ose më mirë hyjnorja, dhe një pjesë e ndryshimeve të pranuar gjerësisht i takuan pikërisht kësaj ane të botës: përdorimi i shkronjës së madhe në emërtimin e hyjnisë, shtimin e ndonjë emri (si Jezu), përdorimi i shkronjës së madhe të festave fetare. Por a mjafton? D.m.th. a i mjaftojnë këto ndryshime të domosdoshme realitetit të ri të pas viteve '90 të përkthimeve të shkrimeve të shenjta dhe të literaturës teologjike dhe komentuese të shumëllojta që është botuar këto vite në Shqipëri?

Synimi i këtij shkrimi është të bëjë një paraqitje të problematikës së shkronjës së madhe në përkthimet e shkrimeve të shenjta (kryesisht Biblës, por edhe të Kuranit) dhe të ndërdyshjeve që shfaqin redaktorët (njëri prej tyre është shkruesi i këtyre radhëve) në marrjen e disa vendimeve gjuhësore-simbolike. Këto vendime lidhen të gjitha me rregullat që përdor gjuha ku përkthehet (shqipja në këtë rast), sa kohë që teksti origjinal ndjek tipologjinë e shkrimit antik, ku mungonin shenjat e pikësimit, hapësirat mes fjalëve dhe patjetër edhe dallimi shkronjë e madhe / shkronjë e vogël (shkronjat në origjinë ishin të gjitha të mëdha dhe shkronja e vogël u shpik më vonë dhe dallimi mes tyre nis e kodifikohet nga shek.16 e 17).

⁷ Propozime për drejtshkrimin 1 (1976-2014), Shkup 2022, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, f.51.

⁸ Propozime për drejtshkrimin 1 (1976-2014), vep.cit., f.61.

Sot nuk besoj se ka ndonjë aspekt të kulturës shqiptare ku po punohet aq shumë sa në sferën e përkthimeve të shkrimit të shenjtë. Bibla ka sot në shqip ka 4 përkthime integrale⁹ dhe është në proces i pesti¹⁰. Të gjitha tekstat integrale janë edhe në variantin e-book, pra ose mund të shkarkohen në pajisjet elektronike, ose mund të këshillohen sa herë është nevoja në rrjet. Ndërkohë Kurani ka sot në shqip të paktën 4 përkthime¹¹, thuajse të gjithë në version elektronik dhe mund të gjenden edhe në internet (madje edhe 2 versione të tjera).

Parimet për përdorimin e shkronjës së madhe dhe që drejtojnë në vendime përkthyesit e shkrimeve të shenjta janë deri diku të njëjta, dhe mbështeten gjerësisht te rregullat e shqipes, por edhe në kundërshtim me to, në disa raste specifike. Një ndër çështjet kryesore me të cilat përballen përkthyesit dhe redaktorët është: fjala (grupi i fjalëve) po shënon një rast të përveçëm,

⁹ 1. Bibla e studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare (ABS), Tiranë, 2009, botimi i parë është i vitit 1994, me titullin Bibla, Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re, Diodati i Ri, përkthimi 1991-94. Përkthimi është bërë nga italishtja, nga përkthimi i rishikuar i gjuhëtarit dhe teologut Giovanni Diodati nga grup autorësh. Ky përkthim përdoret nga kisha ungjillore në Shqipëri. Përkthimi i parë gjendet në këtë uebfaqe <https://my.bible.com/sq/> që ka edhe versione të tjera të përkthimit të Biblës; 2. Shkrimi shenjt: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re, përktheu dhe shtjelloi dom Simon Filipaj, Drita, Ferizaj, 1994. Ky është përkthimi i kishës katolike. Dhe mund të gjendet i plotë në këtë faqe <http://www.bibla.net/?cid=1,1>. Parateksti biblik është Nova Vulgata Bibliorum Sacrorum (versioni i vitit 1979), pra përkthimi, në parim është bërë nga latinishtja, përkthimi i Vulgatës së Re nga Shën Jeronimi. https://www.vatican.va/archive/-bible/nova_vulgata/documents/nova-vulgata_index_lt.html; 3. Bibla: Shkrimi i shenjtë, përkthimi Së Bashku, Tiranë, 2020, botuar nga Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë (Përkthimi gjendet në këtë uebfaqe <https://my.bible.com/sq/>). 4. Shkrimet e Shenjta, përkthimi Bota e re, shtypur në 2007. Ky është teksti që përdorin sot grupi i Dëshmitarëve të Jehovait. Përkthimi është nga parateksti në anglisht i New World Translation of the Holy Scriptures, botim i rishikuar i vitit 1984. Në versionin elektronik mund të gjendet këtu <https://www.jw.org/sq/biblioteke/bibla/>

¹⁰ <https://biblapro.com/> Bibla PRO, ose përkthimi i ri nga origjinali)

¹¹ 1. Kurani i madhërisëm, mbështetur në përkthimin e prof. Hasan I. Nahit, me redaktim gjuhësor të prof.dr. Xhevat Lloshi, Tiranë 2010, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (botimi i shtatë); 2. Kurani i madhërisëm: kuptimet e tij në gjuhën shqipe, sipas përkthimit të Sherif ef. Ahmetit (botim i dytë, janar 2015); 3. Kurani Kerim, përkthim e Komentim nga Muhammad Zakaria Khan, botimi i parë më 1990 në UK. 4. Ndërkohë gjendet në interneti edhe Kurani me përkthim të Feti Mediut dhe 5. i Darus Selamit.

unik, të vetëm në krahasim me një kategori të përgjithshme? A është i kufizuar kuptimi i fjalës vetëm tek një element i veçantë?¹² Duke përdorur edhe rendin e paraqitjes të kapitulli i shkronjës së madhe të Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, është përdorur shkronja e parë të madhe në këto raste:

1) Duke filluar me emrin, emërtimet, titujt e Hyjnisë, Zotit, si titujt në referim të hyjnisë (ndryshe nga rregulli 75), kemi Perëndi, Zot, Frymë, Krisht, Atë, Bir, i Shenjti, dhe të gjithë emrat prejmbiemërorë (mbiemrat e emëruar që i referohen Hyut, Zotit, me përjashtim të nyjave), si i Tejlarti, i Plotfuqishmi, i Madhërishmi, i Vërteti, Përkrähësi, Mbrojtësi, Besniku, Shumë i Lartë etj. Futen këtu edhe emërtimet e përbëra për hyjninë, si Zoti i Ushtrive etj.

Njësoj edhe përkthimet e Kuranit dhe të myslimanët me: *Allahu, Një i e Vetëm, Zoti, Absoluti, Froni Hyjnor, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, i Dijshëm, Gjithëpërfshirës, i Lavdishëm dhe i Lartësuar, Simbolet e Allahut, i Vetëmjaftueshëm* etj. Siç edhe shihet, përdoret shkronja e madhe edhe për gjithë përcaktorët që i referohen Zotit.

Por ndahen të krishterët në përdorimin e emërimit të dy personave të tjerë të Trinisë (në këtë rast me të madhe), që emërtohen me një sintagmë, si *Fryma e Shenjtë/ Shpirti i Shenjtë, Biri i Perëndisë, Biri i Njeriut* etj.

Në këtë kategori përfshihen edhe emra që përdoren gjerësisht në tekst si të përgjithshëm, por që në ndonjë kontekst marrin ngjyrim të veçantë dhe theksohen, dhe shkronja e madhe “shënon karakterin e veçantë të kuptimit të fjalës, solemnitetin, patetiken me të cilën folësi a shkruesi pranon kuptimin sendor e gramatikor të fjalës, desemantizimin e emrave të përgjithshëm dhe kthimin e tyre në të përveçëm”¹³, për të treguar qenien e përveçme, hyjninë, pra, si: *Njeriu* (Gjoni 19:5), *Rrënja, Ylli* (Zb. 22:16), *Emri, Bariu, Providenca, Krijuesi* etj., duke iu referuar këtu edhe rregullit 86.

Një zgjedhje interesante (dhe krejt e veçantë) në shqip (duke ndjekur një përvojë të anglishtes, edhe të italishtes) është përdorimi i shkrimit me të gjitha shkronjat e mëdha (ZOTI) për emrin e Zotit në Dhiatën e Vjetër (Jahvenë/Jehovahun, në Eksodi/Dalja 6:2, p.sh.), emri i Zotit sipas hebrejve, dhe që në përkthimet e ndryshme të gjuhëve moderne është dhënë përgjithësisht thjesht me Zoti (Lord, Dio, Dieu, Eterno, Herr etj.). Përkthimi ABS

¹² Capitalization Rules for English Grammar: An Essential Guide (yourdictionary.com)

¹³ Remzi Përnaska, artikull i cituar, f.409.

dhe Së Bashku, për ta dalluar nga përdorimi i një titulli identifikues për Zotin (ku përdoret vetëm shkronja e parë e madhe) kanë zgjedhur për dallimin në tekst shkrimin e të gjitha shkronjave të mëdha. Duket se sa më shumë shkronja të mëdha të përdoren në tekst, aq më i lartë dhe i rëndësishëm është niveli i qenies që po shënohet.

2) tek emrat e njerëzve, identiteti dhe funksioni i tyre - është përdorur shkronja e madhe për të gjithë emrat e përveçëm, edhe kur pjesë e emrit të përveçëm është një emër a mbiemër i përgjithshëm (Jezus Nazareti, Simon i Zellshmi, Bir i Bubullimës, Thomai Binjaku, Gjon Pagëzori etj.). Titujt *dishepull*, *apostull*, *prift* dhe *kryeprift* janë shkruar me shkronjë të vogël; titulli *mbret* është shkruar me shkronjë të vogël, ndërsa ka luhate me emrin e ndonjë mbretëreshë (Mbretëresha e Shebës/Jugut), edhe për shkak të karakterit të saj unik.

3) Trupat qiellorë, si: yjet, hëna, dielli shkruhen me shkronjë të vogël dhe sigurisht është përdorur shkronja e madhe kur bëhet fjalë për yjësi të dallueshme.

Emrat e vendeve apo sferave specifike gjeo-kozmike me kuptim teologjik, si *Qiejt*, *Qielli*, si referim për sferën e pranisë së Perëndisë, shkruhen me të madhe (megjithëse nuk vihet re në çdo përkthim); por *qiejt* dhe *qielli* do të shkruhen me shkronjë të vogël kur përdoren në kuptim të përgjithshëm, ose më mirë me kuptimin jofetar dhe joteologjik. Po ashtu me shkronjë të madhe do të jenë: *Mbretëria e Perëndisë*, *Mbretëria e Qiellit/ Qiejve*, *Parajsa*, *Ferri*, *Hadesi*, *Sheoli*, *Gehena*, *Gjiri i Abrahamit*, dhe *Jerusalemi i Ri*, si referime të vendeve të përveçme në një realitet të përjetshëm. Gjithashtu në Kuran: *Zjarri (si vendi i gjykimit)*, *Xhehenemi*, *Xheneti*, *Shtëpia e jetës së përtejme*. Në përkthimet e Kuranit kam gjetur të shënuar me shkronjë të madhe pikat e horizontit, Lindja dhe Perëndimi, dhe kam gjetur se ka luhate në shkrimin e Tokës, Diellit (që i kam gjetur edhe me shkronjë të vogël, edhe me të madhe, pa dallime të qarta semantike).

4) Emërtimet gjeografike, të thjeshta dhe të përbëra, janë përdorur me shkronjë të madhe, sipas rregullave. Këtu sfida është sigurisht që ta gjesh njësinë e dallueshme sintaksore, pra kufirin e sintagmës së përveçme (që ka një emërtim të përveçëm) dhe në këtë pikë problematika me shkronjën e

madhe është si në të gjitha rastet e vërejtura deri tani në zbatimin e këtij rregulli edhe për shqipen në përgjithësi.

5) Ngjarjet historike janë shkruar me të madhe dhe duhen shkruar me shkronjë të madhe ngjarje që konsiderohen si historike (që kanë ndodhur në një kohë të përcaktuar) për fenë, si: Krijimi, Ditët e Krijimit, Përmytja, Eksodi etj.

Këtu duhet thënë se në materialet komentuese të tekstit biblik përdoren gjerësisht për shënimin e kohës *para Krishtit* (p.K.) dhe *mbas Krishtit* (m.K.), duke hequr dorë me vullnet nga konceptet *para erës sonë* dhe *pas erës sonë*. Po ashtu janë shkruar me të madhe mbretëritë historike, si *Mbretëria e Veriut* dhe *Mbretëria e Jugut* (në historinë e Izraelit), emërtime figurash historike, kur kanë një mbiemër të përgjithshëm në emërtim, si *Herodi i Madh* (për ta dalluar nga disa mbretër me emrin Herodi), ose edhe ngjarje, po aq historike, që priten të ndodhin në të ardhmen, si *Kthimi i Krishtit* (ose *Adventi*), *Dita e Zotit*, *Dita e Gjykimit*, *Dita e Krishtit*, gjithashtu edhe në Kuran: *Dita e Fundit*, *Dita e Gjykimit*, *Dita (dita) e Kiametit*, *Dita e Llogarisë*, *Ringjallja* etj.

Në këtë pikë, një problematikë ku shfaqet luhatje është emri i ditëve të javës (shabati, dita e përgatitjes/vigjilja) dhe i muajve, si: Adar, Sivan, Tamuz, Abib/Nisan, Elul etj., që janë shkruar në origjinal (në hebraisht dhe në greqisht). Disa përkthime kanë zgjedhur shkronjën e madhe, e dy të tjera shkronjën e vogël.

5) Emrat e festave fetare të të gjitha llojeve, emërtime të thjeshta e të përbëra, edhe të atyre që nuk festohen në Shqipëri, por janë pjesë e botës së shkrimit të shenjtë, shkruhen me të madhe: *Pashkët*, *Dita e Rrëshajave*, por edhe: *Festa e Bukëve pa Maja*, *Festa e Borive*, *Festa e Kushtimit* (të tempullit), *Festa e Kasolleve* (ose e *Tendave*), *Dita e Agjërimit*, *Dita e Shlyerjes* (*Jom Kippur*). Këto emërtime të përbëra të festave me fjalën *ditë* shfaqin luhatje në përkthimet e ndryshme të Biblës etj.

Po ashtu emrat e festave në Kuran, si: *Nata e Kadrit*, *Nata e Caktimit*, *Bajrami i Kurbanit*, *Hàxhi*, *Ramazani*, *Teshriku* etj.

6) Titujt e librave shkruhen me shkronjë të madhe, në radhë të parë *Bibla* e *Kurani* (që të dy të shkruar me të vogla sipas Fjalorit të vitit 1980), si edhe: *Dhiata e Re*, *Dhiata e Vjetër* (ndërkohë që në Fjalorin e 80-ës janë të shkruara edhe këto si *Dhiata e vjetër* dhe *Dhiata e re*), *Besëlidhja e Re*,

Besëlidhja e Vjetër, Shkrimi i Shenjtë, por edhe emra apo emërtime që nënkuptojnë zbulimin shkrimor, si *Ligji, Ligji dhe Profetët, Profetët, Shkrimi, Fjala e Perëndisë* etj. Por në çdo rast tjetër, kur nuk e nënkupton Shkrimin e Shenjtë, do të përdoret shkronja e vogël: *ligji, profetët* etj. Të gjitha fjalët e një titulli apo emërtimi të përbërë, përveç nyjave, do të shkruhen me të madhe, si: *Veprat e Apostujve, Letra Drejtuar Romakëve, Letra e Parë Drejtuar Korintasve (e Para e Korintasve), Libri i Parë i Mbretërve* etj.

7) Megjithëse sipas rregullit 87 përemri *ju* dhe përemrat pronor *i/e juaj, i/e tij* mund të shkruhen me shkronjë të madhe në shenjë nderimi, nuk veprohet kështu në asnjë nga përkthimet e Biblës deri më tani. Ndërkohë që në Kuran, gjithë çfarë lidhet me emrin e Allahut, siç edhe e kemi përmendur më lart, përcaktorë në trajtë emrash, mbiemrash, përemrash (vetorë, pronorë, lidhorë pyetës), gjithë çfarë hyn në rrezën sintaksore e semantike të kësaj fjale, shënohet me shkronjë të madhe.

Si përfundim, një nga letërsitë më të lëvruara në Shqipëri, përkthimet e shkrimeve të shenja dhe literatura teologjike dhe komentuese, janë një terren krejt **i ri**, ku përpiqen të zbatohen e të respektohen sa më shumë parimet dhe rregullat **e vjetra** të përdorimit të shkronjës së madhe. Për shkak të specifikës që këto tekste kanë, të natyrës autoritative dhe solemne të mesazhit që teksti përcjell, shkronja e madhe është një element i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të bërë dallimin mes sferës hyjnore, transcendentale, të përtejme, me tokësoren, nga ana tjetër, njerëzoren, të përditshmen pra mes Huyt, Zotit (autoritetit më të lartë), dhe gjithçkaje tjetër në botë e krijim. Përkthyesit dhe redaktorët janë shpesh me një sy nga kodi ynë i drejtshkrimit dhe me një sy nga rregulla ndërkombëtare dhe/ose të përdorimit të shkronjës së madhe në gjuhët më të lëvruara sot: anglisht, italisht, frëngjisht e gjermanisht, e madje edhe turqisht. Krejtësisht e munguar, madje e deformuar dhe e sulmuar në Rregullat e Drejtshkrimit e më tej në tekstet që e vijuan standardizimin (si Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe), “fetarja” sot kërkon vendin që i takon në instrumentet standardizuese të shqipes zyrtare, të pranohet si një realitet i hapur dhe në ndryshim i lëvrimit të shqipes. Në këtë aspekt të kulturës së shkruar të shqipes kërkohet të merren vendime gjuhësore të qarta, për të shmangur luhatje dhe për të njësuar zgjedhjet gjuhësore të përkthyesve dhe redaktorëve, në mënyrë që mesazhi të shkojë ashtu si duhet te lexuesi i interesuar.

Bibliografi

- Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973
- Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Propozime për drejtshkrimin (1976-2014), vëllimi i parë dhe i dytë, Shkup 2022,
- Remzi Përnaska, *Përdorimi i shkronjave të mëdha në emërtimet e institucioneve shtetërore dhe të organizatave shoqërore*, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1973, f. 407-415
- T. Toska, Shkronja e madhe: rregullat, propozimet e KNGJSH-së dhe realiteti, Studime albanologjike 2014/1, Viti XIX, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë 2014.
- T. Toska, Remzi Përnaska – personalitet i gjuhësisë shqiptare, *Shkrimi si një sistem tjetër në konceptin e normës në punimet e prof. Përnaskës*, Rama graf, 2015, f.151-153.
- English Capitalization Rules: How, When, and Why | YourDictionary
- Bibla e studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare (ABS), Tiranë, 2009, botimi I 1994, *Bibla, Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re, Diodati i Ri*, përkthimi 1991-94 <https://my.bible.com/sq/>
- Shkrimi shenjt: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re, përktheu dhe shtjelloi dom Simon Filipaj, Drita, Ferizaj, 1994 <http://www.bibla.net/?cid=1,1>
- Bibla: Shkrimi i shenjtë, përkthimi Së Bashku, Tiranë, 2020, botuar nga Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë <https://my.bible.com/sq/>
- Shkrimet e Shenjta, përkthimi Bota e re, shtypur në 2007. <https://www.jw.org/sq/biblioteke/bibla/>
- Kurani i madhërishtëm, mbështetur në përkthimin e prof. Hasan I. Nahit, me redaktim gjuhësor të prof.dr. Xhevat Lloshi, Tiranë 2010, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (botimi i shtatë) https://quranenc.com/sq/browse/albanian_nahi
- Kurani i madhërishtëm: kuptimet e tij në gjuhën shqipe, sipas përkthimit të Sherif ef. Ahmetit (botim i dytë, janar 2015); https://www.alukah.net/books/files/book_9572/bookfile/quran_albany.pdf
- Kurani Kerim, përkthim e Komentim nga Muhammad Zakaria Khan, botimi i parë më 1990 në UK. <https://www.alislam.org/quran/Holy-Quran-Albanian.pdf>

Rina ASANI

Vjenë

PRAPASHTESAT -M, -N(Ë), -TË TË PJESORES SË SHQIPES DHE VARIANTET E TYRE

Abstrakt

Sistemi foljor i shqipes, krahas formave të shtjelluara sintetike dhe analitike, ka të përfutur edhe format e pashtjelluara, disa të trashëguara e disa të formuara në zhvillim të brendshëm. Pjesorja, që paraqitet si formë e ngurosor, por që në anën tjetër i ngërthen të dyja, edhe formantet e trashëguara të gjuhës indoevropiane edhe format analitike të krijuara tutje mbi bazën e saj përbën çështje me rëndësi për shqyrtimin diakronik të dukurive të fleksionit foljor dhe paraqitjen e varianteve të tyre sot në lidhje me kategoritë tjera leksiko-gramatikore. Prapashtesat *-m*, *-n(ë)*, *-të* të cilat konsiderohen të trashëguara nga paragjuha indoevropiane, shfaqen në periudhën e dokumentuar të shqipes e më pas i nënshtrohen një kufizimi përmes të cilit mënjanohen duke mbetur në përdorim si elemente përbërëse. Në këtë punim, që synon të analizojë rolin formues të këtyre formanteve, fillimisht do të trajtohen vlerësimet e studiuesve për praninë e participit të dikurshëm të shqipes lidhur me prejardhjen e prapashtesave *-m*, *-n(ë)*, *-të* rrjedhimisht funksionet e tyre në relacion me rrënjën foljore ose jofoljore për të vështuar më pas përdorimin e tyre në të folmet e shqipes së sotme meqenëse qëndrojnë të pranishme në të dy dialektet.

Fjalët kyçe: sistem foljor, pjesore, prapashtesë, formë, zhvillim, temë

Raportet në mes dialekteve e edhe raportet e shqipes me gjuhët tjera janë fushëveprime sfiduese të cilat njëkohësisht e bëjnë shqipen një gjuhë komplekse. Krahas këtyre, kemi shqipen standarde e cila qëndron në mes të gjithë kësaj, si një pikë reference mbi të cilën dashur e padashur nis ose herdokur merr kthesë secila ide sepse 50 vite më parë, krijimi i saj përfaqësonte një kompromis, i cili edhe sot e kësaj dite vlerësohet lart. Favorizimi i njërit dialekt është fakt i pamohueshëm njëjtë sikurse edhe fakti që zhvillimi i shqipes është më intensiv se kurrë. Se cilat janë dimensionet që duhet marrë planifikimi gjuhësor në mënyrë që të ndihmohet edhe përmirësimi i zgjedhjeve me shumë mundësi të gabuara të vendimeve të mëparshme do të diskutojmë ndoshta një herë tjetër, kur dija mbi konceptet e gjuhës lidhur me identitetin që përfshin identitetin e një kombi të tërë të përforcohet e të marrë formën e një propozimi esencial për rastin e shqipes. Megjithatë, le të jetë

ky një hap i parë drejt atij qëllimi. Meqenëse ideja e kombit legjitimohet duke u bazuar mbi folësit e së njëjtës gjuhë atëherë mund të themi që aftësia e gjuhës për të krijuar një unitet është unike dhe prandaj edhe arsyetohet imponimi i një gjuhe të vetme apo në këtë rast i një variant të vetëm të gjuhës, siç është ajo standarde. Këtë e vërteton edhe gatishmëria e plotë e folësve të shqipes në Kosovë për të përdorur shqipen e njësuar letrare pas Kongresit të Drejtshkrimit më 1972 e madje edhe para tij, prapa te Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, më 1968, ku gjeti përkrahje edhe nga fytyrat më të njohura të politikës së asaj kohe. Me gjuhën që shërben si shënues i kulturës, një aspekt që lidh një grup njerëzish së bashku, hulumtimi i standardit preskriptiv dhe empirik (Ismajli, 2003, p. 50) paraqet një mundësi për gjetjen e ndryshimeve brenda gjuhës, në rastin e shqipes brenda dialekteve, gegë e toskë. Gjuha është e komplikuar dhe për të hedhur dritë mbi fenomenet të cilat ajo i zhvillon, krahas gramatikës deskriptive, do të duhet që medoemos të bazohemi në historinë e saj, në të dhënat që ajo ka në përmbajtje për të hulumtuar prapavijën e strukturës gramatikore të saj gjatë zhvillimit historik. Konsiderohet që rikonstruktimi i fazave prehistorike të shqipes të bazohet në sistemin fonologjik të vjetër të dy dialekteve përmes një krahasimi të brendshëm që del i vështirë për shkak të problemeve të pazgjedhura brenda sistemit grafik të shqipes së vjetër (Handbook of Comparative and Historical Indo-European Linguistics, 2018), që ndikojnë që edhe shqyrtimet diakronike të mos sjellin sqarime të plota. Prandaj bazë e idesë së zhvillimit të këtij punimi janë leximet e autorëve si B. Bokshi, R. Ismajli, W. Fiedler, H. Pedersen, F. Bopp, V. Friedman, W. Cimochoowski, B. Joseph e shumë të tjerë të cilët dhanë ide mbi sistemin verbal të shqipes krahasuar me atë indoevropian apo më konkretisht për format e pashtjelluara të foljes, sepse si çdo gjuhë tjetër, edhe shqipja gjatë evolucionit ka zhvilluar forma foljore. Këto zhvillime të sistemit verbal, e në veçanti paskajorja e tipit me punue përbën njërin nga tiparet dalluese në mes të dy dialekteve të shqipes. Kjo paskajore ndeshet në shqipen e dokumentuar në të folmet veriore dhe kërkon sqarim se përse është zhvilluar e përse ka mbetur e përdorshme në dialektin gegë deri në ditët e sotme pa lënë gjurmë në dialektin tjetër. E formuar me parafjalën *me* dhe pjesoren, që konsiderohet të jetë e trashëguar nga një fazë e hershme e gjuhës indoevropiane dhe që do të përbëjë bazën e këtij punimi.

Pjesorja apo në lat. participium, i cili tashmë konsiderohet term i përgjithshëm i saj (eng. participle) shpjegon një veprim dhe është pjesë e paradigmes foljore. Sot mund të themi që është ajo formë gramatikore që pëdoret edhe me vlerë foljore edhe me vlerë mbiemërore. Një definicion nga Lowe, i cili qe nisur nga situatë e sanskritishtes së Rigveda, përshkruan situatën e participit e përgjithshëm indoevropian:

“Këto janë dy kushtet e mjaftueshme dhe të nevojshme për të emërtuar një formë si një pjesore: karakteri morfologjik mbiemëror dhe dedikimi kategorik ndaj sistemit foljor, në kuptimin e të qënurit një pjesë lakuese e sistemit foljor (për dallim nga të qënurit i lidhur vetëm burimisht me sistemin verbal).

Ky parim mund të zbatohet edhe në shqipen. Emrat të cilët tregojnë objekte duke u përdorur si referencë, mbiemrat që u referohen vetive dhe foljet që u referohen veprimeve janë të trija kategori prototipike. Në mes të këtyre kategorive kemi pjesoren e cila përdoret për të treguar veprime, por edhe modifikon emrin morfologjikisht, rrjedhimisht nuk mund të ekzistojë jashtë sistemeve emërore e mbiemërore dhe do të jetë gjithmonë e kufizuar nga ato. Ato nuk tregojnë motive të cilat janë specifike të tyre dhe të cilat tanimë nuk u përkasin foljeve apo mbiemrave. Në shqipen e sotme ka formë të ngurosur formë foljore sintetike, duke u shfaqur si plotës i një foljeje tjetër shemb.: fal: kam falur apo zgjedh: për të zgjedhur. Pjesorja e shqipes, që formon edhe format e pashtjelluara, është particip i së shkuarës dhe në gegërishten e autorëve të shek. 16 ajo del e formuar me formantet *-m(ë), -n(ë) dhe -t(ë). Në anën tjetër, në mënyrë standarde propozohet se prapashitesat pjesore apo të ngjashme me pjesoren që janë rindërtuar në proto-indo-evropianishte janë po të njëjtat pra <PIE *-nó- për -në e shqipes, <PIE *-tó për -të dhe <PIE *-mhno-? (Klein, 2018). Këto formante janë specifikuar në thelb për diatezën, ku si më të diskutuarat i gjejmë diatezën aktive e cila tregon se pjesëmarrja që rezulton është e orientuar nga subjekti dhe e lidhur me funksionet active, kurse mesa do të thotë se është e lidhur me funksionet mediopasive e e orientuar nga tema, rrjedhimisht që forma e saj orientohet nga objekti dhe është pasive. Formanti *-(e)nt- formonte të tashmen dhe aoristin aktiv, shembull Lat. *ferēns*<*-ent-s,-ent ‘duke bartur’, *iēns* ‘duke shkuar’. Goth. *bairands* (Beeks, 2011, p. 279). Formanti *-mhIno- krijon medio-participin. Arm. *Anasun* ‘kafshë’=‘pa folur’, -un<

*omnós kurse formanti *-to është më spikaturi në mbiemra, i ngjitur për rrënjën e foljes të gradës zero. Lat. tentus ‘i zgjatur’ <*m-to-* (Beeks, 2011, p. 280). Me shumë rëndësi është edhe vështrimi i përdorimit të formanteve të participit në gjuhët indoevropiane, në mënyrë që të kemi një pamje më të qartë për situatën e shqipes. Për të dhënë një prapavijë historike të formanteve të pjesores në gjuhët ie. dhe meqenëse njohja e këtyre gjuhëve për mua është ende superficiale për të mbledhur të dhëna nga korpuset direkt, i jam referuar literaturës. Sa i përket indishtes së vjetër, vërejmë formantet *-ant/-atand -māna* ose *-āna* të pjesores të së tashmes së vazhdueshme apo aktive që mund të formohen për secilën rrënjë foljore duke qenë si rrjedhim pjesë e paradigëmës verbale (MacDonell, 1927), për të vazhduar më pas me latinishten e cila konsiderohet si gjuha atike më mirë e studiuar dhe përshkruar. Latinishtja ka një sistem verbal më pak kompleks se indishtja, ku participi i së tashmes së vazhdueshme, siç përmendëm më lart, krijohet me mbaresën *-ent* dhe të së shkuarës pasive me mbaresën *-ūrus*, shembull me foljen *audīre* “dëgjoj” krijohen *audiēns, auditus, dhe auditūrus* (Weiss, 2009, pp. 436-443). Sllavishtja e vjetër kishtare në anën tjetër ka një sistem të zhvilluar të pjesores, me pjesore aktive në të tashmen e të shkuarën, pjesore pasive në të tashmen e të shkuarën si dhe gjurmë të saj në të ardhmen (Vaillant, 1977, pp. vol. 3, 111). Pra, vlerësimi i studiuësve është se formantet e pjesores së shqipes rrjedhin nga formantet e gjuhës proto-indo-evropiane ***meno**, ***no** dhe ***to** që nga mbiemrat prefoljorë u bënë shënueset të participit pasiv të perfektit me kuptim pasiv si invariante me numër të kufizuar (Bokshi, 1998, p. 15). Kur diskutohet për vjetërsinë e formanteve disa e kanë konsideruar formantin *-nē* si më të vjetrin, kurse të tjerët formantin *-mē* nga prapashtesa mediopasive. Në shqipe formantin ***-nē** nga ie. ***no** e gjejmë të pranishëm në të folmen e Rrafshit të Dukagjinit, Drenicës e Moravës së Epërme (Bokshi, 1998, p. 45) i zhlyne – e zhlyne, i lan – e lane, në funksion mbiemëror, krahas kësaj edhe formanti *-ën* i cili shfaqet në të folmet mbiemri i nyjshëm i së cilave del me prapashtesën *-n*: i dekën, i ftofën, i lagën etj. (Bokshi, 1998, p. 46). Prapashtesën *-m* nga ***meno/-mo** e vërejmë te autorët e vjetër bam (Buzuku) apo shërbyem (Bogdani), formant i cili sot ruhet në mbiemrat e nyjshëm prejpjesorë, mbi temën foljore të tyre si *pi* – i pim. Meqë përmendëm foljen *pi*, rasti i saj ndihmon të tregojë situatën e kuptimit pësor, të cilin kjo folje e merr duke

qenë folje kalimtare, pra e orientuar nga objekti, që e përtafron pjesoren e shqipes me atë të gjuhëve ie. Këto dy praprashtesa, -më dhe -në, siç vëren Bokshi e përjashtojnë njëra-tjetrën, duke qenë praprashtesa participesh të ndryshme që nga fillimi, me -në si formantin që vazhdon të jetë përfaqësim i pjesores pësore të së kryerës, e cila duke qëndruar pranë -m e nxorri gradualisht nga përdorimi. Formantin -të nga ie. *-to e gjejmë të pranishëm brenda mbiemrave të nyjshëm si i shprishhtë, i ratë, i kalbëtë, me aftësinë për të formuar mbiemra prejfoljorë. Këta mbiemra vërtetojnë se objekti ka pësuar një veprim të cilin e realizojnë si cilësi, duke shënuar rrjedhimisht edhe kohën e kryer të veprimit të pësuar si pjesore. Funksioni dhe zhvillimi i sistemit të participit edhe pse nuk jep asnjëherë një përgjigje të drejtpërdrejtë për përputhmërinë e tij me atë të gjuhës pasur parasysh vështirësinë e rikonstruktimit sintaksor, duke qenë pjesë përbërëse e një forme foljore si paskajorja e cila që përftuar në fazat e hershme të gjuhës, përbën një pistë sa të komplikuar, po aq edhe të rëndësishme për shqipen. Pasur parasysh që zhvillimi i vazhdueshëm i pjesores ka marrë me vete edhe zhvillimin e paskajores, si temë foljore e infinitivit, kjo formë foljore na del si një supine e latinishtes (lat. supinium) që konsiderohet si një nga format e vjetra foljore.

Përfundime

Diskutimi i pjesores e infinitivit të shqipes në aspektin historik-dia-kronik nuk është i thjeshtë. Humbja e infinitivit me+pjesore në toskërishte erdhi për shkak të zëvendësimit të saj nga fjalia lidhore me të gjitha funksionet, duke krijuar trajtën për të+pjesore si paskajore me funksione të kufizuara sintaksore (Bokshi, 1998, p. 165). Në anën tjetër studiues si Joseph humbjen e infinitivit e shohin si dukuri bazë të gjuhëve ballkanike duke e konsideruar si të qëndrueshme mundësinë e kthimit të infinitivit në përdorim (Joseph, 1983, p. 91). Kjo temë përbën një pistë që shpërfaq edhe përjasjen gjuhësore, por edhe atë sociolinguistike të problemit. Paskajorja gegë është bërë tanimë mjet identifikues i folësve të shqipes që kërkojnë rishikimin e standardit, por në anën tjetër, ofron edhe një enigmë gjuhësore që meriton të tentohet të zgjidhet. Pjesorja e shqipes, përbën hapin e parë drejt hulumtimit të kësaj enigme, që na dërgon në fazën e lashtë të rrjedhjes apo jo të

formanteve te participit të gjuhës së lashtë indoevropiane dhe kushedi, drejt përgjigjes se a mund të kthejë dialekti toskë tiparin nga i cili dialekti gegë nuk hoqi dorë asnjëherë.

Bibliografia

- Beeks, R. S., 2011. *Comparative Indo-European Linguistics: An Introduction*. s.l.:John Benjamins B.V
- Bokshi, B., 1998. *Pjesorja e shqipes - Vështrim diakronik*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.
- Ismajli, R., 2003. *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*. Pejë: Dukagjini.
- Joseph, B. D., 1983. *The Synchrony and Diachrony of the Balkan Infinitive*. New York: Cambridge Studies.
- Klein, J., Joseph B.D, Fritz. M. 2018. *Handbook of Comparative and Historical Indo-European Linguistics*. Berlin/Boston: Walter de Gruyter GmbH.
- MacDonell, A. A., 1927. *A Sanskrit Grammar for Students*. s.l.:Oxford University Press.
- Vaillant, A., 1977. *Grammaire Comparée des Langues Slaves*. s.l.:s.n.
- Weiss, M. L., 2009. *Outline of the Historical and Comparative Grammar of Latin*. New York: Beach Stave Press.

SHQIPJA STANDARDE SOT
Konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit

Prishtinë, 17 nëntor 2022

Përgatiti për botim: Akademik Rexhep Ismajli

2023

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:

ASHAK

Madhësia: 26 tabakë shtypi

Tirazhi: 300 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

811.18(496.51)(062)

821.18(496.51)(062)

Shqipja standarde sot = Standard Albanian today : konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit : scholarly conference on the occasion of the 50th anniversary of the Orthography Congress / përgatiti për botim Rexhep Ismajli. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2023. - 411 f. : ilustr. 24 cm. - (Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë)

1. Ismajli, Rexhep

ISBN 978-9951-26-068-8